Bashkimi i Krijesve Shqiptarë në Mal të Zi

DIJA

DIJA

Revistë vjetore për
shkencë, kulturë, art
nr. 6/2008, viti VI

Kryeredaktor
Hajro Ulqinaku

Redaksia
Pof. Dr. Simë Dobreci
Prof. Dr. Maksut Haxhibrahimi
Dr. Lukë Gjokaj
Dr. Bahri Brisku
Dr. Hajrullah Koliqi
Dr Nail Draga
Mr. Riza Rexha
Muhamet Nika
Dr. Gani Karamanaga

Koordinator dhe redaktor teknik
Gazmend Çitaku

Shtypin e këtij numëri e sponzoroi z. Fuad Nimani, ministër i Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe popujve pakicë të Qeverisë së Malit të Zi

E boton
BASHKIMI I KRIJUESVE SHQIPTARË NË MAL TË ZI
ULQIN

PËRMBAJTJA

Editoriale

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, mr. Riza Rexha.....9

LETËRSI

MIGJENI, POEZI DHE PROZA
Të lindet njeriu.....13
Kangët e pakëndueme.....14
Nji natë pa gjumë.....15
Vetëvrasja e trumcakut.....16
Puthja e cubit.....17
M'at anë gardhit asgja të re.....19
Parle
Nonda BULKA
Mujo Ulqinaku.....21
LETËRSI E BUKUR SHQIPE PËR FËMIJË E TË RINJ
Esad MEKULI
Pa titull.....24
Porosija e nanës.....25
Nol BERISHA
Kushtrimi i bulkthit.....26
Legjenda e Vaut.....27
Rexhep QOSJA
Hirmadhja.....28
Hajro ULQINAKU
Panorama e detit.....38
Kur ta humbësh udhën, Marta.....39
Ali LLUNJI
Në kalimere.....41
Idriz ULAJ
Është i mirë ky telefon.....45
Zuvdija HOXHIQI - BERISHA
Përkundër kufirit të ruajtur mirë - ikjet.....46
Ali M. AHMETI
Llamba.....48
Asllan BISHA
Në pellgun e lumit.....49

Ibrahim BERJASHI
Mallëngjimi.....52
Muzafer ÇAUSHI
Amir S. në ganxhat e kojshive.....55
Zef SKIRO DI MAGJO
ME TË VËRTETË MOREA
Mejtim.....65
Fli.....66
Më para se të ngryset.....66
Mbrojtja.....67
Vetmia e ishujve.....68
Drama e ikjeve.....69
Duhej të kishim.....71
Për Kosovën.....71
Ullirit tim detar.....71
Lexim 72
Rrudha 72
Detar i vjetër.....73
Kosova lule.....73
Poetit Ali Podrimja.....74
Kllapa katrore.....74
Vjersha të Lipit tim.....75
Jeronim de Radës.....76
Vende - ikje.....76
Tash njoh frymën e erëravet.....77
Kërkon detin.....77
Qytetërim mundësor.....78
Martesa.....78
Me të vërtetë Morea.....79
Më i njohuri poet arbëresh.....79
Dy fjalë për Ulqinin e kalimereve 80

STUDIME

Prof. dr. Dhimiter PILIKA
Shqiptarët - Pellazgët 85
Xhoana PERKAJ
Mbi etimologjinë e toponimit *rudinë*.....93
Dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI
Emrat e anijeve të flotës detare ulqinake.....100

Shefkije ISLAMAJ
Konsulta Gjuhësore 1968 -
marrëveshje për njësimin gjuhësor.....106

LEKSIKOGRAFI

Idriz ULAJ
Fjalë të rralla nga krahina e Plavës dhe e Gucisë.....123

HISTORI

Mr. Riza REXHA
Lidhja Shqiptare e Prizrenit.....145
Mr. Enver BATIU
Besëlidhja e madhe që sfidoi kohën.....165
Nezir ÇITAKU
Lidhja Shqiptare e Prizrenit 170
Gazmend ÇITAKU
Grindjet rreth Ulqinit.....179

VËSHTRIME

Fatbardha HOXHA
Magjia poetike e Ndre Mjedës 187
Mr. Haxhi SHABANI
Rrënjët dhe degët e një letërsie.....195
Sahibe HOXHA
Letërsia për fëmijë e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi.....199
Namik SELMANI
Libri për qytetin e detit 211

BOTIME

TAKIM SHKENCOR NË SHKODËR 217
Tefë TOPALLI - Mimoza PRIKU
"Deti dhe detarët në letërsinë popullore shqiptare.....219
Nertila LJARJA
Një punim i tërësishëm, në të gjitha aspektet.....222
Ledri KURTI
Poetët për Ulqinin – Ulqin, ti det.....224

MJEKËSI

Zylfije DURAKU
Lindjet në Maternitetin e Ulqinit.....229
Selami SYLEJMANI
Sëmundjet e gjirit.....239

ETNOGRAFI

Dr. Maksut HAXHIBRAHIMI
Mbi piratin Ali Uruç Ulqinakun dhe gruan e tij Sulltanije.....267
Sami MISHERRI
Ushejza 274

ARKITEKTURË

Mentor LLUNJI
Arkitektura sizmike.....285

ARTIKUJ

Dr. Nail DRAGA
Pabarazia gjuhësore e shqiptarëve në Mal të Zi.....297

SHTOJCË

Azem HAJDINI – XANI
Nga Prizreni në Istri – një sprovë për histori.....307

Fac sapias et liber eries
(Bëju i ditur që të jesh i lirë)

Latine

Vetëm dritë e diturisë përpara do të na shpjerë

Naim Frashëri

EDITORIALE

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

U mbushën plot 130-vjet nga dita kur në Prizren u themelua Lidhja Shqiptare, që përfaqëson një nga ngjarjet më të shquara të historisë kombëtare shqiptare. Ajo u krijua në situata shumë të ndërlikuara e kritike, ku shtrohej çështja e mbrojtjes së të drejtave të ligjshme të kombit shqiptar, që ishin marrë nëpër këmbë e shkeleshin në mënyrë të egër nga sunduesit osmanlinj, ku Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe monarkitë e Ballkanit po kurdisnin plane të errëta për grabitjen e tokave shqiptare. Lidhja Shqiptare që u themelua në Prizren më 10 qershor, 1878, u krijua për të përballuar ato situata. Pjesëmarrja në të e përfaqësuesve të të gjitha krahinave të ndryshme të vendit dhe mbështetja e fuqishme që i dhanë asaj të gjitha shtresat shoqërore, fshatarët, malësorët, vegjëlia qytetare, dëshmonte se me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit kishte ndodhur një ngjarje tepër e rëndësishme historike. Në krye të saj u vu atdhetari Abdyl Frashëri, ideologu i shquar i lëvizjes kombëtare shqiptare dhe luftëtar për të drejtat e popullit shqiptar dhe gëzonte besim të madh në popull si mbrojtës i interesave të larta të kombit.

Me themelimin e Lidhjes Shqiptare në Prizren, përfaqësuesit e kombit, të mbledhur në këtë qytet të lashtë shqiptar të Kosovës, shpallën vendosmërinë e tyre për të luftuar për të drejtat e veta kombëtare dhe i vunë themelet asaj organizate politike me platformë ideologjike kombëtare,

me program të përcaktuar politik të qartë, me organizimin shtetëror në shkallë kombëtare, me ushtri dhe aparat propagandistik kulturor.
Kanë kaluar 130 vjet nga dita e themelimit të saj. Koha, ky gjykues objektiv i historisë, ruan si një thesar të çmuar e përjetëson ato figura dhe ato lëvizje që i kanë pasur rrënjët në popull e që kanë shprehur e realizuar aspiratat e tij. Tradita popullore edhe pas 130 vjetëve vazhdon t'i ruajë një vend nderi Lidhjes së Prizrenit, duke dhënë dhe vlerësimin për meritat dhe përgjegjësitë historike të njerëzve të asaj epoke.
Duke përkujtuar 130-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e kësaj faqeje të ndritur të historisë kombëtare, ne përkujtojmë me respekt e nderim të thellë heroizmat e sakrificat e të gjithë atyre që për çështjen kombëtare nuk kursyen asgjë dhe që në situata shumë të vështira e të komplikuara luftuan me trimëri të rrallë, me pushkë, me penë e me çka mundën për atdheun e vet. Nderojmë me mirënjohje kujtimin e udhëheqësve të shquar që dolën nga gjiri i popullit shqiptar të vogël në numër por të madh në trimëri, burrëri e mençuri. Ata do të mbesin brez pas brezi shembull i madh i atdhedashurisë e devotshmërisë për popullin e vendin e tyre, i luftës për çlirim e unitet kombëtar, i tregojnë botës vitalitetin dhe trimërinë e popullit shqiptar, vendosmërinë për të jetuar i lirë e i pavarur.
Me krenari e mirënjohje, këtë përvjetor e prêt dhe e përkujton mbarë populli shqiptar, kudo ku tingëllon fjala e gjuhës së lashtë shqipe, sepse trashëgimi i madh i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është pasuri e përbashkët e një kombi të tërë, pavarësisht nga ndarjet në vende të ndryshme.

Mr. Riza Rexha

LETËRSI

POEZI DHE PROZA

MIGJENI

TË LINDET NJERIU

Të lindet nji njeri
nga gjin' i dheut tonë të rim me lotë të vakët,
nga thalb' i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të flakët
për nji gen të ri –
Të lindet nji njeri!
Pa hyll në ball – por që me fjalë të pushton,
që të rrëmben qetsin e ban gjaku të vlojë
rrkajë, e ban synin ligshtin' ta zhgjetojë,
që nëpër shekuj ndërgjegjen ta tradhton.
Të dali nji njeri!
Të mëkambi nji Kohë të Re!
Të krijojë nji Epope!
Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re...
- Të gjithë kombet po dehen n'epopea të veta,
flakë e zjarmit të tyne na i përzhiti ftyrat
dhe nepër to nji nga nji po shtohen rudhat,
e nën kambë e mbi krye tinzë po na hikë jeta.
(Liri! – Po, liri edhe gaforrja gëzon,
por, gaforre asht...
Liri, ku plogsi ndërgjegje gjallon,
jo, liri nuk asht!)
Të lindet nji njeri
i math si madhni

dhe ndërgjegjet tona t’i ndezi në dashni
për nji ide të re, ideal bujar,
për nji agim të lum e të drejtë kombtar.

KANGËT E PAKËNDUEME

Thellë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme
të cilat ende vuejtja as gëzimi s’i nxorri,
të cilat flejnë e presin nji ditë ma t ’lumnueme
me shpërthye, m’u këndue pa frigë e pa zori.

Thellë në veten teme kangët e mia jesin...
e unë jam vullkani që fle i fashitun,
por kur t’i vijë dita të gjitha ka me i qitun
në njimijë ngjyra të bukra që nuk vdesin.

Por a do të vijë dita kangët me u zgjue?
Apo ndoshta shekujt me ne prapë po tallen?
Jo! Jo! Se liria filloi me lulzue
dhe e ndjej nga Dielli (alegorik) valën.

O kangët që fleni reliktet e mija
q’ende s’keni prekun as nji zemër të huej,
vetëm unë me ju po kënaqem si fëmija
unë – djepi i juej, ndoshta vorr’i juej.

NJI NATË PA GJUMË

A. SH.

Pak Ditë! Pak dritë! Pak dritë, o shok,o vlla!
Të lutem pak dritë në këtë natë kur shpirti vuen,
Kur të dhemb e s’ di ç’të dhemb, e syni gjumë nuk ka,
Urren, nuk din ç’urren, don e s’din ç’don.

Pak dritë! O burrë! O hero! nga do që të jesh!..
Burrë që shkatrron edhe që ndërton së rish!
Pak dritë vetëm, të lutem mshirë të keshë
Se do të çmendem në këtë natë pa gjumë dhe pa pishë.

Oh! ta kishe pishën të madhe edhe të ndezun!
Me flakën e pishës në qiellin e kësaj nate
Ta shkruejshe kushtrimin... Ehu, Burrë i tretun!
Do ta shifsha vallen tande në meje të nji shpate!

Por pishë nuk kam e vetëm janë burrat, shokët...
Dirgjem n’errsinë pa gjumë dhe pa dritë...
Askush s’më ndigjon, çirrem kot më kot...
Hesht more, hesht! por qindro o shpirt!

Gjeli këndon dhe thotë se asht afër dita,
Gjel rren a s’rren? cila asht fjala jote?
Kur ti këndon thonë se asht afër drita...
Por un s’besoj sonte në fjalët e ksaj bote.

Hiqmuni qafet mendime!
O jastek, ty të rroki, të përqafoj si shpëtimin,
Me fjalë ate që due: gjumin dhe andrrimin
E dy buzvet që pështpërisin ngushllimin.

VETËVRASJA E TRUMCAKUT

Dhe trumcaku vunte nga melankolija. U lind në nji vend me të vërtetë të shkretë. Në vend të barit bijshin qimet e derrit e në vend të pemëvet – brenat e një shtazës parahistorike. Dhe në këtë natyrë – e cila nuk mund të quhet natyrë – kush të mos bahet melankolik? Dihet se nji trumcakut s'i duhet shumë për jetë – por natyra, e cila ishte natyrë,s'i epte as aq.

Mos pyetni si e tek u gjet trumcaku n'at vend, dhe si e tek u gjet njeriu në këtë pikë kosmike – nuk dimë shumë. Hypotheza dhe andrra. Miljuna vjetësh dhe një fjalë goje, si për shembull: "... të bahewt dritë! Dhe drita u ba!" / A shihni? Nji fjalë magjike! Hokus – pokus! Sa bukur!

Dhe unë thashë: të bindet trumcaku në nji vend ku në vend të barit bijnë qimet e derrit, e në vend të pemvet – brenat e nji shtazes parahistorike.

Nji herë trumcaku qëndroi mbiu nji brenë. U mërzit të shikojë qimet e derrit, u mërzit të fluturojë prej brenës mbi brenë. Nga mërzija dhe idhnimi mbylli syt. Ra në pikllim melankolik. Njeriu me temperament melankolik asht inteligjent, dhe trumcaku me temperament melankolik asht inteligjent. E inteligjenca në kuptim ma të hapët të fjalës, pak kuj i solli qetsi të mirë.

Dhe trumcaku, në maje të brenës e në kulm të melankolis, vendosi të vritet. Plot ironi filosofike shikonte rreth përqark vehtes e vendimi i patundun mirfilli pasqyrohej ndër sytë e tij të dëshpruem. Cicrroi nji herë, cicrroi dy herë; cicrroi tri herë. Mandej nji cërrr e gjatë e plot mallëngjim ishte porosija e tij e fundit. Testamenti i dhimave të tija. Dhe, pa u dhanë krahëve, këcej prej brenës... ra mbi nji qime të derrit, të gjatë e të mprehtë si thika, dhe u ngul mbi te.

Trumcaku i ngulun mbi nji qime të derrit. Me krahët dhe puplat e tija lonte era dhe e sjellte rreth qimes, si sillet dhe gjeli metalik në maje t'oxhaqeve tona. Atbotë frynte veri.

Çka janë këto kapërcime logjike!? Po! A pak po kemi kapërcime logjike, morale dhe dogmatike në botën tonë reale? Pse po zemrohe dhe po don me më gjykue për disa kapërcime logjike askuj damsjellse?

PUTHJA E CUBIT

Edhe nji prendverë ka ardhë. Prendvera e 17-të për Dilen, e cila e shtrime në bar ndjeu se ka tamam, as ma pak as ma tepër se 17 vjet.

- Nano! sa vjet kam? - pyeti nanën në shtëpi.

- Tashti i mbushë 17 bijo! – i tha nana me nji dorë n'ijë e me tjetrën mbi sy, m'u mprojtë nga rrezet e diellit.

Edhe Dila, e shtrime në bar, ndjeu se ka tamam 17 vjet. Ashtu e shtrime, shikon qiellin e kaltërt dhe ndigjon cingaret, nji të dashit të grigjës ma e hollë, dhe tjetra e lopës me za ma të trash. Çohet herë herë e shikon bagtinë dhe prap shtrihet, me nji deshirë të vokët në gji. Sa fort Dila që i ndjen të 17 vjetat në vete! Kur në të kapërthyemit e dëshirës, ven shplakët nën krye dhe ma fort shtgrihet, ndjen si ndër veshë dhe nder tamtha i rreh gjaku me rrjedhje të forta dhe e ban me ndie edhe me dishirue ma tepër. Atëhere Dila mbyllë sytë. Ashtu me sy mbyllë pret diçka. Buzët e saja të lagta e të çeluna për gjysë i terte flladi i lehtë...

* * *

Para kësaj prendvere bani nji dimën acar. Bora që tashti shifet si kunorë vetëm nder bjeshkët e nalta, në dimën kish mbulue mbarë tokën. E stuhija e tmerrshme s'kish lanë pa e futë borën deri në shpella mali dhe zgavrriqe drujsh. Në këtë acarim dimni dhe bishët e malit zbritën nëpër katunde, te njerzit, por kta nuk i priten mirë.

Bashk me bishët e malit zbriti edhe Cubi, i cili ishte tmera për ata që kishin ndigjue për te e që nuk e njifshin. Në besë, në buk' e krypë, i ati i Dilës e mbajti Cubin si mik. Dhe gjatë nji mueji sa ndenji Cubi në shtëpi të saj, Dilës i u ba se ky Cub nuk asht ai Cub për të cilin flitshin se vret, grabit, përdhunon. Me të vërtetë po at emen e kishte, por jo, nuk ishte ai. Cubi mik njizetekatër vjeçar i buzqeshej nana, i buzqeshej Prenda, e shoqja e re e vllaut, baba i fliste me za të butë, e vllau këndonte me te. Cubi-mik ishte i mirë dhe të gjithë e nderojshin. Dila kanjiherë me dashje dhe pa dashje e shikonte në sy dhe kuqej, kanjiherë me dashje e pa dashje, tue bamë punë nëpër shtëpi, në të kaluem e prekte me krah dhe nga ajo prekje i u rritshin gjitë.

As nga aremët e tija, rrypat me fyshekë, pushka dhe revolja, nga të gjitha këto Dila s'kish frigë. Nji ndjesi e fshehtë rritej në zemrën e Dilës dhe sa ma shum ditë kalojshin aq ma e madhe bahej. Dhe ndiesija u ba dëshirë, dëshirë që të len pa gjumë.

Por nji ditë, kur dielli sa nji pare e madhe sermi u çfaq në qiell, Cubi shkoi. E Dila mbet vetëm me dashurinë për Cubin.

Asht e flakët dëshira e Dilës në nji ditë të shkëlqyeshme prendvere kur e shtrime në bar ndjen se si i rreh gjaku ndër dej. Asht edhe ma e flakët dëshira e Dilës kur i ka sytë e mbyllun e me andrrim vezullues don me krijue ate së s'ka. S'la... Nuk e pa ma Cubin. E 17 prendvera të saja janë 17 thirrje të nxehta të heshtuna drejtue Cubit.

* * *

Ashtu e shtrime dhe n'andrrim, Dila nuk desht t'i çeli syt edhe se ndjeu mbi trupin e vet nji peshë dhe të dihatunit e nji mashkulli e mbi buzët e veta të përvlueme nji njomsi. S'i çeli syt. Ndoshta kish frigë të mos prish ekstazen në të cilën kishte ramë... E kur ndjeu lehtsimin e trupit i çeli sytë. Por aty s'pa kend. U hodh në kambë. S'ish kush. Shikoi për qark. Vetëm që pau djathtas në bar gjurma njeriu që vazhdojshin mbi bar nga ana e majtë. Dila u drodh. !Ai asht! - tha – Cubi!" dhe u vue në ndjekje të gjurmës majtas. Si e dehun, n'ekstazë, ecte Dila, vazhdoi dhe pa gjurmë dhe njithnji n'ekstazë... La grigjen, as që i binte ndër mend, pse kërkonte Cubin. Doli në rranxë të malit shkambuer. E thirri me emën, por bashkë me kambët e saja që përplaseshin prej shkambit në shkamb, q'ashtu dhe thirrjet e saja u përplasëshin – kot.

Kur erdh muzgu i mbramjes nepër livadhe dhe nepër shkambijt ndigjoheshinb thirrjet plot idhnim dhe dhimbje:

"Dilooo! Dilooo! Dilooo!

M’AT ANË GARDHIT ASGJA TË RE

Nji vransinë si plumbi pushonte mbi qytetin gjithë ditën. Jeta zhvillohej ngathtë, disi xvarrisej. Gjithët e para të vjeshtës këputeshin nga dega, zig-zag e bajshin udhen nëpr ajr e sa përkitëshin tokën si me thanë: qe, këtu asht vend i ynë. Por, aty para muzgut, pa-pritë, fryni nji erë e rrepët. U shkrepen xhamat nder dritore dhe dyertë e nji lagjes mbarë; gjethët si të tërbueme fluturojshin në të gjitha anët, deri sa ma në fund nuk u qetsojshin në nji qoshe. E n’oborr, mbas shtëpis së Selim Mesit teshat e lame, që gjithë ditën shtrie nuk u teren, Tashti filluen të valaviten të rrahen, të fluturojnë, të shkrahen nepër tokë bashkë me gjethe. Nji grue e re tue nga e tue ba poterë të madhe me ndalla, del jashtë e mbas saj, nga-dalë, nji plakë. Shpeejt fillojnë me mbledh teshat. Kur e reja, tue mbledh teshat, mbrrinë te gardhi që ndanë dy oboret e dy shtëpijavet, ndahet, veshtron m’at anë gardhit nji copë herë, e kur mbrrrinë plaka i thotë me za t’ultë: s’ndëgjohet gja!... dhe mbasi kaloi stuhija e reja thoshte që t’i lanë teshat dhe ma n’oborr.

E m’at anë gardhit asgja e re. Vetëm qi nji rreze dielli e cila kish depertue retë dhe si shifet tue mos gjetë vend ma të mirë në botë, kish ra në pleh. Nji gjel, të cilin e kish zanë gjumi mbi peh, u zgjue dhe ia tha kikirikuuun gjatë e tinglleshëm.

- Plaç, he dreq! se më trembe! – pëshpriti plaka e cila ish vue në veshtrime m’at anë gardhit – nuk e shifte gjelin aty afër mbas gardhit.

SHËNIM

MIGJENI, akronim nga Millosh Gjergj Nikolla, lindi në Shkodër më 1911.
Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmen në Tivar (Mal i Zi) dhe Manastir (Maqedoni), në seminarin ortodoks.
Një kohë ka punuar mësues në Verakë, Shkodër dhe Pukë.
I sëmurë rëndë nga TBC-ja, shkoi për shërim në Athinë, e më pas në Torino (Itali), por pa sukses. Vdiq (më 1938) në spitalin "Torre Pelice".
Gjatë viteve të 30-ta Migjeni botoi poezi dhe proza të shkurtra nëpër revistat e kohës: "Rilindja", "Bota e re", "Përpjekja shqiptare", "Illyria" etj.
Në vitin 1936 e botoi përmbledhjen me poezi moderne "Vargjet e lira" e cila menjëherë u ndalua nga censura. (Përmbledhja e plotësuar iu botua më 1944, në Tiranë).
Po atë vit, (1936), e bëri gati për botim edhe përmbledhjen me proza më të gjata"Novela të qytetit të veriut", por s'ia arriti.
Përmbledhja me poezi dhe proza iu botua më vonë: në Tiranë, më 1961 dhe në Prishtinë, më 1963.
Ishte liriku dhe prozatori më i shquar social dhe modern i kohës.
Përzgjedhjen e botojmë në për të shënuar 70-vjetorin e vdekjes së Migjenit.

Parle

NONDA BULKA

MUJO ULQINAKU

Ç’ janë ata që nxijnë detin?
E dëgjon, nëno, tërmetin?
- Jan’ hordhitë e dushmanit
Për t’i vënë zjarr vatanit.
O biro!

Ç’janë ata këmishëzez,
Që po vijnë aq serbes,
Me ca pupla si këndes,
O nëna ime?

Ata janë mizëria,
Që po vijnë me zinxhira,
Të na lidhin këmb’ e kokë,
E ta kthejnë varr’ e gropë,
Çdo luadh, çdo fush’ e pyll,
Do nxirosin çdo yll!
Pa do mbushin me kufoma,
Me kufoma, ah, të njoma
Çdo kodrin’ e çdo hendek
Mal më mal e breg më breg!
- Zjarr nga deti, zjarr nga qielli!
Nëno, u sterrua dielli!

* * *

- Durrës ty, o Durrës plak,
Hasmi po të shkel në prag,
Populli u mbyt në gjak!
Ç’ po lufton një ulqinak.

Lufton djali, lufton plaku
Gjer në gju ma vete gjaku,
Bjeri, Mujo Ulqinaku
Për Liri!

Lufton populli i arbreshit,
Si dikur me pallë sheshit
Për Shqipri.

Thrret Guxoni: “Mama mia!
Ç’ burra paska Shqipëria!”

Telegramet ven’ e vijnë
Nga Londoni në Athinë,
Nga Belgradi n’ Amerikë,
Nga Azia në Afrikë;
Nga Parisi gjer në Moskë:
Ç’po luftojnë geg’ e toskë
Për një truall, për një prag,
Lahen rrugët me gjak!

Kush lufton ashtu në këmbë?
Kush ha hekurin me dhëmbë?
Janë trimat shqipëtarë,
Që po heqin zorrët zvarrë!
Të tradhtuar nga një mbret,
Q’u degdis për në kurbet!
Është Mujua, një kapter,
Që lufton e vdes me nder!
Dhe, ja, plumb i mallkuar,
Tejpërtej në kraharuar!
Ç’na u mbyt trimi me gjak,

Për një truall, për një prag.
Nëna me të madhe qan,
Kur sheh shtrir' atë luan:
- Gjirin ta kam bër' hallall,
Xhan e shpirt, me yll në ballë!
T'i m'u vrave për liri,
Ndaj të qan një Shqipëri,
Bir, o bir, si lumthi ti!

Nga vëllimi "*Në dritën e yllit*", botuar më 1952, (Vepra letrare, 3, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1980).

SHËNIM

NONDA BULKA (Lindi në fshatin Leusë të Përmetit më 1906 dhe vdiq në Tiranë, më 1972. Shkollën fillore dhe liceun e kreu në Korçë. Studimet e larta i ka vazhduar në Francë, ku është diplomuar në drejtësi dhe letërsi. Ka punuar mësimdhënës i gjuhës shqipe dhe frënge, në fillim në shkollat e mesme e më,vonë në Universitet. Që nga vitet e tridhjeta u bë i njohur me shkrime në periodikun letrar.

Veprat letrare: "Kura qan e qesh bilbili" (1934), "Skica e tregime" (1950), "Vargje satirike" (1951), "Nën dritën e yllit" (1952) etj.

MUJO ULQINAKU (Muhamet Cakuli) ishte kapter i Marinës, u vra duke luftuar me pushtuesit italian, në Durrës, me rastin e invazionit të Shqipërisë, më 1939.

ESAD MEKULI

PA TITULL

Nata mbi qytet lëshohet
Dhe i pari muzg
Në heshtje mugullon
Fushave të lulëzueme të vendlindjes

Paqe në rudina
E degë... Në shpirt
Si qielli i pafund mbi krye...

- O heshtje e mrekullueshme e muzgut
Ndër netët e vendit tim!
Qetësija jote me përkëdhelje të buta
Zemra të plagosuna lëmon
E n' paqe mbulon ma të madhen dhimje
Si puthje dashnorje ndër buzë...
E dashtuna heshtje e muzgut
Ndër netët e vendit tim!
Ti je ma i miri bar
Për shpirtin tim të plagosun.

(1932)

POROSIJA E NANËS

(*Me rastin e shpërnguljes në Turqi*)

Për ke në dritë ju qita, o djelm?
Për ke ju rrit, o bij'?
Pse u gëzova unë në jetë?
- Nanën po e leni sot kur kryet
Me mburrje për ju e ngrita;
Kur futën e zezë e hoqa;
Kur zjarmin në votër
Pa frigë e ndezim në mbramje -
Kur sofrën ma thatë s'e shtrojmë!

Në dheun e huej shkoni?

Atje -
Ku vesh s'ju marrin:
Ku vllau të vllanë
Me bisht të synit e shikon
E punën e vet soll kqyr!

Atje -
Ku bima ndër ara
Thahet nën hanë;
Ku grizhlat sqep-mprehta
Frytet e vjehtës s'parit shkretojnë!

Atje -
Ku dheu i zi
Randë do t'ju peshojë mbi rrashta
Pa etnit tuej për bri!

Unë be po u qes, bre djelm -
Në trollin që shkelët si fëmi,
Në eshtnat e të parëve,
Në gjakun e derdhun për liri,
Në fatlumninë tuej e të nipave,
Në tamblin e gjive të mi' -

M’i terni lotët që t’ harroj çdo dhimbë;

Mos me u nda
Prej prehnit tim
As vllau me vlla!

NOL BERISHA

KUSHTRIMI I BULKTHIT

Qe! Hana derdh rreze t’ambla mall’ngjimi
Përmbi natyrë - galdue n’shpresë pranverore.
- I shpejtë si rrezja terk ti m’shejon kujtimi.
M’ kaplon dëshira për të pasun prore.

Shuen mbarë natyra, binë n’ pushim krijesat.
Heshti rëmyese... ndjell gjumë e qetësi,
Ndërsa gëzimet andrrohen edhe dënesat,
Zemrat jetojnë n’ mjerim e lumtuni.

Kushtrimi i bulkthit n’ djerre cyt frymzimin
Me nji krikllimë të llargët,si t’mi flasë mendimet
Tue m’ zhytun në kujtim, përse qellimin
M’duket se m’ grish t’ja gjej unë?! - Ruzullimit!

Prill 1947
Bicaj

LEGJENDA E VAUT

Kaloja verën në katund. Shëtisja lugjeve e kodrinave. Natyra si mëmë zemërgjërë më dhuronte mirësitë e bukurit të cilat nuk mundi kurrë të m'i jepte qyteti. Dola me gjyshin për t'i balluar delet në kullosë. Dielli i bukur i verës reshte dritën praruese, ndërsa gjithnjë e më tepër ngulmonte nxehtësinë. Kur vapa erdhi e u bë e padurueshme, gjyshi ndolli bagëtinë, për të mrizuar nën një qarr madhështor e më të moçëm se edhe ai vetë. Në kurorën e blertë të tij këndonin zogjtë, e diku thellë pyllit, qukapiku trokiste. Poshtë në luginë marshonte lumi duke ushtuar përmallshëm.

Edhe unë e gjyshi bënim diçka: ai rrëfente gjëra të bukura, ndërsa unë e dëgjoja; para vetes kisha mësuesin e mirë.

Ngjau, ndërkaq, që një shtegtar të kalonte lumin e të dilte në bregun përtej. Gjyshi më pyeti:

- A di të flasësh mirë, ti, çun i gjyshit?

- Po! - i thashë i bindur.

- Më thuaj, pra, ç'bëri ai shtegtar?

- *Kaloi lumin*.

- Jo, jo! - curulati kryet gjashi duke varur buzët, e pastaj sqaroi si gjuhëtar i mirë:

- Nuk thuhet *kaloi lumin*, por duhet thënë: *ra va*!

- Të lumtë, gjysh, ç'është kjo fjala: *va*? - pyeta i befasuar.

- Vau është pjesa e shtratit të lumit ku ka pak ujë e mund të kalohet këmbë pa farë frike, - shpjegoi me të mirë gjyshi.

Duke më zbunuar me dorë të ashpërsuar moshe e pune, vijoi?

- Flitet goja-gojës se vau e paska marrë emrin nga një shtegtar i quajtur *Va*?

Turma e katundarëve po kthehej nga qyteti i pasditës e vonë të një dite tregu. Udhëtonin bri lumi, që gjëmonte vajtueshëm, ndërsa zemrat e udhëtarëve rrinin përmallshëm për vatrat e tyre.

Drejt horizonit të skuqur dukej ura e cila me durim rri e ngujuar e krahëhapur, për t'i kaluar njerëzit në bregun tjetër.

Do ta kishte kaluar edhe Vaun.

Por Vau, njëri prej turmës që kthehesin nga qyteti atë pasdite të vonuar, duke dëshiruar të arrinte në shtëpi sa më parë, nuk ra urës; u shmang duke iu qasur lumit në buzë të buzës. Zbathi opingat. Përvol këmbëzat e brakusheve e u fut në lumë për ta kaluar këmbë.

Kur Vau i gjet mes ujit, filloi të lëkundet nga valët. Rrapatosej me to.

Valët e rrëzuan, e morën me vete të gjorin Va.

Atëherë u dha kushtrimi:

- Ooo, u mbyt Vaaau, moreee, u mbyt Vaaau!

Ai zë kushtrimor përplasej brigjeve duke bërë jehonë në atë muzg të trishtueshëm.

- Ooo, u mbyt Vaaau, moreee, u mbyt Vaaau!

Legjenda nuk tregon asgjë më tepër për fatin e Vaut...

... Por ti, shpresa e gjyshit, ki kujdes e *mos bjerë vapava as lumit as shtegut të jetës*!... - përfundoi gjyshi, i tretur në legjendën e largët të Vaut.

REXHEP QOSJA

HIRMADHJA

Djali e kishte emrin Mevlan, e mbiemrin nuk e thoshte, sepse nuk e pyeste kush, kurse emrin e saj do ta mësoni nga fundi i rrëfimit.

Dhe, këta emra të rrallë, shumë të rrallë, që në vendlindjen time ishin dëgjuar kaherë, prej kohës së stërgjyshërve, për dikënd mund të kenë kuptim të veçantë, kurse për dikënd si shumica e emrave të tjerë - të zakonshëm.

Lexuesi do ta gjykojë vetë cilët kanë të drejtë. Si të parët ashtu edhe të dytët po i përkujtoj: e vërteta në një kohë mund të jetë e pavërtetë në një kohë tjetër, ashtu siç e vërteta në Lindje të Bjeshkës së Madhe nuk është e vërtetë në Perëndim të saj. Dhe, nuk mund të jetë.

Shih veprat: Monteskje - *Letrat persinae*; Blez Paskal - *Mendime*; Orman Kuin - *Metoda e logjikës*.

Mevlani ishte djalë i vetëm, pa nënë e pa babë - i kishin vdekur herët, pa vëlla e pa motër, pa grua e pa fëmijë.

Të gjithë njerëzit, thoshte, janë vëllezërit e mi, se të gjithëve na bën nëna mbasi të na mbaj nëntë muaj e dy javë në bark dhe të gjithëve na pret varri.

Mevlanin s’e kishin marrë asnjëherë në Kështjellën magjike!

Mevlani ishte i varfër: nuk kishte shtëpi, as tokë, as bagëti, as ndonjë

pasuri tjetër; bukën e gojës e fitonte nëpër botë, sot në një vend e në mot në një vend tjetër.

Bota, thoshte, është shtëpia ime; qielli, thoshte, është pullazi i shtëpisë sonë të përbashkët, kurse dheu dyshemeja e saj.

As vetmia, as varfëria, as bredhjet e lodhshme nuk e kishin lënë Mevlanin pa shpresë: besonte dhe thoshte, se Fati një ditë do t'i buzëqeshte; dhe kurdo Perëndia përmendej në praninë e tij, Mevlani ngriste kryet përpjetë dhe thoshte: ai më ka falë dhe ai do të ma bëjë çaren.

Dhe, ai që e kishte falur të pashëm siç ishte (e ishte i pashëm si ta kishte bërë e Bukura e Dheut) dhe gjindës siç ishte (e ishte më gjindës se shumica e moshatarëve të tij), ai do t'ia caktonte rrugën e jetës dhe do t'i shënonte Gruan me të cilën do të kalojë jetën dhe do të bëjë trashëgimtarët.

Dhe, ajo ditë e mezipritur kishte ardhur kur Mevlani më së pakti e kishte pritur dhe kur më së pakti kishte menduar për të.

Ishte vjeshtë e vonë, kohë ende e përdiellur, njerëzit po e mblidhnin bereqetin që ua kishte dhuruar vera e ngrohtë. Rruga e kishte qitur Mevlanin në një fshat të madh e të bukur, që mund të ishte edhe i pasur, të cilit banorët e tij dhe fshatarët e fshatrave përreth i thoshin Ajmelot dhe i cili shtrihej afër qytetit Izmerin, nëntë ditë e nëntë net rrugë këmbë larg Vajazanit. Toka humusore që jepte dy të korra në vit; pemët dhe perimet e shumëllojshme; bagëtia dhe shpesëria në numër të madh; malet e dendura në rrëzë të fshatit, që e mbronin prej shenave dhe ortiqeve; bjeshkët me rudina të gjelbëra gjatë nëntë muajve të vitit - të gjitha këto dhurata, që ua kishte dhuruar i Madhi Zot, e bënin jetën e fshatarëve të Ajmelotit të lumtur - të lumtur përgjithmonë, sikur të mos iu kishte vardisur një e Keqe e madhe prej së cilës, kuku nënë,kurrsesi nuk mund të gjenin shpëtim!

Nuk ma merr mendja, në asnjë mënyrë nuk ma merr mendja, se mund ta dini ju pa ju thënë, cila ishte ajo e Keq, që e bënte të zezë, sterrë, jetën e ajmelotasve.

Në Xhaminë e fshatit ishte vendosur një Kuçedër fëmijëngrënëse!

Ajo i kishte dënuar fshatarët të vuanin për ujë të pijes.

Ajo i linte pa ujë edhe të mbjellat, bagëtinë dhe shpesërinë e tyre.

Ajo mëshirohej e ua lëshonte ujin, ajmelotasve vetëm kur ia çonin nga një fëmijë kurban; nga një fëmijë kurban çdo të nëntën ditë!

Mevlani do të jetë shpëtues i fëmijëve të tyre dhe do të bëhet prurësi i Fatit të tyre.

Një ditë, derisa po nxitonte që para natës të mbërrinte në qytetin

Izmerin, Mevlani e kishte dëgjuar kujën e grave; vajin e fëmijëve dhe bërtimën e meshkujve në rrugën që çonte në Xhaminë e fshatit. Ishte ndalur dhe e kishte pyetur udhëtarin e parë që po udhëtonte në drejtimin e kundërt:

Çfarë fatkeqësie e ka goditur këtë fshat?

Udhëtari ishte përgjigjur pa ndonjë shqetësim:

Po ia çojnë kurbanin Bollshardës!

Mevlani ishte çuditur shumë: çfarë Kuçedre? Çfarë kurbani?

Udhëtari i kishte thënë më tej: atje në Xhami, rri një Bollsharde së, cilës çdo të nëntën ditë janë të detyruar t'ia çojnë nga një fëmijë! Kësaj here e kanë radhën të çojnë kurban babë e nënë që kanë vetëm një fëmijë - një djalë.

Udhëtari e kishte vazhduar rrugën pa e pritur përgjigjen e Mevlanit.

(Ai kalonte shpesh nëpër këtë rrugë, shpesh e kishte parë rreshtin e njerëzve të veshur në të zeza dhe shpesh e kishte dëgjuar kujën e grave dhe vajin e fëmijëve).

Mevlani kishte nxituar që t'i mbërrinte fshatarët para se ta fusnin fëmijën në Xhami. Kur u ishte afruar aq sa mund ta dëgjonin zërin e tij, i kishte thirrur: Ajmelotas! Ajmelotas! Pritmëni se dua t'ju bashkohem në qoftë se më begenisni për mik!

Ajmelotasit ishin ndalur: ishin ndalur të befasuar dhe të frikësuar, sepse kurrkush, prej se ishin detyruar t'i çonin kurban Kuçedrës, nuk ishte ndalur që të bisedonte me ta!

Fshatarët e fshatrave të tjerë e ndërronin rrugën vetëm e vetëm që të mos kalonin nëpër Ajmelot! Qytetarët e Izmerinit nuk blinin as bylmetra, as mishra, as lëkura, as dru prej druvarëve të ajmelotasve: i blinin vetëm prej fshatarëve të fshatrave të tjerë.

Megjithse zëri i Mevlanit u dukej shumë i ëmbël, dhe ua përkëdhelte veshët, ajmelotasit nuk pritnin ndihmë prej tij.

Edhe ai ishte si kalimtarët e tjerë - mendonin.

Edhe ai ishte si fqinjët e tjerë - pëshpërisnin.

Kur ishte afruar, dhe kur i kishte parë babë e nënë të bërë ujë prej lotësh, Mevlani u kishte thënë shumë i pikëlluar:

Kthejeni djalin në shtëpi se unë do të shkoj në Xhami e të bëhem kurban në vend të tij!

Sytë e fshatarëve ishin rritur shumë - sa burimi i Lumit: çka po shihnin?

Veshët e fshatarëve ishin tendosur shumë:çka po dëgjonin?

Kush je ti që do të flijohesh në vend të djalit tënd? - kishin pyetur ata.

Njeri! Vetëm njeri! - kishte jehuar përgjigja e tij.

Edhe të tjerët, përreth nesh, që kalojnë këndejpari, thonë se janë njerëz - kishin thënë ata.

Po njerëz, edhe ata janë njerëz! Kishte thënë ai.

E di apo nuk e di çka të pret atje në Xhami?

E di, posi nuk e di.

Mund të vdesësh në vend të djalit tim - i kishte thënë i ati i fëmijës - kurban, derisa lotët çurg po i mblidheshin në të çarën e mjekrës, nëntë ditë të parruar.

E mira më e njerëzishme është ajo që e bëjmë kur e rrezikojmë jetën tonë, - ishte përgjigjur Mevlani.

Të çuditur, pa masë të çuditur kënd kishin takuar dhe çka prej tij kishin dëgjuar, ajmelotasit, që kishin harruar se kur ua kishte bërë kush ndonjë të mirë, me fëmijën përpara ishin kthyer mbrapa, kurse Mevlani, i vetëm si gjithnjë e gjithkund, ishte futur në Xhami.

Lirishta rreth Xhamisë kishte mbetur shkretë!

Të kishit qenë atë natë në Xhami, do ta kishit parë Mevlanin se si kishte rënë në gjunjë thuajse donte të falej, se si kishte filluar t'i lëvizte buzët - thuajse falej, sesi e përkëdhelte dyshemenë me fytyrë e herë ia kthente sytë qiellit - thuajse po i lutej Zotit. Dhe, ai po lutej: që aty, në Xhami, të ketë punë me diçka që shihet e jo me diçka që nuk shihet. Deri në moshën në të cilën ishte (e Mevlani ishte në moshën njëzet e nëntëvjeçare) ai kishte mësuar se të këqijat më dhembjesjellëse dhe më çnderuese mund të jenë të këqijat që nuk shihen dhe nuk dëgjohen, domethënë të këqijat që nuk parashihen!

Nuk kishte arritur të thoshte lutjen deri në fund, si e thoshte kur lutej në skaj të rrugës, në fushë e në mal e në veshët e tij ishte përplasur së pari një vërshëllimë nepërke (kishte menduar) e pastaj një kërcëllimë e paqartë, por frikësuese. Arka të cilën, mbasi i kishin ardhur sytë, në terr, e kishte parë në një qoshe të Xhamisë, përnjëherë ishte çelur dhe, prej saj, si prej një pusi të pafund, kishte dalë një krijesë e çuditshme, e shëmtuar, e cila të tmerronte me pamjen e pashpjegueshme, e lere më me forcën, që e shquante ajo pamje: një krijesë e tmerrshme që (e dinte) gllabëronte fëmijët e fshatit Ajmelot.

Hapësira e Xhamisë në të cilën (e dinte) ishin vetëm Ai dhe Kuçedra, iu kishte dukur shumë e ngushtë, muret e saj prej guri të latuar shumë të trasha, pullazi prej plumbi shumë i fortë, kurse minarja e gjatë - e shurdhër!

Posa e kishte dëgjuar dikënd se po merrte frymë, Kuçedra e kishte përplasur kapakun e Arkës dhe e kishte filluar vallen e saj gjakpirëse nëpër Xhami.

E kishte kërkuar fëmijën përreth Arkës, por nuk e kishte gjetur aty; një frymëmarrje edhe më e fortë e kishte dëgjuar në qoshen tjetër, jugore.

Do të të zë edhe nëntë pash nën tokë po të fshihesh - i kishte thënë dhe ishte turrur vrap në atë qoshe.

Mevlani kishte ikur në qoshen perëndimore.

Do të të zë edhe po të ngrihesh në qiell - kishte bërtitur dhe ishte turrur në qoshen perëndimore.

Mevlani kishte ikur në qoshen veriore.

Do të të zë edhe po të bëhesh erë - kishte ulëritur Ajo dhe për një çast ishte hedhur në atë qoshe, por Mevlanin as këtu nuk kishte arritur ta kapte.

E hidhëruar deri në tërbim, Kuçedra kishte bërtitur:

Nuk do të mund të fshihesh edhe po të futesh në bark të nënës!

Kur i kishte gjurmuar - në të katër qoshet, Kuçedra ishte ndalur në mes të Xhamisë, ishte dredhur e përdredhur mbarë e mbrapshtë dhe kishte bërtitur me të madhe, aq të madhe saqë ishte dridhur Xhamia:

Do t'jua shuaj lumin dhe do t'jua shuaj burimet dhe ju do të detyroheni ta pini gjakun njëri-tjetrit! Unë jam vepra juaj!

Mevlani nuk dëgjohej.

Posa kishte kënduar gjeli i parë, që paralajmëronte agun, Kuçedra ishte futur shpejt në Arkë - se dritës i frikësohej më shumë se njerëzve dhe më shumë se dragonjve.

Ajo i frikësohej dritës sepse vetëm në dritë të ditës mund të shihej se sa e shëmtuar që ishte.

Ajo i frikësohej dritës sepse edhe për arsye se vetëm në terr mund të dilte ngadhënjimtare.

Dhe, posa Ajo ishte zhdukur në Arkë, Mevlani e kishte çelur derën e Xhamisë dhe kishte dalë në dritë.

Përreth ishin mbledhur fshatarët e Ajmelotit: burra, gra, pleq dhe fëmijë.

E ke parë Kuçedrën? - e kishin pyetur njëzëri.

E kam parë aq sa mund të shihet gjë në atë terrinë - ishte përgjigjur.

A ka thënë gjë? - e kishin pyetur.

Ka thënë se njerëzit e kanë bërë të tillë çfarë është dhe njerëzit duhet ta ushqejnë, me hatër a me zor - ishte përgjigjur.

E si shpëtove ti prej saj?! - e kishin pyetur duke mos e fshehur habinë.

Nuk më ka parë, vetëm më ka dëgjuar, dhe pa më parë ia kam ndërruar qoshet e Xhamisë - ishte përgjigjur.

E si nuk të ka parë dhe si nuk të ka dëgjuar kur edhe Ti ishe në Xhaminë ku ishte Ajo? Njeriu i gjallë, që merr frymë, shihet edhe në terr - kishin thënë Ata, kurse Kuçedrat shohin edhe çka nuk shohim ne njerëzit.

Ajo është aq e fortë, dhe ajo është aq e sigurt në veten saqë nuk mërzitet a do të shikojë a do të dëgjojë qartë. Forca të bën të verbër e të shurdhër për të tjerët!

Kur të kemi parë duke dalë prej Xhamisë kemi menduar se Kuçedra do të ketë ikur në qoftë se nuk ke arritur ta vasës; se kemi shpëtuar njëherë e përgjithmonë prej zullumit të saj; se tani e tutje nuk do të jemi të detyruar t'ia çojmë fëmijët kurban as Asaj, as kujt tjetër - kishin thënë të pikëlluar.

Gratë kishin filluar prapë kujën.

Fëmijët ishin strukur në prehërat e nënave a nën sqetullat e baballarëve.

Fshati Ajmelot prapë ishte veshur në të zeza.

Herën tjetër e kam radhën unë që t'ia çoj djalin kurban.

Asaj - kishte thënë një fshatar thatim, mendjetretur, të cilit deri në atë çast nuk iu kishte parë fytyra dhe nuk iu kishte dëgjuar zëri. Gruaja e tij, e zbehur meit, kishte përqafur tokën e fëmija pikëllimin e nënës.

Në vend të fëmijës tënd do të shkoj unë - si herën e parë. Jam i vetëm, nuk kam prindër që t'u shkrumbohet zemra për mua; nuk kam grua e fëmijë që të mbesin keq pa mua; nuk kam pasuri që të vriten fqinjët rreth saj; deri sot asnjë vajzë nuk ka thënë se më dashuron; nuk ka pse të më dhimbset jeta dhe nuk kam përse t'i dhimbsem kujt nëse bëhem therror!

Dhe, pas nëntë ditëve dhe nëntë netëve, Mevlani, i përcjellë prej ajmelotasve, kishte hyrë në Xhami.

Si natën e parë, edhe këtë të dytën, ishte strukur në qoshen e Xhamisë.

Hapësira nuk i dukej më aq ngushtë, as muret aq të trasha, as pullazi i lartë aq fort, as minarja aq e shurdhër si herën e kaluar.

Kur ishte bërë terr, dhe nuk mund të shihej as gishti në sy, Kuçedra kishte dalë prej Arkës dhe kishte filluar rrëmujshëm ta kërkonte fëmijën - kurban prej qoshes lindore, ku ishte vetë, derin në qoshen jugore, prej qoshes jugore deri në qoshen perëndimore, prej qoshes perëndimore deri në qoshen veriore.

E Mevlani, si natën e parë, ikte prej qosheje në qoshe para se të mbërrinte.

Në mëngjes kishte dalë prej Xhamisë.

Fshatarët e mbledhur në lirishten para saj ishin më të gëzuar se herën e kaluar.

Gëzimi i tyre kishte zgjatur shumë shkurt dhe ishte shuar teksa Mevlani u kishte thënë se Kuçedra ishte në Xhami.

Etja i kishte bërë mendjehumbur.

Pas nëntë ditësh u nisën ta çonin, prap, fëmijën - kurban në Xhami.

Prapë Mevlani u tha: Do të bëhem kurban unë në vend të fëmijës; dhe shkoi e hyri në Xhami.

Posa ishte bërë terr, Kuçedra kishte dalë prej Arkës dhe, meqë e kishte humbur durimin, më rrëmbyeshëm dhe më kërcënueshëm se netëve të tjera, turrej prej qosheje në qoshe, duke e kërkuar fëmijën; Ajo turrej e Mevlani ikte prej qoshes jugore në qoshen perëndimore, prej qoshes perëndimore në qoshen veriore dhe, në fund, kishte hyrë në Arkën e Kuçedrës.

Mbasi nuk e kishte gjetur në qoshet ku e kishte kërkuar fëmijën - kurban, Kuçedra ishte kthyer te Arka, e kishte ngritur kapakun dhe, po bëhej gati të futej në të, kur, çka të shihte se: në Arkë ishte Mevlani!

Çka do ti, këtu?! - e kishte pyetur Kuçedra sa e befasuar aq e hidhëruar.

Çka t'i them e të mos e hidhëroj më shumë? - e kishte pyetur Mevlani veten.

Bëju i guximshëm dhe thuaje të vërtetën - iu kishte përgjigjur Vetja. - Qyqaei nuk e ka as këtë bot as atë botën.

Po, po, por në qoftë se qyqarin e përkrahin të gjithë qyqarët e tjerë, atëherë kjo botë i takon atij - i kishte thënë Mevlani.

Provoje Fatin! - i kishte thënë vetja.

Po e provoj - i kishte thënë Mevlani.

Çka do ti, këtu?! - e kishte pyetur Kuçedra Mevlanin.

Unë këtu e ndiej veten mirë; kjo... kjo... kjo... është Arka ime - iu kishte përgjigjur Mevlani Kuçedrës.

Mos bëj shaka! - i kishte thënë Kuçedra duke përpirë gaz, një gaz që ta shtinte tmerrin.

Si mund të bëj shaka unë i varfër e i ulur në Arkë me një Zonjë ashtu të tmerrshme në këmbë?! - iu kishte përgjigjur buzëqeshur Mevlani.

Arka është shtëpia ime e natës, kurse Xhamia e ditës dhe e natës - kishte thënë Kuçedra.

Arka është e atij që është në të, kurse Xhamia e të gjithëve. Kur ishe ti në Arkë - ishte e jotja, tani jam unë - është imja - i kishte thënë Mevlani.

Unë nuk flas tri herë - i kishte thënë Kuçedra dhe sytë iu kishin

qepur në fytyrën e hijshme të Mevlanit.

As unë nuk përgjigjem tri herë - ia kishte kthyer Mevlani, i trimëruar, ishte ngritur në këmbë dhe me faqen e vet të butë e kishte fërkuar faqen e akullt të Kuçedrës.

Vetëm Mevlani dhe Kuçedra mund ta dinin sa gjatë kishin mbetur ashtu faqe për faqe: Mevlani duke iu lutur Zotit që të dëgjohet sa më parë kënga e gjelit, kurse Kuçedra duke iu lutur Shejtanit, që kënga e gjelit të mos dëgjohej kurrë.

Të lutem lëshoma Arkën se po më zuri sabahu pa hyrë në të do të vdes! - Nuk të, vjen keq për mua? - i kishte thënë Ajo Mevlanit.

Si të më vij mua keq për ty, kur ty nuk të vjen keq për fëmijët - kurban? - iu kishte përgjigjur Ai.

Sekush jeton në mënyrën e vet: ti duke lypur e unë duke marrë dhurata - i kishte thënë Kuçedra.

Mund të bëhesh edhe nëntë herë më e mençur se ç'po tregohesh, po unë nuk dal prej Arkës! - iu kishte përgjigjur Mevlani.

Dhe, kështu: Kuçedra kishte vazhduar t'i lutej Mevlanit që t'ia lëshonte Arkën ose në fund do ta gëlltiste, kurse Mevlani kishte vazhduar të refuzonte duke i thënë se ai është kafshata që asaj, në fund, do t'ia zinte frymën.

Dikur, kur Kuçedrës iu kishin përlotur sytë, Mevlani i kishte thënë, i mëshiruar, edhe pse ishte i bindur se ajo nuk meritonte mëshirë:

Ta lëshoj Arkën në qoftë se ma jep fjalën se do të bësh çka do të kërkoj prej teje.

Do të bëj çka të duash - iu kishte përgjigjur Ajo.

Dua që t'i heqësh rrobat që ke veshur - i kishte thënë Mevlani. - Janë aq të shëmtuara, po trishtohem kur të shoh në to. Megjithëse je aq shpirtkeqe, nuk e besoj se trupin e ke të shëmtuar si rrobat.

Për një çast Kuçedra kishte refuzuar t'i hiqte rrobat, por kur ishte bindur se Mevlani ndryshe nuk do t'ia lëshonte Arkën, iu kishte përgjigjur.

Mirë, por kthehu në anën tjetër dhe mos më shiko!

Dhe, Kuçedra i kishte hequr rrobat; dhe kur i kishte hequr rrobat - i kishte thënë Mevlanit:

Tani kthehu dhe shikomë!

Mevlani kishte parë një krijesë njerëzore.

Kuçedra po çuditej pse Mevlani nuk çuditej çka po shihte.

Hajde, lëshoma tani Arkën! - i kishte thënë Kuçedra.

Jo! - iu kishte përgjigjur vendosmërisht Mevlani.

Pse? Nuk e mbajte fjalën!

Nuk ta kam dhënë unë ty fjalën; ti ma ke dhënë mua: se do t'i heqësh rrobat. Hiqe dhe palën tjetër të rrobave!

Kuçedra ishte pa masë e befasuar: ku e dinte ky që kishte edhe një palë rroba kur nuk e kishte parë kurrë jashtë Xhamisë.

Ishte sjellë disa herë rreth Arkës, i kishte thënë Mevlanit të kthehej në anën tjetër dhe, kur Ai kishte bërë çka kishte kërkuar Ajo, e kishte hequr dhe palën e dytë të rrobave.

Mevlani kishte parë se Kuçedra ishe Grua. Si ishte e mundshme që Gruaja të bëhej Kuçedër? - kishte menduar.

- Çou, shpejt, lëshoma Arkën! - i kishte thënë Ajo Mevlanit, tani e sigurt se do të bënte siç i lutej.

Jo, nuk mund ta lëshoj ende! - iu kishte përgjigjur Ai.

Pse? A u morëm vesh që ta lëshosh mbasi të heq palën e dytë të rrobave? - i kishte thënë Ajo.

Hiqe edhe palën e tretë!.. - i kishte thënë Mevlani.

Kur, duke shikuar Mevlanin, e kur duke dëgjuar se mos po këndojnë gjelat, Ajo e kishte hequr dhe palën e tretë të rrobave.

Para syve të Mevlanit kishte dalë një Hyri e rrallë në Botë.

Mevlani nuk ngopej duke e shikuar: bukuria e saj ia kishte marrë mendtë!

Posa ishte dëgjuar kënga e gjelit, Bukuroshja i kishte thënë:

Tani lëshoma Arkën! Siç kërkove i hoqa të tri palë rrobat.

Tani Arka nuk të nevojitet më. Është mëkat të mbyllet bukura në Arkë - i kishte thënë Mevlani.

Më vrasin fshatarët!

Nuk të vrasin kur të shohin kështu të bukur.

Nuk më shohin siç jam tani, por siç kam qenë - Kuçedër.

Mos u frikëso: e kanë kujtesën e shkurtër kur duhet ta kenë të gjatë, dhe të gjatë kur duhet ta kenë të shkurtër. Po si e ke emrin?

Mevlude. E ti?

Mevlan.

Dhe mandej, Mevlani dhe Mevludja dolën, bashkë, në lirishtën para Xhamisë, ku ishin mbledhur fshatarët, të cilët u befasuan pa masë kur i panë bashkë. E si të mos befasoheshin? Mevlani kishte hyrë vetëm në Xhami e po dilte vetë i dyti prej saj!

Kush është kjo me ty?! - e pyetën ata.

Kjo është Nusja ime - u përgjigj Ai.

Nusja jote!? Po ku ishte deri tani Ajo?

Ishte në Xhami. Ishte në Xhami e nuk e ka gëlltitur Kuçedra! Si

është e mundur kjo?

Ishte e veshur si Kuçedër.

Ajo ishte Kuçedra, ë!?

Ajo ishte Vajza më e Hirshme në këto anë - në të gjitha këto anë. Djemtë për të cilët nuk deshi të martohej dhe gratë smirore i trilluan një mijë e një të këqija për të dhe e kthyen në Kuçedër. Kurse ju e detyruat ta mbani me fëmijët tuaj - kurban!

A mund të bëhet Ezhdërhaja Nuse!? - pyeti një biçim fshatar, të cilit ende nuk i kishte ardhur radha që ta çonte fëmijën e vet - kurban.

Më mirë është kur bëhet Kuçedra Nuse sesa kur bëhet Nusja Kuçedër - iu përgjigj fshatari afër, djalin e të cilit Mevlani e kishte shpëtuar mbrëmë.

Dhe, pas kësaj bisede, Mevlani dhe Mevludja u lamtumirën me fshatarët e u nisën në rrugë.

Ku do të shkoni? - pyetën fshatarët.

Bota është shtëpia jonë - u tha Mevlani edhe njëherë ajmelotasve. Do ta bëjmë shtëpinë dikund ku njerëzit nuk i frikësohen Bukurisë, po e adhurojnë.

E vendlindjen, a mund ta merrni vendlindjen me vete? - pyeti një djalë esmer, të cilit teksa i kishte filluar t'i dukej pushi në fytyrë.

Mevlani e Mevludja nuk i dhanë përgjigje. Kur e bëri Ai pyetjen, ata po shikonin përmbi Bjeshkën e Madhe, atje larg, larg, ku bashkoheshin Toka e Qielli, e ku ishte Bota, ku do të mund të ngrisnin shtëpinë e të rrisnin fëmijët.

(Fragment nga romani: Rexhep Qosja, "*Një dashuri dhe shtatë faje*", "Toena", Tiranë, 2003)

HAJRO ULQINAKU

PANORAMA E DETIT

Nëse do të pikturosh panoramën e bregdetit,
vizato kështu:
Pëlhurën ndaje në tri pjesë horizontale.
Fushën e parë ngjyrose në të përhitur.
Ajo është ranishta e argjendtë.
Të dytën ngjyrose me të kaltër.
Ai është deti pa valë, i qetë, pasqyrë.
Pjesën lart ngjyrose në bojë qielli.
Pra, është qielli pa re.

Pastaj:
Në breg vizato: një yll, një gocë dhe një kërmill.
Në detin e kthjellët le të notojë, vallëzojë një masë peshqish të argjendtë.
Në horizont le të lundrojë një barkë me vela të arta.
Në perëndim le të bjerë në det një portokall i madh.
Ai është Dielli që derdh purpur.
Në qiellin pa re le të fluturojnë tri pulëbardha të lira.

Panorama është e mrekullueshme!
Nëse e ke pikturuar me mjeshtëri,
fute në kornizë dhe nënshkruaje!

Unë e nënshkruaj e kënaqësi!

Në Prishtinë, l986

KUR TA HUMBËSH UDHËN, MARTA

Shkrimtari, kur del në shëtitje, duket si një bjerrakohës, bjerraditës…

Ai shëtit bregut të detit, bregut të ranishtës dhe, mbledh guaca, kërmij, yje…

Me një sandall lundron detit, peshkon peshq: të artë, të sedeftë…

Në Ullishtë vjel ullinj: të bardhë, të zez…

Pastaj, ia merr kodrës përpjetë…

I afrohet: reve, Hënës, Diellit…

Por, jo! Shkrimtari nuk është bjerrakohës, as bjerraditës.

Shkrimtari, duke bredhur bëhet: mbledhtar, vjelës…

Shkrimtari mbledh tema.

Shkrimtari vjel frymëzime.

E temën, frymëzimin, shkrimtari e gjen aty ku e takon fëmijën.

Më vonë, në laboratorin letrar të tij, ia jep trajtën: poezi apo prozë.

Marta simpatike u zu rastësisht në rrjetën e tregimit.

U ngjit shkrimtari në majë të kodrës së Pinjeshit dhe, nga lart pa: Kalanë, limanin, plazhin, detin e hapur…

A ka deti, fund? A ka deti skaj?

Çka ka përtej detit? Çka përtej fushave? Çka përtej maleve?

Si velat e barkës iu mbush kraharori me kënaqësi.

Por, në buzëmbrëmje duhej të zbriste në qytezë, të kthehej në shtëpizë…

Mirëpo, e kishte humbur udhën. Kishte hipur shumë lart.

Po, po! Shpesh i ndodh Shkrimtarit ta humbë busullën.

Ai habitet pas ëndërrimeve poetike.

Gjelbërimi mesdhetar ia ka zënë udhën.

Dhe vendos të kalojë një oborr të një shtëpie me kopsht me agrume: limona, portokaj, nerënxa…

Në pjergullën e kivit, pranë një tavoline, një vajzuke lexonte.

- Mirëdita! – e përshëndet me mirësjellje Shkrimtari - Fëmijën.

- Mirëdita! – i gjegjet e befasuar Vajzusha duke e ngritur kryet nga libri.

- Më falni, po ju pengoj duke mësuar, por unë e kam humbur rrugën, nuk di kah të zbres në Ranë, e kam shtëpinë aty pranë plazhit, s'di nga të kthehem, e u bë mjaft vonë…

- Ani, s'prish punë! Ju mund të kaloni edhe nëpër oborrin tim, nëpër këto shkallë mund të zbrisni, por me kujdes, se janë mjaft të pjerrëta,

pastaj do të dilni në rrugën që shpie për në hotele, atëherë do të gjendeni lehtë…

- Ashtu, ju falemnderit! Pak ju pengova… Po, çka po lexoni?

- Jo, s'ka gjë! Po lexoj "Fëmijët e detit" – dhe ia tregon librin e vjetruar të ardhurit.

- E njeh ti këtë shkrimtar?

- Më vjen keq, por s'kam pasur rastin ta takoj!

- Unë e njoh – i thotë – dhe, nëse më jepet mundësia, do të të njoh me të.

- O, ju falemnderit!

- A ma thuani emrin, si të thërrasin?

- Më quajnë Marta.

- Shih, Marta, nëse ndonjëherë do ta humbësh udhën duke shkuar në shkollë, atje pranë Kalasë, ti lirisht kalo nëpër oborrin tim. Do të më vij mirë nëse takohemi! – i thashë në ndarje.

Nuk kaloi shumë dhe një ditë, derisa lexoja në tarracë i fshehur pas fikut nga dielli përcëllues, si frymëzimi më vjen vajzuka…

Marta s'e kishte humbur udhën. Kthehej nga shkolla.

Ajo erdhi të më njihte. Ishte interesuar. I kishte kallëzuar arsimtari i gjuhës.

U gëzua që më pa.

Unë u gëzova që ma fali subjektin e tregimit.

Martës ia dhurova librin "Barka me vela".

Edhe Marta e donte letërsinë. Ishte një poete e vogël.

Ndenjëm, biseduam gjatë, si dy miq të moçëm.

ALI LLUNJI

NË KALIMERE

Kisha ardhë mysafir prej së largu për t'i kalue disa ditë te halla në bregdet. Dëshirojsha me e ndie veten si vendasit dhe me iu largue tollovisë e lëvizjeve të shumta të qytetit tim. Menjiherë u miqësova me mistrecë të lagjes. Nuk kalonte ditë pa më thirrë:

- Bleri, eja të shkojmë në Jalli!

Ditën e dytë:

- Blerim, sot po shkojmë në të Metës, n' Ujin Jeshil dhe Lug të Xhemiles...

Ditëve të tjera:

- Eja të shkojmë në Banjë të Lezes, Ujë të Surfullit, Shpellë të Qelbët... e vende të tjera me emna karakteristikë, që i kishte ky qytet bregdetar.

Këtë vend e quejshin edhe Gjini i Ujqve. Interesant! Pse a thue? E mora vesh: Njerëzit e këtij vendi paskan qenë dikur kusarë në za, e sot janë ndër marinarët t' aftë t' Adriatikut.

Ajo që më la mbresa të thella ndodhi një ditë të nxehtë gushti. Ishte vapë e madhe. Çdo gja thuese kotej e përcllueshme prej diellit të fortë. Qetësinë e ditës dhe të natyrës së molisun e thejshin gjinkallat me melodinë e tyne monotone. Rrotullohesha në shtrat. Mundohesha me e zanë veshin, por kot. Mendimet më shkojshin në vendet e vizitueme aq të bukura e mahnitëse. Çdo vend më ndiellte nga nji kujtim të veçantë. Monotonija më shtyni me u çue prej shtrarit. U vesha. Sillesha nëpër dhomë, kundruell së cilës frynte nji puhi e lehtë nga deti. Hapa dritaren kapakmbyllun dhe soditsha poshtë në plazhë, mol, Kep e Puntë të Nuradinit. Çdo gja pushonte. Njerzit e shtrimë si kubla rrijshin nën çadra dielli dhe rreshknin lëkurën e tyne të lyeme me voj ullini.

Disa mistrecë me sandolina, e ca të tjerë me sanalla lundrojshin të gëzueshëm. Lagshin njani tjetrin dhe zhyteshin në det për t'u freskue. Vetëm loja-gazi i tyne e prishte at monotoni të vapës. Njerzit lëkur-vrrugët kqyrshin me lakmi mistrecët dhe u pëlqente loja e tyne. Disa u larguen prej çadrave të diellit dhe u bashkuen me grupin e gëzuem. M'u duk se edhe natyra, si për hir të tyne, lëshoi një puhi të freskët dhe detin e qetë e mbuluen do valë të vogla.

Dera e dhomës sime u hap dhe ndëgjova zanin e hallës:

- Muer fund vapa - buzëqeshi ajo. - Shih, po fryn maistrali. Nesër kemi mot të mirë, Blerim!

Qesha edhe unë dhe fytyrën ma përshkoi nji gëzim i madh. U ngazlleva dhe ma, kur nën dritaren time ndëgjova zanin e mistrecëve të lagjes:

- Blerim, na po të presim në Mendreq!.. Shih, merr diçka me vete, se sonte do ta kalojmë natën në kalimere!

"*Kalimere*...? Ç' asht kjo a thue...? Mos asht ndonji bujtinë, motel apo ndonji..." Nejse, bana se e kuptova. Mblodha çaklat në strajcë dhe vojta në vendine caktuem. Ishin mledhë të gjithë. Më pritshin mue. U përshëndetëm.

- Disa le të nisen me sanall, e të tjerët - bregut...! - urdhnoi Hasani.

- Blerim, a don me ardhë bregut, apo don me shkue me sanall?

Zgjodha të dytën, meqë dëshirojsha me soditë natyrën prej sanallit dhe me bisedue me marinarët e vegjël. Shkurt, më interesojshin fjalët e detarëve e peshkatarëve, që në qytetin tim s'i dinte kush. Kisha ndërmend me i përdorë për t'u krenue, se edhe unë jam marrë me detari dhe qe sa shpejt i mësova. Para se të niseshim me sanall, Ismeti tha:

- Mendoj se te Shtegu i parë duhet të ndërrohemi me shokët që janë në sanall.

- Mirë e ke ti, por kjo nuk vlen për Blerimin - ia priti Ndreu.

Posa u nisëm, si t'i kisha porositë, filluen fjalët e dëshirueme: Ferit, *voga*! Agim, çoni *ballastamarët*! Mblidhni *rrëmuqat*! Mandej *cekoni* ujin prej *sulltinave*! Merrni ma *arraxha*! Hapni sytë mos po biem në ndonji *rradum*!

Hasani, që ishte pranë meje, m'i spjegonte ato fjalë e unë kënaqesha. Dikur i mësova.

Maistrali i fuqishëm dhe rremat e fortë të sanallit na sollën sa çil e mëshil sytë afër Shtegut të parë. Pritëm pak dhe mistrecët tjerë ia mbërritën. Për t'u gastue ishte vështirë, sepse valët mund të na përplasnin për ndonjë shkëmb. U ngrita në kambë dhe, tue u mbajtë për direk, fillova:

- Lëshoni *ballastamarët*, hidhni *rrëmuqat*, *voga*, Ferit, *shija*, Agim!..

Të gjithë shpërthyen në gaz.

- Bravo, bravoooo! - bërtitën mistrecët nga bregu.

- Blerimi u ba me të vërtetë detar - tha Fani.

- More, as deti nuk po e mundon - ia priti Fatmiri.

- Shihni sa guximtar qenka! Na ashtu të duem! Dëshirojmë të mësohesh edhe ma e të bahesh detar me famë - vazhdoi Skenderi i gëzuem

për lavdatat e mistrecëve për mua.

- Unë ju kam thanë - ndërhyni Hasani - se Blerimi do të mësohet me u ba si na. Asht i vyeshëm dhe guximtar.

Me të gastuem të gjithë ma rrahën supin. Mbas pak, mistrecët u nisën me sanall e na vazhduem rrugën. Më lutën të vazhdoj me ta, por dëshirojsha të kthillem, meqë ndiejsha njifarë turbullimi në stomak. S' bana za, e s'u ankova. Vazhdova rrugën dhe turbullimi më kaloi. Kaluem Shtegun e parë, të dytin, të tretin dhe erdhëm te Pompa e krypores.

- Blerim, kthe kryet dhe shiko! - më tha Engjëlli.

Përnjiherë fytyrat e njoma na i kaploi nji hije e kuqrremtë e diellit. Sa bukur perëndonte rruzulli i kuq. Kurr s'e kisha pa diellin ma të madh se atë ditë. M'u duk se e teri detin dhe nji vapullimë e madhe e kaploi rruzullin e kuq. Dikur u fundos dhe qiellin e la të plagosun tanë gjak.

U ngjitëm nëpër disa rrugë gjarpnore, të rrethueme me qerruca. Mistrecët më hapshin rrugën për të mos u therë në to. Mbërrijtëm në një breg shkëmbor. Ma poshtë shtrihej nji zallinë e pafund. Ngjyrëhini ishte shndërrue prej perëndimit të kuqrremtë n'elbaroz. Ishte kjo plazhë e mrekullueshme dhe e paanë. Skaji i saj bashkohej me horizontin, mbas të cilit gjarpnonte Buna e turbullt dhe bleronte Ada. Prej zallit të përclluem prej vapës ngriteshin avuj fjolla-fjolla thuese digjshin atë natyrë joshëse dhe gjelbrimin e saj. Pamje e papërshkrueshme. E ndante prej bregut nji rryp uji që vijonte disa kilometra në mbrendësi. M'u kujtue Kanali i Suezit dhe Shkretina e Saharasë, të cilat i kisha mësue në shkollë e pa në film.

- Qe Zalli..! Plazha e egër... Qe Porto-Milena...! - klithën mistrecët njizanit.

- Qe kalimeret..! - bërtiti Fani.

- Ku janë? - pyeta unë i habitun. - Unë nuk po i shoh!

- Si s'po i sheh?! Qe, ato kasollat mbi ujë janë kalimeret!

Menjiherë më shkoi ndër mend bendbanimi i njerëzve të parë. Në Porto-Milenë kishte me të vërtetë shumë kalimere. Rrijshin të vendosuna mbi katër huj të fortë. Në të gjitha anët ishin të rrethueme me ujë. Ishin të thuruna me xunka dhe në maje kishin formë koni. Mbrenda kishte minderë të shtruem me rrashtallëk. Para kalimeres ishte futë thellë në zall nji shtyllë tjetër që hapej në katër krih të lakuem teposhtë. Në këta krih miqt e mij vendosën rrjetat dhe ajo muer formën e nji kurthe të lakueme.

- Tash do të pushojmë, e kur të ngryset do të hamë darkë e mandej do të gjuejmë peshk! - më tha Fatmiri.

Shtruem batanitë mbi rrashtallëk dhe u shtrimë. Aroma e detit dhe puhija e lehtë e maistralit që ishte qetsue e që vijshin nga jashtë na këndellën.

Nata si ngjyrë e zezë na futi nën sqetullat e saj. Në largësi ndëgjoheshin lehjet e qenve të katundeve t'afërme. Ishte natë e qetë dhe e pahanë. Miqtë e vegjël lëshojshin ngadalë rrjetën e kalimeres n'ujë.

- Blerim, edhe ti do të gjuejsh sonte - më tha Hasani. - Nuk asht vështirë. Qem, shtylla çohet e rrjeta zhytet vetë n'ujë. Mbas pak e ul shtyllën e rrjeta ngrihet. Kështu veprojnë të gjithë, e mandej çka të qillojë. A more vesh?

Pohova se kuptova. Ngrita shtyllën dhe lëshova rrjetë n'ujë. Dikur e ula, por në rrjetë asgja. Kështu veprova edhe disa herë. Diçka më shtërngoi në fyt kur ndëgjova britmat e gëzueshme të mistrecëve të përziem me shushurimën e ujit dhe përplitjet e peshqve për dyshemenë e kalimeres: gjashtë copë në rrjetë! Uh, sa qefull i madh u hodh prej rrjetës n'ujë! Qillova edhe unë!

- Futni qefujt në vistër!

Vendosa përsëri me e ngritë, e mbas pak prap e ula. Brofa prej gëzimit kur në rrjetë pash grumbullin e peshqve dhe klitha:

- Shokë!.. Shokë, shihni edhe unë qillova!..

U ndëgjuen nji breshën lavdatash. Peshqit përpliteshin në rrjetë e mue më përshkoi nji frigë se mos po hidheshin përsëri n'ujë. Tue ma rrah supin e tue më ndihmue që ta sjelli shtyllën kah kalimerat, Hasani më tha:

- More, Blerim, ti u bane edhe peshkatar i madh! Shih, paske zanë qefuj, levrekë, arava e... Të lumtë, do ta hamë me shije gjahun tand!

Kështu kaloi nata në kalimere. Ky ishte nji përjetim i rrallë në jetën time. S'kish ma lezet se me pjekë qefuj në hellë. U kënaqëm tue hangër.

Në mëngjes vrejta grumbullin e madh të qefujve, levrekëve dhe aravave me sy e gojë të hapun...

IDRIZ ULAJ

ËSHTË I MIRË KY TELEFON

- Është i mirë ky telefon
Kur s’ pret, ai m’ cingëron.
Bisedon me mikun n’ Austri,
Flet me nipçen në Suedi.

Përgëzon nipin në Belgjikë,
Dëgjon djalin në Amerikë:
“Babi, unë jam Alb Gjoni,
Ju uroj nga Uashingtoni!”

“Nënë, këtu Margerita,
Ju përqaf nga Amerika!”
“Babë, këtu Bukuria,
Nga Boni - Gjermania!”

- Është i mirë ky telefon,
Kur s’ pret, ai cingëron.
Na kënaq, na ngushëllon,
Me të dashurit na bashkon.

PËRKUNDËR KUFIRIT TË RUAJTUR MIRË - IKJET

Përkundër kufirit të ruajtur mirë, ikjet, ndonëse sa vete e më rrallë dhe pa sukses, vijuan. Si hije, ato përcillnin, sado të papranuara, por të thella, shumë drama njerëzore, fate të dërrmuara, thyerje dhe krajata. U përsërit kjo edhe me vëllezërit Gariq - Jakovin dhe Mijatin, binjakë. Edhe ata ikën. Që nga fëmijëria ishin të tërhequr dhe të druajtur, kurrë nuk kishin hyrë në ndonjë kopsht të huaj, kurrë nuk ishin zënë me kë. Ashtu dhe mbetën. E mësuan zanatin e këpucarit, hapën dyqanin (dyqani ka nafakë!) u vajti puna mirë. Trashëguan shtëpinë dhe pasurinë, si do Zoti! Nuk kishin përse të druanin, kurrkush nuk do t'i prekte me dorë. Ikën nga të mirat, i ranë bukës shqelm.

Do t'i hedhin nëpër miniera e gurore, në burgje të lagështa, të plasin dhe të mallkojnë qumështin e nënës, të pendohen pse kanë lindur. Tjetër gjë është kur dikush, si Hasa i Merdos, në grindje e sipër e vret njeriun, apo i merr gjakun vëllait; si Mujaga Rashiqi dhe s'i mbetet tjetër pos të ikte përtej kufirit.

Pas tyre shkoi dhe vëllai më i vogël, Stevani, fëmijë, sapo kish shkelur të njëmbëdhjetat. Natën u përvodh nga shtëpia, në mëngjes morën vesh se nuk ishte më, i kish lënë porosi dy-tri fjalë, sa ta dinin se ka ikur. Në fillim menduan se ishte fshehur diku - në tavan, në hambar, në kosh apo në pleme, te kushërinjtë apo ndonjë shok, siç e kanë zakon të bëjnë fëmijët - ikin dhe saora pendohen, lusin Zotin që t'i gjejnë sa më parë, u vjen turp të paraqiten vetë.

E ëma thyen duart, shpreson dhe druan, frikësohet dhe gjëmon.

Vrapuan përreth, e kërkuan, hallakatën, u futën nëpër shelgjishte dhe lajthishte, dolën te lumi, shkelën nëpër moçale dhe ujë amull.

U pajtuan me fatin: në qoftë se nuk e ka vrarë patrulla, nuk e kanë hëngër qentë a ujqit, qafën e theftë!

Depërtoi nëpër terr grykave e gërdhatave, ngushticave dhe andej nga s' kish fare rrugë. Edhe ditën e kish kaluar andej, pëllëmbë për pëllëmbë siç dinë fëmijët, do të ishte me rrezik. Evitoi pusitë dhe rojat, edhe mizë të ishte do ta diktonin! As qentë nuk lehën pas tij, as degët e shtrira të lakohen a të lëshohen, as guralecët të luajnë vendit dhe të rrëshqasin. Mbahej për rrënjë, për tokë dhe për bar, rrëshqiste, rrëzohej, i gërvishtur dhe i lënduar sa s' bën, veç ecte përpara.

Mëngjesi e gjeti ndonja njëqind metra nga kufiri. E pa piramidën, e joshi të fluturonte pranë saj. Shikoi mirë e mirë dhe i pa ushtarët që përgjonin pas pritës. Ia kishin kthyer shpinën. Shikoi dhe prapa - edhe atje kish ushtarë, u habit sa kish kaluar pranë tyre. Tashti ishte si i ngulur mu në mes të dy palëve, si i zënë në kurth. Nuk guxon të presë. Këta përpara as do të arrijnë të shtinë, do të kalojë rrëmbimthi pranë tyre, e ndoshta as që do ta gjuajnë, do të shohin se është fëmijë. Gjithandej mëdyshej: a të qetësohet e të presë, më mirë t'i pushojë ca këmbët, që i dhembin si t'i kish prej hekuri, mund ta lëshonin dhe të kalamendej. Edhe sytë i digjnin, e besa, zuri edhe të ketë frikë. Pak më parë, kur ishte më vështirë dhe më rrezik, nuk u frikësua, nuk çau kokën aspak, e tash po dridhej. Nuk guxon dhe as që do më të presë, tash do të kërcejë dhe do të fërshëllejë rrafshit...

Hoqi opingat, zhveshi fanellën e shqyer nga ferrat dhe degët...

Mu në atë çast e vunë re, u ngritën, u thirrën ushtarëve përpara - t'ia zinin rrugën...

- Mos andej!.. Mos andej!

Zëri u përdrodh dhe u shndërrua në klithje, në lutje dhe gjëmë:

- Mooooooos andeeej! Mooooooos!

Një ushtar gati e zuri, iu hodh sipër, po Stevani u drodh, iu shkëput nga dora dhe si shigjetë fluturoi përpara.

- Mos shko andeeej! Ndaluuuuu, o çun!.. Mos ki frikë!..

- Mos, Zvonkoooo!.. Mos, Zvonkooo! - zërat kryeqëzoheshin dhe ndesheshin, shkrepnin, u qitnin xixa para syve, klithën:

- Mooooos!.. Mooooos!..

Ushtari Zvonko Vabec e dëgjoi, e dinte se ç' gërthisnin, por nuk mendoi për vete, vetëm të arrinte para djaloshit.

- Ooooo, çun! Minaaaaa!.. Kujdes!...

Çuni e kaloi, Vabeci u hodh për tokë, e mbuloi kokën me duar. Si ta kishin çarë rrufetë tokën, shpërtheu dhe mbuloi, krisi dhe gjëmoi, tundi tokë e qiell!

Si i gjuajtur me ndonjë mjet të fuqishëm, Stevon e hodhi mina përpjetë, me duar dhe me këmbë të hapura... U dridh dhe u ngrit trupi i Vabecit, u shtrembërua dhe u rrotullua, u bë kaliboç dhe ra për tokë. Mbi të, si prej qielli, ranë buca dheu, myshku dhe degësh. Mori të ngrihej, por e tradhtuan dhe duart, edhe këmbët, e lanë, ra me fytyrë në bucat e thyera. Ende s'e kish humbur vetëdijen, ua nguli sytë shokëve që ishin përkulur mbi të, u habit ç' kishin që silleshin e vërtiteshin, e thërrisnin, ndërkohë që i flitej, që aq shumë e merrte gjumi, se mos ka gjë më të bukur se gjumi!

E fundit që iu kujtua qe fëmija, ishte varur me duar në një degë, luhatej dhe ciaste, kënaqej... Luhatej... luhatej...

- Po luan!... - dëgjuan të pështpëriste.

Një javë pas varrimit të Stevanit (ushtari Vabec mbeti gjallë) qytezën e dridhi, e tronditi dhe e tërboi lajmi se në kufi ra edhe një viktimë - Meho Kamariqi!

- E vranë Mehon!.. U vra Mehoja!..

(Zuvdija Hoxhiqi: "Ylli i Davidit" (përktheu - Ramiz Kelmendi), "Buzuku", Prishtinë, 1996;

Titujt i nxorëm nga vet teksti - H. U.)

ALI M. AHMETI

LLAMBA

Llamba - ylli
I jetës sonë,
Që lufton
Kundër errësirës
Shtrigë
T'ia tregojë,
Bimës bukurinë,
T'ia shtojë
Lumit shkëlqimin,
T'i madhërojë
Shkollarit
Rrugëtimin,
Shendin e gëzimin,
Njeriut të vogël
Ngadhënjimin.

ASLLAN BISHA

NË PELLGUN E LUMIT

Rrezja e ditës së re kishte larë horizontin. Ajo ishte zgjuar para gjyshit peshkatar.

Ai përgatitej, ndërsa Beni flinte si qengji.

“S’ bën ta trazoj! Ndoshta në gjumë nipi im e zë peshkun më të madh të detit, që ka hyrë në lumë! E ka mashtruar rrjedha dhe, levreku, kur është i uritur vetëm hap nofullat e forta. Atij asgjë s’i shpëton pa bluar në lukth “ - fliste me vete gjyshi duke pirë kafenë.

- Ç’ të gjeti, pse je çuar kaq herët? - e pyeti gjyshja.

- Do të shkojmë në peshkim me Benin në Bunë. Koha është e mirë, do të peshkojmë... - sqaronte gjyshi.

- Ah, ç’më gjeti! Do ta marrësh në qafë djalin. Do ta bësh peshkatar! Do të jetë si ti, i përbaltur, i lagur, i lodhur... Kurrë - në shtëpi! Jo, s’ta jap! Kemi një djalë, ai të na bëhet peshkatar?! Jo, jo, Beni s’ do të bëhet peshkatar! Është mirë dhe mos ia fut në zemër zejen e ujërave. Pale, na ftohet djali! Le të flejë, mos e trazo! Ti shko ku të duash, ti edhe tjetër zanat nuk di... - hidhërohej gjyshja në mëngjes duke pirë kafenë dhe duke qortuar të shoqin.

- Djali është i rritur, i mençur, le të bëhet çka të dojë, por unë s’e bëj me zor. Ai më lutet pareshtur dhe më thotë: “Gjysh, ti më ke premtuar se do të më marrësh në peshkim nëse jam shembullor në mësime!” Ai e bëri këtë dhe mua s’më mbetet tjetër përveç se t’ia plotësoj dëshirën!

- Ke folur me djalë dhe me nuse? Beni është i dobët me shëndet.

- Mos u merakos! Është i fortë. Ata dy do të gëzohen kur të peshkojmë ne. Peshku piqet e helli nuk digjet. - tallej plaku, ndërsa gjyshja luante kokën.

Ajo s’ do ta zgjonte Benin as kur dielli të ngjitej mbi kodrën e Pinjeshit.

- Çohu, he burrë! Zgjohu, o peshkatar! - thërriste gjyshi nipin, kurse Beni, si i hutuar, i përgjumur, brofi në këmbë.

- Laji faqet, pastrohu! Ty po të pres, - fliste e këshillonte gjyshi, ndërsa gjyshja zemërohej edhe më shumë:

- Po e merr në qafë djalin!

Pas pak Beni u vesh. U nisën. Edhe Beni ishte ngarkuar mirë.

- Qëllofsh! Të pastë gjyshja! Ruaju! - uronte plaka dhe vërehej se hidhërimi i kishte kaluar si kalon reja mbi Pinjesh.

- Mos u brengos, se po shkojmë në piknik, gjyshe! - gëzohej Beni.

Zbritën me nxitim në mol.

Ujërat e detit ishin të pastër si ëndrra e Benit. Deti shkëlqente si një fushë e pafundme, si pasqyrë magjike, ndërsa kur bashi çau detin e hapur, një puhizë trazonte faqen e detit. Valëzat e vogla nxitonin njëra pas tjetrës deri në bregun ranor. Aty puthnin rërën e butë. Guri i Gjeranave dukej më i madh. Në ujë dhe në tokë dukej çdo gjë e qetë e rrafshinore. Në anën e majtë dhe në verilindje dukeshin pirgjet e maleve, si dhëmbët e gjyshit. Pellgu i Bunës dhe rrjedha e lumit preku bashin e lundrës. Motori gumëzhinte më shumë. Shpejtësia e lundrës zvogëlohej. Kjo e gëzonte Benin. Ai ngopej me bukurinë e pellgut, ishte, disi, më i qetë dhe më i sigurt. Tash bregu ishte edhe një bërçik dhe shelgjishtet lanin fytyrën në lumë. Vorbulla i freskonte kurorat e tyre. Dhe dukej se pellgu i ujërave nxitonte në mes brigjeve gjelbëroshe për t'u puthur me lumin.

Në brigjet e Shën Kollit, në një gji, gjyshi lidhi bashin dhe bëri gati rrjetën. Ngadalë e lëshoi në ujë, murmuriti sikur lutej. Çdo gjë e bënte me mjeshtri.

- Tash e kryem punën, dalim në breg. Kemi kohë për të pritur dhe peshkuar me kallam. I bëjmë grepat gati. Para nesh është një ditë dhe fati. Duhet të përpiqemi shumë, pa u munduar s'ka as peshq!

Beni iu afrua lumit. Mbeti i stepur. Nuk mundi të fliste asnjë fjalë...

Një levrek i madh, ngjyrë kafeje, u duk me kokë të madhe, me sy kureshtarë dhe me gojë të madhe. E lëvizte bishtin me nervozizëm.

Para tij - një peshk, në rrënjë të frashrit. Strukej, strukej dhe ishte mbledhur si lejleku para furtunës. Këqyreshin sy më sy! I madhi priste me gojë të hapur për të ngrënë të voglin, posa të dilte nga cekëtina. I madhi hapte gojën, mirëpo peshku i vogël rrinte i strukur, rrinte i heshtur. Priste me durim dhe të dukej se thoshte: Ndihmë! Më Ndihmoni! Edhe pse jam i vogël - unë e dua jetën..., mëngjeset e lumit. Vetëm natën fle në rrënjë, se të mëdhenjtë ta bëjnë natën ditë! Ndërsa dita është më e vështirë.

Ashtu do të zgjaste shumë kohë, por zëri i gjyshit i thekshëm u dëgjua:

- Ku je Beni? Beniii!

- Këtu jam, gjysh! Po vështroj levrekun. Sa i madh është! - sqaronte Beni, ndërsa peshku i vogël qëndronte i strukur në rrënjë, s'ua vinte veshin fjalëve të gjyshit dhe zërit të tij të thekshëm.

- Ai është në rrezik. Hë, more bir, e sheh peshkun e vogël - s'i largohet bregut. Aty, në cekëtinë, në rrënjë, gjen shpëtim, se peshqit e mëdhenj s' mund ta fusin nofullën.

- Do të ishte mirë ta frikësojmë, të shkojë në rrjetën tonë dhe ta mbrojmë peshkun e vogël, - foli Beni.

- Mos e luaj, por vështroje ngjarjen! Durim, Beni!

Dikur peshku i vogël la rrënjën ngadalë, duke vështruar majtas e djathtas, por gjithnjë buzë bregut dhe - shpëtoi nga rreziku.

- Si është e mundur kështu!? - pyeste Beni.

- Kështu ndodh vazhdimisht, - luante kokën gjyshi...

U mendua pa, dhe zuri t'i tregojë nipit:

- Jemi në pellgun ku bashkohen ujërat. Këtu janë peshqit e mëdhenj dhe mrekullitë e mëdha. Ndodhin gjëra të pabesueshme! Ti përjetove diçka dhe kjo është hera e parë.

- Po, gjysh! - fliste Beni ngadalë.

Dikur tha:

- Ti, gjysh, çka ke parë të jashtëzakonshme?

Gjyshi luante herë mustakun herë kokën. Përpiqej për t'i tregua nipit ngjarjen më të mrekullueshme, më të jashtëzakonshme. Nuk dinte nga t'ia niste. Kishte shumë ngjarje të përjetuara, të cilat pritnin të shpalohen. Ai filloi të rrëfejë:

- Ishte mëngjes i parë vjeshte. Frynte një erë, zhubraviste ujërat e Bunës. Mëngjesi lëshohej ngadalë mbi kurorat e frashërve, të shelgjeve, kurse kori i bretkosave nuk dëgjohej, përveç ndonjë krrokamë pulëbardhash.

Në një çast, u dëgjua një krismë nga uji, si dallgë në Bunë, diçka e çante ujin. Peshq të zhdërvjelltë, gojëhapur nxitonin. Rrëmujë e vërtetë! Luftë! U habita kur pranë këmbëve të mia, në breg, më ranë nja tre peshq: qefuj gushtakë, të cilët, nga rreziku i gojës së lojbës grabitqare, peshkut të detit, kërcyen në breg për të shpëtuar dhe ranë në lëndinë.

Edhe peshku i vogël kur është në rrezik del në breg. Jeta është e ëmbël! - sqaronte gjyshi.

- E kemi mësuar në biologji. Lufta në natyrë për ekzistencë!

- Jeta është luftë - qeshet gjyshi - prandaj duhet të punojmë, t'i përgatisim grepat! Ndoshta ai levreku i uritur s'e ka zënë peshkun e vogël dhe i bie karremit, sepse uria peshkun e mençur e hedh në grep, - fliste plaku...

...ndërsa Beni vështronte gjyshin duke përgatitur grepat. Ai tha:

Ndoshta bëhem mësues, mjek, nëpunës!.. por, gjysh, unë kurrë s'do

ta le peshkimin. A ka gjë më të bukur se buzë lumit ku lahet peshku, lejleku dhe shelgu?! - foli Beni.

- Edhe ti mund të lahesh, Beni, por prit sa të nxehet dita dhe ujërat!..

... Kështu kemi jetuar nga lumi: unë, babai im dhe gjyshi. Dhe jemi të vjetër sa vetë deti e lumi.

Pra, mëso! Bëju çka të duash, biri im, por duaje dhe ruaje lumin dhe detin, sepse ata janë jeta jonë.

- Po, gjysh, unë e dua detin dhe lumin, - përsëriti Beni, si para më-suesit...

... ndërsa një peshk i ra grepit.

Nisi peshkimi!

IBRAHIM BERJASHI

MALLËNGJIMI

Pulëbardhat ishin mbledhur atë mëngjes mbi Va si asnjëherë më parë. Bëheshin tufë, fluturonin lart në qiell edhe përsëri lëshoheshin si shami mëndafshi mbi liqen, duke dredhur flatrat e bishtat, thuajse po hidhnin valle.

Te Mani i Selimit ishte ulur një plak i moshuar. Sodiste liqenin, lojën e pulëbardhave, Lagjen...

Fanin e prek me bërryl, por sikur s'u kujtua, sikur s'e vërejti plakun dhe u hodh si përherë në lundër duke lëshuar një "hooop" të gjatë. Unë s'e shkëputa shikimin dhe, pa një pa dy, ia prita:

- Natja e mirë, o gjysh!

- Mirë se vini, çuna!

Fani i habitur një herë u soll nga unë e pastaj me të shpejtë përshëndeti dhe ai plakun me fytyrë të zverdhur e plot rrudha, thuajse s'e kishte parë dielli me mote të tëra. Iu afruam. Na zgjati atë dorë të butë, por disi të akullt, së pari mua e pastaj Fanit. U ngrit edhe një herë duke na puthur në ballë.

- Të keqen gjyshi! - foli me një zë të hollë edhe kokrrat e lotëve iu rrokullisën nëpër mollëzat e nxjerra të fytyrës.

- Po vini nga ndonjë vend i largët? - pyeti Fani paksa i shqetësuar.

- Shumë! - ia ktheu plaku shkurt.

- Sigurisht jeni i lodhur, pa fjetur... - shtova unë.

- Ejani të çlodheni në kullën tonë! - thirri përsëri Fani.

Heshti ai, heshtëm edhe ne. Fani u soll nga unë, ngriti vetullat edhe tundi kokën në shenjë pendimi, mbase e qetësuam. Por jo: ne vetëm i uruam natje të mirë edhe e ftuam në kullën tonë. S'ka asnjë të keqe këtu. Po habitem që s'u falënderua për këtë mikpritje, vërtet modeste, por e sinqertë.

- I shihni ato mure? - tha edhe me njërën dorë shtrëngonte valixhen e mbushur me tiketa, kurse me tjetrën mbante në xhep një fyell që vizëllonte sikur të ishte i praruar.

- Po! - thirrëm përnjëherë unë e Fani.

- Ajo ishte kulla ime, - tha dhe tundi kokën.

Atëbotë m'u kujtua mirë kulla e mbuluar me tjegulla të vjetra. Kisha frikë se Fani do të thoshte se unë kam qëlluar më shumë tjegulla. Dreq o punë, po të ndodhej këtu. Afrimi nuk kishte pritur asnjë sekondë edhe do t'i kishte thënë:

- Ky Jani mban rekordin në tërë Lagjen, është shpallur shenjëtari më i mirë, sepse çdo ditë kas thyer nga dhjetë copë tjegulla. Kjo një çikë ma lehtësoi në këtë çast frikën.

- Unë jo, por ky çuni ka gjuajtur pullazin e kullës me gurë! - megjithatë tha Fani, duke nxjerrë veten krejtësisht të pastër.

- Gjysh, më kuptoni, ju betohem me kokë të nënës, një ditë kam hedhur vetëm një gur. Ndodhi disi rastësisht. Një sorrë kishte zënë vend në majë të kullës edhe këndonte një këngë aq të tmerrshme, që edhe liqenin e rëndoi në shpirt. Ia bëra "ish" e "ish" - nuk e ndërpreu atë këngë që rrëqethte njerëzit. Atëherë mora një guralec për ta përzënë atë shpend ndjellakeq. Sorra iku e paqëlluar, por, për fat të keq, godita një tjegull. Më vjen shumë keq që ndodhi ashtu! Nuk iki, për dëmin e bërë jap llogari, shkoj në qytet, blej tjegullën...

Fani vuri buzën në gaz e mua m'u kujtua Ajkuna.

Ndjesë pastë, plaka që na ndiqte sa herë hynim në kullë edhe luanim lojën e Tarzanit.

"Hë, mua më shpallnin kampion në shenjëtari, sepse të gjitha tjegullat i qëlloja me të shigjetën time magjike. Fol tash, Jani trimi, fol! Si do të arsyetohesh nëse Fani do të tregojë fill e për pe?"

...

- Një ditë, herët në mëngjes, kur tërë lagjja po flinte ëmbël, mora

udhëtim të gjatë... Ajo rrugë ishte me shi, borë e valë deti. Më shpuri në Australi, pikërisht në qytetin Melburn. Ishte atje botë me shije pelini. Te zotëri Vilsoni zura punë si kopshtar. Punoja ditë e natë. Pas pak kohësh u njoha me Romanellën. Në krye të motmotit lindi Klaudia, bija ime që aq shumë e doja. Çupëza u rrit vashë me nam. Për çdo mëngjes më pyeste për vendlindjen time. I tregoja kallëzime për liqenin, peshkatarët, lundrat, për Lagjen... Romanella vdiq nga tuberkulozi, kurse Klaudia u martua me një astronaut në Zelandë të Re. Pas dy vjetësh martese më dërgoi një letër për të më treguar se i kishte lindur djalë edhe se më kishte qëndruar besnike - e kishte pagëzuar djalin Mërgim. Shtatë vjet prita se do të më lajmërohej Klaudia ime, por jo. Shtëpia ku jetoja u bë rrafsh me tokë nga tërmeti. Zotëri Vilsoni kisha harruar qyshkur kishte vdekur. Netët, të shumtën i kaloja nën pullaze. Pastruesit e qytetit një natë për pak nuk më hodhën në kontejner. Çunat e lagjes grumbulloheshin rreth meje dhe më lutnin t'i bija fyellit. Kënaqeshin me melodité tona që s'i pata harruar nga fëmijëria. Shkoja me qengja Faqes së Qershisë e luaja me fyell. Duke dëgjuar tingujt magjikë, peshkatarët ndaleshin në liqen, kurse vashat frymëzoheshin dhe mallin për të dashurit e thurnin në faculetë. Më pagëzuan Ahmet Kavalli. Nuk bëhej asnjë dasmë pa më ftuar t'u lozja me fyell - tha plaku.

- Tash, disi e ndieja veten më lehtë, por më vinte keq që kisha thyer aq shumë tjegulla mbi pullazin e *kullës së shkretë*, ashtu siç e quanin në Lagje.

Pa u mbushur dy ditë, të gjithë banorët e Lagjes u hodhën në aksion edhe ia ngritën kullën e re xha Ahmetit. Më së shumti punuam unë e Fani. Pasdite i sillnim gazetat që i arrinin me postë.

Nuk ngurronte të na tregonte rrëfime që s'i kishim dëgjuar asnjëherë për Lagjen e Peshkatarët, për Australinë...

Pastaj merrte fyellin.

Kur e përfundonte repertorin, na përqafonte me radhë ne fëmijët e Lagjes...

... Puthte muret e kullës, shkëmbinjtë e Vaut, liqenin - e nuk ngopej.

SHËNIM

Kjo është një përzgjedhje nga antologjia "Degë e drurit të urtë", letërsi e bukur shqipe për fëmijë e të rinj, me autorë nga Mali i Zi, botoi Asociacioni ULQINI, Ulqin, 2008, përgatitur nga Hajro Ulqinaku.

TREGIM

Muzafer ÇAUSHI

AMIR S. NË GANXHAT E KOJSHIVE

Asaj natës së parë në shtëpinë e Razies, në dhomën e huaj, në shtratin e huaj, as që mbylli sy. E ka shikuar tavanin, i ka përcjellë me sy plasat nëpër të dhe i vinte të qante. Shihte fare qartë edhe pse ka qenë natë, edhe pse drita në dhomë ka qenë e fikur mund të shihte ata sy të pikëlluar të sutës dhe kaprollit në tapetën e madhe në mur, kundruall shtratit të tij.

U çua, e mënjanoi perden dhe shikoi në oborr që rrinte ngushtë dhe shtrëngueshëm në mes të tri shtëpie, të moçme dhe virane. Në mes të oborrit, të shtruar me kalldrëm, në degët e arrës rrinte varë një poç i madh elektrik, që hidhte dritë mu në dritaren e tij dhe i mblidhte të gjitha insektet e dynjasë.

Mendonte në shtëpinë e vet, në shtratin e vet, në shokët e vet, në shkollën e dikurshme...

Ka qenë lehtë të vendoset për shkollim, që ta vazhdojë në qytetin e madh, kur ai ishte larg, kur kujtimi në Sarajevë ishte vetëm Bashçarshia dhe aromat e saja dehëse, Vrello-Bosne dhe Aleja, “Bijelo dugme” dhe “Indexi”...

Tash këtu i duhej të shkonte në shkollë ku askënd nuk e njeh, të kthehet në shtëpinë që është e huaja, të mendojë në ushqime, në çorapet dhe brekët e pastra; ka ditur ndonjëherë edhe të kollitet, të ketë temperaturë dhe ta qesë barku... është dashur të jetohej.

Babai nuk ndenji të bunte te teto Razia, edhe pse ajo e luti dhe i bëri be.

- Për djalin mos ki dert, tash është fëmija im. Edhe njëqind vjet të

jetoj, unë nuk do t'ju dilja hakut për të gjitha që ju keni bërë për rahmetliun dhe për mua! – i tha Razia duke e përcjellë deri te porta.

Ai ia dha dorën, iu falënderua dhe pastaj e përqafoi fort Amirin, e shtrëngoi sikur kurrë më parë.

Amirit iu duk sikur fliste me vaj, ndërsa i thoshte: të bëhej i mirë, që të mësojë mirë dhe të ruhej...

Teto Razien e njihte që nga vogëlia. Çdo verë, nga një muaj, me Akifin e vet e ka kaluar tek ata, në det. Aq shumë janë afruar me ta sa që kur nuk i kanë pritur më si turistë, por sikur të ishin kushërinj të lindur. Veç një sofër shtrohej, ndonjëherë kanë shkuar bashkë në plazh dhe çdo natë, deri vonë, në oborr nën tendën e hardhisë kanë biseduar gjatë e gjatë.

E vendosi në dhomën përdhese, pranë derës së shtëpisë. Nën shkallët që çonin në kat, në dy dhomat e tjera të shtëpisë së Razies, ishte një banjë e vogël dhe një magazinë. Dhoma ishte e madhe, në mes të saj ishte shtrirë një qilim i madh me lara, ndërsa poçin elektrik, që ishte në vend të lusterit, mund ta prekte me kokë. Në dritaren e vogël dhe të ngushtë ishin grilat prej metali, ndërsa në pragun e shtëpisë ishin dy teneqe të marmelatës në të cilat lëshonte aromë fisligeni.

"Jam në hapsanë, ndërsa jashtë është avllia e mallkuar, nuk kam shpëtim" – mendonte duke u kujtuar lektyrës shkollore...; shtrëngohej të mos e kaplonte vala e lotëve që ishin gati dhe prisnin në kapakët e syve.

Mëngjesi i parë i Amirit në Sarajevë lindi i mjegulluar, por që dielli shpejt doli dhe premtoi një ditë të bukur shtatori. Ishte zgjuar, por rrinte në shtrat i mbuluar deri në fyt dhe s' dinte çka të bënte. Në shkollë duhej të shkonte pasdreke dhe s' kishte kurrë një obligim. Priti ta thërriste teto Razia, që ta pinte një gotë çaj ose qumësht, ashtu siç ka qenë mësuar në shtëpi.

- A ke fjetur mirë, djalosh? – ishte e gëzuar ajo në shkallë.

– Eja, lart, more, ne qe një gjysmë ore po pimë kafe!

U pastrua dhe u vesh, mandej me marre e me pritesë, hipi nëpër shkallë dhe, kur qe në gjysmë, u ndal dhe vuri vesh.

Razia me zë të lartë i fliste dikujt se me vite te prindërit e tij, me rahmetliun Akifin, i ka kaluar verat. Burri i gjorë, për të zënit e frymës, ka kërkuar derman duke shëtitur nëpër Pyllin e Pishave, gjatë bregut të detit. Ndërsa ajo në "Plazhin e Grave" e ka lutur Allahun, diellin dhe ujin squfurik t'ia falin një fëmijë, që digjej e përvëlohej për të.

- Edhe brekët e Akifit i kam sjellë tri herë nëpër gurin në det, ashtu

siç më kanë mësuar, dhe jam djegur çdo ditë në diell, dhe atë ujin e qelbur e kam pirë dhe, kot!... – dëgjonte Razien e shqetësuar...

- Është dashur, Rozë moj, ai Akifi yt çdo ditë të ta ngulë, çfarë deti, gjepura! – me lezet qeshte mysafirja.

- Turp, moj rospi, veç ato punë i ke në mend! – qeshte Razia.

Kur më vonë i njoftoi komshinjtë, Amiri e vërejti se Semra, fqinja nga shtëpia Dedos, kurrë nuk ka mundur ta hidhëronte Rozin, siç e thërriste me sherri.

Razia e donte atë dhe të gjitha ia falte, asaj që ishte së paku nja dy decenie më e re.

Ai e pinte qumështin, ato i ofruan kafe dhe cigare.

Semra gëzueshëm e pyeti për shkollën, për të gjitha; i tha se e ka edhe ajo një kushëri student, një djalosh të hijshëm, si Amiri.

- Pa shihja syrin, moj, shiko, një gjysmë të Sarajevës do ta rrotullojë ky fëmija yt! – qeshte dhe e thumbonte Razien.

Amiri i turpëruar me padurim priste që fqinja të shkonte, veç edhe ajo i mungonte, sikur të mos i mjaftonin hallet e tij...

Klasa e tretë të shkollës së mesme të mësimit të orientuar, drejtimi teknik dentist, klasa e tretë dy, ishte një paralele e mirë dhe të shoqërueshëm. Vajza dhe djem të qytetit, me foret dhe fazonet e tyre dhe, që të gjithë në mes vete njihen mirë, ndërsa vetëm ai ishte i ri dhe nga larg. Prej shkolle ngutej për në shtëpi, thoshte se është i uritur, se mezi që pret të hajë darkë, ndërsa në të vërtetë ai ikte në vetminë e dhomës së vet, në atë vendstrehim nga të panjohurit, të huajt.

“Nuk jam unë për këtu!” – mendonte, ndërsa Razies i përgjigjej se nuk mund të delte natën me shoqëri, sepse ka shumë për të mësuar...

Jasna, një vajzuke e lezetshme, bionde, që rrinte në bankën pranë, e thirri në ditëlindje, do të shkojnë të gjithë të klasës, do të jetë një gazmend i vërtetë, pleqtë janë në shtëpinë për pushime, lezet, birra - një vagon...

Ky nuk shkoi, kishte marre për këpucët e veta, ndoshta demode, kishte frikë për theksin e tij, nuk i kupton shpotitë e tyre, e ai shpesh as që kupton se për çka flasin dhe për çka qeshen ashtu si të marrë...

Dritarja, pamja e saj në oborr, në atë botë të vogël – e vetmja gjë që këtu tash e njeh mirë, ishte një ambient në të cilin më së lehti e kalonte vetminë e vet.

Pitet dhe dollmat e teto Razies, hurmadiet dhe kadaifi; cokatja e vazhdueshme e Dedos me çekiç dhe daltë, dhe ajo mërmëritje e bezdisshme; këngët e Semrës dhe ngarendja e çdoditshme nëpër oborr;

vrapimi i Shefikës dhe Tufit pas Dinos; shkundja e zbokthit nga pardesyja e tij... i jepte ngjyrë vjeshtës së hershme sarajevase të tij...

- Sy, kur të kthehesh prej shkolle, bjerë qebapa nga Bashçarshia, hajt, pashë nënën, qe paratë, le të shtjerë në somun edhe mjaft qepë. Hajt, sy, bëj sevap, shih si jam ligështuar, të puth Semra! – vraponte pas tij me gëzim dhe ia fuste dinarët në dorë: - Merr edhe për vete, Rozi, patjetër!..

Hanin qebapa, Semra, fëmijët e saj, Razia dhe ai.

Në dhomën e vogël pranë rrinte e palëvizshme vjehrra e saj dhe Semra në një tabaka ia sillte qullin që ajo e hante çdo mbrëmje.

- Ki kujdes! – i pëshpëriti Razia: - Ajo ka zemër...

- ... më të madhe se sisën! – ndërhyn Semra duke qeshur, pastaj u bë serioze, e shikoi Amirin dhe i tha që të bënte qejf derisa është i ri, pa halle, derisa jeta të mos e shtrëngojë nga të gjitha anët... – i fliste kështu djaloshit, i cili ishte i sigurt se më të munduar se ai në këtë botë nuk kishte.

- A është lajmëruar Haruni, a do të vijë shpjet këtu? – e dinte Razia dhe çka e mundonte.

- Duhet të vijë diku kah fundi i muajit të ardhshëm, nëse e lejojnë. Atje në atë punishte në Irak janë sikur në burg, s'ka asgjë, as njeri, shkretëtirë, mori, veç që rrogat i kanë të mira. Qe, kam mjaft para, asgjë nuk më mungon. Kujton se unë e kam lehtë me dy fëmijë. Midhadi është në klasën e parë, ka nevojë për ndihmë, ndërsa unë gjë s' di... Amra - në foshnjore, e ajo e mjera vetëm në atë dhomë vetëm, mos vet, kupton... ti s' paku e di... Mirëpo Zoti e ka dhanë Semrën të gjallë, të gëzueshme, s' dorëzohem unë, Rozi ime, s' jepem, këndoj edhe kur më vjen të qaj... – shfreu thellë.

- E di, të gjitha i di, edhe si ky Dedo baksuzi, çdo të parin e muajit ju kapet për para, se duhet t'u dërgosh atyre të tuve në Hercegovinë dhe, si duket të jesh pa mashkullin, të gjitha i di. Mirëpo Allahu të ka dhënë fëmijë të artë, të ka gëzuar me ta, t'i ruajt, shpirti i Rozit!..

Amiri shikonte se si Semra me lezet hante një mollë të madhe plot lëng, shikonte dhëmbët e saj të shëndosh, shihte si i rridhte lëngu i tharbët prej goje. Fillimisht kujtoi sa e bukur është ajo, sa e gëzueshme që ishte, sa kënaqësi është me të, shumë më kënaqësi se me shoqet në shkollë, edhe pse ajo i kishte, as vet s'e di sa, nja tridhjetë vjet...

Të shtunën u ngrit më vonë se zakonisht, doli në dritare dhe e pa Dinon që i avitej Dedos. Kishte kërkuar që ta ndizte cigaren prej tij, ndërsa Dedoja me rreptësi ia shkrepi se atje poshtë sokakut është kiosku

dhe se aty ka shkrepëse, andaj le të blejë për vete. Dinoja vetëm buzëqeshi dhe doli nëpër kapi. Në atë çast, në pragun e shtëpisë së tij, e para me të hyrë në oborr, kërceu babai dhe nëna e tij dhe të brengosur shikuan në kapinë e mbyllur, nëpër të cilën kapërceu djali i tyre...

Dinoja ka qenë, të gjitha tashmë ia kanë kallëzuar, student i vitit të dytë të Zhurnalistikës, ndërsa tash gazetar i parë në "Nashi dani". Për tekstet e tij gazeta edhe është shitur më së shumti. Ishte i mavijosur në fytyrë, edhe me qeska të syve edhe më të nxira, i gjatë, por i kërrusur. Flokët e gjata gjithmonë të yndyrshme i hidhte pas koke, ndërsa në cep të buzëve mbante bishtin e cigares...

Amirit i ngjasonte në një figurë nga stripat, por që s'i kujtohej se cili...

- Ta them unë ty, Rozi, nuk bëhen fëmijët në pleqëri, prej materialit të vjetër del malli i dobët. Pa shihe si duket – asfare, i shëmtuat, i heshtur, i keq.

Semra ishte një njohëse e mirë..., ndërsa Razia për këtë sa herë i thoshte se është një djalë i mirë dhe i urtë, por që këta pleqtë baksuza do ta luajnë mendsh plotësisht. Ata veç vrapojnë pas tij, vishe - zhvishe, a ke hëngër - a ke pirë, a e ke bërë shurrën - a e ke bërë kakën?.. Këtë vit është dobësuar shumë, është tkurrë në krahë fare, ngjyrën e fytyrës e ka të keqe...

Po atë natë, kur Amiri u bë gati të binte të flinte, pasi që sa e sa herë i kishte lexuar Alan Fordët që i kishte në dhomë, nëpër dritare dalloi se kah fundi i oborrit, mu pranë murit afër kapisë, kaloi një figurë. E njohu Irfanin, kushëririn e Semrës, studentin dhe u habit pse ashtu, në atë kohë, ikën nga e afërmja e vet....

E zgjoi kënga e Semrës, e kishte ngritur zërin, të shëndoshë, fshatarak, ashtu siç vetëm dinte. U ngrit pa qejf, shikoi përtej dritares dhe e pa se si ajo, në mes të oborrit lante qilimin. Në këmbë kishte të mbathura do çizme të shkurtra, ndërsa fustanin e shtëpisë e kishte ngritur deri mbi ije, e kishte futur mes këmbëve dhe qëndronte në gjunjë lakuriq, në atë qilim punë dore. Amiri i shikonte ato këmbë të bardha, ia shikonte gjinjtë, e mëdha dhe të çliruar në atë fustan të hapur në gjoks, e pa si i frynte ballukes së ballit që ta hidhte pas koke. Rrinte pas perdes si i gurëzuar, por kur kah ai ajo e ktheu atë prapanicën e madhe rrotullake, kur i vërejti shalët lakuriqe, aq të bardha si bora, zuri të dridhej. Ia mori sytë ajo bardhësi e brekëve të saj, që i ishin rrasur në të çarë të prapanicës dhe, i mbeti fryma...

Nuk e vërejti në derë të dhomës teto Razien, kur ishte hyrë me qëllim

që ta zgjonte, e ajo kur e dalloi se sa ishte dhënë pas shikimit jashtë në oborr, iku jashtë dhomës.

Pas pak Amiri dalloi se diçka me hidhërim dhe me nervozë kjo i fliste Semrës.

Ajo vetëm buzëqeshi dhe, posa Rozi hyri brenda në shtëpi, u soll, shikoi kah dritarja e tij dhe ia bëri me sy...

Tërë ditën e kapërceu në një turbullirë që s'e kishte përjetuar deri atëherë. Nuk doli askund, nuk mundi të hante drekë, andaj Razia u brengos, orë e çast zbriste poshtë ta shikonte. Rrinte ratë dhe iu kujtohej vitin e kaluar Olga Prohaskowa, mysafire e një hoteli në të cilin ka punuar si kamerier dy muaj.

Me të, një vajzë jo fort e bukur nga Praga, për pak sa nuk ka... Se ajo kanë qenë më të bukura dhe më tërheqëse Ute Reich dhe Renata Witkova, me të me krenari ka shëtitur nëpër korzo. Ka shkuar në vende ku bëhej muzikë, kanë luajtur dhe vallëzuar, janë puthur dhe ledhatuar, por Ollga ka dashur, ajo ka pranuar! Ajo pas mesnate, në plazhin e hotelit i është dorëzuar e tëra, pak ka munguar, ndonjë minutë...

– Ollllgaaaaaaa! – u dëgjua në bregun e qetë të detit çirrja e nënës së saj.

Ajo me robëdëshambër, kishte dalë jashtë hotelit që ta kërkonte, e krisur nga frika dhe u gjend bash kur..., e ajo qëndronte shtrirë pranë tij, brekët veç i kishte hequr, merrte frymë ashtu...

- Sy, kallëzoi Dedos çka ndodhë, nëse dikush, kështu, këtë bash-Boshnjak, e lan me ujë valë? – e nguci qiraxhiun e vet Semra e krisur.

- Çaj prej ahu! – pa ndonjë qejf që të futet në lojë, iu përgjigj nxënësi i klasës së tretë.

- Djalosh, po çka bëhet kur Herën e mbështjell në petë të pites?

- Pite me mut! – kënaqej Plaku, ai plak rrotullak, matuf që s' dinte tjetër, por të përqeshte...

Ky gjatë tërë ditës dinte të rrinte para derës së shtëpisë dhe të gdhendte ndonjë dru. E kur i avitej ndonjë kalimtar për ta parë atë artizanat, ai e mbulonte me një pecë që e mbante pranë.

S' ishte martuar kurrë, andaj Semra e gërgiste se do të mund ta merrte Rozin, meqë ajo tash është e vejë, e ky qeshej tinëzisht.

- Meazallah, pas atij Akifi!.. Mos e bëj Zot, ajo do të ishte sikur pas bakllavasë të fusësh në gojë farmak! – rrëqethej Razija, ndërsa Dedoja qeshej që Akifi doli bakllava.

Nëntori erdhi me furi, erdhi edhe bora e parë, e Amiri i rrasur mirë nën jorgan, para gjumit, e mori gazetën e pëlqyer “Startin” dhe nisi ta lexonte një lakuriqe.

Një trokëllimë e lehtë derë, pastaj krikëllima se dera hapet, e detyroi Amirin që atë revistë shpejt ta fuste nën shtrat.

Në dhomë u fut Semra, në këmishë nate, me një xhemper krahëve, ndërsa në këmbë kishte pantofle të zeza. I tha se nuk ka mundur të flinte, se e ka parë dritën në dhomën e tij, andaj erdhi që t’i bëjë shoqëri, që të bëjnë muhabet...

Amirit iu zu fryma, sikur të ishte zënë në hajni, u shtang duke e shikuar atë me habi...

- Po a nuk do që të bëjmë llafe, po shkoj, pra? – i tha ajo e pasigurt...

- Jo, jo, rri, po mirë!.. – belbëzoi ai.

- Bërr, sa ftohtë që është këtu! Shtyju pak të hyjë edhe unë nën jorganin tënd! – i tha Semra dhe, pa e pritur përgjigjen e tij, iu fut nën mbulojë.

Rrinin dhe s’ flisnin, e ai ishte tkurrur, kishte hyrë në krahë. E ndiente pranë vetes atë trup të trashë e të majmur, e ajo iu fut dhe ngrohej me trupin e tij. Gjinjtë e saj të mëdhenj e të butë, e shtypnin atë trupin e dobët të tij, ndërsa këmbët ia futi në mes të tijave dhe e trazuan. Kjo e bëri që edhe ai ta prekte me duar, iu fut nën krah dhe kokën e mbështeti me kokën e saj. Meshkujt ashtu bëjnë, kishte parë në filma.

Ajo ia futi dorën nën pizhame, ia qiti dorën në bark dhe, zuri ta ledhatonte në kërthizë. Ai i mbylli sytë dhe s’e besonte se kjo po i ndodhte...

“Po si kjo, këtu, kështu!” – e trazuan mendimet, ndërsa dora e saj iu rras nën brekë. Ai e dëshironte atë punë, prekjet e saj, i dukej se i ishte rritur, i bërë i fort dru, por prapë kishte frikë se s’ ishte ashtu dhe ajo do të dëshpërohej. Ajo ia preku, e pa se ishte i shtrënguar, i dridhej...

- Mashalla, mashalla, po sa i madh na qenka! – shpotitej ajo, e ky, në këtë çast kaq serioz, s’e kishte në mend të bënte lojëra...

Ajo e mori në dorë, me atë dorë çuditërisht të madhe që dinte të bënte punë... Pastaj ia mori dorën e tij dhe ia futi nën barkun e saj. Ajo ishte lakuriqe dhe gishtat e tij u ngatërruan në pyllin e fshehtë. Kur e preku atë të çarën e lëngshme, ai i eksplodoi. Ia derdhi tërë lëngjet e veta në dorën e saj, nëpër barkun e saj, nëpër shtrat.

U qetësua shpejt dhe i vinte turp, të humbte diku.

Semra edhe ndonjë minutë merrte frymë me vështirësi, e shtrëngonte me këmbë, i rrasej, pastaj edhe ajo u qetësua. Pastaj prapë u ngjallë, u

ringjallë, shpotitej me të, e pickonte, e gicilonte, e prekte gjithkund, e përqeshte sa i vogël ishte tash, i vockël...

Ai kishte dëshirë të qante, të bërtiste, të zhdukej dika...

Semra doli nga shtrati, i tha se është vonë dhe u ngrit. Këmishën e natës e kishte të ngritur lart mbi shpinë, e Amiri si i magjepsur e shikonte prapanicën e saj që shkëlqente nga drita që vinte prej oborrit. Në çast ai iu zgjua, kur as që e priti, kur ishte fjetur, ai u çua, u bë hu, donte të pëlciste. Ky kërceu nga shtrati, e kapi atë me të dy duar pas shpine, e shtrëngoi me trup, zuri t'ia puthte qafën, e duart i humbi në ato sisat e saj. Ajo u mbështet në pragun e dritares, flokët iu derdhën në fisligen dhe, me dorë i ndihmoi ta gjente rrugën. Ai rrëshqiti në të, deri në rrënxë, e tërhiqte nga pas, e rrëmbente, s' e lente të lëvizte, dëshironte ta kishte aty gjithherë. Ai ia qiti duart në vithet e saja të majmura, e ledhatonte, ia shtrëngonte me sa fuqi, e pickonte, s'e kishte imagjinuar kurrë ashtu. Ajo merrte frymë vështirë, mbahej për perden, fryma e saj bënte avull në xham të dritares, ajo i rrasej atij trupi të dobët pas. Ajo ia kapi dorën dhe, si ndonjë shakë e çmendur ia ngjiti me dhëmbë. Ai e hëngri buzën dhe nuk bërtiti nga dhimba. Ai zu të dridhej, të shtrydhej e ajo me sa fuqi e shtrëngonte, e thithi të tërin, s'e lëshoi fare...

U qetësuan njëkohësisht, merrnin frymë me vështirësi, gjithnjë e më qetë.

Amiri, i mbështetur në shpinën e saj, dalloi jashtë se si Dinoja rrinte në pragun pranë shtëpisë së tij. "Sigurisht është i dehur!" – kujtoi dhe, me tërë fuqinë, u hodh në shtratin e vet. Edha ajo u shtri pranë tij, e përqafoi, e puthi në faqe dhe qeshi. Nuk mundi të besonte sa shpejt atë e zuri gjumi, por që ajo frymëmarrje e thellë thoshte se ende ishte gjallë. Rrinte shtrirë, ia shikonte profilin, ashtu si i përhumbur, ishte i lumtur, ishte krenar: ajo ishte e bukur, ishte e tija, e tëra, iu dha, atij...

Ia preku qafën, gjinjtë, ia uli dorën deri te kërthiza, ia shkuli pak ato qime nën... Pastaj humbi në atë, ia ledhatoi vithet, i shkri në atë zhgjëndërr të ëndërruar. Dëshironte prapë, prapë kishte fuqi, ajo e shkrirë merrte frymë, ndërsa ai kujtonte si t'i futej prapë, e të mos ia prishte gjumin, "A mund të bëjë vaki kështu?", pyetej e habitej. Me duar, sa më lehtë që mundi, ia hapi kofshët, i doli përmbi, sa nuk i rrinte pezull, i kërkonte lulen e xhenetit. U ngrit mbi të, me kujdes dhe lehtë e zuri pozitën, e ajo në një çast i ngriti këmbët, e ai me furi i shtyp në të, humbi brenda në të. Nuk e dalloi a ishte fjetur apo zgjuar, por që as që e interesonte ajo punë, dëshironte që në atë pozitë të qëndronte sa më gjatë, të mos ndalej kurrë, të vdiste ashtu, të shkrihej e të tretej i tëri...

- Syri im i vogël, ti je më i krisur se unë! – mërmëriti ajo, ndërsa atij donte t'i delte shpirti dhe mundohej të merrte frymë.

I zgjoi një britmë në oborr. Kërcyen nga shtrati dhe panë Shefikën si vërriste dhe shkulte flokët dhe Tufin që kishte rënë në gjunjë mbi Dinon dhe mundohej ta çonte e drejtonte në këmbë. Në oborr, me ato brekushe të gjata, ngarendi Dedoja dhe Amiri u kujtua se tash për herë të parë e shihte se ecte, për herë të parë nuk rri në atë karrigen e tij para pragut të shtëpisë. Vrapoi edhe Razia me një plaf në shpinë, e rrëmbeu Dinon, e shkundi me forcë, e u kapi për koke, dhe duke shikuar qiellin me re të turbullta, vërriti, me një zë të çjerrë, tmerrues, një zë çfarë Amiri kurrë s'e kishte dëgjuar.

Semra doli nga dhoma me nguti, që të mos e vërente askush. Shkoi e iu avit Shefikës, e kapi me duar të forta, e shtrëngoi dhe e mbajti me sa fuqi, si ta ngulfaste, duke i thënë diçka pa u ndalur...

Dinoja ishte i ftohtë, i bërë dru, i mavijosur, më i zi se kurrë më parë.

- Siç duket, e ka tepruar me dozë! – qetë pëshpëriti mjeku që arriti me Ndihmën e shpejtë.

Të nesërmen Dinoja në tabut e la përgjithmonë oborrin e vet. Derisa xhenazja zbriste sokakut, Dedo te porta dridhej nga vaji. Razia s'e çoi kryet, e tërë e ënjtur, e zezë, e vrazhdë, e Amiri me sy e lypte Semrën. Ajo e kishte në kokë shaminë dhe shërbente kafe...

Me ditë nuk është shtrurë sofra, askush në avlli s'e foli një fjalë, ndërsa Shefika dhe Tufi, të qetësuar me mjete qetësuese, ishin sikur ndonjë bimë.

Amiri më pastaj kurrë s'i ka parë më, por e di se herë pas here ka ardhur motra e tij, sillte diçka nga tregu dhe bënte pak punë në shtëpi.

- Djalë i dashur, ti sigurisht je uritur fort, të të zien teto Razia pak groshë dhe e bën një pite, s' do të hash ti nëpër qytet gjithçka!... – vinte ngadalë në vete teto Rozi.

Pas një muaji u kthye nga Iraku Haruni, burri i i Semrës, një burrë kryemadh, i fuqishëm, një zhurmaxhi i lezetshëm. Të gjithëve u kishte sjellë dhurata, edhe Dedos, dhe tërë ditën e shtynte Semrën që të ndreqej, të rregullohej për bukuri dhe të shëtisnin gjithkah nëpër çarshi.

Një të shtunë para kapisë e parkoi "treqindshin" ngjyrë portokalli, gati i ri.

Semra e puthi, u gëzua më shumë se fëmijët. Midhadi e ngriste dhe e ulte frerin e dorës, ndërsa Haruni e solli Razien duke e mbajtur për krahu, si me dhunë, që ta voziste pak.

- Eja, nxënës, afrohu! – iu drejtua Amirit.

- Mua askush nuk më fton, nuk do të rrehen, mos e thuaj, Zot! – iu dëgjua zëri Dedos nga ai vendi i tij.

- Ty do të shëtisim kur ta blejmë një kamion! – kënaqej Semra, meqë i ra në dorë.

Fluturuan nëpër shpatin e mëhallës, nën ta Sarajeva ngulfatej nga mjegulla.

- Nxënës, ti mëson për dentist, a? – e pyeti Haruni.

- Për teknik të dhëmbëve, jo për dentist, ndoshta më vonë... – qetë iu përgjigj Amiri.

- Po, po, ashtu po kujtoj, e tash duhet të ta gjejmë një..., të hyn në punë, - qeshej trashamani.

- Lere, more, djaloshin, çka i vjen hakut, shiko timonin, mos po na e thyen qafën! – hidhërohej Semra dhe e futi kasetën e Halid Bashliqit dhe me të zuri të këndonte me zë...për të puthurën e parë, të harruar që kur...

(E përktheu: H. Ulqinaku)

NJË POET BASHKËKOHËS ARBËRESH

Zef SKIRO DI MAGJO

ME TË VËRTETË MOREA

Mejtim

Dielli na rrjedh prapa
tue korrur ullinjtë

Era
ma lot bashkë.

Na jemi gëzimi
i neve të vetë.

E dielli
ulliri
era
na duken të gëzuar për ne
somenatë
por ata dëfrehen
për ata të vetë.

Fli

U krodha te dejti
e atje u josa
si kripa.

Lëpijta bregun
rërën tue përgëzuar.

Më jikjën nga krahët
gumat
tue shkumuar.

I amshuar durim
vetmia.

Sa deja të t' shihja
te një mbrëmësor shkëleqezim
t' joseshe si dielli
me mua te dejti.

Më para se të ngryset

Më para se të ngryset
këndojëm kujtime
të fëmijërisë tënë.
Më para se të fiket
çdo zërë arbëresh
brënda qarkut të këtyre maleve
shtiem thirrma kushtrimi
për rrezikun të zbiret
e folmja jonë.
Si rrënime pagojë
do t' qëndrojën pethkat
e traditës Pashkët lajmet
turistike në zbiret
gluha.
E kur do njeri do t' vinjë

të shkalisënj ndër rrenimet
ndër kujtimet gjindje
çë ngë flet më, gjindje
çë ngë di më të thet[as tatë
as mëmë as vëlla as nuse
te një katund krejt i ngjashëm
njëi çilitdo vendi t'Italisë
ahierna do t'pështpërinj: këtu
një herë flitej arbërisht!
E heshtimi d t'na bënj
të mortshëm.
Më para se të ngryset
me shpresën e uluritur
të mos vinjë kurrë nata!

Mbrojtja

VII
Këtu s'ka bukë
për të gjithë.
E kanë të drejtë
prindërit arbëreshë
që dolën e gjetën
punë larg Horës
kur urdhërojnë bijve
gjuhën lëtire të bukës
sepse ti nuk fiton bukë
me të folmen arbëreshe
e folmja arbëreshe
është ves i paarsyeshëm
e si i tillë s' të hap
derën e prodhimit.
Ashtu kanë të drejtë
të zëvendësojnë gjuhën
kanë hak të blejnë
një nderim të pamundur më parë:
qytetërimin prodhues
fisnikërinë e rrogës.

E kur prandaj kthehen
si turistë përmes rrugëve tona
na tregojnë emancipimin e tyre
nga gjuha nga tradita nga jeta jonë
ndërsa fëmijët e tyre
nga gjuha nga tradita nga jeta jonë
ndërsa fëmijët e tyre
gjuhën e bukës shqiptojnë
tërësisht të huaj.
Po buri ushqehet
vetëm me bukë?

Vetmia e ishujve
(Metafora)

...10
Horizonti yt detar është Joni
i pjellë nga ujërat e tua amniotike
i pagëzuar me lotët e tu
të fortë kripe.
Mbi ankthin tënd të rindërtuar
ngrite ballkone të reja të vëzhgoje
horizontet e kuqe prej deti
që lindja në agim ti bie.
- Kur m'u çajtën ujërat
ishte stinë e mesme – më thua –
e të lindurit e mi shpejt morën
rrugët tokësore të mërgimit
ashtu që sot druaj
pranverat dhe vjeshtat stinë
në të cilat bijvet që më qëndruan
zakonisht u zgjohen
dëshira dashurie të jashtme.

...35
Të gjej këtu në pragun
e dritares së këtij deti,

flokë toke dhe gruri
kundërmim dielli
e re në lëkurë
sikur të kishe lindur dje.
Ashtu përfytyron rini
as u vë veshin psherëtimave
mbi ditët e tua të tashme.
Në këtë orë të ndryshimit të puhisë
vjen nga deti Adriatik flladi
që pak më parë
ka përkëdhelur mëmën shqiptare të lashtë.
Pra vishesh me mjegull e melankoli.

...43
Krenohesh për paraardhësit nga Morea
sikur të thuash se rrjedh me vijë të drejtë
nga princërit e Anglisë
o nga dyert më të shquara
e fisnikërinë romake.
Ti, që nuk di as se gjuha jote
mund të shkruhet e mund të lexohet,
ti thua Morea për të më treguar pa ditur
vendin dhe kohën e Pellazgëve të lashtë
bij të drejtpërdrejtë të perëndive.
E është këtu ku do t' arrish:
do të më bindësh mua se Morea jote e ti
s' mund të rrjedhni veçse nga perënditë!
Por kë do të habitësh, mik i dashur!
U plotësisht i bindur jam!

Drama e ikjeve

*
Çfarë tjetër?
Poezi me nota të ulëta.
Mot i mbyllur.
Për tragjedi jo për poezi.

Të heshtja plot nderim
ndaj dhembjes së të ikurve. Por
dhembja e të ikurve është imja.
E njoh. Ushqim i hidhët.
Nuk mund të hesht.
As të iki e kam për detyrë edhe këtë herë
megjithëse janë gati aty në port
galeonët e Republikës së Venedikut
dhe velat e Mbretit të Napolit.

*

Fatlumë
ne në port të gjejmë anijet gati
të Republikës Veneciane e të Mbretit
të Napolit miq! Pa ngut ikja jonë me imtësi
planifikuar. Duhet ta kesh të zënë mendjen
të mendosh vogëlsirat në harrove të merrje
krehësin o ndërrimin e rripave të këpucëve
fiqtë e thatë brenda bohçeve me nyjat
e kryqëzuara – tepër i madh duke qenë
ankthi i shkëputjes nga toka ruajtëse
e të vdekurve të tu që s’ke mundësi
të shpëtosh sepse s’ke vend në bohçen tënde
s’ka vend në trastën plot e përplot
me racione për të mbijetuar gjer në cakun
e ardhshëm kushedi ku. E patëm ne të qartë
Atdheun si vend fizik prej toke ujërash
bari malesh qielli? Në bohçe si në anije
s’ka vend për Atdheun! Si e mbart Atdheun
e ku? Mund ta ngarkosh në krahë e ta shtrosh
një herë ç’arrin në cakun e sprasëm? Kam
një këmishë të re që do ta vesh në zbarkim.
Kur përpara na doli te rruga e detit Sicilia
na pëlqeu. Zgjidhur nyjat e bohçeve dolën
këngët dhe poezia e lotëve. Nostalgji o pendim
për “Të Bukurën More” të braktisur? Asnjeri
kurrë do ta dijë! Ne sipër ndërtuam shtëpi e piteri.

Duhej të kishim

Duhej të kishim tri kurme
e tre shpirtra
e të vdisnim tri herë
tri herë ngjallur e prapë vdekur
për të tre atdherat tanë.
Bajron shtatore
në Kopshtin e Trimave në Misolongji
- euzonë të blertë qiparisat -
përshëndetjen time tri gjuhësh.

Për Kosovën

Bariu i Keq rrethoi vathën
me tela të gjembta dhe aty mbylli
kopetë jo të tija
për festën e ardhshme,
Therorët janë gati. Hyjnitë
do t'i pinë gjakun
do ta hanë blatimin e mishrave.
Druaj se Evropa
kur të shohë tymin e flive
të besojë se aty bëhet
piknik me mish të pjekur

7 nëntor 1994

Ullirit tim detar

Rruzaret e tua me perla
i pruri ndoshta shitësi i huaj
nga vende ku lëmon
vela detare.
Këtu lëmon dallga e erës
e rrumbullakon pemët e tua.
Në bashin e kthyer të anijes sate

shkulma degët hipi
e lë që të m' udhëheqin
për detet lindore.
Ankorim është të gjejë
miqtë e vjetër shqiptarë
që shpëtuan nga tufane të vërteta.

Lexim

T'i kuptosh ullinjtë. Mësim
rrënjosjeje dhe pemë me koherencë.
Lehtë të shfletohen në lexim.
edhe kur ndërron pamje qielli.
Nocellare të Beliçes puthje
maureske të sicilianes.
Fryte të Shqipërisë sy
të ngulët dashurie
femërorë për shihje
dhe përhapje.
Athena shpikëse në tokën e Moresë
ullinjsh nga shenja e paqes
antike te flamujt
e të Dielave të dafinave
Lehtë t'i kuptosh ullinjtë!

Rrudha

Ullinjtë me rrudhat e etërve
Gjergj Seferis – Legjenda, XVII

Të këtyre luginave
të këtyre kodrave të gurta
u morën me dashuri Etërit tanë.
E i zbukuruan.
Etërit tanë me kohë ndërruan fytyrë
oh! Plisat e shenjtë të një shtrati
të përjetshëm këtu ku dashuria për tokën

ish për atdheun e humbur.
Rrënjët e ullinjve në thellësi
i kapën. E trungjet morën
fytyra njerëzore
dhe fytyrave njerëzore rrudhat.
Lot të dendur pezull
në pritje frytet.
Rrudhat. Kur të piqet koha
do të kenë edhe të miat.

Detar i vjetër

Kam lëkurë të mësuar me kripën
erë e vrullshme gjithmonë në kursin tim
kurrë puhi e paqes
u bunacë e zemrës.
Nuk di nëse urrej a dashuroj detin.
Njoh llojllojshmërinë e ngjyrosur
të martesave të rrepta qiell – det.
Njoh e mat me sy kreshtat e dallgëve
dhe vijezimet e aq anijesh venë t' sfidojnë.
Për mua edhe dallgët madhështore
kanë përmasën e valave të buta.
Detar i stërvitur jam.
Më ndalon policia kufitare
njohje e fortë për njëri-tjetrin
pijmë një cigare
më vulosin dokumentat e përjashtimit
i përshëndes dhe njëkohësisht
betohem se do t'i provoj sërish.
Një rrotë jeta ime
që nuk qëndron kurrë.

Kosova lule

E gjetëm
të zbuluar qëmoti
Kosovën lule
të bukur si shpirti!

Poetit Ali Podrimja

Ti shkruan Njeri
me Germa të Mëdha
e Bukë e Kripë
si Shenja të Qytetërimit tonë
e pret metaforikisht Kush
do ta vrasë Ujkun - Urrejtjen
që të shpëtohet Kopeja
e thua se ne Arbëreshë
bëjmë punë Zotërash
se mbajmë të gjallë Qenien tonë.
Fjala Jote
Poet Kosovar
këndon si Fryma
e Kosovës së gjallë
që hedh në Luftë
si Armë të Bindjes
Germa të Mëdha
në Nderim
të Farës Njerëzore
të Qytetëruar.

Kllapa katrore*
Mëmës sime [Dheut tim]

1
Këtë herë [herët e tjera u
për Perëndim o Veri]
është mëma ime [dheu im] që më lë [themeli
ku rrija i patundur]. Herët e tjera kur
nisesha [për liri o për punë] shoqëruar
nga orkestra e valëve o nga xhazi i trenave
e shihja [mëmën] [dheun]
të shuhej te horizonti [ngjer tek i sprasmi
rrip i dukshëm]. Nani
është ajo [mëmë e dhe] që niset
për një përmasë tjetër [të detyrueshme] misterioze

e më lë
të zvogëluar në vijën e horizontit
trashëgimtar të [saj] dhëmbjeje tonë [shekullore].

_____

** Kllapat katrore mbajnë tekstin të rindërtuar të dorëshkrimeve të mangët*

Vjersha të Lipit tim
(Pjesë)

Peng. Të zënit fill është gjithmonë kështu.
Të ndodhesh peng. I gjellës
i vdekjes. Je vdekja Murat i dytë Turk.
Por Yni s'e dhuron kapistrën.
Më parë o më pas do ta ngrejë kryet.
Me çilin përfundim.
Të shfletohet historia.

Fermani apokrif
i hap dyert e Krujës.
Përhapet lajmi.
E lehtë do të jetë fitorja.

Të lirosh Dibrën.
Të pushtosh kështjellën e Petrelës.
Të pushtosh Sfetigradin.
Të pushtosh tërë Botën.

Në Lezhë Kuvendi.
Të mundet kanceri.
E bujshme fitorja e Torviollit.
Djetë mijë për njëzetepesëmijë.
Dukej e pamundshme.
Është e mundshme.
Zemra bëhet e pakufirë.

Jeronim de Radës
(Për qindvjetorin e vdekjes 1903 – 2003)

Pelegrinë vijnë këtu
me përulësi të devotshme
te faltorja e Zërit të Math
pas thirrjes së vëllazërisë
me flamurët e ishullit tonë
të anës arbëreshe
për kronikën o historinë e ardhshme
si dokument Thomai Mateu Zefi.
Në agorë bashkë me Tanët
gurin tonë do të kumbisim* përkrahje
të përmendores De Radë
ripërtritur te pasardhësit.

Vende - ikje

Kush më çan fillin e mendimeve
e s’ më jep kohë t’e zë pameta,
është dallëndysha që[më shkon shigjetë
rrëzë faqes e ndienj
hapësirën e flatrës kur jam lis
në marrëveshje. O kur bëhem trung i pjerrë
përpjetë e lehtë për zhapira e hardhje.
Ashtu që dashuroj kë s’më vë
mendime kundra. Botën minerale
të parapëlqehet
se më ngadalë
kjo zbulohet.
Por s’kam asgjë të të urtit oriental
që në heshtje të gjatë
pret të rritet
guri.

Tash njoh frymën e erëravet

Tash njoh frymën e erëravet
e di nga çila anë do të pështpëritin degët
Ka erë artiste poeteshë
që bie mjegulla thjerrëzore pirgje shtresa
e gëzohet nga furtura.
Ka erë që fshin mjegulla
e liron mendimet.
Tash njoh frymën e erëravet
e masat gjysmake e flladit
o të puhisë që vete e vjen
herë nga liqeni në dhe
herë nga dheu në liqen.
As dua të mendoj çila
erë më përket.

Kërkon detin

Kërkon detin sikurse i kishte harruar ngjyrën
o trajtën e epopesë
të ngjitur në mendje e mbi kartë
dhe kërkon të dallosh
duke shtrydhur fantazinë
rripin dheu që u lëkund
tek i sprasmi shikim.
Sikurse të gjithë kishim ikur tek ajo ditë
stërgjyshra e stërnipra të caktuar nga lindja
atij *imprinting*. Me anijet e vargjeve
edhe ne sot marrim detin e ikjes
e të shpresës epike të kthimit
- makar në vetvete që sot ka më shumë rëndësi –
dhe të përqendruar
te lundrimi
i vështirë i fjalëve të tua
rrimë larg shkëmbinjve të indiferencës
që më se më pengojnë vela e motorë.
Na më të ndjeshëm se Odiseu

për këngët allotrope
të sirenave.

Qytetërim mundësor

Mundësor
qytetërimi ynë prej arbëreshish
bij dialektorë t‘ Italisë.
Buzët e zjarrta shqiptare të imagjinatës së tanishme
përbëjnë tingujt e të folmes sonë të përditshme
me të njëjtën sintoni zëri, ashtu që i ndërvënë
fjalë dialektore siciliane
me natyrshmërinë tonë.
Jemi pikë referimi të qytetërimit mundësor.
Përralla e Moresë plot nostalgji nuk mban më:
Morea jemi ne e Bukur kështu
megjithëse është e çuditshme të jemi në botë imigrimi
kur emigrantët tanë nisen drejt një cilësdo Vore.

Martesa

Nusja e dhëndri janë të bukur. Ajo
me emër të pazakontë këtu na bie
detet e mposhtura nga hijeshia e saj. Ai
është arbëreshi zbulues i dashurive
që nga shekujt e tij. Ajo ka shqiptimin
e këndshëm të Elbasanit. Ai të folmen
e thatë të maleve tona të lodhura.
Ashtu kloftë!
Të pranishmit vëllezër e motra të gjithë:
- Si thoni “bukë”? E “verë”?
Ushqyer nga të njëjtat fjalë.
I sigurt ankorimi tani
nga brigjet e bashkuara të pesëqind deteve
e sigurt e ardhmja si akt besimi.

Me të vërtetë Morea

Me të vërtetë Morea jeton ende
dhe nostalgjia e saj. Morea
nuk do të vdesë kurrë. Ka të vazhdueshme
përditshmëri nostalgjie.
Grumbulli shqiptar imigrantësh
që kuvendon në mënyrën e tyre
në këndin e zakonshëm të mureve
të vjetra arbëreshe duken
anijembytur që shënojnë prani
anijes More mbërthim shpëtues
të ndjenjave. Do të shpëtohen ata
në këtë mbrëmë kushedi në e ngjashme
me ngjyrat e qiejve të Krujës
të Korçës o të Beratit.
Morea përditohet e neve
na njom shpirtin me të lashta
ndërhyrje të paprekshme.

Më i njohuri poet arbëresh

Giseppe Schiro di Maggio (Zef Skiro di Magjo) është i lindur në Horën e Arbëreshëve (Palermo) më 1944.

Ka mbaruar Letërsinë klasike në Universitetin e Palermos. Ka mësuar Letërsi e gjuhë italiane në krahinën e Torinos e për njëzet vjet në Shkollën e mesme shtetërore "*Dhimitër Kamarda*" në Horën e Arbëreshëve. Është drejtor i revistës "*Mondo Albanese*" e bashkëpunon dhe revistën "*Katundi ynë*" etj.

Krijon dhe zhvillon një veprimtari të shumëllojshme letrare dhe kulturore. Merret me teatër, shkruan drama. Merret me publicistikë dhe artikuj letrarë. Harton tekste gjuhësore si dhe bën përkthime. Poezitë etj janë në shumë antologji.

Poezitë i shkruan në dy gjuhë, sikur përmbledhjen *Atje kam (La mia More*), Hora e Arbëreshëve, 2004.

Veprat më të dalluara poetike:

"*Sunata*" (1965), *"Më para se ngriset"* (1977), *"APKLPS – Viti zero"* (1980), *"Kopica e ndryshku"* (1981), *"Përtej maleve, prapa kodrës"* (1985), *"Laerti, i jati"* (1989), *"Metaforë"* (1990), *"Kosova lule"* (1991), *"Anije me vela e me motor"* (1992), *"Poezi gushtore e të tjera"* (1995), *"Kopshti im me dritare"* (1996), *"Gjeometri dhe ikje"* (1998), *"Poezi dashurie në kohë vdekjeje"* (1999), *"Atje kam (La mia Morea)"* (2004) etj.

Në Prishtinë e Tiranë i janë botuar përzgjedhjet:

"Gjuha e bukës" (Prishtinë, 1981), *"Përtej maleve, prapa kodrës"* (Tiranë, 1985), *"Ishuj"* (Tiranë, 2007).

"Gjuzepe Skiro di Magjo është tanimë nga personalitetet me peshë në legtërsinë arbëreshe e më gjerë. Një pinjoll e vazhdues i denjë i Serembes e Skiroit, që duke ecur në vazhdën e tyre, në kushte e nivele të reja, lëvron e vitalizon fjalën poetike arbëreshe, me një individualitet krijues të thukët" (Nashpo Jorgaqi: Zef Skiro di Maxho, "Ishuj" (poezi), Ombra GVG", Tiranë, 2007).

Dy fjalë për Ulqinin e kalimereve

Zef Skiro di Magjo ishte mysafir special në *"Kalimeren poetike – Ulqini 2008"*. Fjalën përshëndetëse të tij me rastin e prezantimit, po e botojmë të plotë.

"Unë sonte jam i gëzuar që ndodhem midis jush. Falënderoj presidentin Haxhi Shabani për ftesën që më bëri. Falënderoj për praninë e tij, shkrimtarin Nasho Jorgaqin, mikun e çmuar të arbëreshëve.

Në ju hapni hartën gjeografike të Sicilisë, afërsisht ndo njëzet kilometra në jug të Palermos, gjeni shkruar: Piana degli Albanesi, thënë në gjuhën tonë tingëllon: Hora e Arbëreshëvet. Emri vet na jep lajmin kryesor: aty para pesë shekujsh u strehuan disa mijëra arbëreshë të shpërngulur nga Morea, Labëria, Çamëria e nga treva të tjera ku flitej gjuha jonë e embël.

Unë jam bir i Horës së Arbëreshëvet. Dhe vij këtu me kredencjale të larta, sepse Hora e Arbëreshëvet është nëna e disa e disa bijve të shkëlqyer në tërë botën shqiptare me mbiemra si Matranga, Guxeta, Brankato, Kamarda, Guidera, Petrotta, e gjithë ajo radhë Skiro: Zef Skiro, Pal Skiro, Gjergj Skiroi.

Në pra do të themi edhe për kolonitë e tjera në tokën siciliane, si Kuntisa, Pallaci, Adriano, Munxifsi e Sëndastina, të gjitha brenda kra-

hinës së Palermos, duhet të shtojmë mbiemra si Filja, Keta, Krispi, Dara. Një traditë letrare e shkëlqyer jona dhe njëkohësisht juaja.

Edhe sot tradita letrare në Horën e Arbëreshëvet vazhdon e rritet. Aty bëhet poezi, bëhet teatër, muzikë, art.

Cilat janë motivet kryesore që frymëzojnë punën e shkrimtarit arbëresh:

- ruajtja e gjuhës, në vend të parë,

- ruajtja e identitetit, sot më problematike se dje për shkak të globalizmit, kujtimi i shpërnguljes së vjetër e prandaj

- nostalgjia letrare për dheun e të parëve të braktisur, situata e shqiptarëve kudo të ndodhen dhe janë: Shqipëri, Kosovë, e te minoritetet në disa shtete të afërme,

- jeta e përditshme e arbëreshit me hallet, gëzimet, lipet, ëndrrat, fantazitë, zhgënjimet.

Ashtu edhe unë kam kënduar dhe këndoj në përgjithësi:

- për temat, themi kështu, universale: si ardhja e çuditshme midis të gjallëve, dhembja e shkëputjes nga të gjallit, si liria, si të drejtat e njeriut, sidomos minoritar etj.,

> në veçanti:

për Gjinden time, për agimet e perëndimet e saj, për bukurinë e saj, për ndjenjën e nostalgjisë së kohës që kalon, për përjetësinë e vlerave tona,

- për mbrojtjen e gjuhës si pasuri të gjallë jo vetëm monumentale, ku të vjen lehtë të përdorësh ironinë e sarkazmin për disa sjellje joarbëreshe të vendasve,

- për gjithë katundet arbëreshe këtej e andej Ngushticës së Mesinës,

- për Italinë dhe Sicilinë të të cilave ne arbëreshë jemi bij dhe ndërmjetës të urtë kulturorë tani ka pesë shekuj,

- për Evropën, që është nëna e të gjithë popujve që thithin qytetërimin nga gjiri i saj e që do t' jetë atdheu i madh i përbashkët,

për të Bukurën More, dje ndoshta si tokë e caktuar gjeografikisht, sot si tokë mendore popullore, ku në çdo rast ekzistonte dhe ekziston përsosuria.

- për Shqipërinë si vendi kryesor i të gjithë shqiptarëve,

- për shpërnguljet antike e ato moderne, për të cilat kemi vuajtur: ikjet tona nëpër dete me anije me vela a me motor,

- për Kosovën e viteve 1981 e 1998 e për Kosovën e sotme,

- për Tetovën e Strugën, ku shkova në fund të prillit të sapokaluar dhe bëra poezi,

Edhe dy fjalë për teatrin tim.

Kam shkruar dhe shfaqur teatër për gjinden time e me gjinden time duke përdorur mënyrat e dramës dhe të komedisë deri te kabareti, që për dallim nga kabaretet e tjera, quaj "kabaresh", d.m.th. kabare arbëresh.

Temat e teatrit janë edhe ato lodhur me ruajtjen e gjuhës, me ruajtjen e të qenit arbëresh vërejtur shpeshherë me sy ironik e me ca komicitet, me ruajtjen e dinjitetit të njeriut që ka të bëjë me vështirësitë e jetës së përditshme dje si dhe sot.

Mbyll, me një nderim ndaj një poeti që me poezinë e tij ka hapur gjithmonë përmasa të çuditshme tek unë lexues: them për poetin Ali Podrimja, mikun e vjetër dhe gjithmonë të ri, dhe nëpërmjet tij mbyll me një nderim Kosovës: të cilëve u kushtoj këtë poezi me titull, "Te Hora e Arbëreshëvet mora një zarf":

Te Hora e Arbëreshëvet mora një zarf
me brenda dy libra. Punë
krejt normale thua. Por
ai që më dërgon librat është
Ali Podrimja, poeti. Gëzim
krejt normal thua. Por
nën adresën e tij, për të parën herë
me natyrshmëri shoh shkruar
REPUBLIKA E KOSOVËS. Hare
krejt normale thua?

Të jesh vërtetë arbëresh është para së gjithash një mënyrë e shpirtit, një praktikë e jetës. Shoh se edhe ju jeni vërtetë arbëresh."

* Kështu përshëndeti poeti më i shquar bashkëkohës arbëresh, Zef Skiro di Magjo, natën speciale letrare kushtuar tij, në "Kalimeren poetike – Ulqini 2008", më 02 gusht '08.

E dëgjova me veshët e mi në "Pazarin e Gjytetit", e lexuat edhe ju:

- e do të bëj poezi edhe për Ulqinin, këtu të bukur e të pranishëm, me të cilin takohem për të parën herë e ku më duket se ndodhem te shtëpia ime.

Unë besoj se ai do ta mbajë premtimin.

Edhe unë premtoj se ato poezi do t'i botojmë në numrin vijues të "Dijes".

Përzgjodhi – përgatiti: Hajro Ulqinaku

STUDIME

Prof. dr. Dhimitër PILIKA

SHQIPTARËT - PELLAZGËT

Shqiptarët - banorët më të hershëm të Adriatikut

Sipas autorëve të lashtë, Adriatiku në fillim quhej "Deti i Kronosit dhe i Reas", me pas "Gjiri Jonian", me një emërtim të trefishtë, të lidhur me traditat pellazgjike (parahelenike)

Jo fort larg nga brigjet e Adriatikut, më 1875 u zbulua Dodona, kryeqendra shpirtërore, politike dhe kulturore e pellazgëve, orakulli paragrek i së cilës ka qenë më i lashti dhe më i njohuri në Ballkan e në Evropë. Disa qindra dijetarë, klasikë e modernë, shpesh më emër ndërkombëtar, janë marrë me këtë popull. Disa prej tyre kanë përdorur në rrafsh të gjerë, në shërbim të së vërtetës, përparësinë e faktorëve vendimtarë të brendshëm, vendorë. Rrjedhimisht, ata kanë nxjerrë argumente autentike të pashtershme sidomos pas sjelljes në Luvër të gjetjeve arkeologjike të Dodonës dhe daljes më 1878 në Paris të dy vëllimeve të *Konstantinit Karapanos* "*Dodona dhe rrënojat e saj*". Këto zbulime sensacionale kishin bërë për vete paraprakisht bashkëpunimin aktiv të anëtarëve të Institutit të Francës *E. Egger* dhe *J. De Witte*, që mbahen si pasuesit e pellazgistëve francezë *J. B. Jourdan* (1746), *Ch. Dupuis* (1798), *L. Petit - Radel* (1810-1852), *J. Michelet* (1831), *L. Benloee* (1877).

Në shkallë ndërkombëtare prej gjithë përfundimeve të tyre të verifikuara mirë, del se pellazgët, qe mbizotëronin në Adriatik, i kanë

sjellë Evropës, ndër të tjera, alfabetin e parë, qytetërimin më të lashtë: mjeshtërinë, teknikat e dobishme, themelet e shkencës, mitologjinë etj., e në veçanti emrin e vetë Evropës, kulturën e grurit, shpikjen e bukës, ndërtimin e qyteteve e bërjen e regjistrimeve, të ligjeve, të monedhave, të Lojërave Olimpike... Pindari gjenial i ka quajtur "*paraselenitë*", domethënë që janë shfaqur para daljes se hënës në kupën qiellore... Si rrjedhim, me vërtetimin mbi baza rreptësisht shkencore të autoktonisë me prestigj të pellazgëve kundrejt ardhësve të rinj - helenëve, cili ka qenë zhvillimi i tyre i mëtejshëm në brigjet e Adriatikut?

Kjo kumtesë bën një përpjekje për t'iu përgjigjur shkurt kësaj pyetjeje, të parë nga këndvështrimi i popullit shqiptar, pjesëtar i familjes adriatike.

Sipas humanistëve *Enea Silvio Pikolomini*, para i ardhshëm *Piu II*, *Antonio Sabelikos Rafaelo Volaterranos*, e po ashtu më vonë të *Pjer Ronsarit, Alfons Lamartinit, Zhyl Mishlese, Elize Reklyse, Feliks Zhyljenit* dhe shumë të tjerëve, vazhdimësia e shqiptarëve shkon në vijë të drejtë te Aleksandri dhe Pirroja, mbretër të Epirit, trashëgimtarë të Dodonës "*ab antiquo*". Ky pohim mbështetet gjerësisht nga humanistët tanë *Marin Barleti, Frank Bardhi, Pjeter Bogdani*, si dhe nga mija dëshmi "*in loco*", te shkruara dhe gojore. Më 1882 u gjet në Arkivin e Napolit dhe u botua një letër e dijetarit *Gjergj Kastriotit - Skenderbeut* (1405-1468), poliglotit që dinte pesë gjuhë të huaja bashkë me letërsitë e tyre përkatëse: heroi ynë kombëtar, më 31 tetor 1406 ia dërgonte princit të *Tarenit Xhovani - Antonio Orsinit*, duke thënë se po t'u besojmë kronikave tona

kombëtare, ata na tregojnë se sovranët epirotë e molosë, Aleksandri dhe Pirroja, kanë qenë stërgjyshat e shqiptarëve; këta dy dinastë u shquan me ekspeditat e njohura që ndërmorën përtej Adriatikut. Tërësia e rrethanave domethënëse na tregon se vula zyrtare dhe e fshehtë e Skënderbeut, që u bë e njohur më 1962, ka emblema tërësisht dodonase; përkrenarja e tij, që ruhet në Vjenë, është e njëjtë me helmetën e Pirros, të përshkruar prej Plutarkut; për më tepër, në drurin gjenealogjik të pasardhësve të tij, jo rastësisht janë shquar Pirroja I, Kastrioti - Skënderbe, si dhe Pirroja II Kastrioti - Skënderbe. Si përfundim, duhet të saktësojmë se vija: Aleksandri dhe Pirroja i Epirit - shqiptarët e sotëm, deri me sot, nuk është kundërshtuar nga asnjë dokument historik i vlefshëm.

Një repertor mjaft i pasur greko-romak, që asnjëherë nuk është hedhur poshtë, vërteton se Aleksandri dhe Pirroja, si molosë, ishin aecide, pasardhës të drejtpërdrejtë të Eakut, gjyshit të Akilit, i cili që nga Homeri është vlerësuar si mishërimi i vetë prototipit të pellazgut. Veç kësaj, diçka që është plotësisht e provueshme, ka vazhduar ngritja në shkallën e princit,

pa asnjë qëllim të paravendosur, e tre nipërve të Skënderbeut, që sanksionuan onomastikën pellazgjike, mjaft domethënëse, të paraardhësve të tyre parahistorikë: *Akili I Kastrioti - Skënderbeu, Akili II Kastrioti - Skënderbeu* dhe *Akili III Kastrioti - Skënderbeu*. Si pasojë logjike e këtij realiteti objektiv, lidhja gjenetike ndërmjet shqiptarëve dhe pellazgëve ka vijuar të imponohet qe në zanafillën e epokës moderne, një e vërtetë tashmë e pranuar nga një ushtri specialistësh shqiptarë e të huaj.

Përfundimisht, origjina pellazgjike e kombit shqiptar, të pandarë prej Adriatikut, është provuar në mënyrë të padyshimtë, pa asnjë hije etnocentrizmi, nëpërmjet përputhjeve, ndihmesave, konvergjencave të pakundërshtueshme të mijëra të dhënave ndërdisiplinore, zakonisht të pabotuara, vendore, që u përkasin fushave të mëposhtme: historiografisë, numizmatikës, epigrafisë, fizikës radiometrike, kimisë (së metaleve, tokave etj.), etnologjisë, folkloristikës, gjuhësisë, onomastikës, etimologjisë, antropologjisë, hematologjisë, ballkanologjisë, etruskologjisë, jurisprudencës, paleografisë, statistikës, demografisë, klimatologjisë etj. Afër rivierës sonë, në jug të Buthrotit të lashtë, të cilin e donte aq shume "*Andromaka*" e Rasinit të pavdekshëm, gjendet shpella paleolitike e Kreshmoit, në të cilën janë gjetur më 1933 "*ankorat e argjirit*", një "*specialitet*" gjithëmesdhetar eskluziv i pellazgëve, të quajtur prej kohësh zotër të detëve.

Një legjendë provinciale, e transmetuar brez pas brezi dhe e shtypur më 1875, e sjell lindjen e Zeusit pellazgjik të Dodonës, që është himnizuar nga "*Iliada*", pikërisht te stanet e atit të tij, *Kronosit*, në rrethinat e qytetit të *Anhiazmit* ose të *Onhezmit*, që është emri i babait të Eneut, Ankizit, i cili me sa duket është varrosur këtu (sot Saranda, kryeqendra detare e jona në jug). Gjurmët e kultit të monarkut të gjithëfuqishëm të zoterëve të Dodonës, me shpurën e tyre, e mbulojnë gjithë hapësirën adriatike. Tërësia e këtyre atributeve të posaçme, domethënë shqiponja, dushku, rrufeja, demi, shumë më tepër se kudo gjetke, gjenden me bollëk në bregdetin tonë adriatik, si dhe në brendatokën, deri përtej kufijve të Dalmacisë, të Peonisë dhe Dardanisë, Kosova e sotme. Në këtë krahinën e fundit kohët e fundit janë vënë re pesëdhjetë mbishkrime "zeusiane", tashmë të botuara, në shfaqje të tjera të panumërta të trashëgimisë kulturore dhe të teogonisë pellazgjike. Duke mbajtur parasysh lashtësinë dhe vazhdimësinë kaq të qartë e të pandërprerë, studiuesi i shquar i Mesjetës, Alen Dyselje, ka thënë më 1981: "Historia na mëson se lidhur me Kosovën, serbët janë pushtues të ardhur mjaft vonë"...

Do t'i kapërcejmë hollësitë e bollshme për adhurimin e veçantë të secilës prej dymbëdhjetë hyjnive të Dodonës - Olimpit në mjedisin tonë, dhe do të ndalemi vetëm te hyjnesha e dytë e panteonit paragrek: Demetra, e njohur pa përjashtim nga të gjithë si hyjnesha e mirëfilltë pellazgjike, etimologjia e emrit të së cilës shpjegohet vetëm ndërmjet gjuhës shqipe. Shenjat e adhurimit të saj vazhdojnë të jenë të gjalla edhe në vitin 1994. Çdo vit në një datë që nuk ndryshon, duke respektuar ritet pagane të paracaktuara "ab immemorabili", fshatarët shqiptarë, në pjesën më të madhe gra, të besimeve të ndryshme, shkojnë të lahen veshur me rroba në plazhet tona të Adriatikut me qëllim që të kenë shëndet e pjellshmëri të vazhdueshme. Deri me sot gërmimet kanë zbuluar faltore, flijimore, skulptura, medaljone etj. kushtuar këtij mishërimi karakteristik të matriarkatit dhe bujqësisë pellazgjike. Po të vështrohet sipërfaqja e territorit tonë, denduria e tyre është e habitshme, unikale në botën evropiane...

Në një largësi jo të madhe nga porti "dardan" i Orikumit, në bregdetin adriatik shqiptar, që në agimin e kohëve ndodh një dukuri tepër e rrallë, në rrethinat e fshatit Tragjas, (fshati i sotëm ka po atë emër Tragjas): prodhohet kripë edhe sot e kësaj dite në sasi të mëdha vetvetiu, pa asnjë përpjekje njerëzore, duke përfituar nga veprimi periodik i rrymave detare në gropat e vogla gjeologjike. Sipas fjalëve të Helanikosit dhe Stefan Bizantinit, përfytyrohej se atje ishte djepi i vërtetë i kripës së gjellës, ku Poseidoni, hyjnia tipike pellazgjike i deteve kishte krijuar për herë mbi tokë këtë lëndë të pazëvendësueshme gjatë jetës së njerëzve të vdekshëm...

Shumë kohë përpara Luftës së Trojës, lëvizjet migruese të pellazgëve e kishin përshkuar Adriatikun në drejtim të Apulisë, në grykëderdhjen e lumit Po... *Virgjili* dhe *Aulu - Geli* i vështronin këta lundërtarë si banorët e parë të Italisë; sipas *Plinit, Solinit, Varronit, Tit Livit, Denisit* të *Halikarnasit, Ovisit, Tacitit, Higinit, Ceces*... këta pellazgë çuan atje për herë të parë shkrimin dhe kulturën e artet. Sipas *Denisit* të *Halikarnasit, Plini e Plutarku,* ata madje kanë qenë themeluesit e vërtetë të Romës. Muret e famshme '*pellazgjike*', '*ciklopike', 'poligonare', 'megalitike', 'moenia aeacia'*, që në një farë mënyre kanë mbetur të pashkatërrueshme deri në ditët tona, dalin zakonisht në gjithë rrethimin e Adriatikut, duke nxjerrë në dukje njësinë e tij. Po shënojmë kalimthi, se Athina vetë themelimin e murit të Akropolit të saj e lidhte me dy arkitektë ndërtues, pellazgët *Agronalasi* dhe *Hiperbiosi,* që janë përjetësuar nga *Pausania*. Më pas, rreth viteve 80-81 para erës sonë vëmë re një zhvendosje masive,

me egërsi të padëgjuar në drejtim të përkundërt; 150.000 pellazgë etruskë, të dëbuar nga Gadishulli italik me urdhrin e diktatorit Sula, gjetën strehë të përhershme te bashkatdhetarët e tyre në Molosi (Shqipëria jugore), e cila më parë ishte përgjakur dhe rrafshuar me tokën tërësisht nga xhelati romak *Paul Emili*. Kjo zhvendosje e tmerrshme me dhunë na është kumtuar e dëshmuar prej dijetarit frëng të shekujve të iluminizmit, *Nikola Feretit*, në veprën e tij "*Observations*"...

Aventurat e heroit legjendar Kadmit, Herkulit, argonautëve, të cilët janë cilësuar si pellazgë nga *Lucien i Samosatës, Diodori, Pausania, Liciforo* e të tjerë, e lidhin ngushtë Adriatikun me stërgjyshat e popullit shqiptar nëpërmjet duzinash të dëshmive domethënëse, të cilat për shkak të mungesës së kohës, nuk është e mundur të jepen më gjerësisht... Diodori na meson se ishulli kaonas i Korkyrës, i cili vetvetiu na sjell ndër mend binjakun dalmat, mban emrin e motrës së Pellazgut, stërgjyshen e përbashkët të gjithë pellazgëve. Me lejoni të citoj një shembull të shkallës së habitshme të arritur nga qytetërimi i tyre paragrek, katër mijë vjet më parë. Në këngën e shtatë të "Odisesë", poeti, me akribinë e tij proverbiale, përshkruan pallatin e mbretit të pellazgëve feacine, Alkinoosit në Korfuz: "Herë shndriti nga një shkëlqim i beftë i diellit ose i hënës, herë shkëlqen banesa e lartë e…shqitmadhit Alkinoos. Nga të dy anët e pragut shtriheshin muret e veshura me bronz deri në fund të pallatit; përsipër kanë një brez të kaltër; dyert janë prej ari; pragu është prej bronzi me ndërfutje argjendi; harku është prej ari; nga të dyja anët varen vargonj ari e argjendi, të cilët Hefesi i ka punuar me një art të mrekullueshëm... Brenda përgjatë gjithë mureve janë venë frone të mbuluara me vela të holla e të lehta, punë dore grash. Aty ulen krerët e feacinëve... Në piedestal të ngritur mirë lartohen shtatore prej ari, që paraqesin djelmosha, të cilët mbajnë në duar pishtarët e ndezur dhe që natën ndriçojnë kthinat e Alkioosit..."

Përpara këtij shkëlqimi pothuaj prej dyzet shekujsh lind pyetja me të drejtë: a është kapërcyer ndonjëherë një madhështi e tillë përrallore?...

Përveç se historian, po edhe njohës i hollë i kësaj kulture 'adriatike' të paraardhësve tanë pellazgjike e ilire, Lamartini i paharrueshëm do t'i shkruante nga Iskia më 8 shtator 1844 atdhetarit e poetit tonë, Jeronim de Radës, luftëtarit të betuar kundër zgjedhës osmane të asaj kohe: "Jam i lumtur prej kësaj shenje të vëllazërisë poetike e politike midis meje e teje. Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja dhe atje duhet të kthehet. Unë nuk kam meritë tjetër, veçse ta parandiej dhe të bëj urimet e para për lirinë e për ringjalljen e Shqipërisë..."

Nga pikëpamja gjuhësore, një numër i madh toponimesh rreth Adriatikut me mbaresen *-one* (*-ona*), që ndeshet te *Dodonë - Dodona*, si *Aenona, Avlona, Ancona, Aona, Arasona, Aulona, Bausiona, Blanona, Cartona, Cremona, Crotona, Chrysondyona, Flanona, Herona, Narona, Promona, Salona, Sationa, Scardona, Sulmona, Tariona, Triuncona, Verona* etj... (për të mos u shtrirë më tej gjeografikisht), duket qartë se këtë po këtë mbaresë të emrit të kryeqytetit të pellazgëve, mëmës së qyteteve evropiane. Vetëm analiza e toponimeve dhe etnonimeve primitive, të regjistruara prej kohësh në brigjet rethadriatike, do të na sillte në një përfundim mësimdhënës; një shumicë e emrave të tyre jo rastësisht shpjegohen etimologjikisht nëpërmjet shqipes, ose me mirë, përbëjnë një përkthim fjalë për fjalë nga gjuha jonë. (Dihet sesi *Platoni* në "*Kratilin*" e tij dënon rreptë maninë greke për kalkime, që shkaktohej kryesisht prej hegjemonizmit pa cak e kufi).

Tabloja e mëposhtme onomastike, ndonëse nuk është e plotë, përsëri është mjaft domethënëse.

Agrianes, Antibaris, Auendeates, Autariatae, Avendone, Barbanna, Bari, Bigeste, Bora, Bounima, Bretension, Brina, Brundisium, Busento, Busento, Bylazora, kepi Glotta, Dagnum, Dalmatae, Dalmatia, Delmion, Delminion, Daranti, Daranto, Dardani, Dardania, Dardapara, Dardi, Dassaretae, Dassaretia, Derriopes, Deuriopes, Dimallum, Durrachium, Emathia, Enchelana, Enchelanes, Eordea (Eordia), Gurasson, Gurbicon, Halsion, Helidones, Helidonion, Hellopia, Kerauniabore, Kroia (Kruja), Lamatis, Lim, Lopsi, Lopsoca, Malatis, Maledi, Maljena, Malontina (Maltein), Malontum, Maluentum, Maluntum, deti Croni dhe Rheae, deti Ionium, Mathis, Matoas, Metubarris, Molossia, Ombla, Omphalion, Opitergium, Pelagones, Pelagonia, Petra, Pirustae, Pistum, Ragusium, Rhizon, Sason, Scheria, Stena, Tara, Taras, Tarentum, Taria, Tarin, Tariona, Tariotae, Tarneum, Tarsatica, Tarus, Taulantii, Tergeste, Tergolape, Tharandt, Tirol, (Tyrol), Tragurium (Trogir), Trimallum, Ulcaea palus, Ulcianum, Ulcirus mons, Ulcisia castra, Ulco amne, Ulkinion, Vendenis, Vendum, Vindenis, Vindinid etj... (Ndonëse janë larg nga trevat adriatike, e meritojnë të përmenden në këtë rast, për shkak të rëndësisë së tyre të posaçme, vargmalet madhështore Beskidet dhe Karpatet, deti Baltik, Bizanti, Dardanelet, ishulli anatolik Karpathos...)

Nga ana tjetër, një shkencë eksperimentale, antropologjia, nëpërmjet korifenjve të saj. J. Deniker, E. Pittard, na jep sigurinë se shqiptarët e sotëm e kanë prejardhjen e tyre drejtpërdrejtë nga pellazgët. Në Adriatik dalin metropolet tona antike: Durresi, Apolonia dhe më në jug Buthroti,

që të tria të lulëzuara shumë shekuj përpara themelimit të Romës, nëse i besojmë *Apianit, Antologi Palatinit, Barletit, si dhe Apolodorit, Plutarkut, Pausanias dhe Teukerit të Cizikës, Virgjilit, Stefan Bizantinit*...

Deri në fillim të erës së re ato kanë përdorur pa ndonjë ndërprerje kalendarin e rëndësishëm pellazgjik të *Bunimës*, sipas mbishkrimeve tashmë të njohura. Teatrot e tyre, krahas atyre të *Nikesë, Bylisit, Orikumit, Hadrionopolit, Foinikes, Dodonës* etj. kanë shkëlqyer gjatë antikitetit me emrin e dëgjuar dhe dendësinë gjeografike... Ajka e aristokracisë romake i bënte të kapërcenin Adriatikun pinjollët e saj që ta përsosnin arsimimin e tyre dhe të specializoheshin te ne në fushën e filozofisë, letërsisë, arteve, pa përjashtuar artin ushtarak. Për këtë qëllim Jul Cezari pati zgjedhur *Durrahiumin*, një qendër e rëndësishme kulturore dhe ekonomike, me rreth njëqind mijë banorë, e cila ekspononte materiale të çmueshme (argjend etj.), esenca mjekësore dhe kozmetike shumë të kërkuara. Lidhur me *Oktavian Augustin, Mark Vipsanius, Agripën, Mecenën*, ata parapëlqenin Apologjinë tonë kundrejt Romës dhe Athinës, ndërsa Ciceroni, që e kishte parë në vend Apoloninë, e ka quajtur "*mafnam urbem et gravem*".

Nga fillimi i shekullit XIII para erës së re, bashkëvëllai i pellazgut *Akil, Diomedi* - paraardhësi i *Aleksandrit Molos*, që shpëtoi nga lufta e Trojës, u end pa pushim nëpër pellgun adriatik. Ai i dha emrin e vet ishullit të Diomedit dhe një faltoreje "*të adhurueshme e të shenjtë*", sipas *Aristotelit të Scimnosit*, duke e përfunduar atje poshtë harkun e jetës.

Pothuaj njëkohësisht *Pirro Neotolemi*, djali i arkipellazgut Akil, erdhi te plazhet adriatike të afërta me *Buthrotin* dhe mbretëroi në "*viset e molosëve*" (Prejardhjen e tij pellazgjike e kanë sanksionuar edhe *Eniusi, Ovidi, Prisciani*...) Në brigjet e Adriatikut, sipas Stefan Bizantinit, ai themeloi qytetin e Bylisit, që e përkujtonte në monedhat e veta. Thuhet se, nëpërmjet përzgjedhjes së përsëritur, ka përsosur një racë të lartë gjedhesh, që e kanë lëvduar me të drejtë Aristoteli, *Teopompi, Varroni, Plini, Arriani, Eliani, Ateneu*: ky lloj ka ardhur deri te rritësit e sotëm të racave rekorde. *Akileidi*, veç të tjerash, mbahet si krijuesi i një valleje tërheqëse, pirrikes, që ende vazhdon dhe lulëzon në Shqipëri...

Ndër studiuesit tanë mësimet e urta të një historie të tillë të gjatë ushqejnë dhe ndriçojnë të kaluarën e të ardhmen, kurdoherë në shërbim të paqes, të lirisë, të vëllazërisë mes popujve të Adriatikut dhe të mbarë botës... Plejada të tëra përfaqësuesish të shkencës franceze kanë dhënë ndihmesë të frytshme për ndriçimin e problemeve themelore të pellazgologjisë në kuadrin e kulturave mesdhetare. E ndiej veten të

nderuar që këtu të bëj një homazh të përzemërt e të fuqishëm për ta, në veçanti për kujtimin e pashuar të *Robert d'Anzhelisë* dhe *Dominik Briquel*-it. Ata pajtohen të gjithë sesa e sigurt është mirënjohja e popullit tonë, e "besës", fjalës së dhënë të shqiptarëve, i cili kurrë nuk do ta harrojë bujarinë e popullit vëlla francez.

SHËNIM

** Kumtesa është paraqitur në Kolokuimin ndërkombëtar "E kaluara dhe e ardhmja e hapësirës adriatike", organizuar në Paris më 29 e 30 nëntor 1994 nga institucioni shkencor kulturor ndërkontinental "Horizont 2000", nën kujdesin e lartë të ministrit francez të punëve të jashtme, Alen Zhupe. Nga frëngjishtja: prof. dr. Xhevat Lloshi.*

** DHIMITËR PILIKA, Korçë 1923 – 2003. Ishte nip i Thimi Mitkos. Ka mbaruar fakultetin e Sienës (Itali). Dha mësime në shkollat e mesme të qyteteve: Korçë, Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastër. 15 vjet jetoi në Pragë (Çekosllovaki). Në Universitetin e Karlit e themeloi dhe e drejtoi Seminarin shqiptar, ku ligjëroi të gjitha disiplinat albanologjike. Hulumton, gjurmon dhe, me studentët e vet, boton (çekisht) 64 vëllime me interes për historinë dhe kulturën shqiptare. Pas keqësimit të marrëdhënieve në Bllokun e Lindjes, kthehet në Shqipëri, duke sjellë në atdhe 30 arka me materiale të ndryshme me vlera të mëdha arkivore. Ligjëron në Universitetin e Tiranës; përpunon dhe boton studime nga materialet e sjella. Pseudointelektualët bëhen shkaktarë të internohet në Myzeqe, ku vuajti për 10 vjet. Në Pragë e botoi veprën kapitale "Shqipëria vend shqiponjash", në shqip, anglisht, frëngjisht dhe rusisht. Jetoi dhe vdiq në skamje, më 31 dhjetor 2003, shtypi as që e shënoi shkuarjen e tij në amshim, njeriut që ishte një eruditë i pashoq, që njihte 12 gjuhë të vdekura e të gjalla. Pas vdekjes i botohet studimi prestigjioz "Pellazgët – origjina jonë e mohuar". (Sipas U. Zajmi).*

Xhoana PERKAJ

MBI ETIMOLOGJINË E TOPONIMIT *RUDINË*

I) RUDINËT – fis ilir

Rudinët kanë qenë fis ilir. Ata i përmend *Plini Plak*, në shek. I pas K., në veprën e tij "*Naturalis historiae*". Duke i numëruar hollësisht fiset dhe qytetet ilire, nga veriu drejt jugut, ai thotë se "*Pas Epidaurit* 1) *janë qytetet që gëzojnë të drejtën romake: Rizini, Akrui, Butua, Olcini...; lumi Drin, dhe mbi brigjet e tij, një qytet që gëzon të drejten romake, Skodra, tetëmbëdhjetë hapa larg detit. Përveç asaj, po zhduket kujtimi i shumë qyteteve greke dhe shumë qendrave të fuqishme. Dhe, në të vërtet, në këtë krahinë qenë labeatet, enedet, saset, **rudinët,** grabejt, ruajnë emrin e tyre edhe ilirët e vërtet* 2), *taulantët dhe pyrejt*". 3)

Është kjo, me siguri, e vetmja herë që një burim historik të kohës antike, të përmendet emri i këtij fisi ilir. Plini është një autor i sigurt sa i përket saktësisë së të dhënave. Kështu, edhe lidhur me këtë, ai jep shënimet më precize për emrat e fiseve dhe qyteteve ilire. Përveç kësaj, në shumicën e rasteve, e jep edhe sipërfaqen e trevës të cilën e banon secili fis, kryesisht për ato fise të cilat e kanë banuar Dalmacinë, pra, ato që, si duket, i ka njohur më së miri. Sipas të gjitha gjasave, **rudinët** janë njëri nga fiset e vogla, sikur edhe fiset e tjera, përveç labeatëve, që i numëron Plini, në këtë pjesë të Ilirisë.

II) RUDINË - toponimet ballkanike

Rrypi i bregdetit si dhe hinterlandit adriatik, nga Histria (Istra në Kroacinë e sotme) deri në krahinën e Labeatëve (Malësia e Madhe në Malin e Zi të sotëm) është trualli i cili ka ndikuar në mënyrë vendimtare në krijimin e fizionomisë mesdhetare të civilizimit ilir. Andaj, edhe në rrafshin e toponimisë, kjo trevë është jashtëzakonisht e rëndësishme për hulumtime sepse këtu janë ruajtur më së miri emrat e vendeve në trajtën e tyre thuajse, origjinale antike.

Dalmacia

Në Dalmaci ekzistojnë dy mikrotoponime me rrënjën **Rud**. Në veprën e tij jashtëzakonisht të vlefshme, "*Rruga nëpër Dalmaci*", *Alberto Fortis*, biolog dhe udhëpërshkrues italian i shek. XVIII, duke e përshkruar luginën e lumit Cetina në Dalmaci, në shek, e përshkruan hollësisht edhe përbërjen gjeologjike të Fushës së Cetinës dhe i përmend dy kodrina: **Rude** dhe Trilj, nën të cilat rrjedh lumi Cetina.

Lidhur me kodrinën Rude, Fortis përshkruan dëmet që i bëjnë ujrat nëntokësorë kodrinës së përmendur, ujëra që derdhen afër Trilj- it, ku ka shumë gërmadha të monumenteve romake. 4)

Në një vend tjetër, ai e përmend gotullen Rudi në ishullin Vis (Issa ilire). E përshkruan përbërjen gjeologjike të bregut të Vis -it dhe flet për eshtrat me vjetërsi gjeologjike, të gurëcuara në gotullen **Rudi.** 5)

Përveç këtyre toponimeve, e dimë se në Dalmacinë e sotme, me këtë rrënjë ekziston edhe toponimi **Rudina** në ishullin Hvar (*Pharosi* ilir).

Hercegovina

Rudina është krahinë e brendshme shkëmbore në Hercegovinë . Në shek. XIV, kjo është provincë dhe përmendet me 1357 në një *comercium communis,* lidhur me të drejtën e blerjes së krypës së banorëve të saj dhe banorëve të gjashtë provincave të tjera (*Draèevica, Konavli, Trebinje, Vrm, Hum* dhe Bosnje – emrat mesjetarë dhe të sotëm) në dy magacine të Dubrovnikut. 6)

Mali i Zi i vjetër

Në Malin e Zi të Vjetër, ekziston kodra **Rudina** në kufirin e dy fiseve: *Sotoniqët (Sotoniæi*) dhe *Podgora* në perëndim të Liqenit të Shkodrës 7) **Rudine** është vendi në qendër të fshatit *Jezero*, në trevën e fisit *Æekliæi*,

ku gjenden dy *mogila (tuma*) të mëdha të punuara nga guri. 8) **Rudinica**, është mikrotoponim mes lokaliteteve *Ugnjan* dhe *Ceklin* në *Rijeèka nahija*. 9) *Rudinica* është mikrotoponim në fshatin *Dobronje•*, fisi *Cuce*. 10) **Rudopolje** është fshat i vogël në fisin *Bajice*, 11) **Rudovi** është emri i vëllazërisë së vogël në fisin *Borišiæ*. 12) Në trajtën **Rudinica,** -e, janë disa mikrotoponime: në fshatin *Vodni - Do* dhe te fshati *Kruška*, 13) Me këtë trajtë është fshati në fisin *Donji - Pješivci*, 14) dhe "*rrafshina*" (thonjëzat e origjinalit) e quajtur **Rudinice** në fshatin *Izvor*, 15)

Brda

Në pjesën e Malit të Zi të sotëm që njihet me emrin *Brda* dhe që hyn më vonë në kuadër të shtetit malazez, në trevën e fisit Bratono•iæi, ekziston mikrotoponimi **Rudine**, emër *komuni* (tokë e përbashkët e fistit) në fshatin *Klopot*, 13) Në fshatin *Pavlièiæi*, ekziston toponimi „***Rudine** Pavlièiæa*", 14)

Në fisin *Piper*, në lindje të *katunit •abiæa - Lokve*, është vendi **Rudina**. Pastaj, është *Bijela **Rudina*** në lartësi. 15)

Malësia e Madhe

Në Malësinë e Madhe (Mali i Zi i sotëm), në fisin e Kuçit, gjenden shumë mikrotoponime "**Rudinë"**. Kështu, edhe sot, në fshatin Nikmarash, gjendet një mikrotoponim i tillë të cilin e përmend gjeografi serb Erdeljanoviæ. 16) Në fshatin Delaj, po ashtu. 17) Në fshatin kuças Donji - Cvarin gjendet i njëjti mikrotoponim. 16) Në krahinën e Medunit, (sllav. *Medun*, ilir. *Meteon* – qendra e dikurshme e fisit labeat) në fshatin Meduni i Poshtëm, gjendet mikrotoponimi "*Husove **Rudine***" (Rudina e Husit), pastaj, "*Vlaška - **Rudina***" (Rudina e vllehëve). 18) Në fshatin e fisit të vogël kuças, *Duèiæ*, mes dhjetëra mikrotoponimesh me prejardhje nga popullata më e hershme (ilire, romane, shqipe), ekziston edhe ai i quajtur "***Rudina** od Dodeša*" (Rudina e Dodeshit) 19)

Serbia

Jashtë këtij rrypi adriatik, ekzistojnë toponimet me trajtë të ngjashme dhe me rrënjë të njëjtë sikur këto që i numëruam. Kështu, në Serbinë mesjetare dhe të sotme, ekziston një numër i madh i toponimeve të tilla (*Rudari* - vendbanim, *Rudenica* – kisha, *Rudišta* – miniere afër Beogradit, *Rudnik* – provincë mesjetare serbe; toponim në malin *Mokra – Gora*, mal në Serbi ku eksploatohet bakri, zinku ari etj.; *Rudnik* – vendbanim minator, *Rudnica* – përrua në malin *Tara*; *Rudlo* – emër personal i një

aristokrati në Mesjetë, *Rudno* – emër personal i një farkatari në Mesjetë. 20) Këto janë prezente, kryesisht, në vende të pasura me xehe. Ndoshta, nëse do të hynim më thellë në zbërthimin e këtyre nocioneve dhe nxjerrjen e paraleleve mes tyre, do të vinim në përfundim se rrjedhin nga rrënja dhe kuptimi i njëjtë.

III) Etimologjia e rrënjës RUD

Në shpjegimin e toponimisë së një treve, u referohemi gjuhëve të cilat fliten ose janë folur në atë trevë. Në këtë rast, e dimë se treva të cilën e trajtojmë, ka qenë e banuar nga popullata autoktone ilire. Fisi të cilin e trajtojmë në këtë vështrim ka qenë ilir, këtë e thotë edhe vet autori i cili e ka shënuar këtë emër – Plini Plak.

Kjo është koha kur ilirët janë nën sundimin romak plotë dy shekuj. Gjuha latine është gjuhë në të cilën kryhen punët zyrtare, ndërsa gjuha ilire është gjuhë e shtëpisë, gjuhë private, dhe, ndoshta, gjysmilegale. Sepse, është kjo koha e cila vjen pas shuarjes së kryengritjes më të madhe kundër pushtuesit romak, e cila i rrezikoi edhe vet themelet e Romës, kryengritjes së madhe ilire, viti 6 – 9 pas K., shtypja e së cilës e shënon shndërrimin definitiv të ilirëve në qytetarë të rendit të dytë dhe rënien e këtij civilizimi. Këtë e thotë edhe Plini kur duke folur për këto fise, flet në kohën e shkuar - “qenë”. Pra, për shpjegim të emrit në fjalë, në rend të parë, i referohemi gjuhës me të cilën disponojmë, e kjo është gjuha latine.

Në gjuhën latine gjejmë këto shpjegime të rrënjës **rud**:

I **rudis, e**

1. i papunuar, i pagdhendur, i palatuar: *saxum rude* – gur i palatuar;
2. i trash, i pagdhendur; i trashë, i paeksperiencë.

II **rudis, is** f.

1. purtekë, shufër;
2. purtekë me të cilin gladiatorët dhe ushtarët stërviteshin për skermë: *accipere rudem* – me dalë në lirim.

III **rudo, ivi, - , ere** int.

1) *garris*, ulurij, pall;

2) kërcas, kris, cërrlik, kërkëllij

IV **rudus, deris**, n.
1) zhur, zhavorr;
2) rudera pl. rrënime, gërmadha

V **rudus, ruderis**, n. shih raudus; 21)

VI **raudus, eris,** n.
1) copë tunxhi, monedhë e vogël tunxhi; 22)

Ekziston edhe një opsion me rrënjën **rud**. Këto janë gjuhët e vjetra indoevropiane

- indishtja e vjetër dhe avestishtja 23). Të shohim se çfarë kuptimi ka kjo rrënjë:

Gjuha	Trajta	Kuptimi
Indishtja e vjetër	Rudh	Rritëm, zhvillohem
Avestishtja	Rud	- " -

Tu kthehemi mikrotoponimeve dalmatine që i përmendem më lartë, me të njëjtën rrënjë – rud (**Rudi** dhe **Rude**). Duke gjykuar në bazë të trajtës, pra, nuk është fjala për trajtën **rudinë**, por, për një më të shkurtër, edhe pse, me të njëjtën rrënjë, dhe, si duhet, me kuptim të afërt, ti referohemi gjuhës italiane. Aty e gjejmë se **rude** është adjektiv dhe do të thotë: i papërpunuar; i ashpër, i vështirë. 24) Italishtja si gjuhë bijë e latinishtes, në këtë rast përputhet me kuptimin e adjektivit latin që është cituar më lartë, nën pikën I)

PËRFUNDIM

Opcioni i sigurt është se toponimet që i përshkruan *Fortis* në Dalmaci, me rrënjën **rud (**Rudi dhe Rude**)** rrjedhin nga adjektivi latin **rudis, - e**, i papunuar, i palatuar, i pagdhendur. I takon lakimit të dytë. Ky është adjektiv me dy mbaresa, ***-is*** (mashkullore dhe femërore) dhe –e (asnjanëse)

	Singular		Plural	
	m. f.	n.	m.f.	n.
Nom.	*rudis*	***rude***	*rudes*	*rudia*
Gen.	*rudis*		*rudium*	
Dat.	***rudi***		*rudibus*	
Acc.	*rudem*	***rude***	*rudes*	*rudia*
Voc.	rudis	**rude**	*rudes*	*rudia*
Abl.	***rudi***		*rudibus*	

Trajta me **rudin – ë,** duhet të jetë nga adjektivi latin i lakimit të dytë, për gjininë mashkullore dhe asnjanëse, ndërsa adjektivët e gjinisë femërore i takojnë lakimit të parë. Në këtë rast, adjektivi *rudinus*, - i, (mbaresa me –***us,*** i, si p.sh. *libertinus*, -i), dhe *rudina*, - ***ae***, f., dhe *rudinum*, -i, do të lakoheshin kështu**:**

Singular
rudinus, rudina, rudinum –
i shkëmbit, shkëmbor

Nom.	*rudinus*	***rudina***	*rudinum*
Gen.	***rudini***	***rudinae***	***rudini***
Dat.	*rudino*	***rudinae***	*rudino*
Acc.	*rudinum*	*rudinam*	*rudinum*
Voc.	*rudine*	***rudina***	*rudinum*
Abl.	*rudino*	***rudina***	*rudino*

Plural
rudini, rudinae, rudina

Nom,	***rudini***
Gen.	*rudino*
Dat.	*rudini*
Acc.	*rudino*
Voc.	***rudini***
Abl.	*rudini*

Çfarë mund të konkludojmë lidhur me etimologjinë e termit **rudinë**?

1) Është term që i takon fondit të gjuhës latine.

2) Domethënia e termit është "shkëmbor, nga shkëmbi, i shkëmbit".

3) Nuk është e rastit që domethënia e termit me të cilin romakët e quanin këtë fis ilir, përputhet me trevën në të cilën është evidente prezenca shumë e madhe e këtij termi.

Burimet dhe literatura

1) Dubrovniku në Kroacinë e Sotme

2) Illyrii proprie dicti

3) Plinius Maior, *Naturalis historia*, III, 22, *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Prishtinë, 1979

4) Alberto Fortis, "*Put po Dalmaciji*", Zagreb, 1984, f. 198

5) Ibidem, 246

6) Konstantin Jireèek, "*Istorija Srba"*, II, Beograd, 1988; f. 215

7) Jovan Erdeljanoviæ, «*Stara Crna gora*», Beodrad, 1978; f.188

8) Ibidem, f. 531,534

9) Ibidem, f. 295

10) Jovan Erdeljanoviæ, "*Kuèi, Bratono•iæi, Piperi"*, Podgorica, 1997; f. 72

11) Ibidem, f. 73

12) Ibidem, f. 85

13) Jovan Erdeljanoviæ, "*Stara Crna Gora*", op.cit., f. 621

14) Ibidem; f, 155

15) Ibidem; f. 632

16) Jovan Erdeljanoviæ, "*Kuèi, Bratono•iæi i Piperi*", op.cit., f. 72

17) Ibidem; f. 73

18) Ibidem; f. 46, 47

19) Ibidem; f. 87

20) Konstantin Jireèek, op.cit., f. 476

21) Henrik Lacaj e Filip Fishta, *Fjalor latinisht – shqip*, Prishtinë, 1980; f. 462

22) Ibidem, f. 438

23) Emil Benvenist, *Reènik indoevropskih ustanova*, Novi Sad, 2002; f. 214

24) Reènik italijansko - srpski, Cetinje, 1995; f. 206

Dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI

EMRAT E ANIJEVE TË FLOTËS DETARE ULQINAKE

Askush nuk e mohon që leksiku detar i shqipes së sotme në pjesën e tij më të madhe është i burimit të huajë; veçse edhe këtu, ashtu si në lëmin e toponomastikës, duhet të bëhen dallime cilësore. Të huaja janë termat teknike të lundrimit e të peshkatarisë, sikundër janë në pjesën e tyre më të madhe emrat e mjeteve të lundrimit e të pjesëve të tyre, më të shumtat emërtime të llojeve të peshqve e të veglave të peshkimit.

Po krahas me këto shqipja ka ruajtur një pjesë jo dhe të paktë me fjalë vendi, që janë të fondit autokton të fjalorit të saj, siç është rasti më Ulqinin, si vendbanim i vjetër në brigjet e Adriatikut..

Nga emërtimet e mjeteve të lundrimit emri gjenerik a n i j e dihet se ka lidhje me a n a n ë "e n ë", pra nga kjo anë mund të krahasohet me gjerm. *schiff* - "anije" që vjen nga gjerm. e lartë e vjetër *scif* - "enë", e me frengj. *vaisseau,* ital. *vascello* "anije" nga lat. *vascellum* - "enë" e vogël". Edhe vetë shumësi i fjalës a n a n ë, që është *enë*, përdoret për "mjet lundrimi", enët e mëdha, enët e vogla. Megjithëqë mjetet e sotme të lundrimit kanë pothuajse të gjitha emra të burimit të huaj, nuk kanë munguar as këtu emërtime të vendit; kështu për vitin 1403 gjendet e dëshmuar për Shqipërinë Jugore *gripareas* - "barka kripe" një rrjedhojë e fjalës *kripë* (*Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, II, 742).

Nga emrat e pjesëve e të pajisjes së anijeve janë me burim vendi ndër të tjera emri i pjesës së përparme të anijes (*ballës*), ai i dërrasave të fundit që qëndron në ujë (*terzha*), pastaj emri i velit (*pëlhurë*), i shulit

(*shul*), i lopatës (*lugatë = lugë + lopatë*), i shulit të gjatë për të shtyrë (*shtizë*); khs. Edhe ena *ujtis* - “ena tërheq, thith ujët”, nga fjala *ujë*. Është e vërtetë ndërkaq që kjo terminologji e vjetër është mbajtur vetëm në disa dialekte të mënjanuara të bregdetit; përveç kësaj këto nuk janë studiuar sistematikisht nga kjo anë.

Në hullinë e fjalëve të huaja, sidomos veneciane e turke, në terminologjinë e detarisë e të peshkimit, shqipja ecën bashkë me të tjera gjuhë të Ballkanit, sidomos me greqishten e re e me serbokroatishten.

Pas mendimit të përgjithshëm fjalët që i përkasin lundrimit e peshkatarisë janë të marra prej gjuhëve fqinje, e kjo zihet prapë si një argument kundër një banimi të vjetër në brigjet e Adriatikut. Ky mendim burimin në themel e ka në *Norbert Jokli*, veçse për sqarim të gjithë gjendjes duhet shënuar se ky gjuhëtar më vonë këtë e ka dobësuar ai vetë me kundërargumente. Kështu ai vë në pah kundër *Vajgandit* faktin që gjermanishtja e lartë një pjesë të madhe të termave të saj nga jeta e detarisë i ka marrë prej gjermanishtes së ulët, e megjithatë, është gjë e ditur që gjermanishtja e lartë është gjuhë gjermanike dhe që popujt gjermanikë kanë qenë qëmoti anadetas e detarë (*Indogermanische Forschungen* 46, 383).

Sipas Vajgandit shqiptarët, “po të kishin banuar gjithmonë në Iliri, duhet të kishin shpëtuar disa nga më të zakonshmet terma nga të leksikut autokton të trashëguar, si ndonjë fjalë për lundër, anije, lopatë, timon, shul, vel si dhe emra peshqish etj.”.

Kjo tezë, të cilën e kanë përsëritur disa dijetarë, është hedhur edhe kjo tepër ngutshëm, sepse nuk pajtohet më të dhënat e gjuhës.

Emrat topikë të Shqipërisë, që njihet prej kohës antike e këtej, së bashku me terminologjinë detare të shqipes e me huazimet dorike greke veriperëndimore që ruhen në këtë gjuhë, dëshmojnë që viset bregdetare të Adriatikut bëjnë pjesë qëmoti, së paku që prej epokës greko-romake, në atdheun ballkanik të shqiptarëve.

Edhe në qoftë se nga pushtuesit e huaj u shty duke u tërhequr për disa kohë nëpër zonat malore, ky element etnik nuk u largua kurrndonjëherë nga horizonti i Adriatikut, sikundër vërteton një varg emrash topikë të lashtë, e sikundër tregon dhe karakteri arkaik i huazimeve latine. Kështu, pra, vendbanimi i tij nga koha antike e këtej s’ ka pësuar ndonjë dislokim qenësor. Kjo tezë e paraqitur këtu në vijat kryesore duhej shtjelluar në hollësira. Aty duhet të merreshin parasysh dhe shtresat e mëvona të emrave topikë, të cilat janë një dëshmi për dyndjet e huaja gjatë historisë shqiptare.

EMËRTIMET E LLOJEVE TË ANIJEVE ME VELA (VELANIJE)

BARK (BARC) - anije me vela (velanije) me dy apo më shumë direkë. Prejardhja e kësaj anije (velanije) është nga gjuha angleze; anglisht, bark; (*Veliero da transporto con due o piu alberi*), (*Prontuario Etimologico della lingua italiana* – Megliorini - Duro, Paravia, Torino, 1958).

BARKA (BARCHA) - barkë, varkë, lundër, barkë peshkimi; lat. *barca* dhe në gjuhë të vonshme dalmatine, nga greq. *baris, baridos* (me prejardhje egjiptase), (P. Skok, *Naša pomorska i ribarska terminologija*, Split, 1933, fq. 24, 148); *barca, barcoso*; emërtimi përmendet nga shekulli XIV. Mendohet se prejardhja e kësaj anije është mesdhetare; *barca, barxia, barza* (*navis genus*); *barca* (*che dicessi anche naviglio o legno*) (P. Skok, *Etimologijski rjeènik hrvatskog ili srpskog jezika*, knjiga I-III, Zagreb, 1971 - 1973).

BARKUSI - velanije me dy direkë dhe vela latine. Përmendet gjatë shekullit XIV, i shënuar si: *barcussium, barcosium, barcoso, barcuscius, barcaccia, barcaca, barcaza, barcha*; ital. *barcaccia*, ven. (ven. e vjetër) - *barcaza* (*Lexicon latinitatis medii aevi iugoslaviae*, vol. I et. II, Zagrabiae, MCMLXXIII - M. Kostrençiq).

BRACER - anije për transport të mallrave më dy direkë; lat. brac (*chium*), nga greq. *brachi'on,-onos*; *brazzera* (*chiamassi und barca che porta due alberi con vele quadre, e va anche a remi*); *brazzera, bracera, bracerota* (*Pomorski rjeènik*, R. Vidoviq, Split, "*Logos*", 1984; *Dizionario del dialetto veneziano*, G. Boerio, Venezia, 1867).

BRIGANTINI - velanije me dy direkë; ital. *brigantino*, vened. *bregentin, brigantino* (*bastimento che viaggia in compagnia, brigantino* (*nei secoli XIV-XVI, piccolo bastimento sottile*); brigantinus, brighentinus, brighintinus, brigentin; brigante = brigare - duke luftuar; në gjuhë kelte: fuqi (*Dizionario di Marina medievale e moderno*, Roma, R. *Accademia d' Italia*, 1937).

BRIKU - anije me vela, me bartësi të vogël (*bricco, burricus, brick*). Angl. *brig*; frengj. *brick* dhe *brig*; gjerm. *brigg*; ital. *bricco*. Anije relativisht e kohës së re. Nuk përmendet para fillimit të shekullit XVIII.

CAKORA - anije (bark(ë) e hapur si skaba (*scaba*). Shënohet me këtë emër në këta variante: *zachorum, cachora, cachorum*.

KARAKA (CHARACHIA) - velanije e madhe tregtare me prejardhje nga Portugalia. Në Venedik (Venecia) u paraqit në fillim të shekullit

XIV. Paraqitet më këta emërtime: *caracca, karraka* në gjuhë arabe; angl. *carrack*; frengj. *carraque*; në gjuhë holandeze *kraeck*; në gjuhë spanjole *carraca*; ital. *caracca*.

KARAVELLA - velanije me tre ose katër direkë, me prejardhje portugeze. Në gjuhë latine të vonshme, njihet si: curab(u)*m* = krabë- a (*brachiura*), lloj gaforreje deti; greq. karabos prej shekullit XV-XVI, më së shumti e kanë përdor spanjollët dhe portugezët; ital. *caravella*; spanj. *carabela*; frengj. *caravelle*; angl. *caravel, caravella, carauella* (*Lexicon latinitatis medii aevi iugoslaviae,* vol. I et. II, Zagrabiae, MCMLXXIII- M. Kostrençiq).

KEKIJA (CHECCHIA) - velanije e madhe me dy direkë. Quhet edhe *çeça* (me dialektin venedikas) ose brigantin (*Pomorski rjeènik*, R.Vidoviq, Split, «*Logos*», 1984).

KOKINA dhe KOKA (CHOCHINA) - velanije e madhe (*cocca*); i vogël - *cochina*. Në Mesdhe paraqitet në shekullin XIII. E ndërtuan: gjenovezët, venedikasit, katalonët, dubrovnikasit, kotorrasit dhe ulqinakët në shekullin XIV; c o c a (*grosso bastimento*): nga latinishtja e vonshme *caudica - coca, cochina* (*piccolo coca*). Në Venedik paraqitet prej shekullit XIV - XV; në gjuhën e vjetër italiane - *cocca*; frengj. *coche, cochina* (*Dizionario di Marina medievale e moderno,* Roma, R. *Accademia d'Italia*, 1937; *Prontuario Etimologico della lingua italiana - Megliorini*, Duro, Paravia, Torino, 1958).

FELLUKA, FLLUGA (FELUCA) - velanije tregtare me dy direkë. Është i shënuar më këta variante të emërtimeve, siç janë: *feluca, filuga, filjuga, filegata, filugeta, filughetta* (*piccola felucca*); ital. *feluca*, arab.- *faluk*.

FREGADUNI (FREGATA; FREGADA) - velanije i llojit venedikas në Detin Adriatik me tre direkë. Njihet më këta emërtime: ital. *fregaton(e), fregatone, fregata* prej latinishtes *fricatura, fregada* dhe *fregadina*. *Fregato* - velanije nga shekulli XVIII dhe XIX. Në marinerinë bashkohore është anije luftarake.

FUSTA dhe FUSHTA - velanije e shpejtë me një direk dhe me një velë. Nga latinishtja fuste (*thupër, shkop, kamxhik*; *pastinaku* - lloj peshku (*trygon pastinaca*); ital. *fusta* (lloj i anijeve pirate). *Fusta* në Venedik ishte në përdorim prej vitit 1498 - 1570 (*Prontuario Etimologico della lingua italiana - Megliorini*, Duro, Paravia, Torino, 1958).

GAJETA (GAETA) - velanije e madhe me një direk. Venedikisht - *gaeta*.

GALI(J)A - anije me rrema dhe vela prej shekullit X - XVIII, prej

emrit *galea*. Emri është metaforik për arsye së forma e anijes është e ngjashme me breshkë deti. Emërtimi e ka prejardhjen prej: greq. *galaia*; italishtes së vjetër - *galea*; ital.- *galea, galia, galera* (*Dizionario del dialetto veneziano*, G. Boerio, Venezia, 1867).

GRIPI (GREPARIJA, GREPARIJUSI) - velanije me dy direkë. Në Ulqin daton prej shekullit XV - XVIII. Emrin e ka me prejardhje të gjuhëve: greq. *grip*; ital.- *grippo*; në gjuhë venedikase - *gripo, grypos*; lat. *grifo*, latinishtja e vonshme - *griphum*. Paraqet një zoonim për arsye së është i ngjashëm me formën e sqepit të zogut, në formë të bashit të anijes. (*Lexicon latinitatis medii aevi iugoslaviae*, vol. I et. II, Zagrabiae, MCMLXXIII, M. Kostrençiq).

LANCA - anije pirate dhe bark(ë) (anije) ndihmëse me velanije. Emri i kësaj anije e ka prejardhjen prej fjalëve të gjuhës: ital. - *lancia*, venedikisht - *lanza, lancia, lanchia, lancia* (*barchetta*); lat. – *lancea*, ital.- *lancia* (*Romanisches Etymologisches Worterbuch* – Meyer - Lubke, Heidellberg, 1953).

LEUT - anije peshkatare me dy direkë, i ngjashëm *gajetës*. P. Skoku mendon së ky emërtim e ka prejardhjen lindore. Në gjuhë latine - *leudus* dhe *laudus*; vened. E vjetër - *leuto, leut* dhe *legut* (*Pomorski rjeènik*, R. Vidoviq, Split, «*Logos*», 1984; P. Skok, *Naša pomorska i ribarska terminologija*, fq. 150; *Dizionario del dialetto veneziano*, G. Boerio, Venezia, 1867).

MARSILIANA (MARCRLIANA) - velanije me tre ose katër direkë dhe me vela latine nga shekulli XV dhe XVII. Nëpër Detin Adriatik dhe Detin Jon lundronte deri me shekullin XVIII. Nga gjuha italiane - *marciliana* dhe *marsiliana*. Në Gjenovë njihet me emrin: *marziliana, marciliana, marceliana* (*Dizionario di Marina medievale e moderno*, Roma, R. *Accademia d' Italia*,1937).

MARTIGANI (MARTIGANA) - velanije e madhe me dy ose tre direkë. Në Detin Adriatik përmendet në gjysmën e parë të shekullit XVIII. Emërtimi lidhet më këta fjalë: *martigana, marticana* dhe *martigana*.

NAVA - velanije me tre ose katër direkë. Prej gjuhës lat. - *navicare*; ital. - *navigare, navis, nave, naveata, navesela, nave, navicium, navicius, navicula*.

PEOTA - anije e vogël me direk dhe vela. Përmendet në Detin Adriatik në gjysmën e parë të shekullit XVIII. Njihet me këta emra: *pedotto, pedotta, pedoto*.

PELIGU (PIELEG, PJELEGU) - velanije pirate - korsare. Kjo anije ka poseduar tre direkë, në formë të *trabakullit*. Prej gjuhës latine - *pelagus* = deti.

PINKA, PINK (PINC) - anije me tre direkë dhe me vela latine. Prej fjalës frëngjishte: *pinque; pinco* (*specie di bastimento mercantile usato nel Mediterraneo*), (*Dizionario di Marina medievale e moderno*, Roma, R. *Accademia d' Italia*, 1937).

POLAKA, PULAKA (POLACA) - velanije tregtare me tre direkë. Prej fjalës italiane: *polacca, pollacca*; lat.- *navem palagica*- anije për det të hapur.

SAGENA - anije peshkatare (domethënia greke klasike është: *rrjeta e madhe peshkatare që gërgohet (tërhiqet)*. Të P. Skoku paraqitet me emrin: *sagena* (*piccolo bastimento medievale da pirati littorani* - anije e vogël mesjetare të piratëve bregorë); lat.- *sagena* prej greq.- *sagene*. Në shekullin XIV - *sagina, sagena*.

SAJETA (SAETA, SAGITA) - velanije e shpejtë me dy direk dhe vela latine. Lat.- *sagita* (zhjetë); ital.- *saetta*, lat.- *sagitta, sagettia, sagitea, sagiteda, sachitea* (*navis velocis species* - lloj i anijes së shpejtë).

SHAMBEKU - velanije me tre direkë; ital.- *sciabecco*, frengj.- *chebec*, angl. – *xebec*, sp anj. – *jabeque* (*bastimento da guerra del Mediterraneo*- anije luftarake në Mesdhe). *Shabaka* prej turqishtes - *sciabecco - stambecco, zabecco,* arabisht - *shabbak, a, e,* ital. në shekullin XIV - *sciabica*, arabisht - *shabaca* (*rrjeta* dhe *barka*).

SHKABA (SHABA) - anije. Prej fjalëve: *scaba, cscapha, symba* - anije; arabisht - *shabaka* (rrjetë për peshkim në thellësi të vogël).

SHKUNA - velanije e vogël për lundrim bregor. Nga gjuha italiane: *scuna, scona*.

TARTANA - velanije e vogël për transport të mallrave me dy direkë. Në gjuhë italiane: *tartana* (*bastimento da carico del Mediterraneo* - anije tregtare mesdhetare); në gjuhë arabe - *tartaneh* (*Dizionario di Marina medievale e moderno*, Roma, R. *Accademia d' Italia*, 1937.).

TRABAKULLA - anije tregtare. Prej fjalës italiane: *trabaccolo*, lat. *trabum*; arabisht - *trabaca* - *tabaqah* (pullaz), anije me "pullaz".

VASHELL - velanije e madhe luftarake. Prej gjuhës latine: *vascello, vascellum*.

ZOLISI, ZOLLA - anije e vogël. Nga gjuha italiane: *zola, cola* (*navigii genus* - lloj- i anijes), vened.- *zola* dhe *cola*.

ZOPULIMI (COPOLO) - velanije bartëse me direk katror. Nga gjuha italiane: *zopolo* (*barca lunga e stretta* - anije e ngushtë dhe e gjatë). Emri i anijes paraqitet në këta variante: *copulum, ciopulum, zoppolo*.

Shefkije ISLAMAJ
(Instituti Albanologjik i Prishtinës)

KONSULTA GJUHËSORE 1968 - MARRËVESHJE PËR NJËSIMIN GJUHËSOR

Viti 2008 është viti i përvjetorëve të mëdhenj të gjuhës e të kulturës shqiptare. Njëqind vjet të alfabetit të shqipes. Njëqind vjet të lindjes së Eqrem Çabejt - studiuesit më të madh të shqipes. Dyzet vjet nga mbajtja e Konsultës historike Gjuhësore të Prishtinës - konsultës që do të bashkojë shqiptarët rreth një gjuhe: gjuhës standarde shqipe. Këta përvjetorë tonë të mëdhenj kanë rastisur edhe me Vitin Ndërkombëtar të Gjuhëve të shpallur nga UNESKO-ja – një rast i mirë ky që të bëjmë sivjet diçka posaçërisht të vyer për gjuhë shqipe.

Në fund të vitit që shkoi, në kohën kur po hartohej plani i punës për vitin pasues, Dega e Gjuhësisë e Institutit Albanologjik kishte para vetes një detyrë të vështirë – të zgjidhte njërin prej këtyre tre përvjetorëve që do ta shënonte me sesion shkencor. Përzgjedhja ra mbi Konsultën Gjuhësore të Prishtinës. Pse? Për disa arsye e ndër to, për arsye se institucione të tjera me rëndësi të shkencës në rrafshin kombëtar tashmë kishin shpallur publikisht se do të shënonin 100-vjetorin e Alfabetit dhe 100 - vjetorin e lindjes së Eqrem Çabejt, dhe shënimi edhe nga ana jonë do të thoshte dyfishim. Ndërkaq, për Konsultën nuk u bë me dije asnjë shënim dhe nga asnjë institucion. Arsyeja tjetër, kryesorja, për Degën e Gjuhësisë, ishte fakti se Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila pikërisht më 22 prill mbushi 40 vjet, është ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë tonë gjuhësore e kulturore. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës tash 40 vjet i vuri pikë rrugës veçuese jo vetëm gjuhësore, nëpër të cilën

po ecnin shqiptarët. Ajo hapi rrugën e njësimit tonë gjuhësor dhe bëri që Kongresi i Drejtshkrimit, që do të mbahet katër vjet më vonë të quhet kongres mbarëkombëtar.

Edhe një arsye tjetër kishte Dega e Gjuhësisë për shënimin e këtij përvjetori – Konsulta Gjuhësore e Prishtinës u organizua me nismën pikërisht të Institutit Albanologjik. Ja pse konsiderojmë se përzgjedhja jonë ishte e drejtë. Prandaj, një përvjetor si ky, me domethënien që ka për shqiptarët, me kuptimin që ka për historinë dhe të ardhmen e tyre, meriton më shumë se një shënim modest si ky yni, sepse nuk është vështirë ta marrim me mend se sa të ndarë a se sa të bashkuar do të ishim sot po të mos ishim bashkuar para 40 vjetësh rreth gjuhës së përbashkët standarde. Zëri ynë bashkues ishte Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Ndoshta nuk është e tepërt të përsërisim se gjuha ndan dhe bashkon më shumë se çka do tjetër. Dhe histori të popujve të ndryshëm na e kanë dëshmuar qartë këtë. Ndërkaq me Konsultën u shpreh vetëdije e lartë dhe largpamje kombëtare.

Vështrim historik

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) është mbledhja e katërt gjuhësore e organizuar në Prishtinë përgjatë 16 vjetëve. Me Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968) nuk fillon planifikimi gjuhësor për shqiptarët që asokohe jetonin jashtë shtetit amë, në disa ndarje administrative në ish-Jugosllavinë. Pesë vjet pas përfundimit të luftës, në vitet 50 të shekullit XX, në kohën e rrethanave të reja gjeopolitike në Ballkan, në kohën kur tokat shqiptare, bashkë me shtetet e tjera të Ballkanit, po përballeshin me probleme të shumta politike, sociale, ekonomike e kulturore, kur edhe Kosova, tanimë dhunshëm pjesë e Serbisë dhe e Jugosllavisë, po përpiqej të shëronte shumë plagë, çështja e gjuhës do të shtrohet si kërkesë shumë reale e kohës. Ndarja dhe veçimi nga shteti amë nxori përfushë shumë kërkesa të reja për popullatën e Kosovës, të cenuar rëndë edhe nga shkalla e ulët e arsimimit. Çështja e gjuhës del një ndër punët e ngutshme. Derisa në Shqipëri varianti letrar jugor po kthehej në gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar, një variant që po pasurohej ndjeshëm me përdorimin në administratë, me shtrirje të gjerë edhe në arsim, po sidomos me një prodhim të shtuar letrar e publicistik, të mbështetur në një traditë të pasur shkrimesh letrare, publicistike e përkthimesh, gegërishtja letrare vijonte të përdorej andej e përkëtej

kufijve, jo me epërsinë e shtrirjen që kishte njohur dy a tri dekada më parë. Në kushte të reja e të ndryshme politike e kulturore nga ato të Shqipërisë, gegërishtja vijoi të shkruhej në Kosovë, si edhe në vise të tjera shqiptare të mbetura si Kosova. Në rrethana të këtilla të pasluftës, intelektualët e paktë shqiptarë do të fillojnë punën e ngulmët në fushën e gjuhës, që pati që nga fillimi pikësynimin e mosshkëputjes gjuhësore nga shteti amë. [1]

Në nëntor 1952 në Prishtinë u mbajt Mbledhja e Parë Gjuhësore në të cilën, siç njoftonte Mehmet Hoxha në *Rilindjen* e 20 nëntorit 1952, u diskutuan çështje të ndryshme gjuhësore, ndër to çështje të zgjedhjes së bazës gjuhësore dhe çështje të ndryshme ortografike. Në mbledhje morën pjesë intelektualët shqiptarë të kohës si Idriz Ajeti, Selman Riza, Zekeria Rexha, Murteza Peza, Hivzi Sulejmani, Esad Mekuli, Hasan Mekuli, Vojisllav Dançetoviqi, Hasan Kaleshi, Salih Kolgeci, Petro Janura, Hasan Vokshi etj, si dhe politikanët dhe funksionarët e lartë politikë në organet e Kosovës dhe Jugosllavisë si Mehmet Hoxha, Ismet Shaqiri, Elhami Nimani, Alush Gashi, Kolë Shiroka, Imer Pula, etj.[2] Në diskutimet që u zhvilluan mbizotëruan prirjet që në drejtshkrim të ruhen mundësisht format e përbashkëta gjuhësore të të dy kryedialekteve. Idriz Ajeti, i cili lexoi referatin kryesor, u vu edhe në krye të Komisionit të formuar prej nëntë vetash, që do të shqyrtonte hollësisht probleme të drejtshkrimit, përfshirë këtu edhe rregullat e drejtshkrimit, të botuara një vit më parë në Tiranë. Komisioni zyrtarizoi me rezolutë për shkollën, shkencën e kulturën në Kosovë gegërishten jugore me elemente të të folmeve të gegërishtes verilindore.

Të kujtojmë se gjatë vitit 1952, por edhe para dhe pas tij, në Tiranë ishin zhvilluar dhe po zhvilloheshin veprimtari, diskutime e debate për çështje të gjuhës, të drejtshkrimit, po edhe të planifikimit gjuhësor. Kështu, në shtator 1952 në organizim të Institutit të Shkencave, Seksionit të Gjuhës e Letërsisë, do të mbahet Sesioni i Dytë Shkencor, në të cilin do të marrin pjesë numër i madh i gjuhëtarëve dhe intelektualëve të kohës si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Dhimitër Shuteriqi, Mark Gurakuqi, Zijadin Kodra, Osman Myderrizi, Lirak Dodbiba, Kolë Ashta, Mahir Domi, Injac Zamputi, Zihni Sako, Jup Kastrati, Jakov Xoxa, Kolë Jakova, M. Reso, Andrea Varfi, Sejfullah Malëshova e të tjerë, ndërkaq do të ketë për objekt diskutimesh jo vetëm problemin e gjuhës letrare kombëtare, po edhe probleme të tjera të gjuhësisë shqiptare, ndër to probleme që lidhen me dialektet, ortografinë, fjalorin, terminologjinë e të tjera. [3]

Vetëm pesë vjet më vonë, më 30 e 31 maj 1957, në Prishtinë do të mbahet Mbledhja e Dytë Gjuhësore, në të cilën u shqyrtuan çështje të normës në drejtshkrim, të miratuara në Mbledhjen e Parë Gjuhësore. Në mbledhje u caktuan dy grupe gjuhëtarësh për të përgatitur materialin përkatës, i quajtur *"Projekti i ortografisë i Mbledhjes së Drejtshkrimit"*. Në propozimet e përfshira në projekt hetohej përpjekja veçuese nga drejtshkrimi zyrtar i 1956-s, i botuar në Tiranë. Vendimet e kësaj konsulte shprehnin qartë prirje divergjente dhe për ruajtjen e varianteve letrare me përkatësi të ndryshme dialektore. Por në konsultë veçohet reagimi i prof. Idriz Ajetit, i cili mbajti qëndrimin sipas të cilit rruga që duhet të ndiqet në procesin e normëzimit është ajo që do të sjellë konvergjencën gjuhësore. [4]

Ndërkaq, më 14 -16 janar të vitit 1963 në Prishtinë do të mbahet Mbledhja e Tretë Gjuhësore, në të cilën, pos përfaqësuesve nga Kosova, morën pjesë edhe përfaqësues të shqiptarëve të Maqedonisë e të Malit të Zi. Këtu u diskutuan çështje të drejtshkrimit, më konkretisht u vu në diskutim Projekt-ortografia e re, e hartuar nga Komisioni i gjuhës dhe i letërsisë, i ngritur më 1961 nga Pleqësia e Arsimit dhe e Kulturës e KAKM-ës. Ky projekt u diskutua gjerësisht, ndërkaq pas shqyrtimit dhe analizës u vendos që një grup punues të hartojë tekstin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Nga ky komision u botua më 1964, në formë broshure, *"Ortografia e gjuhës shqipe"* - ortografia e parë dhe e fundit e hartuar pas luftës e para njësimit tonë gjuhësor.

Më 1967, rihapet Instituti Albanologjik. Po në këtë vit në Prishtinë arrin *"Projekti i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe"*, i cili do të nxiste nismën e Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës që më 22 e 23 prill 1968 të mbahej Konsulta Gjuhësore, e njohur gjerësisht me emrin "Konsulta e Prishtinës". Siç informon gazeta *Rilindja* e 23 prillit në faqen e parë, në Konsultë po merrnin pjesë 150 intelektualë e shkencëtarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e viset e tjera shqiptare. [5] Punimet e Konsultës zgjatën dy ditë. Fjalën e hyrjes e paraqiti Fehmi Agani, drejtor i Institutit Albanologjik, i cili duke e konsideruar mbajtjen e Konsultës punën më të rëndësishme të Institutit Albanologjik që nga rithemelimi i tij, midis të tjerash, do të theksojë: "Detyra që kemi asht e madhe, misioni ynë asht i randësishëm. Por, besojmë se rezultatet nuk do të mungojnë. Sepse gjuhëtarët tanë, koshientë për përparësitë e afrimit apo të njësimit gjuhësor, por edhe për nevojat e ruajtjes së lidhjes me popull dhe të funkcionalitetit të fjalës sonë të shkrueme, do të kërkojnë dhe do të gjejnë

zgjidhje ma të arsyeshme e ma të përshtatshme." [6] Më pas prof Idriz Ajeti, protagonisti kryesor edhe i tri mbledhjeve të mëparshme gjuhësore, do të mbajë referatin kryesor me titullin *"Rruga e njësimit të gjuhës letrare shqipe dhe ortografisë së re"*. [7] Në dy ditët u zhvilluan diskutime të shumta nga pjesëmarrësit. Diskutimet u zhvilluan në mbështetje të Projektit të Rregullave të drejtshkrimit. U shtruan çështje praktike, u bënë vërejtje parimore, u dhanë sugjerime të shumta. Numri i diskutuesve ishte i madh. Sipas raportit të gazetës *Rilindja* - vetëm gjatë muajit prill në këtë gazete u botuan 12 shkrime - raporte lidhur me Konsultën, duke i dhënë asaj vendin e merituar - në diskutime u përfshinë: Idriz Ajeti, Hilmi Agani, Besim Bokshi, Remzi Nesimi, Abdullah Zajmi, Mehmet Hoxha, Hasan Vokshi, Gani Luboteni, Mehmet Xhevori, Ismail Bajra, Vehap Shita, Murat Isaku, Anton Çetta, Hasan Kaleshi, Isa Bajçinca, Bahri Brisku, Ahmet Kelmendi Ahmet Maloku, Xheladin Deda, Mehmet Surdulli e shumë të tjerë. [8] Raporti i gazetarit, Ali D. Jasiqi, përfundon kështu: "Konsulta u dha fund punimeve me marrjen e përfundimeve, që do t'i botojmë në numrin e nesërmë të gazetës, me të cilat tubimi pranon unanimisht gjuhën letrare dhe ortografinë e sotme të shtetit."[9] Këto përfundime në të vërtetë janë Konkluzat e Konsultës të cilat do të botohen dy ditë pas në gazetën *Rilindja*.[10] Konkluzat u hartuan nga Komisioni i përbërë prej Hilmi Aganit dhe Besim Bokshit. Pika 7 është propozuar dhe hartuar nga Fehmi Agani.[11] Konkluzat përbëhen prej 9 pikash. Në konkluzën 3 shprehet qartë se Tubimi i 22 e 23 prillit të vitit 1968 njeh "njëzëri si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë."[12] Në pikat e tjera theksohet rëndësia e tri mbledhjeve gjuhësore që i kanë paraprirë Konsultës, rëndësia e njësimit gjuhësor, zbatimi i menjëhershëm i projekt-ortografisë. Në konkluzën nr. 8 autorizohen Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe që ta njoftojnë Universitetin Shtetëror të Tiranës me konkluzat e Tubimit dhe me vërejtjet lidhur me projektin e ortografisë. Ndërkaq, në konkluzën e fundit këto dy institucione "autorizohen që t'u rekomandojnë institucioneve e enteve arsimore e pedagogjike, gazetare e botuese, shkencore e kulturore që të krijojnë mundësitë e zbatimit sa më të shpejtë të konkluzave të Konsultës."[13] Dhe ashtu u bë. Zbatimi i Projekt-ortografisë filloi menjëherë. Edhe vetë Konkluzat e Konsultës Gjuhësore do të botohen në gjuhën letrare, mbështetur në projektin e drejtshkrimit, të miratuar një ditë më parë në Konsultë. Në një intervistë me Ismail Bajrën, gazeta *Zani i rinisë,* njofton lexuesit se "Do të botohen, në letrarishten e sotme shqipe edhe "Zani", edhe "Fjala". [14] Ç'është e vërteta, botimi në letrarishte

në Kosovë kishte filluar më herët. Në shkrimin "Një gjuhë letrare për të gjithë shqiptarët" të autorit Rrustem Berisha, botuar në *Zanin e rinisë,* thuhet: "Shtëpija botuese gazetare "Rilindja" në dy vjetët e fundit ka ba nji punë të çmueshme në këtë drejtim me botimin e nji numri të konsiderueshëm të veprave në letrarishten shqipe…"[15]

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës i çeli rrugë njësimit gjuhësor gjithëkombëtar të shqiptarëve e, rrjedhimisht, edhe Kongresit të Drejtshkrimit, që do të mbahet katër vjet më vonë, më 1972, në Tiranë.

Konsulta Gjuhësore u mbajt më 1968 dhe në Prishtinë. Pse më 1968 dhe pse në Prishtinë? Sepse më 1968 tashmë kishin filluar ndryshime që kishin rrokur kontekstin politik e shoqëror për shqiptarët, rrjedhojë e Plenumit të Brioneve në të cilin do të dënohej ashpër shtypja dhe represioni shtetëror ndaj shqiptarëve për një periudhë afro njëzetvjeçare dhe në Prishtinë, sepse ishte qendra konvergjuese për të gjithë shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, qendra administrative, arsimore e kulturore, sidomos e tillë do të bëhet nga fundi i viteve '6o kur për shqiptarët e Kosovës do të fillojë një periudhë e re zhvillimi sidomos arsimi e kulture dhe një bashkëpunim që do të zgjerohet çdo here e më shumë me Shqipërinë. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës është e nxitur drejtpërdrejt nga këto ndryshime dhe do të shprehë qartë synimet dhe dëshirat për artikulimin identitar dhe për shprehjen përkatësore. Si e tillë ajo do të pranohet gjerësisht, pa hamendjesim dhe me entuziazëm nga klasa intelektuale, ajo arsimore dhe, përgjithësisht, nga populli.

Të kujtojmë, po kështu, se në veprimtaritë gjuhësore standardizuese në Tiranë, ashtu edhe në Prishtinë, roli i faktorëve jashtëgjuhësorë ishte i madh dhe kjo është e kuptueshme, jo vetëm për rrethanat politike në të cilat gjendej populli shqiptar andej e këtej kufirit, po edhe për arsyen se faktorët jashtëgjuhësorë kudo e kurdo kanë peshën e vetë në përcaktimin dhe krijimin e politikave gjuhësore shtetërore e kombëtare. Ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë, në të shumtën e herës, ka karakter të përgjithshëm dhe ai vërehet si në gjuhën në përgjithësi, ashtu edhe në gjuhën standarde. Gjuha standarde ka funksion dukshëm më të përbërë: të paramenduar, të planifikuar dhe kur të paraqitet kërkesa edhe funksion të kontrolluar. Gjuha standarde krijohet në bashkësitë e organizuara shoqërore për të siguruar komunikim të papenguar në gjithë territorin shtetëror, ose për gjithë kombin, siç ka ndodhur edhe me shqipen, por edhe nga nevoja që një kulturë, një komb, një shoqëri në përgjithësi, të përfshihet në komunikimin bashkëkohor ndërkombëtar përmes gjuhës, prandaj zhvillimi i saj, sipas rregullit, është paraprakisht i paramenduar

nga ana funksionale dhe politike dhe i drejtuar në pajtim me to. Edhe në kohën e mbajtjes së Konsultës, por edhe të mbledhjeve të tjera gjuhësore në Tiranë e Prishtinë, përgjatë afro gjysmë shekulli, ndikimi i faktorëve politikë e shoqërorë ka qenë i madh dhe i përligjur. Kështu na e thotë edhe Eqrem Çabej më 1973, fill pas Kongresit të Drejtshkrimit: "Po të shtrohet pyetja nëse në formimin e një gjuhe të përbashkët sidomos në shkrim, ka marrë pjesë në një masë më të madhe veprimtaria gjuhësore-letrare apo komponentja e fuqive jashtëgjuhësore, për Shqipëri përgjigjja është kjo, që – si në shumicën e vendeve të Evropës – shtysa kryesore erdhi nga ana e këtyre fuqive".[16] Në Prishtinë roli i klasës politike në proceset standardizuese gjatë viteve '50 dhe '60 në krye me Fadil Hoxhën ishte jo vetëm mbështetës, po edhe përcaktues.

Politikanët shqiptarë të Kosovës nuk ishin ideatorët e mbajtjes së Konsultës, por ishin mbështetje e fuqishme e saj. Kishte ndër ta që morën pjesë e diskutuan në Konsultë (Ismail Bajra, Mehmet Hoxha). Ndërkaq, siç njofton *Rilindja*,[17] Fadil Hoxha, duke qenë asokohe kryetar i Kuvendit të Kosovës, më 24 prill, një ditë pas përfundimit të Konsultës, do të presë një delegacion – përfaqësues të Konsultës Gjuhësore.[18] Në pritjen Fadil Hoxha, duke miratuar pa rezervë përfundimet e Konsultës, e quajti këtë të fundit kontribut të madh për zhvillimin e kulturës.

Kjo mund të quhet ana historike e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës.

Konsulta gjuhësore dhe refleksionet për gjuhën standarde

Po cilat janë refleksionet që do të sjellë Konsulta Gjuhësore e Prishtinës për gjuhën standarde dhe për shqiptarët?

Duke pranuar bashkimin gjuhësor me të gjithë shqiptarët kudo janë, duke pranuar si normë *Projektin e Rregullave të Drejtshkrimit* të Tiranës të vitit 1967, duke hequr dorë nga rregullat e drejtshkrimit të vitit 1964 të gegërishtes standarde, shqiptarët e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi i dhanë fund rrugës veçuese gjuhësore nëpër të cilën kishin ecur në historinë e tyre të gjatë gjuhësore, në të vërtetë Konsulta Gjuhësore e Prishtinës bëri kthesën vendimtare në rrugën ndarëse nëpër të cilën po ecnin shqiptarët dhe hapi rrugën jo vetëm të njësimit gjuhësor, po edhe të njësimit shpirtëror e kulturor, në të vërtetë ndërroi kahun e historisë, krijues të së cilës, për fat të keq, gjatë, shumë gjatë, nuk ishin vetë. Klasa intelektuale shqiptare, populli, po edhe klasa politike shqiptare, që i dha shtysë e dorë këtij procesi, ishin të vetëdijshëm

se një veprim i tillë nuk ishte aspak i lehtë dhe ishte një veprim jo pak sakrifikues, duke pasur parasysh shumë rrethana e momente të zhvillimit të tyre politik, shoqëror e ekonomik, po sidomos arsimor e kulturor, në të vërtetë ata ishin të vetëdijshëm se rruga e përvetësimit dhe zbatimit të atyre rregullave nuk do të ishte punë e lehtë, sepse në Kosovë ende po luftohej analfabetizmi, shkalla e të cilit ishte shumë e lartë. Megjithatë, dëshira e entuziazmi, po, sidomos, vetëdija e lartë për rëndësinë e këtij veprimi, bënë që, me gjithë vështirësitë, përvetësimi dhe zbatimi në formën e shkruar të shënonte suksese. Zbatimi i rregullave të projektit të drejtshkrimit filloi të realizohej menjëherë në rrafshet formale, në gazetat, në emisionet e radios, në shkolla, sidomos në mësimin e gjuhës amtare, po pak e shumë edhe në mësimin e lëndëve të tjera, më pas në botimet shkollore, letrare e të tjera, në institucionet shtetërore aty ku kishte hapësirë për shqipen. Mund të thuhet se tashmë shqipja letrare kishte fituar autoritetin e pakontestueshëm. Rezultatet në përdorimin praktik të saj ishin më se modeste për arsyet e ditura, para se gjithash, për arsye të kontekstit zhvillimor sidomos në fushën e arsimit në përgjithësi Megjithatë pranimi i gjerë dhe gatishmëria që të mësohej e të përdorej hapën mundësitë që rrjedha e këtij procesi të kishte të ardhme të mirë. Dhe, kjo ndodhi. Me gjithë vështirësitë objektive të fillimit, vitet ‘70 ishin vendimtaret që gjuha standarde në këto hapësira të shënonte suksese edhe përtej parashikimeve. Rruga e filluar mirë, fatkeqësisht do të ketë vështirësi pas ngjarjeve të vitit ’81 për t’u intensifikuar sidomos gjatë viteve 90 për arsyet e njohura. Kriza politike, shoqërore, ekonomike, solli krizën e madhe arsimore dhe rrjedhimisht edhe gjuhësore, në të vërtetë solli vështirësi në rrugën e zhvillimeve të filluara mirë standardizuese. Pësoi rënie shkolla shqipe, dhe kjo pati reflektim sidomos në mësimin e gjuhës. Rënia e disiplinës gjuhësore do të sjellë pasoja jo të vogla për kulturën gjuhësore. Megjithatë, asnjëherë nuk u lëkund mendimi e qëndrimi për drejtësinë e vendimit të vitit 1968.

Në vitet e fundit janë shtuar diskutimet që kanë për objekt zhvillimin e shqipes standarde, shkallën e zotërimit dhe të zbatimit të saj, çështje të sociolinguistikës e të tjera. Me të drejtë. Por, mjaft diskutime e analiza për zotërimin jo të mjaftueshëm të normës gjuhësore në Kosovë shpesh janë shoqëruar e shoqërohen me qëndrime jo objektive. Heshtën ose keqinterpretohen arsyet pse shkalla e zotërimit të gjuhës standarde në Kosovë është tjetër nga ajo që është arritur në Shqipëri. Këto arsye janë të përligjura dhe ato u janë të njohura jo vetëm gjuhëtarëve. Në to kanë ndikuar e ndikojnë faktorë të shumtë e të ndryshëm. Problemet që shfaqen

atje e këtu janë po kështu të ndryshme. Sipas Zhozef Vendries "Gjuhët e përbashkëta gjithkund përcaktohen nga kushte të veçanta. Kur gjuhën e përbashkët e përcakton në thelb dialekti i cili falë rrethanave ka mbizotëruar dialektet e tjera, kjo e fundit më shpejt ose më ngadalë përthith gjuhën e përbashkët."[19] Shikuar nga ky aspekt duhet të theksojmë se në Kosovë është arritur shkallë e dëshirueshme e zotërimit të gjuhës standarde kur të kihen parasysh vështirësitë – rrjedhojë e faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që kanë shoqëruar rrugën standardizuese të shqipes sidomos në këto afërsisht dy dekada. Se do të ketë vështirësi në mësimin e përvetësimin është paralajmëruar edhe në Kongresin e Drejtshkrimit. Profesor Emil Lafe në një shkrim të tij për këto probleme thekson se edhe kur u formua gjuha letrare është theksuar se e sotmja nuk do t'i takojë plotësisht gjuhës standarde. [20] Ky mendim i shprehur asokohe, ishte i drejtë, sepse gjuha standarde po krijohej për hapësirën shqiptare të copëtuar e me kontekste të ndryshme politike, shoqërore, ekonomike e kulturore, ndërsa dihet mirëfilli cili është roli i këtij konteksti në zhvillimin e gjuhës dhe në proceset standardizuese.

Siç është e njohur, shqiptarët e Kosovës do ta mësojnë gjuhën standarde fillimisht dhe më pas vetëm përmes formave të shkruara, vetëm përmes librave e shtypit dhe kjo pashmangshëm do të zgjasë kohën e përvetësimit. Në Kosovë përvetësimi i gjuhës standarde shpreh shpërpjesëtim midis formës së shkruar dhe asaj të folur. Është fare e kuptueshme. Por, në debatet për gjuhën standarde, sidomos në mjetet e informimit, ky fakt merret si pretekst për ta sulmuar standardin, në të vërtetë për ta shpallur të papërshtatshëm e të pazotërueshëm për pjesën më të madhe të folësve të shqipes, sidomos për ata që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe si i tillë i paradestinuar për dështim. Me qëllim lihen anash ose u bihet anash fakteve shkencore dhe dijeve gjuhësore se shpërpjesëtimi midis gjuhës së shkrimit dhe gjuhës së folur është dukuri normale në çdo bashkësi gjuhësore që ka krijuar standardin e vet gjuhësor. Edhe sipas praktikës së përgjithshme dhe teorisë gjuhësore, gjuha standarde gjithmonë e gjithkund së pari standardizohet në formën e shkruar. Gjuha e shkruar e jo ajo e folur, paraqet traditën dhe rregullat që ruajnë gjendjen ekzistuese. Gjithkund gjuha e shkruar dallon nga gjuha e folur dhe gjithkund prirja që ky dallim të rritet është e pranishme. Linguisti Zhozef Vendries në librin e tij *Ligjërimi* sjell shembullin e frëngjishtes: "Dallimi midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur është çdo herë e më i madh. Nuk e kanë të njëjtë as sintaksën e as fjalorin. Madje edhe morfologjia dallon. Dallimi shihet sidomos në fjalorin." [21]

Mësimi i gjuhës standarde duhet të shoqërohet me veprime konkrete e përmes një procesi të vazhdueshëm të shkollës, të mjeteve të informimit dhe të veprimtarisë botuese. Në Kosovë, këto veprime dhe këto proces janë shoqëruar me vështirësi e mungesa. Në këtë kontekst mund t'i bëhen vërejtje planifikimit gjuhësor në nivel institucional, në të vërtetë duhet të thuhet haptas se ka munguar dhe mungon edhe sot politika reale gjuhësore në këtë drejtim. Nuk çohen këto procese përpara vetëm me vullnetin dhe gatishmërinë individuale, as vetëm me ndjenjën patriotike. Në jo pak diskutime, në jo pak shkrime, në jo pak veprimtari të institucioneve shkencore a shoqatave vullnetmirë janë shtruar probleme të ndryshme që lidhen me pakënaqësinë me gjendjen në kulturën gjuhësore në përgjithësi, po sidomos me kulturën gjuhësore të brezit të ri. Jodisiplina gjuhësore, kujdesi i pamjaftueshëm, puna jo e duhur e shkollës, ndikimi i keq i mjeteve të informimit, neglizhenca e institucioneve përkatëse – janë vetëm disa nga shqetësimet që në vazhdimësi janë shtruar nëpër sesionet e tubimet e tjera shkencore, po edhe në gazetat e revistat për këto probleme. Në të vërtetë, shqipja standarde në Kosovë është vënë edhe para sprovash të tjera, rrjedhojë e kontekstit të ri socio-gjuhësor, që lidhet me rrethanat e ndryshuara të jetës shoqërore, me hapjen ndaj botës, me shtimin e kontakteve, me dinamizimin e jetës, me përhapjen e formave të ndryshme të komunikimit bashkëkohor, me problemet që sjell globalizimi etj. Me gjithë pakënaqësinë e shprehur për gjendjen dhe pranimin se sot shqipes standarde i mungon kujdesi, duhet ta pranojmë se përgjatë këtyre 40 vjetëve dhe sidomos në dy dekadat e fundit ajo ka njohur një zhvillim e pasurim të madh në të gjitha drejtimet e në të gjitha përdorimet. Asnjëherë ajo nuk është studiuar e lëvruar sa sot, asnjëherë ajo nuk ka njohur më shumë përdorime, forma e stile funksionale, asnjëherë ajo sa sot nuk ka njohur më shumë botime e përkthime, asnjëherë ajo sa sot nuk ka njohur më shumë kontakte e komunikime ndërshqiptare, asnjëherë ajo nuk ka pasur kërkesa komunikuese sa sot. Ndërkaq në rrjedhat e globalizimit ajo ka sot fatin edhe të shumë gjuhëve të tjera.

A duhet të ndryshohen rregullat e drejtshkrimit të shqipes?

Sot janë vënë në diskutime formale e jo formale edhe rregullat e drejtshkrimit. Ndër vërejtjet që përsëriten shpesh janë: nuk janë zgjedhur format e duhura, nuk janë zgjedhur format që shprehin prirjet gjuhësore, rregullat kanë shumë përjashtime, rregullat janë vjetruar e të tjera.

A janë vjetruar, vërtet, ato?

Në veprimtaritë standardizuese të shqipes, në hartimin e teksteve normëzuese kanë marrë pjesë, siç dihet, studiuesit tonë të njohur, njohësit e mirë të shqipes. Hartues të projektortografisë së vitit 1967 dhe të rregullave të drejtshkrimit kanë qenë Eqrem Çabej, Mahir Domi, Androkli Kostallari dhe Emil Lafe - personalitete këto me kompetenca jo vetëm në fushën e studimeve thjeshtë gjuhësore, po edhe në fushën e planifikimit gjuhësor. Këta emra do t'i gjejmë si autorë të gramatikave, hartues të fjalorit të shqipes dhe të fjalorëve të tjerë terminologjikë. Autorët e përmendur, studiuesit e njohur të gjuhës shqipe e të shqipes standarde kanë shfrytëzuar erudicionin e tyre, kompetencën e tyre dhe parimet e tyre moralo-shkencore në punën rreth krijimit të gjuhës standarde. Prej asaj që na ofrohet në këtë histori të gjuhës letrare del se ata janë pajtuar që standardi i përzgjedhur përmbush kriteret themelore që shtrohen para një forme të tillë të gjuhës. Janë pajtuar se baza e përzgjedhur dialektore ka paraqitur shkallë të lartë normëzimi, se gjuha e krijuar standarde del e përpunuar në të gjitha nënsistemet, se ajo shpreh mundësi të gjera për pasurim nga shumë anë: nga shqipja e shkruar që prej fillimeve e përkëtej, nga të folmet e ndryshme të shqipes, rrjedhimisht edhe nga të folmet e gegërishtes në vijë të gjerë horizontale dhe nga gjuhët e huaja, natyrisht duke i përshtatur ato brenda sistemit fonologjik e gramatikor të standardit. Puna në tekstet standardizuese duke filluar nga rregullat e drejtshkrimit deri te fjalori i drejtshkrimit dhe tekstet e tjera pasuese, dëshmon se autorët e lartpërmendur janë përpjekur për rregulla sa më të sakta dhe me sa më pak përjashtime në të gjitha nënsistemet, janë përpjekur për një drejtshkrim të qëndrueshëm duke pasur për bazë kryesisht parimin fonetik, po edhe parimet e tjera, si morfologjik, semantik, etimologjik, me përpjekjen që të ketë sa më pak dublete dhe sa më pak përjashtime nga rregullat e përcaktuara. Hetohet qartë përpjekja për ta ruajtur frymën e shqipes edhe në rastet kur shfrytëzohen gjedhe nga gjuhët e tjera. Puna dhe përpjekja e tyre në këtë drejtim kërkon vlerësimin dhe nderimin e pasardhësve, kërkon vlerësimin dhe nderimin tonë për ta. Një punë e tillë sot është vështirë e realizueshme, për të mos thënë e parealizueshme, për arsyet që i dimë mirëfilli të gjithë. Plotësimi ose ndërhyrja në këto rregulla do të duhej të nisej vetëm nga kërkesa reale e dalë nga ana empirike e gjuhës dhe do të duhej të bëhej patjetër prej studiuesve a njohësve më të mirë të gjuhës.

A vjetrohen rregullat? Për diçka që ekziston një kohë të gjatë mund të thuhet se është e vjetër ose tradicionale dhe përgjigjja në këtë rast për

shqipen do të ishte negative. Nëse do të përgjigjeshim pozitivisht se 40 vjet janë shumë për një normë, atëherë çka mund të thuhet për drejtshkrimin e frëngjishtes dhe moshën e tij. Do të duhej ta quanim anakronik. I tillë edhe mund të jetë, edhe shkencërisht mund të jetë zgjedhja jo më e mirë, por një gjë dihet: e tillë është qe një kohë shumë të gjatë dhe studiuesit francezë e kanë shprehur sa herë se do të ishte katastrofë kulturore në rast se do të ndërrohej ai në parim. Akademia Franceze edhe do të mund të ndërhynte për të ndryshuar disa imtësi praktike, por drejtshkrimi është drejtshkrim dhe një ndërhyrje e tillë duhet të peshohet shumë, shumë. Edhe drejtshkrimi i cili nga ana shkencore nuk është më i argumentuari është më i miri kur respektohet, përdoret e njihet nga të gjithë, sesa ai më i arsyetuari shkencërisht kur nuk respektohet. Ndërhyrjet e papeshuara mirë në drejtshkrimin në shoqëritë civilizuese konsideroheshin shaka. Sa më i qëndrueshëm e sa më praktik të jetë një drejtshkrimi aq më i mirë është ai. Sigurisht se ky mbetet një ideal dhe synim ndër bashkësi të ndryshme gjuhësore. Edhe për ne. Prandaj ai nuk duhet të ndërrohet, po risimet duhet t'i shtohen dhe të përshtaten mbi bazën e atij ekzistues, sepse jeta, qytetërimi, zhvillimi i shoqërisë dhe i kulturës sjellin probleme të reja. Gjithsesi qytetërimi material e shpirtëror në kohën tonë është tjetër nga ai që ka qenë para 40 vjetëve, po edhe para më pak vjetëve kurse disa dukuri të reja duhet të përfshihen e të zgjidhen në drejtshkrimin tonë. Por këto ndërhyrje duhet të jenë shtesa, plotësime e jo ndryshime.

Shqipja standarde – projekt i hapur

Sot shtrohet shpesh edhe pyetja – a është shqipja standarde projekt i mbyllur?

Gjuha si fenomen asnjëherë nuk është "projekt" i mbyllur. Rrjedhimisht edhe gjuha standarde shqipe. Ajo në thelbin e saj është e hapur, sepse është proces i gjallë, sepse përket në botën e hapur, i përket një bote që zhvillohet pandërprerë. Edhe shoqëria, edhe individi, bartës të gjuhës, ndryshojnë e zhvillohen, janë të hapur. Natyra nuk lejon mbyllje. Gjithçka në natyrë zhvillohet në sistem. Edhe shoqëria, prandaj edhe gjuha. Edhe hapshmëria ka një sistem. Prandaj hapja duhet t'i nënshtrohet një sistemi - sistemit të gjuhës standarde.

Duhet ta kemi të qartë ç'kuptojmë me fjalën hapje, në të vërtetë ç'duam të kuptojmë. E kundërta e sistemit është dhuna është anarkia. Hapje nuk do të thotë anarki, nuk do të thotë dhunë.

Gjuha shqipe sot njeh zhvillim e pasurim të madh dhe nga shumë anë dhe kjo do të thotë hapje e saj. Hapja që do të kishte qëllim shmangien nga norma, hapja që do të parakuptonte destandardizimin e saj, që do të parakuptonte dialektizimin a liberalizimin e saj siç e dëgjojmë shpesh të thuhet, nuk do të thotë hapje e standardit, po përmbysje e tij.

Debatet shterpë

Nuk janë vetëm diskutimet për problemet e zotërimit të shqipes e për problemet e drejtshkrimit të shqipes sot aktuale.

Cilat janë debatet sot për gjuhën standarde?

Më poshtë po i përmbledh disa nga çështjet që shtrohen: a na duhet standardi ekzistues, a duhet ta ndryshojmë bazën e gjuhës standarde e brenda kësaj ta ndryshojmë edhe normën gjuhësore, a duhet ta rivështrojmë, korrigjojmë e ndryshojmë standardin duke i bërë vend gegërishtes, a na duhen dy gjuhë standarde, a u duhet shqiptarëve të Kosovës një gjuhë tjetër, e të tjera të ngjashme me këto?

Duke mos dashur me këtë rast të ndalem posaçërisht në këto çështje, meqë mendimin tim e kam shprehur publikisht shpesh kohëve të fundit, dua vetëm të theksoj se shqiptarët tashmë e kanë vlerësuar në mënyrë shumë qytetëruese aktin e krijimit dhe pranimit të një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët, siç u dëshmua edhe këtu e 40 vjet më parë në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, në të vërtetë shqiptarët e kanë kuptuar se gjuha standarde është vlerë e patjetërsueshme kombëtare. Sado e synuar dhe sado e dëshiruar prej grupacionesh të ndryshme e me interesa, po ashtu, të ndryshme, ndarja gjuhësore e shqiptarëve, do të mbetet përpjekje e dështuar, sepse shqiptarët nuk do të zgjedhin ndarjen: ata i kanë provuar ndarjet e dhunshme shumë herë në historinë e tyre dhe i dinë mirë pasojat e tyre. As shqiptarët e Kosovës nuk kanë nevojë për një ndarje të tillë: ata në gjithë historinë e tyre kanë kërkuar shkëputjen e pavarësimin nga Serbia e Jugosllavia e jo nga shqiptarët e hapësira shqiptare. E provon mirë këtë historia e saj me moshë dhe historia e saj e re. Më në fund, një gjë e tillë është krejt e pamundshme dhe me çmim shumë të madh. Do të ishte tepër i shtrenjtë një aventurizëm i tillë për një popull të vogël siç janë shqiptarët, do të ishte një përmbysje rrënuese për shkollën e arsimin shqiptar, për administratën shtetërore e publike dhe për mjetet e informimit publik.

Duke e përfunduar po theksoj se shqiptarët e dinë cila është rruga e tyre: shqipja standarde do të vazhdojë të mbetet gjuha e përbashkët e të

gjithë shqiptarëve, edhe e shqiptarëve të Kosovës, sepse duke pasur një gjuhë të përbashkët, duke pasur një etnitet të përbashkët e një histori të përbashkët gjuhësore, shqiptarët do të kenë edhe një ardhme të përbashkët, të përparuar e të qytetëruar. Ne sot ndodhemi në fazë të re të historisë së kombit, prandaj edhe të shqipes standarde: do ta kemi një gjuhë standarde, sepse jemi një popull, sepse kemi një territor homogjen historik, sepse kemi mitet e përbashkëta dhe ndjenjat e përbashkëta, sepse kemi historinë e kulturën e përbashkët.

Me vendimin që morëm pikërisht këtu e 40 vjet më parë në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, ne, shqiptarët e Kosovës dhe ata që jetonin në trojet e tyre në ish-Jugosllavinë, me vendimin që morëm në Kongresin e Drejtshkrimit të gjithë shqiptarët bashkërisht, bëmë hapin e madh historik: pushuam të jemi komb klasik dhe u bëmë komb modern. Dhe duhet të sillemi si komb modern.

Gjuha e njësuar kombëtare, domethënë gjuha standarde, është përbërësi kryesor i identitetit tonë gjuhësor e kulturor e kjo do të thotë i identitetit kombëtar.

[1] Shefkije Islamaj, *Idriz Ajeti dhe gjuha standarde shqipe,* "Gjuha shqipe" 2/ 2007, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2007.
[2] Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005, f.152).
[3] "Buletin për Shkencat Shoqërore" IV, Tiranë 1952, f. 64-132.
[4] Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë 2005, f. 215; Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë 2005, f. 187-190.
[5] *Një komb – një gjuhë letrare,* "Rilindja", 23.4.1968, Prishtinë, f. 1.
[6] Rrustem Berisha, *Një gjuhë letrare për të gjithë shqiptarët* "Zani i rinisë", nr. 19, maj 1968, Prishtinë f. 12,13.
[7] Idriz Ajeti, *Rruga e njësimit të gjuhës letrare shqipe dhe ortografisë së re*, *"Rilindja"* 18, 21 dhe 22 prill 1968, Prishtinë**.**
[8] *Shqipe letrare e ortografi unike,* "Rilindja" 24.4.1968, Prishtinë, f.1, 5.
[9] Po aty, f. 5.
[10] *Konkluzat e Konsultës Gjuhësore,* "Rilindja" 25.4.1968, Prishtinë, f. 11.
[11] Rexhep Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë 2005, f. 118.
[12] *Konkluzat* ..., po aty, f.11.
[13] *Konkluzat* ..., po aty, f.11.
[14] *Gjuhë e përbashkët letrare* - fragment i diskutimit të Ismail Bajrës në Konsultëne Prishtinës, "Zani i rinisë" nr.17-18.4.1968, Prishtinë, f. 3.
[15] Eqrem Çabej, *Mbi disa çështje të traditës dhe të drejtshkrimit të shqipes*, "Studime filologjike" nr. 1, Tiranë 1973.
[16] Rrustem Berisha, *Një gjuhë letrare për të gjithë shqiptarët*, "Zani i rinisë", nr. 19, maj 1968, Prishtinë, f. 12,13:
[17] *Njësimi i gjuhës letrare dhe ortografisë – kontribut për zhvillimin e kulturës*. Nga biseda e Fadil Hoxhës me delegacionin e Konsultës Gjuhësore, "Rilindja", 25.4.1968, Prishtinë, f. 1 e 2.
[18] Komisioni kishte këtë përbërje: Fehmi Agani, drejtor i Institutit Albanologjik, prof. dr. Idriz Ajeti, shef i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik, dr. Vojislav Dançetoviqi, shef i Katedrës së Albanologjisë në Universitetin e Beogradit, Besim Bokshi, shef i Katedrës së Shkollës së Naltë Pedagogjike në Gjakovë, dr. Hasan Kaleshi, bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik në Prishtinë, Hilmi Agani, mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, Sylejman Drini, redaktor në Edicionin e "Rilindjes" në Prishtinë. Në mbledhje mori pjesë edhe Sali Nushi, kryetar i Dhomës Arsimore-Kulturore të Kuvendit të Kosovës.
[19] •ozef Vandrijes, *Govor,* Novi Sad 1996, f. 250.
[20] Emil Lafe, *Një vështrim mbi shqipen standarde*, në "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", 20/1, Prishtinë 2002, f. 249.
[21] •ozef Vandrijes, po aty, f, 263.

LEKSIKOGRAFI

Idriz ULAJ

FJALË TË RRALLA NGA KRAHINA E PLAVËS DHE E GUCISË

(Shënuar në fshatrat: Vuthaj, Dol, Martinaj, Kukaj, Hakaj, Hoti i Kujit, Nokshiq, Pepaj dhe Arzhanicë)

A

Â' **f.** është. (Vuthaj…)

AJÄM **ndajf.** (*turq.*) lezet, kënaqësi. (Vuthaj)

AMELE **em. sh.-** punë të pamira; fjalë (sjellje) të këqija. (Vuthaj)

AMLOJA (i, e) **mb**. ëmbël. (Vuthaj)

ARLLË **f**. ardhur. (Dol)

ASHIKOJ **f.** (*turq.*) josh, tërheq. (Vuthaj…)

B

BABUSHAN/E **mb.** njeri indiferent, i qetë, i durueshëm. (Vuthaj)

BAJRAK-U **em. sh.-ë** (*turq.*) loja e bajrakut; lojë djemsh (ngulet një thupër në mes të livadhit, njëri e ruan e të tjerët mundohen për t'ia marrë). (Vuthaj…)

BAJRAK/E-JA **ef. sh.-**i (*turq.*) lopës që u prin lopëve tjera (Vuthaj, Hakaj, Kukaj...)

BALUK/Ë-A **ef. sh.-a** lopë me balushë në ballë. (Vuthaj)

BALÇIN/Ë-A ef. **kënetë. (Vuthaj)**

BALOSH-I **em. sh.-ë** emër qeni, por edhe fjalë e shëmtuar, ofenduese, për njeriun që nuk merr vesh. *More balosh, ty po të flas...* (Vuthaj)

BEJLEN-I **em. sh.-a** pjesë e sarajeve - e kullave. (Vuthaj)

BETERAN-I, **em. sh.-a** (*turq.*) djalë i keq, i parregulluar... (Vuthaj)

BETERUJ/Ë-A, **ef. sh.-a** (*turq.*) vajzë e lënë, e parregulluar, e keqe. (Vuthaj)

BLUD/Ë-A **ef. sh.-a** (*skr.*)çanak i drunjtë. (Vuthaj…)

BOK/Ë-A **ef. sh.-a** kodër, gurishtë. (Vuthaj)
BORÇ/E-JA **ef. sh.-e** përparëse e kuqe prej stofit të pambukut. (Martinaj)
BOR/Ë-A **ef. sh.a** emër femre, gruaje… (Vuthaj)
BORONIC/Ë-A **ef.sh.-a** emër njeriu, i gjinisë femërore. (Vuthaj, Martinaj...)
BREC/Ë-A **ef. sh.-a** thikë e vogël për gërryerje të bukës. (Vuthaj)
BRECAK-U **ef. sh.-ë** brisk i vogël, për gërryerje të bukës…, njeri brecak, njeri i dobët. (Vuthaj)
BREISHT/Ë-A **ef. sh.-a** pyll me bredha,
BREJ-I **em. sh.-a.** dru breji; grimcoj me dhëmbë: *Krimbi bren drurin; mini bren thesin; më bren zemra.* (Vuthaj…)
BRI **ndajf.** brijas, anësh, tërthorazi; briri i shtazëve përtypëse. (Martinaj, Hakaj, Vishnjevë…)
BRIOÇ/E **mb.** me brirë, i brirtë; njeri i fortë, trim. (Vuthaj)
BROVE **ef. sh.** delet që merreshin për qumësht (djathë) nga Malësia e Madhe. (Vuthaj…)
BUBRREC-I **em. sh.-a** mizë përdhese, thnegël, milingonë. (Vuthaj…)
BUCAK-U **em. sh. ë** bucelë e vogël. (Vuthaj)
BUDALL/ËK **ndajf. sh.-qe** (*arb.*) punë, veprime jo të mira
BUJASHK/Ë-A **ef. sh.-a** copëz e hollë druri e shkalur nga trupi i lisit. (Vuthaj…)
BULÇIN/Ë-A **ef. sh.-a** fytyrëbutë; i zihet fryma
BURK-U **em. sh.** burgje, burg. (Vuthaj…)
BUSHËL **ef. sh. -a** grimcë e vogël. (Nokshiq, Martinaj)
BUT/E-JA **ef. sh.-** emër gruaje. (Vuthaj...)
BYLE-JA **ef. sh.-e** emër dhie. (Vuthaj)
BYTHPRAPA **ndajf.** të tërhequrit prapa, pa e kthyer kurrizin; kthimi prapa. (Vuthaj)

C

CAKU/LL-I **em. sh.-j**, strajcë (çantë) për libra shkollore, apo për drekën e barinjve, e bërë prej perit të leshit të deles. (Vuthaj, Hakaj, Hot, Martinaj, Pepaj, Arzhanicë, Nokshiq)
CIGËL **ndajf.** rri lart, pa prekur në tok; hava. (Vuthaj)
CUCË-A **ef. sh.-a** emër njeriu. (Vuthaj…)
CUKAS **f.** trokas. (Hakaj)
CUK/E-JA emër njeriu në Vuthaj...
CUKLAN/E **mb.** njeri cuklan; qengj cuklan, plot cukla. (Vuthaj)
CUMËR-A **ef. sh.-a** një copë trung ku mund të ulemi, ku shkurtohen drunjtë, - cumra e druve. (Vuthaj)
CUXË (CUNXË) **ndajf.** qëndrimi si ulur, ose në thembra të këmbëve, por jo ulur në ndonjë objekt. (Vuthaj)
CUPITÊM **f.** *Më shkon mendja të bëj diçka, hamendem.* (Vuthaj, Arzhanicë)

Ç

ÇAK-U **em. sh.-a** emër i njeriut; Çak Fazlia etj. (Vuthaj)

ÇAKLAFENC/E **mb.** plogështan; i plogët. (Vuthaj)

ÇAKLAN/E **mb**. është plogështuar. (Vuthaj)

ÇALOK-U **em. sh.-ë**, emër njeriu; Çalok Muli i Vuthajve.

ÇALLAMIS, **f.** *E çallamis tue rrahë*; shkatërroj dikë duke i rënë. (Vuthaj)

ÇALLASHNIK/E, **mb.** i depërtueshëm, i gjindshëm, i rreptë, i shpejtë, i shkathtë (Vuthaj)

ÇARAVESHAN/E **mb.** njeri që çaraveshet, që lavdërohet , kërcënohet, duke bërë gjeste dhe grimasa të pahijshme. (Vuthaj, Martinaj,...)

ÇETINAK-U **em. sh.- ë** pishë e zezë në grykë të ujëvarës së lumit Skafkaç në Vuthaj.

ÇIBRIC/Ë-A **ef. sh.-a** kasë e madhe e drurit, ku qiten kumbullat për t'u tharbur për raki. (Vuthaj)

ÇKAP **f.** shkoqis; shkoqis thoin prej mishit të gishtit. (Vuthaj...)

ÇORODITAN/E, **mb.** njeri i çorientuar; njeriu që i ka humbur vetitë e bukura, të mira, njeri i degjeneruar. (Vuthaj…)

ÇPEJT **ndajf.** shpejt. (Nokshiq…)

ÇPRISHALESH/E **mb.** ai që shprish leshin me duar, me gërhanë apo me krehër. (Vuthaj)

ÇUE **f.** heq; *Mos me ta çue mâllin; mos me ta heq mallin*; çoj. (Vuthaj…)

ÇUG-U **em. sh.-a** emër njeriu; Çug Tahiri i Vuthajve.

ÇU/G-U **em. sh.- gje** cung (Vuthaj)

ÇULL/Ë-A **ef. sh.-a** loja e humbur; batanije e bërë prej leshit të dhisë. (Vuthaj…)

ÇUPAN-I **em.sh.-ë** (*srb*.) ushtar malazias; veshpreri. (Vuthaj)

D

DAD/Ë-A **ef. sh.-a** (*pers*.)1. gruaja që hyn në një familje të huaj për t'i ruajtur fëmijët; 2. emër përkëdhelës që e përdorin fëmijët për motrën e babës. (Vuthaj…)

DAJ **f.** ndaj. (Vuthaj, Hoti i Kujit, Hakaj)

DAJMA **ndajf.** gjithnjë. (Martinaj, Pepaj)

DALLKAXHI-U, **em. sh.-nj** zhurmaxhi; dallgaxhi. (Vuthaj, Kukaj, Hakaj...)

DAN **f.** dallon, dalluar. (Martinaj, Arzhanicë)

DAR **ndajf.** nën. (Martinaj)

DAV/Ë-A **ef. sh.-ë** (*arb*.) padi. (Pepaj)

DAZUM-MA **ef.-a** dasmë. (Vuthaj)

DEB/E-JA **ef. sh.-e** enë druri, e ngushtë dhe e gjatë 30-35 cm., me kapak, e punuar apostafat për kos e kumësht, hirrë; bucelë e gjatë deri në 35 cm, e gjerë deri në 15 cm. (Vuthaj)

DEGOÇ/E **mb.** dru i degëzuar; njeri i madh, i gjerë. (Vuthaj…)

DEKIK/Ë-A **ef. sh.-a** (*arb*.) minutë. (Vuthaj…)

DERDHAÇ/E **mb.** ai që e derdh ujin…(Vuthaj)
DERZEJ **f.** largoj; largon dikë nga vendi; ndjek; ndërzim i deleve. (Nokshiq)
DES **f.** vdes. (Vuthaj…)
DIKTIM-I **em. sh.-e** gjyq i dikurshëm i shkallës së lartë; diktim. (Vuthaj)
DIMOJ **f.** ndihmoj (Martinaj, Nokshiq)
DLIRTË (i, e) **mb.** i pastër. (Vuthaj…)
DO **përem.** disa. (Vuthaj…)
DOGRI **ndajf.** menjëherë. (Vuthaj, Martinaj…)
DOKRRIN/Ë-A **ef. sh.-a** shpat me zallë e gurë deri në përrua; vend pa bar
DOLLAT (S) **f.** *E ka rrahur shumë. E ka dollatë me dru*. (Vuthaj)
DORI-U **em. sh.-** kalë me qime ngjyrë kafeje. (Vuthaj,Martinaj, Hakaj, Kukaj, Hoti i Kujit)
DOVLET-I **em. sh.-e** (*turq.*) shtet në kohën e sundimit osman. (Vuthaj)
DREDHAÇ/E mb. dredhak. (Vuthaj)
DUD-I **em. sh.-a** (*turq.*) man i zi. (Vishnjevë…)
DUE/K-U **em. sh.- q, duaj** disa fije misri, gruri, thekre të bëra tubë dhe të lidhura në bashkë. 70 -80 sish formojnë një mullar me tallë.
DUEQ **e. sh. -** dy strajca të kapura njëra me tjetrën, për t'i vënë në krah, njërën para e tjetrën mbrapa shpine. (Vuthaj…)
DUQ-I **em. sh. - a** emër i njeriut; Duq Alia i Vuthajve. (Vuthaj)
DURUKAS **f.** s'lë rehat, po herë kështu e herë ashtu; gjen vërejtje.
DYJE **ef. sh. -** bota, lëmshi tokësor. (Vuthaj…)
DYZENQAR-I **mb.** (*turq.*) qejfli, mahitar, këngëtar. (Vuthaj…)

DH

DHAMÇ/E-JA,**ef**. grua me dhëmbë të mëdhenj. (Vuthaj)
DHINTË (i, e) **mb.** thes, strajcë apo diçka tjetër, e bërë prej leshit të dhisë. (Vuthaj, Kukaj…)

E

ELGAT/Ë-A **ef. sh.-a** lëngatë; sëmundje e rëndë dhe e gjatë. (Vuthaj…)
ELLE **lidh.** edhe, dhe (disa shqiptarë të fesë katolike të fshatit Dol konsonantin *dh* e shqiptojnë *ll*).
ERASHK/Ë-A **f. sh-a** bar për frymëmarrje.
ERGJ/Ë-A **ef. sh.-** ndryshku. (Vuthaj…)
ERLLI **f.** erdhi. (Dol)

Ë

ÊJ **pasth.** gjëmë, vaji, vajtimi. (Vuthaj…)

F

FACULETASH/E **mb.** burrë që pispilloset shumë, që humb shumë kohë mbas femrave; krenar i pamasë; serdar. (Vuthaj)
FERK-U **em. sh.-a** agu i dritës.

(Vuthaj…)
FETFAN-I **em. sh.-e** (*arb.*) vendim; s'mund ndahet pleqëria. (Vuthaj)
FIKALL VETUM **ndajf**. i vetmuar. (Vuthaj…)
FILLIKAT VETËM **ndajf.** i vetmuar, pa askënd. (Vuthaj)
FJALËTOPUZ/E **mb.** fjalërëndë. (Vuthaj, Pepaj…)
FLLAX/Ë-A **ef. sh.-a** thëllëzë. (Vuthaj)
FLLIQ/AN/UJË **mb.** njeri i fëlliqur, i papastër, i pamoralshëm. (Vuthaj, Martinaj, Dol…)
FONEL/Ë-A **ef. sh.-a** (*it.*) fanellë e bërë prej leshit, me mëngë të gjata. (Vuthaj)
FURA/N/JKË **mb.** njeriu që i kryen punët pa përtesë dhe shpejt e mirë. (Vuthaj, Martinaj, Hakaj…)
FURAS **f.** ha me oreks. (Vuthaj)
FURCAT-I **em. sh. e** fuqi, më i fuqishëm. *Mâ a ka furcatin; mâ a ka takatin; Âsht mâ i fortë se û'*. (Vuthaj)
FYTARRXOHEM **f.** *Rrëzohemi të kapur fyt për fyt*. (Vuthaj)

G

GAL/Ë-A **ef. sh.-a** emër gruaje, por edhe emër i deles së murrmë (zezë)
GALMUÇ **ndajf.** *Rri si ni planc grumbull; e ka gjue galmuç, si ni grumbull plehu.* (Martinaj, Hoti i Kujit)
GARROJ **f.** grumbulloj (Vuthaj…)
GASHEJ **f.** tërheq, nxis dikë për të bërë diçka, p.sh. për të ngrënë një ushqim. (Vuthaj…)
GATUA **f.** për t'u gatuar; është përgatitur për të bërë diçka; 2. gatuar bukën. (Vuthaj…)
GËRDHAT/Ë-A **ef.sh.-a** vend shkëmbor, i zhveshur dhe pa ujë. (Vuthaj, Martinaj)
GËRL/Ë-A **ef. sh.-a** humnerë, nëpër të cilën kalon lumi Skafkaç, e thellë 50 – 70 *m*, e gjerë 2 – 20 *m*, e gjatë përafërsisht 350 *m*, me tri ujëvare. (Vuthaj)
GËRVELL **f.** bërtas me zë, çirrem pa masë.
GËRXH/AN/UJË **mb.** njeri (qengj, viç etj.) që ka mbetur gjymtë, me trup të pazhvilluar; i ligshtë. (Vuthaj)
GËRZHAS **f.** ngacmoj (Vuthaj, Martinaj, Hakaj, Hoti i Kujit...)
GET/E-JA **ef. sh.-e** (*it.*) pjesa e çorapit (pa shputë) prej në nyje të këmbës e deri te gjuri. (Vuthaj, Martinaj...)
GEXHAN/E **mb.** njeri (qengj apo viç) që ka mbetur me trup të pazhvilluar, të gjymtë; njeri gexhan, qengj gexhan, viç gexhan. (Vuthaj)
GEXH/Ë-A **ef. sh.- a** lojë fëmijësh: në një rrasë guri vihet një guralec i rrumbullakët, të cilin një lojtar e ruan e tre-katër të tjerët e gjuajnë me rrasa guri për ta hequr nga sipërfaqja e rrafshët e gurit mbi të cilin rri guraleci. Kur e rrëzon ndonjë lojtar, rojtari i guralecit e merr guralecin me shpejtësi dhe e kthen në vend dhe me shpejtësi

mundohet të prekë me dorë ndonjërin nga lojtarët, të cilët mundohen t'i vjedhin rrasat (secili rrasën e vet) dhe për t'u kthyer në cakun, prej ku, me rrasat e veta, e përsërisin gjuajtjen e guralecit. E, kur rojtari i guralecit e prek ndonjërin prej lojtarëve, vetë del prej rojës dhe në vend të tij hyn i prekuri. Loja vazhdon derisa lodhen lojtarët.

GINGAL/Ë-A,**ef. sh.-a** dy drurë të drejtë, të trashë sa dora, të gjatë dy metra, me nga një degë të gjatë 25 - 40 cm mbi majën e poshtme, ku hipet me këmbë, duke u mbajtur lart me duar, dhe ecet nëpër vende të rrafshëta apo ujë. Me këto gingala bëhen edhe gara se kush po ecë më shpejt me to. (Vuthaj)

GOBIS **f.** vdes, varroj. (Vuthaj…)

GOJFIL-I **em. sh.-a** lloj bari që rritet nëpër shkrepa të rrëpirë, i cili, kur piqet, merr formën e leshit. (Vuthaj)

GOJFIL/E-JA **ef. sh.-e** emër femre. (Vuthaj)

GOGISHT/E **mb.** modeli i opingave nga lëkura e lopës, që thuren me dredhë lëkure. (Vuthaj)

GOJFIL/E-JA **ef. sh.-** emër gruaje, sipas emrit të barit gojfil. (Vuthaj)

GOPRRIN/Ë-A **ef. sh. - a** gropë në shpat; vend i rrënuar. (Martinaj)

GORDH **f.** ngreh; organi seksual i mashkullit para ejakulimit, i ngrehur, i zgjuar për seks

GORROMA/NE **mb.** i padijshëm, i pashkollë, i papunë. (Vuthaj)

GRATI (i,e) **mb.** i shkretë, i mjerë.

GRETH-I **em. sh. - a** emër i njeriut; Greth Alia i Vuthajve. (Vuthaj)

GRUA E PATHUA, grua e plogësht, jo e zonja e punëve…

GUNGJATEM **f**. *shtyhem me fjalë me dikë; thumbohem me fjalë me dikë.* (Martinaj)

GURCUP-I **em. sh.-ë** guri i rrumbullakët, i madhësisë së kajsisë, që me pesë sish çobaneshat e luajnë lojën e gurcupëve. (Vuthaj...)

GUXH/Ë-A **ef. sh.-a** loja e guxhës - lojë barinjsh.

GUXHAN/E **mb.** qengj i me trup të pazhvilluar. *Âsht metë guxhan.*

GJ

GJÂ-JA **e. sh.- gjatë** kafsha. (Vuthaj)

GJELAZ **ndajf.** kur zihet dy vetë, ose kur ndahen barazi; gjelas. (Vuthaj)

GJIBROJ **f.** vajtoj, lëshoj brimë më zë. (Vuthaj)

GJIDITËN **ndaj.** Tërë ditën. (Vuthaj)

GJIN-JA **ef. sh.-të** njerëzit, shumë njerëz,. (Vuthaj)

GJINI-A **ef. sh. itë** prindërit e nuses. (Vuthaj)

GJOLL/Ë-A **ef. sh.-a** djerrinë me bar në mal; rrasë ku vihet kripa për të ngrënë bagëtia. (Vuthaj)

GJYGYM-I **em. sh.-a** balon i metaltë për ujë, enë për ujë. (Vuthaj)

GJYLPÂN/Ë-A **ef. sh.-a** gjilpërë.

GJYNAH-I **em. sh.-e** mëkat. (Vuthaj)
GJYNATOJ **f.** shkretoj; mëkatoj. (Vuthaj)

H

HAFI-A **ef. sh.-** e shkretë; hile. (Vuthaj)
HALAMRUKAZI **ndajf**. mënyrë e vrazhdë (e ngutshme) e rrëmbimit të njeriut; pa pritur të vishet a të mbathet.
HALER-I **em. sh.-a** djerrinë; begllëk. (Vuthaj)
HALLAKAS **f.** shpërndaj një grumbull sendesh, gjerash njerëzish, pulash etj.; piskas të madhe, me zë të lartë. (Vuthaj)
HARDALL-I **em. sh.-a** njeri me trup të madh, por i trashë nga mendja; i papunë. (Vuthaj)
HARTIN-I **em. sh.-a** pishë e butë; hartinë. (Vuthaj)
HARUSH/Ë-A **ef. sh.-a** nëna e ariut. (Vuthaj…)
HASH/Ë-A **ef. sh.-a** emër njeriu i gjinisë femërore. (Vuthaj, Martinaj, Pepaj, Hakaj...)
HAVËR-**a ef. sh.-a** fustan. (Vuthaj…)
HAZRET/E **mb.** fëmijë i vetëm në familje; djalë (vajzë) hasreti. (Vuthaj)
HËRRLIKË **em. sh. –** gurë të vegjël që i qet muratori midis murit. (Vuthaj…)
HIJE **ef. sh.-** *Nuk t'ka hije me b*â *atë gj*â. *Nuk* â*sht mirë për ty ashtu…* (Vuthaj…)
HOKLOMAZ-I **em. sh.-a** njeri i madh, i rritshëm mbi normalen dhe i plogësht. (Vuthaj)
HORLLËQE **ef. sh.-** punë të këqija. *Mos b*â *horllëqe; mos u merr me horrllëqe!*
HOZHGJELLDEN **pasth.** (turq.) mirë se na erdhe! (Vuthaj...)
HUKUBET **nd.** shumë keq, shumë i pistë, shumë i parregullt apo i rregulluar. (Hakaj, Martinaj, Hoti i Kujit, Vuthaj...)
HUKUBETAN/E, **mb**. i parregullt, i keq, jo i bukur (Vuthaj, Hakaj...)
HURP **f.** hurb; pi me hurb çajin, qumështin e nxehtë. (Vuthaj)
HURPAÇ-I **em. sh.-a** ai që s'mund duron pa e provuar secilën pije apo ushqim. (Vuthaj)

I

ILLNON **f.** hidhëroj, hidhëroj. (Dol, Vishnjevë)
IMÊNE **ndajf.** e vërtetë. (Vuthaj)
INAD-I **em. sh.-e** (*arb.*) inat. (Vuthaj)
INSAN-I **em. sh.-ë** (*arb.*) njeri. (Vuthaj…)
ITIBAR-I **em. sh.-e** (*arb.*) respekt. (Vuthaj…)
IXHRAM-I **em. sh.-e** (*turq.)*merak. (Vuthaj…)

J

JASHTABEG-U **em. sh.-a** (ironi) njeriu që s'ka mbulojë mbi kokë (Vuthaj).
JARAZ/E **mb.** iu rri në këmbë të tjerëve. (Arzhanicë, Martinaj…)

JORDUM-I **em. sh.-a** tëmbli (qumështi) i dhenve në vjeshtë - i trashur (Vuthaj etj.).
JORDAN-I **em. sh.-e** salltanet, krenari. (Vuthaj)

K

KACALLAK-U **em. sh.-ë** vjegëza në këmbëz të çakshirëve (tirqve). (Vuthaj)
KACATURR/Ë-A **ef. sh.-a** (*turq.*) armë, pushkë, kacaturrja. (Vuthaj)
KACUL **nd** mënyrë e qëndrimit e kërrusur
KAÇADREN-I **mb.** (leshi) i dredhur në trup. (Vuthaj)
KAÇORR-I **em. sh.-a** kasolle (shtëpizë) e vogël druri, ku rrinë pulat. (Vuthaj)
KAÇUMIS **f** kacafytem me një tjetër. (Vuthaj)
KALENIC/Ë-A **ef. sh.-a** enë dheu, në formë të bludës. (Vuthaj)
KALLÇIK-U **em. sh.-ë** (*turq.*)çorapi deri në gju, por pa shputë; gete. (Vuthaj)
KAMCAN-I **em. sh.-a** mbërthyese prej teli. (Vuthaj)
KAMËTURQISHT **mndajf.** i ulur këmbëkryq. (Vuthaj…)
KAPREÇ/E **mb.** (*fr.*) djalosh i harlisur, me teke, kapadai. (Vuthaj)
KAPXHIK-U **em. sh.-ë** (*turq.*)dera që lidh dy kate apo dy shtëpi., apo dy oborre. (Vuthaj)
KARAGJOZ/E **mb.** (*turq.*)njeri palaço, por këmbëngulës dhe kinse trim.
KATAZI-A **ef.sh.-** vuajtje shpirtërore. (Vuthaj)
KATËRRESXHI/JKË **mb.** njeri që shtie ngatërresa.
KATUT-I **em.sh.- e** katund, fshat. (Martinaj, Pepaj)
KAVALER/E **mb.** (*it.*)dorëlirë, njeri dorëdhënë e bujar. (Vuthaj)
KERRSANX/Ë-A **ef.sh.-a** bimë shëruese;sanëz (*Gentiana lutea L.*) (Vuthaj)
KÊTË (jam kêtë) isha (kam qenë). (Nokshiq, Pepaj, Martinaj)
KIMETLI/E **mb.** (*arb.*)me vleftë, çmim, gjë e shtrenjtë. (Vuthaj)
KJUMËSHT-I **em. sh.-** *Asht zanë hirra kjumësht*; kumësht. (Vuthaj)
KOKRROJ **f.** punon kokrra - kokrra, një nga një vetëm, kokërrohen dhentë në kullosë. (Vuthaj)
KOLLOMOQ/E **mb.** i rregulluar, i ndrequr, elegant; kollomboq. (Vuthaj)
KOLLOVOGJ/E **mb.** *(skr.)*valle malaziase, prijësi i valles.(Pepaj, Nokshiq, Arzhanicë)
KOPAÇ-I **em. sh.-e** kërdhokull. (Vuthaj…)
KOPSHIQ **ndajf.**. i ngirë dhe i fryrë shumë, përtej mase. (Vuthaj…)
KOSAXHOR/E-JA **ef, sh.-e** dhia që merret prej tjetrit për interes - për kos e qumësht gjatë verës…(Vuthaj)
KRAC/Ë-A **ef. sh. –a** emër dhie. (Vuthaj)
KRÂN/E-JA **ef. sh.-** krande, thupra të thyera dhe të thara. (Vuthaj…)

KRÂT-I **em. sh.-** ushqim për bagëti, sidomos për dhi; majat e njoma të rrembave të ahut…, të prera ose të thyera nga barinjtë, gjatë stinës së dimrit, për t'i ushqyer dhinë, kalin, lopën…(Vuthaj…)
KRIN **f.** ngrin. (Vuthaj)
KROZH/E-JA **ef.sh.-e** shportë e thurur nga thuprat e holla (Vuthaj, Martinaj, Pepaj)
KRYERRABOL/E **mb.** (i,e) pa mend, pa gjë në kokë (Vuthaj).
KTOJ **f.** Këndoj (Martinaj, Pepaj)
KTUA **f.** kënduar (Martinaj).
KUCË E MANUCË **em. sh.-ë** të mirë e të këqij, gjithkush (Vuthaj).
KUK/Ë-A **ef.shm.-a** çekiq druri për t'i cokatur gështenjat; mjet për tredhjen e deshve, hamshorëve, sqepve etj..
KUKULOSH/E, **mb.** njeri i dobët, jo punëtor, i plogësht, i ngadalshme, përtac
KUKUNESHË **mb.** gruaja që thërret zi, keq (Hakaj).
KUKORR DJATHI **em. sh.-e** dërrasa a rafti ku është vënë djathi për t'u kulluar dhe terur (e kanë lënë 15 ditë). (Vuthaj)
KÛKULL **em. sh.-j** kungull. (Martinaj)
KUM-I **f.** kam. (Vuthaj…)

L

LACAN-**I em.sh.ë** emër sqapi. (Vuthaj)
LAC/Ë-A **ef. sh.- a** emër gruaje, por edhe emër dhie. (Vuthaj)
LAJTHISHT/Ë-A **ef. sh.-a** vend i pyllëzuar me drurë lajthish. (Vuthaj…)
LANUJË **mb.** femër e ngadalshme, jo e shkathtë (Vuthaj, Martinaj, Kukaj, Hakaj, Hoti i Kujit)
LARK **ndajf.** larg. (Vuthaj).
LARUK/Ë-A **ef.sh.-a** emër lope. (Vuthaj...)
LASKUT-I **em. sh-ë** njeri i pavlerë, rrugaç; shëtitës i pacipë, që shkon aty-këtu për të ngrenë; interesxhi i rryer. (Vuthaj)
LASTRAFIN-I **em. sh.-a** lëkurë. (Martinaj)
LASHKE **f.** lente, lë. (Hoti i Kujtë)
LÂT/Ë-A **ef. sh.-a** tratë e shtëpisë me gjithë pjesët tjera. (Martinaj)
LÂTË **f**. (kam) lënë. (Martinaj)
LEDIN/Ë-A **ef. sh.-a** fushë e vogël, livadh; ia qiti rrenat në ledinë. (Vuthaj)
LÊN-I **em. sh.-a** lêni i ahut, gështenja e ahut, boça e bredhit. (Vuthaj)
LER/Ë-A **ef. sh.-a** lug druri ku mblidhet uji i shiut e ku pinë bagëtia. (Vuthaj)
LESHPER-I **em. sh.-ë** qethtar, floktar, berber. (Dol)
LETREK **mb**. mashkull gjysmë i tredhur, që nuk mund barrëson. (Vuthaj…)
LEVOR/E-JA **ef. sh.- e** patllake, allti. (Vuthaj)
LËMUÇ **ndajf.** rënie në tokë i alivanosur; ka mbetur lëmuç në tokë…(Vuthaj…)
LËNUE **f**. heqje e peshës nga

shpina. (Vuthaj…)
LËNUER **f.** kreh leshin e deleve. (Vuthaj…)
LGAT/Ë-A **ef. sh.-a** sëmundje e gjatë; lëngatë. (Vuthaj…)
LIVAD-I **em. sh.-e** livadh. (Vuthaj)
LMES/Ë-A. **ef. sh.-a** vishkull i hollë druri, i gjatë 3-4 m, që i vihet sanës prej në maje e poshtë, në katër anët nga një, për të mbajtur fort majën e sanën. (Vuthaj)
LOK-U **em. sh.-** shesh, sheshi i burrave. (Vuthaj)
LULE RREMAÇOKE **ef. sh.-** aguliçe *(Primula officinalis L.)* (Vuthaj...)
LULISHTAR/EI **mb.** ai që kujdeset për lule. (Vuthaj)
LULS (i,e) **mb.** verdhë. (Vuthaj…)
LVRIS **f.** lëviz. (Vuthaj…)

LL

LLABOÇ-I **em. sh.-a** veshmadh (Vuthaj)
LLABUD/Ë-A **ef. sh.-a** bula e veshit. (Vuthaj)
LLABUDAN/E **mb.** njeri me veshë të mëdhenj. (Vuthaj...)
LLÂM-I **em. sh.-ë** dhëmbët. (Dol, Vishnjevë)
LLASHT/ËR-RA**, ef.** kashtë elbi. (Vuthaj)
LLE-U **em. sh.** - dheu, toka. (Dol, Vishnjevë)
LLÊN **ef. sh.-** dhen, shumë dele. (Dol, Vishnjevë)
LLÊTË **esh.** dhentë, delet. (Dol, Vishnjevë)
LLOPATIC/Ë-A **ef. sh.- a** femër e madhe dhe e plogësht. (Vuthaj)
LLUÇK/Ë-A **ef. sh.-a** vajzë e shëndoshë, e bukur dhe e madhe. (Vuthaj)
LLAZ-I **em. sh.-e** (*skr*.) livadhe të pjerrëta, shpatina (Nokshiq, Pepaj, Arzhanicë)

M

MAHALL/Ë-A **ef. sh. a** (*arb*.) lagje; vllazëri. (Vuthaj)
MAJ **f.** mbaj. (Vuthaj…)
MAJOJ **f.** *Majoj sanën e grumbulluar rreth mullarit; e rregulloj majën e sanës rreth mullarit, mos me i hi shiu.* (Vuthaj...)
MALACAK-U **em. sh.-ë** banor i malit (kështu e quajnë njeriun vendeve të larta edhe në Tuz) (Arzhanicë, Vuthaj)
MALUK/Ë-A **ef. sh.-a** emër lope. (Vuthaj)
MALLIM-I **em,sh.-e**, një turr i kullosës së deleve (Vuthaj etj.)
MALLOJ **f**. kullos kalimthi delet nëpër një vend me bar të mirë, sa për t'ua plotësuar shujtën. *Çobani i ki pa lëshue mallim delet dhe ish shkue.* (Vuthaj)
MAN/E-JA ef.sh.- emër njeriu i gjinisë femërore (Vuthaj,...)
MANXERR/E-JA **ef. sh.- e** (*gjerm.*) pushkë. (Vuthaj)
MÊJ **f.** pusho (!), mjaft (!).(Vuthaj)
MEJDANXHI-U **em. sh.-nj** (*arb.*) luftëtar. (Vuthaj)
MËLLUG/Ë-A **ef, sh.-a** gungë me ngjyrë të murrmë në lëkurë të kokës

etj. (Vuthaj)
MLLIJAN/E **mb.** mashkulli i dhisë së zezë, me brirë. (Vuthaj)
MIELL **f.** mbjell; mbjell arën. (Vuthaj)
MJEDIS-I **em. sh.-e** beli, përmjeti. (Vuthaj)
MJELC/Ë-A **ef. sh. -a** enë e punuar prej drurit, në formë kusie, por me bisht,
që përdoret për qumësht në shtrungën e deleve; shekë. (Vuthaj)
MOC **mb.** mocanik, moshatar. (Vuthaj)
MJELTORE **mb.** ajo që mjel delet, lopët... (Nokshiq...)
MOCANIK/E **mb** moshatar. (Vuthaj)
MOCANIK-U **em. sh.-ë** moshatar (Vuthaj, Martina...)
MORRA **f.** mora. (Vuthaj)
MRAPSHT/AN/UJË **mb.** ai/ajo që punon mbrapsht (Vuthaj, Hakaj)
MRIJOJ **ft.** kur nuk shikon drejt nga hidhërimi, nga inati, nga pakënaqësia...; kur nuk dëshiron të bisedosh... (Vuthaj)
MTOJ **f.** mëtoj; pres prej tij se do të më ndihmojë. (Vuthaj)
MULLACAK-U **em. sh.-ë** njeri i vogël, shkurtabiq; me krye të qethur. (Vuthaj)
MURRIK/Ë-A **ef. sh.-a** lopë me qime të murrme. (Vuthaj, Martinaj...)
MYMLEQET-I **em. sh.-e** (*truq.*) krahinë, vis, popull etj. (Vuthaj)
MYSHKET/Ë-A **ef. sh.-a** pushkatim. (Vuthaj)
MYSHKETUR, **mb**. i pushkatuar. (Vuthaj)
MYSHKIBET-I **em. sh.-e** vrasje, masakër. (Vuthaj)

N

NABETXHI **mb** i pa vlerë; njeri i papërshtatshëm (Vuthaj...)
NÂLE-JA **ef. sh.** emër përkëdhelës për nënën. (Vuthaj)
NASHIK E NAGRIP **ndajf.** (*arb.*) larg njëri-tjetrit; në dy pole të tokës. *Ju çoftë Zoti nashik e nagrip! (Vuthaj)*
NÂTJE-JA **ef. sh.- e** mëngjes. (Vuthaj, Kukaj…)
NAVI/K-U **em. sh.-q**, grumbull sane; druri i prerë, i gjatë deri në katër metra, i trashë sa llana e dorës së burrit të mesëm, që përdoret vetë i dyti për të bartur naviqtë e sanës (Vuthaj…).
NËRGAÇ-I **em. sh.-a** ai që ndërgon pa nda - viçi, qengji, por edhe njeriu i rritur (ironi) (Martinaj).
NËRMJET **ndajf.** midis tyre. (Vuthaj)
NËRVETI **ndajf.** midis veti. (Vuthaj)
NËR **ndajf.** nën. (Vuthaj)
NIMOJ **f.** ndihmoj. (Vuthaj)
NISHANXHI-U **em. sh.- nj** (*turq.*) njeri me grada. (Vuthaj)
NOLLË **f.** ndodh. (Dol)
NONI **përem.** ndonjë. (Vuthaj)
NREQ **f.** përcjellë babai vajzën për te burri, bëj gati; përgatit; ndreq. (Vuthaj)

NJ

NJÂJ **përem.** ai. (Vuthaj)
NJÂJO **përem.** ajo. (Vuthaj)
NJÂTA **përem.** ata. (Vuthaj)
NJÂTJE **ndajf.** atje. (Vuthaj)
NJEKAQ **ndajf.** kaq. (Vuthaj)
NJEKJO **përem.** kjo. (Vuthaj)
NJETA **përem.** këta. (Vuthaj)

O

OROG-U **em. sh.- oroqe**, (*skr.* rok) data kur shkon vajza nuse. *Iu ka da orogu.* (Vuthaj)
OTERRG-U **em. sh.- oterrgje**, orteku i borës. (Vuthaj)

P

PAISHT/Ë-A **ef. sh.- a** shpat i pyllëzuar me dru paje. (Vuthaj)
PAR/E-JA **ef. sh.-e** emër njeriu i gjinisë femërore (Vuthaj)
PATENIC/Ë-A **ef.sh.-a** shtëpizë barinjsh, për një apo dy vetë, i punuar prej drurit, pranë torishtës së deleve. (Vuthaj)
PELHURAN/E **mb.** ai që s'mund rri pa i shpaluar a prekur gjërat e huaja. (Vuthaj, Martinaj...)
PELHURAS **f.** kontrolloj; shpaloj gjërat e huaja në mënyrë të papërgjegjshme, panevojshme, nga kureshtja. (Vuthaj, Martinaj, Hakaj)
PËRCALL **f**. kur mjelatorja ia jep sisët e lopës viçit një nga një, vetëm nga një herë, sa për ta liruar lopa qumështin, për ta mjelë pastaj mjalatorja. (Vuthaj)
PËRJARGOJ **f.** bëhem me pështymë; qes jargë prej goje.
PËRHJEK **f.** frymëmarrjet e fundit të jetës. (Vuthaj)
PËRJEÇ/A **ef. sh.-a** mbathje të këqija; çorapë ose opinga, ose këpucë të shqyera, të vjetra. (Vuthaj, Martinaj)
PËRJEÇ/AN/UJË **mb.** njeri me mbathje krejt lecka, njeri i pakujdesshëm në veshmbathje. (Vuthaj...)
PËRMJET-I **em. sh.-** beli, mjedisi. (Vuthaj)
PËRISHÂN/E **mb.** *(turq.)* shumë i keq, i shëmtuar. (Hakaj)
PËRPRAPA **ndajf.** prej mbas shpinës. (Nokshiq, Pepaj)
PËRTËNZON, **pasth.** betim: *Pasha Zoten!* (Vuthaj)
PI **ndajf.** mbi (rrugë). (Martinaj)
PIÇMAN **em. sh.-e** pendim. (Vuthaj)
PIPIRUQ **ndajf.** (*turq.*) diçka që qëndron i ngrehur drejt. (Vuthaj)
PJETPOSHTË **ndajf.** teposhtë. (Vuthaj)
PLAGIM-I **em. sh.-e** plagë. (Vuthaj)
PLAS/Ë-A **ef. sh.-a** një e çarë e vogël në mur, në dru apo në asht…(Vuthaj)
PLEM-I **em.sh.a** shtresë shumë e hollë e borës.(Martinaj, Hoti i Kujit)
POJAT/Ë-A **ef. sh.-a** kasolle për bagëti, e mbuluar me rremba me dushk. (Vuthaj)
POJÂV/Ë-A **ef, sh.-a** batanije e trashë, e madhe, e bërë në vekë (vjegë) me pe prej leshit të deles.

PRÂJ **f.** hesht, pushoj, mjaft(!). (Vuthaj)
PRAPSHTAN/E **mb.** njeri i mbrapshtë. (Nokshiq, Martinaj)
PRAPSHTOJ **f.** punoj keq. (Martinaj, Nokshiq)
PRAPSHTUÊ/A **ef.sh.-a** femër e mbrapshtë
PREFULAS **f.** ngutem për të bërë një punë
PREZOR/E-JA **ef. sh.-e** (*skr.*) dritare. (Vuthaj)
PRIHERË **ndajf.** menjëherë; nisja në të njëjtën kohë. (Vuthaj)
PROZHËM-I **em.** mal i rrethuar(Vuthaj)
PSHTOJ **f.** shpëtoj nga vdekja; *I ra gota prej dore pahiri dhe u thye.* (Vuthaj)
PUÇI/K-U**, em.-qe** pus, jo i thellë, me ujë. (Vuthaj…)
PULAZ **ndajf.** të rrëzuarit anësh, pa fituar asnjëri garues; baras. (Vuthaj)
PULÇAK-U **em. sh.-ë** vend në Mirditë. (Vuthaj)
PUPAGJEL-I **em. sh.-a** kokrrat e misrit kur piqen; kërcimtar, që kërcen lehtë. (Vuthaj)
PUTIN/Ë-A **ef. sh.- a** kofshë. (Vuthaj)

Q

QAS/Ë-A **ef. sh.-a** (*arb.*) enë e bakërt, në të cilën i kanë larë filxhanët. (Vuthaj)
QESAT-I **em. sh.-e** (*arb.*) skamje. (Vuthaj)
QESKIN/E **mb.** (*turq.*) (i,e) shpejtë. (Vuthaj)
QESKINOJ **f.** (*turq.*) shpejtoj, ngutem. (Vuthaj)
QET/Ë-A **ef. sh.-a** vend me bar, i rrëpirë, midis majës shkëmbore. (Vuthaj)
QOKISHT/Ë- A **ef. sh.-a** vend i skajshëm, që rrallëherë i bien rrezet e diellit. (Vuthaj)
QOKISHTË **mb.** vend i skajuar nga rrezet e diellit. (Vuthaj)
QYLER-I **em. sh.-e** (*turq.*) dhoma (e vogël) e nuses. (Vuthaj)
QYPAK/E **mb.** njeri me trup të shkurtër. (Vuthaj)
QYQEVETËM **ndajf.** i vetmuar si qyqja në mal; ai që rri vetëm. (Vuthaj, Martinaj, Pepaj, Hoti i Kujit...)
QYQAN/E, QYQUJË **mb**. gruaja që s'është e zonja e punëve të shtëpisë. (Kukaj, Hakaj)
QYSTEK-U **em. sh.-ë** (*turq.*) zinxhirët e orës së xhepit. (Vuthaj)
QYTEK-U **em. sh.-ë** (*turq.*) dru i shkurtër, i hollë, me të cilin rrahet dikush. (Vuthaj)

R

RÊN-I **em. sh.-e** rend, radhë. (Vuthaj)
RIG/Ë-A **ef. sh.-a** (*lat.*) shi i hollë, i herahershëm. (Vuthaj)
RJEP rjep, heq lëkurën prej mishit. (Vuthaj…)
ROBNI-A **ef. sh.-** shumë njerëz, tërësi njerëzish. (Vuthaj, Martinaj…)
ROD-I **ef. sh.-e** soj, gjini. (Vuthaj,

Martinaj, Pepaj, Hakaj, Kukaj…)
ROG/Ë-A **ef. sh.-a** vend i vogël me bar, kullosë midis malit. (Vuthaj, Martinaj…
ROP-I-I **em. sh.-ë** anëtari i familjes. (Vuthaj…)
RUB/Ë-A **ef. sh.-** shami. (Vuthaj, Hakaj, Kukaj…)
RUDÊ-A **ef. sh.-a** (*skr*.) emër deleje; delja me lesh të shkurtër dhe tëbutë, tëdredhur. (Vuthaj…)
RUDIN/Ë-A **ef. sh.-a** (*sllav*.) shpat me bar e pa mal të bjeshkëve. (Vuthaj)
RZMOJ **f.** nënçmoj, rëndoj me fjalë. (Vuthaj…)

RR

RRAH-U, **em. sh.-e** pjesë e malit të rrethuar. (Vuthaj)
RRAQE **ef. sh.-** enët, orenditë dhe gjërat tjera shtëpiake. (Vuthaj…)
RRASË **f.** futur; jemi rrasë; kemi hyrë me zor - zatetshim; i (e) ngopur me ushqim; zatetur çantën me rroba; dendur thesin me bar. (Vuthaj)
RRAT/Ë-A **ef. sh.-a** bari i djathit i përgatitur prej mullëzës së viçit. (Vuthaj...)
RRÉ-JA **ef.** rrugë, gjurmë nëpër borë. (Vuthaj)
RREBAJK/Ë-A **mb.** femër e shkathtë, që i kryen punët menjëherë. (Vuthaj...)
RREBAK/E **mb.** njeri i shkathtë, i fortë, që i bën punët shpejt e mirë. (Vuthaj...)
RREK/E -JA **ef. sh.-e** emër dhie; rreket e dhisë në qafë; rreket e plehut të gurëzuar nëpër kofshë të deles, ngjitur në leshin e saj. (Vuthaj...)
RREK/E **ef. sh.-** dhi me rezhda (vath) në qafë. (Vuthaj)
RREKË **f.** ngopur. (Vuthaj)
RRÉR/É-JA**, ef.** rrugë, gjurmë nëpër borë. (Vuthaj)
RRETHOKOLLA **ndajf.** Rreth e rrotull. (Hakaj, Hoti i Kujit, Nokshiq, Pepaj)
RREXUELL-I **em. sh.-nj** puçërr e vogël në kapak të syrit. (Vuthaj)
RRKE **ndajf.** pa nda, p.sh. bie shi pa nda. (Vuthaj)
RRNOJ **f.** jetoj. (Vuthaj, Rrzhanicë, Pepaj…)
RROKATJ/E-A **ef. sh.-e** humbja e të menduarit; çmenduria. (Vuthaj)
RROKATUR (i,e) **mb.** i çmendur (Vuthaj...)
RRUKËTAR-I **em.sh.-ë** udhëtar, rrugëtar. (Vuthaj…)

S

SAKIC/Ë-A **ef. sh.-a** sëpatë. (Në krahinën e Plavës e Gucisë)
SALTE **ndajf.** vetëm. (Vuthaj…)
SALL **ndajf.** (*turq*.) vetëm. (Vuthaj...)
SEDEF-I **em. sh.-ë** (*turq.*) kopse e sedeftë (Vuthaj, Martinaj, Hakaj, Kukaj, Pepaj, Arzhanicë)
SERBESOJ **f.** (*pers.*) rri kryelartë, lirisht, pa druajtje; shes mend. (Vuthaj)
SERÇ-A **ef. sh.-a** gotë. (Arzhanicë)
SIMUZQ/Ë-A **ef.-a** shi e borë

bashkë, skllotë. (Nokshiq)
SINOR-I **em. sh.-ë** lëmë sane, tallash. (Rrzhanicë, Vuthaj, Hoti i Kujit)
SJOLL/Ë-A ef. **sh.-a** vendi ku ruhen vezët. (Vuthaj)
SKAQ-i **em. sh.-e**, vend i skajuar, që nuk e ngroh Dielli, mali. (Vuthaj, Martinaj…)
SLLUB/Ë-A **ef. sh.-a** (*skr.*) shkallë druri apo hekuri. (Vuthaj,…)
SMET-I**, em.sh.-e** (*skr.*) borë e grumbulluar në një vend. (Martinaj, Nokshiq, Pepaj)
SOJ-I **em. sh.-e** fis, farefis (i mirë, i keq). (Vuthaj)
SOKOL/ESHË **mb.** femër e shpejtë - si petriti. (Dol, Hakaj, Kukaj)
SOS/E-JA **ef.sh.-e** emër femre; ndërsa *e sosa*, d.m.th. e mbarova punën ose e lëndova plagën… (Vuthaj…)
SURDAR/E **mb.** mendjemadh, kryelartë. (Vuthaj)
SUT/Ë-A **ef. sh.-a** emër i gruaje. (Martinaj)
SYÇAKAR/E **mb.** syvëngër; syçekërr; njeriu që ka njërin sy të zi e tjetrin të kaltër; syshtrembër, që nuk mund të shikojë drejt me të dy sytë. (Vuthaj)
SYÇEKER/E **mb.** syvëngër, syçekërr; syshtrembër, që nuk mund të shikojë me të dy sytë drejtë. (Vuthaj)
SYLAH-I **em. sh.- e** (*turq.*) pushimi vjetor i ushtarit. (Vuthaj…)

SH

SHAK/E-JA **ef. sh.-e** emër njeriu në Vuthaj...
SHAK/Ë-A **ef. sh.-a** bushtër. (Vuthaj)
SHAKIDON-I **em. sh.-e** ballkon, parmak. (Vuthaj)
SHAPUEM **mb.** (i, e) verdhë; luls. (Vuthaj)
SHAROV-I **em. sh.-a** qen i larmë. (Vuthaj)
SHAT/E-JA **ef. sh.-t** emër njeriu në Vuthaj, Martinaj...
SHEH/ËR-I **em. sh.-e** (*turq.*) qytet.
SHÊJ **e(m)f. sh.-a** shenjë (njollë) në ballë, në trup; shenjë për shtënie. (Vuthaj)
SHIT/Ë-A **ef. sh.-a** sëmundje e rëndë. Mallkimi:*Të raftë shita*! (Vuthaj)
SHKOKËLOJ **f.** dremis dikë, e lodhi dikë. (Vuthaj)
SHKUL-I **em- sh.-a** masë e perit që qitet në vekë. (Vuthaj)
SHKULLOJ/Ë-A **ef. sh.-a.** tel i trashë, i lakuar në fund në formë kërrabe, që përdoret për të shprushur zjarrin dhe për të ngritur çerepin e bukës në votër. (Vuthaj)
SHLLUG/Ë-A **ef. sh.-a** tufa e leshit, i vënë në furkë për t'u tjerrë. (Vuthaj)
SHMRET/E **mb.** qyqar; kur plaket njeriu bëhet shmret; i paaftë. (Vuthaj)
SHMRIJAK/E **mb.** njëri prej tre ortakëve që ruajnë bagëtinë (një sot, tjetri nesër...)
SHOT/Ë-A **ef. sh.-a** emër gruaje,

por edhe emër i patës së butë apo të egër. (Vuthaj...)
SHPLAK/Ë-A **ef. sh.-a** shpullë. (Vuthaj…)
SHPLOJ **f.** zbuloj. (Martinaj)
SHPUT/Ë-A **ef. sh.-a** pjesa e çorapit prej në nyje të këmbës e poshtë; meste, këputë. (Vuthaj)
SHQILAK-U **em. sh.-ë** enë drunjtë, kasë (zllakop, tinar) e vogël, që zë deri në 15 kg. djath, mazë, zahire. (Vuthaj).
SHQIL/Ë-A **ef. sh.-a** shqilë, shqilak, enë e vogël, kasë e vogël prej druri, me kapak, e ngushtë 10 – 15 cm. dhe e gjatë 15 – 25 cm. që zë 2 – 5 kg. mazë, kos të kulluar ose tëmbël delesh i trashur. (Vuthaj);
SHTALP –I **em. sh.-a** boça e misrit me kokrra të njoma; djalë shtalp, djalë i ri – i papjekur; djathi shtalp, djathë i ri; shtalpi i djathit të pakulluar. (Vuthaj)
SHTIH/AN/HUJË, **mb.** ai që e paraqet veten ndryshe nga ç'është për të mashtruar të tjerët shtirak, shtinjak. (Vuthaj)
SHTIHAN-I **em.sh.-ë** njeri shtirak. (Vuthaj, Martinaj, Hakaj, Pepaj, Hoti i Kujit, Arzhanicë)
SHTJERRA **em. sh. –** qengja. (Vuthaj)
SHTJERR **f.** shpoj; dobësuar. (Vuthaj)
SHTON/Ë-A **ef. sh.-a** vendi i daljes së ujit nëpër mur të shtëpisë nga brenda jashtë. (Vuthaj)
SHTYPC-I **em. sh.-a** shtypës; njeriu që shtyp diçka - boça, bosa etj. (Vuthaj)
SHUL/E-JA **ef. sh. –e** emër dhie. (Vuthaj)
SHULOR-I **em.sh.ë** shular. (Vuthaj...)
SHULLA **mb.** Vend ballë diellit, që e ngroh dielli gjithë ditën.
SHUSHLI **mb.** vesvese, i hutuar. *M'ka bâ shushli; m'i ka marrë metë; m'ka hutue...; e kanë bâ shushli.* (Hakaj, Pepaj...)
SHYB/E-JA **ef. sh.-e** (*arb.*) dyshim. (Vuthaj...)
SHYHRET-I **em. sh.-e** (*turq.*) kënaqësi, bukur; për bukuri. (Vuthaj...)
SHYT/Ë-A **ef. sh.-a** emër dhie; emër gruaje. (Vuthaj...)

T

T'LIGAT **ef. sh.-** të këqijat e njeriut. *M'i marrsh të ligat!* (Vuthaj)
TALIM-I **em. sh.-e** (*turq.*) ecja në hap e ushtarëve; ushtrime ushtarake, stërvitje. (Vuthaj)
TEJ/Ë-A **ef. sh.-e** litar i leshtë. (Vuthaj, Martinaj…)
TËRPIAN/E **mb.** i pangopur. (Vuthaj...)
TÊJ/Ë-A **ef.sh.-a** ndeja; qëndrimi diku (Martinaj).
TËRFËLLOJ **f.** përfëlloj; tërfëllon kali me hundë. (Vuthaj...)
TERË **f.** Ia teri paratë; ia pagoi menjëherë paratë
TËRKLITUN (i, e) **mb.** i (e) molisur, i shkapërderdhur, i trazuar.

TIEJ **f.** dëgjoj (Martinaj).
TINGALLË **mb.** i (e) zbrazët, pa kurrgjë në thes; shkoi tingallë vetëm; tangallë. (Vuthaj)
TLLALL/Ê-A **ef.sh.-a** kosi i tëholluar (Vuthaj); ajron (Prizren),
TOROLÂG **nd.** mënyrë e rrokullisjes nëpër teposhte; shkoi torolag... (
TRALLTOR/E **mb.** ai është tralltar; tradhtar. (Dol)
TRAP-I **em. sh.-a** gropë e vogël në tokë ku ruhen patatet gjatë dimrit
TRASH/E-JA **ef.sh.-e** emër njeriu. (Vuthaj…)
TRÊT/JE **ef.sh.-** përgatesat me petë. (Pepaj)
TROKLLINË (E THATË) **ef. sh.-a** vend i kullotur dhe i rrahur shumë nga bagëtia; djerrinë e thatë. (Vuthaj)
TROSH/Ë-A **ef. sh.-a** thërrmijat e bukës (Martinaj,Vuthaj)
TRUÇ **ndajf.** grumbull; një truç (tubë) lulesh në tokë. (Vuthaj)
TRULLAN/E **mb**, njeri i hutuar. (Vuthaj)
TRUTRASHË **mb.** njeriu që s'kupton, që s'i hyn gjë në mend.
TURTULEC/E **mb.** njeri i vogël, shkurtabiq. (Vuthaj)
TURUKAS **f.** s'e lë rehat dikë, duke ia tërhequr gjithmonë vërejtjen. (Vuthaj)
TYB/E-JA **ef. sh.-** be; *ta bâj me tybe* (be); betim. (Vuthaj)

TH

THAJ **f**. Ia paguaj menjëherë paratë; ia thaj paratë
THARK-U **em,sh.-qe** vend i vogël, i ndarë nergut për viça ose qengja në ahur
THËNGI-U **em.-nj** gaca e shuar e zjarrit; thëngjill. (Vuthaj).
THËRMI-A, **ef. sh.-** thërrmijë e vogël, troshë (Vuthaj...)
THMI **em.sh.-** fëmijë. (Vuthaj...)
THO' **f.** them. (Dol, Martinaj)
THYESHËM (i, e) **mb.** vend i vështirë për kalim; material që mund të thyhet. (Vuthaj...)

U

UGIÇ-I **em. sh.- a** ogiç. (Vuthaj...)
UN/Ë-A **ef. sh.- a** dru, pak a shumë i djegur. (Vuthaj...)
URZAK-U **em. sh.-ë** shufër hekuri e ndrequr në formë "kali" për të vënë në vatër - për t'i mbajtur drutë. (Vuthaj)
URTH-I **em. sh.-a** sëmundje misri… (Vuthaj)

V

VARZAT **ef.sh**.-vajzat. (Vuthaj...)
VATIS **f.** ujis; vadis. (Nokshiq, Pepaj,…)
VAZHDAR **ndajf.** Po derdh grurë vazhdar rrugës, pa ndërprerje. (Vuthaj...)
VAZHDOR **ndajf.** (po ecin) varg e vijë. (Vuthaj)
VERDHË (i,e) **mb.** gjelbër. (Vuthaj, Martinaj, Hot…)
VËRTAKAÇ-I **em.sh.-a** mesiti. (Nokshiq, Hoti i Kujit)
VIGLAÇ-I **em.sh.-ë** vigël. (Vuthaj)

VIKAS **f.** bërtas, thërras me të madhe. (Vuthaj)
VIK-U **em. sh.- viq** lese, shkalq; vig. (Vuthaj)
VIRAN/E **mb**. (*turq*.) i shkathët; i fortë (Vuthaj)
VIZAR nd. vazhdimisht, njëri pas tjetrit. *Shkojshin vizar njani mas tjetrit. (Vuthaj)*
VIZDRAL **ndajf.** i shtrirë si i vdekur në tokë (Vuthaj)
VJEL/Ë-A **ef. sh.-a** vjelja e rrushit - e pemëve në vjeshtë. (Vuthaj)
VLLAÇ/EG-U **em. sh.-gje** lug nëpër të cilin tërhiqet drunjtë e gjatë, ose barra e sanës. (Vuthaj)
VLLAK-U **em. sh.-a** disa vishkuj drurësh të lidhur; një vllak dru. (Nokshiq)
VNER-I **em. sh.-e** lëng i verdhë, i tharbët, që krijohet në lukth; thartira. (Vuthaj)
VOJVOD/Ë-A **em. sh.-ë** (*sllav.*) prijës luftarak; i ngarkuari i qeverisë osmane për një krahinë të caktuar në Shqipërinë e Veriut në shek. XIX; kryetari i një fisi. (Vuthaj)
VROGOJ **f.** bëj shenja në trupë me rënie të forta (Vuthaj).

X

XERR/E-JA, **ef.sh.-** grimcë; asnjë grimë (Vuthaj).
XIGLOJ **f.** të prekurit me majë të gishtërinjve nëpër vende të ndjeshme të trupit, të cilat nuk mund durohen lehtë. (Vuthaj).

XH

XHAGAJLOZ-I **em. sh.-a** njeri që kërkon sherr; kopuk, ngatërrestar që nuk përton të grindet me këdo; xhagajdur. (Vuthaj)
XHEMI-A **ef. sh.-** xhemi, shumë anije. (Vuthaj)
XHEPHÂN/E-JA **ef. sh. -e** shtëpitë, kullat e mbretit. (Vuthaj)
XHGOGLOJ **f.** heq kokrrat e misrit nga boça. (Vuthaj)
XHIN/ËS/E **mb.** (*turq*.) i (e) shpejtë. (Vuthaj)
XHVARITEN **f.** rrallohen retë; hiqen retë; kthjellet moti (Vuthaj)

Y

YMYT-I **em. sh.-e** (*turq*.) besimi, shpresa për diçka. (Vuthaj...)

Z

ZAHERE **ndajf.** ndoshta. (Vuthaj)
ZALLOG/Ë- A **ef. sh.-a** copë e lëkurës që shtrohet brenda opingës. (Vuthaj)
ZANOG/Ê-A **ef. sh.-a** pjesë e arës, livadhit. (Martinaj)
ZAPREG/Ë-A **ef. sh.-a** përparëse në bel e poshtë te kostumet e grave në trevën shqiptare të Plavë-Gucisë.
ZAPRES **f.** mbledh, mbuloj pjesët e trupit, mbyll vrimat…; afro gjunjët pak se u bëre horë! (Vuthaj)
ZATES **f.** takoj, ndesh; dend diçka. (Vuthaj)
ZAVALL **ndajf.** (*turq.*) gjendje e vështirë; hall i madh; sana zavall - e përhapur për t'u tharë. (Vuthaj)

ZDESHOR/E-JA **ef.sh.-** dhoma e zhveshjes. (Vuthaj)
ZDUHISHËM (i, e) **mb.** fuqishëm, rrëmbyeshëm, furishëm; i madh, pehlivan. (Vuthaj)
ZEBANI-A **ef. sh.** - grup i madh i njerëzve…Ishin zebani e madhe! (Vuthaj)
ZGËRLYQ-I **em. sh-e** luginë e ngushtë dhe e gjatë midis sukave, në Vuthaj.
ZGËRLYQ/E **mb.** luginë e ngushtë dhe e gjatë midis sukave. *Âsht bâ zgërlaq ai ven.* (Vuthaj)
ZGIEDH **f.** zgjedh; zgjidh. (Vuthaj)
ZGROFULLIM-I **em.sh.-e** i lodhur nga shëndeti i ligë…(Vuthaj)
ZGRUFULLUEM (i, e) **mb.** i (e) lodhur nga uria; i hapur sysh nga uria e madhe; i dobësuar në fytyrë nga ndonjë sëmundje. (Vuthaj)
ZOGJOJ **f.** vërej me kujdes, shikoj si po shkon puna. (Vuthaj)
ZOJ **esh.** Zogj. (Vuthaj)
ZOLLUM **em. sh.-e** (turq.) zullum, dëm. (Vuthaj)

ZH

ZHAB/Ë-A **ef. sh.-a** (*sllav.*) thes prej lëkurës së dhisë. (Vuthaj)
ZHAG/Ë-A **ef.** copë mishi pa muskuj e eshtra. (Vuthaj)
ZHBIJ f. nxjerr (shkul) një dru me gjithë rrënjë. *E kam çfarosë.* (Vuthaj)
ZHDRIP **f.** zbres. (Martinaj, Vuthaj)
ZHDRIS **f.** shndris, ndriçoj. (Vuthaj)
ZHELAN **mb.** njeri i veshur me rroba lecka-lecka. (Vuthaj, Martinaj, Hakaj, Kukaj, Pepaj, Arzhanicë, Hoti i kujit))
ZHEVAR-I, **em. sh.-** bar që rritet në livadhe me lagështi, pranë liqenit të Plavës.
ZHELEPOL, **mb.** lecka-lecka, me arna gjysmë të qepur.
ZHIG-U **em. sh.-a**, e bloza e kusisë; shenja nga bloza në trup (Vuthaj)
ZHIGOJ **f.** Nxij fytyrën ose ndonjë pjesë tjetër të trupit me thëngjill. (Vuthaj...)
ZHUGAN-I **mb.** njeriu me zgjebe; zgjeban. (Vuthaj...)
ZHUJ/Ë-A **ef.sh.-a** dele me faqe bojëkafe. (Vuthaj)
ZHUJAN-I **em.sh.-a** dash me faqe bojëkafe, në të kuqe.(Vuthaj)
ZHUJAN **mb.** dash me faqe bojëkafe, në të kuqe. *Je bâ zhujan.*(Vuthaj)
ZHYLLAN-I **mb.** njeri i pistë, i papastër, i leckosur dhe i papastër. (Vuthaj...)
ZHVARITEN **f.**. rrallohen retë; hiqen retë; kthjellet moti

HISTORI

Mr. Riza REXHA

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

(130-vjetori i themelimit - 10. 6. 1878 – 10. 6. 2008)

Rrethanat ekonomike shoqërore, politike e kulturore në trevat shqiptare para themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Koncepti i '*territorit shqiptar*" si një problem politik, historik në procesin e formimit e të konsolidimit të popullit shqiptar, në fillim si *kombësi* e më vonë si *komb*, është pasqyrim i zhvillimit ekonomik e shoqëror, politik e kulturor, i luftës shekullore për liri e pavarësi dhe për krijimin e shtetit shqiptar.

Populli shqiptar, si pasardhës i ilirëve të cilët njihen si banorë të lashtë të Ballkanit, e gëzon plotësisht të drejtën e autoktonisë, të drejtat e tija historike mbi trojet ku u krye etnogjeneza e popullit shqiptar, në fillim si bashkime të qëndrueshme fisesh e më vonë në kombësi e komb.

Territoret etnike shqiptare u formuan gjatë shekujve dhe populllsia që banonte në këto territore i përvetësoi duke u shtrirë plotësisht në to dhe u krijua bindja e plotë se "mëmëdheu" është i lidhur me fatin e popullit, krijohet bindja jo vetëm e përkatësisë etnike e kombëtare, jo vetëm gjuhësore e kulturore, por edhe territoriale. Fatet e zhvillimit etnik e kombëtar të shqiptarëve u lidhën ngusht me ruajtjen e bashkësisë dhe tërësisë territoriale. Historikisht u krijua ajo tërësi të drejtash që pati dhe ka populli shqiptar mbi ato territore ku ai ka qenë shtrirë gjatë shekujve dhe që mbetën të drejta të tija historike të ushtronte sovranitetin e plotë e të pakufizuar. Mbi këtë bazë lindi patriotizmi i shqiptarëve, që

u bë gjatë shekujve një nga forcat kryesore lëvizëse në luftë kundër agresorit të huaj që u përpoqën t'i marrin nëpër këmbë të drejtat historike të popullit shqiptar mbi trojet e tij .

Populli shqiptar i ngulur në toka, që historikisht morën emrin "*troje shqiptare*" ka ato të drejta historike siç i ka çdo popull, në territorin ku u formua e konsolidua si kombësi e më vonë si komb.

Në procesin e zhvillimit ekonomik e shoqëror, politik e kulturor u krijuan gjatë shekujve kufijtë etnikë midis popujve, kufij të cilët më vonë u shndërruan edhe në kufij midis tërësisë së territoreve kombëtare. Në trojet shqiptare nga brezi në brez trashëgohej dhe pasurohej përvoja e prodhimit, zakonet, veshja, rregullat e organizimit shoqëror e politik, kultura e arti në specifikën e vet etnike shqiptare.

Në kushtet historike të shthurjes së rendit feudal, lidhjes midis pjesëve të veçanta të një vendi ku jetonte një popull u forcuan mjaft.

Në kushtet e zhvillimeve ekonomiko-shoqërore kapitaliste, u krijua një lidhje më e ngushtë midis krijimit të shtetit borgjez dhe përcaktimit të kufijve shtetëror e atyre kombëtarë, si edhe e përcaktimit më të qartë e më të plotë të kufijve të trojeve kombëtare. Kombi është *sovran* mbi tërë territorin që i përket dhe kjo kërkon vendosjen e kufijve shtetërorë në përputhje me përkatësinë kombëtare të territoreve. Territori shpallej pronë e kombit.

Populli shqiptar si një bashkësi kompakte etnike kaloi nëpër shekuj në luftë me armiq të shumtë

Qysh nga pranvera e vitit 1382 kur hordhitë turke depërtuan për herë të parë në territorin shqiptar, deri në pranverën e vitit 1878, kur u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, kishin kaluar gati 500 vjet. Gjatë këtyre shekujve sundimi osman nuk qe asnjëherë i qetë. Çdo brez derdhi gjakun dhe djersën e vet për të shkundur robërinë turke dhe zgjedhën feudale, për të mbajtur gjuhën amtare dhe traditat popullore, për të zhvilluar mendimin shoqëror dhe ndërgjegjen e pavarësisë. Lëvizjet e armatosura dhe të paarmatosura, me të cilat është e ngjeshur historia e këtyre shekujve, nuk patën kurdoherë të njëjtin karakter dhe të njëjtën shtrirje. Përmbajtja dhe rezultatet e tyre u përcaktuan nga struktura ekonomike, nga fizionomia shoqërore, nga niveli kulturor, nga detyrat politike dhe nga rrethanat ndërkombëtare që ekzistonin në periudhën kur ata u zhvilluan.

Struktura ekonomike dhe shoqërore në trevat shqiptare kishte pësuar ndryshime. Regjimi feudal ushtarak i timarëve ishte suprimuar përfundimisht që në vitet '30. Vendi po ecte në rrugën e marrëdhënieve kapitaliste. Borgjezia industriale në qytet dhe borgjezia agrare në fshat ende nuk ishin formuar si forca shoqërore me peshë. Masat popullore si masa të shtypura dhe të shfrytëzuara, nuk kishin asnjë interes për të qëndruar në suazën e Perandorisë Osmane ose për të hyrë nën zgjedhën e një shteti tjetër të huaj. Shtresat e gjëra fshatare dhe qytetare qenë bërë mbështetja kryesore e Rilindjes Kombëtare shqiptare, e cila synonte ta çlironte krejtësisht atdheun nga zgjedha shekullore osmane dhe të formonte një shtet kombëtar shqiptar të pavarur, demokratik.

Në kohën kur proceset e brendshme ekonomike dhe shoqërore po e shtynin popullin shqiptar drejt luftës për çlirim kombëtar nga zgjedha shekullore e huaj, Perandoria Osmane po e forconte më tepër zgjedhën e saj perandorake.

Shekulli XIX, ashtu siç kishte ndodhur edhe në vende tjera të Evropës, kishte sjellë ndryshime rrënjësore në trevat shqiptare. Lindja e marrëdhënieve të reja kapitaliste, lidhja e krahinave midis tyre, shkrirja e tregjeve lokale në një treg të përbashkët kombëtar, kishin krijuar një bashkësi të vetme ekonomike, që krahas ekzistencës së bashkësisë së gjuhës e të territorit, kishin çuar në formimin e kombit shqiptar ku çdo veprim me karakter ekonomik, politik e kulturor merr dimensione dhe ka një vulë të qartë kombëtare.

Kjo dukuri vihet re edhe në kryengritjet e mëdha popullore të viteve 30-70 të shekullit XIX të drejtuara kundër pasojave shkatërrimtare të reformave turke të Tanzimatit dhe kundër administratës së korruptuar burokratike që Porta e Lartë u orvat të vendoste në trevat shqiptare. Këto kryengritje e pasqyrojnë në mënyrë të qartë ndryshimin rrënjësor që kishte ndodhur në procesin e zhvillimit historik të popullit shqiptar. Këto kryengritje mishëruan një ide tepër të rëndësishme, atë të dallimit të kombësisë shqiptare. Këto dëshmojnë se në trevat shqiptare ekziston një komb dhe një ndërgjegje e formuar kombëtare.

Kuadri që u paraqit në vitet 30-70 të shekullit XIX, karakterizohet nga acarimi i mëtejshëm i konfliktit osmano-shqiptar që nxori në shesh elemente të reja, sasiore dhe cilësore. Në këto kryengritje merrnin pjesë të gjitha shtresat e popullit shqiptar çka i bënte ato në fakt kryengritje të përgjithshme të shqiptarëve si një tërësi kombëtare. Ato shpërthyen njëra pas tjetrës, në të njëjtat vite, kundër të njëjtit armik, për të njëjtat kërkesa e qëllime. Këto rrethana u bënë shkak që të realizoheshin forma

organizative më të larta, për t'u gjetur forma organizimi politik-ushtarak, forma më të qëndrueshme. Deri në pragun e Lidhjes nuk u arrit ende një organizim i tillë unitar i gjithë kësaj lëvizjeje. Kërkesa për të përjashtuar nga zbatimi i politikës së centralizimit burokratik në tokat shqiptare, donte të thoshte në fakt zbatimin e një statusi të veçantë për territoret shqiptare.

Këto lëvizje të viteve 30-50, ku rolin kryesor e luanin masat popullore, përbëjnë fazën e parë përgatitjeje të asaj epoke të re e cila me emrin *Rilindja Kombëtare Shqiptare*, realizoi detyrën historike të shekullit XIX - çlirimin e popullit shqiptar nga robëria feudale osmane, krijimin e shtetit të pavarur, si kusht për zhvillimin e tij të mëtejshëm ekonomik shoqëror. Kërkesat që kishin shtruar kryengritjet popullore mbetën në fakt edhe më tej në rendin e ditës, përtej viteve 1878-1881. Në vitet e Lidhjes ato gjetën rast për të shpërthyer me forcë të re. Ato përbëjnë atë lëvizje masive që zhvillohet përsëri në të gjitha krahinat shqiptare. Urrejtja shoqërore kundër shfrytëzuesit e nxiste edhe më tepër urrejtjen kundër sundimtarit të huaj, kur ky, pa pikë ngurrimi, po nxirrte në ankand pasurinë e parë dhe kryesore të popullit, truallin, tokën e tij, duke përdorur të njëjtën dhunë. Në këtë pikë përputheshin interesat shoqërore dhe ato kombëtare të masave popullore me ato të borgjezisë kombëtare. Në momentin e caktuar historik, në këtë front u tërhoq edhe klasa çifligare, e mënjanuar nga pushteti politik, e kërcënuar edhe ajo nga rreziku i përbashkët i humbjeve territoriale. Këtij fronti të gjerë forcash shoqërore i shërbeu programi i paraparë nga aktivistët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ky program arriti përcaktimin e objektivave dhe të rrugëve konkrete për realizimin e tyre, në pragun e Lidhjes dhe gjatë viteve të veprimtarisë së saj.

Lëvizjet e armatosura që shpërthenin pa ndërprerje, deri në pragun e Lidhjes, nxorën në shesh edhe pyetjen se ç'farë duhej bërë? Nuk është kurrsesi e rastit, që të gjithë ideologët e Lëvizjes Kombëtare, duke filluar nga Jubani, Pashko Vasa e deri te Sami Frashëri, e nisin pikërisht nga këto ngjarje fillimin logjik për konsideratat e tyre në lidhje me rrugën historike e me platformën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Përgjigjen u përpoq t'ua jepte këtyre pyetjeve një brez, i cili doli në arenën historike pikërisht në këtë fazë të re.

I pari që e njohin me emër ndër figurat e ideologëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, është Naum Veqilharxhi, i cili thoshte se *ka ardhur koha që t'i flakim të gjitha paragjykimet e vjetruara, ka ardhur koha që të kërkojmë udhë duke marrë shembull kombet e përparuara*.

Armët mendore për zgjidhjen e këtyre detyrave, përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje të re, i morën nga arsenali i ideve që u ofronte koha.

Rritja e zgjerimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare shtronte si detyrë gjithnjë e më urgjente, krijimin e një qendre organizative unike. Formimi i shoqërive e komiteteve të veçanta në Shkodër e sidomos jashtë atdheut, në Stamboll, në Bukuresht, në kolonitë arbëreshe të Italisë, qenë një fillim që arriti të realizohej në plan mbarëshqiptar vetëm me 1877, me krijimin e *Komitetit të Stambollit* dhe nën kujdesin e tij, të *Komitetit Qendror të Lidhjes në Prizren* dhe me degët e komitetit të saj lokale në gjithë krahinat e banuara prej shqiptarëve.

Kriza Lindore e viteve 1875-1878

Çështja lindore është quajtur herë-herë "*çështja diplomatike par exellence*" tipike e shekullit XIX. Kjo do të thotë se "*çështja lindore*" përbën boshtin kryesor të të gjitha aleancave më të mëdha diplomatike në Evropë gjatë gjithë shekullit XIX e më parë. Ne mënyrë paradoksale kjo e deformoi problemin e vërtetë, sepse çështja e Ballkanit, në thelb një çështje kombëtare, u inkuadrua në vijat më të gjëra të interesave politike e strategjike të Fuqive në Lindje, përgjithësisht u shkri dhe u shndërrua në "çështjen lindore" si çështje më e madhe e diplomacisë evropiane, me pasoja dëmprurëse për procesin e emancipimit të plotë të kombeve ballkanike nën Turqinë.

Gjatë Krizës Lindore 1875-1878, Perandoria Osmane hyri në një krizë të thellë ekonomike, politike dhe shoqërore. Asaj i kërcënohej rreziku i shpërbërjes dhe copëtimit. Përpjekjet që me reforma të ndryshme administrative t'i shmangej shpërbërjes e t'i forconte pozitat e luhatura ishin të kota. Fati i trashëgimit të tokave, që Perandoria Osmane mbante në këtë rajon, si dhe vet çështja ballkanike, tërhoqi vëmendjen e Fuqive të Mëdha dhe shteteve fqinje. Është e qartë se interesimi i politikës evropiane për Ballkanin është më i hershëm, mirëpo, për të realizuar qëllimet e saj, politika evropiane bëhet më dinamike, më agresive e me brutale në këtë periudhë. Fuqitë e Mëdha, edhe kur deklaronin se ishin për ruajtjen e status quo - së, edhe kur pretendonin se ndihmonin luftën e popujve të shtypur, në të vërtetë kërkonin drejtpërdrejtë fitime territoriale për vete ose tentonin të siguronin, nëpërmes aleatëve të tyre, monarkive të reja ballkanike, baza politike-strategjike për depërtim të mëtejshëm në Ballkan. Politika e Fuqive të Mëdha ishte një kompleks i tërë me

manovra diplomatike, kërcënime ushtarake e premtime mashtruese. Qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj Perandorisë Osmane nuk ishte i njëjtë. Anglia dhe Franca përpiqeshin ta mbanin në këmbë Perandorinë e dobësuar Osmane duke u nisur nga interesat e tyre për të vendosur mbi te kontrollin e plotë ekonomik e politik dhe për ta grabitur atë sistematikisht. Austro-Hungaria ishte kundër formimit të një shteti të madh sllav në Ballkan. Megjithatë, për çështjen e Krizës Lindore dhe për Ballkanin, prej Fuqive të Mëdha më të interesuara ishin Rusia dhe Austro-Hungaria, ambiciet, planet dhe konkurrenca e së cilave ka një traditë qindravjeçare.

Rusia cariste ndiqte rrugën e shembjes së Perandorisë Osmane për t'u zmadhuar në kurriz të saj dhe me pretekstin e mbrojtjes së interesave të popullsisë sllave e të krishtera në Ballkan, të vendoste hegjemoninë e saj në këtë zonë. Në projektet që hartonte për rregullimin e ardhshëm të Turqisë evropiane, shqiptarët nuk i llogariste fare. Gadishulli Ballkanik ishte për Rusinë një territori greko-sllav, i cili duhej t'i nënshtrohej vetëm influencës ruse. Sipas saj, së pari do të forcohej ndikimi rus në Ballkan, e pastaj, dalëngadalë, do të dominojë në këtë rajon. Brenda këtij kuadri vepronin edhe monarkitë ballkanike të mbështetura nga Rusia. Politika nacionale e tyre fillon të konfrontohet me rastin e ndarjes së trashëgimisë turke në Ballkan. Borgjezitë e këtyre vendeve kishin hequr dorë me kohë nga idealet çlirimtare e demokratike dhe kishin hartuar projektet e një politike ekspansioniste që i kalonte caqet e bashkimit të tyre kombëtar dhe që synonte të krijonte shtete të mëdha në kurriz të popujve të shtypur e sidomos të popullit shqiptar. Faktikisht, gjatë Krizës Lindore shtetet fqinje që kishin mjaft divergjenca midis tyre, dolën si një bllok në synimet për të copëtuar tokat shqiptare. Kjo periudhë për popujt e Ballkanit është epokë e zhvillimit të vetëdijes kombëtare. Lëvizja e popujve të shtypur të Ballkanit për çlirim kombëtar e shoqëror ishte në rritje.

Edhe populli shqiptar, që ishte në kuadër të Perandorisë Osmane, kaloi nëpër faza të zhvillimit shoqëror-ekonomik, nëpër të cilat kalonte edhe tërë pjesa evropiane e Perandorisë Osmane. Hendeku midis masave të gjëra dhe pushtetit feudal turk thellohej gjithnjë e më shumë. Shqiptarët ndihmuan për dobësimin e mëtejshëm të Perandorisë Osmane. Ngjarjet në trojet shqiptare ishin një hallkë në luftën e përbashkët të popujve të Ballkanit për çlirimin nga autokracia e Portës. Si një bashkësi territoriale, gjuhësore dhe historike, shqiptarët përbënin një unitet, i cili kishte interesa ekonomike, politike e kulturore të përbashkëta, pavarësisht nga ndarja në krahina apo në tri fe rivale e përçuese ndikimesh politike e kulturore

të huaja. Tek shqiptarët zotëronte parimi: *shpata para – feja prapa*, theksonte një udhëpërshkrues dhe shkencëtar anglez. Shqiptarët jo vetëm të krishterët, por edhe myslimanët, deklaronin se nuk duhej të luftonin për ruajtjen e Turqisë po qe se do të shpërthente një luftë e përgjithshme në Ballkan. Lufta e popujve të shtypur ishte faktori shpërthyes kryesor që e çoi Perandorinë në shembje. Porta e Lartë me represalie, me detyrime agrare dhe tatimore si dhe me pasiguri personale shkaktoi një vlim pakënaqësie në Ballkan.

Kontradiktat e thella ekonomike, shoqërore dhe politike që ekzistonin prej kohësh midis popullit të shfrytëzuar dhe pushtuesit turk, paraqitnin një konflikt i cili qëndronte i hapur dhe ishin shkak i lëvizjeve të fuqishme anti-turke. Mjaftonte vetëm një shkëndijë për t'i dhënë flakë gjendjes së krijuar. Kjo shkëndijë u bë kryengritja në Hercegovinë me 1875 e cila shpejt e përfshiu edhe Bosnjën, ndërsa në pranverë të vitit 1876 u përhap edhe në Bullgari. Lufta në Hercegovinë dhe Bosnje, si dhe nxitja nga Rusia, e shtynë Serbinë dhe Malin e Zi në një aksion të përbashkët kundër Turqisë. Kur hynë në luftë Serbia dhe Mali i Zi, Austro-Hungaria, e frikësuar se situata nuk do të zhvillohej në favor të saj, zgjodhi rrugën e një marrëveshjeje me Rusinë për caktimin e sferave të interesit. Ajo tentativë u paralajmërua në Rajhshtat (Çeki), me 8 korrik të vitit 1876, ndërsa në Konventën e Budapestit, me 15 janar 1877, u përkufizuan edhe obligimet dhe me këtë rast Rusia lejoi që Austro-Hungaria ta pushtonte Bosnjën dhe Hercegovinën, ndërsa Rusia të mos e ndihmonte formimin e një shteti të madh sllav në Ballkan. Rusia ishte në ballë të aksioneve të lëvizjeve kombëtare sllave dhe u dërgonte atyre edhe ndihmë financiare dhe ushtarake.

Edhe Rusia cariste, më 24 prill 1877 i shpalli luftë Turqisë. Kështu "Pika e Vogël e Zezë" në Hercegovinë, si e ka quajtur Bizmarku, është rritur në re të madhe dhe e ka turbulluar qiellin e kthjellët të diplomacisë evropiane. Ndërhyrja e Fuqive të Mëdha dhe shndërrimi i të gjitha çështjeve të brendshme të Perandorisë Osmane në çështje të politikës evropiane, e komplikonte dhe shpesh e nënvlerësonte luftën çlirimtare të vendeve ballkanike.

Turqia sulmohet në disa fronte. Ishte e qartë se ajo nuk ishte në gjendje t'i mbronte territoret që kishte pushtuar në Ballkan. Paraqitej rreziku i copëtimit të territoreve shqiptare. Shqiptarët e vlerësuan se ishte e arsyeshme të formohej një front i përbashkët anti-osman. Ekzistonin kushte objektive për bashkëpunimin midis popujve të Ballkanit për formimin e një fronti të bashkuar anti-osman dhe për një luftë të

përbashkët e cila do të mundësonte çlirimin e të gjithë popujve të Ballkanit. Mirëpo, kjo nuk ndodhi. Rrjedha e ngjarjeve tregoi se qarqet drejtuese të shteteve ballkanike e shfrytëzuan situatën e krijuar jo vetëm për të realizuar qëllimin e drejtë të çlirimit të bashkatdhetarëve të vet që gjendeshin ende nën zgjedhën e Perandorisë Osmane, por edhe për të realizuar planet ekspansioniste që kalonin caqet e bashkimit të tyre kombëtar dhe synonin kufijtë e shteteve mesjetare, ku përfshihej edhe pjesa më e madhe e tokave shqiptare. Qeveritë e këtyre shteteve nuk e shihnin shqiptarin si aleat, por të nënshtruar. As Fuqitë e Mëdha nuk u dhanë shqiptarëve ndonjë nxitje morale, aq më pak materiale në luftën e tyre çlirimtare. Ky zhvillim i ngjarjeve i bindi shqiptarët se ata nuk mund të përfitonin nga këta faktorë.

Lufta kundër Perandorisë Osmane zhvillohej në disa fronte

Kriza Lindore arriti pikën kulminante me Paqen e Shën-Stefanit. Rusia kishte pushtuar territore deri afër Stambollit. Anglia dhe Austro-Hungaria e kishin sinjalizuar Rusinë se nuk do të pranonin kurrfarë paqeje që nuk do të ishte në përputhje me interesat e tyre. Rusia duke mos përfillur Fuqitë tjera të Mëdha e as popujt e shtypur të Ballkanit, diktoi kushtet e paqes në Shën-Stefan, me 3 mars, 1878.

Në Shën-Stefan u murr vendimi që pjesë të mëdha të tokave shqiptare t'i jepeshin Serbisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë. Malit të Zi i jepeshin: Hoti, Gruda, Kelmendi, Vermoshi, Plava, Gucia, Rugova, Tivari, Ulqini, Ana e Malit e Kraja. Serbisë një pjesë e Sanxhakut të Prishtinës deri në afërsi të Gjilanit e Mitrovicës; Bullgarisë: Kumanova, Kaçaniku, Tetova, Kërçova, Gostivari, Dibra, Struga, Pogradeci, Korça etj.

Traktati i Shën-Stefanit i trajtonte në mënyrë më brutale interesat e shqiptareve.

Traktati i Shën-Stefanit ishte një akt ndërkombëtar që konfrontoi interesat e Fuqive të Mëdha dhe shënoi fillimin e copëtimit të trevave shqiptare në dobi të monarkive ballkanike.

Paqja e Shën-Stefanit tregoi qartë se copëtimi i tokave shqiptare ishte një rrezik real dhe i madh. Tokat shqiptare që parashiheshin t'u kalonin shteteve ballkanike në kuadrin e humbjeve që po pësonte Turqia, nuk çonin peshë për Turqinë, ndërsa për kombin shqiptar ato ishin humbje të mëdha, aq më tepër kur injorohej edhe ekzistenca e tij kombëtare. Paqja e Shën-Stefanit në realitet ka qenë vepër e Rusisë dhe aleatëve të

saj ballkanikë. Evropa vepronte me shqiptarët sikur ata të ishin një racë me turqit "shtetas të Turqisë", ndërsa territoret shqiptare si " pjesë e tokave të Turqisë" të cilat duhet të ndahen. Kalimi i tokave shqiptare nga zgjedha turke në një zgjedhë të re ndikoi në shpërthimin e protestave ku dënoheshin me urrejtjen më të madhe vendimet e Shën Stefanit. Protestat ishin shprehje e vullnetit të popullit për mbrojtjen e tokave të veta dhe njohjen e kombit shqiptar, si dhe shprehje e ndjenjës së urrejtjes kundër Portës së Lartë. Në protesta, në mes të tjerash thuhej: "…pëlqejmë të asgjësohemi sot duke mbajtur nderin dhe lirinë tonë, prandaj kemi vendosur të mos biem në skllavërinë e Malit të Zi."

Në memorandumin e shqiptarëve kundër Paqes së Shën Stefanit dërguar më 1 prill 1878, theksohej: "Aneksimi i krahinave Malit të Zi…vende këto që janë të banuara që nga kohërat e lashta nga shqiptarët të cilët ndryshojnë qenësisht për nga gjuha, origjina, kostumet, traditat dhe religjionet, nuk do të ishte vetëm një padrejtësi pikëlluese, por më tepër një veprim i pavend…shqiptarët, qoftë të besimit mysliman apo të besimit katolik, nuk do t'i nënshtrohen sundimit të ndonjë shteti sllav…Raca, gjuha, krenaria kombëtare është kundër një gjëje të tillë…"

Më 30 maj 1878, Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave Kombëtare Shqiptare, i bëri thirrje popullit:…"*Atdheu ynë është një dhe i pandarë…Ne dëshirojmë me gjithë zemër të jetojmë në paqe me mbarë fqinjët tanë, Malin e Zi, Serbinë, Greqinë etj. Nuk duam dhe nuk kërkojmë asgjë prej tyre, por jemi krejt të vendosur që ta mbajmë atë që është e jona. T'u lihen shqiptarëve tokat shqiptare*…"

Sami Frashëri shprehej: "*Me tokën tonë amtare nuk mund të luhet, ajo është e shenjtë. Nuk duam gjënë e tjetrit, por s'duam të lëmë edhe gjënë tonë.*"

Themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Vendimet e Shën Stefanit mbetën vetëm në letër, sepse me një projekt të tillë nuk u pajtuan Fuqitë e Mëdha evropiane rivale të Rusisë, të cilat kurrsesi nuk mund të lejonin forcimin e dominimit të Rusisë në Ballkan. Ata kërkuan që të rishqyrtoheshin të gjitha hollësitë e Paqes së Shën Stefanit. Pas marrëveshjeve të fshehta, Fuqitë e Mëdha, në mënyrë që të fitonin beneficione të tjera duke siguruar edhe pjesë nga territoret që mbante Turqia, u përcaktuan që më 13 qershor 1878 ta thirrnin Kongresin e Berlinit.

Gjendja e re që u krijua, vërtetë i dha një shtytje të fuqishme lëvizjes kombëtare shqiptare, por i ndërlikoi së tepërmi detyrat që qëndronin para saj. Krahas Perandorisë Osmane që mbetej armiku shekullor, populli shqiptar duhej të përballonte në praktikë, në fushën e luftës, armiq të rinj e të fuqishëm. Lufta në shumë fronte shtoi detyra të reja politike dhe organizative dhe nevojën e formulimit të një strategjie e taktike politike të tillë që të merrte parasysh raportin e ri të forcave dhe të lejonte manovrimin me shkathtësi në labirintin e interesave kontradiktore të Krizës Lindore. Kjo kërkonte në radhë të parë, të bëhej hapi i ri i domosdoshëm që kishte munguar më parë: të krijohej një forum drejtues që të përfaqësonte gjithë kombin për të zhvilluar veprimtarinë e nevojshme politike brenda dhe jashtë shtetit. Këtë detyrë e kreu "Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare" që u formua në Stamboll më 1877dhe ku morën pjesë mendjet më të ndritura shqiptare të kohës si: Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj. Memorandumet e tij drejtuar Fuqive të Mëdha i bënë të ditur botës interesat dhe aspiratat e kombit shqiptar, kërkesat për njohjen e tij, për mos prekjen nga askush të trojeve të tij dhe për të bashkuar në një njësi të vetme administrative autonome shqiptare.

Lufta në dy fronte kundër armiqve të shumtë shtroi përpara Komitetit problemin e aleatëve të mundshëm të popullit shqiptar në luftën e tij për çlirim dhe bashkim kombëtar. Thirrjet për bashkëpunim nuk mund të gjenin jehonë pozitive, kur politikën në Ballkan e bënin Fuqitë e Mëdha dhe monarkitë reaksionare ballkanike. Mbetej vetëm një mbështetje në luftën për realizimin e programit kombëtar. Në këto kushte, qendra e lëvizjes do të kalonte brenda në Shqipëri, ku duhej bërë një organizim i ri modern i forcave popullore, duhej nxjerrë nga gjiri i tyre një udhëheqje e vetme kombëtare.

Për këtë qëllim, u themelua në Prizren më 10 qershor 1878 Lidhja Shqiptare me përfaqësues të shtresave e të viseve të ndryshme të atdheut.

Lidhja e Prizrenit është e para organizatë politike mbarëshqiptare, një organizatë që ka jo vetëm një platformë ideologjike, kombëtare e një program të caktuar qartë politik, por edhe një organizëm shtetëror në shkallë kombëtare, një ushtri të sajën dhe një aparat propagandistik e kulturor të vetin. Ajo veproi si përfaqësuese e vetme e gjithë popullit jo vetëm brenda vendit, por edhe ndaj botës së jashtme , qeverive të huaja e organizmave ndërkombëtare. Programi i saj shprehte kërkesat themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare: njohjen e kombit shqiptar si një e të pandarë, ruajtjen e paprekshmërisë e të tërësisë së trojeve kombëtare

dhe bashkimin e tokave shqiptare në një shtet të vetëm kombëtar. Nën flamurin e luftës së Lidhjes për çlirim kombëtar, u bashkuan pa dallim krahine e feje zemrat e armët e masave patriotike. Ky s'qe një program që mbeti në letër. Programi u shpreh në protestat e memorandumet , në programet politike-ideologjike që dolën nga pena e udhëheqësve e ideologëve të shquar të Lidhjes. Ai u vu në jetë në llogoret e luftës për mbrojtjen e trojeve të atdheut në Plavë e Guci, në Hot e Grudë, në Ulqin e në jug, në mobilizimin e masave popullore për të dëbuar administratën e urryer osmane, për t'ua dhënë pushtetin organeve të Lidhjes si organe të vetësundimit autonom të vetëligjësisë kombëtare.

Me formimin e Lidhjes mori një shtytje e zhvillim të mëtejshëm edhe mendimi politik shqiptar. Me zhvillimin e stuhishëm të ngjarjeve, Lidhja Shqiptare u forcua organizativisht e fitoi një autoritet në mbarë vendin.

Kongresi i Berlinit që u mblodh në 13 qershor 1878, për të rishikuar Traktatin e Shën-Stefanit në favor të Fuqive të Mëdha perëndimore jo vetëm e mohoi qenien e kombit shqiptar, por edhe vendosi copëtimin e pjesëve të truallit amtar, në favor të shteteve fqinjë. Lidhja mori ne duart e veta fatin e kombit duke deklaruar në arenën ndërkombëtare se kurrkush nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi tokat e banuara prej shqiptarëve e t'i bënte ato monedhë këmbimi dhe se zot i vetëm i tyri ishte populli shqiptar.

Përkatësia kombëtare e territoriale të banuara nga shqiptarët mbështetej në konsiderata historike dhe aktuale. Në përcaktimin e karakterit historik të territoreve shqiptare, Lidhja nisej me të drejtë nga fakti se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve.

Lëvizja e viteve 1878-1881 është një lëvizje për çlirimin e bashkimin kombëtar

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka meritën e madhe se mbrojti kombin shqiptar. Lidhja bëri një luftë të madhe për t'ua bërë të qartë jo vetëm Fuqive të Mëdha që ishin mbledhur në Berlin, por mbarë opinionit publik evropian se shqiptarët përbëjnë një komb me vete e të formuar, ka një histori të lashtë, që ka gjuhën e kulturën e tij, që ka dhënë kontributin e vet në qytetërimin evropian.

Luftërat e shqiptarëve për njohjen e kombësisë, për të qëndruar në tokat ku kanë lindur të parët e tyre, për gjuhën e kulturën shqipe, për

ruajtjen e traditave e të individualitetit kombëtar, nuk i kanë sjellë dëm askujt, nuk kanë cenuar të drejtat e ndonjë kombi apo populli tjetër.

Lidhja Shqiptare e mbështetur në parimin e kombësisë duke parashtruar argumente historike, etnografike, ekonomike, kulturore proteston pranë Fuqive të Mëdha kundër copëtimit të tokave shqiptare duke theksuar se shqiptarët do t'i mbrojnë ato me luftë deri në vdekje. "Shqipëria…thuhet në protestë, nuk mund të mendojë kurrë që Traktati i Berlinit të bëhet shkak për copëtimin e territorit të vet, në mënyrë të atillë që do të kishte si pasojë për humbjen e të drejtave më të pashlyeshme të një kombësie me tipare më të karakterizuara më së miri…" Populli shqiptar, thuhet në një protestë tjetër, numëron dy milionë e treqind mijë frymë. Përpara lakmive të egra të fqinjëve të tyre dhe rreziqeve që u kërcënohen, këto popullsi atdhedashëse, janë bashkuar të gjitha midis tyre me një betim solemn që, me përpjekje të përbashkëta të ruajnë…atdheun e tyre, kombësinë e tyre, gjuhën e tyre."

Në një protestë tjetër thuhet:"…Kemi nderin të shpallim se kombi shqiptar, qoftë mysliman qoftë katolik, që ndryshon aq shumë prej sllavëve si nga kombësia ashtu edhe nga feja, është njëzëri i vendosur të mbrojë atdheun e vet, është kundër ndarjes së territorit që është projektuar si një veprim në kundërshtim me historinë…Ne ju lutemi të mbroni tërësinë tonë kombëtare dhe territoriale."

Abdyl Frashëri theksonte:"Shqiptarët kanë ruajtur atdheun e tyre, kombësinë e tyre, gjuhën dhe zakonet e tyre duke zmbrapsur në kohët barbare sulmet e romakëve, të bizantinëve, venedikasve. Si mund të lejohet që në këtë shekull të diturisë dhe të qytetërimit një komb kaq trim dhe aq i lidhur me truallin e tij të sakrifikohet".

Sami Frashëri shprehej: "Me tokën tonë amtare nuk mund të luhet, ajo është e shenjtë. Nuk duam gjënë e tjetrit, por s'duam të lëmë edhe gjënë tonë". Kur Fuqitë e Mëdha të Evropës nuk i dëgjuan vërejtjet e shqiptarëve, Abdyl Frashëri iu drejtua me fjalët:"Puna juaj me Traktatin e Berlinit mbaron, puna jonë si shqiptar nga kjo ditë fillon".

Roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare

Lidhja e Prizrenit shënon një etapë të re në zhvillimin e kulturës kombëtare demokratike. Ajo ndikoi drejtpërdrejtë që të zgjidheshin një varg çështjesh imperative qe kishin të benin me zhvillimin e kësaj kulturë.

Duhej të përcaktohej një alfabet unik për zhvillimin e arsimit kombëtar, për zgjerimin e botimeve të ndryshme letrare, publicistike, politike, arsimore etj. Hovi që mori në këtë periudhë shkrimi shqip, letërsia artistike e politike, gazetaria e përkthimet dëshmojnë për rëndësinë tepër të madhe që kishte faktori kulturor krahas atij politik, diplomatik e ushtarak. Qysh në ditët kur zhvilloheshin betejat luftarake të Lidhjes, problemi i gjuhës shqipe u shtrua dhe u konsiderua si një strumbullar e lëvizjes kombëtare, si një faktor që i çimentonte unitetin e jetës shpirtërore të kombit, si një shprehje e origjinalitetit të kulturës kombëtare dhe si armë e luftës për liri e pavarësi.

Fryma patriotike dhe demokratike e lëvizjes kombëtare shqiptare të periudhës së Lidhjes së Prizrenit u ndie me forcë të veçantë dhe në literaturën artistike dhe publicistike të kohës. Formimi i shoqërisë së Shkronjëzave në Stamboll me 1879, hartimi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe botimi i teksteve shkollore i dhanë një shtytje të madhe përhapjes të mësimit te gjuhës shqipe.

Krijimtaria letrare dhe publicistike e burrave të shquar te penës, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Jani Vreto, Thimi Mitko, Jeronim De Rada, Koto Hoxhi etj ka pasur atë rëndësi dhe ka qenë aq e vlefshme sa edhe lufta me pushkë.

Rritja e interesimit për vlerat e kulturës popullore, veçanërisht, të folklorit, njohja më e mire e traditave të lashta dhe historisë së popullit, shpërthimi i bujshëm i krijimtarisë gojore dëshmojnë për influencën e madhe që ushtruan idetë e veprimtaria e Lidhjes për përparimin e kulturës kombëtare.

Duke analizuar gjendjen në trevat shqiptare, udhëheqësit e Lidhjes, të nisur nga kushtet konkrete historike të kohës, shtonin këto objektiva:

- përballë poetikës shkombëtarizuese që ndiqnin shtetet fqinje nëpërmjet shkollave të tyre dhe përhapjes së gjuhëve greke, sllave e italiane – politikë që kishte sjellë pasoja të hidhura në shkombëtarizimin e shqiptarëve, në thellimin e përçarjes fetare, ata kërkonin zhdukjen e këtyre shkollave si vegla në shërbim të politikës shoviniste të fqinjëve, njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë kombëtare, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe krahas gjuhës zyrtare osmane e cila do të përdorej në marrëdhëniet me Portën e Lartë si dhe caktimin e një sasie të hollash nga të ardhurat e vendit si shpenzime për arsimin e popullit me qëllim që ky të qytetërohej e të pajisej me kulturë. Qeveria Osmane u mohonte shqiptarëve kombësinë, i ndante sipas kriterit fetar, duke identifikuar fenë me kombësinë, dhe si rrjedhim - gjuha shqipe nuk ishte future në shkolla.

Roli i Lidhjes së Prizrenit në ndërkombëtarizimin e çështjes së shqiptareve

Ndërmjet karakteristikave që dallojnë Krizën e re Lindore, është edhe fakti se çështja kombëtare në Ballkan përfshin tani si një pjesë përbërëse edhe çështjen shqiptare. Lidhur me këtë roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në arenën ndërkombëtare merr një rëndësi të veçantë.

Është fakt real, se çështja lindore nxjerr më shumë në dritë vlerën e veprës së Lidhjes së Prizrenit në aspektin diplomatik. Me veprimtarinë e saj Lidhja ia imponoi çështjen shqiptare vëmendjes së diplomacisë. Është e vërtetë se çështja shqiptare nuk figuroi si e tillë në traktativat rreth Krizës Lindore, as u përfshi në vendimet e Kongresit të Berlinit të korrikut 1878. Por, Lidhja iu kundërvu haptazi vendimeve të Fuqive të Mëdha dhe tregoi qartë se në veprën e tyre kishte një zbrazëti. Asnjë nga Fuqitë e Mëdha, as Rusia në Shën Stefan dhe as "koncerti evropian" në Berlin, nuk prisnin që dispozitat e marrëveshjeve të tyre lidhur me tokat shqiptare të ngjallnin një kundërveprim të tillë masiv si ai që i dha jetë e hov lëvizjes më të madhe politike të shqiptarëve gjatë shekullit 19-të. Kundërshtimi i popullsisë shqiptare edhe pse të paorganizuar në një shtet të vetin, u bë shkak ndërlikimesh të reja në Evropë dhe kjo u shty ta njohë çështjen shqiptare.

Në një kohë kur diplomacia evropiane nuk njihte formalisht as ekzistencën e një çështjeje shqiptare, nuk mund të pritej që ajo të njihte vetë Lidhjen, si bartëse dhe shprehëse e saj zyrtare. Krahas veprimeve të saj luftarake në frontet e mbrojtjes së tokave shqiptare, krahas aksionit të brendshëm politik për sqarimin dhe mobilizimin e masave popullore, Lidhja ka gjithashtu në aktivitetin e saj një veprimtari të caktuar në fushën e politikës së jashtme.

Në veprimtarinë diplomatike një nga këto probleme ishte ai i përkrahjes ndërkombëtare si një faktor me rëndësi për realizimin e dy kërkesave kryesore të Lidhjes: mbrojtjen e tokave shqiptare nga copëtimi dhe sigurimin e autonomisë. Në thirrjet, peticionet, mesazhet, protestat e shumta drejtuar Fuqive të Mëdha të Evropës, kjo çështje del me qartësi të mjaftueshme. Lidhja e shtriu veprimin e saj edhe jashtë kufijve të Perandorisë Turke, duke u përpjekur të sensibilizonte edhe opinionin publik evropian për çështjen shqiptare.

Dy dokumente përmbajnë konsiderata të hollësishme për politikën e jashtme, prej nga edhe mund të gjykojmë më mirë për aksionet diplomatike të Lidhjes Shqiptare. Është fjala për memorandumin që iu

dërgua nga Shkodra kryeministrit anglez Lordit Bikensfild, si kryetar i delegacionit të Anglisë në Kongresin e Berlinit më 13 qershor 1878, si dhe për telegramin që disa nga ideologët kryesorë të Lidhjes si Pashko Vasa, Sami Frashëri etj. i drejtuan ministrit të jashtëm të Austro-Hungarisë, Andrashi, po në Kongresin e Berlinit më 20 qershor 1878.

Veprimtaria diplomatike pas Kongresit të Berlinit për kundërshtimin e vendimeve territoriale që preknin tokat shqiptare është një aspekt tjetër themelor i Lidhjes së Prizrenit. Pa u ndalur në listën e gjatë të protestës, të thirrjeve për ndreqjen e padrejtësive, të deklaratave për denoncimin e grabitjeve, dëbimeve në masë dhe masakrave në viset e pushtuara, duhet theksuar se ato vinin nga shtresat dhe anët më të ndryshme, gjë që është një tregues i qartë se populli shqiptar është i ndërgjegjshëm për çastet historike që përjetonte. Krijohet në këtë mënyrë bindja se aksioni politik, dhe bile më specifik diplomatik, shoqëron hap pas hapi rezistencën e trupave të Lidhjes për mbrojtjen e integritetit të tokave shqiptare.

Për lëshimet territoriale në veri në favor të Malit të Zi, Kongresi i Berlinit përcaktoi disa dispozita të formës së prerë dhe ajo që shtrohej pas Kongresit ishte çështja e zbatimit të tyre. Lidhja duhet ta zhvillonte veprimin e saj kryesisht nëpërmjet kundërshtimit me forcën e armeve. Pa mohuar, madje duke i theksuar orvatjet në adresë të diplomacisë evropiane, duhet të pohohet pa asnjë dyshim se lufta e armatosur është momenti që mbizotëron në veprimin e Lidhjes për mbrojtjen e kufirit në veri, që nga ndeshjet e para në vjeshtën e vitit 1878 e deri në dorëzimin e Ulqinit në duar të Malit të Zi në nëntor 1880. Qëndresa me armë e Lidhjes Shqiptare u bë shkak për ndërlikime të reja diplomatike në shkallë evropiane, dhe si pasojë për zgjatjen e paparashikuar të Krizës Lindore.

Nga një memorandum qeverive: të Anglisë, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Italisë

Momentin kulminant në këtë drejtim e përbën padyshim udhëtimi i delegacionit të Lidhjes, të kryesuar nga Abdyl Frashëri në Evropë në pranverë të vitit 1879. Delegacioni vizitoi kryeqytetet e 5 Fuqive të Mëdha me përjashtim të atij të Rusisë dhe u dorëzoi në maj nga një memorandum qeverive: të Anglisë, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Italisë. Memorandumi fillohej me dënimin e veprës së Kongresit të Berlinit ku të drejtat e shqiptarëve u shkelën keqas dhe, me gjithë protestat e shumta, u shkëputën shumë toka shqiptare për t'ua dhënë Malit të Zi e Serbisë.

Lidhja shënon shkallën më të lartë të bashkimit të popullit shqiptar të realizuar në kushtet e sundimit otoman. Ky unitet shfaqet në të gjithë rëndësinë e tij si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Zëri që mbërrin në Evropë për të denoncuar padrejtësitë, për të shprehur vendosmërinë për kundërveprim, është zëri i të gjithë shqiptarëve. Abdyl Frashëri i bie kryq e tërthor gjithë vendit, ai është atje ku rreziku është më i madh, ku duhen marrë qëndrime dhe vendime me përgjegjësi. Atë e shikojmë në Stamboll të ndërhyjë pranë Portës së Lartë, në Ballkan dhe Evropë të zhvillojë bisedime me përfaqësues të shteteve fqinje dhe të Fuqive të Mëdha. Ai ishte një simbol i unitetit të mendimit e veprimit të Lidhjes Shqiptare.

Në veprimtarinë diplomatike të Lidhjes nuk është vështirë të ndiqet kjo vijë e autonomisë. Ky aspekt i çështjes shqiptare e çan rrugën në arenën ndërkombëtare.

Veprimtaria diplomatike e Lidhjes Shqiptare nuk siguroi përkrahjen ndërkombëtare si një faktor për realizimin e programit të saj. Asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk e llogariste ende çështjen shqiptare si një element të mundshëm të politikës së saj në Ballkan..

Aksioni diplomatik i Lidhjes Shqiptare bëri një shërbim të madh. Me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit çështja shqiptare doli në një dritë të re jo vetëm në kuadrin e brendshëm të Perandorisë Otomane, por edhe në planin ndërkombëtar. Për herë të parë Lëvizja Kombëtare Shqiptare hedh themelet për një politikë të jashtme të saj, si një sferë e rëndësishme e veprimtarisë së gjithanshme për realizimin e objektivave të afërta në perspektivë. Në qoftë se nuk arriti të sigurojë një pikëmbështetjeje në planin ndërkombëtar, ajo megjithatë vuri diplomacinë e Fuqive të Mëdha ballë përballë me problemin shqiptar. Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënoi fillimin e historisë diplomatike të shtetit shqiptar të kohës së re.

Rëndësia Historike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte një organizatë patriotike revolucionare me karakter politik dhe ushtarak, e cila veprimtarinë e saj e zhvilloi në kushtet e sundimit shekullor osman. Ajo lindi nga vrulli patriotik i masave popullore dhe udhëhoqi për tre vjet me radhë popullin shqiptar në luftë kundër prepotencës së Fuqive të Mëdha, agresivitetit të monarkive fqinje dhe brutalitetit të Portës së Lartë, për mbrojtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Për

herë të parë në historinë e popullit shqiptar, pas epokës së lavdishme të Skënderbeut, Lidhja i drejtoi e i bashkoi përrenjtë e lëvizjeve çlirimtare shekullore në lumin e gjerë të lëvizjes kombëtare që vërshoi i fuqishëm e i pandalshëm duke çare shtigje të reja e duke kapërcyer pengesa të panumërta që gjatë më shumë se katër shekuj robërie të rëndë ishin ngritur në rrugën historike të popullit shqiptar. Lidhja vërtetoi se populli shqiptar, si gjithë popujt tjerë, ruante energji të pashtershme dhe një vetëdije kombëtare që e ngritën në piedestalin e historisë si një komb me histori, tradita, gjuhë e kulturë të vetën, si një komb që me armë e me penë, me patriotizmin, vitalitetin e vendosmërinë e tij iu imponua, edhe pse i vogël dhe i vetëm, Fuqive të Mëdha kapitaliste e monarkive ballkanike fqinje.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u themelua dhe veproi në një nga çastet më dramatike që kalonte Shqipëria nën sundimin osman, në kohën kur Rusia cariste me Traktatin e Shën-Stefanit dhe pastaj Fuqitë e Mëdha me vendimet e Kongresit të Berlinit, jo vetëm nuk e trajtuan Shqipërinë si subjekt të drejtash kombëtare, por vendosën t'i copëtonin trojet e shqiptarëve në dobi të monarkive fqinje duke rrezikuar kështu ekzistencën e tyre si komb. Lidhja Shqiptare e Prizrenit mori përsipër detyrën e madhe historike: të bashkonte mbarë popullin shqiptar në luftë për të afirmuar identitetit e tij kombëtar në arenën ndërkombëtare, për të kundërshtuar copëtimin e trojeve amtare dhe për të realizuar detyrën madhore të Rilindjes - formimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Lidhja si lëvizje kombëtare, për nga karakteri e përmbajtja e saj nuk ishte një dukuri e veçuar as në rrafshin ballkanik dhe evropian. Lidhja ishte pjesë përbërëse e lëvizjeve çlirimtare kombëtare që karakterizonin historinë e Evropës dhe të Ballkanit në shekullin XIX.

Lidhja realizoi bashkimin e popullit shqiptar nën një udhëheqje të vetme dhe me një program të përbashkët kombëtar.

Kuvendi i Përgjithshëm i Prizrenit, nuk ishte si kuvendet e dikurshme, nuk kishte karakter ndërkrahinor, por përmasa kombëtare. Delegatët përfaqësonin të gjitha viset e atdheut. Kuvendi i Përgjithshëm i Prizrenit pati përballë jo vetëm armikun osman, por pengesa të jashtme dhe të brendshme. Ajo duhej të përmbyste vendimet e Kongresit të Berlinit, të thyente brutalitetin e Fuqive të Mëdha të Evropës, të përballonte ndërhyrjen ushtarake të monarkive fqinje. Lufta e Lidhjes kur Shqipëria jo vetëm nuk kishte aleat, por kishte shumë armiq, ishte me të vërtetë një luftë heroike. Vetëm një patriotizëm i flaktë, një qartësi mendimi, një besim i patundur në forcat e veta, një krenari kombëtare mund t'i ngrinte, ashtu siç i ngriti shqiptarët në luftë kundër armiqve. Meritë

historike e Lidhjes dhe guximit të saj, është fakti se ajo, e mbështetur në forcat ushtarake kombëtare, me përkrahjen e popullsisë, pa pritur miratimin e sulltanit e zbatoi autonominë në praktikë, zëvendësoi administratën civile dhe ushtarake turke. Përfaqësuesit radikalë të Lidhjes dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në tërësi, formimin e një shteti kombëtar autonom me shkëputjen e tij nga Perandoria osmane, nuk e shikonin thjeshtë si një akt formal administrativ, por si një kthesë që do t'i çelte rrugën përparimit ekonomik, shoqëror e kulturor të pavarur të vendit. Lidhja e Prizrenit i trajtoi të gjitha gjymtyrët e popullit shqiptar, pavarësisht nga dallimet fetare dhe nga pikëpamjet politike, nga përkatësia shoqërore dhe nga shpërndarja krahinore, si pjesëtare të një bashkësie të vetme kombëtare. Ndonëse sfidën e saj të parë Lidhja Shqiptare e Prizrenit e shpalli kundër Kongresit të Berlinit, pushkën e saj të parë ajo e shkrepi kundër Portës së Lartë me vrasjen e mareshal Mehmet Ali pashë Maxharit në Gjakovë. Ndonëse përfaqësonte një vend të vogël, të robëruar nga një zgjedhë shekullore, pa ushtri të organizuar, pa mjete financiare dhe pa përkrahje ndërkombëtare, ajo i detyroi Fuqitë e Mëdha të rishikonin tri herë me radhë vendimet e tyre të prera dhe nuk u vunë në jetë për shkak të rezistencës së Lidhjes. Lidhja e Prizrenit dhe udhëheqësit e saj kishin besim të patundur në forcën e popullit, në dashurinë e tij të zjarrtë për liri, në vendosmërinë e tij për t'u qëndruar tallazeve të historisë.

Lidhja e Prizrenit dhe ngjarjet e periudhës 1878-1881 e bënë të mundur që të kuptoheshin më mirë rreziqet që i kanoseshin vendit dhe të zbulohej politika antishqiptare e Fuqive të Mëdha evropiane dhe e monarkive fqinje. Veprimtaria politike, ideologjike dhe ushtarake e Lidhjes zgjoi dhe kaliti ndërgjegjen politike të mijëra dhe mijëra shqiptarëve, katundarë, malësorë e qytetarë, të cilët për tre vjet me radhë luftuan me guxim e vendosmëri kundër armiqve të shumtë e të fuqishëm. Lidhja realizoi në shkallë kombëtare bashkimin e popullit shqiptar, zbuloi forcën e këtij bashkimi. Ajo bëri një luftë të vendosur për kapërcimin e ndasive fetare, partikulariteteve krahinore e fisnore dhe bëri përpjekje për të bashkuar të gjitha masat rreth idealit kombëtar. Ideja e unitetit u përgjigjej interesave më të larta të atdheut dhe përfaqësonte aspiratat e masave më të gjëra, përfaqësonte armën më të fuqishme e më të sigurt me të cilën populli shqiptar mund t'u kundërvihej armiqve. Lidhja krijoi një front të gjerë të forcave patriotike të kombit, një bashkim që la gjurmë të pashlyeshme në mendimin politik dhe në veprimtarinë praktike të lëvizjes kombëtare gjatë gjithë periudhës të mëvonshme.

Gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Lëvizja Kombëtare

Shqiptare nuk u zhvillua vetëm në truallin politik, diplomatik apo ushtarak, por edhe në frontin e madh të kulturës. Në këtë front ajo nuk u zhvillua vetëm si lëvizje kombëtare për të fituar të drejtat kulturore të mohuara nga Porta e Lartë, por edhe si lëvizje ideologjike, e cila përfshin në diapazonin e vet si mendim politik, filozofik, shoqëror ashtu edhe veprimtarinë publicistike, letrare dhe shkencore të këtyre viteve.

Penat e kulturuara të këtyre viteve mendonin se robëria ka sjellë paditurinë kurse padituria ka forcuar vargonjtë e skllavërisë. Ata mendonin se këta vargonj mund t'i thyente vetëm dituria, vetëm kultura, por jo çdo dituri dhe jo çdo kulturë, por vetëm dituria dhe kultura që përvetësohen me arsimin në gjuhën amtare, në gjuhën shqipe. Sipas tyre emancipimi kulturor dhe politik i shqiptarëve kishte nevojë për një kulturë militante, kombëtare nga forma, patriotike nga ndjenjat, iluministe nga përmbajtja, rrjedhimisht për një shkollë shqipe laike dhe masive.

Shpërndarja e Lidhjes së Prizrenit

Pas një jete trevjeçare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp. Ajo u shtyp jo vetëm nga epërsia ushtarake e Perandorisë Osmane, por edhe nga ndërhyrja e Fuqive të Mëdha, pa mohuar dobësitë e saj të brendshme. Ajo u shtyp në pragun e realizimit të programit madhor të Rilindjes Kombëtare - autonominë e Shqipërisë. Përkundrazi, programi i saj politik që mbështeste programin madhor të Rilindjes Kombëtare nuk u shua. Platforma e saj politike mbeti në rend të ditës dhe vazhdoi të frymëzojë brezat e ardhshëm.

Lidhja e Prizrenit la gjurmë të pashlyeshme në historinë e popullit shqiptar, si një lëvizje e madhe politike për unitetin kombëtar, për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar. Ajo mbeti gjithmonë si shembull i madh frymëzimi dhe si pikë referimi për lëvizjen e mëvonshme të popullit shqiptar për liri e pavarësi kombëtare, sepse e kaluara nuk është thjeshtë një diçka e kaluar, ajo është pjesë përbërëse e së tashmes dhe i shërben së ardhmes.

Patriotët dhe luftëtarët e mëdhenj të Rilindjes Kombëtare Shqiptare nuk jetuan të shihnin frytet e veprës së tyre. Por, mundi dhe gjaku i derdhur nuk shkuan kot. Ata hodhën rrënjë e u mishëruan në përpjekjet e brezave të mëvonshëm që, duke ecur në gjurmë të të parëve, mbajtën gjithmonë të gjalla traditat e luftës për liri dhe pavarësi.

LITERATURA:

1. Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912), Tiranë, 1978

2. Aleks Buda, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saja historike, Studime historike, 3* , Tiranë 1978

3. Arben Puto, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit në vitet e Krizës Lindore, Studime historike, 3*, Tiranë 1978

4. Historia e popullit shqiptar, II, Tirane 2002

5. Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë 1997

6. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente osmane 1878-1881, përgatitur nga Kristaq Prifti, Tiranë, 1978

7. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ne dokumente osmane, përgatitur nga Iljaz Rexha, Prishtinë 1978

8. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ne dokumente angleze, përgatitur nga Skënder Rizaj, Prishtinë 1978

9. Selami Pulaha, *Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e provincës autonome të Shqipërisë (qershor-nëntor 1878), Studime historike, 2*, Tiranë 1978

10. Stefanaq Pollo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin e bashkimin kombëtar, Studime historike, 3*, Tirane 1978

11. Shyqri Ballvora, *Koncepti i territorit i Lidhjes Shqiptare te themeluar në Prizren dhe lufta e saj për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë, Studime historike 2*, Tiranë 1978

Mr. Enver BATIU

BESËLIDHJA E MADHE QË SFIDOI KOHËN

Shkaqet për t'u formuar Lidhja Shqiptare

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është rezultat i rrethanave të brendshme dhe të jashtme në Evropën e gjysmës së dytë të shek. XIX. Ajo u ngjiz nga zhvillimet ekonomike, politike, sociale dhe kulturore të asaj kohe.

Nga rrethanat e jashtme mund të numërojmë:

- zhvillimi i hovshëm i kapitalizmit në disa shtete të reja të Evropës dhe tendencat e tyre për të hap tregje të reja dhe për të bërë rindarjen e Botës;

- paraqitja në skenën botërore të Rusisë si shtet i fortë dhe me tendenca për t'u zgjeruar në Mesdhe dhe Azinë Jugore; - paaftësia e Perandorisë Osmane për t'iu përshtatur kushteve të reja në zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste dhe dobësimi ekonomik i saj;

- zgjimi i shteteve të reja ballkanike si: i Greqisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi për t'u zgjeruar në dëm të njëra-tjetrës e në veçanti me tendencat për të ndarë tokat shqiptare dhe

- luftërat ruso-osmane në të cilat, Perandoria Osmane, pësoi humbje të turpshme, si dhe përfundimi i saj me Paqen e Shën Stefanit ku u bë, pothuajse, ndarja e re e viseve të Perandorisë Osmane në trevat e Ballkanit, me të cilën u dëmtuan më së shumti trevat shqiptare.

Nga rrethanat e brendshme veçojmë:

- formimi i shtresës borgjeze shqiptare e cila tani më kërkonte tregun e vet dhe kushtet për një zhvillim më të hovshëm në mesin e vet ashtu si bënë edhe popujt tjerë të Ballkanit;

- formimi i shtresës intelektuale shqiptare e cila e ndikuar nga iluminizmi dhe duke përcjellë ngjarjet në Ballkan, Evropë dhe Botë filloi nxitjen e Lëvizjes gjithëkombëtare për krijimin e shtetit shqiptar me të cilin do të mundësohej lëvrimi dhe zhvillimi i kulturës dhe arsimit shqiptar në mënyrë më të suksesshme;

- bashkimi i masave të gjera popullore me lëvizjen e re nga dëshira për të punuar e vepruar në trojet e tyre dhe për të bërë një jetë më të mirë e më të përparuar si dhe

- pezmatimi i përgjithshëm pas përzënies me dhunë nga trojet e tyre etnike të qindra mija shqiptarëve nga Nishi, Prokuplja, Kurshumlia, Vranja, Pazari i Ri dhe fshatrat e tyre.

Formimi i Lidhjes

Formimit të Lidhjes i parapriu një peticion për çështjen shqiptare, dërguar Kongresit të Berlinit, një peticion dërguar Portës së Lartë, Kararnameja (Akti i vendimeve – Kanuni) dhe Talimati (urdhëresa).

Lidhja trajtohej në Kararname si një institucion politik, me një personalitet juridik të pavarur nga Porta e Lartë. Qeveria e Stambollit, thuhej, "nuk do të përzihej në asnjë mënyrë në çështjen e Lidhjes". Por, ajo që e theksonte më shumë karakterin e saj të përsosur ishte e drejta që fitoi Lidhja me anën e Kararnamës për të ngritur në këmbë forca të armatosura, të veçuara nga ushtria perandorake osmane, dhe për të hyrë në luftë kundër fuqive të huaja që cenonin trojet shqiptare, pavarësisht nga qëndrimi i Portës së Lartë. Lidhja merrte përsipër edhe disa prerogativa në fushën administrative dhe gjyqësore.

Me dokumentin tjetër, që e miratoi Kuvendi i Përgjithshëm, i cili u quajt Talimat, trajtoheshin aspekte administrative, politike e ushtarake të Lidhjes. Nëpërmjet këtyre, delegatet e Kuvendit të Përgjithshëm shpallën Prizrenin kryeqytet të tokave shqiptare.

Pas këtyre përgatitjeve, në pranverën e vitit 1878, në mbarë krahinat shqiptare u gjallërua dhe u brumos dëshira për të çliruar atdheun si dhe u shtrua kërkesa për themelimin e një lidhjeje të madhe dhe të përgjithshme, karakterin kombëtar të së cilës do ta mbrojnë si patriotët radikalë, ashtu edhe qarqet e moderuara. Rrjedhën për formimin e saj udhëheqësit politikë vendosën ta shfrytëzonin traditën e lashtë shqiptare. Sipas kësaj tradite, sa herë që vendin e kërcënonte rreziku i jashtëm, secila krahinë thërriste kuvendin e vet krahinor dhe pastaj përfaqësuesit e tyre

mblidheshin në një kuvend të jashtëzakonshëm, i cili, formonte sipas traditës besëlidhjen ndërkrahinore ose lidhjen e përgjithshme. Tradita e kësaj mënyre të organizimit të jetës e lehtësonte punën e udhëheqësve politikë të kohës. Tani duhej vetëm thirrja e një kuvendi të përgjithshëm dhe organizimi me sukses i punimeve të tij.

Pasi gjer me tani të gjitha punët për një organizim të lëvizjes së përgjithshme i kishte krye Komiteti i Stambollit edhe nismën për thirrjen e Kuvendit të përgjithshmen e mori Komiteti i Stambollit. Vendi ku do të mbahej Kuvendi u caktua qyteti i Prizrenit nga se ku qytet jo vetëm që ishte njeri nder qytetet më të lashta të trojeve shqiptare, por ishte edhe kërthiza e tokave shqiptare nga i cili mund të bëhej komunikim i lehtë me të gjitha trojet tjera shqiptare. Njëherit Prizreni, në

këtë kohë ishte qyteti më i zhvilluar ekonomik i trojeve shqiptare. Tri vjet më parë Komiteti i Stambollit kishte porositur Ymer Prizrenin që qytetin ta përgatisë për këtë ngjarje të madhe. Ai kishte bërë meremetimit e Medresesë së Mehmet Pashës me xhaminë dhe objektet përcjellëse të saj. Kishte trefishuar numrin e mullinjve, për të pasur sasi të mjaftueshme të millit dhe kishte bërë në meremetimin e rrugëve të qytetit si dhe për mysafirët e veçantë kishte ndërtuar një shtëpi të re. Në qytet dhe fshatrat përreth kishte përgatitur konaqet për vendosjen e delegatëve dhe kishte mbledhur një sasi të theksuar të armëve dhe barutit për nevojat ushtarake të Lidhjes. Me organizimin e drejtpërdrejtë të veprimeve për thirrjen e Kuvendit u ngarkua një komision i posaçëm në krye me Ymer Prizrenin dhe Ahmet Korenicën, ndërsa thirrjen për mbajtjen e Kuvendit themelues e lëshoi në fund të muajit prill, Ali Pashë Gucia. Gjatë gjysmës së majit të vitit 1878 Lëvizja për thirrjen e Kuvendit gjithëkombëtar u gjallërua në kulmin e fuqisë së saj. Në këtë kohë u caktuan delegatët nga të gjitha trojet shqiptare dhe u drejtuan për në Prizren, nga se rreziku për ndarjen e mëtutjeshme të trojeve shqiptare po trokiste në portat e atdheut.

Kuvendi gjithëkombëtar u hap me 10 qershor të vitit 1878. Edhe pse ende nuk kishin arritur të gjithë delegatët nga trojet shqiptare, qarqet sulltaniste u munduan, në të gjitha mënyrat, të pengojnë punën e rregullt të Kuvendit, duke u munduar që në mesin e delegatëve të fusin njerëz të cilët janë prosulltanorë, por nuk ia arritën qëllimeve të tyre, nga se udhëheqësit e Lidhjes arritën, me shumë sukses, të paralizojnë qëllimet e tyre. Kuvendi i filloi punimet ditën e caktuar, me qëllim që kërkesat e shqiptarëve t'u paraqiteshin Fuqive të Mëdha para se të fillonte punën Kongresi i Berlinit – më 13 qershor 1878.

Kuvendi i zhvilloi punimet e para në Xhaminë e Mehmed Pashës e cila në popull njihet si Xhamia e Flamurit, pranë Medresesë së tij në qendër të qytetit, të ndërtuar nga ky shqiptar i madh, në gjysmën e dytë të shek. XVI.

Kryetar i parë i Kuvendit u zgjodh delegati më i vjetër në Kuvend, Iljaz Pash Dibra - Qoku.

Të gjithë delegatët në Kuvend kishin një unitet të plotë mendimi; të gjithë ishin të vendosur për të kundërshtuar me çdo kusht copëtimin e trojeve shqiptare, për të mbrojtur tërësinë tokësore të saj. Në ditën e parë të punimeve në Kuvend folën delegatë të gjitha grupimeve politike.

Është i njohur fjalimi i delegatit Abdyl Frashërit, kryetar i Komitetit të Stambollit dhe delegat i Toskërisë – Vilajetit të Janinës:

"Qëllimi i Kuvendit është që t'ua presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t'i mbrojmë me gjak trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë".

Fjalimi i Abdyl Frashërit la përshtypje të madhe në sallë dhe jashtë saj. Menjëherë pas themelimit të Lidhjes u formuan organet e saj të larta. Në krye të Lidhjes qëndronte Këshilli i Përgjithshëm me funksione legjislative dhe me qendër në Prizren, nga i cili do të vareshin degët krahinore.

Kryetar u zgjodh Iljaz Pashë Dibra e më vonë do të bëhet Ymer Prizreni. Për të ushtruar funksionet ekzekutive u formua Komiteti qendror i të gjithë shqiptarëve, i përbërë nga tri komisione: - Komisioni i punëve të jashtme, - Komisioni i punëve të brendshme dhe - Komisioni i punëve financiare.

Lidhja formoi edhe Ushtrinë Shqiptare e cila ishte ekskluzivisht nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e Qeverisë të dalë nga mbledhja e Kuvendit Themelues.

Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes filloi zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe do të jetë udhëheqës dhe organizator i mbrojtjes së interesave të kombit gjer në ditët e shuarjes.

Rëndësia historike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si organizatë, shënoi një hap të madh cilësor nga pikëpamja e funksioneve politike, e shtrirjes territoriale dhe e mjeteve të luftës në krahasim me besëlidhjet e mëparshme. Ajo është e para organizatë gjithëkombëtare që krijoi degët e saj në të gjitha trevat

shqiptare dhe e para organizatë atdhetare që përdori për interesat e larta të atdheut krahas pushkës edhe penën.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte e para organizatë, e cila u vesh që në fillim të punës me funksione kushtetore, dhe arriti që në fund të fitonte atributet e një qeverie të përkohshme shqiptare, pothuajse krejtësisht të pavarur nga autoriteti i Perandorisë Osmane.

Lidhja e Prizrenit hapi dhe thelloi edhe më tutje hendekun e asimilimit të shqiptarëve në turq dhe duke iu kujtuar të kaluarën i kthjelloi që të shohin mirë momentin në të cilin gjendeshin dhe iu dha të gatuar projektin e së ardhmes së kombit.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit për herë të parë sfidoi prepotencën e Fuqive të Mëdha, agresivitetin e monarkive fqinje dhe arrogancën e portës së lartë. Nën udhëheqjen e atdhetarëve më të përparuar të kohës ajo i nënshtroi armiqtë e brendshëm, t'i izolonte bashkudhëtarët e përkohshëm dhe të merrte karakterin e një fronti të gjerë, duke e udhëhequr Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në mënyrë të shkallëzuar, por gjithnjë në rritje, gjersa arriti në veprën e saj më kulmore, në formimin e Qeverisë Shqiptare.

Amanet dhe barrë e çdo shqiptari

Gjatë periudhës së veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u bënë hapa të mëdhenj se sa shumë shekuj më parë në procesin e bashkimit gjithëkombëtar, pa marrë parasysh dallimet fetare, përkatësinë shoqërore, shpërndarjen krahinore dhe pikëpamjet politike, në një bashkësi të vetme kombëtare, e cila u sanksionua edhe në llogoret e luftës së udhëhequr prej saj.

Me luftërat heroike që i udhëhoqi Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e trevave shqiptare të Plavës, Gucisë,Grudës, Hotit, Ulqinit, Tivarit, Kelmendit dhe Çamërisë, i tregoi botës se tokat shqiptare nuk mund të trajtohen si plaçkë tregu për të kënaqur interesat e fuqive të mëdha e as lakmitë pushtuese të monarkive fqinje.

Lidhja u bë promotor i të gjitha lëvizjeve pas saj e edhe të shpallës së pavarësisë së Shqipërisë, edhe të luftës së UÇK- së dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Ajo do të jetë edhe më tutje amanet dhe barrë e çdo shqiptari kudo që të jetë për gjersa të kryhet ai amanet - të bëhet bashkimi i të gjithë trojeve shqiptare.

Nezir ÇITAKU

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT – 130 VJETORI

Gjatë viteve 1875 – 1878, Perandoria Osmane po përjetonte krizë të thellë. Kështu, e rraskapitur, do t'ua hapë dyert Fuqive të Mëdha evropiane që me autorizime të pakufizuara të ndërmjetësojnë në çështjet kontestuese ballkanike.

Së këndejmi, më parë fillon Kriza lindore e viteve 1875 – 1878, kur edhe fillon lufta agresive territoriale ndaj trojeve shqiptare prej nacionalistëve serbë, malazez dhe grekë duke shfrytëzuar përkrahjen e Rusisë cariste dhe të Fuqive të Mëdha evropiane rreth ndarjes së territoreve turke, të pushtuara shqiptare në Ballkan. Andaj, kjo tragjedi inicion dhe e shpejton themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 10 qershor 1878.

Gjatë kësaj krize, Rusia cariste në luftë kundër shembje së Perandorisë Osmane kishte për qëllim shtrirjen e kufijve të saj edhe në Ballkan, kinse me motivacionin e mbrojtjes së interesave të popullsisë sllave në Ballkan. Meqë kinse edhe "Gadishulli Ballkanik, ishte një territor greko-sllav, i cili duhej t'i nënshtrohej vetëm ndikimit rus dhe të dominojë në këtë rajon".

Në këtë periudhë kohore të Krizës së Lindjes, fillon lufta agresive territoriale ndaj trojeve shqiptare prej nacionalistëve serbë e malazez dhe grekë, duke shfrytëzuar përkrahjen e Rusisë cariste dhe të Fuqive të Mëdha rreth ndarjes të territoreve turke të pushtuara në Ballkan.

Kjo periudhë për popullin shqiptar, njëherit është edhe epoka e zhvillimit të vetëdijes kombëtare dhe mbrojtjen e trojeve autoktone

shqiptare në Ballkan. Meqë, me ngadhënjimin e ushtrisë ruse ndaj asaj turke në Plevne, Edrenë, Shën-Stefan dhe përparimi drejt Stambollit. Atëherë edhe Serbia hyn në luftë për të dytën herë, në prill 1877, dhe duke depërtuar kah lindja dhe kah jugu, e pushton Pirotin, Nishin, Leskovcin, Prokuplen, Kurshimlinë, Toplicën, Vranjën dhe Luginën e Preshevës e banuar kryesisht me shqiptarë.

Në Sanxhakun e Nishit, i cili kishte pesë kaza, jetonte populli autokton shqiptar.

Kjo dokumentohet në bazë të ***Salnames*** së viteve 1873 dhe 1874, ku Sanxhakun e Nishit e përbënin kazatë: Nishi kishte 4921 shqiptarë të fesë myslimane; Piroti kishte 5772 shqiptarë të fesë myslimane; Leskovci kishte 10525; Vranja 12502 shqiptarë; Prokupla kishte 6207 dhe Terni kishte 149 shqiptarë myslimanë. Sanxhaku i Nishit kishte gjithsej 46027 shqiptarë myslimanë.

Me okupimin e këtyre trojeve të Sanxhakut të Nishit, i cili ndodhej në kuadrin e Vilajetit të Kosovës, fillon shpërngulja me dhunë e 30 mijë shqiptarëve për në Kosovë e Turqi.

Së këndejmi, më 3 janar 1880 aprovohet Ligji mbi mënyrën e kolonizimit të trojeve shqiptare të boshatisura me dhunë.

Humbja e luftës nga ana e Perandorisë Osmane, fillon dhe bëhet Paqja e Shën-Stefanit, më 3 mars 1878, ku me ratifikimin e *Traktatit të Paqes*, u mor vendimi që pjesë të mëdha të trojeve shqiptare t'u jepeshin Serbisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë.

Serbia zgjerohet në lindje dhe në jug në trojet shqiptare të pesë kazave të Sanxhakut të Nishit.

Mali i Zi, edhe duke humbur betejat, me ndihmën e Fuqive të Mëdha, në Kongresin e Berlinit, fiton trojet shqiptare: të Plavës, Gucisë, Hotin, Grudën, Kelmendin, Vermoshin, Tivarin dhe Ulqinin me rrethinë.

Përfaqësuesit e viseve shqiptare, si dhe përfaqësuesi i Ulqinit, u mblodhën në Prizren, më 10 qershor të vitit 1878 dhe themelohet Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Themelimi i LSHP si organizatë politike me platformë ideologjike kombëtare, organizatë shtetërore, me ushtri veproi në emër të popullit shqiptar. Kur trojeve shqiptare u kërcënohej rreziku nga copëtimi, ajo nisi luftën kundër planeve të shteteve fqinje sllave të Ballkanit dhe planeve të Fuqive të Mëdha.

Andaj, LSHP i drejtohet Kongresit të Berlinit, të mos i jepte asnjë pëllëmbë tokë shqiptare ndonjë shteti të huaj... meqë do të mbrohej edhe me armë.

Në Kongres merrnin pjesë: Anglia, Franca, Austro-Hungaria, Gjermania, Italia dhe Rusia. Kurse përfaqësuesi i Turqisë nuk kishte të drejta të barabarta me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha. Ndërkaq, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha nuk paraqitën në Kongres protestat shqiptare kundër copëtimit dhe pushtimit të trojeve shqiptare, kur në Kuvendin e mbajtur në Prizren, u aprovua memorandumi i nënshkruar nga 500 veta që ia drejtuan Kongresit të Berlinit që mbahej më 13 qershor 1878. Kërkesat e popullit shqiptar nuk u përfillën, çfarë shtuan edhe më tepër pezmatimin dhe zemërimin e shqiptarëve kundër vendeve fqinje të Ballkanit, si dhe kundër Fuqive të Mëdha Evropiane dhe Portës së Lartë. Pezmatimi u shpreh sidomos në Shkodër, Plavë e Guci, Ulqin, Tivar, Kosovë dhe në Shqipërinë e jugut.

Kur Perandoria Osmane kapitulloi para Fuqive të Mëdha dhe po i shtrëngonte shqiptarët t'u dorëzonin shteteve ballkanike viset e tyre. Tani fillon hyrja e ushtrive të huaja në trojet shqiptare dhe dëbimi i popullsisë shqiptare nga trojet e veta, çfarë iniciuan Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për mbrojtjen e trojeve dhe të drejtave të tyre.

Ymer Prizreni, kryetar i LSHP, dha një kontribut të çmuar për përgatitjen e Kuvendit duke paraqitur figurën më të shquar të kohës, rreth filozofisë së tij humaniste, veprimtarisë së tij politike dhe strategjisë së tij luftarake, të përqendruara rreth një qëllimi, së pari rreth bashkimit të vilajeteve shqiptare: të Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit/Selanikut dhe Janinës. Së dyti rreth fitimit të Pavarësisë së Shqipërisë etnike. Pastaj, Ymer Prizreni dha kontribut të veçantë për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë, Hotit e Grudës, meqë Turqia duhej deri nga fundi i gushtit 1878 t'i jepeshin Malit të Zi, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, i cili formoi edhe Komisionin ndërkombëtar rreth caktimit të vijës kufitare.

Zemërimi i shqiptarëve arriti kulminacionin, kur Kongresi i Berlinit ia njohu Malit të Zi, qytetin e Tivarit, të Ulqinit dhe Plavën e Gucinë duke përfshirë Hotin e Grudën. Bëhen përgatitjet për mbrojtjet e trojeve shqiptare. Në Guci vendoset shtabi i ushtrisë shqiptare në krye me Ali Pashë Gucinë. Gjendja e krijuar në Plavë e Guci ishte në favor të ushtrisë shqiptare, atëherë Mali i Zi priste ndihmat e Rusisë dhe të Fuqive të Mëdha. Pas shumë luhatjeve diplomatike Fuqitë e Mëdha qëndruan dhe vendosën që demonstrimi detar i forcës së flotave detare ta zbatonin plotësisht Traktatin e Berlinit.

Për ta zgjidhur çështjen e Ulqinit në favor të Malit të Zi, meqë Ali Pashë Gucia mbronte me sukses Plavën e Gucinë, kurse, Hoti e Gruda mbrohej prej forcave shqiptare nën komandën e Dedë Gjo Lulit.

Luftanijet ndërkombëtare bëjnë spirancën në Raguzë, në limanin e Gruzhës të këtyre shteteve: Rusia - 3 luftanije; Austria – 2; Gjermania – 1; Franca – 3; Anglia – 3; dhe Italia – 3 luftanije.

Në muajin shtator 1880 vazhdon demonstrimi i Flotës ndërkombëtare para Ulqinit. Ata i kërcënohen forcave osmane dhe atyre shqiptare që luftonin për të ekzistuar si qenie njerëzore (thotë Skënder Rizaj).

Dega e Lidhjes Shqiptare të Ulqinit mobilizoi vullnetarë nga Shkodra, Malësia, Kosova, Tetova. Në përfundim të muajit shtator, në Shkodër hynë rreth 500 vullnetarë të armatosur që kishin ardhur nga Prizreni dhe vazhduan për Ulqin (S. Rizaj). Po kështu, edhe nga Gruda, Hoti, Tuzi dhe Lohja u nisën vullnetarë për në Ulqin.

Së këndejmi, udhëheqësi i forcave ulqinake, Mehmet Gjyli dhe komandanti i forcave vullnetare të Shkodrës, Isuf Sokoli, deklaruan vendosmërinë e tyre për ta mbrojtur Ulqinin.

Më 18 nëntor 1880, kur filloi ekspedita e forcave osmane ndaj vullnetarëve shqiptarë të përqendruar në Shëngjergj, në Kllezën, në Mozhur dhe në Ulqin.

Dervish pasha filloi bombardimin e pozitave shqiptare në Shëngjergj.

Mirëpo më 22 nëntor 1880 filloi beteja e vullnetarëve shqiptarë në Kllezën dhe pushkën e parë, sipas konsullit Lippi e shkrehu **Fetah Dragusha,** hoxhë nga Shkodra, i cili shtiu mbi ushtarët turq.

Definitivisht, më 23 nëntor 1880, Dervish Pasha me ushtrinë turke hyri në Ulqin.

Më 26 nëntor 1880 forcat e armatosura malazeze, kaluan kufirin dhe marshonin në drejtim të Ulqinit dhe se princ Nikolla mori në dorëzim Ulqinin.

Në Ulqin fillon shpërngulja e shumë familjeve, si pasojë e revoltës dhe mospranimit të pushtetit të ri.

Shkodra pranon strehimin e emigrantëve që vinin nga Ulqini dhe rrethina. Po kështu, familjet ulqinake marrin drejtimin e Shëngjinit e Durrësit.

Thuhet se nga Tivari e Ulqini u shpërngulën afro 200 familje, sidomos ata që merreshin me detari. Në anën tjetër, sipas të dhënave, Ulqinin e lëshuan afro 400 familje me 3000 banorë, e një prej tyre ishte edhe Hafiz Ali Ulqinaku.[1]

Ndërkohë filloi procesi i kolonizimit, ku vetëm në rajonin e Ulqinit u vendosën rreth 400 familje malazeze.[2]

YMER PRIZRENI

Ymer Prizreni, personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe një prej organizatorëve, themeluesit kryesor të LSHP (1878 – 1881), u lind në Prizren. Në Stamboll kreu studimet juridike, filozofike dhe teologjike. Pos gjuhës shqipe, fliste turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten dhe kuptonte gjermanishten.

Ymer Prizreni si kryetar i LSHP ishte i vendosur për formimin e një shteti autokton shqiptar... duke bashkuar sanxhaqet me popullsi shqiptare në një njësi të vetme administrative, krijimi i një Vilajeti të bashkuar shqiptar.[3]

Në muajin maj 1881 gjatë shtypjes së egër të LSHP nga forcat ushtarake osmane, qindra veprimtarë të Lidhjes u arrestuan dhe u dënuan me masa të rënda nga gjykatat ushtarake turke.

Mirëpo, Ymer Prizreni për të shpëtuar persekutimeve, u arratis në Ulqin, më 26 maj 1881.

Në Ulqin u strehua në gjirin e familjes myderrizit Sali Efendi Hylja, pastaj në lokalet e Meqemesë, zyra e Vakëfit, përballë Xhamisë së Namazgjahut.

Në Ulqin Ymer Prizreni gëzoi mbështetjen morale të Mulla Beqirit, (Mulla-h Beqirit). Qëndroi në odën e Tahir Mulla Beqirit; në odën e Kadisë së Mujalëve qëndroi deri sa ndërroi jetë, më 1884.

Ndërsa, deri sa Ymer Prizreni nuk u kap nga forcat osmane, Porta e Lartë internoi familjen e tij, në fillim në Selanik e pastaj në Stamboll.[4]

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shpërnda nga forcat turke, por ajo kishte ndikuar në zgjimin e vetëdijes kombëtare. Kështu, Lëvizja Kombëtare Shqiptare vazhdoi të marrë gjithnjë e më tepër përmasa të reja mbarëshqiptare.

KRYENGRITJET NË KOSOVË

Andaj, edhe në Drenicë gjatë muajit prill 1890 dhe janar 1891 shpërthen kryengritja kundër vendosjes së kazasë në Drenicë nga ana e Qeverisë Osmane. Por, kryengritjet në Drenicë udhëhiqeshin nga Ahmet Delia i Prekazit, marrin përmasa të mëdha shtator 1891 – maj 1893 kundër sulmeve të ushtrisë turke kur e sulmoi Prekazin e Epërm me topa gjatë vitit 1892 e deri në maj 1893.

Përpjekjet për ringjalljen e LSHP, pati themelimi i Lidhjes së Pejës në Kuvendin e mbajtur në Pejë, më 26 – 30 janar 1899, kryetar u zgjodh Haxhi Zeka.

Ndërkaq, për t'ia prerë hovin Lëvizjes kryengritëse të shqiptarëve, Rusia cariste dhe Austro-Hungaria, kërkuan nga Porta e Lartë që të jepte sa më parë "reformat". Atëherë më 3 dhjetor 1902 sulltani shpalli "reformat". Kurse për të përcjellë kryengritjet në Kosovë, Rusia hapi konsullatën ruse në Mitrovicë (janar 1903). Për konsull rus në Mitrovicë ishte emëruar Grigorije Shçerbin, i cili më parë kishte qenë konsull në Shkodër. Mirëpo, krerët shqiptar të Gjakovës, Pejës dhe të Drenicës nuk u pajtuan me "reformat" meqë do t'u përmbahen vendimeve të marra në Gjakovë, Pejë, Istog, Llaushë të Drenicës.[5]

Tubimi i mbajtur më 13 mars 1903 në Fushë të Marinës të Drenicës, ku morën pjesë rreth 5000 vetë të armatosur, u kërkua nga tubimi jo vetëm kundër reformave turke, por edhe u deklaruan kundër veprimtarisë së Konsullatës Ruse në Mitrovicë... e cila vepronte kundër interesave të shqiptarëve dhe iu bë me dije se në të kundërtën kanë për ta dëbuar prej Mitrovicës.[6]

Pasi që mbledhja në Fushë të Marinës përfundoi, kryengritësit marshuan për Vushtrri dhe sulmi bëhet në Mitrovicë dhe erdhi deri te vrasja e konsullit rus Shçerbin. Tani, Lëvizja Shqiptare merr hov në vitet 1905-1908 dhe arriti kulmin e vet në Kryengritje të përgjithshme shqiptare të viteve 1909-1912, që u kurorëzuan me shpallej e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912.

Ndërkaq, në Kosovë kryengritja e armatosur së pari shpërthen në Rrafshin e Dukagjinit në krye me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, ndërsa më 28 qershor 1912, luftimet vazhduan Drenicë-Mitrovicë; Podujevë - Prishtinë të udhëhequra nga Isa Boletini e Ahmet Deli Prekazi... Këto forca, më 19 korrik 1912 sulmuan forcat turke në fshatin Braboniq dhe më 27 korrik 1912 çliruan Mitrovicën, më 21 korrik u çlirua Prishtina, pastaj Drenica, Vushtrria e Ferizaj, kurse më 27 korrik kryengritësit hynë në Pejë.

Shkupi u çlirua më 12 gusht, Tetova, Kumanova dhe Presheva u çliruan nga pushtuesi turk më 16 gusht 1912. Organet e pushtetit turk u zëvendësuan me organet e pushtetit shqiptar. Mirëpo, procesi i marrjes së pushtetit ndërpritet në Kosovë me fillimin e Luftës I dhe të II Ballkanike, kur trojet shqiptare të Kosovës bien nën pushtimin e Serbisë, i cili okupoi trojet shqiptare të çliruara nga vetë kryengritësit shqiptarë pas robërisë pesëshekullore turke.

Mirëpo, patriotizmi i shqiptarëve i frymëzuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, vazhdon edhe pas luftërave ballkanike, pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore kundër copëtimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje të nacionalizmit serb, malazez e grek. Mandej, lufta kundër nazifashizmit gjermano-italian e bullgar.

Së këndejmi, për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet amë të përbashkët me Shqipërinë, në Prizren themelohet Lidhja e Dytë e Prizrenit më 1943 pas kapitullimit të Italisë fashiste (8 shtator 1943). Kjo traditë vazhdon me themelimin e Lidhjes III shqiptare të Prizrenit në mërgim, mbajtur në Nju-Jork (New York) të SHBA-ve më 1962 për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare me orientim properëndimor.

Ndërkaq, me shpërbërjen e Jugosllavisë socialiste gjatë viteve 1991-1995, atëherë edhe në Kosovë prej popullit autokton shqiptar lind UÇK. Kjo ushtri e armatosur nën mbështetjen e forcave të NATO-s në luftë kundër pushtuesit serb vjen deri te çlirimi i Kosovës dhe Serbia nënshkruan kapitullimin e saj në Kumanovë në qershor të vitit 1999.

Ky triumf i UÇK-së, sjell shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Ndërsa, hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Pavarur dhe Sovrane të Kosovës më 15 qershor 2008.

Kjo koincidencë e muajit qershor dhe e vitit 1878-2008 shënon jubileun e manifestimit madhështor të 130 vjetorit të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Andaj, Pavarësia e Kosovës pranohet zyrtarisht më parë prej SHBA-ve, shtetet e BE, shteteve skandinave, arabe dhe të shteteve fqinje të Ballkanit.

Pavarësia e Kosovës nuk pranohet nga Serbia e cila gëzon mbështetjen e Rusisë, dhe kjo duke shtrembëruar të vërtetën historike, kinse "Kosova është djepi i Serbisë" duke i ikur në heshtje meqë serbët e kanë prejardhjen prej Karpateve ruse, d.m.th., se ai që nuk di nga ka ardhur nuk di as ku të shkojë.

Se sllavët e përgjakën historinë, dokumentojnë burimet historike jo vetëm ato shqiptare, por edhe burimet historike rumune, sidomos ato të autorit rumun **Lionel Lulian**, të botuara këto ditë në revistën rumune, *Natiunea* nr.455/2008, në kuadër të studimit "*Istoria Europeana*", ku sipas të dhënave Serbia del një krijesë artificiale e përbërë nga popujt e asimiluar sipas rekomandimeve ruse për zgjerimin e pansllavizmit në Ballkan.

Dhe Lionel, thekson se Kosova nuk i përket Serbisë dhe se "*Serbia dhe Bullgaria që krijohen pas ekspansionit osman, ishin troje të rumunëve të lashtë dhe të Ilirisë. Andaj, historianët pansllavistë inskenojnë fabula e legjenda që nuk kanë mundur të shndërrohen në histori...*" Mirëpo, më 1812 pansllavizmi do të nxjerrë... nocionet *serb* dhe *Serbi*. Kështu, po atë vit, pra më 1812, carizmi rus (sidomos gjatë Krizës Lindore 1875 – 1878/80 e 1912 - N. Çitaku) ia shkëputi Besarabinë Rumanisë, për të vazhduar sulmet barbare pansllaviste kundër trungut shqiptar, kur Serbia më 1812 përkufizohej me trojet e Rashkës.

Lionel, vazhdon: "*Ajo që është e njohur sot, është se serbët janë kolonistë në Vojvodinë, që nga viti 1690. Meqë në Vojvodinë pos hungarezëve dhe gjermanëve, jetonin edhe rumunë dhe se emri i Vërshacit thirrej nga rumunët para 100 vitesh Vërshoara, siç thirret Timoshara (Timoku), në zemër të Banatës*".

Po kështu ndodhi edhe me Kosovën Lindore në vitin 1878 kur Serbia në mbështetje të Rusisë dhe Fuqive të Mëdha pushton Sanxhakun e Nishit që ishte në kuadër të Vilajetit të Kosovës dhe banohej me shqiptarë të cilët edhe më se 30000 shpërngulen me dhunë për në Kosovë, Turqi e gjetiu. Tani serbët bëhen kolonistë dhe se emri i Nishit është i gjuhës shqipe që nga Iliriku, kur me pushtimin e Perandorisë Romake, Nishi thirrej *Naisus*. Pastaj, emri Leskovac në gjuhën shqipe thirrej *Leskaj – Leskovik*, ose emri Preshevë do të thotë presh; apo Bujanovci thirrej *Bujan – Bunë* që do të thotë *burim uji*, e kështu me radhë.

Andaj, me të drejtë historiani rumun Lionel thekson se: "*Serbët duhet të zgjohen nga gjumi letargjik i trillimeve fantasmogorike të historisë së tyre të përgjakur, për ta parë se ndërmjet shqiptarëve dhe rumunëve ndodhen si ndërmjet kudhrës dhe çekanit, edhe pse çekanin e kanë shfrytëzuar ata kundër popujve autokton, e jo anasjelltas*".

[1] Dr. Nail Draga, *Shqiptarët në Mal të Zi*, Ulqin, 1994, fq. 21.

[2] •arko Bulajiæ, *Agrarni odnosi u Crnoj Gori*, Titograd, 1959, fq. 132.

[3] Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare*, dok. 37).

[4] Xh. Belegu, vep. e cit. fq. 191

[5] Shukri Rahimi, *Format e rezistencës së popullit shqiptar kundër sundimit turk gjatë viteve 1900-1903 dhe karakteri i tyre*, "*Përparimi*", nr. 4, prill 1962; Sima Avramoviq, konsull serb në Prishtinë, raporti (pov. br. 67 od 06.3.1903), *Diplomatska prepiska*, fq. 598 – 599.

[6] Vladimir Èoroviæ, *Diplomatska prepiska*, 182, 217, 616).

Gazmend ÇITAKU

GRINDJET RRETH ULQINIT

(Shkrimet në *New York Times,* të datave: 21, 22, 23 dhe 24 shtator 1880)

Dobësimi i Perandorisë Osmane bëri që Fuqitë e Mëdha të bëjnë tregti me toka shqiptare, pasi që ato konsideroheshin si toka turke. Presionet që bënte Rusia cariste ndaj Portës së Lartë bënte këtë të dytën që të lëshonte tokat shqiptare nën posedimin e shteteve tjera ballkanike. Ashtu Rusia, përmes aleatëve të vet sllavë, dëshironte që të ketë dalje edhe në Detin Adriatik. Një gjë e tillë vendoset me Kongresin e Berlinit, ku Fuqitë e Mëdha, përmes Rusisë, vendosin që Malit të Zi t'i japin qytetin e Ulqinit, qytet ky i cili ishte shumë i njohur për mundësitë dhe si skele detare. Një histori e tillë e pasur detare, konsideronin shtetet e mëdha se do t'i bënin shërbim Malit të Zi në forcimin e tij në det.

Edhe pse dihet se Kongresi i Berlinit kishte vendosur që Ulqinin t'ia jepte Malit të Zi, popullsia vendase nuk ishte dakord dhe vendin e tyre e mbrojnë me forcë, duke u organizuar në formacione luftarake. me ç'rast në ndihmë iu vijnë edhe luftëtarë nga trevat tjera shqiptare. Ashtu bëjnë që Mali i Zi edhe pas dy vjetësh nuk mundi të hynte në Ulqin. Presionet e mëdha bëheshin ndaj Portës së Lartë dhe kërkonin nga ajo që të bëjë presion në Ulqin për vetëdorëzim, por një gjë e tillë nuk ndodhte.

Për gjendjen e tillë të krijuar, shkruanin edhe gazetat më prestigjioze të kohës.

(Këtu ne po sjellim vetëm shkrimet e 4 ditëve të "*New York Times*"-it, të datave: 21, 22, 23 dhe 24 shtator 1880).

Porta e Lartë kërkon shtyrje
(Riza Pasha refuzon të merret me dhënien e Ulqinit)

Londër më 20 shtator – Korrespodenti nga Raguza lajmëron si vijon:

I ngarkuari për punë të jashtme sapo arriti nga Shkodra. Ai thotë se Riza Pasha i ka thënë se ai nuk mundet dhe nuk dëshiron të merret me çështjen e dhënies së Ulqinit Malit të Zi. Riza Pasha nuk e lëshoi Shkodrën për të shkuar në Ulqin e as që e ka ndërmend. Lëvizjet e raportuara të trupave turke për dorëzimin e Ulqinit ishin të rreme. Riza Pasha gjatë tërë kohës ishte së bashku me udhëheqësin e Lidhjes Shqiptare në Shkodër. Kokëfortësia e Portës, dhe qëndrimi i vendosur i Britanisë dhe fuqive tjera, mund të çojë në bllokim të kombinuar të Dardaneleve.

Riza Pasha, komandant i forcave turke në Ulqin

Sipas depeshes së dërguar nga Gravozha raportohet si vijon:

Pas konferencën së mbajtur, një përfaqësues i Fuqive, së bashku me një njëri të luftës (Ministrisë së luftës - vërejtje e autorit*), shkuan të veprojnë sipas instruksioneve të marra, që së pari të takojnë Princin e Mali të Zi dhe pastaj të shkojnë në Shkodër dhe të prezantojnë para Riza Pashës, përfaqësuesit të Portës, rrethimin e Ulqinit për katër ditë.*

Korrespondenti nga Raguza thotë:

Kjo është e panevojshme pasi që shqiptarët kanë çdo gjë në duar të veta. Shumë shqiptarë muhamedanë nga rrethi i Ulqinit, të cilët janë të shqetësuar për aneksimin nga ana e Malit të Zi, haptas shprehin pakënaqësinë ndaj Sulltanit, madje kërkojnë largimin e tij nga posti.

Ndërkohë asgjë nuk është e mundur të bëhet dhe familjarët e konsujve janë larguar të sigurt nga kështjella.

(New York Times, Published: September 21, 1880).



THE DULCIGNO QUARREL.

THE PORTE STILL SEEKING DELAY—RIZA PASHA REFUSES TO CARRY OUT THE CESSION.

LONDON, Sept. 20.—A Ragusa correspondent telegraphs as follows: "A foreign Chargé d'Affaires has just arrived here from Scutari. He says Riza Pasha told him that he could not and would not carry out the cession of Dulcigno to Montenegro. Riza Pasha did not leave Scutari for Dulcigno at all. The reported dispatch of Turkish troops to attempt the surrender of Dulcigno was a feint. Riza Pasha was all the time living with the chief of the Albanian League at Scutari. The obstinacy of the Porte, and the determined attitude of the British and some of the other powers, may lead to a combined blockade of the Dardanelles."

A dispatch from Gravosa says: "After the conference of the representatives of the powers aboard the British man-of-war Alexandra, on the 16th inst., an English Captain left with instructions to have an interview with the Prince of Montenegro, and afterward to go to Scutari and present to Riza Pasha, the Turkish commander, a formal demand for the surrender of Dulcigno within four days.' A correspondent at Ragusa says: "This is probably useless, as the Albanians are masters of the situation. Many Mohammedan Albanians of the Dulcigno district, who are anxious for annexation to Montenegro, openly advocate the deposition of the Sultan. Meanwhile nothing can be done until the Consular families are removed to a place of safety."

CONSTANTINOPLE, Sept. 20.—Fresh difficulties have arisen over the Montenegrin question. The Sultan insists on the powers simultaneously recognizing the new frontier line from Lake Scutari to Dinosch before Dulcigno is surrendered. Mr. Goschen, the British Ambassador, has had an interview with the Sultan, and protested energetically against the action of the Porte in connection with the Dulcigno affair.

LONDON, Sept. 21.—A dispatch from Gravosa reports that the British Captain sent to Montenegro and Scutari has arrived at Scutari, delivered his dispatches, and summoned the Consular body to remove their families to a place of safety. The weather is hot and sultry, and the sirocco is coming on.

A Vienna correspondent learns from Ragusa that anarchy reigns in Dulcigno. The Turkish officers have been forced by the Albanians to leave the town. Riza Pasha has gone to Chorica.

The New York Times
Published: September 21, 1880
Copyright © The New York Times

Forcat armike në Ulqin

(Një përparim i pritur i malazezëve – protestë e banorëve të Ulqinit)

Paris, më 22 shtator – Një telegram nga Raguza thotë:

Komandanti malazez në Podgoricë ka arrestuar disa krerë shqiptarë muhamedan. Kjo ka irrituar pamasë shqiptarët, dhe njëherit ka rritur vështirësitë rreth dorëzimit të Ulqinit.

Londër, më 22 shtator – Një telegram nga Raguza thotë:

Të ngarkuarit për punë të jashtme raportojnë nga Shkodra se trupat turke afër vendit janë duke vdekur nga ethet në masë prej 200 vetëve në ditë.

Raguzë, më 22 shtator – Lajmet të cilat arrijnë nga Cetina tregojnë për dobësinë e forcave të Riza Pashës, se malazezët janë kështilluar nga njëri prej fuqive që të fillojnë me aksion dhe se përparimet drejt Ulqinit do të fillojnë që nga sot, (e mërkurë).

Shkodër, 22 shtator – Tridhjetë e pesë njerëz të parisë së Ulqinit kanë prezantuar pakënaqësinë e tyre para konsujve të jashtëm, duke u treguar se banorët të cilët ata përfaqësojnë, kurrë nuk do të pranojnë

që të shkëputën nga Qeveria turke, dhe se, nëse malazezët do të provojnë që të depërtojnë në drejtim të tyre, ata do të reagojnë me forcë. Disa nga konsujt nuk i pranuan në takim. Dy shqiptarë katolikë dhe dy myslimanë, anëtarë të Ligës Shqiptare, shkuan në Tuz, në mënyrë që të bindin malësorët të marrin pjesë në mbrojtjen e Ulqinit. Si pasojë e presionit dhe ultimatumit të cilin e ka dhënë Admirali Seymor, Riza Pasha ka intervenuar te Liga Shqiptare që të pranojnë dorëzimin e Ulqinit, pasi që, nëse refuzojnë, pasojë do të kenë sulmet e Fuqive të Mëdha dhe se nuk do të mund të llogarisin në mbështetjen nga Porta e Lartë.

FORCING TURKEY TO TERMS.

THE INITIAL STEPS LOOKING TO MONTENEGRIN OCCUPATION OF DULCIGNO.

RAGUSA, Sept. 23.—In accordance with he decision taken at the council of the Admirals yesterday, Admiral Seymour has sailed for Cattaro, whence he will proceed to Cettinje, for the purpose of ascertaining personally the position of the Montenegrins and arranging for future action with respect to the occupation of Dulcigno.

VIENNA, Sept. 23.—A dispatch from Cettinje announces that Admiral Seymour has arrived there. The Commander-in-Chief of the Montenegrin force which is to operate against Dulcigno has arrived at Suturman to hold a conference with Admiral Seymour.

CONSTANTINOPLE, Sept. 23.—The Porte has issued a fresh note protesting against the naval demonstration, again declaring it to be an exercise of armed pressure contrary to the rights of the Sultan.

PARIS, Sept. 23.—A telegram from Antivari declares that, notwithstanding denials, the statement that the Albanians drove the garrison out of Dulcigno on the 17th inst. is confirmed.

LONDON, Sept. 23.—A Constantinople dispatch dated yesterday says: "The Sultan is endeavoring to persuade Mahmoud Nedim Pasha, the present Minister of the Interior, to accept the office of Grand Vizier."

The London correspondent of a Manchester paper says: "I am informed that six of the best vessels of the Russian Pacific Squadron have been ordered by telegraph to hold themselves in readiness to return immediately to the Mediterranean. In the event of the Dulcigno affair taking a serious turn, and a rupture occurring between Russia and Turkey, the remainder of the squadron would follow as needed."

LONDON, Sept. 24.—A dispatch from Antivari says: "None of the great Albanian tribes are now represented, in any strength, among the defenders of Dulcigno. The defending force consists almost entirely of the native Moslem population, who believe they are acting under the countenance of Riza Pasha."

A correspondent at Vienna learns from Antivari that the Montenegrins began marching to Dulcigno on Wednesday.

The New York Times
Published: September 24, 1880
Copyright © The New York Times

Londër, më 22 shtator – Një telegram nga Badiku raporton se *Riza Pasha u bën thirrje popullit të Ulqinit të lëshojnë qytetin dhe u premton se do t'u paguajë 30000 funta turke, gjithashtu si kundërshpërblim do t'ua ndërtojë një Ulqin të ri në territorin e Matit, por ai mori një përgjigje të vendosur negative, dhe tani është i detyruar të përgatisë një forcë prej 5000 njerëzve, me 6 topa, në mënyrë që të risjellë pozitën...*

Një telegram nga Vjena tregon se *kështjellën e Ulqinit ende e mbajnë forcat turke me dy batalione dhe se forcat kryesore të tyre gjenden në verilindje të Ulqinit ku mbajnë pozita në të*

dy krahët që janë në drejtim të Mozhurit e ku njëherit gjenden edhe kampet e shpërndarë të shqiptarëve, si dhe në drejtim të Tivarit ku edhe ndodhen malazezët.

(New York Times, Published: September 23, 1880).

Londër, më 24 shtator – Një telegram nga Tivari thotë:

Asnjë nga fiset e mëdha të shqiptarëve nuk janë të përfaqësuar në asnjë fuqi midis mbrojtësve të Ulqinit. Forcat mbrojtëse të Ulqinit përbëhen gati tërësisht nga popullsia lokale muhamedane, të cilët besohet se veprojnë sipas udhëzimeve të Riza Pashës.

Një korrespodent nga Vjena tregon se *nga Tivari ka marrë vesh se forcat malazeze kanë filluar marshin drejt Ulqinit të mërkurën.*

(New York Times, Published: September 24, 1880).

Konkludim

Siç shihet edhe nga përkthimet të cilat prezantuam del se, popullsia lokale e Ulqinit ishte kategorikisht kundër ndërrimit të Qeverisë sunduese, madje në shenjë proteste ata kërkonin që të ndërrohej edhe Sulltani, pasi që ai kishte pranuar që një pjesë e territorit të vet të tëhuajësohej.

Pakënaqësitë e veta paria e Ulqinit ia kishte prezantuar edhe konsujve të shteteve të ndryshme të cilët ishin të instaluar në Shkodër dhe se kategorikisht deklaronin se çdo lëvizje malazeze në drejtim të Ulqinit ata do t'i përgjigjen me forcë.

Fuqitë e Mëdha bënin presion ndaj Portës së lartë dhe Porta pastaj bënte presion në Pashën e Shkodrës dhe e detyrojnë atë që të ndërmarrë masa ndaj popullsisë së padëgjueshme të Ulqinit.

Sipas deklarimeve të korrespodentëve të huaj del se, Riza Pasha as nuk ndërmerrte e as që e kishte ndërmend të ndërmerrte ndonjë gjë rreth dorëzimit të Ulqinit, por sa për sy e faqe bënte manovrime mashtruese në mënyrë që të jepte me dije se kinse Porta merrte hapa ndaj ndëshkimit të popullsisë ulqinake e cila shprehte revoltë.

Riza Pasha gjatë tërë kohës ishte në kontakt me krerë të Lidhjes Shqiptare dhe, siç raportonte korrespodenti i Vjenës nga Tivari, del se Riza pasha së bashku me krerët shqiptarë koordinonin punët dhe ndërmerrnin hapa më parë të dakorduar.

Në momentin kur presionet ndaj Riza pashës kishin arritur kulminacionin ai i ofron banorëve ulqinakë se, nëse pranojnë që ta lëshojnë Ulqinin, Porta do të ndërtojë një Ulqin të ri dhe se çdo kush do të fitojë një kundërshpërblim në vlerë prej 30000 funtash turke. Ofertën

e tillë banorët e Ulqinit kategorikisht e hedhin poshtë dhe detyrojnë Riza Pashën që të përgatiste një forcë prej 5000 ushtarësh, me 6 topa, në mënyrë që të rikthejnë pozitat, derisa në Kalanë e Ulqinit ende gjendeshin dy batalione me ushtarë turq, kurse forcat mbrojtëse të Ulqinit përbëheshin kryesisht nga popullsia lokale dhe se ishin të shpërndarë në tërë territorin e Ulqinit, dhe se koncentrimet më të mëdha të forcave mbrojtëse ishin në drejtim të Tivarit, ku marshimi i forcave malazeze, sipas raporteve, fillon ditën e mërkurë, d.m.th., më 22 shtator 1880.

Me rastin e rënies së Ulqinit në duar të Malit të Zi, në shenjë revolte dhe mospajtimi shumë familje ulqinake u shpërngulën nga Ulqini dhe u vendosen në vende të ndryshme të Shqipërisë si: Shkodër, Lezhë, Durrës etj.

VËSHTRIME

Fatbardha HOXHA

MAGJIA POETIKE E NDRE MJEDËS

(70 vjet nga ndarja e Poetit nga kjo jetë dhe 90-vjetori i botimit të “Juveniljes”, veprës së tij të rëndësishme)

Edhe pse kanë kaluar plot 70 vjet nga ndarja e Poetit nga kjo jetë, ai e ka sfiduar kohën dhe me veprën dhe fjalën e tij të bukur shqipe ka fituar përjetësinë. Ky është privilegji i poetëve të mëdhenj, atribut që pa mëdyshje mund të cilësojë personalitetin unik të Mjedës dhe veprën e tij të papërsëritshme. Ky jubile i vdekjes së tij përkon dhe me 90 vjetorin e botimit të “Juveniljes”, veprës së tij të rëndësishme.

Në personalitetin e tij të formuar nën kujdesin e të tjerëve edhe me përkushtimin personal u bashkuan mrekullisht natyra mitike e Alpeve tona me qytetërimin shqiptar, kultura klasike dhe moderne me disiplinën e punës që i dhanë institucione të njohura të disa vendeve evropiane në Francë, Spanjë, Itali, Kroaci dhe Poloni, ku ai u përgatit dhe u kultivua si rrallë njeri tjetër në historinë tonë kombëtare.

Në veprën e tij të shumanshme shquan poezia që vërtet nuk është voluminoze, dhe kjo gjë përsëritet shpesh, pothuajse nga të gjithë ata që janë marrë me veprën e tij, edhe pse përballë vlerave monumentale të mirëfillta estetike që ka vepra e Mjedës, sasia, volumi zhvleftësohen disa herë. Për të do të vlente verbi latin “Intiligenti pauca”.

Por fati i poetëve të mëdhenj ka qenë dhe mbetet përherë i trazuar. Ata kanë qenë dhe janë përherë të diskutuar, të polemizuar dhe të sfiduar.

Leximi kritik i veprës së Mjedës në kohëra e provon më së shumti këtë. E megjithatë ai ka marrë në rrjedhën e kohës vlerësimin absolut dhe vepra e tij e magjishme me tonet e fuqishme qytetare dhe me dridhjet delikate e fërfëllimat e shpirtit njerëzor ka depërtuar aq thellë në vetëdijen dhe kujtesën e njerëzve.

Qasja që do të donim të shpërfaqnim në këtë shkrim lidhet me pyetjen se çfarë e bën unik personalitetin e Mjedës dhe çfarë e bën të papërsëritshme veprën e tij, duke i dhënë përmasë universale dhe përjetësi, problem i trajtuar jo pak nga studiuesit, por për të cilin ka ende mundësi për të artikuluar qasje e mendime.

Çelësin për të hyrë në ngrehinën madhështore të veprës ta vë në dorë vetë poeti që ushtroi edhe profesionin e pedagogut të letërsisë, të stilistikës, të muzikës dhe të filozofisë, që adhuronte dhe praktikonte pikturën dhe arkitekturën. Ai ka lënë fare pak gjëra teorike. Por edhe aq sa ka lënë ai është i vetëmjaftueshëm. Në artikullin "Përmbi poezi përgjithësisht", ai është shprehur qartë dhe pa ekuivoke: "Por kena e poezisë nuk pshtetet në të shprehun e në stil, por ma fort në send" [1] Në mënyrën e arsyetimit dhe në përparësinë që i njeh përjetimit poetik, frymës së poezisë të kujton Luigj Gurakuqin.

Dhe përtej adhurimit të natyrshëm për poetët latinë, afrimitetit shpirtëror që ka me romantikët italianë Karduçi, Paskoli dhe D'Anuncio në qendër të veprës së tij fokusohet historia kombëtare, shqetësimet e kohës historike të Rilindjes dhe dashuritë dhe dhimbjet e kohës letrare të romantizmit që do të nxirrnin në reliev, lidhjet e thella të brendshme, të pandara të poetit me filozofinë, kulturën dhe botën e madhe shpirtërore të shqiptarëve që i dha dritë dhe origjinalitet veprës së tij poetike. Fati i atdheut dhe i shqiptarit, liria e tyre do të përthithnin energjitë e tij krijuese. Rreth këtyre poleve liria e Atdheut, liria e individit do të përftohen idetë e tij në formë krejtësisht të mëvetësishme dhe origjinale.

Me një simbolikë dhe metaforikë jo të panjohur më parë, ai e fillon krijimin poetik që hyn në një konotim që përcjell përjetime poetike që shprehin qartë identitetin e tij krijues që në krijimin e tij të parë "Vaji i bylbylit", çfarë ndodh shumë rrallë me poetët. Internacionaliteti i institucioneve ku studion vetmia, anonimiteti që e shoqëron në ato mjedise kanë lënë gjurmë në këtë krijim të parë të Mjedës, por prirjet e tij rilindëse i kanë dhënë shumë rrafshe kuptimi simbolikës sa që në vetëdijen e lexuesit ajo të mund të identifikohet me vetë poetin, me njeriun, me shqiptarin dhe në një kuptim të shtrirë me atdheun.

I rëndësishëm është fakti se me intuitë e vetëdije ai ka ndërthurur

shqetësimin për lirinë e Atdheut me shqetësimin për lirinë dhe të drejtën e njeriut dhe kjo e realizuar në një trajtë të veçantë të subjektit lirik, shfaqje nga më të spikaturat e individualitetit të tij.

Kjo temë – më e rëndësishmja në veprën e poetit, hyn në rezonancë me kohën historike e letrare të Rilindjes Kombëtare, duke e bërë një nga shprehësit më të fuqishëm dhe më autentikë të saj. Ajo do të njohë në veprën e poetit të gjitha pamjet që nga himnizimi dhe kulti romantik për të shkuarën që ai reflektoi në poezitë "Vorri i Skënderbeut", "Mahmut Pasha në Mal të Zi"; kulti i atdheut, gjuhës tek "Malli për atdhe", "Gjuha shqipe", kulti i së ardhmes së lirë tek poema "Liria". .

Nga këto vlen të theksohet vlera e tetralogjisë së projektuar por që mbet e parealizuar, plotësisht, por që gjithsesi dha modelin klasik të kultit të së shkuarës si në brendi dhe në formë, në poemat me tingëllima "Lissus" e "Skodra" me të cilat i ngre përmendore letrare qytetërimit dhe qëndresës ilire.

Por kurorën këtij shqetësimi ia vë poema me tingëllimë, "Liria" që mbetet një gjerdan perlash që lëshojnë xixa bukurie fjale e poezie.

Vlerësimi poetik realizuar në metra, strofa dhe vjersha sa shqiptare dhe klasike nuk vjen si eksperimentim formal në vetvete, as si instrumentalizim teknik i ftohtë, por si një nevojë e thellë e brendshme për të përputhur në një të vetme vlerën dhe shprehësinë estetike të fjalës.

Vargjet pesë, shatë, tetë dhe dhjetërrokësh i rapsodive shqiptare i ka dhënë dorë poetit të krijojë atë derdhje fjale që shpreh ndjesi të thellë dhe melodi ose të shprehë atë rrokullisje së fjalës që i ngjan rropamës së ortekut që rritet nga zemërimi i subjektit lirik që vë përpara e shtyp e i jep tatëpjetën gjithçkaje që i bie ndesh lirisë, ashtu siç ngjet me dhjetërrokëshat e poezisë së paarritshme Mustafë Pasha në Babunë që është antipodi apo antivlera e Mahmud Pashës.

Me tingëllima, për të cilat Martin Camaj do të shkruante, duke shprehur adhurim të pakufishëm për mjeshtrin, përvojën e tij të paarrirë nga të tjerët: "Njimbëdhjetë rrokësh mundet me pasë mija muzikalitetesh"[2] me strofa plastike plot muzikalitet me tone himnike që gurgullojnë në vargje nga variacioni i theksave ritmikë janë ndërtuar poemat "Lissus" e "Scodra" dhe veçanërisht "Liria". Në këto prurje klasike xixëllon forca e jashtëzakonshme dhe e veçantë e shqipes veriore, që me sa ndjehet është e lindur dhe e denjë për të tilla krijesa poetike monumentale.

Inversionet, shtimi i theksave ritmikë, bartjet e habitshme mjedjane i japin hapësirë të pamasë përfytyrimit dhe ngjyresën e afreskeve murale.

E kush mund ta artikulonte aq hijshëm njëmbëdhjetërrokëshin si Mjeda, për të cilin Ernest Koliqi do të shkruante se "ia len dalë poetëve ma të ardhangët (të fuqishëm) latinë"[3]

Por poezinë e tij e bën të jashtëzakonshme dhe vlerë të veçantë, një krijim jo voluminoz por i rrallë siç është gjithë krijimtaria e poetit, i afirmuar si i tillë në hierarkinë e veprave letrare të shqipes të të gjitha kohërave që ka nxitur aq shumë vështrime, qëmtime, hulumtime dhe studime. Dhe në këtë kryevepër, siç është cilësuar që i ka të rralla shoqet në krejt letërsinë tonë, Mjeda shpërfaq magjishëm identitetin e tij krijues, talentin në gjen të poetit.

Ndër aq vlera që ka kjo vepër, vlen të veçohet së pari ideja poetike, sado që për këtë problem është folur mjaft. Janë artikuluar mendime nga më të ndryshmet, ku nuk kanë munguar vlerësime të drejta e të qëndrueshme.

Mjeda ka meritën që në këtë vepër tepër interesante në tërësinë e saj poetike edhe pse jo i pari, dhe jo i vetëm arrin të fokusojë në krijimin e tij me sa thuhet më të dashur për poetin, një nga temat apo argumentet nga më të rëndësishmet, më të përhershmet, më universalet e më të natyrshmet, të qëndrimit ndaj jetës dhe vdekjes, kthimin tek e cila e solli Rilindja Evropiane. E në letërsinë tonë ajo i ka fillesat e veta tek Barleti që në veprën e tij flet për brishtësinë e njeriut, për njerëzit që "nuk mjafton tua qajmë hallin, por të vuajturve duhet t'u japim dorën e tua lehtësojmë vuajtjet"[4] Një tjetër shqiptar evropian Leonik Tomeo do t'i thurë himne jetës njerëzore në poezitë me frymëzime humaniste si në vargun:

"E bukur, e qetë e shenjta jetë"[5]

Ndërsa Pjetër Budi edhe pse me një etikë fetare të ndriçuar nga humanizmi e sheh të zhvleftësuar sqimën, madhështinë dhe pasurinë ndaj një dukurie të pashmangshme për të gjithë njerëzit siç është vdekja.

Meditimi për jetën dhe vdekjen është pothuajse i pranishëm në veprën e P. Vasës, De Radës, Serembes, S. Frashërit, N. Frashërit, F. Shirokës, L. Gurakuqit, Çajupit, Asdrenit etj.

Janë tema të mirëfillta romantike që joshin dhe nuk i shmangin romantikët tanë. Dhe secili nga romantikët shqiptarë ka dhe ruan optikën e tij ndaj këtij problemi. P. Vasa, De Rada, Naimi, Shiroka, Serembe e Gurakuqi janë më afër romantikëve të Evropës. Nga të cilët veçojmë vargjet e L. Gurakuqit. "Oh jeta, përnjimend plot rrena qenka n'këtë botë të lashtë/ u shueka tepër shpejt lakmimi i i saj/ Si zjarmi i bamë me kashtë". Kjo temë që mbeti tërheqja e të gjithëve në veprën e S. Frashërit, Mjedës, Çajupit u mpleks me një optikë sociale që e afronte produktin

letrar me të vërtetat e jetës që kushtëzonin kuptimin e saj, duke i dhënë letërsisë një sens meditativ modern sado që në fillimet e këtij përftimi.

Por nga të gjithë Mjeda i ka vënë kurorën shqetësimit njerëzor universal duke e artikuluar me aq konkretësi, thjeshtësi dhe bukuri pa retorikë e moral të pajetë.

Diskutimit të gjatë dhe jo pak të ndërlikuar lidhur me zhanrin e poemës lidhur me komponentët e saj, dimensionin filozofik e social të saj, përparësitë e tyre në por diskutimit për poetikën e mbyllur apo të hapur të poemës, të romantizmit apo realizmit të saj u qëndrojnë thuajse mrekullisht bukur përballë 296 vargjet e poemës dhënë me një arkitekturë të përpiktë përmes një shkallëzimi të çrregullt asimetrik në kompozimin e saj.

Sensi i masës, përpjesëtimi ka krijuar raporte matematike që vihen re po të arsyetosh për numrin e vjershave apo numrin e vargjeve që realizojnë triptikun, që ka subjekt, tre personazhet e njohura, Trinën, Zogën dhe Loken.

Me intuitë apo me vetëdije, dhe me të dyja bashkë poeti është ngritur dhe ka prekur "pikën e prerjes së artë" në një vepër letrare ku "njësia me vogël" (Trina), është në raport me "njësinë më të madhe" (Zoga), ashtu siç është "njësia më e madhe" në raport me të tërën: Poeti që ka njohuri nga artet figurative, nga muzika dhe arkitektura arrin dhe mund të arrijë në zgjidhje të tilla, që e bëjnë tejet të beftë në vlerat e saj veprën e tij dhe shumë interesante atë.

Ndërsa për nga kumti dhe sistemi i kuptimësisë poeti është ndër ata krijues shqiptarë që iu afrua kufijve tepër delikatë që nga fillesat e njerëzimit deri në kohët moderne dhe postmoderne që ekzistojnë midis vlerave, kuptimit, qëllimit, bukurisë së jetës dhe absurdit të saj që përbën antipodin e tyre. Brishtësia e kufijve bën që njerëzit të gjenden nga njëra apo nga ana tjetër për arsye që janë jashtë tyre, por ndonjëherë të shkojnë edhe me vetëdije e mosdije, apo të luhaten në mënyrë të habitshme midis tyre. Prandaj edhe kumtet e veprës edhe pse të shterueshme krijojnë një spektër të gjerë duke marrë trajtën e një sistemi kuptimesh.

Duke reflektuar thellë për këtë sistem vlerash që poeti i realizon me aq pak e aq shumë në të njëjtën kohë detajesh reale që të kujtojnë por dhe që e tejkalojnë realitetin shqiptar, poeti të shtyn e të zhyt në përsiatje të shumta.

A nuk vjen që nga një lashtësi e thellë e letërsisë së njerëzimit dilema e dhimbjes që shkakton ndërprerja e jetës, dilema e njeriut midis jetës qeshëse dhe vdekjes kërcënuese. Epi i Gilgameshit[6] që vjen nga qytetërimi

i lashtë babilonas 4000 vjeçar është pronë e ndijësimit të hershëm të njerëzve për atë çfarë e lidh dhe në të njëjtën kohë i ndan këto fenomene pazgjidhshmërisht që përcjellin rrugëtimin e gjatë e të pafund të njerëzimit. Ndonëse më vonë në kohëra edhe miti i Sifizit bart shumë ndjeshmëri, shumë meditim që reflekton sot e gjithë ditën në mendjet e njerëzimit.

E parë në këtë optikë universale njerëzore, vepra e Mjedës "Andrra e jetës" është ndër të vetmet vepra që i qaset kësaj ndjeshmërie njerëzore, edhe pse e vendosur në një mjedis shqiptar. Edhe kur e kanë ndjerë tejkalimin e ndjeshmërisë së autorit, studiuesit janë mjaftuar të shprehen për përmbajtjen e autorit në pamjen e kritikës sociale, rrafsh që dallohet në vepër, por që s'është i vetmi qëllim i autorit. Veprës i jep thellësi tejkalimi i këtij argumenti, edhe nëse nënkuptohet.

Poema "Andrra e jetës" ka një strukturë të ndërlidhur kuptimesh e vlerash që funksionojnë në një njësi të vetme. Edhe pse e veshur me tisin e hollë të një perceptimi romantik, poema me dy kuptimësinë e saj prek në mënyrë të habitshme të vërtetat e dy fenomeneve jashtëzakonisht të rëndësishëm midis tyre. Pikëzimi poetik mjedjan që arrin të japë një pamje aq transparente të jetës njerëzore, ndjeshmëria dhe kumti pa shumë detaje por plot domethënie i vdekjes së vogëlushes Trinë apo i nënë Lokes që qëndron aq larg apoteozës së përjetësisë së shpirtit melakonizmin tipik mjedjan "u ndal drita e ajo mbaroi ", apo mrekullimi dhe mahnitja sugjestionuese që të sjell zgjimi dhe realizimi i dashurisë dhe i mëmësisë në qenien fluide të Zogës, a thua se kemi të bëjmë me gëzimin dhe dritën e jetës së pafund.

Sistemi kuptimor shumë shtresor i veprës nxit përsiatje e meditime tek lexuesi ashtu si edhe është pohuar [7] të cilat qartësojnë vetëdijen e tij i japim botë jetës së tij të zakontë, por sakaq ata i japin edhe kuptim dhimbjes dhe tmerrit të vdekjes që në poemë ndjehet si pjesë e jetës, si vazhdim i panatyrshëm apo i natyrshëm i saj. Këto kumte të paprekura më parë në letërsinë shqiptare i japin veprës një vend dhe një rol të veçantë në këtë letërsi.

Që poema të sugjestionon për qëllimin, bukurinë dhe ngadhënjimin e jetës, për çfarë shërben veçanërisht kulmi i saj i ndritshëm, që realizon pjesa që i kushtohet Zogës, ku gjithçka ndrit, buzëqesh, josh, ndjell gëzim e hare. Dhe Mjeda na shfaqet i paarritshëm në këtë poemë. Por ai sakaq edhe për vdekjen arrin të artikulojë poezi me shumë shtresa kuptimi, si ajo që na jep pjesa e parë dhe e tretë e poemës. Dhe ka një drejtpeshim emotiv të habitshëm. Me nëntekstin e fuqishëm ai ka shprehur dhe

shqiptuar vdekjen e dhimbshme të Trinës, që mbetet shëmbëlltyra e krijesa të pafajshme e të pambrojtura por edhe vdekjen e Lokes, që e thellon dukurinë e mungesës totale të mbrojtjes. Dhe në të dy rastet ka natyrshmëri, nuk ka pompozitet, nuk ka tjetër, veç humanizëm dhe dashuri dhe vetëm dashuri që ai sjell dhe kultivon me poemën e vet.

Poeti Ndre Mjeda i sheh të lidhura pazgjidhshmërisht të dy fenomenet si jetën dhe vdekjen, dhe në këtë lidhje qëndron universaliteti i poemës. Në një vend të veprës së tij Franc Kafka shkruan: "Vdekja na rri përballë, pak a shumë siç rri varur tablloja e betejës së Aleksandrit të Madh në murin e një klase shkolle. Ajo që ka rëndësi është zbehja apo fshirja e asaj tabloje, ende sa jemi gjallë, përmes veprimtarive tona.[8]

Vepra e Mjedës duke himnizuar jetën, bukurinë, simfoninë e saj, pohon edhe vdekjen si një anë ekzistenciale e saj. Por nuk janë vetëm këto që i kanë shqetësuar dhe shprehur njerëzit që nga Epi i Gilgameshit apo Miti i Sifizit e të tjerë pas tyre, vepra është e mbushur plot e përplot me detaje të magjishme përmes të cilave poema e percepton jetën dhe vdekjen dhe njeriun si protagonist të tyre. Prandaj dhe ka aq shumë substancë absolute, atë përsosmëri të përhershme që e ka bërë dhe e bën veprën aq të pranuar dhe aq të pashlyer në horizontin e pritjes të të gjitha kohërave.

Të tillë veprën e Mjedës e bën poetika e saj, laboratori i veçantë i poetit. Dhe këtu do të veçonim strukturën dhe arkitekturën e saj.

Në traditën letrare shqiptare qe lëvruar gjerësisht poema, nga autorët që e shkruajnë shqipen me alfabet arab, nga arbëreshët, nga romantikët shqiptarë. Por me veprën "Andrra e jetës", Mjeda e kapërcen traditën e poemës monokolone, monostrafike e monometrike jo thjesht si pasurim formal, por në funksion të tekstit poetik. Me sistemin e saj kuptimësor shumë shtresor poema qëndron midis poemës klasike dhe poemës me poetikë të hapur dhe nga forca me të cilën artikulon dhe shpreh problematikën sa universale aq edhe të veçantë ajo tejkalon kohën historike e letrare në të cilën është formuar, duke qenë jo vetëm produkt i saj, por edhe veprën që prodhon kohë, kapërcen kohë dhe hap shtigje të reja për letërsinë kombëtare.

Ndër aq vlera për t'iu riqasur veprën së poetit, është dhe rizbulimi i vlerave estetike të shqipes së veriut, estetika e fjalorit të tij poetik. Leximi dhe rileximi i poezisë së tij të fut mes befasish të regjistrave poetike të shqipes e në veçanti të asaj që flitet në Shkodër, që është mbase i vetmi logos shqipfolës që përmban variacione dhe forma që nuk gjenden gjetiu. Ky variacion rrit pasurinë e arealit gjuhësor, shpërfaq fenomene fjalë

dhe kuptime të pazëvendësueshme si: me shungullue, me u çerlikë etj, apo shprehje: rreth e rrotull, kand e kand etj. Mjeda di të shfrytëzojë edhe trajta të stilit të zakontë plot bukuri që në vargjet e tij marrin apo më drejt shpërfaqin një tingëllim e melodi gati të padalluar jashtë tekstit letrar si në këtë pjesë të veprës.

E tuj gjimue
Shkon rreth e rreth
Nji përrue
qi veret
Rrjedh nëpër gjeth.

Vepra e tij në tërësi është jo vetëm thesar vlerash poetike, por edhe thesar kuptimesh, nuancash melodike të fjalës, e regjistrash gjuhësorë.

Në tërësinë e saj filozofike – poetike, vepra letrare e Ndre Mjedës, me magjinë e saj poetike qëndron midis dy kohëve historike, shekullit të artë të Rilindjes dhe shekullit 20, midis kohës letrare klasike-romantike dhe kohës letrare moderne. Kjo i jep veprës së poetit atë origjinalitet të papërsëritshëm dhe atë vend të veçantë në kujtesën letrare kombëtare.

REFERENCA

Ndre Mjeda: Vepra letrare, 2, Tiranë 1988, fq. 111-119
Martin Camaj: Tri letra të Martin Camajt dërguar Krist Malokit.
Phoenix, viti IV i botimit, nr. 3-6 (17-23), Shkodër, 2000; fq. 211
Ernest Koliqi: Çajupi e Mjeda në 100 vjetorin e lindjes, “Shejzat”, vjeti X, nr. 5-8, Romë, 1966
Marin Barleti: Rrethimi i Shkodrës, Tiranë, 1982, fq. 6
Mahmut Hysa: Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare, 1, Shkup, 1992, fq. 28
Epi i Gilgameshit, Përkthyer nga gjermanishtja nga autori Berisha, Tiranë 1990
Shih: Pashko Gjeçi: “Andrra e jetës” e D. Nre Mjedës, “Shkendija”, nr. 8-9, Tiranë 1943, fq. 28-34; Grup autorësh: Letërsi shqipe, Tiranë 1959
Mark Gurakuqi: Mbi veprën poetike të Mjedës, Tiranë 1980
Rinush Idrizi: Ndre Mjeda, Tiranë, 1980
Grup autorësh: Histori e Letërsisë shqiptare, Tiranë, 1983
Rexhep Qosja: Panteon i rralluar, Tiranë, 1988
Franc Kafka: Maksima, Tiranë, 2006, fq. 68.

Mr. Haxhi SHABANI

RRËNJËT DHE DEGËT E NJË LETËRSIE

Rrënja dhe dega

Letërsitë e ndryshme në botë, sa i përket vendeve e shteteve, gjuhëve dhe rajoneve në të cilat janë krijuar kanë histori nga më të çuditshmet. Thuhet zakonisht se janë qendrat të cilat prodhojnë vlerat më të larta në kulturë e letërsi. Por, duke pasur parasysh ndryshimet kronologjike, kur një qendër mund të bëhet periferi dhe anasjelltas dhe në kohën aktuale kur tashmë realisht një shkrimtar mund të bëjë letërsi për çmimin Nobël edhe duke jetuar në një ishull, është relativizuar edhe më shumë pohimi se vetëm qendrat mund të krijojnë vlerat e vërteta letrare. P.sh. në qoftë se Parisi deri vonë mund të konsiderohej qendra kryesore e letërsisë, aktualisht Londra e Nju Jorku, mund të jenë më përpara.

Në rrafshin shqiptar, nëse mund të thuhet se janë Tirana e Prishtina të cilat përbëjnë qendrat kulturore shqiptare, nuk do të thotë se të këtilla kanë qenë gjithnjë. Po përmendim rolin në këtë drejtim që e ka pasur Shkodra në kulturë e letërsi, deri në vitet e pasluftës së dytë Botërore. Po të mos ishin, sidomos autorët shkrodranë në letërsinë shqiptare: Fishta, Camaj, Koliqi, letërsia shqiptare do të kishte një pamje tjetër, sigurisht më të zbehtë. Por, po t'i relativizojmë kufijtë politikë të vendeve shqiptare, gjeografikisht Ulqini është në mes të vendeve shqiptare. Dhe ky mes që pastaj mund të dalë se ka qenë pikërisht i destinuar që të jetë vend ku ka nisur të bulojë për herë të parë letërsia shqipe, ka mbështetje në një fakt që tashmë është i pranuar gjerësisht nga personalitetet më të

njohura të shkencës së albanologjisë. Fjala është për pohimin se autori i parë i gjuhës shqipe, Gjon Buzuku ka lindur dikund në trekëndëshin Ulqin-Tivar-Shkodër. Përpos këtij fakti, dëshmia më e hershme për mundësinë e të folurit dhe të shkruarit shqip e Atë Brokardit e ka vulën e vitit 1333 dhe të qytetit të Tivarit, na bënë të relativizojmë edhe më shumë se pjesa e letërsisë shqipe që është krijuar, sot në kuadër të kufijve politikë të Malit të Zi, është periferike. Realisht libri i parë i gjuhës shqipe "Meshari" i Buzukut së bashku me dëshminë e Atë Brokardit, mbase të parën për gjuhën shqipe dhe fakti i ekzistimit të qendrës së kulturës dhe letërsie si rrjedhim, na bënë që të pohojmë me siguri se epitetet kulturë e letërsi periferike apo të skajshme për këto vende: Shkodrën e Ulqinin luhatën përfundimisht. Prandaj, në diskutimin e çështjes se kush është apo ishte qendër e periferi në letërsinë e kulturën shqiptare, mund të thuhet, duke u nisur nga ky këndshikim i problemit, se pikërisht aty ku sot mund të thuhet se janë degët e letërsisë në nisjen e lindjes së kësaj letërsie, ishin rrënjët.

Dy degët e origjinës

Duke këmbëngulur në gjetjen e rrënjëve të vërteta, mund të vërejmë se edhe bimët, drunjtë, p.sh, kur shikojmë degët e një lisi, aty gjejmë edhe rrënjët e tij. Në këtë drejtim mund të shikohet edhe letërsia e sotme shqiptare që është shkruar nga shqiptarët që janë me origjinë nga vendet shqiptare në Malin e Zi, apo jetojnë këtu.

Pikërisht shkrimtarët që kanë hyrë në librin me titullin "Dega e një trungu" përzgjedhur nga shkrimtari Hajro Ulqinaku e vërtetojnë sidomos dy emra: Esat Mekuli dhe Rexhep Qosja. I pari, në krijimtarinë e tij të hershme vjen me nota nostalgjike për vendin e tij të origjinës, kurse më pastaj shndërrohet në emërues të përbashkët të ideve, qëllimeve të gjysmës së pjesës më të dhimbshme shqiptare, që është Kosova. Esat Mekuli me poezinë e tij do të jetë artikuluesi i përjetimeve individuale të shqiptarëve të Kosovës dhe i fatit të përgjithshëm të saj, por më në fund ai do të jetë edhe përjetuesi i zhgënjimeve të mëdha. Kurse në planin kulturor, arsimor, mediatik e shkencor Esat Mekulit i njihet merita e themeluesit, pionierit të institucioneve përkatëse në Kosovë.

Emri tjetër, që po ashtu rrjedh nga trevat shqiptare në Malin e Zi, Rexhep Qosja, aktualisht është padyshim një nga njerëzit më me kulturë shumëplanshe që nga letërsia e deri te filozofia në tërë hapësirën

shqiptare. Ndihmesa e tij në studimet letrare mund të matet me arritjet e institucioneve në nivel evropian. Kurse veprimtaria e tij e pastër imagjinative letrare, me befasitë në metodologji dhe përmbajtje, mund të merret si model sesi duket shkruar përballë njëtrajtshmërisë që letërsisë shqiptare ia ka marrë frymën.

Të dy këto personalitete të kulturës dhe letërsisë shqiptare dhe më gjerë: Esat Mekuli dhe Rexhep Qosja kanë arritur që të bëhen emra të pashmangshëm në fushat e kulturës shpirtërore shqiptare dhe asaj të Kosovës në veçanti, edhe pse kanë lindur në periferinë gjeografike të sotme shqiptare.

Dy shkrimtarët e tjerë përfshirë në këtë libër: Hajro Ulqinaku dhe Nol Berisha kanë hyrë në letërsinë shqiptare pikërisht falë trajtimit të duhur letrar të mjediseve nga vijnë: i pari nga bregdeti dhe i dyti nga malësia. Këta dy autorë zënë vendin e tyre në letërsi, duke u bazuar në faktin e pasurimit të letërsisë me tema, personazhe, ngjarje e mjedise nga vijnë. Dy autorët e tjerë: Asllan Bisha dhe Ibrahim Berjashi vijnë në këtë përzgjedhje për të dëshmuar se letërsi shqipe është shkruar në Malin e Zi edhe atëherë kur gazetën në gjuhën shqipe është dashur ta mbështjellësh me një gazetë në gjuhën serbokroate, siç quhej atëherë. Ata të dy së bashku, reflektojnë në veprat e tyre motivin e vendlindjes, duke sjellë aromën e bregut të Bunës dhe Liqenit të Shkodrës (anën e këndejme). Përfshirja në këtë libër e Zuvdija Hoxhiqit dëshmon për ekzistimit e situatave jotipike në letërsi. Ky autor i cili nuk shkruan në shqip, por që temat, personazhet, ngjarjet i ka shqiptare dhe është shkrimtari, i cili pothuajse, të gjitha veprat i ka të përkthyera në shqip, ka botuar romanin "Viti i Gucisë" për ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit, në kohën kur ajo ngjarje ishte e anatemuar në ish-Jugosllavi. Dhe së fundi, inkuadrimi edhe i disa autorëve të tjerë, besoj ka si pretendim formimin e pasqyrës së plotë për degën e një letërsie, siç ka dëshirë ta quajë autori i përmbledhjes, Hajro Ulqinaku.

Shkrimtarët që janë me origjinë nga trevat shqiptare në Mal të Zi, por që krijimtarinë e tyre e kanë zhvilluar në Prishtinë dhe ata që jetojnë në këto treva përbëjnë dy degët e një letërsie të përbashkët që është letërsia shqipe, kurse pesha e secilës degë edhe pse nuk është e njëjtë, ndikojnë që të krijojnë drejtpeshimin e tërë drurit të letërsisë në tërësi.

Roli i doracakut

Libri “Dega e një trungu” e cila iu kushtohet lexuesve të moshës fëmijërore dhe të rinjve ka si një nga qëllimet që të mbulojë sadopak atë boshllëkun që ekziston sa u përket botimeve të teksteve letrare të autorëve të vendlindjes për nxënësit shqiptarë në Malin e Zi. Në bazë të plan-programeve shkollore parashikohet që për autorët e mjedisit ku jetojnë nxënësit të kenë orë të posaçme, rreth 20% të tyre. Ky libër është projektuar si i këtillë që t’u vijë në ndihmë nxënësve të shkollës fillore për të mësuar autorët e letërsisë shqiptare të cilët jetojnë apo janë me origjinë nga Mali i Zi. Si rrjedhim, shkollat dhe institucionet përkatëse ministrore do të duhej të kenë reagimin e duhur për ta bërë këtë libër pjesë të teksteve shkollore. Në anën tjetër, ky është vetëm një nga librat e duhur në shërbim të krijimit të nxënësit shqiptar në Malin e Zi me dije e kulturë si të gjithë bashkëmosharët e tyre në këtë vend.

Ulqin, 20 maj 2008

Sahibe HOXHA

LETËRSIA PËR FËMIJË E SHKRIMTARËVE SHQIPTARË NË MAL TË ZI

Letërsi artistike është një formë e njohjes dhe e vlerësimit ideor dhe estetik të realitetit. Ajo e pasqyron jetën me anën e figurave artistike. Karakteristikë e figurave artistike është se vetitë thelbësore të jetës ato i mishërojnë në individë të veçantë me veçoritë e tyre individuale, domethënë, me anën e personazheve, në pamje të gjallë të natyrës ose të jetës së njerëzve, në ndjenja emocione e në gjendjen e tyre shpirtërore konkrete etj. Pra, veçoritë e letërsisë si lloj i artit është se synon t'i paraqesë njerëzit, ndjenjat mendimet e dëshirat e tyre në një formë sa më konkrete e të gjallë. Kjo është një ndër arsyet që veprat artistike pëlqehen e kërkohen nga të gjithë njerëzit. Veprat e mira letrare na lartësojnë shpirtërisht, na ndihmojnë të mposhtim dobësitë tona. Çdo vepër e re artistike çel një dritare të re për të parë e kuptuar botën me larminë e pafund të dukurive të saj. Vlera njohëse e letërsisë artistike na ndihmon për të njohur më mirë karakterin tonë, shqetësimet, dëshirat e synimet tona, vendin që zëmë në jetë. Letërsia na jep mundësi për të njohur më mirë edhe njerëzit e tjerë me të cilët ndeshemi në jetë, për të njohur vetitë e tyre karakteristike, të mirat e të metat e tyre. Vlera njohëse e letërsisë artistike buron, në radhë të parë, nga njohja e thellë prej shkrimtarit e shoqërisë njerëzore, e realitetit që pasqyrohet artistikisht. Shkrimtarët në veprat e tyre më të mira pasqyrojnë epokën në të cilën jetojnë, dëshirat, gëzimet e hidhërimet e jetës së tyre personale. Duke na njohur me jetën e njerëzve, letërsia edukon me vetitë më të mira morale,

me dashurinë për të vërtetën. Vlerat njohëse dhe edukative të letërsisë dalin përmes vlerave të saj estetike. Këto vlera, nuk ekzistojnë asnjëherë të veçuara. Në çdo vepër letrare ato janë të shkrira njëra me tjetrën dhe veprojnë njëkohësisht tek lexuesi. Nëse ato shkrihen natyrshëm në një vepër letrare, kjo e fundit i reziston kohës e mbetet përherë aktuale. Shprehja më e sinqertë e ndjenjave dhe e mendimeve të shkrimtarit, e mishëruar në një formë të lartë artistike, ndikon drejtpërdrejt në botën shpirtërore të lexuesit dhe mbetet në mendjen dhe zemrën e tij. Në vepra të tilla ne shpesh ndjejmë të gjejmë vetveten. (1- Enver Muhametaj - Xhevat Lloshi, "Teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore").

Letërsia për fëmijë e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi është e zhvilluar dhe me vlerë. Shkrimtarët në Mal të Zi, si dhe botuesit e librave, po bëjnë një punë të madhe për të qitur në dritë vlerat e vendlindjes, duke botuar dhe përhapur tek lexuesit.

Antologjia për fëmijë "Degë e drurit të urtë", libri i parë për fëmijë e të rinj me shkrimtarë shqiptarë nga Mali i Zi, është një ide tejet origjinale me përmbajtje e tematika të ndryshme, me karakter edukativ, e me një përzgjedhje shumë të qëlluar prej dhjetë autorësh, dhjetë zëra për veten dhe historinë e popullit të vet. Është një polifoni e kësaj ane e shqiptarëve në Mal të Zi, është një pasuri, një kulturë e traditë, duke përfshirë momente e situata, përjetime dhe emocione të ndryshme. Shkrimtarët në Mal të Zi u bënë urë lidhëse dhe mirëkuptimi, me vendet se ku dhe kur kanë jetuar e vepruar, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe në hapësirat ku jetojnë e veprojnë shqiptarët. Mendoj se ka edhe shkrimtar tjerë, por secili libër duhet të ketë fillimin e mbarimin, prandaj këtu u zgjodhën, thjeshtë ata letrarë.

Antologjia për fëmijë "Degë e drurit të urtë", përfaqësohet me shkrimtarët: Esad Mekuli, Nol Berisha, Rexhep Qosja, Hajro Ulqinaku, Ali Llunji, Idriz Ulaj, Zuvdija Hoxhiq - Berisha, Ali M. Ahmeti, Asllan Bisha dhe Ibrahim Berjashi.

Në këtë antologji janë përfshirë punimet e shkrimtarëve të krijuara që më parë, disa edhe në fillim të krijimtarisë, si studentë, e disa nga përjetimet si pedagogë, apo nga përjetimet e vet shkrimtarëve me motive të ndryshme nga ambienti që i rrethon, natyra e vendlindjes së vet, vendin se ku jeton e vepron akëcili krijues. Sidomos përshkruhen përjetimet dhe emocionet duke iu afruar kështu botës së fëmijëve me të gjithë origjinalitetin dhe natyrshmërinë e përshkrimeve që fëmijëve u bëhet e dashur dhe e afërt leximi i këtyre punimeve. Ata i ndjejnë dhe i përjetojnë po me atë dashuri si i përjetoi shkrimtari. Me gjithë këtë angazhim dhe

punë gjatë viteve, shkrimtarët në Mal të Zi kanë arritur të realizojnë deri - diku kërkesat e popullit shqiptar, pas shumë situatave të ndërlikuara që janë zhvilluar në këto treva, duke treguar aftësi dhe fuqi për zgjidhje sa më të drejtë prandaj, suksesi nuk mungoi. Duke vepruar në këtë drejtim, duke zbuluar vlerat e secilit me një bashkëpunim, mendoj se afirmohet ajo që është më njerëzore, kultura e një popullit, sot e nesër.

Autorët e kësaj përmbledhje "Degë e drurit të urtë", antologjisë për fëmijë e të rinj, shkrimtarët shqiptarë në Mal të Zi, janë personalitete të shquara në të gjitha këto treva, në rrafshin Ballkanik e më gjerë. Në veprimtarinë e tyre kanë përfshirë të gjitha kohët e moshat, duke pasur si motiv qenësor fëmijët, vendlindjen e dashur dhe përjetimet fëmijërore. Fjala letrare e tyre është zëri, fryma dhe shpirti i popullit të tyre, të kulturës dhe traditës së këtij populli të lashtë, që dikur fjala e shkruar shqipe dhe emri shqiptar ishte frikë të shqiptohej.

Ndërsa sot po shpërthen, falë intelektualëve, e sidomos shkrimtarëve vendas, po gjithsesi edhe atyre të huaj që e duan dhe e adhurojnë vendlindjen. Ata e ndjejnë dhe e përjetojnë çdo pjesë të natyrës së vendit të vet dhe shpirtin e popullit të tij. Edhe pse jetuan (jetojnë) e veprojnë larg vendlindjes, motivi kryesor ishin (janë) fëmijët dhe vendlindja. Duke qenë shumë të afërt me fëmijë i kuptojnë lehtë preokupimet, gëzimet e shqetësimet e tyre.

Shkrimtarët përdorin një gjuhë letrare, me një fjalor të pasur me fjalë e shprehje të kuptueshme, të qarta, konkrete e reale që i afron lexuesit e vegjël, e gjithsesi dhe të rinjtë që me kënaqësi ta lexojnë veprën dhe ta ritregojnë me dashuri. Lexuesve ua mundësojnë që të mendojnë për përjetimet e veta.

Si përfundim mund të themi se kjo përmbledhje e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi e karakterizon në masë të madhe interesimi i lexuesit për librat e shkrimtarëve vendas, që kanë tematikë nga vendlindja dhe fëmijët i lexojnë me kënaqësi.

"Degët e drurit të urtë" na mundëson që për herë të parë të mbërrijë tek lexuesit libri – përmbledhja – antologjia, për të na njoftuar për së afërmi me shkrimtarët shqiptarë nga Mali i Zi, që jetojnë apo kanë jetuar, por që punojnë e veprojnë edhe jashtë vendlindjes, duke mos e harruar kurrë vendlindjen popullin dhe përjetimet e veta fëmijërore, rrënjët e prejardhjes së vet, rrënjët e thella e të degëzuara në shumë hapësira, por prej të njëjtit trungu, në këto troje të lashta.

Kjo pasuri kulturore e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi është një nxitje për talentet e rinj të pazbuluar në fushën e letërsisë, një shtytje e

kurajë e madhe një mbështetje, se po vlerësohet e botohet njëkohësisht po lexohet letërsia për fëmijë.

Pra duhet të kuptojmë se dituria dhe kënaqësia janë trashëgimia më e madhe, sepse, siç thotë dijetari Hasan el Basri: “Mendja, sjellja dhe butësia është shoku, udhërrëfyesi dhe këshilluesi më i mirë”.

ESAD MEKULI

Poet që për jetën shqiptare në viset ku jetoi shfaqet si portretist, psikolog, sociolog, e mbi të gjitha si humanist i pashoq. Ai krijoi duke u frymëzuar prej jetës e rrethanave në të cilat është gjendur populli të cilit ia ka kushtuar tërë veprimtarinë e vet poetike, të gjitha ëndërrimet e aspiratat e veta prej kah ka nxjerr; motive për krijimet e veta më të bukura. Prandaj edhe themi se është gjithnjë e angazhuar fjala artistike e Esad Mekulit, e frymëzimit poetik i drejtpërdrejtë, i sinqertë e i qartë shfryrje ndjenjash të njoma e klithjesh buçitëse, protestë për gjendjen e mjerueshme në të cilën është gjendur populli i tij, thirrje për luftë e përpjekje, dhimbje për vuajtjet e padijen, e gëzim për ditët e agimet e reja.(1- Vehap Shita, Esad Mekul, “Për ty”).

Poezitë e veta Mekuli i ndan në tri grupe që i përkasin tri periudhave historike të popullit të para luftës, të luftës e të mbas luftës, kur ka krijua e veprua. Çdo kohë në poezinë e tij është sintezë e asaj peshe sociale e psikologjike që breznitë i lënë njëra tjetrës. Pra, poeti është bërë lajmëtar i kohës dhe për nga misioni afrohet shumë me Migjenin. Tematika e krijimtarisë së tij është shoqërore. Shikon realitetin e vrazhdë e të padurueshëm. Shpreson tek e nesërmja dhe shfaqet romantik, në poezitë e tij ka lajtmotiv rininë. Edhe sa i përket stilit, vargjet e tija nuk janë të rimuara sa duhet. Vjershat mbajnë më tepër seç mundet të durojnë. Tematika e tij është tematikë e vlimeve dhe e kthesave të mëdha në jetë. (2- nga interneti – Albanino - 12-10-2002).

Kritiku Rexhep Qosja, për Esad Mekulin thekson angazhimin intelektual të tij në letërsinë shqipe. Ai ndoq një rrugë të veçantë në krijimtarinë e tij duke i ikur gjuhës bombastike, parullave të kohës, patetikës së lartë. Ai gjithashtu thekson se “poezia e tij është fenomen specifik i letërsisë sonë” (3- nga interneti - Rexhep Qosja).

Poezia e Esad Mekulit ka gjithnjë qëndrim aktiv e krijues ndaj kohës e shoqërisë në të cilën krijohet e zhvillohet, të cilën e reflekton dhe së cilës i drejtohet me porositë e veta, ndaj ngjarjeve e situatave, në të cilat

gjendet kjo shoqëri. Prandaj edhe e quajmë poezinë e Esad Mekulit gjithnjë të gjallë dhe aktuale, gjithnjë të freskët e bashkëkohore. Në opusin e tij letrar nuk janë të parëndësishme edhe vargjet intime, ajo lirika e njomë suptile që lind prej penës së tij, qoftë në moshën e djalërisë, qoftë në kohën e pjekurisë burrnore. Po sikur edhe poezia patriotike me ngjyra më të thekshme me shumë tone të buta lirike të një shpirti të butë e melankolik, me elemente patriotike-sociale. Po këto tone e ngjyra kanë edhe vjershat tjera të Esadit, ato që bëjnë fjalë për ndalesat e rinisë, gëzimet, mundimet dhe mallin për të pambërritshmen. Gjithashtu na paraqiten përshkrimet e peizazhet e bukura me ngjyra të ngrohta lirike. Ndërsa vjersha me tone të dalluara patriotike "Porosia e nanës", drejtuar bijve që lanë plang e shtëpi e u larguan në horizonte të largëta në dheun e huaj, "ku vesh s'ju marrin.... ku dheu i zi rëndë do t'ju peshojë mbi rreshtna e pa etnit tuaj përbri", u ngrit haptazi kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi.

I këtillë, me një diapazon shumë të gjerë temash, me një botë të formuar poetike, me fuqinë e vet shumë të madhe, Esadi ka ushtruar ndikim shumë të madh në poezinë dhe përgjithësisht në letërsinë tonë, në krijuesit letrarë e publikë, ndërsa vepra e tij artistike është faktor me rëndësi dhe kontribut i madh i kulturës tonë.(1- Vehap Shita - nga libri "Për Ty" - Esad Mekuli).

NOL BERISHA

Krijimtaria e shkrimtarit Nol Berisha është e gjithanshme, me tematikë të ndryshme nga jeta përditshme. Në poezi përshkruhen kujtimet e shkrimtarit për natyrën që ta ketë pranë. Për Hënën me rreze të ëmbla, për kujtimet që vëren syri në dritare, rri dhe mendon për dimrin dhe verën, vjeshtën dhe pranverën. Bukuritë natyrore të pranverës. Gjithashtu përshkruhen lule vjollcat që i dhurohen nënës për ditën e saj. Shkrimtari përshkruan për

qetësinë në shtëpi, për verime në mal, e sidomos nxënësit në shkollë dhe rrëfimet e gjyshit.

Shkrimtari përdor një gjuhë të pasur me figura e shprehje të ndryshme stilistike që e shtyn lexuesin të mendojë dhe e tërheq të lexojë.

REXHEP QOSJA

Në opusin e tij krijues Rexhep Qosja shkroi vështrime kritike, recensione e trajtesa, në përgjithësi për krijuesit në Kosovë e një numër më të vogël edhe për krijuesit në Shqipëri. Kjo erdh si rezultat i ndarjes regjionale të letërsisë shqiptare, si një komunikim i penguar në mes të këtyre regjioneve, por edhe si një përpjekje për ta ngritur letërsinë e kësaj ane në nivel kombëtar. Në radhë të parë ai trajtoi letërsinë shqipe në përgjithësi, pa bërë ndarje regjionale ose përpjekje për ta abstrakuar letërsinë e sotme shqipe nga letërsia e traditës dhe, kështu, për ta trajtuar këtë letërsi si diçka të veçantë. Si kriter, kritiku kishte kriterin estetik të cilin ia kundërvinte kritereve të tjera. Ai në qendër të interesimeve të veta vinte veprën letrare. Ai afirmon sensibilitetin modern të letërsisë, kritikon të metat, frymën patriarkale, optimizmin e rrejshëm, ideologjizmin dhe politizimin e letërsisë.

Rexhep Qosja nuk e shikon veprën nga një aspekt. Ai veprës letrare i bënte një vështrim të gjerë, e zbërthen nga aspekti social dhe historik, nga aspekti sikologjik, ekzistencial, për të arritur në analizën formale, në analizën e stilit, të figuracionit, të strukturës së veprës. Kritika e tij është quajtur "kritikë integrale". Angazhimi i prof. Qosjes në art dhe kulturë, por edhe në probleme aktuale, është angazhim i llojit të intelektualëve evropianë. Kritika e tij në përgjithësi shënon kulmet në shqyrtimin e veprave letrare dhe është e mirëpritur si nga lexuesit ashtu dhe nga kritika letrare. Fjalori i tij është fjalor intelektuali bashkëkohor që zotëron filozofinë dhe kritikën tradicionale, humaniste të shekullit të shkuar, po edhe filozofinë e kritikën bashkëkohore.

Sipas Ali Aliut: "Rexhep Qosja përfshinë një diapazon e sfera në pakufi në të trajtuarit e aspekteve letrare".

Vlerësim pozitiv për kritikën e tij i ka dhënë edhe Jorgo Bulo i cili thekson se "Vepra është e pandarë nga personaliteti i tij që e krijon..E tillë është edhe vepra shkencore e Rexhep Qosjes, e këtij krijuesi poliedrik, që për një çerek shekulli, me talentin e rrallë, me pasion dhe me guximin krijues qytetar që e karakterizon i është kushtuar lëvrimit të shkencës e të letrave shqipe".

Një kujdes të veçantë në shkrimet e veta, Rexhep Qosja i kushton gjuhës dhe terminologjisë së veprës. Gjuha e kritikës së tij është e gjallë, mjaftë e pasur në shprehje dhe përshkohet nga nocionet e kritikës moderne. Fjalori i tij është fjalor intelektuali bashkëkohor, që e zotëron estetikën, trashëgiminë e kritikës humaniste, por edhe kritikës moderne.

Nocionet që përdor janë ato të teorive bashkëkohore letrare, por duhet përmendur se mendimi i tij e ruan kontinuitetin me mendimin e mirëfilltë mbi artin dhe krijimtarinë. Sintaksa e kritikës së Rexhep Qosjes është mjaftë e pasur, elokuente dhe nuk e lodh lexuesin, përkundrazi e bënë të afërt me një masë më të madhe lexuesish. (3 - nga interneti - Mendimi i Rexhep Qosjes për poezinë e sotme shqipe - Gjuha, stili Rexhep Qosja).

HAJRO ULQINAKU

Në letërsinë tonë për fëmijë, Hajro Ulqinaku imponohet si shkrimtar specifik pikërisht pse tematika e pjesës më të madhe të krijimtarisë së tij ndërlidhet me nuancat e ndryshme të jetës bregdetare, të cilën ky krijues e njeh përimtësisht, prandaj e trajton me përkushtim e dashuritë veçantë, me kujdes të duhur artistik e frymëzim të sinqertë, gjë që dëshmohet edhe përmes veprave të shumta të tij. Nga opusi i gjerë tregimtar i Hajro Ulqinakut, hetohen vijëzimet më karakteristike të këtij autori, si në aspektin e motiveve të trajtuara, po ashtu edhe në aspektin e veçorive stilistike e figuracionale. Në letërsinë tonë për fëmijë vepra e Hajro Ulqinakut njihet si sektor, me ngjyrat e veta, temperaturën e vet, dimensionet ideotematike, kataraktet e thyerjeve të intonacionit kuptimor dhe atij artistik, modelin tanimë të gjetur për një shprehje origjinale që çon kah individualiteti i një krijuesi të pjekur, dhe të gjitha këto tipare, me prozat e tij për fëmijë H. Ulqinaku ka dhënë të kuptojmë se në botën tonë letrare ky krijues disponon me specifika natyrash të ndryshme, që herë na dalin si rezultat e strukturës së brendshme të prozës së tij, e herë si komponentë e një natyre të veçantë të trajtimit plot sharmë e dinamizëm e begati ngjyrash e sistemesh mediterane. Prandaj nuk është e vështirë të konkludohet se Hajro Ulqinaku jo rastësisht është orientuar kah ajo sferë tematike që e njehë më mirë. Prandaj preokupimet e këtij krijuesi të shumtën e herëve lindin dhe përfundojnë në bregun e detit të nxehtë, në valët e shkumëzuara “mbi krahët e pulëbardhave, në flatrat e peshqve dhe në barkat e peshkatarëve të vegjël e të mëdhenj. (1 - Agim Deva - nga ,”Libri për Detin” - vepra të zgjedhura – Hajro Ulqinaku).

Në skicat e tregimet e bukura, me tematikën e larme e të shëndoshë, me vlera edukative e artistike që ka, pëlqehet nga lexuesit e vegjël dhe zë vend në bibliotekat e tyre. Ata herë pas here do ta hapin këtë libër, për të rikujtuar ato çaste të bukura e të gëzuara që kaluan kur e lexuan dhe do t’u duket se po e lexojnë për herë të parë. Kjo tregon se Hajro Ulqinaku di të komunikojë me lexuesit e vegjël dhe të futet në zemrën e tyre

natyrshëm. (2 - Odhise Grillo – nga “Libri per detin” - vepra të zgjedhura - Hajro Ulqinaku). Nëpërmjet parmit të njohjes, Hajroja na jep shumë njohuri toponimike nga fusha e gjeografisë, e historisë, e së kaluarës së Ulqinit, por jep edhe frymëmarrje pune e jete nga ditët e sotme të detit. Me një lirizëm të hollë paraqet vendin plot bukuri deti ku lindin fëmijët ndërmjet ullinjve, nën fiq, nën tenda hardhish...

Toponimia e Ranës (lexo: Plazhi i Vogël), por edhe tërë bregdetit të Ulqinit është një monografi në miniaturë e mpleksur me vokacion poetik të frymëzimit. Nga këtu del porosia se rrëfenjat toponimistike, si rrallë ndër ne, kanë edhe karakter mësimor. (3 - Riza Greiçevci – nga “Libri për detin” - vepra të zgjedhura - Hajro Ulqinaku).

Ulqini, qytet i lashtësisë ilire, i kulturës, i qëndresës dhe mbijetesës në det, botës shqiptare i ka dhënë personalitete në dije dhe në art. Ndër ta, edhe shkrimtarin e sotëm për fëmijë Hajro Ulqinakun, autor i pesëmbëdhjetë librave me tregime, me novela, romane, me prozë poetike e poezi.

Lojërat me bashkëmoshatarët buzë detit, rrëfimet e vjetra dhe të reja për zotësinë, për shkathtësinë dhe për mençurinë e anijetarëve ulqinakë në det, bukuritë dhe mrekullitë e natyrës bregdetare, mbetën mbresë fëmijërie që do të riprodhohen artistikisht në pjekuri nga shkrimtari me natyrë dhe temperament të qetë, Hajro Ulqinaku. Me Hajro Ulqinakun gjeografia e letërsisë shqipe për fëmijë prek skajin më perëndimor të hapësirës gjuhësore shqiptare në Ballkan. Me temat dhe me motivet karakteristike me shtjellimin e tyre origjinal dhe me botëkuptimin optimist të jetës. Hajro Ulqinaku ka peshë në mozaikun e shkrimtarëve të sotëm për fëmijë. Niveli i qëndrueshëm artistik i veprës letrare atë e bënë shkrimtar të pranuar nga të gjithë lexuesit e vegjël të hapësirës shqiptare. Botimet e veprave të Hajro Ulqinakut në Prishtinë, në Tiranë, në Podgoricë e në Shkup janë dëshmia më e mirë e këtij konstatimi. (4 - Islam Pali – nga “Libri për detin” - Hajro Ulqinaku).

Duke i analizuar tregimet dhe romanet e Hajros kuptojmë të vërtetën se në përgjithësi ato me kompozicioni, me konceptimin e ngjarjeve dhe të personazheve, me shembuj që i paraqet - transmetojnë vlera të çmueshme ideo-edukative dhe ideo-letrare. Krijimtaria artistike për fëmijë e Hajros pa dyshim është e vlefshme e dobishme dhe e rëndësishme për formimin e shëndoshtë e të drejtë të fëmijëve. Hajro Ulqinaku në pjesën më të mirë të veprimtarisë letrare objekt këndimi e bën detin dhe fëmijët, madje jo vetëm të Ulqinit, por edhe të trevave tjera, që vijnë për të pushuar në këtë qytet të bukur, i cili, thënë figurshëm, rri krenar me

shekuj, gjithnjë i papërkulshëm atje në bisht të Adriatikut, duke u bërë në kapërcell të shekujve edhe riviera më e njohur në gjithë Ballkanin. Andaj është tepër e nevojshme për të kuptuar se "shkrimtari për fëmijë është pedagog, psikolog e shkencëtar. Ai të gjitha duhet t'i dijë, barërat dhe lulet, kafshët dhe insektet, përrallat dhe legjendat, se përndryshe nuk shkruan dot". (5 - Faik Shkodra – nga "Libri për detin" - vepra të zgjedhura – Hajro Ulqinaku).

Fëmija dhe fëmijëria kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në shpirtin e shkrimtarit. Fëmijët në përgjithësi, e fëmijët e detit, në veçanti, formojnë botën e tyre, botë në të cilën nuk mund të depërtojë gjithkush, përveç atyre që e njohin mirë e në hollësi. Këtë e ka bërë Hajroja që si mësues i mirë në vise të ndryshme shqiptare ka ditur të depërtojë thellë në shpirtin e fëmijëve, ka ditur të zgjedhë tema e motive që fëmijëve do t'u interesojnë më shumë.

Gjuha me të cilën i ndërton tregimet e veta autori - është gjuha letrare me tiparet e saj karakteristike të një ambienti të veçantë, e kjo është gjuha e bregdetit, është gjuha e peshkatarëve me të cilën ata komunikojnë dhe i shprehin mendimet e veta. Gjuha e tregimeve të Hajros shquhet për fjalitë e shkurtra me çka ai arrin efekte të duhura te lexuesit e vegjël. (6 - Salajdin Mehmeti – nga "Libri për detin" - vepra të zgjedhura – Hajro Ulqinaku).

Në përmbyllje të këtij shkrimi mund të konkludojmë se bota bregdetare është e pasur dhe e larmishme dhe se autori ka privilegjin për të përzgjedhur ngjarje e tema nga skena e asaj jete shqiptare. Përshkrimi i panoramës së gjerë të hapësirës së bukur e madhështore të detit i pikturuar nga shkrimtari Hajro Ulqinaku ngjall ndjenjën e dashurisë për atë pjesë të atdheut, kurse ndaj personazheve fëmijë kemi një simpati të veçantë. (7 - Veli Veliu nga "Libri për detin" - vepra të zgjedhura - Hajro Ulqinaku).

ALI LLUNJI

Ali Lunji, intelektual dhe krijues ulqinak i cili, traditës kulturore të Ulqinit në veçanti, dhe kulturës shqiptare, në përgjithësi, i dhuroi, përveç tjerash, veprën dramatike të rrallë të llojit të vet, "Lugu i Xhemiles". Dramatizimi i kësaj gojëdhëne, legjende, realizuar mjeshtërisht e besnikërisht, me një sens autentik të mprehtë dhe me emocion të thellë të autorit, shpërthen me një bukuri të zezë, njollë e dhembshme nga e kaluara që përshkohet dhe jeton aty-këtu, në gjenet e mentalitetit të sotëm

ulqinak.

Gjuha që përdor shkrimtari në veprat e tij është e rrjedhshme e qëlluar dhe e natyrshme, me vokabular e shprehje tipike të së folmes së Ulqinit, përkon harmonishëm me tipat, personazhet dhe me karakterin e veçantë të ambientit përkatës.(Ruzhdi Ushaku - nga libri “Lugu i Xhemiles” - Ali Llunji).

Me krijimtari letrare merret që herët. Shkroi prozë për fëmijë, monografi dhe drama.

Edhe ky krijues si dhe shumë të tjerë jetoi dhe veproi larg vendlindjes, por duke mos e harruar kurrë vendin e lindjes, e fëmijërisë, që ia kushtoi shumë në veprimtaria e tij.

Në prozat për fëmijë, mbizotëron tematikë nga vendlindja – Ulqini, me motive të ndryshme, nga deti, si dhe karakteristikat e emrave të vendeve që i kishte ky qytet bregdetar. Në to përshkruhen mbresat e thella, ngjarjet dhe ndodhitë, natyra e bukur, e piktoreske e qytetit, si dhe përjetimet e fëmijëve në ditët e nxehta të stinës së verës .

IDRIZ ULAJ

Shkrimtari Idriz Ulaj, gjithë veprimtarinë e tij ia kushton vendlindjes së vet, Vuthaj, komuna e Plavës. Shkruan vjersha për fëmijë e të rinj. Aty përshkruhen zërat dhe gëzimet e fëmijëve të bjeshkëve në festë të shkollës si dhe për një të folme drejtshkrimore në gjithë hapësirat shqiptare. Ai përshkruan bukurit natyrore të liqenit, me netët e bukura, me yje e hënë. Ai i këndon lumit të tiji i cili rrjedh, valë-valë, si dhe jetës fshatare në viset malore. Ai krijon një pikturë të kundërt të jetës në Bjeshkët e Nemuna.

ZUVDIJA HOXHIQI-BERISHA

Veprimtaria e shkrimtarit Zuvdija Hoxhiqit lavdërohet edhe nga kritikët edhe nga lexuesit. Veprat e këtij shkrimtari përshkohen nga një humanizëm i thellë dhe nga një realizëm mitik. Atë rrafsh mitik shkrimtari e gjenë në Gucinë e tij, në të kaluarën dhe të tashmen e tij, në fatin dhe jetën e bashkëvendësve të vet. Ato për shkrimtarin janë të veçantë.

Shkrimtari Zuvdija Hoxhiqi ishte i lidhur ngushtësisht me Esad Mekulin, të cilin e donte si më të afërmin e vet. Esadi ishte një nga personalitetet që kishte ndikuar më së shumti në te dhe se librat e tij ishin një lektyrë e vërtetë, nga duart e të cilit kishte marrë më vonë edhe

librat e para të shkrimtarëve shqiptarë.

Shkrimtari Zuvdija Hoxhiqi, siç theksojnë kritikët, për stilin dhe gjuhën "Ka një gjuhë të pasur". Përveç kontemplacionit të thellë, njohjes së jashtëzakonshme të mendësisë dhe psikologjisë së njerëzve për të cilët shkruan, historisë dhe jetës, forcës epike dhe frymëzimit lirik, ai është edhe njohës i shkëlqyer i natyrës dhe botës së saj. (1 - Bajram Kabashi - intervistë nga vepra "Ylli i Davidit" - Zuvdia Hoxhiqi).

ALI M. AHMETI

Veprimtaria e shkrimtarit Ali M. Ahmeti është e lidhur ngushtësisht me vendin e lindjes, fshatin Vuthaj, katund i krahinës së Plavës e Gucisë. Punoi e veproi larg vendlindjes, njëzet vjet në arsim në Prishtinë si profesor i nderuar të gjimnazin "Samir Frashri".

Botoi tezën e magjistraturës dhe studimin monografik të doktoraturës, ku bëhet fjalë për veshjet dhe për letërsinë gojore e shqiptarëve të anës së Plavës dhe të Gucisë.

Pas vdekjes, me përkujdesjen e familjes, iu botuan veprat me vjersha për fëmijë dhe poezi për të rritur. Në këto poeti përshkruhen gëzimet e njeriut, drita si yll i jetës kundër errësirës, për orën besnike që nuk gabon për punë e shkollë me kohë të shkojmë, si dhe për prehrin më të madh, më të ngrohtë dhe më të dashur të nënës .

ASLLAN BISHA

Veprimtaria e shkrimtarit Asllan Bisha është e lidhur me vendlindjen. Jeton dhe vepron në vendlindje për dallim nga të tjerët, por që bashkëpunon me të gjithë vendet ku jetojnë shqiptarët.

Ka botuar vepra me tregime për fëmijë dhe prozë e roman për të rritur. Tematika e tregimeve për fëmijë është me motive nga deti dhe peshkimi, ndërsa në proza për të rritur përshkruhet shoqëria në mes të rinjve, shëtitjet, gëzimet e të rinjve në ditët e bukura të verës nën hijen e pallmës.

Në prozat për fëmijë përfshihen edhe rrëfimet e ndryshme të gjyshes e gjyshit, nipit dhe mbesë, për të kaluarën e këtij qyteti si dhe bukurit e këtij qyteti, sidomos gjelbërimet në stinën e pranverës rreth luginës së lumit si dhe për princeshën tyre që jetonte në kështjellë pranë liqenit të Shasit. Prozat vazhdojnë me përshkrimin e stinës së vjeshtës, ditët me shi dhe punën e bujkut. Shkrimtari gjithashtu përshkruan bukurit e natyrës

rreth lumit Buna dhe fushën e mbushur me dallëndyshe. Në prozat e shkrimtari përshkruhet edhe loja e fëmijëve, kureshtja dhe interesimi i tyre, për detin peshqit, dhe peshkimin, si dhe për shumë rrëfime tjera.

Prandaj vijmë në përfundim se tregimet e shkrimtarit Asllan Bisha janë edukative si dhe njohuri të ndryshme për jetën e njerëzve rreth liqenit të Sasit dhe lumit Buna, për peshkim dhe për llojet e peshqve që zihen në lumin Buna, si: levrek, shojza, orada.

Në veprat e veta shkrimtari Asllan Bisha përdor një gjuhë të pasur letrare me shprehje e figura të ndryshme stilistike e qartë dhe e kuptueshme.

IBRAHIM BERJASHI

Poeti bashkëkohor për fëmijë Ibrahim Berjashi, me letërsi filloi të merret që në bankat e shkollës së mesme. Shkruan vepra me poezi për të rritur dhe vepra me vjersha e tregime për fëmijë.

Si intelektual i njohur është i drejtuar në shumë fusha. Ka bashkëpunuar me të gjitha gazetat e revistat në gjuhën shqipe në Prishtinë e Shkup. Ka qenë recensent i shumë veprave letrare të autorëve shqiptarë nga Mali i Zi. Aktualisht është gazetar-redaktor në TV "Teuta".

Në vjershat për fëmijë përshkruan kënaqësitë e tij dhe dashurin e bashkëvendësve të vet, të fshatit të vogël Arbnesh, që gjendet në Krajë, Mali i Zi. Gjithashtu përshkruan edhe stinën e vjeshtës me ngjyrë të verdhë e të kuqe e me pemë të ndryshme. Po ashtu përshkruan shoqërinë mes shokut e shoqes, si dhe lojën e gëzimin e tyre me njëri - tjetrin.

Tematikë tjetër që shtjellon shkrimtari në veprat e veta janë me motive nga deti dhe liqeni. Ai përshkruan velanijet që lundrojnë në det dhe gëzimin e fëmijëve. Përshkruan rrjedhjen e lumit dhe yjet e detit, guacat si margaritar me shumë korale. Gjithashtu përshkruan bukuritë e liqenit dhe fluturimin e pulëbardhave lart në qiell dhe përsëri lëshohen si shami mëndafshi mbi liqen.

Në veprën me tregime "Floçka e Liqenit" përshkruan lagjen e peshkatarëve e cila është e qetë dhe nuk dëgjohet njeri i gjallë, përveç një pulëbardhë që ka humbur rrugën. Atë e kaploi një varfri e madhe. Liqeni mbeti pa ujë në ditët e nxehta të gushtit.

(Trajtesë për antologjinë: Hajro Ulqinaku, "Degë e drurit të urtë" (letërsi e bukur për fëmijë e të rinj të shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi), botuar nga Asociacioni Ulqini, Ulqin, 2008, sponsoruar nga ministri Fuad Nimani).

Recension

Namik SELMANI

LIBRI PËR QYTETIN E DETIT

(*Duke shfletuar antologjinë poetike "Ulqin, ti det" të autorit Hajro Ulqinaku*)

Kur të ketë mbyllur fletën e fundit të antologjisë poetike kushtuar vendlindjes së tij, Ulqinit., Hajro Ulqinaku ose "*Poeti i Detit*" si e quajnë në Ulqin këtë " *bacë urtësie"* do të ketë ndjerë bukur mirë po atë emocion që kanë pasur të gjithë poetët për këtë qytet – magjik buzë Adriatikut. Një qytet me histori, bëma, legjenda e ndodhi nga më të besueshmet e të pabesueshmet që mund të ketë historia e një qyteti.

Një mirënjohje e secilit lexues të kësaj antologjie e bën aq shumë të mirëpritur në rrethet e lexuesve shqipfolës të të gjithë trevave shqiptare.

Do ta nisnim përgëzimin tonë si lexues së pari për këtë nismë kaq të bukur e fort të dobishme për Ulqinin.

Një qytet që ka një Antologji të tillë padyshim e ka në gjen krenarinë dhe gëzimin.

Mbase që këtu duhet nisur edhe sugjerimi im dhe i lexuesve të secilës moshë.

Sa bukur do të ishte që qytete të tjera të trevave shqiptare të kishin antologji të tilla poetike! Ato janë *biografia poetike* që ka e duhet të ketë secila pjesë e kombit tonë. Janë rreth 60 autorë të të gjithë trevave shqiptare, të Ulqinit, të Kosovës, të Tiranës dhe Beratit që nëpërmjet vargjeve të ngrohtë të tyre formojnë një kurorë të madhe poetike. Mund të ishte prej dafine. Mund të ishin prej trëndafilash, por edhe me këto vargje të këtyre fjalëbukurve, Ulqini bëhet edhe më i bukur para syve të

gjithë atyre që e shohin, e prekin dhe jetojnë sadopak natyrën dhe historinë e lashtë të këtij qyteti. Vetë poeti Hajro Ulqinaku shkruan në Parathënien e tij këto vargje për Ulqinin

Secili ia fali
nga një varg inxhi
kush dhjetë buqetë e
ndonjëri kurorë sonete

Thesari i vargjeve kushtuar Ulqinit e nxjerr atë si një qytet frymëzues, madhështor, krenar tek i sheh kalanë – fortifikatë mbrojtjeje. Secili varg për të mban adhurimin, dashurinë, admirimin, mrekullinë që ndjen njeriu para ekzotikes dhe modernes.

Nuk është shënuar në biografinë jetësore ndonjë udhëtim i Naim Frashërit në qytetin e Ulqinit, por mesazhi i trimërisë së tij ka shkuar në tërë qenien poetike të këtij poeti të madh kombëtar kur ai shkruan për të:

Burrat tuaj aqë trima a do ta lënë vallë Ylqinë
edhe gjithë shqiptarët ta mbaj armiku ynë?

Vargje të tillë me të drejtë hartuesi i Antologjisë i ka vënë që në faqet e para të këtij libri.

Këngët popullore, të pranishme në kujtesën e secilit qytet, kur është fjala për Ulqinin i bëjnë jehonë qëndresës legjendare të këtij qyteti. Në to është "*Balada e Ago Ymerit*" kënga "*Trimat e Ulqinit*", "*I ra mjegulla Buenës*", "*Haxhi Alia me të birin*".

Padyshim pjesa më interesante e Antologjisë është ajo e krijimeve të poetit të madh spanjoll Miguel De Serevantes, kushtuar Ulqinit. Ish i burgosuri i kalasë së Ulqinit (që në mesjetë quhej ndryshe edhe DULCIGNO), provoi njëherësh në këtë qytet edhe mjerimin e një të burgosuri, edhe dashurinë për një vajzë që quhej Dulqinja dhe shumë pjesë të romanit të tij "*Don Kishoti i Manças*" i ka shkruar me përshtypjet nga ky qytet.

Më tej pasqyra poetike e Ulqinit shfaqet e madhërishme në poezitë e poetëve të shquar të letërsisë mbarëkombëtare shqiptare si: Agim Gjakova, Agim Vinca, Ali Podrimja, Arben Kondi, Basri Çapriqi Arian Leka, Din Mehmeti, Martin Camaj, Milianov Kallupi, Moikom Zeqo, Namik Selmani, Visar Zhiti, Vorea Ujko, Xhevahir Spahiut, dhe prozatori Ramiz Kelmendi etj.

Është e vështirë që në një shkrim të thjeshtë të gjesh vargjet më të goditura për portretin e Ulqinit. Poeti nga Kosova Rifat Kukaj shkruan në poezinë "*Shtatë motra*" për të:

Ulqinin e madhërojnë shtatë kodra
tërë blerim e shtëpia
a nuk janë vetë poezia?

Poeti arbëresh Vorea Ujko shkruan për të në poezinë "*Ulqini*":

Nuse e zgjedhur
në vështrim të parë
e stolisur për mua
për një mbrëmje vallëzimi.

Ndërsa poeti Xhevahir Spahiu te poezia tashmë e mirënjohur "*Ujku i detit*" shkruan për historinë e lavdishme të Ulqinit dhe ulqinakëve

Të vrau e pabesa
Mbretëresha e Deteve
S'diti të flinte me ty,
as një natë të vetme,
në vend të parajsës
po më vret Ulqini….

Suksesi i librit është edhe forma e larmishme e rrëfimeve poetike të autorëve të paraqitur më këtë përmbledhje. I larmishëm është edhe këndshikimi i secilit në hapësirat e poezisë së tij. Natyra, deti, kështjella, qëndresa , janë pjesë që plazmojnë të gjithë poezitë e tyre. janë tharmi edhe i poezive që ende nuk janë shkruar për të.

Edhe vetë autori i përmbledhjes "*Ulqin, ti det*" Hajro Ulqinaku në të gjithë librat e botuar më parë që janë shumë të vlerësuar për tematikën e cilësinë artistike duket se me këtë libër të tij ka realizuar jo vetëm një ëndërr të kahershme për çdo autor në raport me vendlindjen e tij, por edhe të shumë bashkëkombasve të tij.

Librat që mbajnë firmën e tij krijuese si "*Deti, detarët e Ulqinit*", "*Detarë, peshkatarë, ulqinakë*", "*Libri për Ulqinin dhe ulqinakët* ", "*Thesar popullor*" (folklor) janë një "portë" e madhe dhe e ndritshme që e kanë sjellë atë te ky libër i shumëpritur nga rrethet lexuese shqiptare e më gjerë.

Në kohët që po jetojmë na duhen më shumë se në vitet që kemi kaluar botime që tregojnë identitetin tonë kulturor, historik dhe shpirtëror. Kur flitet për në trevë ku popullsia shqiptare njihet në numër si minoritet, por aspak inferiore në rrezatimin e kulturës së tyre kombëtare, antologjia për Ulqinin është një tjetër pasaportë e domosdoshme për brezat që do të jetojnë në këto treva.

Duket se libri i Hajro Ulqinakut e plotëson më së miri këtë kërkesë të trefishtë.

Jo më pak duhen falënderuar për këtë botim edhe Asocioni "*Ulqini*", redaktori Nexhat Halimi, recensenti Milianov Kallupi dhe kontribuesit financiarë të tij që është Ministri Fuad Nimani, në Ministrinë e Popujve Pakicë dhe Grupeve Nacionale në Republikën e Malit të Zi.

Përtej një falënderimi publik duam të përforcojmë kërkesën që edhe qytetet të tjerë me shumë tradita historike, artistike si Shkodra, Pogradeci, Korça, Berati mund ta kenë sa më parë në duar një Antologji simotër . Ka filluar një punë e mirë , ndonëse ende e brishtë për botimin e Enciklopedive të disa qyteteve si Elbasani, por qëmtimi i poezive janë një tjetër shkallë e portretit të tyre.

Nga ana tjetër duhet gjetur mundësia që të qarkullojnë sa më parë vlera të tilla madhore kulturore që krijohen në të dy anët e kufirit shqiptar, duke bërë para se politika bashkimin tonë kombëtar.

BOTIME

TAKIM SHKENCOR NË SHKODËR

Në organizim të Fakultetit të Shkencave Shoqërore – Sektorit Shkencor të Albanologjisë dhe Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë të Malit të Zi, të shtunën më 24.5.2008, në auditorin 207 të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkodër u organizua promovimi i botimeve të studiuesve shqiptarë të Malit të Zi.

Në një atmosferë të ngrohtë, me shumë konsideratë të ndërsjellë, dhe shkencore programin e udhëhoqi prof. dr. Tomor Osmani kurse fjalën përshëndetëse në emër të nikoqirëve e mbajti dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof. as. dr. **Paulina Hoxha** kurse nga mysafirët prim. dr. **Gani Karamanaga**. Me këtë rast recensionet dhe vështrimet për librat e përuruara i mbajtën si në vijim:

Prof. dr. **Tomor Osman**i: Revista "Dija" nr. 4/5 - një vazhdim i arrirë.

Prof. dr. **Vehbi Hoti**: "Meteorët e arsimit shqip në Mal të Zi" (1916 - 1999) të prof. dr. Palokë Gjelosh Berisha.

Prof. dr. **Fatbardha Hoxha** : "Lirika popullore në trekëndëshin Ulqin, Shestan dhe Bregu i Bunës" të dr. Bahri Briskut.

Prof. dr. **Mahir Hoti**: "Polemika lidhur me falsifikimin shkencor kundër shqiptarëve të Kapllan Buroviqit" të dr. Bahri Briskut.

Dr. **Ledri Kurti**: "Ulqin, ti det" të Hajro Ulqinakut.

Prof. as. dr. **Tefë Topalli - Mimoza Priku**: "Deti dhe detarët në

letersinë popullore shqiptare” të dr. Bahri Briskut.

MA **Nertila Haxhia:** Rreth veprës “Drenica në shekuj” të Nezir Çitakut.

Të pranishëm ishin edhe njerëz eminentë të penës dhe të punës shkencore, si Vili Kamsi, Gëzim Uruçi etj., si dhe shumë studentë të degëve të ndryshme.

Në vazhdim po i botojmë recensionet e lexuara në këtë përurim akademik.

Prof. as. dr. Tefë TOPALLI - dr. Mimoza PRIKU

“DETI DHE DETARËT NË LETËRSINË POPULLORE SHQIPTARE”,

autor: dr. Bahri Brisku
(Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006, 296 fq)

Vepra e studiuesit të njohur nga Ulqini dr. Bahri Brisku, që paraqitet sot në këtë auditor të nderuar, është gjithëpërfshirëse, një kuintesencë e kulturës popullore dhe e konstitucionit shpirtëror të një treve që ka jetuar e jeton në bregdet e midis lumenjve; jo paraqet një mënyrë jetese që bëhet pasqyrë dhe reflekton në krijimtarinë popullore, që nga lirikat e moçme të besimit pagan, ritualet, ninullat, këngët me motive detare, elegjitë dhe këngët qytetare. Ajo është njëkohësisht një antropologji kulturore, me të dhëna të imta etnografike, vlera morale, etike, si: besa, trimëria, mikpritja, sedra, doket, zakonet, besëtytnitë, hijet, shtrigat; vlera historike, folklorike e mitologjike, pa munguar të dhënat enciklopedike për letërsinë në mjaft gjini të saj, nga gojëdhënat, baladat, legjendat, rrëfimet e ndryshme etj., të cilat u vunë në dukje këtu nga parafolësit specialistë.

Tema e detit dhe e detarëve është një temë shumë e ndeshur në krijimtarinë popullore shqiptare, por njëkohësisht sferë që “*dimë shumë pak, meqë deri më tani nuk kemi studime për të*” (*Parathënie*, fq. 5).

Evidentimi i kësaj pasurie gjuhësore, studimi i saj ka rëndësi për albanologjinë në përgjithësi, faktor i rëndësishëm për autoktoninë e shqiptarëve, të cilën ka studiues që mundohen ta mohojnë duke “*ia mohuar shqiptarëve traditën e lashtë detare, e cila faktikisht ishte një*

kontinuitet i pandërprerë i jetës iliro-shqiptare" (*Parathënie*, fq.7). Mohojnë terminologjinë detare, duke i parë shqiptarët si një popull baritor, pa terminologji detare. Ky studim zbulon këtë thesar të paçmueshëm letrar, gjuhësor, etnografik, etnolinguistik, historik etj.

Libri ndahet në gjashtë krerë, ose kaptina, siç i quan autori, të cilët shtjellohen pas një parathënieje (fq. 5 – 11).

Kreu (kaptina) I *Deti dhe detarët në lirikën popullore* (f. 11 – 73), përmban shtatë sytha në të cilat përfshihen elementet e besimit fetar pagan në lirikën popullore me motive detare, ninullat, këngët e fëmijëve, këngët e dashurisë etj.

Autori ynë i identifikon dhe analizon elementet pagane që gjenden në këngët me temë detin. Deti në këto këngë mishërohet me fuqi magjike, pasi pranë burimeve të tij janë dërguar të sëmurët për t'u shëruar, gratë që të lindin fëmijë, gratë që nuk u jetonin foshnjat etj. Vajzat e reja i drejtoheshin detit, pasi tek gratë, sipas autorit "*gjendet i rrënjosur besimi i krijesave dhe fuqive të natyrës, para asaj fuqie pagane, e cila është nderuar dhe besuar me shekuj nga ky popull" (Kaptina I*, f. 13). Elemente pagane autori i gjen edhe në këngët e detarisë ku vajzat i drejtohen fuqive magjike të natyrës për të lehtësuar ardhjen e djemve, kur vetë detarët i drejtohen detit për të pasur peshkim të bollshëm; e jo vetëm tek këto këngë, por edhe tek këngët për motmotin, tek këngët e fëmijëve. Të gjitha këto elemente e drejtojnë autorin të dalë në përfundim se këto gjurmë dëshmojnë për një popull të lidhur me detin që në lashtësi, pra dëshmojnë autoktoninë e shqiptarëve. Si gjurmë të ritualeve të lashta pagane, që kanë mbërritur deri tek ne, autori sjell ditën e 6 majit (Shën Gjergjin) 9 majin (Shën Kollin), të cilat festohen nga të gjithë besimtarët.

Elemente pagane autori ka hulumtuar edhe tek popujt e tjerë të Ballkanit, si tek grekët, maqedonasit, serbet, kroatët. Kjo është një "*dëshmi e bashkëjetesës dhe e marrëdhënieve shekullore ndërmjet kombeve në regjionin ballkanik" (Kaptina I*, f. 5).

Përveç këtyre,mendojmë se vepra e studiuesit Brisku, ka edhe vlera gjuhësore, sidomos në Kaptinën e 5-të dhe të 6-të. Njëri prej këtyre kapitujve, i 5-ti, nuk duhet shikuar vetëm si mbledhje e fjalëve të urta dhe i llojeve të tjera të prozës së shkurtër, të gjeneruara nga sfera e detarisë, siç i quan autori, por një pasuri gjuhësore e një thesari të çmuar popullor, i cili rrezikon të humbasë, të shtrembërohet apo edhe të tjetërsohet, në qoftë se nuk mblidhet e nuk shpjegohet si përdorim gjuhësor apo në kuptimet e tij të figurshme, sipas kontekseteve të bisedës, duke e pasuruar e konotuar të folurit në monolog ose në dialog. Për shembull, të tërheqin

vëmendjen thënie e maksima kaq të goditura, që kalojnë përtej situatave nga kanë lindur e janë përfituar, si: *As spiranca nuk hidhet gjithkund; Kur shifet fneri, isht lehtë me gjet bregun; Kur të hyn uji në hambar, mos lyp psehin; Ma mirë isht me qenë kapidan në barkë të vogël se gjemxhi në barkë të madhe; Në shegë të huej nuk bahet rrëmujë; Ullini vin si florini; Nuk ban ftoni sa limoni; Gjemxhija i mirë flen me nji sy çilë; Ai isht si njalë; S'ka tru ma tepër se peshku; U shkri si shkuma e detit* etj. Nuk mungojnë në këtë mbledhje të kujdesshme e profesionale edhe fjalë të urta me krahasime nga trevat e tjera të vendit, si ajo e Spiro Dines: "*Lundra me shumë kapidana është ngaherë në rrezik*". Doktor Bahri Brisku jo rrallë bën edhe ndërhyrjet e veta lakonike, në zbërthimin e kuptimit të mjaft proverbave, duke treguar se ç' gjerësi përdorimi dhe çfarë efekti kanë në ligjërim, për shembull, për thënien e qëlluar: *Është i gjanë sa deti*, shpjegon se *ka të bëjë me një person, i cili nuk zemërohet lehtë*: ose, për: *Lumi kudo të shkojë, në det do të derdhet* – thuhet për një veprim të pamirë të ndonjë njeriu, i cili "*do t'i paguajë kusarët*"; ose për ndonjë të ri që braktis familjen, por kurdoherë do të kthehet sërish në shtëpinë e tij. Këto dhe të tjera, marrin një rëndësi të madhe në planin e shprehjes, parë si ekonomi gjuhësore, me sintaksë tepër të veçantë dhe në pajtim me natyrën e shqipes. Po kështu mund të shprehemi edhe për Kaptinën e 6-të, ku autori Brisku bën disa sprova etimologjike të mjaft leksemave shqipe me rrënjë e burim vendës.

Kapitulli II (f. 73 – 97) *Motivet detare në balada popullore*,

Kapitulli III (f. 87 – 137) *Motivet popullore në epikën popullore shqiptare*,

Kapitulli IV *Deti dhe detarët në prozën popullore* (f. 137 – 232) është ndër kapitujt më të gjatë dhe përmban 49 sythe,

Kapitulli V *Fjalë të urta dhe llojet e tjera të shkurtra* (f. 237 – 259),

Kapitulli VI *Gjurmime leksikore nga sfera e detarisë* (f. 259 – 269),

Përfundime (f. 269 – 277),

Burime dhe literatura (f. 277 – 293).

Literatura në cilën është mbështetur autori është mjaft e pasur dhe është e ndarë në:

a. Burime, ku përfshihen hulumtimet e bëra nga autori në arkiva të ndryshëm si, Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Arkivi historik i Dubrovnikut etj.,

b. Literatura e përgjithshme në të cilën përfshihen 252 zëra.

Libra të tillë janë në të mirë të kulturës sonë mbarëkombëtare, nisur nga folklori, etnografia dhe pasuria shpirtërore e popullit tonë të lashtë.

Nertila LJARJA, MA*

NJË PUNIM I TËRËSISHËM, NË TË GJITHA ASPEKTET

(Rreth veprës "Drenica në shekuj" të autorit Nezir Çitaku)

Monografia "Drenica në shekuj" e autorit Nezir Çitaku është një punim i tërësishëm, në të gjitha aspektet, që përfshin si aspektin gjeografik, kulturor dhe atë historik të këtij rajoni duke filluar që nga prehistoria, antikiteti dhe deri ditët e sotme.

Kjo vepër merr një rëndësi të veçantë në lidhje me çështjen kosovare që sot është mjaft e vështirë për një sërë arsyesh. Së pari, sepse në të mpleksen ngjarje, dukuri dhe figura të ndërlikuara e të diskutuara gjerësisht në opinionin publik. Kjo rrethanë është prezente dhe ushtron influencën e vet në trajtesat që i kushtohen kësaj çështjeje. Këtu punën e vështirëson dhe e komplikon një tendencë politizimi e skajshme që vazhdon të ruhet përgjithësisht për problemet e historisë së sotme të Shqipërisë, sidomos në lidhje me qëndrimet ndaj Kosovës, spekulime që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen me këtë çështje, pasi siç dihet karta e Kosovës është përdorur jo pak nga forca të ndryshme politike për të fituar kapital politik. Këtyre rrethanave u shtohen gjithashtu dhe pengesat e vështirësitë që ende ekzistojnë në shfrytëzimin e dokumenteve, sidomos në arkivat e vendeve të huaja të implikuara në çështjen shqiptare.

Drenica, megjithëse një krahinë ekonomikisht më e dobët se disa rajone të tjera të Kosovës, ka rëndësinë e saj historike të veçantë. Nga

---

*NERTILA LJARJA, MA (Departamenti i Historisë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 24 maj 2008)

gjiri i kësaj krahine kanë dalë prijës dhe atdhetarë në të gjitha kohët, duke filluar nga trimëresha Drenica, emrin e së cilës mori dhe rajoni, duke vazhduar me Ahmet Delinë, Azem e Shote Galica etj.

Ky vëllim monografik na e paraqet Drenicën jo vetëm në një këndvështrim historik, por na paraqitet me një analizë të thellë, shumëplanëshe, të kulturës materiale dhe shpirtërore të kësaj krahine duke na dhënë një material të bollshëm etnografik dhe folklorik, pasuri kjo mjaft e madhe për studiuesit e ardhshëm.

Vepra është e ndarë në 12 kapituj të cilët ndjekin rrjedhën kohore të historisë së kësaj krahine duke filluar me antikitetin, dëshmitë materiale të së cilës vërtetojnë tezën pseudoshkencore më të përfolur nga historiografia shoviniste serbe mbi autoktoninë e shqiptarëve në këto troje.

Të dhënat arkeologjike, faktet historike, citimi i mjaft autorëve të njohur, literatura e përdorur e bën këtë vëllim, në çdo etapë të tij, duke filluar nga antikiteti, mesjeta, periudha e pushtimit turk duke vazhduar me luftërat ballkanike, me trajtimin e Çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës, me luftën kaçake dhe të ashtuquajturën reformë agrare që kishte qëllim të vërtetë e kryesor të vetin, ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës në disfavor të shqiptarëve. Një pjesë mjaft të rëndësishme në vepër zë dhe lufta e popullit të Drenicës gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke ardhur deri në momentet më të rëndësishme të ngjarjeve së viteve të fundit.

Veçori mjaft e dukshme e kësaj vepre është gjuha e pastër dhe me një fjalor mjaft të pasur e përdorur nga autori, gjithashtu dhe stili i tij e bën veprën të lexueshme jo vetëm për studiuesit e historisë, por edhe për një rreth më të gjerë e më të larmishëm lexuesish.

Falënderojmë autorin për punën e madhe që ka bërë dhe mendoj që kjo vepër do jetë një ndihmesë e madhe jo vetëm për studiuesit e historisë së Kosovës, por dhe për studentët e Departamentit të Historisë pranë Universitetit tonë.

Ledri KURTI

POETËT PËR ULQININ – ULQIN, TI DET

(Antologji e përgatitur na Hajro Ulqinaku)

Antologjia që na ofrohet të kemi në radhën e antologjive tona shqipe, përgatitur nga Hajro Ulqinaku, ë bën të mendosh, se edhe antologji të llojit me bazë temën e vendlindjes, ku shkrihen gjithë lirat e shpirtit të poetëve ulqinakë dhe joulqinakë për kreaturën e këtij qyteti, është një antologji që do to gjejë receptues të denjë për ta shijuar.

Në këtë antologji, Ulqini ngre siparin e përshëndetjes së vet me të gjithë dhe të gjithë gjejnë sytë dhe zemrën e vet, brenda vargjeve kushtuar atij. Përballë lexuesit, poetët e përfshirë në antologji, strukturojnë një tërësi për Ulqinin. Aty gjejmë një Ulqin fizik si ekzistencë e dukshme dhe një Ulqin metafizik me të padukshmen, në nënshtresat historike dhe shpirtërore, si në poezinë "*Ulqin, ti det*" të Hajro Ulqinakut:

Ulqin, Ulqin / Kala prej guri / Prej deti / Prej ulliri / Prej floriri / Të lakmoi Dovleti / Ta pati zili Mbreti / 25 shekuj antik / Dajma / 25 mijë frymë / Kasaba / Të mori deti / Kurbeti / Rininë / Ardhmërinë / Det plak i thinjë / Duron, ofshan nën ullinj / Ulqin, Ulqin!

Por kemi këtë Ulqin të padukshëm edhe në Ulqinin spiritual, si tek "*Kur piqen maranxhat*" të Marin Camës, apo magjistrali "*Mos qaj, Kestrina*" të Nexhat Halimit.

Ecim nga rrënjët historike në ndjejshmërinë individuale të autorëve, në raport me stimën dhe kënaqësinë e veçantë që i ofron apo i ka ofruar ky qytewt së bashku me kujtimet e heshtura të tij:

Hej, Bjeshkë e Rumisë. që u matke me qiell / Rizgjomë nga gjumi i ëmbël princëror! / Kur supi bëhet sofër dhe guri bashkohet me qiell / Te kjo vatër do ta vë dhe në një gur, qofsha edhe pa dorë. (Bjeshka e Rumisë, poetit Hajro Ulqinaku, nga Namik Selmani),

për të arritur në perlat e bukura të dashurisë që i kushtohen Ulqinit, i kthyer në tashmë në objekt për t'u dashuruar: *Mos i thoni erës / me vështrimin nga kalaja e Ulqinit* / (të Namik Selmanit), nga ku po e shkëpus:

Mos i thoni erës ta marrë këtë qytet / Se i ngrin në duar rrjeta e fjalës / Peshkatarëve të mençurisë së kombit tim sybukur / Ku ta gjejnë më tej këtë hambar diellor / Këtë djep valësh / T'ua përkundë këngën e pathënë kah motet e rreptë?

Po ashtu, e gjejmë Ulqinin, si subjekt që indirekt, fal dashuri për të gjithë ata që arrijnë ta njohin dhe marrin frymë në ajrin e tij.

Nuk mbetet vetëm me kaq! Autorët bashkëkohës, si të rinj apo dhe jo aq të rinj, pranë këtij qyteti, sikurse gjejnë edhe lenë mozaikë të dashurisë së tyre, gjejnë tinguj kitare dhe sy vashe të bukur, të cilat nuk mund të harrohen.

Ulqini si temë përbashkuese e një lloj antologjie të veçantë, e ka merituar të përfshijë në gjirin e tij këtë tërësi shpirtrash poetikë, të renditur me kujdes nga autori qëmtues e përzgjedhës, duke përfshirë me kujdes, që nga këngët popullore, përkthimet e Fan Nolit, me arsyen e bukur të Dulcigno-s, emër i vjetër i Mesjetës për Ulqinin, krijimtarinë e: Vorea Ujkos, poezinë e Naim Frashërit, shkrimet e Ramiz Kelmendit të lindura në Ulqin, Din Mehmetit, me *Ulqinakja digjet në kitarë*, Ali Podrimjes me *Kullën e Balshajve*, Basri Çapriqin, me *Ubla e Krajës*, Agim Vincën, e të gjithë me radhë plot jetë dhe duke i bërë ato në të njëjtën kohë të ndjehen të dashuruar me Ulqinin.

Të gjithë poetë e lexues, pas kësaj antologjie i përkushtohen Ulqinit dhe shpirtëzohen në, apo për dashurinë e tij. Ajo që vlen të përmendet, mendoj, është fakti, se autori, me seriozitetin e strukturimit të një antologjie,ka ditur t'i përmbahet respektit ndaj një kriteri temë, të zgjedhur, por po aq të respektuar edhe përfshirjen përmbledhëse që i përkushtohen kësaj teme, Ulqinit qytet, qytet historik, trashëgimisë poetike popullore kushtuar po këtij qyteti dhe figurave të njohura popullore, që dëshmojnë identitetin e tij, në pjesën e parë dhe bosht logjik do të thosha të veprës.

Si antologji e llojit, me kriter të përzgjedhur temën qendër, të bën të ndjehesh mirë dhe të marrësh kënaqësinë gjer në asht, nga poetike dhe

gjuha e metaforave dhe gdhendjeve të shpirtit, që ndesh në skulpturën që i bëhet dhe i përkushtohet këtij qyteti dhe krijuesve të tij: natyrë e bukur dhe njerëz të mirë!

Nga ajo mori lirikash, krijimesh dhe përkushtimesh në emër të Ulqinit historik dhe kreaturës së tij poetike dhe natyrës së tij, nuk ka si të mos të bie në sy ndjeshmëria femërore e shkrirë në vargje për Ulqinin.

Po të mbajmë vesh, tingujt e bukur të vargut të Vorea Ujkos *Shkëmb deti* ku thotë:

Shkëmb deti / Që çdo ditë pret të Bukurën / Duke vështruar para këmbëve / Baticën, zbaticën / Sonte mos e prit / Sonte e Bukura s' vjen.

Mund të kërkojmë një përqasje me Ulqinin e Magjishëm, të cilit e Bukura i vjen dhe i vjen pranë dhe thellë në shpirt i hyn si poete, pa u ndarë prej tij, duke i lënë atij në mos veten fizike, gjithnjë përsëri veten e bukur shpirtërore, të shkumëzueshme në vargje arti.

Të tilla janë brenda këtij areali poetet: Fatmire Duraku, Miradije Ramiqi, Naime Beqiraj, Syrmije Cakuli, Zhaklina Zadrima.

Në poezinë *Ndjeu, u shemb kalaja,* për autoren Naime Beqiraj, deti përmbyset si një gotë për dashurinë. Dielli kish sjellë pas vetes pluhurin mbytës për të. Ndërsa *Enigma ulqinake* e Miradije Ramiqit, *... Vjen e kthehet në kohë / Arkeologji e pazbuluar*, e po aq Ulqini për Fatmire Durakun shkrihet në domethënien "det" sa shkrihet në simbolikën "*Zog i ndezur*", kur për "mallin" e Syrmije Cakulit, Ulqini i fal asaj dëshirën e "*tangoje të gjatë me valë*" ajo e dëshiron Ulqinin si Dashurinë e shumëpritur dhe kurrë të shterueshme në bukuri – madhështinë e vet.

Dhe të duket sikur Zhaklina i mbledh në kuvend të gjithë së bashku, të gjithë poetët, kur thotë: *Unë i mbledh së bashku me detin dhe malin, duke pritur paqësisht perëndimin dhe vjeshtën pas...*

Por, duke mos mundur t'i ndaj poezitë. dhe shpirtrat poetikë për Ulqinin, nga një tërësi xhevahirësh, që shkëlqejnë me praninë edhe vetëm të emrit të tij, do të më pëlqente të përfundoja, përveç se me urimin për punën e bërë, për këtë antologji edhe me një varg të marrë nga "*Pulëbardhat e Ulqinit*" të Milianov Kallupit, i cili përdor në stilin e tij të shkruarit poezi, haikun:

Pyes Detin (pyet poeti) / *Ku shkruan Hajro Ulqinaku / Mbi valë.*

vjen përgjigja e shpirtit inkadeshent, të poetit, për poetin dhe për poetët në tërësi, që i këndojnë së bashku në këtë antologji Ulqinit.

MJEKËSI

Dr. Zylfije DURAKU
(Shtëpia e shëndetit me Maternitet – Ulqin)

LINDJET NË MATERNITETIN E ULQINIT

Materniteti në Ulqin u hap më 05 shkurt 2005. Lindja e parë u bë më 06 shkurt 2005.

Sipas ecurisë klinike, procesi i lindjes ndahet në katër faza:

I Faza e dilatimit (*phasis dilatationis*)
II Faza e lindjes së fëmijës (*phasis expulsionis*)
III Faza e lindjes së placentës (*phasis placentalis*)
III Faza e hemostazës (*phasis hoemostosis uteri*)

UDHËHEQJA E FAZËS SË PARË

- Dhimbjet janë ato që e bëjnë shtatzënën në maternitet.
- Me hyrjen në dhomën e pranimit, Merret anamneza detale: familjare, personale, e *menarhes, e* shtatzënisë së tanishme.

Bëhet shikimi i përgjithshëm: matet tensioni, pulsi, temperatura

a. Bëhet shikimi i jashtëm dhe i brendshëm akusherik
b. Merren masat pelvike.

Me shikimin vaginal vërejmë:
qafën e mitrës, gjatësinë, pozitën, konsistencën, dilatimin.

c. Caktohet prezantimi dhe lartësia e pjesës prezantuese në krahasim me *spinën ishiadice*.

d. Prekim muret *vaginale* dhe pjesën *kockore* – caktojmë formën e *sacrumit* dhe ekzaminimin e harkut *pubik*.

e. Bëjmë ETG – monitorojmë gjendjen *fetale* dhe *kontrakcionet*

f. Partogramin – e shkruajmë kur fillojnë kontraksionet e rregullta me dilati 3 cm

g. Amniotomin – e bëjmë me dilatim 4 cm – nëse nuk ka shkuar spontan.

- Faza e parë zgjatë mesatarisht 8 orë të *primiparat.*
- Dilatimi normal 1cm/1orë.

FAZA E DYTË E LINDJES

- Fillon me dilatimin komplet prej 10 cm dhe mbaron me momentin e lindjes së fëmijës.
- Në këtë fazë bëjmë zbrazjen e fshikës urinare para shtërzimeve.
- Bëjmë *episiotomin* – çdo herë të primiparet, sipas nevojës të multiparet.
- Bëhet mbrojtja e perineumit.
- Kjo fazë zgjatë 40 min të primipara e multipara 15 min, sipas *Stewartit.*
- Nëse ekspulsioni zgjat më shumë se 1 orë – parashikohet ndonjë komplikim.

FAZA E TRETË E LINDJES

- Fillon me mbarimin e lindjes së fëmijës dhe mbaron me lindjen e placentës dhe membranave *fetale*.
- Me *traksionin* e kordonit *umbilikal* dhe dorën tjetër mbi *simfizë* bëhet shkëputja e placentës.
- Rëndësi të madhe ka shikimi i placentës dhe membranave nëse to janë në rregull kjo fazë ka përfunduar.
- Faza e tretë normal zgjat më pak se 30 min.

FAZA E KATËRT E *HEMOSTAZËS*

- Është fazë e rëndësishme për shkak të rrezikut për gjakderdhje.
- Bëhet aplikimi i *oxitocinës.*
- Humbje e gjakut në lindjet normale është 300 – 500 ml.

LINDJET E REALIZUARA NË MATERNITETIN E ULQINIT



Viti	L						
	I						
2005	4						
2006	5						
2007	5						
15 maj 2008	3						
	1						
	38%	**53%**	**19%**	**5,7%**	**2,0%**	**1,4%**	

Prej tyre: – 3 presentim pelvik, - 3 occipitoposterior, - 1 lindje gemellare

EPISIOTOMI LAT DEX

Viti	Lindjet						
	I	II	III	IV	V	VI	Gjithsej
2005	43	21	4	2	/	/	**70 – 56%**
2006	53	26	5	1	/	/	**85 – 57%**
2007	52	35	4	1	/	/	**92 – 60 %**
15 maj 2008	30	5	1	/	/	/	**36 – 64%**
	178	**87**	**14**	**4**			**283 – 58%**
	62%	**30%**	**4,9%**	**1,4%**			



RUPTURA CERVICIS UTERI

VITI	LINDJET			
	I	II	III	Gjithsej
2005	3	3	1	7 – 5,6%
2006	6	2	/	8 – 5,3%
2007	3	1	/	4 – 2,6%
15 maj 2008	1	/	/	1 – 3,5%
	13	6	1	20
	7%	3,7%	1%	4,1%



RUPTURA PERINEII GR. I – II

VITI	LINDJET					
	I	II	III	IV	V	Gjithsejt
2005	2	4	6	1	/	**13**
2006	3	14	3	1	1	**22**
2007	/	12	4	1	/	**17**
15 maj 2008	/	3	/	/	/	**3**
	5	**33**	**13**	**3**	**1**	**55 – 11%**
	2,7%	**20%**	**14%**	**10%**	**10%**	



REVISIO CAVI UTERI MANUALIS

VITI	LINDJET				
	I	II	III	IV	Gjithsej
2005	4	9	1	2	**16**
2006	8	9	2	/	**19**
2007	4	3	1	/	**8**
15 maj 2008	**1**	**1**			**2**
	17	**22**	**4**	**2**	**45 – 9,3%**



LINDJET ME VAKUM

VITI	LINDJET			
	I	II	III	Gjithsej
2005	/	/	/	**/**
2006	4	1	1	**6**
2007	6	/	/	**6**
15 maj 2008	**2**	**/**	**/**	**2**
	12	**1**	**1**	**14 – 2,8%**

KANË MARRË TRANSFUZION

2005	7 – gra	5,6%
2006	9 – gra	6,0%
2007	9 – gra	5,8%
2008	3 – gra	5,3%
	28 – gra	5,7%

- 15 Shtatzëna 3,1% kanë nisur lindjen tek ne dhe kanë përfunduar në Tivar
- 76 gra shtatzëna për shkak të indikacioneve medicinale – si lindje para kohe dhe lindjet me SC kanë lindur në Tivar apo Podgoricë.

REZYME

1. Numri i përgjithshëm i lindjeve për 3 vite, 483
   a. 3 me prezantim *pelvik*
   b. 3 prezantim *occipito posterior*
   c. 1 lindje *gemellare*
2. Nr i *spisiotomive* – 283 (58%)
3. Ruptura te Cerviksit – 20 (4,1%)
4. *Ruptura te perineuma* – 55 (11%)
5. *Ruptura te vagines* – 18 (3,7%)
6. *Revisio cavi uteri man* – 45 (9,3%)
7. Lindje me *vakuum* – 14 (2,8%)
8. *Transfuzion* – 28 (5,7%)
9. 15 (3,1%) e lindjeve kanë përfunduar në Maternitet të Tivarit me se apo *forceps*
10. 1 rast për shkak të gjakderdhjes ka përfunduar me *histerektomi*
11. 52 gra shtatzëna – të përcjella nga ana jonë – kanë kryer lindjen në Tivar apo Podgoricë si lindje para kohe ose me SC.

KONKLUDIM

1. Në kushtet ekzistuese është realizuar numri optimal i lindjeve pa komplikime.

2. Vërehet se kemi më shumë *episiotomi* të *pluriparet* dhe kjo ndodhë edhe nga frika e komplikimeve të mundshme në mungesë të sallës së operacionit dhe transfuzionit.

3. Salla e operacionit do të kishte shtuar numrin e lindjeve në maternitetin tonë, dhe ishin zvogëluar komplikimet nga streset e lindjes për vetë gruan dhe personelin mjekësor.

4. Intervenimet tjera janë në përqindje normale.

Dr. sc. Selami SYLEJMANI

SËMUNDJET E GJIRIT

Gjiri (lat. *mammae*, greq. *mastos*) është organ ndihmës, zakonisht simetrik dhe çift i aparatit gjenital femëror. Gjinjtë e femrës bëjnë pjesë në organet riprodhuese. Ato kanë funksion shumë të rëndësishëm në sigurimin e qumështit për foshnjën. Të gjithë gjitarët kanë gjinj, mirëpo te femrat e llojit njerëzor, ata shumë mirë janë të zhvilluar.

ANATOMIA DHE FIZIOLOGJIA E GJIRIT

Gjëndrat e qumështit zhvillohen nga rrudhat ektodermale që formohen në sipërfaqen ventrale të embrionit. Shumica e tyre zhduken gjatë procesit të zhvillimit fetal, përveç një çifti në regjionin pektoral që eventualisht zhvillohet në dy gjëndra qumështi. Nëse sythat përgjatë kanalit të qumështit nuk zhduken plotësisht, ato kalojnë në ind glandular ektopik. Kjo mund të shfaqet si gjinj shtesë (*polymastia*) apo thimtha shtesë (*polythelia*). Gjatë zhvillimit embrional, rreth mesit të shtatzënisë, dy sythat mamarë që janë paracaktuar për t'i formuar gjinjtë, fillojnë të rriten dhe të ndahen. Pesëmbëdhjetë deri 25 sytha sekondarë formohen

Doktor i shkencave mjekësore, gjinekolog–obstetër, ultrasonist në lëmin e gjinekologjisë, obstetrikës dhe sëmundjeve të gjirit
Poliklinika GINEKOS, Prizren, Republika e Kosovës

dhe që në esencë janë sistemi i kanalit qumështor të gjirit tek të rriturit. Shtresa e jashtme e qelizave shndërrohet në mioepitel (*myoepithelium*) dhe është përgjegjëse për mekanizmin e nxjerrjes së qumështit jashtë. Gjëndra e qumështit haset te të dy gjinjtë, por te meshkujt dhe vajzat e reja para pubertetit janë të pazhvilluar. Madhësinë normale gjiri e arrin rreth moshës 16 - 19 vjeçe. Gjiri i femrës i zhvilluar normal, është i vendosur në anën e përparme të kraharorit dhe zë vend nga briri i dytë deri në briri në shtatë[1]



Foto-skicë format e ndryshme të gjirit, të kushtëzuara me shkallë të ndryshme të zhvillimit reproduktiv dhe moshës së femrës

Paraqitja skematike e ndertimit të parenkimit të gjirit – sistemi i lobuseve të gjirit

Strukturën e gjinjve ose gjëndrave të qumështit, e përbëjnë krejt çka përfshin dhe mbulohet me lëkurën e gjinjve si: parenkima e gjinjve, indi lidhor, dhe indi dhjamor. Pesha mesatare e një gjiri të zhvilluar normalisht në periudhën reproduktive të femrës sillet nga 200 deri në 300 gram. Nuk është e pazakonshme që njëri gji të jetë më i madh se tjetri dhe kjo është dukuri krejt normale.

Thimthi (*mammilla mammae*): I tërë regjioni i areolës së gjirit dhe thimthit-thelbit të gjirit është i pigmentuar në mënyrë intensive (*areola mammae*), i cili pigmentim edhe më shumë shtohet gjatë periudhës së shtatzënisë. Ky regjion ka një perimetër rreth 35 deri në 50 mm. Në qendër të areolës së gjirit ndodhet thimthi-thelbi i gjirit, i cili ka madhësi dhe forma të ndryshme.

Futja e thimthit të gjirit brenda-retraksioni, mund të jetë e lindur por edhe e fituar. Çdo tërheqje ose futje brenda e thimthit, papritmas në moshën e pjekurisë, duhet të zgjoj kërshërinë e mjekut klinicist. Thimthat nuk kanë qime, por tek disa gra mund të haset edhe prani e qimeve rreth areolës.

Indi dhjamor: Është i vendosur në mes të nënlëkurës dhe fascijes superficiale, i cili është i shpërndarë në sasi të ndryshme në pjesë të ndryshme të gjirit. Pas thimthit nuk ka fare ind dhjamor.

Indi gjëndëror: Njësia themelore histologjike në strukturën gjëndërore është *acinusi*. Disa acinuse kur bashkohen së bashku përbëjnë një strukturë në formë kalaveshi që quhet *lobul* i gjirit. Lobulet e gjirit përbëjnë njësinë themelore të gjëndrës së qumështit, e cila përfshinë edhe duktusin alveolar (*ductus lactiferus*), në të cilin derdhet përmbajtja e lobulit. Grupi i këtyre njësive lobulare të cilët janë të grupuar për rreth të njëjtit kanal interlobular, rezulton me lobusin mamar. Një lobusi alveolar i takon një kanal (*ductus lactiferus*), i cili përfundon në thimthin e gjirit në formë të një zgjerimi (*porus lactiferus*). Gjinjtë janë të ndërtuar në rreth 15 deri në 20 lobuluse të renditur në formë radiale nga thimthi. Çdonjëri përfundon me çelje në drejtim të thimthit [2, 3]

Furnizimi me gjak i gjirit: Gjiri furnizohet me gjak nga arteriet e gjirit të cilat dalin nga tri burime; arteria *thoracica interna, arteria thoracica lateralis* dhe arteriet *Intercostales* ([1])

Rrugët limfatike: Rol me rëndësi ka drenazhi limfatik për të njohur rrugët e përhapjes së kancerit të gjirit të cilat janë dy: sipërfaqësore *nënareolare* dhe të thella *subfasciale*. Shumica e enëve limfatike drejtohen kah një koleksion indi, në formë të kokrrës së fasules, të quajtura nyjat limfatike. Limfa derdhet në enët limfatike *aksilare, subklavikulare, mediastinale* dhe në drejtim të një pjese të *heparit* dhe nyejt limfatike *subdiafragmale*[(2)]. Në secilën nënsqetull ka rreth 20-30 nyje limfatike, që drenojnë limfën nga gjinjtë. Në aspektin kirurgjik nyjat limfatike i ndajmë në tri nivele. Niveli i parë i nyjave limfatike janë të vendosura në mënyrë laterale të muskujve të vegjël pektoral, niveli i dytë ndodhen nën muskujt e vegjël pektoral dhe niveli i tretë janë të vendosura në mënyrë mediale të muskujve të vegjël pektoral([4]).

Indi lidhor: ndërtohet nga ligamentet e Cooper-it, të cilët shtrihen nga lëkura deri në fascien pektorale (fascia pectoralis), e cila është e vendosur nën. Përfshirja e këtyre ligamenteve nga procesi malinjë, shoqërohet me deformim të lëkurës, që është shenjë për zgjerim të procesit malinj.

Lëkura e gjinjve: Lëkura e trupit të njeriut në përgjithësi ka rol mbrojtës. Lëkura e personave të rritur me gjatësi mesatare ka një sipërfaqe rreth 1,7m^2, ndërsa peshon rreth 18% e gjithë peshës trupore. Lëkura e cila i mbulon gjinjtë, ka një trashësi rreth 0,5 deri ne 2 mm, por nuk e ka të njëjtën trashësi në të gjitha segmentet e gjirit, dhe nuk i ka të njëjtat karakteristika në të gjitha pjesët. Për rreth areolës së gjirit, lëkura është më e hollë dhe më e fort.

SEMUNDJET E GJIRIT

Si çdo organ i organizmit të njeriut që mund t'i nënshtrohet proceseve patologjike, edhe gjinjtë nuk mund të përjashtohen. Sëmundjet e gjinjve i ndajmë në dy grupe në: procese inflamatore dhe procese tumoroze. Këto procese zakonisht shoqërohen me ndryshime subjektive siç janë dhimbjet dhe ndryshime objektive siç janë ndryshimet në formë gunge ose nyjave në gji, pezmatim të pjesshëm apo të plotë të gjirit, gjegjësisht rrjedhje të sekrecionit nga thimthi. Gjatë jetës së vet, çdo e dyta grua mund të hasët në dukuritë e përshkruara.

SËMUNDJET BENINJE TË GJINJVE

Në këtë grup të sëmundjeve bëjnë pjesë proceset inflamatore dhe tumorët beninjë të gjirit.

SËMUNDJA FIBROCISTIKE, në literaturë përmenden rreth 38 shprehje për këtë sëmundje të gjinjve([5]). Sëmundja fibrocistike është një ndryshim beninjë në gjinj, zakonisht i dyanshëm, e cila përshkruhet si strukturë granulare e gjirit. Ky ndryshim shfaqet në mbi 50% të femrave të cilat gjatë kontrollit me dorë hetojnë strukturë jokompakte të gjirit. Sëmundja më së shpeshti paraqitet në formë të ndjeshmërisë dhe dhembjes që përsëritet në mënyrë ciklike. Disbalansi hormonal në mes të estrogjeneve dhe progesteronit, krijojnë ndryshime të shumta në indin e gjirit, të cilat i emërtojmë bashkërisht si sëmundje fibrocistike. Ndryshimet e këtilla shpesh lajmërohen nën apo rreth areolës, si dhe në kuadratet e jashtme-epërme të gjirit.

RRJEDHJA NGA THIMTHI: Me këtë gjendje nënkuptohet paraqitja e sekrecionit nga thimthi jashtë periudhës së shtatzënisë apo të dhëines gji.



Paraqitja skematike e proceseve beninje në gjinj

Meqë gjiri është gjëndër, sekrecioni nga thimthi i gruas në moshën e pjekurisë nuk është dukuri e rrallë dhe nuk paraqet domosdo shenjë të sëmundjes së gjirit. Gjendje të caktuara beninje në gji mund të shoqërohen me simptomë të tillë. Sekrecioni i dendur i verdhë në të gjelbër mund të jetë shenjë i ndryshimeve inflamatore në gji. Sekrecioni i cili sipas rregullit kërkon trajtim dhe analizë, është ai i cili përmban më pak ose më shumë gjak.

INFLAMACIONI I GJIRIT: Proceset inflamatore mund të kaplojnë indin e gjirit (*mastitis*) ose vetëm thimthin (*thelithis*). Shkaktarët më të shpeshtë janë bakteret gram pozitive, si streptokokët dhe stafilokokët që karakterizohen me shenja karakteristike për procese inflamatore([6]). Inflamacioni i gjirit jashtë periudhës së dhënies gji, është dukuri më e rrallë. Edhe nëse paraqitet, zakonisht është i kufizuar në një pjesë më të vogël të gjirit, kryesisht në pjesën përreth areolës.

FIBROADENOMAT: Janë tumoret më të shpeshtë beninj të gjirit tek femrat nën moshën 30 vjeçe. Më së shpeshti janë tumor relativisht të vegjël, me diametër rreth 2-3 cm, ndonëse ndonjëherë mund të jenë të mëdhenj, bile edhe gjigantë, të madhësive mbi 6-7 cm. Këta tumor në masë të vogël zmadhohen para përfundimit të ciklit menstrual, kur mund të shkaktojnë dhimbje, spontanisht apo në prekje. Me plakjen e gruas, edhe te fibroadenomat fillon procesi i plakjes që shoqërohet me zvogëlim diskret. Fibroadenomat rrallë mund të aterojnë në proces malinjë.

TUMORI FILODES: Ky tumor paraqet variantin malinj të fibroadenomës. Tumori filodes në vete përmban qeliza beninje epiteliale,

por indi që i lidh është malinj. Nëse në tumor nuk ka qeliza epiteliale, por është i ndërtuar vetëm nga indi ndërqelizor, ai ka rritje shumë më agresive dhe prognozë më të keqe në aspektin e shërimit. Zakonisht lajmërohen tek gratë e moshës 40-50 vjeçe. Sjellja e tumorit filodes shpesh është e paparashikueshme. Shumica e këtyre tumoreve paraqesin problem lokal dhe nuk metastazojnë. Vetëm rreth 20% e këtyre tumoreve metastazojnë, edhe atë me rrugë hematogjene.

HAMARTOMET: Hamartomet janë tumor beninj të gjirit të cilët shpesh janë asimptomatikë (nuk hetohen në prekje e as që shoqërohen me shqetësime). Zbulohen rastësisht gjatë ekzaminimit ultrasonografik apo mamografikë. Ky tip i tumorit më së shpeshti shfaqet pas moshës 35 vjeçare. Mund të jenë plotësisht apo pjesërisht të inkapsuluar. Ndonjëherë mund të paraqesin problem në diferencimin nga tumoret e tjerë beninj, e edhe nga ata malinj, ndaj kjo është arsyeja që trajtimi i tyre të kryhet vetëm në mënyrë kirurgjike.

CISTET: Cistet paraqesin ndryshimet më të shpeshta që hasen tek femrat ndërmjet moshës 40 dhe 50 vjeçare. Cistet janë hapësira të mbushura me lëng të cilat krijohen nga kanalëzat e zgjeruara dhe të mbyllura të qumështit. Mund të paraqiten si të veçuara apo disa sosh njëkohësisht në njërin gji, por shpesh edhe në të dy gjinjtë. Madhësia e tyre lëkundet nga mikroskopike, kur nuk mund të hetohen me prekje, deri në madhësinë prej disa centimetrash. Cistet e vogla zakonisht nuk shoqërohen me shqetësime të mëdha, por ato mund të rriten dhe të shkaktojnë dhimbje para fillimit të ciklit menstrual. Në rastet e cisteve të vogla që nuk shkaktojnë shqetësime të veçanta, përcjelljen nëpërmes kontrollit të rregullt specialistik, me ekzaminime të kohëpaskohshme ultrasonografike (jo më rrallë se një herë në vit), gjersa cisteve të mëdha, dhe ato që shkaktojnë dhimbje, mund tu bëhet punksioni ose të operohen.

ADENOZA E GJIRIT: Adenoza nënkupton një tërësi ndryshimesh brenda lobuluseve të cilat fillojnë me shumëzimin e qelizave gjëndërore në lobulus, shpesh të përcjellë me zhvillimin e indit lidhor dhe shtresimin e kripërave gëlqerore - kalcifikateve. Nëse ndryshimi manifestohet në formë të ngurtësimeve, quhet tumor adenozë. Adenoza relativisht shpesh haset në kompleksin e sëmundjeve fibrocistike të gjirit në formë të tumorit pak a shumë të pllakëzuar, kryesisht elastik dhe jo qartë i kufizuar nga rrethina. Nganjëherë paraqet problem të madh diagnostikë dhe kërkon terapi kirurgjike.

FIBROZA: Nënkupton shumëzimin e indit lidhor në gji, gjersa pjesa gjëndërore me atë rast zvogëlohet. Krahas numrit, zvogëlohet edhe

diametri i lobuluseve. Rrallë është prezent në tërë gjirin në ndonjë shkallë më të gjerë. Fibroza fokale - e kufizuar, mund të manifestohet si tumor i cili hetohet në prekje, ndonjëherë shumë i fortë dhe jo qartë i kufizuar nga rrethina, apo konstatohet gjatë mamografisë si abnormalitet i shkallës së caktuar të ndërtimit të gjirit. Madhësia e tumorit lëkundet dhe ndonjëherë mund të kërkon trajtim shumë serioz, duke përfshirë dhe trajtimin kirurgjik. Një lloj i caktuar i fibrozës në gji mund të paraqitet tek pacientet me diabet i varur nga insulina që një kohë të gjatë trajtohen nga ajo sëmundje.

DUCTECTASIAE: Kjo shprehje ka kuptimin e zgjerimit kryesisht të kanalëzave përfundimtar të qumështit nën areolë, ndonëse mund të përfshijë edhe kanalëzat edhe më të vogla. Arsyeja e vërtetë e paraqitjes së saj nuk është e njohur. Si shkaktar shpesh përmenden proceset inflamatore, që shkaktojnë dëmtimin e fijeve elastike në muret e kanalëzave, si shfaqjen e indit lidhor në rrethinën e kanalëzave. Në këto gjendje, rrjedhja nga thimthi e sekrecionit të dendur, i verdhë në të bardhë nuk është dukuri e rrallë. Fibroza dhe kalcifikimi, janë pjesë e kësaj gjendjeje të cilat, nga kjo arsye, mund të sjellin huti dhe të krijojnë dilema gjatë mamografisë apo ultrasonografisë, duke imituar kancerin e gjirit.

PAPILOMAT INTRADUKTALE: Papilomat paraqesin ndryshim beninj në gji në formë të qelizave të gufuara të brendësisë së kanalëzave, të cilat formojnë tumor papilomatozë. Këto papiloma më së shpeshti lajmërohen në kanalet përfundimtare të qumështit nën areolë. Manifestimi i tyre më i shpeshtë është sekrecioni i përzier me gjak nga thimthi. Tumoret shpesh janë të vegjël (1-3 mm) dhe nuk mund të hetohen me prekje. Papilomat ndonjëherë mund të jenë më të mëdhenj (2-4 cm), posaçërisht ato të cilat formojnë ciste të vogla apo të mëdha rreth vetes, të mbushura me përmbajtje të përzier me gjak. Për këtë arsye duhet të bëhet analiza cito-patologjike apo analiza patohistologjike, pas largimit kirurgjik të tumorit. Pas operacionit, pjesa rreth areolës dhe thimthit mund të forcohet ose të bëhet më pak e ndjeshme ([7]).

LIPOMAT: Janë tumor të indit dhjamor, mirë të kufizuar, të cilët mund të zhvillohen në cilëndo pjesë të gjirit. të ndërtuar nga indi dhjamor. Me prekje vështirë mund të hetohen, e nëse hetohen, janë të butë, të lëvizshëm, të lëmuar dhe mirë të kufizuar. Shpesh lajmërohen në kuadër të lipomatozës së përgjithshme (kur janë të pranishëm më shumë tumor dhjamorë të karakteristikave identike në pjesë të ndryshme të trupit). Këta tumor operohen më rrallë, edhe atë kryesisht kur kanë rritje të përshpejtuar, kur shkaktojnë dhimbje spontane apo kur vjen gjer tek

nekroza e një pjese të indit, e shoqëruar me shtresimin e kripërave gëlqerorë.

TUMORET VASKULAR: Tumoret me prejardhje nga enët e gjakut, janë të ndërtuar nga kapilarët venozë, të gërshetuar në formë shpuzore. Në qoftë se gjenden në shtresat sipërfaqësore të gjirit, bëjnë ngritjen e lëkurës, duke dhënë pamjen e koagulatit nënlëkuror të gjakut. Nëse janë të lokalizuar më thellë, vështirë mund të zbulohen, sepse kanë konzistencë të butë. Janë mirë të kufizuar nga indet për rreth, në të cilat nuk depërtojnë. Nëse vjen gjer tek transformimi i tyre në angiosarkom malinje, shoqërohen me rritje të shpejtë dhe me infiltrimin në indet rrethuese.

TUMORET QELIZORË GRANULARË: Në fillim të shekullit XX është menduar se këta tumorë beninj kanë prejardhje prej indit muskulor, por falë mikroskopit elektronik, është vërtetuar se prejardhja e tyre është nga qelizat të cilat i ndërtojnë mbështjellësit e fijeve periferike nervore. Nga të gjithë tumoret e këtij lloji, vetëm 6% e tyre zhvillohen në gji. Periudha e paraqitjes është rreth moshës 40 vjeçare të gruas. Karakteristikë e këtyre tumoreve është se imponohen si tumore malinj të gjinjve, sepse kanë fortësi të theksuar gjatë kontrollit me dorë ("të fortë si gurë") dhe e fiksojnë lëkurën. Shërimi arrihet me heqjen e plotë kirurgjike të tyre.

NEKROZA DHJAMORE NË GJI: Vdekja e indit dhjamor, më shpesh ndërlidhet me trauma (lëndime), intervenimeve kirurgjike në gji apo rrezatimeve. Mirëpo, arsye e paraqitjes së tyre mund të jetë edhe e panjohur. Paraqiten në formë të nyejve, shpesh pa kufizim të qartë, me dhimbje dhe jo rrallë me fiksimin dhe tërheqjen e lëkurës. Në këto raste kërkohet trajtimi kirurgjik – largimi i këtyre ndryshimeve dhe analiza patohoistologjike.

PAPILOMATOZA DHE ADENOMA E THIMTHIT: Këta tumor krijohen me gufimin e qelizave të pjesës përfundimtare të kanalëzave të qumështit dhe ndonjëherë rriten në brendësi të thimthit. Atëherë paraqiten në formë kalaveshi apo me ulcerime plagëz në thimth. Periudha e paraqitjes është ndërmjet moshës 40 dhe 50 vjeçare të femrës-gruas. Adenomat e thimthit mund të diagnostikohen gabimisht si papilomatoza keratinizuese nën areolë, e cila zakonisht lajmërohet më thellë në gji. Këta tumor jashtëzakonisht rrallë kërkojnë shërim.

DERMATITI KRONIK I THIMTHIT: Inflamacioni i lëkurës së thimthit, shfaqet në formë të një sipërfaqe të skuqur në vetë thimthin, zakonisht të mbuluar me shtresa të keratinizuara të lëkurës së vdekur, shpesh shoqëruar edhe me kruarje. Kjo gjendje beninje ndonjëherë është

vështirë të dallohet nga sëmundja e Paxhet-it e gjinjve. Nëse përjashtohet sëmundja e Paxhet-it, që nuk është gjithmonë e lehtë, shërimi i besohet specialistit të sëmundjeve të lëkurës.

SËMUNDJA PAXHET: Kjo gjendje manifestohet si një sipërfaqe më pak ose më shumë e kuqe, në formë të njollës në vetë thimthin, e cila mund të shtrihet edhe në rrethinën e vet në areolë, e edhe jashtë saj. Ndryshimi ka pamje të ekcemit, ndonjëherë me zbokth të lëkurës, e ndonjëherë duket si plagëz sipërfaqësore në thimth. Kruarja është shpesh prezentë, por nuk është simptomë i domosdoshëm. Rreth 1-2% e kancerit të gjirit prezantohen në këtë mënyrë. Tek rreth gjysma e grave me ndryshime në thimth, kanë tumor gjiri të hetueshëm me prekje, ndërsa 90% të tyre kanë tumor malinj të vendosur më thellë në kanalëzat e qumështit. Duhet të bëhet biopsia e këtij ndryshimi, dhe nëse dëshmohet malinjiteti, trajtimi, si për çfarëdo kancer tjetër të gjirit të lokalizuar në pjesën qendrore të saj.

KANCERI I GJIRIT

Kanceri paraqitet kur qelizat në një pjesë të trupit fillojnë të rriten jashtë kontrollit. Qelizat normale ndahen dhe rriten në një mënyrë të rregullt, por jo dhe qelizat e kancerit. Ato vazhdojnë të rriten dhe i shtyjnë qelizat normale nga hapësira e tyre. Edhe pse ka lloje të ndryshme të kancerit, të gjithë kanë të përbashkët rritjen jashtë kontrollit të qelizave. Ndonjëherë qelizat e kancerit shpërthejnë dhe shpërndahen në pjesët tjera të trupit nëpërmes gjakut apo sistemit limfatik. Ato mund të vendosen në vende të reja dhe të formojnë tumor të rinj. Kur ndodh kjo, quhet metastazë. Kanceri që shpërndahet në këtë mënyrë quhet kancer metastatik. Edhe atëherë kur kanceri përhapet në një vend tjetër në trup, ai emërtohet sipas pjesës së trupit ku është shfaqur së pari. Për shembull, nëse kanceri i prostatës përhapet në eshtra, ai ende quhet kancer i

prostatës. Nëse kanceri i gjinjve përhapet në mushkëri, ai ende është kancer i gjinjve. Kur kanceri i rikthehet personit tek i cili është dukur se sëmundja është larguar pas trajtimit, kjo quhet *rekurencë*.

Kanceri i gjirit është tumor malinj që lind nga qelizat e gjirit. Sëmundja ndodh më së shpeshti tek gratë, por edhe meshkujt mund ta kenë këtë kancer. Shumica e kancerëve të gjirit fillojnë në qelizat përgjatë kanaleve (*kanceri duktal*), disa fillojnë në lobuluse (*kanceri lobular*) dhe pjesa tjetër në indet tjera të gjirit. Tipet kryesore të kancerit të gjirit janë:

Carcinoma in situ: Ky term përdoret për fazën e hershme të kancerit, kur ai është i lokalizuar në vendin ku është shfaqur. Në kancerin e gjirit, kjo do të thotë se kanceri është i kufizuar në kanale apo lobule, varësisht se ku është shfaqur.

Carcinoma ductale in situ: Ky është tipi më i shpeshtë i kancerit joinvaziv të gjirit. Karcinoma duktale in situ do të thotë se kanceri është i kufizuar në duktuse-kanalet e qumështit. Gati se të gjitha femrat-gratë me kancer në këtë fazë mund të shërohen.

Carcinoma lobulare in situ: Kjo gjendje fillon të paraqitet në gjëndrat që tajitin qumësht por nuk i depërton muret e lobuluseve.

Carcinoma ductale invasivum: Është forma më e shpeshtë e kancerit të gjirit. Fillon në kanalet e qumështit, depërton nëpër muret e kanalit dhe përfshin parenkimën e gjirit. Prej aty mund të përhapet në pjesët e tjera të trupit. Paraqet rreth 80% të kancerëve invazivë të gjirit.

Carcinoma lobulare invasivum: Kjo formë e kancerit shfaqet në gjëndrat qumështore apo lobule. Mund të shpërndahet në pjesët tjera të trupit. Në rreth 10% të kancerëve invazivë të gjirit janë të këtij tipi.

Ka edhe disa lloje të tjerë të kancerit të gjirit të cilët janë më të rrallë.

Epidemiologjia e kancerit të gjirit:

Kanceri i gjirit është ndër sëmundjet më të shpeshta malinje te femrat. Kanceri i gjirit po fiton një shtrirje ose zhvillim epidemik. Nga kjo sëmundje malinje në botë, në vit vdesin rreth 400.000 femra, ndërsa sëmuren rreth 1.000.000. Në Evropë, nga kjo sëmundje në vit vdesin rreth 129.000 femra, ndërsa sëmurën rreth 370.000. Sipas Shoqatës Amerikane kundër kancerit të gjirit, (*American Cancer Society*) në Amerikë, gjatë vitit 2006 në mbi 200.000 femra është zbuluar se kanë kancer invaziv të gjirit. Mbi 40.000 femra do të vdesin brenda vitit nga kjo sëmundje. Sipas kësaj shoqate, momentalisht, në SHBA ka diç mbi 2 milionë gra që jetojnë dhe mjekohen nga kanceri i gjirit. Në Kroaci në vitin 2003, frekuenca e kancerit të gjirit ka

qenë në rreth 1%o. Sipas Shoqatës së Senologëve të Kroacisë, sot çdo e 11-ta femër në Kroaci rrezikohet nga kanceri i gjirit. Gjasat që një grua të ketë kancer invaziv të gjirit në ndonjë periudhë të jetës është rreth 1 ndaj 8. Gjasat e vdekjes nga kanceri i gjirit është 1 ndaj 33. Megjithatë, shkalla e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit është në rënie. Kjo rënie me gjasë është rezultat i zbulimit të hershëm të kancerit dhe trajtimit mjekësor më të avancuar.

FAKTORËT E RREZIKUT DHE PARANDALIMI I KANCERIT TË GJIRIT

Ne ende nuk e dimë saktësisht se çka e shkakton kancerin e gjirit, por e dimë se faktorë të caktuar të rrezikut janë të ndërlidhura me sëmundjen. Faktori i rrezikut është çfarëdo që rrit gjasat që një person ta ketë një sëmundje si për shembull kancerin. Kancerët e ndryshëm kanë faktorë të ndryshëm të rrezikut. Disa faktorë të rrezikut, siç është pirja e duhanit, mund të vihen nën kontrollë. Të tjerat, sikur mosha e personit apo anamneza familjare, nuk mund të ndryshohen. Por, nëse personi ka një faktor të rrezikut, apo edhe disa, nuk do të thotë se ai person domosdo të sëmuret nga ajo sëmundje. Disa gra të cilat kanë një apo më tepër faktorë të rrezikut, kur nuk sëmuren nga kanceri i gjirit. Dhe shumë gra të cilat sëmuren nga kanceri i gjirit nuk kanë pasur çfarëdo faktorë të rrezikut. Përderisa të gjitha gratë janë në rrezik potencial për t'u sëmurë nga kanceri i gjirit, faktorët e numëruar më poshtë mund t'i rrisin gjasat e një gruaje për të pasur sëmundjen.

FAKTORËT E RREZIKUT TË CILËT NUK MUNDEMI T'I NDRYSHOJMË

GJINIA: thjeshtë të qenit femër-grua paraqet faktorin më kryesor të rrezikut për kancer të gjirit. Përderisa edhe meshkujt mund ta kenë këtë sëmundje, ajo është 100 herë më e shpeshtë tek gratë krahasuar me meshkujt.

MOSHA: Gjasat për ta fituar kancerin e gjirit rriten me kalimin e moshës së gruas. Afërsisht 8 nga 10 kancer të gjirit janë zbuluar tek gratë prej moshës 50 vjeçare e më shumë.

FAKTORËT GJENETIKË: Nga rreth 5% - 10 % të kancerëve të gjirit janë të ndërlidhur me ndryshimet në gjenet e caktuara. Ndryshimet

më të shpeshta gjenetike ndodhin tek gjenet BRCA1 dhe BRCA2. Gratë me këto ndryshime gjenetike kanë deri në 80% gjasë për ta fituar kancerin e gjirit gjatë jetës. Edhe ndryshimet tjera gjenetike mund ta rrisin rrezikun nga kanceri i gjirit.

ANAMNEZA FAMILJARE: Rreziku i shfaqjes së kancerit të gjirit është më i lartë tek gratë që kanë të afërm të gjakut me këtë sëmundje. Të afërmit mund të jenë si nga ana e familjes së nënës po ashtu edhe nga ana e familjes së babait. Nëse gruaja ka nënën, motrën apo vajzën me kancer të gjirit, kjo e dyfishon rrezikun për të.

ANAMNEZA PERSONALE: Gruaja me kancer në njërin gji ka gjasa më të mëdha që të fitojë kancer të ri në gjirin tjetër apo ndonjë pjesë tjetër të gjirit të njëjtë. Kjo dallon nga rekurenca, gjegjësisht rikthimi i kancerit të parë. Gratë e racës së bardhë kanë diç më tepër gjasa për kancer të gjirit në krahasim me zezaket. Por, zezaket kanë më tepër gjasa të vdesin nga ky kancer. Shumë ekspertë janë të mendimit se arsyeja kryesore qëndron në faktin se ato kanë tumore që rriten më shpejt. Aziatiket, Hispaniket dhe gratë Indiane të Amerikës kanë rrezik më të vogël për ta përfituar kancerin e gjirit.

BIOPSIA ABNORMALE E GJIRIT: Tipet e caktuara të biopsive abnormale mund të ndërlidhen me rritje në masë të vogël të rrezikut për kancer të gjirit.

RREZATIMI I MËHERSHËM I GJIRIT: Gratë të cilat kanë pasur trajtim me rrezatim në zonën e gjoksit (si trajtim për ndonjë kancer tjetër) më herët gjatë jetës, kanë rrezik të shtuar për kancer të gjirit.

CIKLET MENSTRUALE: Gratë të cilat fillojnë të kenë menstruacione herët (para moshës 12 vjeçare) ose ato të cilat kanë hyrë në menopauzë pas moshës 55 vjeçare kanë një shkallë diç më të lartë të rrezikut nga kanceri i gjirit.

TRAJTIMI ME DES: Në të kaluarën, disa grave shtatzëna u është dhënë ilaçi DES (*diethylstilbestrol*) sepse është menduar se i ul gjasat për abort. Studimet e mëvonshme kanë treguar se këto gra (dhe vajzat e tyre që u janë ekspozuar DES-it gjersa kanë qenë në mitër), kanë një shkallë diç më të rritur të rrezikut për përfitimin e kancerit të gjirit.

FAKTORËT E RREZIKUT TË CILËT MUNDEMI T'I NDRYSHOJMË

MOSLINDJA E FËMIJËVE: Gratë të cilat nuk kanë lindur fëmijë, ose ato që e kanë lindur fëmijën e parë pas moshës 30 vjeçare kanë shkallë diç më të ngritur të rrezikut nga kanceri i gjirit.

NUMRI I SHTATZËNIVE-LINDJEVE: Të qenit shtatzënë më shumë se një herë në moshë më të re zvogëlon rrezikun nga kanceri i gjirit.

PILULAT KONTRACEPTIVE: Studimet kanë treguar se gratë që përdorin pilula kontraceptive janë në rrezik të shtuar nga kanceri i gjirit në krahasim me ato që kurrë nuk i kanë përdorur këto pilula. Gratë të cilat kanë ndërprerë marrjen e këtyre pilulave më shumë se 10 vjet, duket se nuk kanë rrezik të shtuar.

TERAPIA ZËVENDËSUESE HORMONALE: Është konstatuar se përdorimi në afat të gjatë (disa vite apo më tepër) i terapisë hormonale zëvendësuese (estrogjenet bashkë me progesteron) pas menopauzës rrit rrezikun e kancerit të gjirit si dhe të sëmundjeve kardiovaskulare. Kanceri i gjirit po ashtu është zbuluar në fazën më të avancuar, me gjasë ngaqë terapia hormonale zëvendësuese duket se ul efektivitetin e mamogramit. Pesë vjet pas ndërprerjes së terapisë zëvendësuese hormonale, rreziku nga shfaqja e kancerit të gjirit duket se kthehet në normale. Dhënia vetëm e estrogjeneve nuk duket se e rrit rrezikun e kancerit aq shumë, apo fare nuk e rrit. Në ditët e sotme, duket se ka pak arsye të forta për përdorimin e terapisë hormonale postmenopauzale, përveç për lehtësimin afatshkurtër të simptomeve menopauzale. Në një analizë të një varg studimesh lidhur me ndikimin e terapisë zëvendësuese hormonale dhe kancerit të gjirit ([8]) vihet në përfundim se terapia zëvendësuese hormonale është një ndihmesë për gratë në menopauzë, si dhe ende pa rrezik afatshkurtër për kancer të gjirit. Sipas këtij studimi konsumimi me masë i alkoolit dhe mbipesha në fakt paraqesin rrezik më të shtuar për kancer të gjirit se terapia zëvendësuese hormonale.

GJI-DHËNIA DHE SHTATZËNIA: Disa studime kanë treguar se gji-dhënia e ul në njëfarë mase rrezikun nga kanceri i gjirit, veçanërisht nëse gji-dhënia zgjat një vit e gjysmë deri në dy vjet. Kjo mund të jetë nga arsyeja se gji-dhënia e ul numrin e përgjithshëm të cikleve menstruale të gruas, sikur që bën dhe shtatzënia. Një studim ka treguar se të pasurit më shumë fëmijë dhe dhënia gji për një periudhë më të gjatë, mund ta zvogëlojë përgjysmë rrezikun e kancerit të gjirit.

ALKOOLI: Përdorimi i alkoolit është qartazi i lidhur me rritjen në njëfarë mase të rrezikut nga fitimi i kancerit të gjirit. Gratë që konsumojnë një gotë alkool në ditë, kanë rritje në masë shumë të vogël të rrezikut. Ato që konsumojnë dy deri pesë pije në ditë kanë 1 ½ më shumë rrezik në krahasim me ato që nuk e konsumojnë alkool. Një meta-studim i një grupi studiuesish (*Ccollaborative Group on Hormonal Factors in Breast Cancer*) në vitin 2002 ([9]) tregon se në shtetet e zhvilluara risku për kancerin e gjirit nga konsumimi i alkoolit është 4%.

MBIPESHA DHE USHQIMI SHUMË I YNDYRSHËM: Të qenit mbipeshë është i ndërlidhur me rrezikun më të lartë për kancer të gjirit, veçanërisht tek gratë pas ndryshimeve jetësore dhe nëse fitimi i peshës ka ndodhur në moshën madhore. Po ashtu, duket se rreziku është më i lartë nëse ka tepricë dhjami në zonën e belit. Por lidhja ndërmjet peshës dhe rrezikut për kancer të gjirit është komplekse, dhe studimet mbi varshmërinë e kancerit të gjirit nga sasia e yndyrës në ushqim kanë dhënë rezultate kontradiktore. Meqenëse ushqimi dhe pesha ndikojnë në përfitimin e disa tipave të tjera të kancerit si dhe sëmundjeve të zemrës, rekomandohet që të ruhet pesha normale dhe të kufizohet përdorimi i mishit të kuq, veçanërisht i atyre me shumë dhjam apo që janë të përpunuara.

USHTRIMET FIZIKE: Studimet kanë treguar se ushtrimet fizike zvogëlojnë rrezikun e kancerit të gjirit. Çështja e vetme që parashtrohet është se sa ushtrime janë të nevojshme. Një studim ka treguar se vetëm 1 orë e 15 minuta deri në 2 orë e 30 minuta në javë të ecjes së shpejtë ka zvogëluar rrezikun për 18%. Të ecurit 10 orë në javë e zvogëlon rrezikun diç më tepër. Rekomandohet aktivitet fizik në rreth një orë, së paku për 5 ditë në javë.

FAKTORËT E DYSHIMTË TË RREZIKUT

AMBIENTI: Shumë studime janë bërë për të mësuar se si ambienti mund të ndikojë në rrezikun e kancerit të gjirit. Për momentin, hulumtimet nuk tregojnë lidhje të qartë ndërmjet rrezikut të kancerit të gjirit dhe ndotësve të ambientit, siç janë pesticidet dhe PCB-të (*Polychlorinated biphenyls*).

DUHANI: Shumica e studimeve nuk kanë zbuluar ndonjë lidhje ndërmjet pirjes aktive të duhanit dhe kancerit të gjirit. Edhe pse pirja aktive si dhe ajo pasive e duhanit tregon rritje të rrezikut të kancerit të gjirit në disa nga studimet, kjo çështje ende mbetet kontradiktore. Pa marrë parasysh lidhjen e mundshme ndërmjet duhanit dhe kancerit të gjirit, mospirja e duhanit

dhe kufizimi i qëndrimit në vendet ku pihet duhani është dobiprurëse për një numër të arsyeve shëndetësore, duke përfshirë rrezikun e zvogëluar nga kancerët e tjerë dhe sëmundjet e zemrës. Përderisa ndonjë lidhje direkte ndërmjet pirjes së duhanit dhe kancerit të gjirit nuk është gjetur, disa studime sugjerojnë se pirja e duhanit mund ta rrisë rrezikun e kancerit të gjirit, veçanërisht nëse gratë kanë filluar të pinë duhan në moshën e adoleshencës. Pirja e duhanit dëmton shëndetin përgjithësisht dhe rrit rrezikun për shumë kancer të tjerë, si dhe sëmundje të zemrës.

DEODORANSET: Nga emailat në internet janë përhapur thashetheme se deodoransët kundër djersitjes për nënsqetull mund të shkaktojnë kancerin e gjirit. Ka shumë pak dëshmi për ta përkrahur këtë ide.

JELEKU I GJINJVE: Edhe pse ka shkrime se jeleku i gjinjve që ka tel mbajtës nga ana e poshtme mund të shkaktoj kancerin e gjirit, megjithatë nuk ka dëshmi shkencore për ti përkrahur këto shkrime më shumë në formë thashethemeve.

ABORTET: Disa studime tregojnë se abortet e detyruara nuk e rrisin rrezikun e kancerit të gjirit. Poashtu, nuk ka dëshmi për të treguar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet abortit spontan dhe kancerit të gjirit. Mirëpo, abortet nuk janë mjet ose metodë kontraceptive.

IMPLANTET E SILIKONIT: Implantet e silikonit për gji mund të shkaktojnë formimin në gji të indit me vraga. Mirëpo disa studime kanë zbuluar se kjo nuk e rrit rrezikun e kancerit të gjirit. Te gratë me implante të gjirit, nevojiten imazhe speciale rëntgeni gjatë mamograme ve.

PUNA GJATË NATËS: Disa studime të fundit japin sugjerime se gratë që punojnë gjatë natës (psh. infermieret) kanë rrezik më të lartë të kancerit të gjirit. Por, kjo ende nuk është dëshmuar.

PARANDALIMI I KANCERIT TË GJIRIT

Edhe pse ne i dimë disa nga faktorët e rrezikut që kanë të bëjnë me kancerin e gjirit, ende nuk dimë se cili është shkaktari i shumicës së kancerëve. Mund të thuhet se një grua me faktor mesatar të rrezikut mund ta ul rrezikun deri diku, duke ndryshuar ata faktorë të rrezikut që mund të ndryshohen. Kjo përfshin lindjen e fëmijëve me kohë para moshës 30 vjeçare e disa fëmijëve, gji-dhënia për disa muaj, mospirja e alkoolit dhe duhanit, ushtrime të rregullta fizike, dhe ruajtja e peshës normale.

Ka teste që mund të tregojnë nëse një grua ka gjene të ndryshuara (me mutacione) që janë të lidhura me kancerin e gjirit. Me këtë informatë, gratë mund të ndërmarrin hapa për ta zvogëluar rrezikun. Rekomandohet këshillë

gjenetike para se të bëhen këto teste dhe para se të merren çfarëdo vendimesh lidhur me masat parandaluese. Sipas rekomandimeve të fundit, vetëm njerëzve që kanë anamnezë ekstensive familjare për këtë sëmundje, duhet t'u bëhet vlerësimi gjenetik. Gratë që kanë mutacionin e BRCA1 dhe të cilave u janë hequr vezoret në mënyrë kirurgjike para moshës 40 vjeçare, kanë rrezik më të ulët të kancerit të gjirit.

Bari *Tamoxifen* është përdorur me vite të tëra si trajtim për disa tipa të kancerit të gjirit. Disa studime tregojnë se gratë me shkallë të lartë të rrezikut për kancer të gjirit kanë më pak gjasa ta fitojnë këtë sëmundje nëse marrin Tamoxifen. Një bar tjetër, *Raloxifene* po ashtu është hulumtuar për t'u përdorur për reduktimin e rrezikut të kancerit të gjirit. Tash ka barna edhe më të reja të kësaj natyre që janë duke u studiuar.

VETËKONTROLLI I GJINJVE

Më së paku që një femër-grua mund të bëjë për veten është që vetë t'i kontrollojë gjinjtë e saj një herë në muaj. Vetëkontrolli i gjinjve është metoda e parë dhe më e përhapur për zbulimin e hershëm të ndryshimeve në gji. Kjo metodë për shkak të mënyrës së thjeshtë të realizimit dhe pa pasur nevojë për shpenzime, paraqet metodën themelore në vargun e ekzaminimeve për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Kanceri i gjirit është i pranishëm 2 deri në 8 vjet para se të mund të hetohet ose të diagnostikohet. Për këtë shkak sa më herët të fillohet me vetëkontrollin e gjinjve aq më herët mund të zbulohen ndryshimet që mund të ndihmojnë për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Çdo femër-grua, me vetëkontrollin e gjinjve duhet të filloj që në moshën 20 vjeçare, por jo më vonë se 25 vjeçe. Kuptimi i vetëkontrollit të gjinjve është që femra-gruaja të mëson ose kupton ndërtimin normal të gjinjve të saj. Duke e njohur formën, madhësinë, ndërtimin-konsistencën, normale të gjinjve, femra-gruaja në të ardhmen më lehtë do ti heton ndryshimet eventuale në rast se ato shfaqën, dhe me kohë do të ndërmerren veprime përkatëse.

Vetëkontrolli i gjinjve duhet te kryhet një herë në muaj, përafërsisht çdo muaj në të njëjtën kohë. Më së miri në mëngjes ose në mbrëmje. Femrat-gratë me cikël të rregullt menstrual, duhet të kryejnë vetëkontrollin e gjinjve nga dita e 5-të deri ditën e 10-të të ciklit menstrual. Kjo periudhë është e përshtatshme edhe për ekzaminimin mamografik e edhe për ekzaminim ultrasonografik[10]

Kujdes, dita e parë e menstruacioneve është dita kur fillojnë gjakderdhjet menstruale. Kjo periudhë e ciklit menstrual është momenti

kur gjinjtë janë më pakë të ndjeshëm. Femrat-grat me cikël të parregullt menstrual dhe ato në periudhën e postmenopauzës, mund të zgjedhin vet cilëndo ditë në muaj, dhe të bëjnë vetëkontrollin e gjinjve, por gjithmonë në të njëjtën kohë. Kohëzgjatja normale e vetëkontrollit të gjinjve duhet të sillet nga 15-30 minuta.

Vetëkontrolli i gjinjve kryhet në dy pjesë. Pjesa e parë është vështrimi i gjinjve dhe pjesa e dytë është prekja ose palpimi i gjinjve. Vetëkontrolli i gjinjve mund të kryhet: para pasqyrës, në pozitë të shtrirë në një sipërfaqe të fortë dhe nën dush.

I. VETËKONTROLLI I GJINJVE ME ANË TË VËSHTRIMIT - QËNDRIMI PARA PASQYRËS

Gjatë pjesës së parë të vetëkontrollit të gjinjve femra-gruaja fillimisht duhet të qëndron para pasqyrës.

a)Në fillim duke i vendosur duart në bel vështron gjinjtë. Gjatë vështrimit duhet të përqendrohet në madhësinë, formën, konturat-reliefin e gjinjve. Të dy gjinjtë duhet të jenë simetrik, ndërsa thimthat në të njëjtin nivel. Duhet vështruar se a ka ndonjë të ngrituri-gungë ose ndonjë të ulur-gropëz. Vazhdon dhe vështron pamjen dhe ngjyrën e lëkurës së gjinjve, pamjen dhe ngjyrën e thimthave, futjen-tërheqjen e thimthave brenda dhe rrjedhjet eventuale nga thimthi.

b)Vazhdon vështrimin e gjinjve me duar të lëshuara poshtë për rreth trupit, duke analizuar dhe vështruar të njëjtat detaje si në rastin me duar në bel.

c)Në fund, duart ngritën dhe vendosën pas kokës, dhe vazhdohet vështrimi dhe analiza e të njëjtave detaje të përshkruara si në rastet me duar në bel dhe me duar të lëshuara për rreth trupit.

Nëse hetohen çfarëdo ndryshimesh gjatë vështrimit të gjinjve, duhet që asaj pjese ose atij ndryshimi ti përkushtohet vëmendje e posaçme gjatë pjesës së dytë (prekjes-palpimit) të vetëkontrollit të gjinjve.

II. VETËKONTROLLI ME ANË TË PREKJES

Kjo mënyrë e vetëkontrollit të gjinjve kryhet në dy mënyra, në pozitë të shtrirë në një sipërfaqe të rrafshët dhe të fortë dhe nën dush. Gjatë vetëkontrollit duhet të përdorën dy ose më shume gishta, e jo vetëm një gisht. Pjesa më e ndjeshme e gishtërinjve, e cila më së miri i heton ndryshimet në prekje janë mollëzat e gishtërinjve.







Duhet pasur kujdes që të mos shtypet fortë gjiri me maje të gishtërinjve ose mos të gërvishtet me thonj, sepse këto janë gabimet më të shpeshta që bëhen gjatë vetëkontrollit. Me rëndësi është që femra-gruaja të mësohet të prek dy lloje ndryshimesh ose ndjesisë. Ndjesia e parë që prek, janë prekjet e sipërfaqeve të lëmuara dhe të rrëshqitshme. Në këto raste preken struktura normale dhe u përgjigjën gjëndrave të qumështit dhe kanaleve të tyre, eventualisht ndryshimeve cistike beninje. Për ta kuptuar këtë ndjenjë të prekjes, me mollëz të gishtit tregues bëni shtypje dhe lëvizni gishtin mbi syrin e mbyllur. Gjatë lëvizjeve hetohet ndjenjë e prekjes me rrëshqitje - rrëshqet kapaku i syrit mbi bebëzën e syrit. Ndjenja e dytë e prekjes gjatë vetëkontrollit të gjinjve, është prekja e sipërfaqeve të forta dhe jo të rrëshqitshme. Për ta kuptuar këtë ndjenjë të prekjes, preket hunda, dhe pastaj provohet që lëkura e hundës të lëvizet pa e lëvizur majën e hundës. Kjo nuk mund të arrihet sepse lëkura është e fiksuar për majën e hundës dhe i përcjell edhe lëvizjet e majës së hundës. Çdo herë kur bëhet vetëkontrolli i gjinjve duhet të shënohet në kalendar. Në rast se hetohet ndonjë ndryshim gjatë vetëkontrollit të gjinjve, duhet kërkuar ndihmën e mjekut për ta sqaruar ndryshimin.

VETËKONTROLLI I GJIRIT NË POZITË TË SHTRIRË

Veprimi i parë: Fillimisht femra-gruaja duhet të ç'veshët nga beli e lart dhe të shtrihet në shpinë. Vendos një jastëk nën shpatullën e majtë. Vendosja e jastëkut nën shpatull ndihmon që indi i gjirit të jetë i tërhequr në tërë gjirin njëlloj gjë e cila mundëson kontrollin më të lehtë dhe më të mirë të gjirit. Shuplaka e majtë ngritët dhe vendoset pas kokës. Me mollëza të tre gishtërinjve të shtrirë të dorës së djathtë, (gishtit tregues, gishtit të mesëm dhe gishtit të unazës), kontrollohet së pari gjysma e gjirit të majtë. Në fillim 1/4 e brendshme e sipërme e pastaj 1/4 brendshme e poshtme, duke kërkuar ndryshime në formë të çfarëdo nyje apo ngurësimi eventual në gjirin e majtë.

Veprimi i dytë: Në vazhdim femra-gruaja e lëshon dorën e majtë përreth trupit dhe e vazhdon kontrollin e gjysmës së jashtme të gjirit. Në fillim 1/4 e sipërme të jashtme e pastaj 1/4 e poshtme të jashtme.

Gjatë vetëkontrollit të gjinjve me anë të prekjes, duhet aplikuar prekje-palpim me intensitet prej tri nivelesh. Palpimi-prekja me intensitet të lehtë nevojitet për të prekur ndryshimet sipërfaqësore, prekja-palpimi me intensitet të mesëm, nevojitet për të analizuar ndryshimet në indet e mesit të gjirit dhe prekja me shtypje me intensitet të fortë nevojitet për të analizuar indet e thella të gjirit afër brinjëve. Pra, gjatë vetëkontrollit femra është me rëndësi të shtyp mjaft fortë, por megjithatë me gjentilesë, për ta ndjerë dhe njohur strukturën e gjirit të saj. Është normale që femra të ndjej një vijë të fortë në gjysmërrethin e poshtëm tek secili gji. Me mollëzat e gishtave të përmendur, duhet të kryeni lëvizje që janë treguar në skemat vijuese. Mund të zgjedhin lëvizje poshtë-lartë (A), lëvizje rrethore (B) apo lëvizje kah dhe nga thimthi (C). Orientimi i vetëkontrollit të gjirit duhet të ketë një rregull të caktuar. Orientimi në drejtim të rrotullimit të akrepave të orës ose në formë të kuadrateve. Vetëkontrollin mundohemi ta lehtësojmë duke e

ndarë gjirin në ¼ ose kuadrate dhe dallojmë 4 kuadrate dhe atë: kuadrati i sipërm medial, i sipërm lateral, i poshtëm medial dhe i poshtëm lateral. Është me rëndësi që kuadratet të paramendohen si sirtar të një vitrine. Shumë më mirë do të mund rregullohet një vitrinë nëse ajo fillohet e rregullohet sirtar për sirtar se sa të gjithë përnjëherë.

Veprimi i tretë: në fund femra-gruaja kontrollon edhe regjionin e nënsqetullës. Pasi e kryen kontrollin e gjirit të majtë, të njëjtat veprime i kryen me gjirin e anës së djathtë.

Të gjitha ndryshimet që i has femra gjatë vetëkontrollit duhet të jenë si një vërejtje që ajo të kërkojë këshilla dhe ndihmën e mjekut.

Pasi të ketë përfunduar vetëkontrolli i gjirit të majtë, fillohet me të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën renditje edhe vetëkontrolli i gjirit të djathtë.

VETËKONTROLLI I GJINJVE NËN DUSH: Meqenëse disa ndryshime hetohet më lehtë kur lëkura është e lagur dhe e lyer me sapun, rekomandohet vetëkontrolli nën dush. Kryhet në mënyrë të njëjtë si gjatë vetëkontrollit në pozitë të shtrirë dhe me të njëjtën renditje. Gjatë vetëkontrollit të gjinjve nën dush, më së miri është që dora me të cilën bëhet vetëkontrolli të jetë me sapun sepse rrëshqet më lehtë, dhe në këtë mënyrë më mirë preken ose hetohen ndryshimet eventuale.

MJEKIMI I KANCERIT TË GJIRIT

Mjekimi i kancerit të gjirit është multidisciplinar. Kombinimi i terapisë kirurgjikale, rrezatimit, dhe mjekimi sistematik, siguron suksesin më të mirë gjatë mjekimit. Lloji dhe renditja e metodave të mjekimit para se të fillohet të mjekohet çdo paciente duhet të jenë të planifikuara nga ekipe multidiscilinare të mjekeve si kirurg-onkolog, radioterapeut dhe internist-onkolog. Vetëm një qasje e këtillë ekipore, siguron suksesëshmëri maksimale të mjekimit të kancerit të gjirit([11]). Përzgjedhja dhe renditja e metodave dhe mënyrave të mjekimit, varet fillimisht nga përhapja e procesit malinjë, e lidhur me te edhe nga vetit biologjike të tumorit për secilën paciente veç e veç.

Mjekimi lokal i kancerit operabil: Për kancerin operabil flitet kur sëmundja ende mund të trajtohet me metoda kirurgjike, kur kanceri nuk është i përhapur në lëkurë dhe murin e kafazit të kraharorit, nuk ka dhënë metastaza të afërta në nyjat limfatike regjionale ose nuk është përhapur në organet dhe sistemet tjera të organizmit. Largimi i tumorit së bashku me indin e shëndosh për rreth (sinonime: *tumorektomia, kudrantektomia, lumpektomia*), ose largimi i tërë gjirit (*mastektomia*). Mastektomia është e nevojshme sidomos në rastin e kancerit multifokal. Nëse me rezultat patohistologjik është konstatuar se bëhet fjalë për kancer të tipit invaziv, atëherë duhet të largohen edhe nyejt limfatike të nënsqetullës, edhe pse rezultatet janë të njëjta edhe nëse nënsqetulla rrezatohet([12]). Te pacientet te të cilat është bërë vetëm largimi i tumorit duhet të behet rrezatimi i gjirit. Në një meta studim dyvjeçar kanadez dhe danez, kanë ardhur në përfundim se terapia shtesë me rrezatim pas mastektomisë, ul mundësinë e recidivit lokal dhe përmirëson kohëzgjatjen e jetës([13])

Mjekimi shtesë sistemik me citostatik dhe terapi hormonale: Në kancerin e gjirit, femrat-gratë, nuk i rrezikon vetëm tumori por edhe metastazat të largëta, të cilat gjatë viteve shfaqen në rreth gjysmën e pacienteve me kancer të gjirit. Për këtë shkak është i nevojshëm mjekimi shtesë sistemik, i cili në shumë meta studime është treguar se për rreth 1/3 e rasteve e ul rrezikun për zhvillimin e metastazave të largëta([14],[15]). Sipas këshillave të konferencës së rregullt në Shën Gallen ([16]) dhe NCL-së (*National Cancer Institute*), mjekimi sistemik shtesë duke pasur parasysh përhapjen e sëmundjes, propozohet te të gjitha pacientet me kancer të gjirit pos te rastet me tumor me prognozë të volitshme e që në fakt janë tumoret me madhësi më të vogël se10mm, me shkallë të ulët malinjiteti dhe hormon receptor pozitiv dhe nëse pacientet nuk janë më

të reja se 35 vjeç. Një meta analizë ka konstatuar si dobiprurëse aplikimin e mjekimit shtesë hormonal me antiestrogjen - Tamoksifen te të gjitha kanceret e gjirit të varur nga hormonet-receptor pozitiv, dhe atë si para ashtu dhe pas periudhës së menopauzës(15). Për këtë shkak, terapia shtesë hormonale ju propozohet të gjitha pacienteve me kancer të varur nga estrogjenet-receptor pozitiv.

Mjekimi simptomatik: Kanceri i gjirit është sëmundje kronike, kështu që shumë pacienteve u duhet edhe mjekim simptomatik shumëvjeçar, i cili u lehtëson shumë shqetësime pacienteve të shkaktuara nga tumori. Është me rendësi të udhëhiqet si duhet terapia me analgjetik. Një përparim në kualitetin e jetës së pacienteve me kancer të gjirit, është bërë me futjen në terapinë simptomatike të barnave me veprim më efikas. Në këtë grup bëjnë pjesë Biofosfatet që nxisin osteoblastet dhe osteoklastet që nxisin krijimin e masës së re kockore, e cila në rastet me metastaza kockore dëmtohet. Është provuar se mjekimi i pacienteve me metastaza kockore me biofosfate, lehtëson dhimbjet, zvogëlon numrin e frakturave patologjike si dhe zvogëlon besueshmërinë e zhvillimit të *hiperkalcemisë* ([17]).

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Numër i madh i grave nuk i kontrollojnë gjinjtë e vet nga frika se mund të gjejnë ndonjë ndryshim, i cili mund të jetë kancer i gjirit. Me injorimin e kontrollit dhe vetëkontrollit të gjinjve, ndryshimet eventuale në gji asnjëherë nuk do të eliminohen vetvetiu, përkundrazi, ato vetëm sa do të shtohen.

Krahas vetëkontrollit të rregullt të gjirit, rekomandohet edhe ekzaminimi specialistik i kohëpaskohshëm i gjirit. Qëllimi i të gjitha vizitave dhe ekzaminimeve të gjinjve është zbulimi sa më i hershëm i kancerit të gjirit mundësisht në fazën fillestare kur edhe mjekimi është i suksesshëm për të thënë edhe 100 për qind. Në vazhdim do të përmendim disa nga mënyrat dhe metodat kryesore për diagnostikimin e sëmundjeve të gjinjve.

Mamografia: është një prej metodave diagnostike për zbulimin e hershëm të sëmundjeve të gjirit. Ajo është një teknikë rëntgenologjike e cila nëse përdoret me kujdes, dhe nga ekspert, nuk shkakton as dhembje e as dëm. Me këtë metodë diagnostikuese përfitohet imazh i qartë i brendësisë së gjirit. Është gabim t'iu shmanget mamografisë, nëse ajo është rekomanduar, nga frika e gjoja efektit të dëmshëm të rrezatimit.

Egzaminimi me ultratingull, është metodë tjetër diagnostikuese e cila këshillohet të behët sidomos te femrat-gratë në mosha të reja. Ekzaminimi ultrasonografik është treguar i padëmshëm pavarësisht sa herë përsëritet, dhe së bashku me diagnostikën rëntgenologjike (mamografinë) e rrit saktësinë diagnostikuese në diagnostikimin e sëmundjeve të gjirit si të sëmundjeve beninje, ashtu edhe të kancerit të gjirit.

Vizita ultrasonografike është shumë e vlefshme sidomos në diferencimin e tumoreve solid me ata cistik, si dhe sqarimin e shumë strukturave që preken me dorë gjatë vetëkontrollit të gjinjve. Aparatet ultrasonografike të gjeneratave më të reja së bashku me sondat me rezolucion të lartë (mbi 10 Mhz) e në vartësi edhe nga eksperti që kryen vizitën, deri në rreth 98% të rasteve dallon dhe diferencon proceset beninje dhe malinje. Në rastet kur ka dyshim ose nuk mund te përcaktohet me siguri natyra e proceseve patologjike, atëherë me ndihmën e ultrazërit këto procese *punktohen (hyhet me gjilpërë*) dhe merret materiali për analizë citologjike ose verifikim patohistologjik, në mënyrë që të fitohen të dhëna të reja për sqarimin e natyrës së procesit dhe vënien korrekte dhe të saktë të diagnozës.

Përdorimi i teknikave të reja të diagnostikës ultrasonografike sidomos kolor Doppleri, ndihmon në sqarimin e proceseve patologjike duke analizuar vaskularizimin dhe vendosjen e enëve te gjakut të cilat e furnizojnë tumorin gjegjësisht procesin patologjik. Kohëve të fundit është në përdorim edhe 3D-4D ultrasonografia e cila fut të dhëna shtesë në sqarimin e natyrës së tumoreve gjegjësisht proceseve patologjike në gjinj.

Disa shkencëtar mendojnë se ekzaminimi ultrasonografik me sondë speciale me rezolucion të lartë (nga 10-15 MHz), do të bëhet metoda më e fuqishme për zbulimin e hershem të kancerit të gjirit, ndërsa mamografia do të mbetet si metodë për zbulimin e kancerit intraduktal të gjirit.

Ekzaminimi me rezonancë magnetike: Incizimi me rezonancë magnetike përdoret në rastet kur as kontrolli i mjekut, e as edhe incizimi ultrasonografik dhe mamografik nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme në bazë të të cilave mund të konstatohet me siguri se ndryshimi në gji ka natyrë beninje. Për këtë arsye, ky incizim duhet të jetë i rezervuar vetëm për rastet e dilemave të pazgjidhshme diagnostikuese.

Propozimet e shumë shoqatave botërore për luftë kundër kancerit të gjirit ofrojnë disa këshilla, për orarin e vizitave, të cilat në pika të shkurtra do ti paraqesim. Orari i vizitave ka një renditje të caktuar dhe në rend të parë varet prej moshës së femrës dhe disa të dhënave anamnestike.

Femrat e reja-vajzat: duhet të fillojnë me vetëkontrollin e gjinjve që nga mosha 20 vjeçare (një herë në muaj, nga dita e 5 deri në ditën e 10-të ciklit menstrual.

Nga mosha 25 vjeçare: propozohet që një herë në vit të bëhet një vizitë klinike dhe një vizitë ultrasonografike e gjinjve. Edhe këto vizita bëhen nga dita e 5 deri në ditën e 10-të të ciklit menstrual

Nga mosha 40 vjeçare: propozohet të fillohet edhe me mamografinë e parë të quajtur mamografia bazike. Mirëpo ka shoqata të ndryshme në botë që luftojnë kancerin e gjirit, dhe propozojnë që në vartësi prej të thënave anamnestike mbi faktorët e rrezikut, me mamografinë bazike duhet të fillohet nga mosha 35 vjeçare. Disa shoqata propozojnë që kjo të bëhet në moshën 38 vjeçare. Nëse kjo mamografi është negative, atëherë me mamografitë tjera vazhdohet në moshën 40 vjeçare.

Nga mosha 40 deri në moshën 50 vjeçare, nëse nuk ka anamnezë të ngarkuar në familje vizita ultrasonografike ose me ultrazë propozohet të kryhet çdo 6 deri në 12 muaj, por të shoqërohet edhe me mamografi (çdo 2 vjet).

Nga mosha 50–70 vjeçare, vizita ultrasonografike duhet të bëhet çdo 6 muaj, ndërsa mamografia një herë në vit.

Pas moshës 70 vjeçare vizita ultrasonografike propozohet të behet sipas nevojës ose propozimit të mjekut përkatës.

KODEKSI EVROPIAN KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

Mos pini duhan.

Nëse jeni duhanxhinj, pos pini në prani të jo duhanxhinjve dhe mundohuni që sa më parë ta lëni duhanin

Mos përdorni alkool ose përdoreni atë në sasi të vogël

Mos qëndroni shumë nën diell. Lëkuren mbrojeni duke e lyer me krem ose losione për mbrojtjen e lëkurës.

Kur jeni në punë në kontakt me substanca të cilat mund të provokojnë kancer, konsultoheni me mjekun përkatës.

Ushqehuni me ushqim të shëndetshëm.

Shkoni menjëherë te mjeku nëse hetoni ndonjë ndryshim gjatë vetëkontrollit të gjinjve, ndonjë ndryshim-shenj në lëkurë ose rrjedhje të pazakonshme nga gjiri, kollë të shpeshtë, marrje të zërit, ndryshime ose shqetësime në organet e tretjes, humbje apetiti ose peshe

Rregullisht kontrollojeni *strishon* e porcionit vagjinal të qafës së mitrës.

Bëni vetëkontrollin e rregullt të gjinjve

---

[1] Krmpotic-Nemaniæ J. Dojka, Mamma. Në: Anatomia Èovjeka, Jugoslovenska medicinska naklada, Zagreb, 1981;524-528.

[2] Vlaisavljeviæ V. Bolesti dojke: dijagnostika i detekcija. Në: Ginekologija i Perinatologija, red. Kurjak A. Golden Time, Vara•dinske Toplice, 1995;511-536.

[3] Ravnik D. Anatomija dojke. *Radiol Oncol* 1998; 32 (Suppl 7): 30-5.

[4] Thono E, Cosgrove DO, Sloane JP. *Ultasound diagnosis of breast diseases*. Churchill Livingstone; 1994.

[5] Vlaisavljeviæ V, Paja-Perušiæ D, Borut G, Rauter Z. Ciste dojke. Jogosl. ginekol. perinatol., 1985;5-6:125-128

[6] Grgureviæ M, Pavlic Z, Grizelj V. Bolesti dojke, Në: Ginekologija, Zagreb, JUMENA, 1987:325-343.

[7] 2. Sewwell WC. Patology of benign and malignant breast disorders. *Radiol Clin North Am* 1995; 33: 1067-80.

[8] Simunic V. Hormonsko nadomjesno lijecenje i rak dojke. Tema Broja MEDIX Br. 50 listopad 2003:51-53.

[9] Collaborative Group on Hormonal Factors in Breast Cancer. Alcohol, tabaco and breast cancer – collaborative reanalysis of individual data from 53 epidemiological studies, including 58 515 women with breast cancer and 95 067 women withaut the disease. British Jurnal of Cancer 2002;87:1234-45.32 (Suppl 7): 36-40.

[10] Hertl K, Kadivec M, Vargazon T. Rentgenska anatomija normalne dojke. *Radiol Oncol* 1998;

[11] Cufer T. Breast Cacer. Medicus 2001.Vol.10,No2, 173-178

[12] Early Breast Cancer Trialists' Collaborative Group. Favorable and unfavorable effects on long-term survival of radiotherapy for early breast cancer: an overview of the randomized trials. Lancet 2000; 353:1757-70

[13] Early Breast Cancer Trialists' Collaborative Group. Effects of radiotherapy and surgery in early breast cancer. N Engl J Med 1995;333:14444-55.

[14] Early Breast Cancer Trialists' Collaborative Group. Polychemotherapy for early breast cancer: Lancet 1998; 352:930-42.

[15] Early Breast Cancer Trialists' Collaborative Group. Tamoxifen for early breast cancer. an overview of the randomized trials. Lancet 1998; 351:1451-67.

[16] Goldhirch A, Glick JH, Gelber RG, Sen HJ. Meeting highlights: International Consensus Panel on the Treatment of Primary Breast Cancer. J Natl Cancer Inst 1998;90:1601-8.

[17] Hillner BE, IngleJN, Berenson JR et al. American Society of clinical oncology guideline on the role of bisphosphonates in breast cancer. J Clin Oncol 2000;18:1378-91.

ETNOGRAFI

Dr. Maksut HAXHIBRAHIMI

MBI PIRATIN ALI URUÇ ULQINAKUN DHE GRUAN E TIJ SULLTANIJE

Në qytetin e Ulqinit para 3000 vjetësh kanë sunduar piratët, që zotëronin mbi 500 anije të vogla dhe të mëdha.

Janë ruajtur kujtime të shumta për historinë e tyre. Piratët e Ulqinit kanë qenë guximtarë, nuk njihnin kompromiset dhe ishin detarë të shkathët deri në perfeksion. Ata ngjallnin frikë dhe tmerr në gjithë Mesdheun. Shumë prej tyre kanë shënuar në epoka të ndryshme të qytetit të vjetër, ngjarje që kanë mbetur deri më sot në faqet e historisë.

Duke marrë shkas nga veprat e tyre, në atë kohë janë thurur mjaft legjenda.

Njëra nga ato flet për piratin e famshëm dhe të patrembur Ali, i cili mbi të gjitha donte të respektonte gruan e tij të bukur Sulltanije.

Sa herë kthehej nga deti, Aliu e mbulonte me dhurata të kushtueshme, me veshje të bukura e të çmueshme. Por, heshturazi, ai lutej, lutej për trashëgimtarin që duhej t'i dhuronte bashkëshortja. Për këtë mungesë të hidhur dhe të padurueshme, për hir të këtij fëmije që s'po vinte kurrë, trimi pirat u detyrua të linte gruan.

Megjithatë, për asnjë çast të vetëm, nuk reshti së menduari se ajo s'mund t'i përkiste askujt tjetër, veçse atij.

Mënyra e vetme për të arritur këtë ishte një: vrasja e saj.

Kur morën vesh qëllimin e Aliut, njerëzit e tij të afërm, fisi dhe nëna e tij, u trishtuan jashtëzakonisht shumë.

Rituali i rrotullimit rreth gurit në Plazhin e Grave të Ulqinit;

Nëna e Aliut mendonte si të shpëtonte nusen, të cilën e adhuronte dhe i lutej Zotit që të bekonte çiftin me një trashëgimtar. Kështu, një natë dëgjon në ëndërr zërin e një burri, i cili i jepte rrugëzgjidhjen dhe shpëtimin nga gjëma që i priste.

Me shumë maturi, mëngjesin e nesërm nëna e Aliut e çoi Sulltanijen jashtë mureve të qytetit, tek ujërat e burimeve sulfurore.

Ajo e mëson të futet në ujë gjer në grykë. Më pas duhej të rrotullohej tri herë rreth një guri. Ky ritual misterioz, i këshilluar nga zëri i ëndërruar në gjumë, do të përsëritej për tri javë rresht.

Mbas këtij rituali kurativ, gruaja e të famshmit Ali ngeli shtatzënë dhe solli në jetë trashëgimtarin e shumëpritur.

Aliu bëri një pritje - gosti aq madhështore, sa s'ishte parë ndonjëherë.

Legjenda e piratit të famshëm Ali ka lënë gjurmë të thella deri në ditët e sotme.

Burimet e ujërave kurativo-sulfurore që gjenden poshtë hotel "Albatros"-it sot janë një vend i njohur në mbarë botën si "Plazhi i Grave".

Në këtë vend, me të vërtetë qëndron guri, rreth të cilit burojnë ujërat kurativo-sulfurore. Atë vend e kanë vizituar për shekuj me radhë mijëra gra që s'kanë mundur të kishin fëmijë. E vizitojnë edhe në ditët e sotme, në agim para lindjes së diellit dhe zhvillojnë ritualin e rrotullimit rreth gurit. Shumë gra që nuk lindin ose që duan të kenë djalë, janë frekuentuese të këtij plazhi të rrallë.

Duke zbatuar me përpikëri ritualin, shpresojnë dhe jo rrallëherë natyra i realizon ëndrrat e këtyre nënave që presin mrekullinë.

Nën shtresën shekullore të pyllit me pisha e në lugina asgjë nuk ka ndryshuar që nga koha e piratit Ali dhe të nuses së tij Sulltanije.

Çdo gjë ka mbetur po ajo: guri, deti dhe ujërat kurativo-sulfurore që burojnë, rituali i rrotullimit rreth gurit para lindjes së diellit. Ka mbetur legjenda.

Kënga e Ali Uruç - Ulqinakut

Në periudhën e pushtimit turk, Ali Uruçi dhe shoku i tij më i ngushtë, për mosbindje ndaj Portës së Lartë të Stambollit, u vunë në kërkim nga ushtria turke në kalanë e Shkodrës, me ç'rast e burgosi Ali Uruçin, të cilit i kërkohej që t'u tregonte turqve se ku fshihej kryepirati, ulqinaku i

tmerrshëm Haxhi Ali Ulqinaku.. Në atë kohë, Haxhi Aliu strehohej në një shpellë në gadishullin e Karaburunit, në afërsi të qytetit të Vlorës. Ali Uruçi nuk e tradhtoi shokun dhe bashkëluftëtarin e vet, Haxhi Alinë, e për këtë sulltani, me një ferman të veçantë, urdhëroi që t'i pritet koka.

Shpella ku fshihej Haxhi Alia edhe sot quhet nga banorët e Vlorës "Shpella e Haxhi Alisë".

Me këtë rast në Ulqin, këngëtarët popullorë i krijuan këtë këngë Ali Uruçit, trimit besnik të Ulqinit.

Ali Uruçi po bërtet,
Haxhi beg ti mos ki dert
Ali Uruçi nuk të qet.
Kush ma gjen Haxhi Alinë,
Me tartana me gjemi,
Ja mbush shpinë un me flori.
N'shpellë Onufre asht me huq,
Mos u sill se ka Uruç,
Prej Prevezet dir ke Buna,
Venedik s'ke pa ti burra,
Turkoshak mor krye-babune,
Hajde m'gjej n'Karaburune,
N'shpellë Onufre mbush n'fugure,
Haxhi beg ti s'u përkule,
Ali Uruç del te Sazana
Ulqinak ma trim s'ka Rana,
Djem të ri bini n'saraja
Uruç trim ma s'ka Kalaja,
Uruç trim ka prep Kalaja.

(Materiali u sigurua nga Abdullah Ali Uruçi, në Kalanë e Ulqinit).

Shpella me emrin "Onufre"

Siç shihet edhe nga kënga, këtu flitet edhe për një shpellë me emrin "*Onufre*", në zonën e Karaburunit.

Kjo shpellë na përshkruhet si një vend - kishë, ku ka punuar dhe jetuar Onufri i madh, piktori ikonografik shqiptar me origjinë nga Shpati i Elbasanit.

Ai pikturoi shumë shpella dhe kisha në shumë vende të ndryshme si: në Berat, Shpat, Elbasan, Ohër, Prespë, Greqi, Maqedoni, Bullgari, Shkodër, Mal të Zi si dhe në Raguzë (Dubrovnik).

Për këtë kemi edhe një rast shumë interesant që dëshmon për punën e Onufrit në Dubrovnik.

Në Sheshin e qytetit të vjetër, në Stradun, në Pile, në krahun e djathtë është edhe "*Çesma e Onufrit*" si dhe kisha "*Sveti Vllaho*" me disa piktura (afreske) të tija.

Këtë çesme, e tipit fontanë, e projektoi dhe e ndërtoi vetë Onufri.

Legjenda:

Shpella e Haxhi Ali Ulqinakut në Karaburun të Vlorës, shpella e tmerrit për anijet e tregtarëve dhe ato ushtarake venedikase, italiane, turke e franceze. Nga kjo shpellë pirati i famshëm ulqinak Haxhi Aliu i sulmonte me tërbim deri në asgjësimin e plotë.

Sami MISHERRI

USHEJZA

Ushejza, “e xhda me thanë kja fjalë”, më pyeti nji djalosh i ri që po rrinte në tryezë me mu dhe shokët e mi, në nji restorant të Ulqinit, mu në “verë të madhe, pra në gusht kur bahej vapë, për djegagur”, kur nji nga shokët e mi tha : „*Turizmi në Ulqin do të zhvillohet. Tesh na vijnë ne turistët e huj prap n’ ushejzë*”. Në moment u befasova, por menjiherë e kuptova se ky i ri as s’e kishte idenë se çka do thotë fjala **ushejzë** e kurrsesi **gaxharra**, sepse ka ma se 30 vjet që fjala ushejzë nuk përdoret ma në Ulqin, veçse në raste kur dokush e përdoron për përshkrim ose në mënyrë simbolike, që të spjegohet ndonji situatë jetsore, siç ishte kjo e rastit.

Në Ulqin, në kohnat e kaluara ashtë folë*: “Ulqinakët, tri herë në vit luajnë menç: në kohë të livadheve, në kohë të gjuetisë së turtullit dhe në kohë të mbledhjes së ullishtës”*. Pra, në Ulqin qysh nga mesi i gushtit e deri gati në fund të shtatorit, ushejzë e gaxharra kanë qenë fjalë ma të ndigjume në qytetin tonë. Me fillimin e gushtit ulqinakët bajshin përgatitjen, përmirsimin ose ngritjen e ushejzës, për gjahun e turtullit.

Ushejza, gaxharrani

Pra, me fillimin e gushtit ulqinakët ndërmerrshin përgatitjet për përmirsimin e ushejzave, sepse ma së largti, me datën 28 gusht, ushejza duhet të jetë e ngritun dhe gati për gjueti.

Për ngritjen e ushejzës zakonisht janë marrë degët i ndonji drunit që dominonte dhe ishte ma naltësi ma të madhe në krahasim me pyllin për rreth, për shkak të naltësisë së veçantë ose nga pozite e tij në ndonji kodrinë që e bante të dallumun nga drunjt e pyllit për rreth.

Kjo ishte e nevojshme sepse gjahu në turtuj bahej në mëngjez, mu "në t' zbardhun të dritës". Ushejza e vendosun mirë dhe e dallume qartë, me gaxharrat e saja të thata, të plarueme me diellin e mëngjezit, asht ofertë e pashmangëshme për turtullin shtegtar, të cilin e ka lagë vesa e mëngjezit dhe shpreson pushimin, për terjen e krahëve të randë e të lagun nga vesa që ja ngadalson fare fluturimin.

Karpshkurta, turtulli

Turtulli ashtë shpend i familjes së pëllumbave dhe mu në gusht ban migrimin shtegtar dhe kalonte në numër të madh nëpër viset tona. Gjahtarët e vjetër thojnë se kurë në mëngjez ndigjohet zani i **karpshkurtës** dhe fryn erë Murra nga veriu atherë gjahu në turtull vjen me vrull, sepse karpshkurta ashtë shpendi që i paraprin migrimit të turtullit. Turtulli ashtë shpendë fluturus i mirë i pastërt dhe shumë i shijshëm. Nanat tona janë mjeshtre pa konkurencë për përgatitjen e gjellëve nga gjahu e sidomos turtullit, që nga natyra ashtë i majmë dhe gatuhet si specialitet tradicional **me oriz** ose **me petë**, që ulqinakëve i shkon lang nga goja kur përmendet gjahu në kohnat e kaluara.

Edhe sot në kohë të migrimit shifet ndonji turtull, por gjahtarve të vërtet as nuk i shkrepet ma pushka, se e dijnë që devastimi botnor i natyrës ka marrë përmasa tronditëse dhe se vrasje e turtullit nuk sjellë ma krenari e shkathtësi si dikur, por vetëm trishtim dhe nostalgji për kohë të kaluara.

Si shumë ulqinakë edhe babai im ka qenë shumë i pasionuar me gjuetinë e turtullit. Kur para disa vjetëve shkuam bashkë për gjah në *Shpatull*, vrejta se babai nuk e ngriti pushkën për *me gjujtë turtullin* që i kaloi "në botë të pushkës". "*Pse s'e vrave turtullin*?" - ju drejtova çuditshëm. "*Janë rrallu shumë, m' vjen gjyna me i vra ma. Ball e ka pasë, se edhe kta kajnë shpirt*!" - foli babai dhe e vuni çiften në krah.

Babai tashma 83-vjeçar e ka pasionu gjahun ma se 65 vjet dhe në fjalën e tij ndjeva tronditje për gjahun dhe natyrën që për xhdo ditë po e devaston "njeriu modern".

Ficka, qelengra, pupci, gugashi

Përpos turtullit, në ushejzë *kanë kapë*, pra *janë gjue* edhe shpendë tjerë sikur: **ficka**, me ngjyra karakteristike të verdha, e cila ashtë ma e vogël se turtulli; **qelengra**, me ngjyra si të sokolit, por me pika të bardha, gjithashtu ma e vogël se turtulli; **pupci**, me ngjyra si bari i thatë, por shumë i bukur dhe karakteristik për pupla të vendosuna mu në maje të kokës të cilat i ngrit kurë fluturon, por fare i vogël dhe shpesh herë gjahtari ka vra nji ose dy pupca, veç për hijeshimin e gjahut në vistër. Në ushejzë *ka kapë* edhe **gugashi**, shpend gjithashtu i familjes së pëllumbave që ashtë shumë ma i madh se turtulli dhe fluturues shumë i mirë, por gjahu në gugasha ka fillua menjiherë mbasi përfundonte gjahu në ushejzë dhe zakonisht asht gjue *n' fluturim*.

Shkurta gjuhej me fner, ferrë dhe karrubë

Shkurta gjithashtu ashtë shpendë i majmë dhe shumë i shijshëm, por ashtë fluturus i dobët, shumë ma i vogël se turtulli, dhe nuk asht gjuajtë në ushejzë, mbasi ashtë shpend fushe, me ngjyra si bari i thatë, kështu që fare kamuflohet dhe ambijentohet në natyrë dhe ashtë shumë vështirë të gjuhet pa **zagar shpendësh** të cilët me nuhatje e gjejnë dhe e trazojnë, duke i dhanë gjahtarit mundësinë e gjahut. Në kohë të kaluara shkurta ka pasë në përmasa shumë të mëdha. Për këtë shkak shkurta ashtë gjue edhe **me ferrë,** por edhe ashtë xanë e gjallë natën *me fner* dhe *karrubë*. Mbasi që shkurta, nga natyra dhe instikti i beson shumë mimikrisë, me të cilën veti pothuajse mbetet e pa dalluashme në ambijentin natyror, gjahtari mundet të afritet në nji metër prej qëndrimit të saj në fushë. Gjahtari, sympreftë, me ferrë në dorë, ka mujtë me korrë sukses në gjah, ose natën, duke e vështru me fner, ja ka qitë **karrubën** përmbi dhe e ka xanë të gjallë, dhe shpeshherë ashtu gjallë shkurtat janë shitë në tregun e Ulqinit.

Në pyll xhdo ushejzë isht ditë se e kuja isht

S'ka qenë fare e randësishme se i kuji ka qenë pylli. Ushejza ashtë ngritë, ashtë mirëmbajtë dhe ashtë shitë dhe ble, si e drejtë e gjahut në te. Në qoftë se trungu i drunit të naltë ka qenë në pronë private, pronari ka

pasë të drejtë me e ngritë për ushejzë, për nevojë të vetë ose atë të drejtë ka mujtë me ja falë, ose me ja shitë ndonji gjahtari, për gjithmonë, ose për nji kohë të caktume, sipas marrveshtjes. Zakonisht, ushejza ashtë ngritë në disa trungje të lartë të lisave, verrave, plepave, por edhe ullinjve, të cilët nga pozita kanë qenë dominus në krahasim me ambientin.

Sot lagja e *Gjeranave* ashtë pjesë përbase e qytetit, por dikur ka qenë nji ndër zonat e para për gjueti, e sidomos për turtullin.

Gjahtarët e vjetër ende sot e kujtojnë ushejzën e ***Cafit Riza Resylit***. Gaxharranjtë e kësaj ushejze kanë qenë të vendosun në disa lisa të naltë në pozitë shumë të mirë, që rezultonte me gjah, pothuajse fantastik. Në këtë ushejzë, në mëngjez ashtë qitë prej 80 deri në 100 fishekë e gjatë ditës ka qitë "tak – tuk", deri në muzg.

Në gusht, kur janë përmirsu dhe ngritë gaxharratë e damtumun gjatë vitit, dita e fillimit të punës për ngritjen e kësaj ushejze pothuajse ka qenë ditë feste për gjuetarët e fatumun e sidomos për *të zotin e ushejzës*. Ashtë gatu sarajli dhe pjekë mish në hell, sepse për xhdo vjet familjes, por edhe miqve, i ka sjell gjah të sigurt dhe begatinë e tryezës. Gaditja e ushejzës nuk ka qënë punë e lehtë. Ashtë nevojit që gaxharratë të vendosen në degët sa ma të larta të trungjeve, që të dallohen qartë nga turtulli dhe në afërsi të ushejzës të vendoset strehimi i gjahtarit i kamufluem me degë drurit në ngjyrë me ambijentin që gjahtarët e quajnë **kaçorre.**

Kaçorrja

Kaçorrja zakonisht ashtë vendosë në tokë dhe "në botë të pushkës", drejt gaxharrave të ushejzës, por në qoftë se lisat ose plepat kanë qenë shumë të naltë, kaçorja atëher ashtë vendosë në trungun e ndonji druni afër dhe gjahtari në te ka hypë me shkalla të improvizuara dhe po ashtu të kamufluara, sepse xhdo gabim të pakamufluar turtulli ka mujtë me e vrejtë me instiktin e vetë dhe ashtë "*turit*" dhe "*nuk ka kapë në gaxharra*".

Fjala kaçorre, rrjedh nga fjala latino-italiane "*kaçatore*", që don të thotë *gjahtar*, kurse në Ulqin ka kuptimin e *strehimit të gjahtarit* për gjahun në ushejzë të cilin spjegim ma ka vërtetu edhe prof. dr. ***Ruzhdi Ushaku***, shkencëtar dhe ekspert për etimologjinë e fjalës.

Për gaxharra janë përdorur degë të thata të drunjve, të përgatitun posaçërisht dhe të vendosur si gishtat e hapun të dorës, në degët ma të nalta të trungut. Për ngritjen e ushejzave ka qenë i dallumun *b*, me mjeshtri dhe guxim për ngritje në degët ma të nalta, por njikohësisht ka qenë edhe gjahtar shumë i pasionumun.

Shkujka – Amer Duli

Në gjahun e turtullit gjithashtu rrol të randsishëm ka pasë edhe **shkujka.** Shkujka zakonisht nuk ka qenë gjahtar, por ka qenë i domosdoshëm për informim në lidhje me gjuetinë dhe vijimin e gjahut. Pra, shkujka ka qenë person i cili gjahtarëve i jepte informatat e sakta për gjueti. Kështu, deri sa gahtartë pijshin kafen e mëngjezit në kafehanen e qytetit dhe pritshin agimin, shkujka bante vëzhgimin a do të ketë gjah për atë ditë. Zakonisht këtë informat e ka vërtetu duke shkuar, pa pushkë, deri ke *Lisat e Haxhibetve*, në Gjerana. Turtulli në mëngjez i ka krahët e randuame me vesën e mëngjesit dhe shumë vështirë trazohet dhe nuk fluturon, deri me rrezen e parë të diellit që cila e ngroh dhe e lehtëson nga vesa e lagët që ja ngadalson fluturimin. Duke e ditë këtë veti, shkujka ka shku deri nën Lisat e Haxhibetve, në Gjerana, të cilët kanë qenë përmbi njizet metra të naltë, dhe aty ndizte shkrepcen. Kjo trazonte turtujt që qëndrojshin në lisa dhe ai vinte me informata në kafene duke i than gjahtarve: "*Set prifni synin mirë! Lisat janë plot e përplot me turtuj*. *Qillofshi*!"

Shkujka e fundit në gjahun e turtujve ka qenë ***Amer Duli***. Gjahtarët e vjetër për te kanë thanë se ashtë *sympreft* dhe *zamirë*.

Gjahtarët kanë qenë edhe "vesveseli". Për shembull: ka pasë gjahtarë që nuk ashtë nisë për gjah në qoftë se në mëngjes antari i familjes nuk e ka përcjellë me fjalën: *qillofsh*. Kjo ka mujtë me ndodhë shumë rrallë, sepse nanat e tona nuk kanë vazhdu gjumin e mëngjezit pa i thanë burrit ose djalit: "*Qillofsh e kurrë pushka mos të shkrepti*!" Gjithashtu, gjahut (shpendit) nuk ashtë guxu t'i hapen krahët. Gjyshja ime shpesh ma tërhiqte vrejtjen kur unë si fëmi lujshe dhe i hapshe krahët e turtullit. "*Mas ja hap krahtë se i shkrep djalit pushka*!", më qortonte gjyshja, me plot seriozitet.

Gozhda e pushkës

Gjahtari dhe pushka kanë pasë respektë të posaçëm. Në shtëpi ashti ditë ku ashtë e vendosun gozhda e pushkës dhe në te përpos pushkës nuk ashtë guxua të varet asnji send tjetër. Përpos gjahtarit ose burrave të familjes, pushkën nuk ka guxu me e prekë askush. Pra, pushkën kurrë s'e kanë prekë gratë e kurrsesi fëmijtë. Në qoftë se ndonji fëmi ka kërku që të prekë pushkën, ashtë qortu dhe tërhjekë vrejtja me fjalë: "*Mos e bërkit, t' pastë nana, se pushkën e mbushin shejtanat*!" Dhe fëmiut i

ashtë dhanë ndonji lodër, por kurrë pushka, pa marrë parasysh vajtimin dhe insistimin fëminor. Për ndonji gjahtar, që nuk ka pasë sukses në ditën e gjahut, kanë mujtë me u ndigju komente nga gjahtarët: "*Da t' ja kenë varë gruja benebrekt n' gozhdë t' pushkës*" ose "*nuk i paska thanë kush qillofsh*". Por, mbi të gjitha, gjoja kurrë ska qenë burim jetsorë. Gjahtartë kurrë nuk kanë pytë: "*sa turtuj ke vra*?", por "*sa herë ke qitë*", sepse qefi nuk ashtë matë me turtuj të vramë, por me qitjen në gjah. Gjahtarët e vjetër shpeshherë ia kanë tërhjekë vërejtjen të rive: "*Në gjah nuk delet për mish, por për qef*". Pa marrë parasysh që në ditët e gjuetisë tryeza ishte e begatshme, për gjueti dhe pushkë ashtë thanë: "*Sa ka grykën ka nefakën*". Mbasi që kryhej gjahu, shkujkës ashtë dhanë nji pjesë e gjahut, me dëshirën e gjahtarve, sepse simbas zakoneve të vjetra, sepse *shkujka gjithashtu merrë pjesë në gjah, pa marrë parasysh se nuk ka pasë pushkë*.

Rregullat e vendosuna me Kanu

Gjahu ka pasë rregullat e veta të vendosuna me Kanu, që në Ulqin edhe sot e kësaj dite zbatohen në mnyrë të përpiktë. Kështu, në *Kanunin e Lekë Dugagjinit* i përmbledhur nga ***atë Shtjefën Gjeçovi***, në kapitullin *Gjoja*, në nenin 401 ashtë parapa: "*Me dalë 50 vetë me guejtë e me kenë gjymsa me armë e gjymsa tjetër pa armë, paraz marrin pjesen e gjojës, për arsye se me nji qellim dualen në mal. Të pa-armatosurit u apin ndihmë t' armatosurve, ku me brimë ku me rojë e ku me rrethim të vendit*". Gjithashtu dhe neni 419 i të njajtit kapitull parashef: "*Po dole me gjuetë, dhe t'u shoqnu ndokush me pushkë a edhe pa pushkë, në vrafsh gja, do t'i apish pjesë*". Gjithashtu ndarja e gjahut kurrë nuk asht peshu në kandar. Kjo gjithashtu ashtë e rregullueme me Kanu. Në nenin 416 të kapitullit *Gjoja* ashtë parapa: "*S'ashtë me Kanu me e peshu mishtë e gjasë... por qitet në short si t'i biej kuej*". Rregullat e gjahut janë të shumta dhe unë nuk do t'i trajtoj, sepse të gjitha janë të lexueshme në Kanunin e Lekë Dugagjinit nga atë Shtjefën Gjeçovit, i cili ka randësi jo vetëm në aspektin juridik, por ashtë dëshmi e civilizimit dhe lashtësisë të shqiptarve që sot ashtë faktë i pa mohushëm dhe që meriton trajtim të posaçëm shkencor.

Ushejzat ma të njoftuna

Përpos ushejzës së lartpërmendur, në za kanë qenë edhe ushejza e Brashnjës, të cilën e kanë përba tri ushejza, prej të cilave dy kanë qenë të

vendosun në lisa e njena në ullinj. Njena prej këtyne ushejzave ka qenë dominuse dhe e kanë quajtë "***Brashnjanja***", simbas familjes ***Brashnja*** që ashtë marrë me gjueti. Gjithashtu, në Gjerana kanë qenë të njoftuna edhe ushejza e ***Likës***, ***Zatit, Sulës, Can Mikuliqit, Hadxhi Brashnjës***, në të cilën ka gju ***Cafo Begu - Alibegu***,ushejza në Shkallë të Pinjeshit dhe ushejza në pronë të ***Gjuro Filipit***, në të cilën ka gju babai im dhe ***Dushan Hajdukoviqit*** në të cilën kanë gju familja ulqinake ***Hoxha***. Ushejza gjithashtu ka pasë edhe në Kodra, Kuçe dhe Shtoj, prej të cilave kanë qenë në za ushejza: e ***Shurrdhës e Prençit Monit, Sel Dylit, Misherit Kalavrezit, Qehajës*** dhe ***Plepat e Mark Prelës***, që ende sot gjinden ke Hoteli "Lido".

Gjahtarët e pasionuar në fillimin e shekullit 19 kanë qenë: ***Beqir Kalavrezi, Dyl Zyberi, Daut Mavriqi, Lito Begu-Resulbegu, Cafo Begu-Alibegu, Caf Fici, Cen Lamoja, Alush Lamoja Daut Lati, Mus Kahari, Halil Milla, Beqir Molobeqiri***, por edhe shumë të tjerë, jo ma pak në za se të përmendurit.

Tue numru ushejzat dhe emnat e gjahtarve pa dyshim kam ba lëshime dhe me siguri nuk i kamë numrua të gjitha ushejzat dhe kurrsesi gjahtarët, sepse shumë ulqinakë jenë marrë me gjueti, por pa t' keq, sepse kjo kujtesë për ushejzë dhe gjueti tradicinale tipike ulqinake ka për qellim kujtesën për mënyrën e gjuetisë, që me kalimin e kohës e rrezikon harresa e cila ashtë kundërshtarja ma e madhe e traditës dhe kulturës ulqinake.

Gjuetija në ato kohna ka qenë pasion i madh, sepse natyra ka qenë pothuajse e paprekun dhe mjetet e gjuetisë primitive.

Për gjah asht shkua me kalë dhe pushkët e gjahut kanë qenë zakonisht me nji grykë.

Kapsulaçja, çarku, kamza, dacet, pipi

Pushka ma e vjetër ka qenë **kapsulaçja.** Kjo pushkë ashtë mushë nga gryka, që zakonisht nuk ka qenë e rrumbullakët, por tetëkëndëshe dhe shumë ma e gjatë se grykët e pushkës që janë sot në përdorim. **Çarku** i pushkës ka qenë i vendosun në anë të djathtë të pushkës dhe ashtë **ngref** me dorë dhe qitja ashtë kry me tërhjekjen e **kamzës**. Kapsulaçja nuk ka pasë fishek, si pushkët që sot janë në përdorim, por ashtë mbushë nga gryka, në mynyrë të veçantë. Pra, gjahtari përpara se të niset në gjah ashtë dashtë së pari me mbushë **dacet,** me barot dhe saçma. Dacja ka qenë prej pjesës së **kallamit**, ku natyrisht ashtë e ndamun, dhe në nji pjesë se boshllëkut të kallamit asht vendosë masa e saktë e **barotit të zi**

dhe ashtë **blloku** me **fije linit** dhe në pjesen tjetër, po të njajtit kallam, janë vendosë masa e saktë e saçmave, gjithashtu e bllokume me fije linit. Pra, për çdo qitje asht dashtë me përdoru nji dace. Për mbushjen e kësaj pushke, së pari janë hekë fijet e linit nga dacja dhe baroti i zi ashtë qitë në grykë të pushkës, duke i ra me dorë dhe kujdes që baroti të shkojë deri në fund të grykës dhe të depërtojë deri në **pip** i cili ka qenë me nji grykë të hollë i lidhun me grykën e pushkës. Pipi ka qenë i vendosun në anën e djathtë të pushkës, mu në pozitën ku **rref çarku**. Mbasi që ashtë vendosë baroti në grykë, ashtë futë dhe janë shty me **shkop të pushkës** fijet e linit dhe mandej janë qitë **saçmat** dhe përsëri janë vendosë fijet e linit, që gjithashtu janë shty me shkopin e pushkës, deri në fund të grykës.

Mbasi ashtë kry proçesi i mbushjes së pushkës, në pip ashtë vendosë kapsuli dhe pushkës tash ashtë dashtë me dorë t'i ngrifet çarku dhe me tërhjekjen e kamzës pushka ka marrë zjarr, drejtë gjahut të shenjumun nga gjahtari.

Filinda (filinta), çiftja, pushka me gur

Kështu ka funkcionu kapsulaçja, por me kalimin e kohës janë përdru pushkë me nji grykë **filindë**, ose me dy grukë **çifte**, me fishk nga letra dhe çarkë që i ka ra gjylpanës së pushkës në fishekun e vendosun në grykë të pushkës. Për shkak të procesit shumë të ngadalshëm të mbushjes së kapsulaçes, edhe sot ulqinakët, për ndonji veprim të ngadalshëm, përdorojnë shprehjen "**prit ta mush",** shpeshherë të pavetëdijshëm se kjo rrjedhë nga qitja me kapsulaçe, ku procesi i qitjes ashtë shumë i ngadalshëm.

Kur ashtë fjala ke pushka e gjuetisë vlen të ceket se në kohët e mapërparshme ashtë përdorë **pushka me gur.** Pushka me gur pothuajse ka qenë e ngjajshme me kapsulaçen. Ka qenë me nji grykë të gjatë dhe me dallim nga kapsulaçja në vendë ti pipit ka pas nji brimë në të cilën ka qenë i vendosun **guri i pushkës.**

Guri i pushkës ka qenë gur i veçantë, normalisht i marrun në natyrë, që ka qenë me veti xixa-prodhues në rast të **rrafjes** me metal. Pra guri i pushkës asht vendosë në pjesën e fundit të grykës së pushkës mu në vendin ku e ka rrafë çarku i pushkës. Me **ngrefjen** e çarkut dhe tërhjeqjen e kamzës çarku i ka ra gurit të pushkës duke prodhu shkëndinë -xixën që ndez barotin në grykë të pushkës. Për shkak se guri dhe baroti kanë qenë të dukshëm, kjo pushkë pothuajse fare s'ka funkcionu për mot të lig e kursesi me shi. Pushka me gur ashtë identike me pushkën e vjetër të

tipit **mushket,** e cila asht përdorë në betejat gjatë shekullit 18 dhe mapërpara prej kohës kur filloj përdorimi i barotit.

Guri i pushkës - gur unuri, kafi

Pushkët e gjahut, por edhe ato të brezit në ato kahna prodhoheshin kryesisht nga mjeshtrat e farkimit dhe përpunimit të metalit. Posaçërisht të njoftun kanë qenë mjeshtrat e Shkodrës, Prizrenit dhe Gjakovës, ku përpos prodhimit të armëve janë prodhu dhe stoli nga argjendi dhe ari, mjete pune dhe sende të nevojshme për jetën e përditshme, deri me zhvillimin industrial.

Guri i pushkës gjithashtu ashtë përdor edhe për ndezjen e duhanit, si *shkrepcë primitive* dhe asht quajt **unur** ose **gur e unur**. Si edhe ke pushka me gur, për ndezje asht dashtë që me unur i cili ka qenë i përbrë nga metali, **të rrifet guri i pushkës** i cili asht vendosë përmbi **kaf** dhe mbas disa rrafjesh kafi, nga xixa-shkëndija, ka marr zjarr. Kafi ashtë marrë nga trungu i lisit, asht zi në ujë të vlum dhe pastaj ashtë tha në diell. Kafi kështu i përgaditun ashtë ndezë lehtë edhe nga shkëndija ma e vogël e unurit.

Tregimi për Dyl Zaberin

Dihet se për gjahtarë dhe gjah ka tregime të shumtë shpeshherë edhe të zbukuruam dhe të shtuem, por nji tregim i cili flet për mjeshtrin dhe synin e mpreftë të gjahtarit, ende sot nuk ashtë harrua në Ulqin.

Ulqinakët e moshuar tregojnë se gjahtari Dyl Zyberi ka pasë sy sokoli dhe ka qenë mjeshtër pa konkurencë për gjah.

Dikur në Ulqin, në ditë të pazarit ashtë shitë gjahu, sidomos turtulli dhe shkurtat e cila migron menjiherë mbas migrimit të turtullit, prej fundit të gushtit e deri me mbarimin e shtatorit.

Tregimi që vijon ka të bajë me rastin kur nji grua kishte dalë në pazar me shitë shkurtat gjallë, të xana me karrubë.

Dyl Zyberi, që atë ditë kishte dalë në treg për me ba pazarin, kur i pa shkurtat në kafaz, iu drejtu shitses: "*Vallahi, moj fisnike, me mi lëshu këta shkurta, nji ka nji, t'i vras e t'la pa ta, e në qoftë se e gaboj njenën, jam n' gjendje me të pagu dyfishin e çmimit*". "*Vallahi, zatni, unë po i lëshoj e ti n'mujç, vriti, e merri falas të gjitha ose m'paga dyfishin*!" - foli shitsja e shkurtave. Dylit i meti fjala n'gojë, e shokët e tij që ishin prezent filuan ta ngacmojnë tue i thanë: "*S'ke çajre, Dylo, pa i gjujtë, se burrat nuk banë me folë kat*!".

"*Del në Fushë të Merasë, se ja mrrita*!" - foli Dyli dhe shkoj me marrë pushkën me 50 dace, aq sa kishte shkurta në kafaz. Kështu edhe ndodhi. Shitsja filloj të lëshoj shkurtat Dylit, nji nga nji, e Dyli, mush e shpraz pushkën, për xhdonjenën shkurtë, 50 herë qëlloj dhe asnji nuk e qiti bash. Shitsja mbeti e trullume dhe pa dashje i pshtuan fjalët: "*Si s'ta thau zoti dorën mi qitë bash veç nji, mare bir i robit*!" Dyli ka qenë gjahtar shumë i pasionuar dhe mjeshtër i vrtetë i gjuetisë dhe mbasi që vendosi pushkën në krahë foli: „*Urdhno, fisnike paret, aq sa bajnë shkurtat n' pazar dhe merri edhe po aq pare, për qefin qi kam ba*!" - dhe i pagoi shitses dyfishin e çmimit të 50 shkurtave. Shitsja përsëri mbeti e çuditun dhe kur e kuptoj se shkurtat i shiti bukur mirë, foli me gëzim e me bejte: "*Paske pasë sy sokoli, paske qenë sokol me fletë, paske qenë edhe zatni, kurrë pushka mas të shkreptë*!"

Zagari i gjuetisë nuk quhet qen

Tregimet për gjahtarë janë të shumtë e sidomos ata që bajnë fjalë për mënyrën dhe sasinë e gjahut. Në kohna të kaluara nuk ka qenë e çuditshme që në ditë të veçantë gjahu, gjahtari të vrasë përmbi 50 turtuj ose shkurta të cilat kryesisht janë gjue me **zagar shpendësh**. Gjahtarët e pasionuar nuk kanë shku në gjah pa zagar, përveç në ushejzë ku zagari nuk ka pasë asnji detyrë.

Për këtë arsy në Ulqin për gjahtarin pa zagar ashtë thanë se ashtë **gjysë gjahtari**.

Zagarit ashtë kushtu trajtim i posaçëm, si në mirmbajtje, por edhe trajtimin e tij si pjesë shoqnuse e gjahtarit. Dikush ka mujtë me gabu deri në ofendim në qoftë se zagarin e gjahtarit e ka thirr **qen**. Në kohë të ushejzave gjahtarët e kishin zakon që para agimit të tubohen në dy kafene të qytetit të cilat enkas punojshin para agimit, në stinën e gjuetisë së turtullit. Gjahtarët vendosnin pushkët dhe **rrypat e fishekëve** pranë tryezës së kafenesë dhe zagarët, në shumicën e rasteve, kanë qëndru pranë gjahtarve pa e prish fare rendin dhe qetësinë, që mua deri sot më ka lanë përshtypje të veçantë. Kujtoj rastin kur babai, mbasi e luta me kambëngulje, sepse isha fëmi dhetvjeçar, më morri së pari herë për gjah.

Edhe sat qartë e kujtoj atë pamje në kafehane, ku ishin ulë nji grup gjahtarësh që bisedojshin me za dhe temperament, karakteristik për ulqinakë, dhe njeni prej gjahtarëve, i cili ishte ma i moshuari, tregonte se kishte pasë shumë sukses në gjah me dy zagarët që po i rrijshin pranë tij,

fare të qetë, që mua më la përshtypje të veçantë e sidomos ngjarja që ndodhi.

Nji gjahtar djalosh i gjatë dhe i hijshëm, hyni në kafene, porositi kafen dhe mbas pak iu drejtu nji gjahtari të moshuar: "*Për njat punë edhe sot paske marrë **qenjt** me vedi*!" - foli djaloshi dhe në moment ra nji heshtje. "*Unë, mare djalë, nuk kam majtë e as nuk kam shku kurrë n' gjonjë me **qenj**, por vetëm me **zagarë,** si këta qi i kam përanë. Edhe ty, si gjahtarit të ri, të këshilloj kështu, se përndryshe si me kend t'rrijsh ashtu edhe bahesh*!". Djaloshi, fjalët e gjahtarit të vjetër i morri me humor, që u përkrah edhe nga gjahtarët tjerë, por fare qartë u kuptu se **zagarët e gjahut nuk quhen qen**.

Në bisedat e gjahtarëve të vjetër shpesh herë ashtë bisedu se gahtari ma parë ka shitë pushkën sesa zagarin e mirë të cilin e ka pasë për qefë. Në Ulqin ende kujtohet rasti kur zagari i nji gjahtarit, me rastin e vdekës se tij, muj me radhë ka **luru (vajtu)** mbi varrin e gjahtarit.

Për gjah dhe gjahtarë ashtë ma se e sigurt se ka shumë tregime që edhe sot bisedohen sidomos nga gjahtarët e vjetër, por unë duke shkru për ushejzën, kam parimisht për qëllim që me mbrojtë nga harresa traditën e lashtë shekullore, që doemos ashtë dhe duhet të mbesë pjesë e kulturës sonë, që në të ardhmen të rezultojë me mbrojtjen e ambijentit, natyrës se bukur që nuk guxojmë ta devastojmë, por përkundrazi ta ruajmë si thesarin ma të çmushëm dhe në të ardhmen ta revalorizojmë në xhvillimin e turizmit dhe qytetit tonë si perlë e detit e plaruame me rrezet e dillit mezdhetar.

Ulqin, 18.06.2007

SHËNIM

***Sami Misherri**, (Tivar, 1955) me profesion është avokat në Ulqin.*

Në revistën "Kronika" të Ulqinit ka botuar më shumë punime të këtij karakteri etnografik. I ka sistemuar në një përmbledhje që e ka të gatshme për botim.

Kallëzimi i autorit, në të folmen lokale (të Ulqinit) na duket me interes gjuhësor, andaj po e botojmë si të tillë.

ARKITEKTURË

Ing. dipl. Mentor LLUNJI

ARKITEKTURA SIZMIKE

Hyrje

Zonat-regjionet me aktivitet të theksuar sizmik çdoherë kanë paraqitur kokëçarje për ndërtuesit. Tërmeti ka ndikuar me shekuj në kufizimin e shprehjes arkitekturale. Kjo ndodh pasi vetëm format e rregullta dhe simetrike kanë siguruar reagim të rregullt dhe simetrik te objekteve në rast te goditjes së tërmeteve.

Punimi merret kryesisht me mundësitë e përdorimit të çështjeve - njohurive sizmike si inspirim apo ide arkitekturale. Ky koncept quhet *arkitektura sizmike***,** e formuluar së pari nga arkitekti *Christopher Arnold* dhe e popullarizuar nga inxhinierët zelandas *Andrew Charleson* dhe *Bob Reitherman*. Një ide e tillë ka dalë si reagim ndaj kufizimeve arkitekturale në zona me sizmicitet të lartë.

Ideja mbi një arkitekturë sizmike është vetëm një dëshirë e shprehjes së projektimit asizmik në formë arkitekturale dhe është prodhim i kolaborimit të ngushtë të arkitekteve dhe konstruktorëve në zona sizmike.

Origjina e idesë mbi arkitekturën sizmike

Përforcimi i objekteve ekzistuese, si masë asizmike, ka për qëllim parësor modifikimin apo përmirësimin e reagimit sizmik të një strukture.

Kryesisht cak i intervenimit për përforcim janë objektet me vlerë historike, mirëpo shpesh përforcohen edhe objektet e kohës. Mendimi ndërkombëtarisht i pranuar sa i përket përforcimit të objekteve të vjetra, historike është se nuk guxon të preket në vlerat historike të objektit, e sidomos jo në pamjen e jashtme.

Përforcimet zakonisht bëhen brenda me mjete dhe mënyra të ndryshme. Masat bashkëkohore përfshijnë përdorimin e damperëve, izolimit sizmik, shiritave të karbonit etj..

Situata tek objektet e reja është pak më ndryshe. Nga fakti që nuk e kanë faktorin e vjetërsisë, shkohet kah ajo që rehabilitimi i tyre të bëhet me mjete modeste financiare. Kjo nënkupton që struktura e re e përforcuar është pothuaj pastër një intervenim inxhinierik. Me impenjime shumë të vogla ai intervenim mund të inkorporohet mirë në arkitekturën ekzistuese.

Po të hedhim një vështrim mbi natyrën e objekteve bashkëkohore shohim se materialet moderne, stilet arkitekturale të cilat janë shumë adaptive dhe nuk i nënshtrohen ligjeve strikte, lejojnë intervenime më të 'lira' në fasadë.



Fig 1. *Një shembull i përforcimit asizmik*

Nevojitet, pra, krahas një qasjeje inxhinierike edhe një ndihmesë jo e madhe nga ana arkitekturale. Kolaborimi i ngushtë i arkitektëve dhe konstruktorëve në këto impenjime do të rezultojë me përforcime të cilat njëkohësisht kanë kryer punën e sigurimit të objektit nga goditjet e mundshme sizmike dhe, po ashtu, janë përshtatur 'situatës' ekzistuese në fasadë, duke i dhënë asaj një shprehje të re. Rezultat i këtyre kolaborimeve, përveç një kontributi pozitiv arkitektural, besohet të jetë edhe ideja e për një arkitekturë sizmike. Ka edhe një mendim tjetër se, ideja për një të ashtuquajtur arkitekturë sizmike, mund të jetë paraqitur edhe si revoltë ndaj kufizimeve të shumta arkitekturale në zonat me

sizmicitet të theksuar, ku ndodh që zgjidhjet arkitekturale t'i përshtaten zgjidhjes se konstruksionit e jo edhe anasjelltas.

Ideja e një arkitekturë sizmike nuk është e re. Dihet rasti i arkitektit *David Farquhason* i cili duke prezantuar masat e reja asizmike (të vitit 1873) në *Universitetin e Berkeley*-it propozoi që, pikërisht këto masa t'i prezantojë në formë të arti. Pra, përforcimet e parapara nga çeliku të përpunohen dhe të shfrytëzohen njëkohësisht si dekorime arkitekturale. Sidoqoftë, përdorimi i parë i elementeve për shtangim (kundër erës dhe forcave sizmike) si elemente arkitektonike konsiderohet të jetë bërë në shumëkatshen *John Hanckok Center – Chicago,* në vitin 1969 dhe, pothuaj se nga ai moment, është bërë një qasje normale në detajizimin arkitektural të shumëkatsheve në SHBA.

Fig 2. John Hanckok Center në Chicago (Fazlur Kahn)

Nuk janë vetëm shtangimet ato të cilat tashmë ka kohë (në vitet 70-80-ta) që përdoren edhe si masë mbrojtëse sizmike edhe si detaje arkitekturale. Konceptet e rezistencës, shtangësisë, brishtësisë mund të imponojnë zgjidhjet e ndryshme dhe të pasura arkitekturale. Përdorimin e një simbolike sizmike e shpjegon më së miri *Ch. Arnold,* duke marr për shembull *Nunotani Headquarters Building* në Tokyo (*Peter*

Eiseman), fasada e të cilit ka qenë e inspiruar me shpërndarjen e valëve sizmike. Dhe jo vetëm fasada, por edhe shumë pjesë tjera të objektit përkujtojnë në aktivitete të ndryshme sizmike. Një vështrues i thjeshtë mund të mendojë se bëhet fjalë për një arkitekt jokompetent. Rast ndoshta edhe më drastik është projekti tjetër (fig. 3) i *Peter Eiseman*-it (i cili bënë pjesë në drejtimin e dekonstruktivistëve) në *New York*.

Fig 3. *Piter Eisemann, New York*

Formësimi arkitektural si përgjigje e mundësive inxhinierike mund të shihet në shumë lloje të strukturave, duke filluar nga urat e deri hallat e mëdha kulturore, sportive, hangarët etj..

Megjithatë, ende vetëm sporadikisht mund të gjenden shembuj të arkitekturës sizmike në Zelandë të Re, Japoni dhe SHBA, dhe të paktë janë ato objekte që me arkitekturën e tyre shprehin ide të derivuara nga efektet dhe aktivitetet e tërmetit. Është e kuptueshme pasi që arkitektët zakonisht nuk kanë kurrfarë njohurish sa i përket projektimit asizmik, aq më pak edhe interes në këto çështje.

Më lartë u tha se interesi për kyçje të masave asizmike, si shprehje arkitekturale, erdhi vetëm si rrjedhojë e nevojave për përforcim të objekteve të goditura nga tërmetet. .Në anën tjetër përveç kësaj, një segment shumë me rendësi është ndjenja e sigurisë në objekt, e cila në literature quhet *siguri psikologjike* (këtë e dinë më së miri ato të cilët jetojnë në zona sizmike). Nëse elementet asizmike janë të dukshme dhe nëse banorët, blerësit potencialë informohen mbi efektin e tyre, ata do të jenë sigurisht më të qetë.

Faktor tjetër i cili duhet të analizohet është sigurisht aspekti ekonomik. Nëse ka nevojë për masa asizmike, pse ato të mos shfrytëzohen

si pjesë e fasadës. Me një fjalë, të kryejnë dy funksione, atë estetik dhe atë mbrojtës.

Edhe pse me potencial të madh arkitektura sizmike ende nuk mund të shpallet si një stil i ri në arkitekturë apo thjeshtë *frymëzim*. Aspektet e shumta të një fenomeni tejet interesant siç është tërmeti, japin mundësi për aplikime dhe ide të nduarnduarshme të cilat, po të shfrytëzohen, mund të kenë efekte pozitive arkitekturale.

Hapi i pare është që arkitekti strukturën ta shohë si një pjesë integrale të projektit, e jo si diçka të cilën konstruktori ia shton projektit arkitektural. Të realizohet kjo ka dy mënyra;të rritet informimi i arkitektëve mbi çështjet sizmike, apo të punohet në bashkëpunimin më të thellë të arkitektit me konstruktorin.

Nevoja për edukim më të mirë apo bashkëpunimin më të thellë, del thjesht si pasojë e faktit se masat asizmike shumë më tepër ndikojnë në zgjidhjet arkitekturale se sa, p.sh., çështjet apo masat për përcjelljen e forcave vertikale, apo edhe të erës.

Nuk ka nevojë të shtjellohet diçka për implikimet e masave sizmike në arkitekturë, ato janë tepër të qarta, ndikime të cilat përfshijnë formën, shtrirjen, pozicionimin e mureve, shtyllave, çka drejtpërdrejt ndikon në pamje dhe funksionalitet.

Arkitektura sizmike - mundësitë

Inspirimet për shprehjen arkitekturale të çështjeve sizmike mund të jenë metaforike apo simbolike lidhur me tërmetet (aktivitetet tektonike, valët sizmike, shtangësia, rezistenca etj.), apo edhe çka është më e shpeshtë, fokusimi në aspekte vizuale dhe fizike të përforcimeve asizmike.

Në fushaplikimin e arkitekturës sizmike duhet të dallohen dy momente. Implikimi i arkitekturës në përforcimin e objekteve, apo përshtatja dhe formësimi i masave asizmike situatës ekzistuese në objekt dhe përdorimi i problematikës sizmike si burim i ideve për zgjidhje të ndryshme arkitekturale. Problematika sizmike ka potencial të shfrytëzohet nga pikëpamjet e ndryshme, duke filluar me përdorimin e elementeve shtanguese, apo si burimi ideve mund të jenë edhe parimet, principet asizmike, apo edhe vet aktiviteti i tërmetit, çka varet sigurisht nga niveli i njohurive të kësaj problematike. Aktivitetet strukturale si forcat aksiale, momentet, forcat prerëse që janë pasojë e tërmetit mund të shfrytëzohen në detajizimine elementeve strukturore dhe zakonisht njëri prej

parametrave ka kapacitet të mjaftueshëm arkitektural. Hulumtimi mbi shfrytëzimin e principeve asizmike, përfshinë përdorimin e mundësive të panumërta që ofron projektimi sipas kapacitetve, kërkesë fundamentale e të cilit është që dëmet e mundshme sizmike të ndodhin në trarë, e jo në shtylla, kështu që koncepti i trarëve të dobëta dhe shtyllave të forta, mund të prezantohet shumë lehtë. Fokusimi mund të bëhet në zonat e nyjave të mundshme plastike, që duhet të jenë zakonisht në fund të trarëve, dizajnimit të të cilave duhet të jepet shumë kujdes. Ka shembuj të panumërt të intervenimit në zona të nyjave plastike, çka edhe varet nga njohurit e strukturistit dhe imagjinata e arkitektit.

Projektimi sipas kapaciteteve mund të japë mundësi të shumta për detajizime arkitekturale.

Një qasje e sigurt dhe ekonomike, sidomos për pjesët që punojnë shtypje apo tërheqje, të cilat priten të deformohen dhe të cilat me deformimin e tyre do të shkarkojnë elementet strukturore nga ky obligim, jep mundësi që këto elemente të shprehen në mënyrë arkitekturale, posaçërisht nëse detajizohen si duhet dhe nëse pozicionohen në vende adekuate.

Te objektet nga druri (i lameluar) vendet e disipimit të energjisë janë nyjat e lidhjes (me elemente çeliku) detajizimi i të cilave jep mundësi të panumërta.

Forma e objektit – inspirimi i mundshëm.

Format masive - Qoftë ato piramidale apo thjeshtë kubike, mund të jenë si aludim mbi stabilitetin sizmik të objektit. Aq më tepër se eliminohen mundësitë për katet "e buta" apo thyerjet e ndryshme të cilat do të ndihmojnë në *koncentrimin e rrezikshëm të sforcimeve në strukture*.

Fasada - Ofron mundësi të panumerta. Shprehja arkitekturale mund të shkojë nga prezantimi "subtil" i pjesëve të konstruksionit, deri te një shfaqje direkte e tyre. Edhe pse ka pasur një përdorim të tepruar të shtangimeve të çfarëdo llojit, gjithmonë ka vend për përpunimi kualitativ të varianteve të reja, sidomos tash kur objektet janë më tepër poroze se kurrë më parë dhe ku shihet një tendencë e zhveshjes suptile të strukturës nëpërmes sipërfaqeve të mëdha të xhamit gjysmë të tejdukshëm dhe *eksponimit të pjesërishëm të strukturës*.

Përdorimi i "*ramave rigjidë*" për përcjelljen e forcës sizmike, mundet po ashtu me efektivitet të eksploatohet në aspekt arkitektural (fig. 2. b).

Fig. 6 - *Disa shtangimet klasike asizmike si pjesë të fasadës*

Enterieri - Një pjesë e madhe e intervenimeve asizmike bëhet në brendi të objektit, me qëllim të ruajtjes së imazhit të vjetër të objektit, apo evitimit të implikimeve të panevojshme në arkitekturë. Shtangimet në konstruksion, e sidomos ato në formë të shufrave të çelikut, mund të jenë detaje interesante të cilat pasurojnë ambientet dhe hapësirat brendshme, (fig 8).

Pajisjet apo teknologjitë asizmike

Kohëve të fundit vërehet një përdorim i gjerë izolimit sizmik, përdorimit të amortizatorëve (*damperëve*) në objektet moderne. Deri tash

kryesisht nuk kanë qenë prezante për vështrim të lirë. Me një dizajnim të kujdesshëm mund të ekspozohen si brenda ashtu edhe jashtë objektit.

Fig. 7, a - *Shtangimet asizmike si element arkitektonik*

Rezyme

Punimi nuk e prezanton arkitekturën sizmike si një ‘shpresë’ në arkitekturë, por më tepër ka për qëllim të theksojë rëndësinë e bashkëpunimit më të thellë dhe të obligueshëm arkitekt – konstruktor, bashkëpunim nga i cili sigurisht fitojnë të dy palët. Arkitektët do ta kuptojnë më mire strukturën dhe mundësitë e shumta që ofron, ndërsa konstruktori, duke dëshiruar të plotësojë shprehjen arkitekturale të objekteve, do të futet në hulumtime që do të sjellin pasurimin profesional.

EARTHQUAKE ARCHITECTURE

Abstract

This paper gives an overview of possibilities for architectural expression of seismic principles -or possibilities for expressing seismic principles architecturally in the contest of common structural forms.

The notion - Earthquake Architecture is first labeld by Christopher Arnold but was widely known from the papers of Andrew Charleson and Bob Reitherman, therefore biggest part of concepts and materials presented in this paper are provided by their work.

This paper provides reader with basic ideas about the relation between seismic issues and architecture using them as interesting architectural expression.

For a similar discussion on earthquake architecture topic, the reader is referred to the literature.

LITERATURA

Ambrose J. and Vergun D., *Design for Earthquakes John Wiley&sons*, Inc New York 1999

Arnold Ch. and Reithman R., *Building configuration and seismic design John Wiley & Sons*, Inc 1982

Bungale S.T., *Steel, concrete and composite design of tall buildings McGraw-Hill Companies*, Inc 1998

Marco MEZZI Paolo VERDUCCI Jia Jun LIU**,** *Innovative Systems for a Sustainable Architecture and Engineering*

Charleson, A. W.**,** *Strengthening the link between earthquake engineering and architecture Paper No. 4, Proceedings of the conference of the NZ Society for Earthquake Engineering*, 19-21 March 2004, 8pp.

Lindebur R. and Baradar M., *Seismic design of building structures Proffessional publications Inc*, 8th edition 2001

Andrew W. CHarleson, Mark Taylor**,** *Towards an earthquake architecture*

Proceedings 12th World Conference on Earthquake Engineering January 2000, NZ National Society for Earthquake Engineering, Paper 0858,

Mezzi M, Parducci A, Verducci P., *Architectural and structural configuration of buildings with innovative aseismic systems World Conference on Earthquake Engineering* ,Vancuver, 2004

Naeim. F.**,** *The seismic design handbook Springer, second edition 2001*

Charleson, A., Taylor, M. and Preston, J.**,** Envisioning Earthquake Architecture in New Zealand-Proceedings of the Technical Conference of the New Zealand Society for Earthquake Engineering Annual Conference, Wairakei, March 2001, Paper 3.01.01, 7 pp.

Pauly T and Pristley M.J.N.**,** *Seismic design of RC and masonary buildings*

John Wiley & Sons, Inc 199212

Charleson, A., Preston, J and Taylor, M.**,** *Architectural Expression of Seismic Strengthening Earthquake Spectra*, Vol.17, No. 3, August 2001, pp. 417-426

Eurocode 8: prEN – 1998 - Draft January 2003

wwww.curee.org

ARTIKUJ

OPINION

Dr. Nail DRAGA

PABARAZIA GJUHËSORE E SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI

Pabarazia e vazhdueshme gjuhësore e shqiptarëve ne Mal të Zi, dëshmon në mënyrë transparente pabarazinë kombëtare ne ketë mjedis shumëgjuhësor qe është në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe standardët demokratike ndërkombëtare

Trajtimi i çështjeve nga fusha e barazisë gjuhësore në Mal të Zi si mjedis shumëkombësh dhe shumëgjuhësor nuk janë çështje e re dhe e panjohur. Ne sajë të strukturës së popullsisë e cila dëshmohet edhe nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2003, dëshmohet në mënyrë transparente se ky mjedis është specifik, jo vetëm për regjionin por edhe më gjerë, sepse asnjë popull nuk është shumicë dominuese numerike. Andaj duke marrë parasysh një konstatim të tillë përkatësia gjuhësore gjegjësisht barazia gjuhësore e popujve përkatës në Mal të Zi, paraqet çështje me interes të veçantë. Por, kur ceket një çështje e tillë nuk ka dilemë se vend të veçantë zë gjuha shqipe si e vetmja gjuhë me origjinë josllave, sikurse edhe shqiptarët si popull. Këtu kryesisht kemi të bëjmë me pjesëtarët e popullit shqiptarë të cilët si popullsi autoktone janë të pranishëm ne pesë komuna në kuadër të Malit të Zi.

1. Mungesë e vullnetit politik të pushtetit

Por, edhe pse Mali i Zi ka pasur mundësi reale si ne të kaluarën në monizëm por edhe tash në pluralizëm për të qenë shembull për të tjerët nuk ka dilemë se ka munguar vullneti politik i pushtetit për avancimin e barazisë së gjuhës shqipe e me atë edhe të shqiptarëve si pjesëtarë te mozaikut të përgjithshëm nacional në Mal të Zi. Madje edhe kur është marrë ndonjë nismë ne ketë drejtim nga viti 1968 e këndej çdo gjë ishte utilitare e asgjë më shumë në sajë te rrethanave shoqërore.

Por, me të drejtë është pritur që përvoja e trashëguar negative nga monizmi dhe tash në pluralizëm të fillojë te eliminohet pikërisht nga 21 maji 2006 prej kur Mali i Zi fitoi pavarësinë pas vitit 1918. Pasi shqiptarët pothuaj në mënyrë unanime kanë votuar për pavarësi, madje duhet thënë haptazi se vota e elektoratit shqiptarë kanë qenë vendimtare, me të drejtë kemi pritur fillim të ndryshimeve pozitive në avancimin e pozitës dhe të statusit të shqiptarëve në Mal të Zi.

Por, një ide e tillë ishte vetëm iluzion, sepse pushteti aktual, ne vend që të tregohej mirënjohës për kontributin e shqiptarëve, për demokratizimin e proceseve politike dhe pavarësinë e Malit të Zi, vazhdon gjithnjë me të vjetrën.

2. Pasaportat e reja me gjuhë të vjetër(!)

Një veprim i tillë dëshmohet në mënyrë transparente me rastin e publikimit të tenderit për pasaportat e reja të qytetarëve. Ne sajë të informacionit që disponojmë pasaportat e reja do të shtypen në dy gjuhë: malazeze dhe angleze, për të gjithë qytetarët e Republikës. Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme harrojnë se në Mal të Zi jetojnë edhe pjesëtarët e popullit shqiptarë të cilët kanë gjuhën dhe shkrimin e tyre të veçantë nga gjuhet sllave. Një veprim i tillë, sa absurd dhe i papërgjegjshëm, dëshmon se strukturat qeveritare vazhdojnë me të vjetrën duke injoruar kërkesat elementare të shqiptarëve për barazi gjuhësore, kombëtare dhe qytetare.

3. Nuk respektohet Kushtetuta

Nuk ka dilemë se një veprim i tillë bie ndesh edhe me Kushtetutën aktuale të Malit të Zi (1992), sepse në atë është shënuar qartë përdorimi i gjuhëve dhe i shkrimeve të tyre, që është definuar në dy nene (neni 9

dhe 68). Kështu në nenin 9 thuhet se "*në komunat ku shumica apo pjesë të konsiderueshme të popullsisë e përbëjnë pjesëtarët e grupeve nacionale dhe etnike, në përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe shkrimi i tyre*". Nga përmbajtja e këtij neni del së ekziston një barazi gjuhësore për të gjithë qytetarët, që kësaj here i përkasin kategorisë së *grupeve nacionale* dhe *etnike*, apo më mirë të themi, për joserbo-malazezët. Sa për sqarim duhet thënë se në këtë kategori, që më parë quhej herë *pakicë nacionale* apo *kombësi*, bëjnë pjesë: *shqiptarët, boshnjakët/myslimanët* dhe *kroatët*. Sipas mendimit tonë ky nen meriton një analizë të veçantë, sepse formulimi i tillë jep mundësi për komplikime praktike.

Fjala është për definimin preciz të pjesës ku thuhet *"pjesë të konsiderueshme"*, sepse nëse për shumicë çdo gjë është e qartë, për këtë kategori është e paqartë. Vetë fakti se nuk është përcaktuar në përqindje sasia "*e konsiderueshme*", organet kompetente lehtë mund ta keqpërdorin këtë nen, andaj si i tillë ky nen është i paprecizuar si duhet dhe me mundësi të mëdha për komplikime. Nëse në ato komuna ku shqiptarët janë shumicë, si p.sh. Ulqini, përdorimi i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj nuk duhet për të paraqitur problem të veçantë, por problemet paraqiten në ato komuna ku shqiptarët janë numerikisht pak, siç është, p.sh., Rozhaja (4%).

Në lidhje mbi përdorimin e gjuhëve, gjegjësisht të barazisë gjuhësore në Mal të Zi, kujdes i është kushtuar edhe në Kushtetutën e re (2007). Madje duhet cekur së për të parën herë gjuhë zyrtare në Mal të Zi përcaktohet me kushtetutë gjuha malazeze, ndërsa në përdorim zyrtar janë edhe: gjuha serbe, boshnjake, kroate dhe shqipe (neni 13). Është kjo një risi që duhet përshëndetur, sepse si gjuhë në përdorim zyrtar evidentohen pesë gjuhë që e bën ketë mjedis edhe në praktikë mjedis multigjuhësor. Ndërsa është çështje tjetër së si do të jetë realiteti në praktikë.

Sa i përket gjuhës shqipe nuk theksohet në mënyrë decide se në cilat mjedise ajo është gjuhë në përdorim zyrtar pa dyshim aludohet në ato ku shqiptarët janë popullsi autoktone. Por, duke pasur një përvojë aspak të mirë deri më tash në lidhje mbi pabarazinë gjuhësore të shqiptarëve ne ketë mjedis, dyshojmë se në ketë aspekt do të ketë ndryshime pozitive nga e kaluara. Po të ndodh ndryshe do të jetë një mrekulli!

4. Barazia gjuhësore e drejtë natyrore

Andaj, duke marrë parasysh këtë të dhënë, jemi të mendimit së kjo çështje është dashur të definohet ndryshe, sepse e drejta e përdorimit të

gjuhës është e drejtë natyrore dhe universale e çdo populli në çdo mjedis. Kjo çështje nuk bën të kufizohet në shifra të ndryshme numerike, sepse ne shtetet demokratike barazia e gjuhëve është e drejtë elementare e barazisë nacionale.

Barazisë së gjuhëve i është kushtuar kujdes edhe në kapitullin e pestë të Kushtetutës (neni 68) e cila është enkas për grupet nacionale dhe etnike. Më një fjalë del së kemi një mbrojtje të veçantë të tyre, me çka dëshmohet praktikisht se Mali i Zi sa i përket kushtetutës është shtet nacional e jo qytetar, sepse po të ishte i tillë, ky kapitull nuk ka pasur nevojë të ekzistojë.

Duke u bazuar në përvojën e deritashme të diskriminimit të vazhdueshëm praktik të gjuhës shqipe në relacionet ekzistuese politike në Mal të Zi, është iluzore të pritet së do të behën kthesa pozitive në këtë aspekt, sepse për diçka të tillë nevojitet vullneti politik i pushtetit.

5. Papërgjegjësia e pushtetit vendor të Ulqinit

Sa i përket kësaj çështje me të drejtë është pritur qe të bëhen kthesa pozitive në komunën e Ulqinit, sepse nga viti 1990-2006, pushtetin lokal e kanë pasur shqiptarët, përmes subjekteve të ndryshme apo në koalicion (LDMZ, 1990-1996; LDMZ-LLMZ, 1996-1998; LDMZ-UDSH, 1998-2002; UDSH-LDMZ-PPD, 2002-2006), por më gjithë premtimet e dhëna në fushatat parazgjedhore pothuaj çdo gjë është si më parë, që është për çdo kritikë. Madje jemi dëshmitarë se në parlamentin lokal të Ulqinit në rend të ditës janë venë shumë çështje, madje edhe stërpikja e mushkajave, ndërsa *çështja e barazisë së gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj nuk është trajtuar asnjëherë.*

Edhe pse ne lidhje mbi ketë temë mund të flitet gjatë me ketë rast, po theksoj vetëm tre raste të cilët dëshmojnë në mënyrë transparente papërgjegjësinë e pushtetit vendor të Ulqinit.

1. Ne qershor të vitit 2003 me iniciativë të Ministrisë së Turizmit edhe në territorin e komunës së Ulqinit janë vendosur tabelat për monumentet kulturo-historike dhe turistike. Tabelat kishin mbishkrimin në dy gjuhë: atë malazeze dhe angleze, por jo edhe ne gjuhën shqipe.

2. Ndërsa në muajt gusht - shtator 2006, nga ana e NP"Crnagoraput" u vendosën tabelat e vendbanimeve e atë vetëm ne gjuhën malazeze, duke injoruar në tërësi gjuhën shqipe. Si në rastin e parë ashtu edhe atë të dytë ka munguar reagimi i pushtetit vendor të Ulqinit, duke demaskuar një veprim të tillë të subjekteve përkatëse, që

është ne kundërshtim flagrant me barazinë e gjuhëve në këtë mjedis.

3. Ndërsa kulmi i këtij turpi nga ana e pushtetit vendor të Ulqinit arrin me rastin e votimeve të 10 shtatorit 2006. Fjalën e kemi për një vendvotim të ri i cili i shtohet regjistrit të vendvotimeve të komunës së Ulqinit. Vendimi për të themeluar një vendvotim të ri për fshatin e Selitës ishte i qëlluar, sepse një nevojë e tillë ka qenë edhe më herët, por është skandaloze emërtimi i këtij vendvotimi, në saje të emrit të një lagjeje apo të një patronimi të banorëve të fshatit Selitë e atë në variantin sllave Gjonoviq(!). Nëse kanë dashur ta emërtojnë ketë vendvotim me emrin e lagjes, atëherë është dashur Gjonaj, si njihet ne popull, e jo ne variantin sllav (!).

Një veprim i tillë absurd është turp për të gjithë ne, por në veçanti për punonjësit e administratës komunale në Ulqin. Por, nuk është për të befasuar një veprim i tillë i kësaj administrate, sepse ne mënyrë identike kanë vepruar edhe me herët. Sepse ne vend që të evidentohet vendvotimi i fshatit Brajshë e kanë evidentuar si vendvotimi Objekti "Osmanoviq" e po ashtu edhe vendvotimi në Bojkë si vendvotimi Objekti "Smajloviq" (!).

Nuk ka dilemë se veprimet e tilla të administratës komunale të Ulqinit janë anakronike të bëra nga individ të papërgjegjshëm të cilëve iu mungon dinjiteti njerëzor dhe profesional.

E tërë kjo papërgjegjësi nuk ka dilemë se iu takon atyre subjekteve të cilët kanë udhëhequr pushtetin vendor (2002-2006) ku në ketë mandat madje kanë pasë formuar koalicionin trepartiak (UDSH-LDMZ-PPD) të quajtur me emrin "*Shqiptarët bashkë*". Për fat të keq koha e dëshmoi se një koalicion i tillë ishte vetëm formal, sepse nuk ka ekzistuar sinqeriteti dhe gatishmëria për bashkëpunim korrekt për një qeverisje optimale lokale, sepse janë manifestuar në mënyrë perfide interesat personale, klanore e partiake.

Madje ekzistojnë argumente të mjaftueshme për të konkluduar se ky mandat ishte qeverisja me e dobët lokale që ka pasur Ulqini nga viti 1990 e këndej.

Andaj është çështje e ndërgjegjes së përbërjes së re parlamentare e cila ka dalë nga zgjedhjet lokale të 10 shtatorit 2006 në kuvendin komunal të Ulqinit iu takon që të përpiqen për të eliminuar këto devijime të cilat janë të dëmshme për të gjithë qytetarët në përgjithësi dhe shqiptarët në veçanti. Sepse nëse nuk angazhohemi ne për këto çështje është e tepërt që të presim diçka konkrete nga të tjerët. Ndërsa, pse këshilltarët në përbërjen e mëhershme të kuvendit komunal të Ulqinit nuk kanë vepruar

në këtë drejtim është çështje për diskutim të veçantë, por assesi ato nuk mund të amnistohen nga një veprim i tillë indiferent.

6. Gjuha nuk është çështje private

Një veprim i tillë thënë më së buti është papërgjegjësi e subjekteve përkatëse politike, sepse kjo nuk është çështje partiake dhe private, por ekskluzive kombëtare. Dhe ata të cilët nuk patën guxim që këtë çështje për vite të tëra ta vejnë në rëndin e ditës të pushtetit lokal, nuk kanë të drejtë morale të premtojnë se në të ardhmen do të punojnë në këtë drejtim, sepse kësaj propagande parazgjedhore nuk i beson më askush.

Deri sa shqiptarët dokumentet e tyre personale si letërnjoftimi, pasaporta, certifikatat dhe dokumente të tjera t' i kenë vetëm në gjuhën sllave, dëshmon në mënyrë transparente diskriminimin praktik të gjuhës shqipe. Veprimet e tilla të pushtetit, duke injoruar elementin kryesor të identitetit kombëtar të një populli, dëshmon për aspiratat asimiluese të ati pushteti.

7. Hipokrizia e pushtetit republikan

Se pushteti republikan mund të veprojë në mënyrë të drejtë kur ato duan dhe është në interesin e tyre, dëshmon e dhëna se me rastin e votimeve të përgjithshme parlamentare republikane, apo siç ishte rasti i referendumit (21 maj 2006) shqiptarët fletëvotimet e tyre i kanë të shtypura edhe në gjuhën shqipe. Një veprim i tillë nuk ka dilemë se është pozitiv dhe në favor të barazisë gjuhësore të shqiptarëve, por një veprim i tillë është iritues, sepse ka dimensionin e veçantë e atë kryesisht për të fituar pikë politike te elektorati votues, por edhe të faktori ndërkombëtar.

Nuk ka dilemë se nga një veprim i tillë del qartë hipokrizia e pushtetit që paraqet një manipulim momental, sepse kur i njëjti vendim është i marrë nga Kuvendi republikan për fletëvotimet edhe në gjuhën shqipe, pse nuk veprohet ne të njëjtën mënyrë edhe me dokumentet e identitetit personal për shqiptarët në Mal të Zi. Por, edhe pse një hipokrizie te tillë i ka dalë boja dhe është transparente për çdokënd, me të drejtë bëhet pyetja deri kur do të vazhdohet me të vjetrën, duke injoruar barazinë gjuhësore në mënyrë praktike të qytetarëve shqiptarë ne ketë mjedis.

8. Qëndrim indiferent nga Ministria e Pakicave

Edhe pse nga data 10 maj 2006, në Kuvendin e Malit të Zi është miratuar *Ligji për Liritë dhe të Drejtat e Pakicave*, deri me tash nuk kemi asnjë ndryshim pozitiv edhe pse nga data 10 nëntor 2006, ka qenë e udhës për të filluar zbatimi praktik i tij që do të ishte në favor të barazisë së popujve pakicë në Mal të Zi. Qëndrimi indiferent nga ana e Ministrisë së Popujve Pakicë pikërisht në lidhje mbi këtë çështje shumë të rëndësishme dëshmon paaftësinë e tyre për t'u ballafaquar me realitetin.

Nëse edhe me tutje veprohet si më parë, duke qenë dekor i Qeverisë, e jo duke u marrë me çështjet kyçe që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar, në rastin konkret të shqiptarëve, me të drejtë bëhet pyetja se: për çka është dhe kujt i shërben një Ministri e tillë.

9. Të miratohen standardet ndërkombëtare

Strukturat qeveritare në Mal të Zi, janë nonsens i veçantë, sepse janë në kundërshtim flagrant edhe me kushtetutën dhe ligjet që kanë miratuar vetë. Nuk ka dilemë se për ndryshime pozitive duhet të ekzistojë vullneti politik i pushtetit ku pjesëtarët e popujve pakicë t'i trajtojë si partnerë e jo si element i huaj, duke zbatuar në praktikë standardet më të avancuara demokratike ndërkombëtare, ndërsa për Malin e Zi, në aspektin e barazisë gjuhësore, sipas mendimit tim, më i përshtatshëm është modeli i Belgjikës, Zvicrës apo Finlandës, ku ekziston barazi e plotë gjuhësore.

10. Përfundim

Praktika e deritashme, sa i përket barazisë gjuhësore të shqiptarëve në Mal të Zi ka dëshmuar se shqiptarët nuk kanë qenë asnjëherë të barabartë. Edhe pse strukturat shtetërore i kanë pasur mundësitë që në këtë aspekt të paktën ku shqiptarët janë popullsi shumicë, siç është rasti me komunën e Ulqinit, të bëjnë ndryshime pozitive, sepse çdo gjë ka vendnumëruar. Një veprim i tillë është për çdo kritikë, sepse shqiptarët si popullsi autoktone duhet të gëzojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe të shkrimit shqip në administratë dhe dokumentet personale të identitetit.

Edhe pse është pritur së do të bëhen kthesa me rastin e miratimit të pluralizmit politik (1990), çdo gjë pothuaj vazhdon si më parë, edhe kërkesat e shqiptarëve kanë qenë të vazhdueshme për barazi të mirëfilltë

të një mjedisi multinacional, multikonfesional dhe multuikgjuhësor, siç është Mali i Zi.

Nëse edhe në të ardhmen shqiptarët do të jenë me ketë status gjuhësor, nuk ka dilemë se do të kemi vazhdimësi të pabarazisë kombëtare, sepse barazia kombëtare fillon me barazinë gjuhësore.

SHTOJCË

(Kujtime dhe dëshmi, pranverë 1945)

Azem HAJDINI – XANI

NGA PRIZRENI NË ISTRI – NJË SPROVË PËR HISTORI

H Y R J E

NËPËR FERRIN E TIVARIT KALUAN MBI 22 MIJË SHQIPTARË

Nga dokumentet arkivore të proviniencës ushtarake të Jugosllavisë del mirëfilli fakti se për çlirimin përfundimtar të ish-Jugosllavisë gjatë LDB, nga Kosova morën pjesë më shumë se 53 mijë luftëtarë, numri më i madh i të cilëve ishin shqiptarë. Një numër i tyre kishin qenë pjesëtarë të aradhave partizane, me përvojë ushtarake që nga viti 1941 e deri në vitin 1944, kurse shumica e tyre u mobilizuan në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945. Nga ky numër, për plotësimin e njësive ushtarake të Jugosllavisë, jashtë Kosovës u nxorën gjithësej 35017 luftëtarë. Në frontin e Sremit u dërguan 13 mijë luftëtarë, të cilët përfshiheshin në Brigadën VI (3000), në Brigadën VII (mbi 6000) dhe në Brigadën VIII (4000 luftëtarë).

Për plotësimin e Armatës IV të Jugosllavisë, që operonte në Frontin veriperëndimor të bregdetit Adriatik, në mars dhe prill të vitit 1945 u dërguan shumë njësi ushtarake të quajtura eshalone, me gjithsej 22017 luftëtarë shqiptarë, si më poshtë:

a) në mars: Eshaloni I kishte 3700 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më 24 mars 1945, arritja në Tivar - më 30 mars 1945,

Eshaloni II kishte 4700 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më 26 mars 1945, arritja në Tivar - më 31 mars 1945, dhe

Eshaloni III kishte 2700 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më 27 mars 1945, arritja në Tivar - më 1 prill 1945.

b) në prill: Eshaloni I kishte 1506 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më

19 prill 1945,

Eshaloni II kishte 2601 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më 20 prill 1945,

Eshaloni III kishte 1216 luftëtarë. Nisja nga Prizreni u bë më 24 prill 1945.

c) Eshaloni I (i posaçëm) kishte 5594 luftëtarë shqiptarë nga Maqedonia. Ky eshalon ishte dërguar në Frontin veriperëndimor të Adriatikut në ditët e para të prillit 1945.

Eshalonin e Parë (të marsit) e përbënin kryesisht ushtarët shqiptarë nga të gjitha viset e Kosovës. Ky eshalon kishte arritur në Shkodër më 27 mars 1945. Pas një pushimi dyditor (deri më 29 mars 1945), ai niset për në Tivar. Kur po nisej nga Shkodra, sipas Shtabit ushtarak, eshaloni kishte 2394 ushtarë shqiptarë apo 1306 luftëtarë më pak se sa ishin nisur nga Prizreni, që d.m.th se të munguarit ishin likuiduar gjatë rrugës Prizren - Shkodër. Një numër ishte likuiduar në afërsi të Kukësit, në relacionin e rrugës Kukës - Fushë-Arrëz, me ç'rast kufomat ishin hedhur në gremina të thepisura. Për këtë fakt kanë rrëfyer shumë përjetues të këtij marshimi.

Eshalonin e Dytë (të marsit), e përbënin ushtarët shqiptarë, të cilët më vonë do t'i shohim të fundosur në det në qytetin e Tregurit (Trogirit). Në Eshalonin e Dytë, sikur edhe në Eshalonin e Parë, përveç rekrutëve të mobilizuar, kishte edhe numër të madh luftëtarësh me përvojë luftarake, që kishin qenë edhe më parë të inkuadruar në formacione të ndryshme ushtarake në Kosovë. Por, me qëllim të caktuar diversiv, të gjithë i kishin nxjerrë nga formacionet e para dhe i kishin futur në kuadër të Eshalonit të Dytë. Pastaj i kishin nisur rrugës tragjike të pakthim.

Shtrohet pyetja: A ishte i nevojshëm një mobilizim me përmasa aq të mëdha i shqiptarëve, në kohën kur çdo ditë pritej kapitullimi i pushtuesit nazist? Përgjigjja është e logjikshme: Jo! Dërgimin e numrit kaq të madh të shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera etnike shqiptare si ushtarë nëpër vendet e largëta të ish – Jugosllavisë duhet kërkuar te një strategji dhe nevojë për izolimin e tyre, meqenëse dyshohej se në atë pranverë mund të shpërthente një kryengritje e armatosur me përmasa të gjera, se mund të shpërthente një luftë për çlirimin e viseve etnike shqiptare.

Fjalët dhe parullat se shqiptarët po shkonin në luftë, se po shkonin në front, si dhe heqja e armëve nga krahu i tyre, kinse për t'i kursyer nga mundimet e rrugës së gjatë, ishin vetëm mashtrim për ta realizuar më lehtë qëllimin; vrasjen e njerëzve duarthatë.

Në kohën e dërgimit të numrit kaq të madh të luftëtarëve shqiptarë jashtë Kosovës, në Kosovë kishin hyrë jo më pak se 25 brigada jugosllave, si dhe Divizionet V dhe VI shqiptare, me një efektivë të përgjithshme prej 80 deri 100 mijë ushtarë e oficerë të të gjitha gjinive e me armatim mjaft modern për kohën.

Likuidimi i rekrutëve shqiptarë në Tivar, në Tregur (Trogir) dhe në Raguzë (Dubrovnik) janë vetëm disa prej shumë masakrave të serbëve mbi shqiptarët. Po qe se e bëjmë një prapashikim në histori, do të shohim se Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia gjatë shekujve ka pas dhe ende e ka qëllim

kryesor shfarosjen fizike dhe biologjike të shqiptarëve apo dëbimin e tyre nga trojet e veta etnike. Këtu edhe duhet kërkuar përgjigjen për ngjarjet e Tivarit, të Tregurit e të Raguzës, por edhe mobilizimin dhe dërgimin e forcës aktive shqiptare jashtë Kosovës dhe viseve shqiptare.

Përmes këtij marshimi tragjik serbët, malazezët dhe maqedonasit kishin për qëllim realizimin e synimeve të tyre në mënyrë më perfide për shfarosjen e shqiptarëve:

1. Izolimin e forcës aktive shqiptare, që përfshinte moshën 16 - 65 vjeç, me qëllim të dobësimit të rezistencës ndaj pushtuesit dhe ndaj terrorit që po ushtronte pushteti okupues ndaj popullatës së pafajshme shqiptare,

2. Asgjësimin fizik të ushtarëve shqiptarë në një vend dhe në një kohë më të përshtatshme, jashtë trojeve të tyre, si ndodhi në Tivar, në Tregur e në Raguzë gjatë deportimit për në frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri, në Stari Beqej e në vende tjera në ish-Jugosllavi,

3. Krijimin e rrethanave politike e ushtarake për aneksimin e Kosovës dhe viseve tjera etnike shqiptare, si ndodhi në korrik të vitit 1945 etj.

Pikënisje e këtyre njësive ushtarake shqiptare ishin qendrat e qarkut dhe ato komunale në Kosovë. Njërën njësi, ku isha edhe unë, e përbënin ushtarët e aradhave partizane të rrethit të Mitrovicës, të Shalës së Bajgorës dhe të Drenicës, vullnetarë dhe shumë të mobilizuar nga këto anë, me numër të përgjithshëm prej 1000 deri 1200 luftëtarë. Në rrugë e sipër drejt Prizrenit, ky numër sa vinte e shtohej me ushtarët shqiptarë të mobilizuar në qendrat tjera të Kosovës, si në Vushtrri, në Prishtinë, në Llap, në Gallap, në Gjilan, në Dardanë (Kamenicë), në Bujanoc, në Preshevë, në Kumanovë, në Shkup, në Gostivar, në Tetovë, në Kaçanik, në Viti, në Ferizaj, në Sufrekë, në Sharr (Dragash), në Opojë, në Gjakovë, në Deçan, në Pejë, në Burim (Istog), në Klinë, në Rahavec, në Prizren etj. Pra, ky numër, pas ardhjes së rekrutëve nga të gjitha qendrat e Kosovës, arriti në 4700 shqiptarë.

Për përgatitjen e masakrës së 31 marsit 1945 në Tivar, për ngulfatjen e rekrutëve shqiptarë më 18 prill 1945 në Raguzë dhe për fundosjen e ushtarëve në det në Tregur në prill 1945 nga organet më të larta shtetërore ushtararake dhe politike të Jugosllavisë në Beograd, në Mal të Zi, në Prishtinë dhe në Shkup, dëshmojnë shumë argumente, siç janë:

1. tubimet e organizuara rreth datës 23 mars 1945 në shumë qendra të Malit të Zi, si në Cetinë, në Podgoricë, në Kotor, në Hercegnovi, në Tivar, në Ulqin, në Virpazar dhe në shumë fshatra dhe lokalitete tjera. Tubimet organizoheshin me komunistë, skojistë, rini e qytetarë dhe temë kishin gatishmërinë më të lartë të popullit, nga se ato ditë pritej të sillej në Tivar numër i madh i "banditëve" shqiptarë, siç i quanin ata rekrutët shqiptarë. Shqiptarët, sipas tyre, mund t'i rrezikonin, jo vetëm njësitë ushtarake, por edhe popullsinë dhe integritetin e Malit të Zi dhe të Jugosllavisë, ndaj i armatosën dhe i organizuan forcat e tyre ushtarake në kuadër të Brigadës

X të Malit të Zi, si dhe njësi tjera ushtarake, në mënyrë që ta bllokonin terrenin deri të kufiri shqiptar dhe pastaj të shtinin në "banditët" shqiptarë, kudo që të gjendeshin, në mënyrë që të mos shpëtonte askush i gjallë për të kaluar kufirin jugosllav;

2. mobilizimi dhe dërgimi në frontin veriperëndimor të Adriatikut vetëm i shqiptarëve të Kosovës, i atyre të Maqedonisë dhe i viseve tjera etnike shqiptare, por jo edhe i serbëve, i malazezëve dhe i maqedonasve, si dhe caktimi i një marshimi kaq të gjatë e të rëndë në këmbë, pa veshmbathje, të zhveshur e të zbathur, të uritur dhe të sëmurë në relacionin Prizren – Kukës – Shkodër – Tivar;

3. mospërgatitja dhe mosorganizimi i ushtarëve shqiptarë nga Komanda Supreme për marshimin normal ushtarak deri në vendin e caktuar, edhe pse ishte e obliguar për këtë gjë?!

4. përcjellja e rekrutëve shqiptarë nga një komandë, ku kishte vetëm eprorë ushtarakë të Serbisë, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Në komandë nuk kishte asnjë oficer apo ushtar shqiptar (deri në Prizren ata komandoheshin në gjuhën shqipe nga eprorë ushtarakë shqiptarë). Ky fakt flet shumë për skenarin e kurdisur!

5. riorganizimi dhe çarmatimi definitiv i ushtarëve shqiptarë në Prizren (deri në Prizren shumë rekrutë i kishin marrë me vete armët nga shtëpitë e tyre, kurse një pjesë e tyre ishte armatosur kur ishin inkuadruar në brigadë apo njësi tjera ushtarake);

6. deportimi i rekrutëve nëpër territorin e Shqipërisë, edhe pse nëpër Mal të Zi kushtet për udhëtim ishin shumë më të volitshme. Eprorët serbë, malazezë dhe maqedonas parashikonin se gjenocidi në rrethana lufte do të kishte "mbulesë", sepse nuk do të dyshohej se duke kaluar nëpër Shqipëri mund të likuidoheshin shqiptarët nga serbo - malazezët. Kështu mund të plasohej eventualisht edhe te aleatët, nga se ishte krijuar imazhi i rrejshëm i "bashkim - vëllazërimit";

7. Tivari, Raguza dhe Treguri ishin zgjedhur për vendet e masakrave, si skuta më të izoluara në bregdetin malazias dhe dalmatinas, pak më larg nga lidhjet e gjera komunikative. Konfiguracioni i terrenit krijonte mundësi që krimet të mbuloheshin pa lënë gjurmë dhe më lehtë, në heshtje e pa depërtuar ndonjë fjalë në opinion;

8. ndodhja në vendin e krimit dhe në kohën e caktuar, në gjendje të gatishmërisë së lartë, përveç njësive ushtarake të Brigadës X, edhe njësi tjera ushtarake e civile, shtetërore e qytetare, mantilbardhë e punëtorë.

9. futja me dhunë në anije të 150 - 180 ushtarëve shqiptarë. Me këtë rast, për ta kaluar kanalin mes ujdhesës Çiova dhe qytetit Tregur eprorët serbo - malazezë, përkatësisht jugosllavë, përgjegjës për "kujdesin" dhe transportimin e tyre, sipas skenarit, me dhunë i futën shumë ushtarë në anije, në mënyrë që pesha e lejuar e ngarkimit në anije të tejkalohej dy – tre herë. Pos kësaj, ushtarët ishin të ngarkuar edhe me armë e pajisje tjetër ushtarake. Kjo bëri që anija, pasi kaloi 20 - 30 metra nga bregu, u nda në dysh dhe u shkatërrua tërësisht, duke i lëshuar në det të gjithë të ngarkuarit, të gjithë shqiptarë;

10. mungesa e kujdesit të eprorëve ndaj ushtarëve në momentet e lundrimit të tyre nëpër kanal dhe pas fundosjes së anijes me ushtarët në të. Shihet qartë se likuidimi i rekrutëve shqiptarë në Tregur ishte planifikuar me kohë dhe mjaft mirë, ngase eprorët e komandës ushtarake dhe as njësi tjera ushtarake, asnjë institucion ushtarak apo civil nuk u angazhuan dhe nuk morën pjesë në shpëtimin e ushtarëve të fundosur. Edhe ky fakt flet mjaft.

Këtu veçuam disa nga shumë argumentet që dëshmojnë për skenarët e hartuar paraprakisht për masakrën e Tivarit, të Raguzës dhe fundosjen e ushtarëve shqiptarë në det në Tregur.

Kapitulli I – PRIZRENI

"RIORGANIZIMI" DHE ÇARMATOSJA E USHTARËVE SHQIPTARË NË PRIZREN

Pasi na tubuan nga të gjitha anët e Kosovës në Prizren, na vendosën në një kamp të rrethuar me tela gjemborë, nën qiellin e hapur, përballë kazermave ushtarake të këtij qyteti. Prizreni pra ishte vendtubimi qendror, ku i kishin tubuar djemtë dhe burrat e zgjedhur të Kosovës të të gjitha moshave, por shumica dërmuese e tyre ishin nën moshën 35 vjeçare (kishte mjaft djemë nën moshën 16 vjeçare, siç kishte edhe burra mbi moshën 65 vjeçare). Shumica prej tyre ishin të veshur dobët, madje vetëm në këmishë e tëlina, ngase, kur i kishin marrë nëpër shtëpitë e tyre, nuk i kishin lejuar të përgatiteshin; të visheshin e të mbatheshin si duhet. Shumica kishin të mbathura opinga lëkure, por ato u ishin grisur gjatë rrugëtimit. Kishte nga ne që ecnin zbathur e me këmbë të gjakosura. Secili mbante pas shpine nga një trastë (janxhik) pëlhure apo lëkure, brenda të cilës kishin futur ndonjë kafshatë buke të misrit.

Derisa kanë arritur në Prizren, ushtarët e mobilizuar shqiptarë ishin të organizuar nëpër formacione të ndryshme ushtarake vendore; në kompani, në batalione, në togje e deri në njësitë më të vogla. Edhe komanda dhe ushtrimet zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Mirëpo, gjatë qëndrimit në Prizren, sipas planit ushtarak serb, malazez dhe maqedonas, u bë "riorganizimi" dhe çarmatimi i plotë i ushtarëve shqiptarë, apo, siç e quanin ata, i kuadrateve, ku secili kuadrat numronte 100 - 150 ushtarë.

Ishte ditë e shtunë. Komanda ushtarake serbo - malazeze në Prizren kishte lëshuar urdhërin e shtetrrethim-

it. Askush në qytet nuk guxonte të lëvizte nëpër rrugë e as të dilte nga shtëpia. Kishte filluar gjahu në njerëz. Ushtria kishte nxjerrë nga shtëpitë të gjithë të rriturit. Nëpunësit ishin nxjerrë nga institucionet shtetërore, ushtarake dhe civile, madje edhe nga posta e Prizrenit, ku punonin, pos të tjerëve, edhe Anton Çetta dhe Rasim Juniku. Të gjithë ishin urdhëruar të shkonin në kamp. Pas pak në kamp sollën edhe 480 ushtarë shqiptarë të armatosur dhe të uniformuar, të cilët i kishin nxjerrë nga brigadat dhe njësitë tjera ushtarake, ku kishin qenë me shërbim. Të nesërmen (e diel) Xhavit Nimani, i cili ishte kthyer nga Tirana në Prizren, nga kampi nxori të gjithë ushtarët gjakovarë. Pos ushtarëve, nga kampi u nxorën edhe Anton Çetta e Rasim Juniku. Më vonë udhëheqësit serbë, malazezë e maqedonas nga kampi i nxorën edhe ushtarët bashkëkombas të tyre, të cilët i angazhuan të na përcillnin ne, d.m.th. të ishin eprorët tanë.

Para se të marshonim nga Prizreni në drejtim të Tivarit, në kamp erdhën disa oficerë të lartë. Në mesin e të sapoardhurve ishin edhe Elhami Nimani dhe Gafur Luma. I pari na mbajti një fjalim të shkurtër, në të cilin, mes tjerash, tha fjalë miradie për Ushtrinë Nacionalçlirimtare, për bashkim-vëllazërimin, për Titon, për Stalinin dhe për Enverin. Madje, ai tha se nga ky eshalon me 4700 luftëtarë pritet shumë.

"Keni nderin dhe duhet të mburreni me misionin që u është besuar, ngase ju do të jepni kontributin tuaj për çlirimin e Istries dhe të Triestës nga okupatori fashist italian, në mënyrë që këto troje t'i bashkangjiten shtetit amë, Jugosllavisë", - tha mes tjerash Nimani.

Pastaj, njëri ndër oficerët e lartë serb, në gjuhën serbe, na komunikoi urdhëresën e Shtabit Operativ për Kosovë e Metohi, në të cilën, mes tjerash, thuhej:

"Për shkak të rrugës së gjatë deri në Tivar, rrugë kjo e cila do të kalohet këmbë nëpër territorin e Shqipërisë, të gjithë ata që kanë armë zjarri me vete duhet t'i dorëzojnë e mos t'i bartin ato për së rëndi".

U tha se kjo vlenë edhe për oficerët dhe nënoficerët shqiptarë, sepse ata mbajnë armë heterogjene; gjermane, italiane, jugosllave, bullgare etj., kurse posa të arrijnë në territorin e çliruar, të gjithë do të armatosen me armë moderne anglo – amerikane, me ç'rast do të bëhet riorganizimi i njësive, të cilat përsëri do të udhëhiqen nga oficerët e mëparshëm shqiptarë.

"Përcjelljen tonë tash e tutje do ta sigurojnë oficerët dhe ushtarët e rryer të Divizionit 46 - të të Serbisë, - siç thanë ata, - për ta bërë më mirë sigurimin nga rreziqet gjatë rrugës".

Duke qenë të çiltër e të pastër në shpirt, sikur e ka zakon shqiptari, por duke qenë edhe të bindur se Partia Komuniste, në aleancë me koalicionin antifashist, nuk do ta ndjekë politikën e shfarosjes së shqiptarëve, siç ndodhi në Jugosllavinë monarkiste, urdhërat që na dhanë, i nderuam, madje i vlerësuam si humane dhe si shprehje e kujdesit mjaft të mirë ndaj nesh. Askush nuk dyshonte se pas kësaj fshihej një dramë e tmerrshme e kon-

struktuar kundër nesh dhe popullit shqiptar.

Fjalët dhe parullat e tyre se po shkojmë në front, si dhe lënia e armëve kinëse për të na kursyer nga mundimet e rrugës së gjatë, shpejt u pa se kishin qenë vetëm mashtrim për ta realizuar më lehtë qëllimin e tyre djallëzor, ngase, duke qenë duarthatë, nuk mund të paraqisnim ndonjë qëndresë. Ndërkaq, Tivari, Treguri, Raguza, si dhe rruga Prizren – Shkodër – Istri, ishin planifikuar dhe ishin zgjedhur si pika më të veçuara, më pak të dukshme për ta kryer krimin e paparë në histori. Konfiguracioni i terrenit, me shkëmbinjë, me kanjone e në det të gjerë ju afronte atyre mundësi që t'i fshihnin gjurmët e krimit ndaj të gjitha viktimave të këtyre masakrave, që tërë këtë krim ta mbulojë terri dhe heshtja, pa depërtuar dot asnjë fjalë në opinion, e të mos flasim për ndonjë jehonë më të madhe në vend apo jashtë tij.

Të dhënat memoriale të përjetuesve të kësaj rruge të mundimshme flasin për dhunë, mizori, vrasje të të sëmurëve, inskenime të incidenteve, pushkatime... Të shohim se çka do të bëhet më vonë me regrutët, të cilët "po shkonin në frontet e luftës"... Të ecim rrugës së tyre, siç ecën ata 62 vjet më parë!

Kapitulli II – RRUGA

MARSHIMI NGA PRIZRENI NË KUKËS

Në mëngjesin e 26 marsit 1945, eshaloni ynë është nisur nga Prizreni, i përcjellë dhe i komanduar nga njësitë e Brigadës 27-të të Divizionit 46-të të Serbisë, si dhe nga një njësit maqedonas. Në komandë, pos të tjerëve, ishin edhe kapiteni Janko Llakiqeviq, Bogolub Nedelkoviq e të tjerë, të gjithë të përkatësisë kombëtare serbe, malazeze apo maqedonase. Kolona e gjatë 5 - 6 kilometërshe ishte e rreshtuar për katër dhe e ndarë në kuadrate. Para, në mes dhe në fund të çdo kuadrati vinin nga një apo dy oficerë të hipur në kalë, ndërsa anash dhe nga prapa secilit kuadrat ecnin ushtarët serbë, të armatosur deri në dhëmb e me armë të gatshme për zjarr.

Derisa ushtarët – rekrutë shqiptarë ende mendonin se do të shkonin në front për t'ia dhënë grushtin vendimtar nazizmit, papritmas u gjetën në një situatë të rëndë. Në fillim nuk e kishin kuptuar se çka po ndodhte me ta, ishin ushtarë apo robër lufte, por pas një kohe të shkurtër e panë se gjendeshin në duart e armikut të përbetuar serb, përkatësisht jugosllav.

Por, kur hymë në territorin e Shqipërisë, u gëzuam pa masë, duke menduar se tash e tutje do te jemi nën përcjelljen e ushtarëve të shtetit tonë, të Shqipërisë dhe se më nuk do të përjetonim mizori, siç kishim përjetuar në Kosovë nga serbët, malazezët dhe maqedonasit. Shumë shpejt pra u

bindëm se as këtu nuk kishte vend për gëzim, sepse skenari i parapërgatitur vazhdonte të realizohej me përpikëri. Pas disa kilometrave të udhëtimit, ende pa arritur në Kukës, ra viktima e parë. Ai ishte Fetah Salihu nga Krasmiroci, i cili e pësoi vetëm pse ishte ndalë pakëz për ta lidhë këmbën e zbathur, që i rridhte gjak.

Gjatë rrugës nëpër territorin e Shqipërisë përcjellësit i shtonin torturat dhe vrasjet ndaj nesh. Ata më nuk na konsideronin si bashkëluftëtarë të tyre, madje as si robër të luftës (edhe ndaj robërve të luftës nuk do të duheshin të silleshin ashtu, sepse edhe robërit mbrohen me konventa ndërkombëtare, kurse sjellja ndaj tyre duhet të jetë humane). Neve nuk na trajtonin as si kope bagëtishë. Për përcjellësit tanë tashmë ishte njësoj nëse do të vdisnim gjatë marshimit, nëse do të na vrisnin gjatë rrugës apo do të arrinim në vendin e caktuar, në Tivar, në Tregur, në Raguzë, ku na ishte përgatitur likuidimi masiv. Përveç se nuk na jepnin ushqim e na mundonte aq shumë uria, edhe më shumë na mundonte etja, duke mos na lejuar të afroheshim te ndonjë krua, te ndonjë lumë apo te ndonjë burim tjetër i ujit për ta shuar etjen që na kishte kapluar apo edhe për t'u freskuar sadopak.

Zgjedhja e marshimit nëpër territorin e Shqipërisë padyshim se e kishte një qëllim djallëzor. Dr. Hakif Bajrami ka konstatuar se:

- "kjo zgjedhje ishte bërë që të përgatitet terreni përmes veprimeve gjenocidale për ekzodus të plotë të viseve shqiptare, derisa të zgjasin aksionet e luftes",

- "Në realitet, sllavokomunistët mendonin se gjenocidi në rrethana të luftës ka mbulesë, sepse zhvillohej në kushte të volitshme për ta",

- "Mandej, ishte llogaritur se askush nuk do të dyshojë se duke kaluar nëpër Shqipëri, shqiptarët mund të likuidoheshin masovikisht nga serbët, malazezët dhe maqedonasit. E tërë kjo mund të plasohej edhe te aleatët, edhe po të zbulohej, sepse tashmë ishte krijuar imazhi i rrejshëm i "vëllazërim - bashkimit".

Arritja në Kukës

Në ato rrethana, ditën e parë të marshimit tonë, rreth orës 20, arritëm në qytetin e Kukësit. Meqë urën mbi Drin e kishin shkatërruar nazifashistët, lumin e kaluam përmes një vigu. Ashtu, siç ishim të lodhur e të rraskapitur, të etur e të uritur, por edhe të veshur dobët, na vendosën për të kaluar natën në një pllajë me kaçuba buzë Drinit, nën qiellin e hapur dhe nën reshjet e imëta të shiut. Aty ishim të rrethuar; në lindje dhe verilindje nga valët e turbullta të Drinit, nga perëndimi dhe jugperëndimi nga forca të shumta ushtarake serbe.

Në bregun e Drinit, në atë lëndinë, edhe pse në rrethana tepër të vështira, ushtarët shqiptarë me vetëmohim të lartë angazhoheshin që t'u jepnin ndihmë shokëve të sëmurë e të lodhur nga mundimet e llojllojshme që i përjetonin gjatë asaj rruge të gjatë. Në një gjendje të tillë nuk mund të parashikohej se çka do të ndodhte më

tutje me ne. Diku rreth mesnatës filluan të thirren në Shtab njerëzit më autoritativë të radhëve tona, sidomos ata të cilët kishin rënë në sy më parë, gjatë rrugës nga Prizreni, apo ata që ishin të identifikuar si eprorë ushtarakë.

Por, ç'ndodhi më vonë? Rreth orës 1, pas mesnate, u dëgjuan disa të shtëna me pushkë automatike dhe me britma të tmerrshme, të cilat na e prishën gjumin tonë të thellë. Edhe pas këtyre të shtënave, të cilat na habitën dhe na frikësuan, ende nuk besonim se eprorët tanë po na tradhtonin dhe po donin të na vrisnin. Më vonë u njoftuam se në Shtab ishin ftuar "për konsultime" dy grupe ushtarësh me nga katër veta. Pas rreth tridhjetë minutave në shtab ishte ftuar edhe grupi i tretë, në krye me Bajram Zukën.

- Të shtënat dhe britmat që i kishim dëgjuar më parë ishin një sinjal i keq se diçka po ndodhte me ne, se diçka nuk ishte në rregull. U konsultuam me disa shokë të tjerë për dilemën, të shkojmë apo të mos shkojmë", nëse na thërrasin. Në fund vendosëm të shkojmë. Shtabi ndodhej rreth 800 metra larg nga vendi ku gjendeshim ne, ushtarët shqiptarë. Duke shkuar, rreth 200 - 300 metra para se të arrinin në shtab, - thotë Bajrami, - hasëm në një pusi, prej ku është dëgjuar komanda nga ushtarakët serbo - malazezë: "Ruke uvis! Predajte se!" (Duart lart! Dorëzohuni!).

Grupi, me Bajram Zukën në krye, qysh më parë kishin marrë nga një shkop dhe nga disa gurë në duar dhe ishin përpjekur t'u kundërviheshin ushtarakëve serbë, duke i gjuajtur ata me gurë, kurse eprorët kishin menduar se ata po gjuanin me bomba dore, prandaj ishin shtrirë përtokë. Duke shfrytëzuar errësirën e natës, por nën rrebeshin e plumbave kemi arritur të tërhiqeshin nga pusia dhe jemi kthyer në vendin ku ishin shokët thotë Bajrami. Me atë rast është plagosur Sefedin Avdyli (ky person asnjëherë, edhe pas katërdhjetë vjetëve të jetës së tij, nuk ka guxuar t'i tregonte askujt se kishte qenë i plagosur ndonjëherë).

Pas kthimit nga vendi i pusisë, në fytyrat e shokëve tjerë vërehej një shqetësim i madh, sepse ata ishin merakosur fort për vonesën e kthimit tonë nga shtabi dhe për të shtënat me armë zjarri që ishin dëgjuar.

Pas kësaj ngjarjeje, të prirë nga Bajram Zuka dhe nga disa shokë të tjerë, në fshehtësinë më të madhe e kemi informuar pjesën më të madhe të kolonës për atë që na kishte ndodhur atë natë dhe jemi organizuar, me mundësitë që kishim, për të marrë masat e nevojshme preventive mbrojtëse:

a) kemi njoftuar se ishim të rrethuar dhe të përcjellë nga forcat serbe, malazeze dhe maqedonase dhe se nuk na konsideronin më si bashkëluftëtarë dhe as si robër lufte,

b) kemi rekomanduar që askush të mos u përgjigjet thirrjeve eventuale të shtabit, dhe

c) kemi urdhëruar që askush të mos largohet nga vendi, madje as për nevoja personale, kurse në mëngjes të kërkojmë sqarime për fatin e shokëve që na i morën gjoja për konsultime

dhe të informojmë Këshillin Krahinor në Prizren për trajtimin tonë.

Bajram Zuka, nga Likoshani, është i lindur në vitin 1909. Më 1935, në një proces të montuar politik, është dënuar me 101 vjet burg, ose, thënë ndryshe, me burg të përjetshëm. Me kapitullimin e Jugosllavisë monarkiste, ai e kishte thyer burgun e Shkupit dhe ishte kthyer në shtëpi. Për idetë patriotike që kishte, në vitin 1946 është dënuar me 6 vjet burg, ndërsa në vitin 1953 është dënuar përsëri, këtë herë me 13 vjet burg të rëndë. Pra, ai ishte i dënuar me gjithësej 120 vjet burg. Bajrami ishte nga të rrallët që ishte arratisur nga "eshaloni i vdekjes", ishte kthyer në shtëpi dhe pastaj ishte anëtarësuar në organizatën ilegale NDSH.

Masat që i morëm, dhanë fryte. Askush më nuk largohej nga vendi dhe askush më nuk u përgjigjej thirrjeve të shtabit. Bajram Zuka dhe Sefedin Avdyli, të vetëdijshëm për skenarin serb të përgatitur kundër ushtarëve shqiptarë, në mënyrë më të fshehtë i apeluan pjesës më të madhe të ushtarëve tanë që me çdo kusht t'i sulmonin në befasi forcat e armikut, t'ua grabisnin armët dhe të kthehen në Kosovë, ku do të luftonin për Kosovën e lirë dhe për bashkim me Shqipërinë. Por, për shkak të frikës se do të pësonin familjet e tyre, apeli nuk pati përkrahje të dëshirueshme.

Ndonëse apeli i Bajram Zukës për t'i sulmuar forcat e armikut dhe për t'u kthyer në Kosovë nuk u realizua, ai, i vetëdijshëm se do të likuidohet shpejt dhe në një vend të largët, falë strategjisë së mirëfilltë dhe trimërisë që kishte, arriti që me disa shokë të dezertonte dhe të arratisej nga ushtria, pastaj të kthehej në Kosovë, ku i ishte bashkangjitur Lëvizjes Nacional - Demokratike Shqiptare.

Në mëngjes 54 ushtarë shqiptarë të sëmurë, të lodhur e të rraskapitur, nuk mund të lëviznin për ta vazhduar rrugën me të tjerët, në kolonë. Edhe pse kërkonim që atyre t'u sigurohej ndonjë mjet transportues për t'i dërguar në ndonjë spital të afërt, kërkesa jonë nuk u mor parasysh. Përkundrazi, mbi këta të sëmurë e të rraskapitur u vërsulën si bishat në gjah kriminelët serbë, duke i goditur me shkopinj, me kondakë pushke e me shqelma. Prej tyre 23 vetë, të cilët pas rrahjes nuk ishin në gjendje të ngriten e ta vazhdojnë rrugën, i shpallën simulues dhe aty për aty i pushkatuan, kurse kufomat e tyre i hodhën në valët e Drinit.

Helmimi i rekrutëve shqiptarë

Në Kukës, para se ta vazhdonim rrugën, na dhanë për ushqim një mish gjysëm të tharë e pak të kryposur, që kundërmonte një erë të rëndë. Ndonëse dyshonim se ai mish ishte i prishur dhe mund të na helmonte, megjithatë uria e madhe na detyroi ta hanim. Nuk kishin kaluar as dy orë të plota kur u shfaqën simptomet e para të helmimit, të cilat manifestoheshin me dhembje stomaku, me barkqitje, me vjellje e me temperaturë të lartë.

Në këtë gjendje ishim të detyruar të largoheshim nga kolona për të kryer nevojë dhe për të gjetur ndonjë burim uji për ta shuar etjen, që na kish-

te kapluar, apo për t'u pastruar. Edhe pse eprorët tanë e dinin se ishim të helmuar dhe se kishim nevojë për t'i kryer nevojat fiziologjike, e veçmas për të pirë ujë, ata na pengonin dhe na urdhëronin të mos e lëshonim kolonën. Çdo përpjekje jona për t'u larguar nga kolona për nevojë apo për ta shuar etjen, na kushtonte me vdekje.

Eprorët kriminelë serbë, malazezë apo maqedonas, sipas një skenari të përgatitur paraprakisht, çdo krua apo burim tjetër të ujit buzë rrugës e shfrytëzonin për të nxitur ndonjë incident, duke bërë roje pranë burimeve të ujit. Ata vazhdimisht shtinin në drejtim të krojeve, duke na kërcënuar se do të na vrisnin nëse i afroheshim burimit të ujit apo nëse largoheshim sadopak nga kolona.

Për fat të keq, në gjendjen në të cilën ishim ne, as rafalet e armëve nuk na ndalonin t'ia mësynim burimeve të ujit për ta shuar etjen që na kishte kapluar. Kështu, një numër jo i vogël i ushtarëve - rekrutë gjeti vdekjen m'u pranë burimeve të ujit, pa pasur mundësi madje ta shuanin etjen para se të vriteshin. Edhe sot më rri në mendje dhe shumë herë më parafytyrohet vrasja e të riut, Alush Ramadani nga Krasmiroci i Drenicës, i cili gjeti vdekjen me kokë në burim, në një krua, pa arritur ta shuante etjen. Afër një përroni, 15 kilometra përtej Kukësit, tre ushtarëve - rekrutë shqiptarë, më parë të lidhur, ua prejnë veshët, vetëm pse kishin protestuar dhe kishin kërkuar që të ndërpritej terrori dhe keqtrajtimi ndaj tyre. Kjo ndodhi me Nazif Plakën nga Ferizaj, kur me një shok shkoi te oficeri që gjendej i ulur pranë një çezme dhe kërkoi nga ai që t'i lejonte edhe ushtarët tjerë t'i afroheshin kronit për të pirë ujë. Oficeri bëri sikur i lejoi ata të pinin ujë, por u kishte dhënë shenjë vartësve të tij të shtinin nga prapa mbi ta, duke i lënë të dytë të vdekur në vend, kurse të tjerët i kishte kërcënuar me likuidim të menjëhershëm.

Kjo mënyrë e likuidimit të ushtarëve shqiptarë ishte pjesë e strategjisë së okupatorit serb, malazez e maqedonas. Ata nxisnin dhe krijonin incidente, për të pasur pastaj shkase për të vrarë shqiptarë.

Krimet makabre nëpër malet shqiptare

Sa më shumë që i largoheshim Kosovës, përcjellësit tanë e tregonin gjithnjë e më shumë fytyrën e tyre të vërtetë, fytyrën e një bishe gjakpirëse. Në çdo hap ata i shtonin torturat dhe reprezaliet ndaj nesh dhe, siç dukej, këto reprezalie atyre u shërbenin si uvertyrë para shfaqjes së madhe "të natës së Bartolomeut", që do ta realizonin në Tivar, në Tregur, në Raguzë dhe në vende tjera të bregdetit Adriatik. Përcjellësit tanë serbë, malazez dhe maqedonas bënin gara mes vete se kush do t'ia kalonte tjetrit për egërsi dhe pashpirtësi.

Siç kemi thënë dhe më parë, përveç se na mundonin me uri, duke mos na dhënë fare ushqim, edhe më shumë na mundonin me etje, duke na penguar t'i afroheshim çfarëdo burimi të ujit

për t'u freskuar apo për ta shuar etjen. Po ashtu, për ne nuk kishte strehim as kur binte shi e as kur bënte të ftohtë. Natën e kalonim nën qiellin e hapur. Për ne nuk kishte as pushime, me përjashtim të disa pushimeve gjysëmorëshe, të cilat ishin, jo aq shumë për pushimin tonë, sa për të na plaçkitur. Këto "pushime" ne i shfrytëzonim kryesisht për t'i kryer nevojat fiziologjike, ngase ndryshe, gjatë marshimit, nevojat mund t'i kryenim vetëm në brekë. Në këto pushime kujdeseshim sadopak t'u ndihmonim shokëve të sëmurë e të lodhur, të cilët nuk mund të ecnin dhe që vazhdimisht kërcënoheshin me vrasje.

Edhe pse ishim aq shumë të lodhur e të rraskapitur, mbi 80 për qind e njerëzve tanë ecnin këmbëzbathur, nga se u ishin grisur opingat e lëkurës nga rrugëtimi i gjatë. Dhe, si mos të griseshin opingat, kur ishim të detyruar të kalonim nga 60 kilometra rrugë në ditë, sikur të ishim të dënuar me vdekje dhe sikur të ishin duke na dërguar për ekzekutim. Disa prej nesh, që ishin më të dobët fizikisht e që nuk mund t'u përballonin aq shumë stërmundimeve apo ishin të sëmurë e mbeteshin prapa në rresht, për "përcjellësit" tanë ishin simulues, prandaj mund të pushkatoheshin në çdo çast, aty për aty. Plumbin në kokë apo bajonetën në gjoks e merrte edhe ai ushtar i cili sadopak shmangej nga rreshti, qoftë edhe për ta lidhur këmbën që i rridhte gjak, qoftë edhe kur me kapelë donte të merrte një pikë ujë në ndonjë krua apo për raste të ngjashme.

Burimi i ujit - burim i vdekjes

Njësitë ushtarake jugosllave, që na përcillnin sipas një skenari, çdo krua apo burim tjetër të ujit buzë rrugës e shfrytëzonin për të krijuar incidente dhe për të pas shkase për të shtënë në ne. Për këtë qëllim pranë çdo burimi të ujit xhelatët në mënyrë provokative e ndalnin kolonën gjoja për të pushuar pak. Ata e dinin se në këto raste ne do të kërkonim leje për ta shuar etjen, kurse leja nuk na ipej dhe kështu krijoheshin skena të rënda kur dikush reagonte, protestonte apo pa leje tentonte të pinte ujë. Në këtë mënyrë ata merrnin shkas që kërkesat tona të arsyeshme t'i cilësonin si moszbatim të urdhërave e deri në tentim për kryengritje. Kështu edhe krijonin "arsye" për të na vrarë. Pos shumë rasteve tjera, i kësaj natyre ishte edhe rasti me Ymer Isufin nga Nisheci, i cili u vra bashkë me dy shokë të tij vetëm pse kërkoi leje për të pirë ujë. Pas këtij krimi të rëndë disa të rinjë shqiptarë, të prirë nga Qazim Zeqiri nga Klladernica, protestuan, por edhe protesta e tyre u cilësua si tentim për kryengritje. Dhe kështu nga kolona u ndanë dhe u pushkatuan 16 shqiptarë, ndërsa kufomat e tyre i rrokullisën në një greminë në shkrepat e thellë të pjesës së rrugës Fushë-Arrëz - Pukë.

Sipas Dr. Hakif Bajramit, përcjellësit serbë në një rast i kishin nxjerrë nga kolona dy rekrutë shqiptarë, të cilët më shumë u kishin rënë në sy sepse ishin të veshur me kostume kombëtare. I kishin pushkatuar ata në vend, me arsyetimin se gjoja

kishin tentuar të dezertonin! Por, nuk ishin kënaqur as me vrasjen e tyre, sepse nga kolona i kishin nxjerrë dhe i kishin pushkatuar edhe 20 rekrutë të tjerë, gjoja se edhe ata kishin kontribuar në tentimin për dezertim! Dr. Bajrami shkruan gjithashtu se afër Pukës kishin mbetur 72 rekrutë shqiptarë të sëmurë e të rraskapitur, të cilët nuk kishin mundur të ecnin. I kishin ndarë ata nga kolona duke i trajtuar si simulues e sabotues dhe i kishin pushkatuar. Këso rastesh e të ngjashme kanë ndodhur në kontinuitet gjatë tërë rrugës që nga Prizreni e deri në Shkodër, në Tivar e në Istri.

Mund të them se uria përballohej disi, kurse etja assesi, sidomos pas helmimit që na ndodhi. Etja po na çonte në çmenduri. Ka pas raste kur për ta shuar etjen dhe për t'iu shmangur çmendurisë, disa ishin të detyruar ta pinin urinën e vet apo të njëri - tjetrit, si dhe ta shuanin etjen me urinën e kuajve të përcjellësve tanë. Në një rast, në rrugën Fushë-Arrëz - Pukë, kur po urinonte kali i Bogolub Nedelkoviqit (udhëheqës i lartë i pasluftës në Kosovë, i cili ishte në përcjelljen tonë), e pinë nga pak urinë disa shokë tanë të kolonës.

Në këto rrethana, çdo burim i ujit përgjatë rrugëtimit tonë nëpër territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi ishte shndërruar në një mënyrë edhe në burim të vdekjes, siç ndodhi në qendër të Tivarit të Ri, që u gjet si shkas për masakrën e 31 marsit 1945 në Tivar.

Masakra në Fushë - Arrëz

Kolona me ushtarët shqiptarë arriti në Fushë-Arrëz më 29 mars 1945, rreth orës 18. Me qëllim të realizimit më të lehtë të skenarit, kriminelët na ndanë në grupe më të vogla. Meqë ishim shumë të lodhur e të rraskapitur, aty, nën qiellin e hapur e nën reshje të shiut, kaluam edhe një natë. Na zuri një gjumë i thellë. Mirëpo, diku pas mesnate kemi dëgjuar të shtëna me armë automatike, rafale të gjata. Duke mos ditur se ç'po ngjante, jemi ngritur në këmbë, por nuk pamë asgjë. Ramë dhe na zuri gjumi përsëri. Në mëngjes gojë pas goje u hap fjala se një njësit prej 120 - 140 vetëve ishin likuiduar në gjumë, kurse shumicën e kufomave të tyre i kishin hedhur në gremina të pafund e disa prej tyre i kishin hedhur në një hendek dhe i kishin mbuluar me dushk. Këtë masakër e kishin parë disa reparte të Eshalonit të Tretë, të cilat në natën e ditës së nesërme kishin kaluar aty pari. Ata kishin dëgjuar gjëmë dhe ofshamje, e kur ishin afruar, në humnerë kishin parë kufomat e shqiptarëve të kryqëzuara një mbi një. Ndër ta kishte pas ende njerëz të gjallë. Nga frika se do t'i diktojnë kriminelët, ishin kthyer fshehurazi në kolonë dhe me frikë të madhe e kishin kaluar natën.

"Sipas të dhënave arkivore serbe (A VII-B secret nr.53 dt. 8 - IV/45), në rrugën e eshaloneve në Fushë-Arrëz serbët kishin vrarë 126 shqiptarë në gjumë" (…)

Kështu, të rraskapitur kemi vazhduar rrugën drejt Pukës, ku kemi arritur rreth orës 19. Na kanë vendosur

në një luginë të rrethuar me pyje, kurse mbi ne vazhdimisht binte rrëke shiu. Të nesërmen dhjetra ushtarë mëngjesi i gjeti të vdekur, kurse shumë vetë ishin të sëmurë. Ata nuk kanë mundur ta vazhdojnë rrugën në kolonë, prandaj kanë mbetur në mëshirën e kriminelëve.

Qëndrimi i shkurtër në Shkodër

Pas këtyre skenave të tmerrshme, kolona e rekrutëve shqiptarë kishte vazhduar rrugën si një hije e zezë. Të lodhur e të rraskapitur, sa nga rruga e mundimshme, aq edhe nga pasiguria, nga etja dhe uria, në Shkodër kanë arritur më 30 mars 1945, në orën 16. Në Shkodër në të dy anët e rrugës na pritën mijëra qytetarë, shumica e të cilëve na përshëndesnin duke qarë e duke pështpëritur: "Ku po shkoni?", "Jeni në rrugën e pakthim". Shumë qytetarë na dhanë bukë, e sidomos na dhanë ujë, sepse kishim etje shumë të madhe. Një qytetar shkodran, i cili dukej se ishte i sektit bektashi, kur i pa vëllezërit kosovarë se si ishin katandisur, se si kishin mbetur pa opinga dhe se si këmbët u rridhnin gjak, ndaloi kolonën para dyqanit të vetë dhe të gjithë atyre që ecnin të zbathur u dhuroi këpucë. Kështu ai ndau rreth 250 palë këpucë dhe disa palë rroba për ata që ishin të veshur dobët. Shpejt na vendosën në një kazermë ushtarake, por më kujtohet se në të nuk kishte pasur ujë për pije.

Ndonëse në Shkodër e ndienim veten pak më të sigurtë dhe shpresonim se do të jemi nën mbikëqyrjen e organeve ushtarake shqiptare të shtetit amë, kjo shpresë shpejt u shndërrua në dëshprim.

Në Shkodër ranë edhe shumë viktima tjera. Rizah Llalloshi nga Hertica e Llapit, kishte apeluar në shtab që t'u lejohet edhe ushtarëve shqiptarë të pinin ujë nga cisterna, prej të cilës furnizoheshin me ujë eprorët tanë serbë, malazezë dhe maqedonas. Por, ende pa i thënë të gjitha fjalët, njëri oficer kishte urdhëruar ushtarët serb ta qëllonin, me ç'rast, pos Rizahut, aty pranë ujit, gjetën vdekjen edhe dy shokë të tij që e kishin shoqëruar. Por, nuk u vranë vetëm këta. Rreth orës 1, pas mesnate, në momentin kur u dha urdhëri që brenda 15 minutave të rreshtohemi në oborrin para kazermës në kuadrate prej nga 100 vetëve, u vranë edhe 11 ushtarë të tjerë. Pasi një numër mjaft i madh i ushtarëve shqiptarë nuk kanë mundur të dalin aq shpejt, sepse ishin të lodhur e të sëmurë, u rrahën aq fort nga përcjellësit – eprorët e ushtarët serbë, sa 13 prej tyre nuk lëviznin fare, kurse menjëherë ata i shpallën se po shtiren dhe aty për aty i pushkatuan. Për këtë krim të shëmtuar flasin edhe ata ushtarë shqiptarë të Eshalonit III, të cilët të nesërmen në dhoma të kazermave i gjetën 11 kufomat e ushtarëve shqiptarë të Eshalonit II, të cilat i kishin mbuluar me kashtë.

Pas mesnate, më 31 mars 1945, u vazhdua rruga për Tivar. Xhelatët e pashpirtë nuk ishin ngopur me gjak, por, sipas skenarit, me të dalë nga Shkodra, në mes të rrugës, në një gjatësi 10 - 20 metra, kishin vënë një shtresë eksplozivi - lëndë shpërthyese.

Në orën tre pas mesnate, kur kolona shkeli mbi të, eksplodoi në seri prej 4 - 5 detonimesh të një pas njëshme, ku humbën jetën 35 shokë tanë dhe mbetën shumë të plagosur. Edhe në këtë rast fajin ia mveshën "reakcionit shqiptar!".

Provokimi i ushtarit malazias

Sipas skenarit, secilën urë që ishte e shkatërruar nga nazistët, eprorët tanë e shfrytëzonin për të krijuar ndonjë incident, në mënyrë që pastaj të kishin shkase për të vrarë ushtarë shqiptarë. Kështu ishte te ne dhe ngjashëm, ndoshta edhe me keq, ishte nëpër eshalonet tjera. Kësisoj, sipas dr. Hakif Bajramit, ndodhi me një rast në lumin Drin, afër Bushatit, ku ura e improvizuar në formën e një teleferiku u këput dhe me këtë rast gjetën vdekjen 17 shqiptarë, ndërsa 6 të tjerë, që dinin notin, kishin shpëtuar.

Rasti tjetër ndodhi në urën e Gomsiqes, kur në një vagonetë të improvizuar i ngarkuan 50 veta. Natyrisht, edhe këtu teleferiku i improvizuar, sipas skenarit, u këput, me ç'rast gjetën vdekjen 36 ushtarë, kurse 14 të tjerë u lënduan rëndë. Pasi nuk u dha asnjë sqarim për fatin e të lënduarëve, kurse nuk u kthye asnjëri prej tyre në shtëpi, supozohet se edhe ata janë likuiduar, sikur janë likuiduar edhe shumë shokë tjerë të tyre. Ngjashëm ndodhi edhe në Vaun e Spases, në lumin Buna, kur nga njëra anë e lumit në tjetrën kaluan 20 trajekte (lloj anije) me më shumë se 1100 ushtarë shqiptarë. Në trajektin 21, në mesin e 55 shqiptarëve, sipas skenarit, e futën edhe një ushtar malazez nga ata që mbanin rendin dhe që na përcillnin. Posa trajekti arriti në mesin e lumit, ushtari malazez, që ishte në trajekt, kërceu në lumë, duke lëshuar britma të mëdha dhe duke u shtirë se po kërkonte ndihmë nga eprorët e tij, me fjalët: "Pobuna, u pomoç, pucajte, ubishe me shqiptari", etj. (Kryengritje, ndihmë, qëlloni, më vranë shqiptarët etj). Me këtë rast kriminelët, që ishin në gjendje të lartë gatishmërie, qëllonin nga të gjitha anët dhe nga të gjitha llojet e armëve në të dy anët e lumit, duke vrarë 234 ushtarë shqiptarë dhe duke plagosur shumë të tjerë.

Në ato çaste dramatike disa ushtarë shqiptarë nga Shqipëria, duke kaluar andej pari me motoçikleta, kishin dëgjuar të shtënat dhe britmat e ushtarëve shqiptarë, të cilët kërkonin ndihmë dhe kishin ndërhyrë te ushtarët jugosllavë për t'u ndërprerë zjarri. Prania e ushtarëve nga Shqipëria në vendin e ngjarjes në lumin Buna tregoi edhe një të vërtetë: Po mos të vinin në atë moment e të ndërhynin ata për ndërprerjen e zjarrit, forcat jugosllave do t'i likuidonin të gjithë, deri në ushtarin e fundit shqiptar (Edhe në Detin Adriatik, diku afër Raguzës, në një rast tjetër të eksplodimit në një anije, kishin humbur jetën 27 rekrutë shqiptarë. Në atë moment tragjik, nga frika e trishtimi, ishte çmendur Ymer Greiçevci. Në vend të ndihmës mjekësore e humanitare, atë e pushkatuan, kurse kufomën ia hodhën në det, me justifikimin se gjoja atë e kishte vrarë reakcioni

ustash dhe ai çetnik).

Fajin për të gjitha këto raste ia veshën "reakcionit shqiptar", se ai gjoja kishte arritur të infiltrohej në radhët e këtyre eshaloneve përmes disa hoxhallarëve (!) etj.

"Do t'u vrasim të gjithëve, he..."

Sa më afër Tivarit, siç kemi thënë edhe më parë, gjakpirësit serbë, malazias e maqedonas i shtonin torturat, reprezaliet, inskenimet e incidenteve, si dhe vrasjet ndaj nesh. Edhe eprorëve më të ulët, që ishin ushtarë serbo – malazez e që ndodheshin në përcjelljen tonë, nëse u tekej, mund ta ndanin cilindo prej nesh nga kolona e ta bënin shoshë me automatik apo ta therrnin me bajonetë e kufomën pastaj ta shtynin me majë të çizmes në greminë apo në ndonjë hendek, për t'ua lënë pre korbave të zi apo bishave të egra për ushqim. Këtë fat të zi e patën dhjetra eprorë të deritashëm ushtarakë shqiptarë të kolonës sonë, pastaj njerëz me autoritet dhe ata të cilët më parë ishin të rënë në sy apo mbanin ndonjë simbol apo rrobe të dalluara kombëtare. Nga ata që kanë pësuar në këtë mënyrë, kam njohur Xheladin Rrustemin nga Resniku i Vushtrrisë, Ahmet Poterën e Muhamet Poterën nga Llapashtica e Llapit, Selim Xheladinin nga Prekazi, Rrustem Sylën nga Luboveci etj.

Nga këto tortura dhe reprezalie, që na bëheshin gjatë tërë rrugës, sigurisht më së vështiri e kanë pasë ata që ndodheshin në fund të kolonës, sepse kanë pasur rastin më shumë t'i shohin gjurmët e gjakut dhe, më saktë, t'i numronin viktimat. Por, sigurisht se në këto rrethana pak kujt i ka shkuar mendja t'i numëronte kufomat, ngase në çdo moment ekzistonte mundësia që edhe vetë të bëhej viktimë e eprorëve të tërbuar. Instikti i vetekzistencës dhe rreziku që në çdo moment mund të likuidoheshin edhe të tjerët, nuk lejonte të mendohej tjetër, por vetëm se si të shpëtohej jeta. Këtë gjendje psiqike e rëndonte dhe e bënte edhe më të tmerrshme ndeshja në kufoma dhe në gjurmë të gjakut gjatë tërë rrugës. Në këtë pjesë të rrugës sharjet dhe ofendimet, si "shiptarsku vam majku", "osvetice se cernagorska omladina", "sve cemo vas ubiti", "necete se vishe zhiv vratiti" (nënën shqiptare, do të hakmerret rinia malaziase, të gjithëve do t'ju vrasim, nuk do të ktheheni më të gjallë) etj., ishin "përshëndetjet" më të shpeshta që na drejtoheshin nga eprorët dhe përcjellësit tanë, duke na provokuar vazhdimisht dhe duke i shtuar reprezaliet ndaj nesh. Edhe nëse ndonjëri nga ne ishte i gatshëm që nga revolta të reagonte, duke e ditur se do ta paguante me kokë, këtë nuk e bënte, sepse e dinte se pos tij do të pësonin edhe shumë të tjerë.

Sa ishte numri i ushtarëve shqiptarë të cilët humbën jetën pa gjurmë gjatë rrugës Prizren - Shkodër e deri në kufi të Malit të Zi, edhe pse pjesën më të gjatë të saj e kaluam nëpër tokën e Shqipërisë nënë, askush nuk e di dhe as që do ta dijë ndonjëherë saktësisht. Ndonëse sipas të dhënave të disa dëshmitarëve, si të Hajdin Halilit nga Krasmiroci, të

Rizah Hajdinit dhe të Selim Sinanit nga Baksi e të shumë të tjerëve, të cilët kanë deklaruar se janë përpjekur t'i numrojnë viktimat dhe t'i evidencojnë gjurmët e gjakut dhe gjurmët tjera të viktimave gjatë tërë rrugës Prizren – Kukës – Shkodër e deri në kufirin me Malin e Zi, del se ky numër arrin në rreth 800 vetë. Ndërsa, sipas të dhënave të Prof. Ymer Berishës dhe të Bajram Golës, ish - oficer i Armatës jugosllave, ky numër arrinë në 700 vetë, që mund të merret si numri më i saktë, e jo 30, edhe ata të sëmurë dhe dezertorë, siç del nga raporti i shtabit të kolonës dhe, mjerisht, të disa "konstatimeve historike" të ndonjë doktori shqiptar të historisë.

Kështu të lodhur e të rraskapitur nga rruga, nga uria e nga etja, por edhe nga pasiguria, e kaluam rrugën nëpër territorin e Shqipërisë. Me të hyrë në kufirin e ish-Jugosllavisë, afër Tivarit, na kanë urdhëruar që të ndalet kolona gjoja për pushim, kurse të gjithë të sëmurët dhe të plagosurit që ishin me ne, të ndahen në një vend të veçantë, gjoja për ta evituar ndonjë epidemi të mundshme. Sipas të gjitha gjasave edhe këta fatmjerë i gjeti fati i njëjtë i atyre të cilët kishin pësuar më parë. Tashmë kriminelët bisedonin mes vete më me zë se si duhej të silleshin ndaj shqiptarëve, duke mos e kursyer as fjalorin me fyerje e kërcënime: "Druzhe komandante, sve je spremno. Samo minuti su u pitanju. Sve cemo ih strelati" (Shoku komandant, çdo gjë është gati. Presim vetëm minutat. Të gjithë do t'i pushkatojmë) etj.

Në një rast një kapiten, duke i raportuar një oficeri tjetër të lartë, i cili quhej Roloviq, që e përcillte kolonën i hipur në kalë, në mes tjerash, thotë: "Druzhe komandante, vojska je spremna da izvrshi zadatak. Sve je spremno!" (Shoku komandant, ushtria është e gatshme ta kryejë detyrën. Gjithçka është gati). Komandanti përgjigjej duke i përsëritur me zë të ultë e neveritës frazat: "Samo minuti su u pitanju! Sledi naregjenje: Znakom pucanja iz topa velikog kalibra (Presim vetëm minutat. Pason urdhëri: Me shenjën e të shtënës nga topi i kalibrit të madh). Kështu, të lodhur e të rraskapitur nga rruga e gjatë, nga etja dhe uria, nga pasiguria që na e kishte rënduar edhe gjendjen psiqike, vetëm sa nuk pëlcisnim. Dhe, përkundër të gjitha këtyre ngarkesave fizike e psiqike, ishim të detyruar që patjetër ta vazhdonim rrugën.

Kapitulli III – TIVARI

ARRITJA E KOLONËS NË TIVAR

Kur eshaloni i parë ka mbërri më 30 mars 1945, rreth orës 13 në Tivar, është vendosur në një objekt afër Portit të Tivarit. Aty eshaloni me regrutë shqiptarë u nda në tri njësi apo në tri grupe:

Njësia e parë, me 1200 ushtarë shqiptarë, në mëngjesin e 31 marsit 1945, deportohet me anije në veri, drejt Frontit të Adriatikut.

Njësia e dytë, që numronte 400 - 500 ushtarë shqiptarë, vendoset në një barakë të madhësisë 150 m2, që gjendej në afërsi 200 - 250 metra në verilindje të ndërtesës së Monopolit të Duhanit. Edhe këta pritnin për t'u deportuar në vijën e Frontit të Adriatikut.

Njësia e tretë përbëhej prej 450 - 500 ushtarëve shqiptarë, pjesëtarë të Eshalonit të Parë. Para se të fillonte sulmi masiv mbi ta, ushtarët shqiptarë u dërguan në një luginë, në Tivarin e Vjetër, gjoja për t'i pastruar rrobat nga morrat e shumtë. Me të arritur në atë vend, rreth orës 12 apo 13, u befasuam, kanë thënë përjetuesit. Ata kanë vërejtur një mobilizim të theksuar të forcave ushtarake dhe të popullatës civile. Qëndronin me armë të drejtuara në drejtim të ushtarëve shqiptarë. Sapo kishte filluar sulmi mbi ushtarët shqiptarë në Tivar të Ri, kishte pasuar urdhëri që të shtrihen ushtarët përmbys, me fytyrë për toke. Ushtarët shqiptarë, të shtangur dhe të tronditur nga kjo skenë tmerruese e kriminale, nuk kanë ditur se çka të bëjnë. Të hutuar, ata vetëm shikonin para vetes dhe prisnin se çka do t'u sjellë secili çast i ardhshëm. Kur askush nuk kishte bëza më, oficerët i kishin kërcënuar, duke bërtitur se do t'i likuidonin të gjithë, një nga një.

Dhe vërtet, heshtjes së ushtarëve iu përgjigjën me tërbim. Kjo më së miri shihet nga rasti i raportimit që ia kishte bërë një toger një kapiteni, kur i kishte thënë: "Shoku kapiten, njësiti ushtarak është i gatshëm për zjarr!". Kurse kapiteni i ishte përgjigjuar: "Po presim përforcime të reja e pastaj do të pasojë urdhëri për zjarr". Në këto çaste dukej sikur asgjë nuk po lëvizte. Fitohej përshtypja sikur ishte zënë dielli. Edhe sekondat dukeshin të ishin shumë të gjatë. Këtë heshtje të përmortshme papritmas e kishte shpërthyer zëri i një oficeri të lartë, të hipur në kalë, kur kishte urdhëruar: "Vojnici, ne pucajte do daljeg" (ushtarë, mos shtini deri në urdhërin tjetër!), sepse vëzhguesit amerikanë kishin ardhë aty, rreth nesh. Kështu, falë pranisë së vëzhguesve amerikanë, ky njësit i ushtarëve – rekrutë shqiptarë i shpëtoi masakrës së përgatitur për të.

Eshaloni i Dytë në Tivar

Me të arritur në Tivar, në çdo skutë të qytetit vërehej një mobilizim i madh i ushtrisë dhe i popullsisë. Me armë në dorë, të mbajtura drejt nesh, drejt kolonës me ushtarë shqiptarë, të gjithë na shikonin me përbuzje të madhe. Kuptohej qartë komploti që po na bëhej dhe gracka që po na përgatitej. Qeniet tona të pafajshme, të lodhura deri në vdekje, tash u gjetën në shënjestër të pushkëve, të mitralozave, të minahedhësave, të trombllonave dhe të armëve tjera, që ishin vendosur në çdo kënd të rrugëve, dritareve dhe terracave të shtëpive, në shkëmbinjë e kodra përreth. Fitohej përshtypja se nga kjo bllokadë as zogu s'do të mund të shpëtonte i gjallë.

Në qendër të Tivarit të Ri na kanë urdhëruar të ndalemi dhe të ulemi në mes të rrugës, gjoja për pushim. Në afërsi të rrugës kishte qenë një krua, nga i cili rridhte pandërprerë ujë. Pasi ishim shumë të etur, u morëm vesh që tre shokë tanë; Jahir Murtezi, Ramadan Mihaliqi dhe Sylë Ali Morina (Gllabari), të ngriten në këmbë dhe të kërkojnë leje nga oficeri, i cili e kishte bllokuar kronin apo çezmën, në mënyrë që edhe ushtarët shqiptarë të pinin ujë, ashtu siç pinin eprorët e ushtarët serbë e malazias që ishin në përcjelljen tonë. Mirëpo, me të paraqitur të kërkesës, oficeri u mërdhez dhe filloi bërtimën e kërcënimet me fjalë fyese: "shiptarsku vam majku, crknite svi, do jednoga" (Nënën shqiptare, ngordhni të gjithë, deri te i fundit) etj. Në çastin kur Syla me shokë u përpoq ta arsyetonte kërkesën, përnjëherë oficeri ka urdhëruar ushtarët të vërsulen mbi të me armë zjarri, me ç'rast i goditën për vdekje dy shokët që e shoqëronin Sylën. Nga plumbat që kishin bredhur anash u plagosën disa shokë tanë në kolonë dhe ndoshta edhe "një ushtar malazez". Kurse Syla, si më i zhdërvjellti, nën rrebeshin e plumbave, arriti të futej në kolonë. Mirëpo, oficerët me ushtarët e tyre iu vërsulën prapa dhe posa e gjetën, u hudhën mbi të, ashtu siç vërsulen bishat mbi gjah, duke e bërë "shoshë" me automatikë dhe me bajoneta, me pretekstin se ai gjoja e kishte vrarë ushtarin malazez. Ne të tjerët, pas këtij akti kriminal, mbetëm të shtangur në mes të rrugës, pa pasur guximin as të lëviznim e as të bisedonim mes vete. Ashtu, siç ishim në ankth, prisnim se çka do të bëhej më tutje me ne, pasi na i kishin drejtuar tytat e armëve dhe i kishin bërë gati bajonetat. Për një çast ushtria u tërhoq rreth 50 metra larg nesh dhe zuri pozita më të mira; dikush pas shkëmbinjve, dikush pas mureve të shtëpive e disa edhe brenda mureve. Dhjetë apo pesëmbëdhjetë minuta më vonë nga komanda e lartë ushtarake arritën edhe tre oficerë të lartë dhe shumë eprorë dhe ushtarë tjerë. Ardhjen e tyre ne e pritëm me një fije shprese se ndoshta ata do t'u jepnin fund këtyre vrasjeve dhe torturave të papara ndaj nesh. Mirëpo, edhe këto shpresa ishin të kota, sepse njëri nga oficerët e lartë zuri pozitë në një lartësi dhe filloi të na drejtonte fjalë ofenduese dhe kërcënuese, si na kishin drejtuar edhe herave tjera, si: "Shiptarsku vam majku… (Nënën

shqiptare...), “sve çemo vas ubiti” (të gjithëve do t’u vrasim), “neçete odavde izvuçi ni zhivu gllavu”... (nuk mund të dilni nga këtu të gjallë...), “Samo minuti su u pitanju” (vetëm minutat janë në pyetje...) etj.

100 ushtarë shqiptarë - për një ushtar malazias

Nuk ka vonuar shumë dhe përmes autoparlantit është komunikuar se gjoja një ushtar - rekrut shqiptar kishte tentuar t’ia rrëmbente revolen një oficeri serb, kur ai e kishte vrarë Sylën. Andaj, kjo dhe kërkesa e arsyeshme për të pirë ujë, serbëve u shërbeu si pretekst për ta kualifikuar këtë si tentim për kryengritje, për çka na u kërcënuan me masa më drastike. Mirëpo, ne të gjithë tashmë e dinim se ky ishte vetëm një trillim, si bazë për një masakër me përmasa të mëdha.

Pas disa çasteve të heshtjes “së varrit”, u ngrit në këmbë njëri nga të rinjtë shqiptarë, për të cilin më vonë mësuam se ishte Ymer Sinani nga Kozhica e Drenicës, i cili, pas konsultimit me shokë, ishte drejtuar kah oficerët me kërkesë dhe thirrje që ata t’u japin fund vrasjeve, maltretimeve dhe sjelljeve barbare ndaj shqiptarëve duarthatë. Por, pa u afruar mirë, në të u vërsulën ushtarët serbë e malazezë me armë e me bajonetat, që i kishin vënë në tytat e pushkëve, duke e copëtuar Ymerin si të ishte një lakër, klithjet e të cilit na tmerruan të gjithëve. Ndërkaq, kriminelët atë skenë e përcillnin me duartrokitje, me këngë e hare.

Të shtrënguar dhe të tronditur nga këto skena të tmerrshme, ne nuk dinim se çfarë të bënim, çka të flasim dhe çka të veprojmë. Të hutuar e me sy të zgurdulluar, vetëm shikonim para vetes dhe pritnim se çka do të sjellë secili çast, secila minutë e çdo sekond i ardhshëm. Këtë heshtje mortore papritmas e theu njëri prej oficerëve të lartë, kur, si i tërbuar, urdhëroi, duke e vënë dorën në mes të kolonës dhe duke thënë: “Prej këtu të ndahen 100 shqiptarë për pushkatim!” (dhe jo 40, sipas A. Rankoviqit dhe as 20, sipas njërit nga doktorët shqiptarë të historisë). Shkasi ishte se gjoja pranë një kroni ishte vrarë një ushtar malazez nga një ushtar shqiptar. Atyre 100 vetëve ua lidhën duart dhe duke i rrahur me shufra metalike e duke i therrë nga prapa me bajoneta, i strehuan në një kënd mes disa shtëpive, nja 50 apo 60 metra larg kolonës. Nga goditjet e rënda, disave u është ndarë koka në dysh dhe i janë derdhë trutë në tokë. Pasi u ngopën me rrahje e therrje, ata shtinë me armë zjarri, derisa askush nuk lëvizte më e nuk jepte shenja jete.

Pasi vendi ku u bë ekzekutimi (pushkatimi) ishte i ngushtë, kufomat dhe të plagosurit binin njëra mbi tjetrën. Disa persona, duke u gjendur nën kufoma, kishin shpëtuar të gjallë. Por, xhelatët, për t’i qitur në sipërfaqe dhe për t’i goditur edhe njëherë ata që eventualisht kishin mbetur të gjallë nën kufoma, hodhën bomba dhe granata mbi ta dhe nga bombat fluturonin trupat dhe gjymtyrët e shkëputura. Kështu, ata që gjendeshin nën kufoma dolën në sipërfaqe dhe u terror-

izuan edhe njëherë nga xhelatët e pashpirtë.

Në momentin e fundit, kur askush nuk jepte shenja gjallërie, filloi një sulm i ri masiv ndaj ushtarëve tjerë shqiptarë që ndodheshin në depo, në oborr, në shesh dhe në qytet, ku kriminelët u orientuan në asgjësimin e tyre. Në ndërkohë kishte rënë errësira e natës.

Me këtë rast Ymer Sherifi nga Krajkova kishte marrë 16 plagë në trup, tetë prej të cilave në kokë. Para se të mblidheshin kufomat dhe të plagosurit, Ymeri e kishte mbledhë forcën e fundit që i kishte mbetur dhe kishte dalë mbi kufomat. Duke u zvarritur, pa u parë nga askush, u ishte bashkangjitur atyre që i kishin shpëtuar masakrës dhe kishin dalë në stere (pranë detit), prej nga të nesërmen një oficer dalmatinas e kishte dërguar në spitalin e Milloçerit. Por, edhe në spital e kishin trajtuar si armik dhe e kishin refuzuar pranimin e tij, prandaj eprori dalmatinas e kishte dërguar në një spital tjetër, në spitalin e Melinës, ku pacienti ishte paraqitur si i plagosur në luftë me gjermanët. Tri herë e kanë operuar, duke ia nxjerrë plumbat dhe copat e granatave, por tri copa edhe sot, pas 75 vjetëve, i mbanë ende në kokë, pa guxuar t'i tregoj kujt se i kishte marrë në Tivar.

Me të përfunduar të aktit mizor, meqenëse ishim në kolonë në gjatësi prej 5 - 6 kilometrave, kurse mundësia për një shfarosje masive ishte pak më e vogël, na kanë urdhëruar të ngritemi në këmbë e t'i hedhim në një vend të caktuar bastunet, apo si i quanim ne, krroqet, të cilat na shërbenin të mbaheshim gjatë asaj rruge të gjatë e të mundimshme. Na urdhëruan të qëndrojmë në vend me duar të lidhura mbi kokë. Pas pak na kanë urdhëruar të ecnim drejt një ndërtese të madhe trikatëshe, me një sipërfaqe afërsisht prej 300 metrave katrorë, për të cilën mësuam më vonë se kishte qenë ndërtesa e Monopolit të Duhanit. Ndërtesa ishte e rrethuar nga të tri anët me kodra shkëmbore dhe në veriperëndim me det të gjerë, kurse oborri ishte i rrethuar me mur të lartë dhe me rrethojë të hekurit, me maje të mprehta, që krijonte kushte shumë të volitshme për likuidimin tonë, pavarësisht nëse ndodheshim në oborr apo brenda në ndërtesë.

Hyrja në oborrin e ferrit

Me të hyrë në oborrin e Monopolit, pamë se në të dy anët e hyrjes ishin të vendosur nga 10 deri 15 ushtarë serbë të përgatitur me shufra hekuri në dorë. Secili prej nesh, kur hynte nëpër atë hyrje, goditej në kokë, në gjoks apo në shpinë me shufër hekuri. Ishte e pamundur të kalosh nëpër atë hyrje të ngushtë e të mos marrësh goditje. Kishte nga ne që nuk mund t'i përballonin të rënat dhe mbeteshin në vend. Ai i cili mbetej i shtrirë nga goditjet, shkelej nga turma, e cila detyrohej të kalonte nëpër atë hyrje, kurse askush nuk kishte mundësi t'i ndihmonte. Vetëm gjatë kësaj hyrjeje në oborr kanë mbetur të shtrirë në tokë 100 deri 150 vetë, shumica prej të cilëve pastaj kanë vdekur.

Ashtu të përgjakur dhe të rraska-

pitur, rreth 1000 rekrutë shqiptarë, sa ishim në kolonë, na futën në atë ndërtesë. Pasi ndërtesa u mbush plot, në oborr kishin mbetur edhe 2200 deri 2500 vetë, kurse në rrugën, të gjerë 7 – 8 metra e të gjatë 80 – 100 metra, mbetën të rrethuar edhe 1000 - 1100 vetë, por tani jo më të rreshtuar, por të grumbulluar. Ky grumbullim u bë për shkak se në këtë mënyrë bëhej likuidimi më i lehtë i tyre.

Me të përfunduar të këtij aksioni, kriminelët, sipas skenarit, kapën Ramiz Loshin nga Çardaku, vetëm pse ai ishte i dukshëm dhe i veshur me rrobe kombëtare, por pretekst kishin se ai gjoja ishte personi i cili kishte tentuar t'ia marrë revolen oficerit serb, ashtu si e kemi përshkruar këtë rast edhe më parë. Edhe pse Ramizi i prapësoi akuzat, mbi trupin e tij, para syve tanë, u zbraz një karikator i revolverit, duke e bërë pastaj trupin e tij copa – copa me bajoneta.

Edhe pse e dinim se gjakatarët e pashpirtë po përgatisnin masakër tjetër ndaj nesh, i riu 17 – vjeçar, Ibrahim Koca nga Polaci i Drenicës, së bashku me 7 shokë të tjerë, shkuan te Komanda e Shtabit, e cila ishte e vendosur në oborr dhe ishte duke komanduar: "Udri majku njihovu shiptarsku, neka znaju da je ova Crna Gora i da çemo sve do jednog zaklati..." (qëlloje, he nënën e shqiptarit, le ta dinë se këtu është Mali i Zi dhe të gjithë këta do t'i presim...). Ata kishin dy qëllime:

- shufra hekuri, dhe
- të lejoheshin t'u ndihmonin shokëve të lënduar, të cilët kishin mbetur në hyrje të ndërtesës nga të rënat që kishin pësuar.

Para se Ibrahim Koca ta bënte paraqitjen e kërkesave të përmendura, me urdhërin e komandantit janë vërsulur mbi të shumë ushtarë, e kanë ngulur në bajoneta dhe ashtu e kanë ngritur lart, pastaj e kanë gjuajtur në një shkëmb, që ta shihnim ne më lehtë. Pastaj, në mënyrë mizore Ibrahimit ia kanë prerë hundën, veshët, krahët, duke e bërë copa - copa. Pas këtij akti barbar, Shtabi dhe ushtarët serbë janë tërhequr anash, rreth 100 - 150 metra pas shkëmbinjve, për t'i lënë vend finales së tmerrshme.

E shtëna me top - sinjal për sulm masiv mbi shqiptarët

Në ato çaste të vështira, te ne kishte rënë një heshtje varri. Të tronditur nga këto skena të tmerrshme që po i përjetonim, ne nuk dinim se çka të bënim, por vetëm prisnim dhe shikonim se çka do të sillnin çastet në vijim. Atë heshtje e theu një e shtënë me top të kalibrit të madh, e cila forcave ushtarake dhe civile u shërbeu si sinjal për të hapur zjarr mbi ne nga të gjitha anët dhe nga të gjitha llojet e armëve. Rrebeshet e plumbave të armëve të ndryshme vinin drejt nesh nga çdo anë; nga oborri, nga shtëpitë, nga shkëmbinjtë, nga dritaret, nga pullazet e shtëpive... Rreth ndërtesës, oborrit dhe qytetit ishin improvizuar me kohë pesë punkte, prej nga shtinin si në egërsira; me mitroloz, me mortaja, me trombllona, me topa dhe me armë tjera të zjarrit. Përveç armëve të zjarrit, ushtarët dhe qytetarët në këtë sulm

ndaj nesh përdorën edhe armë të ftohta, si: bajoneta, thika, sëpata, këmesa, tëfurqe etj. Nga detonimet na dridhej toka nën këmbë. Bubullima e armëve shoqërohej me klithmat e të rinjëve shqiptarë, por edhe me ulurimat e kriminelëve, që shtinin në ne duke na sharë e duke na fyer dhe në këtë mënyrë duke u kënaqur si sadistë me aktet e veta shtazarake. Nga çdo anë fluturonin copat e trupave; këmbë, duar dhe gjymtyrë tjera. Qielli ishte errësuar plotësisht, dukej sikur ishte muzgu i mbrëmjes. Rrezet e diellit mezi depërtonin nga pluhuri, nga tymi e flaka e barotit, ndërsa gjaku ecte sikur uji pas shtrëngatës.

Me intensitet të njëjtë dhe me të gjitha llojet e armëve sulmuan edhe njësitin e dytë të Eshalonit të Parë, që numëronte 450 – 500 vetë, e që ishte i vendosur në një barakë nja 200 – 250 metra në verilindje të Monopolit të Duhanit. Ky njësit po priste komandën për nisje drejt Frontit të Adriatikut, por...

Nga të shtënat e fuqishme të granatave dhe të armëve tjera të zjarrit u ngrit në ajër baraka bashkë me ushtarët shqiptarë që gjendeshin në të. Shaqir Demën e shumë të tjerë granatat e këputën në bel, kurse gjysma e trupit i kishte fluturuar në ajër. Aty gjetën vdekjen mbi 420 ushtarë shqiptarë të njësisë së dytë të Eshalonit të Parë. Ndër ta ishin Ymer Feka dhe Hysen Rexhepi nga Llajkoci, Kadri Selmani nga Gemnica, Shaqir Arifi nga Sfirca, Musli Klaiqi e Hysen Klaiqi nga Tugjeci e shumë të tjerë.

Kësisoj, brenda dy orëve nga grumbulli i dendur i shqiptarëve (mbi katër mijë vetë që ishin të vendosur në oborr, në rrugë dhe në qytet), asnjë nuk mbeti pa u qëlluar me armë. Kështu, tërë ajo hapësirë u shndërrua në lumë gjaku, që i ngjante një kataklizme të vërtetë.

Tavanat u bënë ujëvare gjaku, dyshemetë - liqene gjaku

Krahas sulmit në oborr, në shesh e në qytet, me armë të njëjta dhe me intensitet të njëjtë na sulmuan edhe brenda ndërtesës. Nga të shtënat e armëve, nga granatat e bombat, tavanet e ndërtesës filluan të bijnë mbi kokat e njerëzve dhe ato sikur u shndërruan në ujvare, ndërsa dyshemeja - në liqe gjaku. Në njërën prej kateve nga të shtënat u rrënua i tërë tavani. Bashkë me tavanin ra një numër i madh i ushtarëve të gjallë, kryesisht të plagosur. Ata ranë mbi kokat e ushtarëve tjerë që ishin një kat më poshtë. Gjatë sulmit, ne që ishim në dhoma e që ende nuk ishim goditur, siç thonë Isuf Halili e Sylë Ferizi, apelonim te shokët në dhomë:

- që askush të mos ngritet në këmbë, sepse ishin në shënjestër të armëve të kurdisura në shkëmbinjtë përreth, nëpër kodra dhe vende të ndryshme përballë dritareve,

- që bombat e hedhura nga jashtë, ende të pashpërthyera, të cilat binin në dhomë, të kapen me kujdes dhe të hidhen jashtë,

- të pengohet dalja nga dhoma si dhe lëvizjet nga vendi, sepse kushdo që ngritej në këmbë apo ia mësyente të dilte jashtë, qëllohej me armë zjar-

ri nga dritaret,

- në rast se kriminelët përpiqen të hyjnë brenda nëpër dhoma, rekrutët të përgatiten për kundërsulm deri në vdekje, dhe

- të pengohet kërcimi nga dritaret, të pengohen vetëvrasjet e t'u ndihmohet të plagosurve dhe atyre që pësuan psikikisht.

Më kujtohet se një pjesë e atyre që pësuan psikikisht, por edhe të tjerë që ishin në dhomat në katet e epërme të monopolit, pas pak ranë në njëfar kome të thellë dhe më nuk lëviznin e nuk dinin asgjë.

- Në këtë mënyrë u lehtësuam sadopak, thotë Isuf Halili, sepse më nuk kishim nevojë të angazhoheshim rreth shpëtimit të tyre, ndërsa, në anën tjetër, kishim mundësi më të mëdha të merremi me vetorganizimin, sepse prisnim sulm të ri nëpër dhoma.

Trauma psiqike me pasoja të rënda për tërë jetën, përveç shumë të tjerëve, pësuan edhe Qerim Syla nga Krasmiroci i Drenicës, Ymer Greiçeci nga Greiçeci, Haxhi Kadriu, nga Pokleku, Ahmet Bytyçi nga Kravaseria, Adem Hoxha nga Krileva, Muhamet Mahmuti, nga Peçani, etj.

Shtabi ushtarak lëshonte proklamata të rrejshme

Nga grumbulli i dendur i shqiptarëve, ishin mbi katër mijë vetë në oborr, në rrugë, në sheshe dhe në qytet, brenda dy orëve asnjë nuk mbeti në këmbë pa u qëlluar me armë. Kriminelët, për t'i zbuluar të plagosurit dhe ata që ende nuk ishin goditur nga armët e zjarrta, lëshonin proklamatë pas proklamate, në të cilat afërsisht thuhej kështu:

- Informohen të gjithë ata të cilët kanë mbetur gjallë ose janë të plagosur se komandanti suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, shoku Tito, ka urdhëruar ndërprerjen e zjarrit dhe i ka falur të gjithë, pavarësisht prej gabimeve që kanë bërë,

- të gjithë të plagosurëve do t'u ipet ndihma mjekësore dhe, sipas nevojës, do të dërgohen për shërim, kurse të plagosurit lehtë dhe ata që nuk janë të lënduar, të ngriten në këmbë dhe të tubohen në një vend. Ndërsa të plagosurit rëndë, të cilët japin shenja gjallërie, të paraqiten për ndihmë mjekësore,

- në fund ata kërkonin nga të gjallët të brohorisnin në serbisht parullat: "Rroftë shoku Tito", "Rroftë bashkim - vëllazërimi", "Rroftë Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë" etj.

Duke menduar se thirrjet nëpërmjet proklamatave megjithatë ishin të çiltra, shumica e të plagosurve dhe e atyre të cilët nuk ishin të plagosur filluan të ngriteshin e të tuboheshin në një vend dhe të kërkonin ndihmë mjekësore. Mirëpo, posa u zbuluan dhe u identifikuan, mbi ta sërish u vërsulën ushtarët dhe banorët, duke i masakruar keq.

Në proklamatën tjetër, që u shpall në ndërkohë, përsëri të gjithë të plagosurve iu premtua ndihma mjekësore nëpër spitalet e Tivarit, të Raguzës, të Splitit e gjetiu, kurse nga të plagosurit lehtë u kërkua që të mënjanoheshin me qëllim të hapjes së rrugës për t'u ndihmuar të plagosurve rëndë.

Mirëpo, të mashtruar disa herë, tashmë askush nga të plagosurit nuk guxonte të lëvizte nga vendi. Pasi askush nuk lëvizte, atëherë kriminelët vazhduan aksionin e hulumtimit dhe të asgjësimit të atyre që ende kishin shenja të jetës. Ky lloj gjurmimi dhe asgjësimi ka vazhduar ditë të tëra. Sa për dëshmi, po i cekim vetëm disa prej shumë rasteve. Abedin Veliu nga Randobrava, ka pohuar: "Me të dëgjuar proklamatën, me 11 shokë të tjerë të plagosur, me duar të lidhura mbi kokë, u ngritëm në këmbë dhe iu afruam njëri - tjetrit. Mirëpo, posa u zbuluam, ata qëlluan me armë të zjarrta mbi ne, me ç'rast unë mora disa plagë të reja dhe humba vetëdijen. Pasi m'u kthye vetëdija, vërejta se të 11 shokët e mi ishin masakruar egërsisht. Qazim Morina nga Randobrava, ka treguar: "Me të dëgjuar proklamatën, unë, Xhemajl Morina, Halil Kastrati dhe Xhemal Dani u ngritëm në këmbë dhe iu afruam njëri - tjetrit, mirëpo, sapo u zbuluam, filloi sulmi i ri mbi ne nga të gjitha anët dhe u goditën për vdekje tre shokët e mi, kurse unë u godita rëndë dhe e kisha pas humbur vetëdijen.

Edhe qytetarët tivaras i masakronin ushtarët shqiptarë

Nuk ishte i vogël numri i atyre fatzinjëve ushtarë - rekrutë shqiptarë, që në valën e masakrimit, siç ngjanë gjithmonë në raste të tilla, të mos i kishte marrë plumbi dhe që në kërkim të shpëtimit të jetës, kishin kaluar rrethin e vdekjes dhe kishin kërkuar ndihmë te banorët malazezë apo ishin fshehur nëpër shtëpia, ahure, plevica, kotece pulash, tharçe derrash, kësolla të qejve, nëpër zgavrat e ullinjve, nëpër gypat e kanalizimit, nëpër kaçuba, shkurre, përroje, male, moçale, kaçuba e kudo tjetër. Mjerisht, shumë prej tyre nuk shpëtuan dhe prapë u masakruan, ngase në ndjekjen dhe kapjen e tyre ishin organizuar, përveç njësive ushtarake, edhe paramilitarë, skojistë, rini dhe qytetarë tjerë, që nga Kotori e deri në kufirin shqiptar. Të gjithë ata që ishin të organizuar në këtë aksion të rëndë, makabër dhe ç'njerëzor, kishin marrë një urdhër: "ku t'i gjeni "banditët shqiptarë" (siç i quanin ata rekrutët shqiptarë) aty për aty t'i vrisni". Sipas dëshmitarëve, numër të madh të rekrutëve shqiptarë kishin vrarë e masakruar edhe myslimanët (tërbeshët) në mëhallën Marziq, në shtëpinë e Sylë Llavriqit. Duke pirë ujë në kronin e bushtrës u godit për vdekje Musli Adem Iballi nga Bllaca. Dëshmitarët kanë thënë se ky mysliman, përveç Musliut, ka vrarë edhe 18 rekrutë të tjerë shqiptarë. Madje, në fshatin Turqin me sëpata janë masakruar 12 shqiptarë, në Tuxhemil 7 të tjerë e kështu me radhë. Sa për ilustrim po i theksojmë vetëm dy - tri raste: Rexhë Mirocin, posa kishte kërkuar strehim në një shtëpi, e kishin sulmuar dy femra, të cilat ia kishin prerë kokën me kosë. Në një oborr të një malazezi, duke kërkuar strehim, ishin vrarë dhe masakruar Brahim Syla dhe Behram Ajeti nga Ternaci, Avdi Ramadani nga Krasmiroci, Arif Shala nga Kopiliqi i Poshtëm, Musli Sopi nga Bukoshi

etj.Avdyl N. Tulla nga Peqani ishte strehuar në një shpellë diku në kodrat rreth Tivarit. – Më kishin hetuar dhe më kërkonin xhelatët. I dëgjoja kur fare afër meje flisnin mes vete: "Tu se nekde krije, majku mu shiptarsku", - ka treguar Avdyli. Nga trishtimi i madh kishte rënë në depresion psiqik Muharrem Mahmuti, i cili nuk ishte larg vendit ku qëndroja unë. Ishte zdeshur dhe kërcente i lakuriqësuar, si në dasëm, duke thënë: Po luaj me tupan. E kapën xhelatët dhe bënë me bajoneta copa – copa. Në ato momente tragjike mua më ra të fikët dhe për një kohë e kam humbur vetëdijen, - ka treguar më tej Avdyl Tulla.

Shpëtimi nga vdekja - nëpër gypat e kanalizimit

Me të filluar sulmi masiv, predhat dhe granatat i kishin plandosur për tokë Ramiz Berishën, Kadri Berishën e shumë të tjerë dhe mbi ta kishin rënë shumë të vdekur dhe të plagosur. Pasi u nxorën nga kufomat, nën rrebeshin e armëve e duke vrapuar për të gjetur shpëtim, ata hynë në një gyp të kanalizimit dhe kështu iu kishin shmangur goditjeve të tjera. Prej frikës se mund t'i nxjerrin edhe nga ato gropa të kanalizimit, Kadriu kishte nxjerrë briskun që mbante në xhep për t'u mbrojtur. Meqenëse Ramizi ishte më i shkathtë për këso rastesh, i kishte propozuar Kadriut që të largoheshin përmes gypit dhe të vazhdonin rrugën, me synimin që të dalin në anën tjetër të qytetit. Por, përkundër përpjekjeve, nuk kishin arritur ta gjejnë daljen. - Në pjesët më të ulëta, ku gypat e kanalizimit ishin plot ndyrësira, Ramizi, nga frika se do të më hynin ndyrësirat në gojë, ma mbante kokën me dorë lart, ka rrëfyer Kadrush Berisha. Pas 5 apo 6 orëve të përpjekjeve mbinjerëzore nëpër gypat e kanalizimit, ata ishin kthyer prapa, andej nga kishin ardhur. Për fat të keq, edhe hyrjen tjetër ua kishin mbyllyr xhelatët me një hekur të rëndë. Prandaj, ishin detyruar të qëndronin në gypat e kanalizimit edhe më tutje, duke pritur se çka do të ndodhte më vonë. Kur i humbën shpresat dhe veten e shihnin të vdekur, papritmas nga tre bashkëkombas që i kishin shpëtuar masakrës, të strehuar afër gropës së kanalizimit, ishte dëgjuar një zë: "O Zenë, mos u largo nga vendi se do të na zbulojnë shkijet". Me të dëgjuar këto fjalë, Kadriu dhe Ramizi, thirrën disa herë: - O Zenë! O Zenë! Kishin kërkuar nga Zena që t'ua hapte gropën e kanalizimit. Në atë situatë ankthi e droje, Zena, që i kishte dëgjuar të strehuarit, ua kishte hapur gypin, prej të cilit dalin Kadri Berisha dhe Ramiz Berisha. Përveç Kadriut dhe Ramizit, në gypa të kanalizimit gjeti shpëtim edhe Sylë Salihu nga Hajkobilla. Por, kurrë nuk do të dihet numri i vërtetë i ushtarëve shqiptarë, të cilët gjetën vdekjen në këtë masakër të tmerrshme.

Reshat Morina, nga Çikatova, ishte strehuar në një shtëpi të një malazezi. Ishte hetuar nga gruaja e të zotit të shtëpisë, e cila ishte përpjekur t'ia prente kokën me sëpatë, por ai kishte arritë të largohej disi në një oborr tjetër dhe të strehohej në një

thark plot me derra. Aty gjen pak strehim, por veç frikës nga njerëzit, kishte frikë edhe nga derrat, të cilët orvateshin t'ia hanin rrobat të zhytyra me gjak. Avdyl Ferati, për të shpëtuar, ishte strehuar në një furrë të bukës në oborrin e një malazezi, por sapo ishte hetuar nga i zoti i shtëpisë, ishte goditur me një dru në kokë, duke ia thyer të dy nofullat. Pasi ishte larguar edhe nga aty, gjeti shpëtim në një kasollë qeni, kurse qeni ishte treguar i butë dhe e kishte pranuar "mysafirin" pa asnjë problem. Bashkë me qenin ishte ushqyer dhe kishte qëndruar plot 44 orë.

Nën kufoma, pos të tjerëve, ishin nxjerrë të gjallë edhe Fazli Sadiku nga Gjyrysheci, i cili kishte 13 plagë në trup dhe një dorë të thyer. Abedin Veliu nga fshati Randobravë, kishte marrë 12 plagë, prej tyre pesë i kishte në kokë, kurse Rifat Peruku kishte marrë katër plagë të rënda, Izet Tupella nga Mitrovica kishte tri plagë të rënda dhe muskulin e këmbës së djathtë të humbur.

Nëpër gypat e kanalizimit kanë shpëtuar gjallë Kadri Berisha e Ramiz Berisha nga Kamenica dhe Sylë Salihu nga Hajkobilla etj.

Një xhip ushtarak amerikan afër vendit të ngjarjes

Pas likuidimit të rekrutëve shqiptarë në rrugën e gjerë 6 - 7 metra në qytet, në oborr dhe në katet përdhese të ndërtesës së Monopolit të Duhanit, radha u kishte ardhur edhe atyre pak ushtarëve shqiptarë që kishin mbetur ende të gjallë në katet e larta të ndërtesës, si dhe atyre të Eshalonit të Parë, që në atë moment gjendeshin në Tivarin e Vjetër, gjoja për zierjen e rrobave të ndotura nga morrat.

Në një moment kritik, kur ishin në pyetje sekondat për jetën tonë, afër vendit të ngjarjes papritmas është shfaqur një automobil me disa vëzhgues amerikanë, të cilët, me gjasë, kishin dëgjuar të shtënat e armëve dhe kishin ardhur për ta parë vendin e ngjarjes. Kriminelët u informuan për ardhjen e tyre, u dolën atyre përpara dhe i bindën të largoheshin dhe të vazhdonin rrugën për Ulqin, duke u thënë atyre se aty po zhvillohej një luftë e ashpër me mbeturinat e nazizmit. Po në atë kohë ishin vërejtur edhe disa persona të paidentifikuar, të cilët i kishin fotografuar të gjitha këto masakra, por që ata ishin zhdukur, pa mundur t'i zënë.

Mirëpo, prania e një makine - xhipi me vëzhgues amerikanë afër vendit të ngjarjes dhe prezenca e disa personave të paidentifikuar, të cilët e fotografuan vendin e ngjarjes, ishte vendimtare për të shpëtuar ata pak ushtarë shqiptarë që përjetuan masakrën. Të dhënat për praninë e makinës me vëzhgues amerikanë në afërsi të vendit të ngjarjes dhe e personave të paidentifikuar duke e fotografuar masakrën, i ka konfirmuar edhe Shtabi i Divizionit 46-të të Serbisë, në raportin e vet të datës 8 prill 1945 dërguar Shtabit Operativ për Kosovë e Metohi, në të cilin, pos të tjerave, thuhet:

"Për të qenë gjendja edhe më keq,

në kohën e të shtënave atypari ka kaluar një xhip amerikan dhe ka arritur në afërsi të vendit të ngjarjes, ku është bërë masakra, për fat oficerët tanë arritën t'i bindin ata që ta vazhdojnë rrugën për Ulqin".

Në raport thuhet më tej se në vendin e ngjarjes janë vërejtur edhe disa persona tjerë të paidentifikuar, të cilët kanë fotografuar dhe, duke shfrytëzuar rrëmujën, kanë ikur pa lënë gjurmë.

Raportuesi i mësipërm, përkatësisht komandanti i Shtabit të Kolonës së Armatës IV, në informatën e 8 prillit 1945 për Shtabin Operativ të Kosovës ka zbuluar edhe një fakt: Të vërtetën e madhe se masakra do të vazhdonte deri në vrasjen e shqiptarit të fundit nga Eshaloni i Dytë dhe Eshaloni i Parë, sikur në momentin e ekzekutimit të mos vinte një ekip vëzhgues i aleatëve amerikanë.

Përpjekjet për arsyetimin e masakrës

Pasi ishin larguar vëzhguesit amerikanë, Shtabi ushtarak ishte informuar se në katet e epërme të ndërtesës së Monopolit të Duhanit kishte ushtarë shqiptarë të gjallë. Në proklamatën që u shpall në ndërkohë, sërish të gjithë të plagosurve dhe atyre që fare nuk ishin plagosur e që gjendeshin në katet e epërme të ndërteses së monopolit, iu premtua ndihmë mjekësore. Ata na ftuan ta lëshojmë ndërtesën dhe të dalim në oborr, sepse komandanti suprem, "Shoku Tito", gjoja kishte urdhëruar ndërprerjen e zjarrit dhe se të gjithë i kishte falur, pavarësisht nga "gabimet" që kishin bërë. Mirëpo, të mashtruar tash disa herë, askush nga të gjallët nuk lëvizte nga vendi.

Pas pak aty arriti një grup oficerësh dhe një njësit ushtarak, të cilët deri atëherë nuk i kishim parë e që paraqiteshin si dalmatinas. Pasoi një bisedë mes tyre dhe Shtabit ushtarak, herë - herë e përcjellë me zhurmë dhe me tone polemizuese. Përsëri na ftuan të dalim jashtë, me premtime se nuk do të na ndodhte asgjë e keqe. Na thoshin se tash këtu janë edhe njësitë ushtarake të Dalmacisë. Përsëri na u tha se ndërprerjen e zjarrit e ka urdhëruar vetë Titoja, i cili, siç thonin, na e ka falur jetën.

Njerëzit që ishin brenda në ndërtesë u hamendën një kohë të gjatë të dalin apo të mos dalin jashtë. Për hamendjen tonë ndikonte përvoja e hidhur që e kishim marrë gjatë tërë rrugës dhe në qytet, prandaj me të drejtë dyshonim në çiltërinë e kësaj thirrjeje. Pas konsultimeve mes vete dhe me disa shokë tjerë me përvojë, si Isuf Halili e Sylë Ferizi nga Radisheva, që kishin rënë në kontakt edhe me Shtabin ushtarak dhe me shtabin tjetër ushtarak, që prezantohej si ushtri dalmatinase, pas disa premtimeve që morëm se nuk do të ketë më vrasje dhe nuk do të na ndodhte asgjë e keqe, vendosëm ta lëshojmë ndërtesën. Atëherë Isuf Halili nga Radisheva tha se ai do të dalë i pari për të kontaktuar me njerëzit që na bënin thirrje për të dalë. Pastaj edhe ne të tjerët vendosëm të dalim nga ndërtesa. Para se të kishte filluar dalja, serbët e

malazezët kishin vënë roje në çdo kat të ndërtesës, prandaj askush nuk mund ta lëshonte ndërtesën pa u kotrolluar detalisht. Gjatë këtij kontrollimi prej xhepave tanë është marrë - konfiskuar çdo send që na kishte mbetur e që kishte sadopak vlerë, si unaza, orë xhepi, të holla, ndonjë rrobe e re etj.

Kur kemi dalë nga ndërtesa, kemi vërejtur se oficerët e Shtabit, të cilët na kishin masakruar, po polemizonin me oficerë që paraqiteshin si dalmatinas. Nga kjo polemikë mësuam se të parët përpiqeshin ta arsyetonin masakrën, duke u arsyetuar se ata nuk kishin bërë atë masakër, por shqiptaret ishin vrarë mes vete për interesa të ndryshme klanore dhe të ideologjive të tyre politike. Këtë arsyetim e bënin me qëllim të fshehjes së veprës së tyre – masakrës, në mënyrë që shqiptarët t'i paraqisnin para botës si njerëz të egër.

Qëndrimi ynë mbi kufoma ishte i trishtueshëm

Me të dalë nga ndërtesa e Monopolit të Duhanit, na vendosën në një kënd në oborr, ku vërejtëm një rrethim të madh nga shumë njësi ushtarake, paramilitare dhe civile. Na detyronin të qëndronim në këmbë mbi trupat e të vrarëve dhe të plagosurve. Krahas kësaj, vërejtëm edhe një skenë të llahtarshme para nesh; në oborr, në katin përdhes, në rrugë dhe në qytet shtriheshin mijëra të vrarë dhe të plagosur. Pamje trishtuese paraqisnin sidomos gjësendet e mprehta, si bajonetat, sëpatat, thikat, tëfurqit, shkopinjtë etj., që kishin mbetur të ngulura në gjokse, në stomaqe, në shpina apo në pjesë tjera të trupave të shqiptarëve të vrarë apo të plagosur. Kishte njerëz me koka të prera, me sy të nxjerrë, me zorrë të nxjerra...

Në atë grumbull kufomash dhe të plagosurish, të shtrirë e të kryqëzuar si drurët e paluara njëri mbi tjetrin, nuk mund të dallohej se kush është kush, se ku e ka kokën e ku këmbët apo trupin. Kishte shumë të plagosur që vuanin, që vajtonin, që kërkonin ndihmë, që klithnin e ofshanin. Është vështirë të përshkruhet tërë ajo skenë e tmerrshme, kur të plagosurit, të cilëve u shkonte gjaku rrëke, kërkonin ndihmë, kurse ne nuk ishim në gjendje t'u ndihmonim. Për ne që mbetëm gjallë ishte shumë i vështirë detyrimi që të qëndronim në këmbë mbi kufomat dhe mbi të plagosurit. Edhe ne qanim bashkë me të plagosurit, të cilët pandërprerë klithnin: "Ndihmomë, o vëlla e mos shkel mbi varrën time!", "Ma jep një pikë ujë, o vëlla!", "Ma hjek thikën nga shpina!", "Më nxirr prej kufomave"!, "M'i tubo zorrët që po më shkojnë zhag"! etj., etj. Nuk ishin të rralla as lutjet: "Vëllezër, mos na leni në duart e këtyre xhelatëve, më mirë na mbytni ju!", "Më mbuloni me diçka!", "Na e ndalni gjakun!"e të tjera.

Të shtrënguar nga të gjitha këto kërkesa, edhe pse ishim të rrethuar nga ushtarë të armatosur, ne megjithatë u përpoqëm që sadopak t'u ndihmojmë, duke i nxjerrë të plagosurit nga kufomat, duke ua hequr gjësendet e ngulura në trup, duke i mbuluar etj. Por, në momentin kur na kanë hetuar

oficerët, kanë dhënë urdhër të ri kërcënues, se kush përpiqet t'u ndihmojë të plagosurve ose që shmanget nga vendi, atë do ta zë plumbi. Po ashtu do të dënohet me vdekje secili i plagosur që përpiqet t'u bashkohet atyre që kanë mbetur të gjallë.

Në një situatë të tillë, kur kudo rreth nesh, por edhe nën këmbët tona dëgjoheshin vaje, ofshamje dhe klithje të të plagosurve që kërkonin ndihmë, xhelatët na mbanin fjalime për Ushtrinë Nacionalçlirimtare jugosllave, për Titon etj., duke na detyruar edhe të brohorisnim parulla, si "Rroftë shoku Tito". Ky lloj fjalimi, përkatësisht maltretimi, zgjati afërsisht 60 - 80 minuta, derisa ra terri i natës. Mëkot të plagosurit vazhdonin të kërkonin ndihmë prej nesh, sepse me qindra ushtarë përreth e vëzhgonin çdo lëvizje tonë, kurse çdo përpjekje tonën për ndihmë e dënonin me vdekje.

Në det notonin plisat e bardhë

Pasi që ushtria, punëtorët, gratë, burrat dhe fëmijët pastruan pjesën më të madhe të sheshit dhe të rrugës përreth, nga kufomat dhe të plagosurit, nga rrobat dhe mbeturinat tjera të masakrës, radha i erdhi oborrit ku ne ishim të vendosur mbi kufoma.

Derisa na urdhëruan ta lëshonim oborrin, pas nesh mbetën klithmat e të plagosurve, duke dëshiruar që edhe ata të vinin me ne. Ata qanin dhe bërtisnin "Vëllezër, ku po na leni neve, mos na leni te këta xhelatë!" etj. Ky ishte një trishtim i madh për ne që kishim mbetur gjallë e nuk kishim mundësi t'u ndihmojmë. Prej aty na kanë dërguar në një plazh, i cili prej "kasaphanes" ishte larg 200 deri 300 metra. Prej atje shikonim se si e pastronin oborrin, ndërtesën, rrugën dhe qytetin nga kufomat dhe të plagosurit, të cilët vazhdonin të transportoheshin një mbi një në mjete transportuese, në drejtim të Tivarit të Vjetër e drejt shkëmbinjve, drejt ndonjë humnere apo varreze masive.

Gjaku i shqiptarëve të pafajshëm kudo: lumenjve, detit, rrugëve, shesheve, humnerave... Edhe plisat notonin mbi sipërfaqe të detit

Në plazhe e kemi kaluar natën, të rrethuar në një anë nga deti i hapur, ndërsa në anën tjetër nga qindra ushtarë me armë të drejtuara drejt nesh, kurse ne ishim të zbehur, të lodhur, të torturuar, të frikësuar, të etur e të uritur. Të gjithë kishim frikë se gjatë natës do të na kidnapojnë apo do të na likuidojnë një nga një. Kështu, secili prej nesh e kërkonte mesin e turmës, sepse atje kishte shpresa më të mëdha të shpëtimit.

Në mëngjes vërejtëm se si mbi sipërfaqe të detit po notonin plisat e bardhë, shokat, japangjat dhe qindra kufoma të shokëve tanë.

Gjakun e shqiptarëve nuk e lante deti

Për pastrimin e ndërtesës së Monopolit të Duhanit, të oborrit të tij, të rrugës, të sheshit dhe të qytetit, përnjëherë u mobilizuan, përveç njësive ushtarake, edhe të gjitha institucionet

ushtarake, shtetërore e civile, si dhe qytetarët; burra, gra, pleq, të rinjë, punëtorë, me qëllim që sa më shpejt të fshihen gjurmët e masakrës. Për këtë qëllim u angazhuan cisternat, kamionët, kovat e fshesat e të gjithë Tivarit. Në kumtesën që e dhanë më parë e që dëgjohej fort mirë, u tha:

- Të gjitha njësitë ushtarake, institucionet shtetërore dhe civile, të gjithë qytetarët dhe punëtorët, me të gjitha mjetet që kanë, të mobilizohen për pastrimin e qytetit nga stërvinat e banditëve shqiptarë;

- Në mjetet transportuese, si në kamiona, në vagona, në qerre e tjera, të ngarkohen të vdekurit dhe të plagosurit;

- Pas transportimit të viktimave, të pastrohen rrugët, sheshi, oborri dhe ndërtesat e monopolit dhe tërë qyteti nga gjaku dhe mbeturinat e banditëve shqiptarë;

- Meqenëse gjurmët e gjakut të ngjizur nuk mund të zhdukeshin me fshesa dhe me ujin e detit, u urdhërua të sillej rërë nga bregdeti me kamiona dhe me mjete tjera transporti, në mënyrë që të mbulohet gjaku i derdhur. As deti nuk mund ta lante krimin e madh të serbëve e të malazezëve, përkatësisht të jugosllavëve mbi shqiptarët e pafajshëm në Tivar,

- zbatimi i kësaj urdhërese filloi menjëherë, kështu që mjetet e transportit ngarkoheshin përplot me të vdekurit e të plagosurit.

Të kota ishin kundërshtimet dhe përpjekjet e të plagosurve për t'i ikur këtij transporti të paparë, sepse ata që rezistonin, vriteshin e masakroheshin menjëherë me armë të ftohta, por edhe me armë të zjarrit.

Edhe pse ishim të shtrënguar dhe të rrethuar nga çdo anë, një grup prej tre shokëve tanë të gjallë, të cilit i priu Elez Myrta nga Llausha, u nda nga turma jonë dhe shkoi te komandanti, që ishte larg nja 20 - 25 metra, me kërkesë:

- që të ndërpriteshin masakrat dhe torturat ndaj shqiptarëve,

- që të kenë mëshirë ndaj të plagosurve, në mënyrë që të mos transportoheshin së bashku me të vdekurit, dhe

- të na lejohet që ne t'i marrim nën mbikëqyrje dhe përkujdesje të plagosurit dhe të na lejohet dërgimi i tyre në ndonjë spital.

Edhe këto kërkesa gjakatarët e dënuan me vdekje, duke i vrarë të tre kërkuesit. Por, nuk u kënaqën me kaq. Nga mesi ynë nxorën edhe gjashtë persona të tjerë, me motivacion se edhe ata ishin pjesë e grupit që "protestonte". Të gjithë u ekzekutuan, kurse neve na kërcënuan se po të dëgjohej edhe vetëm një zë, do të na gjente i njëjti fat. Derisa zhvillohej ky aksion, nga masa e qytetarëve dëgjohej kënga:

"Druzhe Tito, mi smo t'i obeqali, da çemo sve shiptare zaklati, osim devojaka i mladih nevesti, s'kojima çemo kolo zaigrati" (Shoku Tito ne të kemi premtuar, se do t'i therrim të gjithë shqiptarët, përveç vajzave dhe nuseve të reja, me të cilat do të hedhim valle), etj.

Edhe ne detyroheshim t'i ngarkonim kufomat

Për t'i tubuar, për t'i ngarkuar dhe për t'i humbur mijëra kufoma, të plagosur, si dhe gjymtyrë të këputura të shqiptarëve në ndërtesën e Monopolit të Duhanit, në oborrin e saj, në shesh dhe në qytet, nuk mjaftuan ushtarët, punëtorët, burra e gra të Tivarit dhe lokaliteteve përreth. Që ironia të jetë më e madhe, për këtë qëllim kriminelët mobilizuan edhe 350 ushtarë shqiptarë që e kishin përjetuar masakrën.

Në kohën kur ne prisnim në ankth duke qëndruar në ranishtë (plazh), arritën disa oficerë serbë apo malazezë, të cilët i urdhëruan 350 rekrutë shqiptarë, natyrisht ata që ishin më të shëndetshëm, që të ngriteshin në këmbë dhe me duar të lidhura të ecnin para tyre.

Të gjithë menduam se ata i nxorën për t'i pushkatuar. Shumica prej tyre, duke qajtur, i porosisnin të afërmit e vet që në rast se kthehen në shtëpi, t'i njoftojnë familjet për fatin e zi të tyre dhe për krejt çka u ka ndodhur. Porositë e tyre mund të krahasohen me vargjet:

Thuaj nënës mos më qajë,
se jetimat pa babë pa nënë,
gjithmonë fatin të zi e kanë!
M'i thuaj nuses të mos më pret,
se jeta ime sot mbaroi krejt!

Por, të nesërmen kuptuam se ata i kishin mobilizuar për ta pastruar qytetin nga gjurmët e masakrës. Për këtë qëllim, përveç shumë të tjerëve, u angazhuan edhe Ramë Curri dhe Rizah Dushku nga Prelezi, të cilët me grupin e tyre prej 12 vetëve tubuan dhe ngarkuan gjashtë kamiona, ndërsa 250 kufoma të tubuara janë ngarkuar në natën e ardhshme. Bajram Gashi nga Mohlani, me grupin që numronte 15 vetë, ngarkoi katër vagona treni dhe dy kamiona të tjerë, ndërsa të tubuar për transport kishin mbetur edhe 250 - 300 kufoma, të cilat prisnin të transportoheshin një natë më vonë, nga se nuk lejohej që kjo veprimtari të kryhej gjatë ditës etj.

Si u zhdukën gjurmët e gjakut

Kreu ushtarak, ai shtetëror dhe partiak jugosllav, i cili e kishte inskenuar masakrën e paparë e të padëgjuar në histori, njëkohësisht kishte planifikuar edhe mënyrën e pastrimit të qytetit dhe zhdukjen e kufomave dhe të të plagosurve, por edhe për fshehjen e gjurmëve tjera të masakrës, që të mos i bien në sy ndonjë personi dashakeqës për ta, e sidomos të ndonjë anglo - amerikani. Për këtë qëllim Tivari ishte zgjedhur si vendi më i përshtatshëm për masakrën më të madhe ndaj shqiptarëve, ai, sipas të gjitha gjasave, i plotësonte më së miri kushtet gjeostrategjike për këtë qëllim.

Dr. Zekeria Cana në hulumtimet e veta ka konstatuar se në "dokumentet arkivore jugosllave të kohës nuk ka gjurmë mbi vendin e varrosjes së kufomave të masakrës së Tivarit, masakrës më të madhe mbi shqiptarët në vitin 1945, të cilën viktimologët botërorë me të drejtë do ta quanin "Magna Krimen".

Nga të dhënat gojore të mbledhura nga dëshmitarët e kësaj masakre, nga të dhënat e disa ushtarëve shqiptarë nga Ulqini, të cilët ishin të mobilizuar me dhunë gjatë masakrës së Tivarit për zhdukjen e kufomave dhe gjurmëve tjera, si dhe nga të dhënat e Dr. Zekeria Canës dhe Dr. Hakif Bajramit, me të drejtë mund të nxirret përfundimi se:

a) Një pjesë e kufomave u hodhën në thellësi të Detit Adriatik, skaj limanit, aty ku sot janë rezervoaret e karburanteve,

b) Një pjesë tjetër e kufomave u hodhën në dy shpella të thella në afërsi të fshatit Tugjemil në Malet e Kunorës dhe u dogjën,

c) Një pjesë u hodhën në disa istikame të luftës, në barrikada dhe strehimore, që gjermanët i kishin hapur për strehimin dhe barrikadimin e forcave ushtarake dhe të arsenalit ushtarak afër fshatit Zupç, në varreza tjera masive në Tivar e përreth,

d) Një numër i kufomave ka mbetur në hendeqe e nëpër malet rreth Tivarit dhe fshatrave përreth, duke u bërë ushqim korbash, bishash të egra dhe qejsh.

Kapitulli IV - RAGUZA

CILI ISHTE FATI I USHTARËVE SHQIPTARË NGA MAQEDONIA NË FRONTIN E ADRIATIKUT?

Dërgimi i shqiptarëve të mobilizuar në Frontin e Adriatikut nuk është ndalur as pas masakrës së Tivarit. Eshaloni III, me 2700 ushtarë shqiptarë, ishte nisur në mëngjesin e 27 marsit 1945 nga Prizreni në drejtim të Kukësit, të Shkodrës, të Tivarit e të Istries, që përcillej nga një batalion i Brigadës XXVII të Serbisë. Ky eshalon në Shkodër ka mbërri më 31 mars, kurse në Tivar më 1 prill 1945, rreth orës 13. Sipas raportit të Divizionit 46-të të Serbisë, ky eshalon na del nga më mëdhenjtë në numër, por nga më të dobëtit nga pikëpamja shëndetësore, pasi në të kishte shumë të sëmurë nga tifoja dhe nga sëmundje tjera. Vetëm nga ky eshalon, sipas këtij raporti, më shumë se 170 ushtarë shqiptarë mbetën të sëmurë gjatë rrugës. Në raport theksohej se “disa prej të sëmurëve i kemi bartur me kamionë, kurse pjesa tjetër janë vetëzhdukur”! (U vetëzhdukën!!! – sa cinizëm).

Të dhënat nga kujtimet e dhjetëra përjetuesve të këtij rrugëtimi thonë se të 170 ushtarët e sëmurë i pushkatuan skuadrat e përcjelljes, që përbëheshin nga eprorë dhe ushtarë serbë, malazezë dhe maqedonas. Rekrutët shqiptarë ishin të ndarë në grupe nga 20 – 25 vetë dhe ata vriteshin në udhëtimin përgjatë rrugës Kukës – Fushë-Arrëz – Pukë – Gomsiqe – Sh-

kodër e deri në lumin Buna, duke i hedhur kufomat nëpër gremina të thella. - Është fakt, - thotë Bajram Gola, - se ushtarët e Eshalonit III në pjesën më të madhe ishin nga viset shqiptare që sot ndodhen në Maqedoni. Por në këtë rrugëtim shqiptarët nuk kishin pësuar vetëm në Tivar. Në një ndërtesë, ku ishin vendosur për ta kaluar natën, për t'u çlodhur e për t'u stërvitur për luftë, në Babin - Kuk të Raguzës, ishin helmuar 1300 ushtarë shqiptarë. Përsëri ushtarët ishin që të gjithë shqiptarë!?

Në vjeshtën e vitit 1912 ushtria serbe vetëm në Pollog ka mobilizuar mbi 30 mijë djem shqiptarë. Prej tyre asnjë nuk është kthyer më në shtëpi i gjallë. Ata i vrau soldateska serbe e ardhur nga Vraja, Leskoci e Nishi.

As ky rast, si edhe rasti i Tivarit, ku pësuan aq shumë vetëm ushtarët shqiptarë, nuk mund të klasifikohet si incident i rastit. Është indikativ fakti se si në mesin e ushtarëve të ardhur nga viset shqiptare në Maqedoni, që ishin të tubuar në Prizren, nuk kishte asnjë ushtarë maqedonas apo të ndonjë kombësie tjetër. Bajram Gola ka konstatuar edhe se "Azem Hajdini, në fejtonin e botuar në "Flaka", tregon se të masakruarit ishin vrarë në emër të LNÇ me sëpata, me thika, me tërfurq, me bajoneta etj., por nuk i ka thënë të gjitha. Në Maqedoni ka shumë raste të ngjashme, për të cilat është heshtur. Ata të cilët tentuan të flisnin, "i hëngri nata".

Është e vërtetë se një shkresë diskrete ka qarkulluar dorë më dorë te komandantët ushtarakë serbë e malazezë, me përmbajtje se si duhej të shfaroseshin 400 mijë shqiptarë, për shkak se, sipas tyre, ata iu shmangën Luftës së Dytë Botërore dhe se nataliteti i tyre do t'i kërcënohet Jugosllavisë. Kjo shkresë rastësisht i kishte rënë në dorë një partizaneje shqiptare, por shumë shpejt shkresa u fsheh, me arsyetimin se ajo ishte lëshuar nga forcat reaksionare.

Kreu ushtarak, shtetëror dhe partiak jugosllav nuk u ngopën as me izolimin, deportimin dhe likuidimin e forcës aktive shqiptare nga Kosova, por, në emër të mobilizimit, izoluan edhe forcën aktive shqiptare nga Maqedonia, duke e dërguar edhe atë në vise të ndryshme të Jugosllavisë kinse për t'i plotësuar njësitë ushtarake të Armatës Popullore të Jugosllavisë (JNA). Për këtë qëllim në mars e prill të vitit 1945 nga Maqedonia u mobilizuan 5594 luftëtarë shqiptarë, të cilët u dërguan për plotësimin e Armatës IV të Jugosllavisë në Frontin Veriperëndimor të Adriatikut.

Për deportimin e shqiptarëve nga Maqedonia ka të dhëna jo të plota, sepse në raportin zyrtar bëhet fjalë vetëm për transportimin e Eshalonit I dhe XI, ndërsa për eshalonet tjera nuk ka të dhëna me të cilat do të shihej pasqyra reale e numrit të të deportuarve në frontin e Adriatikut. Pra, del se nga shqiptarët e Maqedonisë në eshalonet e përmendura kishin mobilizuar 5594 shqiptarë.

Prizreni – vendtubimi qendror

Pikënisje e njësive ushtarake me të mobilizuar shqiptarë ishin qendrat

e rretheve të Maqedonisë, si Shkupi, Tetova, Dibra, Gostivari, Kërçova, Kumanova e vende tjera të banuara me shqiptarë. Në rrugë e sipër drejt Prizrenit ky numër gjithnjë rritej. Këtë fakt, si thotë Bajram Gola në "Flaka...", e ka dëshmuar edhe Dane Cekoviski, kur ka thënë: "Shqiptarët në front, jashtë trojeve të veta e brigadat maqedonase mbetën si ekspedita ndëshkuese në viset e banuara me shqiptarë" (...)

Kësisoj del konstatimi se këto njësi ushtarake me rekrutë nga viset shqiptare të Maqedonisë paraprakisht ishin të destinuara për asgjësim fizik, por në kohë dhe në vend të përshtatshëm, jashtë trojeve të tyre, siç ndodhi më vonë në Prizren, në Shkodër, në lumin Buna, në Tivar, në Raguzë, në Stari Beqej etj.

Për mobilizimin e luftëtarëve shqiptarë në Maqedoni dhe për dërgimin e tyre jashtë trojeve të tyre, kreu ushtarak jugosllav përdori strategji të njëjtë me atë të shqiptarëve në Kosovë dhe në vise tjera etnike shqiptare, që kishte për qëllim krijimin e rrethanave politike e ushtarake për t'i realizuar planet antishqiptare që shtronte Programi i V. Qubriloviqit më 1937, i modifikuar edhe më 3 nëntor 1944, si dhe projekti i Ivo Andriqit i vitit 1939. Programi kombëtar i ideologut çetnik Stevan Maloviqit e programet tjera shoviniste, paraqisnin platformën ushtarake e politike edhe të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe në viset etnike shqiptare.

Bajram Gola është njëri ndër ata pak shqiptarë, e të mos flasim për oficierë apo bartë të funksioneve i cili u përpoq të kontribuonte për ndriçimin e Masakrës së Tivarit dhe të ngufatjes së ushtarëve shqiptarë në Raguzë. Ai më 31 maj 1990, me një parashtresë iu drejtua qarqeve politike, gjyqësore, ushtarake dhe mbarë opinionit jugosllav si një dëshmi për një tragjedi shqiptare e për një gjenocid serb, malazez e maqedonas mbi rekrutët shqiptarë të mobilizuar nën flamurin e Armatës Popullore të Jugosllavisë.

Kjo u dëshmua që nga dita e parë, kur forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë shkelën truallin e Kosovës dhe viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, kur u mbushën rrugët, përrenjtë, hendeqet e malet me kufoma të shqiptarëve. Pothuaj se nuk kishte mbetur pus në Kosovë, në Maqedoni, në vise tjera etnike shqiptare të mos ishte mbushur me koka, me trupa dhe me gjymtyrë të shqiptarëve.

Raguza - Dahau i shqiptarëve

Planifikuesit e masakrave nuk i ka kënaqur as mobilizimi i 16423 ushtarëve shqiptarë nga Kosova dhe të 5594 shqiptarëve nga Maqedonia, që ishin dërguar në Frontin e Adriatikut për t'u bërë mish për top. Nuk u ngopën as me qindra shqiptarë të vrarë mizorisht gjatë rrugëtimit nga Prizreni e deri në Tivar. Nuk u kënaqën as me likuidimin për një ditë të 4300 shqiptarëve në Tivar. Ata dëshironin ta realizonin planin plotësisht; t'i likuidonin të gjithë shqiptarët e mobilizuar. Për ndryshim nga Tivari, në Raguzë u përdor një metodë tjetër e

vrasjes; helmimi me materie kimike toksike. U zgjodh kjo metodë e vrasjes në mënyrë që të mos e merrte vesh opinioni! U zgjodh Raguza si vend i vrasjes, që të mos dyshohej se krimin në Kroaci e kishin bërë serbët e malazezët.

Meqenëse Raguza ishte çliruar disa muaj më herët, kazermat ushtarake të këtij qyteti bregdetar kroat u shërbenin njësive ushtarake të Jugosllavisë për pushim dhe për përgatitjet e fundit për frontet e Istries. Këtu do "të pushojnë" dhe do "të përgatiten" edhe rekrutët shqiptarë, të mobilizuar në Ushtrinë jugosllave.

Një njësit ushtarak, që i takonte Eshalonit II me shqiptarë të Kosovës, e kishte vazhduar rrugën drejt frontit. Ai kishte qëndruar disa ditë në barakën ku më parë kishte qëndruar ushtria fashiste italiane. Me arritjen e rekrutëve shqiptarë në këto baraka, komandanti kujdestar i kazermës kishte caktuar pesë mjeshtër të profileve të ndryshme dhe shtatë punëtorë të thjeshtë, ndër të cilët edhe Ramë Hysenin, Zeqir Hamzën dhe Bajram Bajraktarin, për ta pastruar dhe meremetuar objektin, në të cilin do të vendoseshin përsëri rekrutë shqiptarë nga Maqedonia.

Më 17 prill – vendosja në kazermë

Pikërisht më 17 prill 1945, rreth orës 19, një njësit ushtarak me rekrutë shqiptarë vendoset në kazermë, në barakat, të cilat gjatë luftës i kishte ndërtuar e shfrytëzuar ushtria fashiste italiane (ato nuk ishin "lokale ku më parë ishte ndonjë depo apo ndonjë barutanë ushtarake", siç kishte pohuar A. Rankoviqi).

- Sapo u informuam për ardhjen e shqiptarëve në atë kazermë, shkuam disa shokë te ata që të informoheshim për gjendjen në Kosovë. Mirëpo, pamë se shumica dërmuese e tyre ishin nga viset shqiptare të Maqedonisë, por kishte disa edhe nga Kosova. Ndër ta ishin edhe Avdi Hajra e Behram Tahiri nga Pantina, Tahir Ramadani nga Mramori, Rrustem Ahmeti etj. Pas përshëndetjeve ata na treguan për dhunën e përjetuar, për vrasjet, për incidentet e kurdisura gjatë rrugëtimit të tyre. Në eshalonin e tyre, siç kanë thënë, kishte 1600 – 1700 rekrutë shqiptarë. - Para se të agonte dita e 18 prillit, - siç kanë pohuar Zeqir Hamza, Haxhi Maliqi dhe Ramë Hyseni, - nga objekti ku ishin vendosur ushtarët është dëgjuar një bërtitje e madhe. Ne që ishim në objekte tjera në afërsi, dolëm në oborr të shikonim se çka po ndodhte. Pamë 10 – 15 ushtarë në oborr, të cilët kishin dalë që më parë për nevoja personale. Por, nga ana tjetër pamë edhe shumë ushtarë serbë të armatosur e të pajisur me maska. Ata kishin bllokuar në tërësi objektin, dyert e dritaret e kazermës dhe nuk lejonin ata që ishin brenda të dilnin jashtë. Ushtarët shqiptarë të helmuar po përpëliteshin brenda objektit dhe po luftonin me vdekjen, duke tentuar të dilnin për dere e për dritare. Kurse autoritetet që po e ruanin kazermën thoshin se shqiptarët nuk janë të helmuar, ata nuk kanë asgjë por janë duke inskenuar helmimin, në mënyrë që të lirohen apo të ikin nga lufta.

Pasi ishte bërë zhurmë dhe alarm i madh me rastin e tragjedisë, ishin alarmuar edhe qytetarët e Raguzës, të cilët menjëherë kishin ardhur për ndihmë, duke i hapur fillimisht dyert dhe dritaret e objektit ku ishte bërë helmimi. Qytetarët pastaj për të helmuarit kishin sjellë qumësht, kos, vezë e lëngje të ndryshme. Ata u hidhnin ujë në trup të helmuarve, me ujë të ftohtë ua fërkonin ballin, fytyrën, qafën e gjoksin për t'i sjellë në vete. Mirëpo, për shkak se një kohë të gjatë nuk ishin hapur dritaret e dyert e lokaleve me gaz, pak persona nga të helmuarit mundën të mbijetojnë. - Në këtë rrëmujë, brenda në objekt kam hyrë unë (Azem Hajdini), Ramë Hyseni dhe shumë të tjerë. Aty kemi parë:

a) qindra ushtarë shqiptarë të vdekur, të ngulfatur nga gazi sa ishin në gjumë,

b) një numër të vogël të të helmuarve, për të cilët supozonim se ishin ende të gjallë e të cilët po ngriheshin ngadalë në këmbë, por prapë binin mbi kufomat e kryqëzuara,

Vlen për të theksuar se as njësitë përcjellëse dhe as njësitë tjera ushtarake nuk u angazhuan fare për dhënien e ndihmës së parë, por ato vetëm pengonin që shqiptarët e helmuar të dilnin nga dera dhe nga dritaret, duke u arsyetuar para qytetarëve raguzas se shqiptarët nuk janë të helmuar, por ata po simulonin. Pas ndërhyrjes së qytetarëve të Raguzës, në vendin e ngjarjes kanë ardhur forca të mëdha ushtarake, por ato nuk janë lejuar të ndihmojnë derisa kanë ardhur edhe njësitë speciale me pajime përkatëse.

Barten viktimat pa u konstatuar vdekja

Posa u hapën dyert dhe dritaret, menjëherë kanë ardhur dhjetëra kamionë të mbuluar me shumë ushtarë, të cilët, me gjasë, kishin qenë të përgatitura qysh më herët, për t'i bartur të vdekurit. Ngarkimi dhe bartja e kufomave bëhej me shpejtësi të madhe, pa identifikimin e viktimave dhe pa ndonjë konstatim mjekësor të vdekjes. Kjo ka bërë që ne të dyshojmë për vrasjen me qëllim të tyre. Kështu kanë pohuar edhe Hamdi Osmani, Rushit Osmani, Latif Rushiti, Rrustem Ahmeti dhe Bajram Bajraktari. Kurse, disa prej të helmuarve ende ndodheshin pa ndjenja, por nuk ishin të vdekur. Me rastin e ngarkimit të tyre nëpër kamionë, te disa nga të helmuarit shiheshin shenja jete; nga goja u dilte një lëndë si avull, pastaj kishin frymëmarrje të dobët, kurse disa i kishin sytë të kthjelltë, i kishin gjymtyrët e lëshuara, por jo të shtanguara etj. Zeqir Hamza nga Klina e Epërme ka pohuar se ndër shumë të vdekur, ishin edhe dy miq të shtëpisë së tij: Avdi Hajra dhe Behram Tahiri nga Pantina, ndërkaq Hamdi Osmani dhe Rashit Osmani kanë pohuar se ndër të vdekurit ishte edhe Tahir Ramadani nga Mramori, etj.

Posa janë bartur kufomat, shtabi ushtarak i kazermës organizoi një bisedë kushtuar kësaj ngjarjeje, ku ishin të pranishëm dëshmitarët: Azem Hajdini – Xani, Habib Berisha, Ramë Hyseni, Bajram Bajraktari, Rrustem Ahmeti, Latif Rushiti, Hajdar Berisha, por edhe qytetarë të Raguzës, të Tre-

binjës dhe të lokaliteteve përreth, të cilët u kishin afruar ndihmë shqiptarëve, si është Mustafa Spahiq.

Në bisedë e sipër shtabi ushtarak dhe oficerët e lartë shprehën "keqardhje" për tragjedinë që ndodhi, ku, siç pohuan vetë, humbën jetën 1340 ushtarë shqiptarë. Po ashtu ata thanë se kjo ngjarje ishte vepër e nazizmit gjerman, pastaj e çetnikëve dhe e ustashëve, sepse pas largimit të tyre nga objektet – kazerma - barakë, ata gjoja kishin lënë lëndë helmuese dhe pas hedhjes së një duqi të cigares nga shqiptarët, është aktivizuar materia helmuese dhe kështu ka ardhur deri te helmimi i ushtarëve shqiptarë brenda në objekt. Kjo ngjarje, sipas tyre, ka ndodhur nga pakujdesia e ushtarëve shqiptarë, por ata kanë harruar se:

a) Raguza, Spliti, Treguri, Biogradi në Det, Zara me rrethinë ishin çliruar disa muaj para se të ndodhte kjo tragjedi.

b) Në kazermën ushtarake të Raguzës, ku janë helmuar shqiptarët, më parë kishin qëndruar për të pushuar dhe për stërvitje edhe ushtarë tjerë të brigadave të UNÇ. Madje, në atë objekt më parë kishin qëndruar, kishin pushuar dhe ishin përgatitur për front edhe tri eshalone të marsit me ushtarë shqiptarë.

c) Po atë ditë, posa një njësit ushtarak me shqiptarë, që i takonte eshalonit të dytë, ka vazhduar rrugën për në frontin e Adriatikut, me urdhrin e komandantit të kazermës u lirua objekti në fjalë dhe u pastrua e u riparua objekti në të cilin më vonë u helmuan ushtarët shqiptarë dhe pastaj objekti iu dorëzua komandantit të kazermës në gjendje të rregullt.

Si janë zbuluar eshtrat e shqiptarëve në Babin – Kuk?

Sipas mediave kroate, zbulimi i eshtrave të shumë njerëzve në fillim të muajit maj në një grumbull dheu afër një objekti në lagjen Babin – Kuk të Raguzës i ka trazuar shpirtrat e raguzasve, ngase fillimisht dyshohej se ishin eshtra të ustashëve të vrarë gjatë LDB. Gërmimet e dheut kishin filluar nga barakat e hotelit "Libertas Ryxos" e deri te "Varrezat e ustashëve". Vetë qytetarët e kishin lajmëruar gazetën "Dopisni list" për atë që kishin zbuluar.

Në fillim të vitit 1945 Shtabi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë kishte dhënë urdhër për mobilizimin e shqiptarëve dhe për plotësimin e brigadave partizane. Atëherë vija e frontit lëvizte nga Sremi e deri në lumin Neretvë, ndërsa njësitë ushtarake nga Kosova, të cilat "po i plotësonin" repartet ushtarake drejt frontit, kanë arritur deri në Raguzë. Natën e kanë kaluar në kazermën ushtarake në Babin - Kuk, në kuadër të së cilës ishte edhe baraka e ndërtuar nga ushtria italiane, ku më vonë janë helmuar ushtarët shqiptarë. Madje, ishte folur se si malazeztë për hakmarrje i kishin helmuar disa ballistë si i çuanin ata rekrutët shqiptarë.

Në ditët e turbullta të luftës ky krim mund të bëhej aferë, pasi qytetarët ishin alarmuar dhe ishin angazhuar për ndihmë. Prandaj OZN-a me shpe-

jtësi kishte dërguar në vendin e ngjarjes një komision hetimor. Madje, flitej se OZN-a e kishte vrarë komandantin e ushtrisë për qytetin, Ilija Antunoviqin, i cili ishte nga rrethina e qytetit bregdetar Makarska. Mirëpo, më vonë u mësua se "Ilija gjakatarin", siç e kishin quajtur, nuk e kishin vrarë, por e kishin dërguar në Beograd, gjoja se te ai nuk kanë gjetur fakte për këtë tragjedi. Sipas shtypit kroat, viktimat ishin fshehur. Flitej se një numër i madh i viktimave janë varrosur në "Varrezat e ustashëve". Për këto varreza është mësuar vetëm pas vitit 1990, kurse punëtorët e ndërmarrjes funerale "Bonivono", sipas drejtorit Zlatko Urshiq, i kanë rivarrosur të gjitha eshtrat e gjetur.

Varrezat kanë mbetur të braktisura deri në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, prej kur për to kujdeset shoqata "Ustashi Hrvatske". Kryetari i kësaj shoqate, Peshiq, ka rrëfyer: "Në kadastër kemi gjetur se në ç'vend afër varrezave ustashe janë varrosur shqiptarët, ku janë varrosur ata që janë vrarë në Orsul e ku janë ata që janë vrarë në malin e Trebinjës. Për të informuar opinionin e gjerë për eshtrat e zbuluara kemi shkruar në 15 adresa, por askush nuk lëvizi".

Pjesa më e madhe e kufomave janë eskhumuar më vonë, kurse për këtë qëllim pohohet se në Raguzë kishte shkuar edhe një delegacion nga Kosova përbërja e të cilit nuk është ditur. Peshiqi ka shtuar se ato kufoma janë trajtuar me respekt dhe njerëzisht, pavarësisht se të kujt ishin ato. "Duhet të veprojmë si njerëz të civilizuar e jo të lejojmë që dheu me eshtrat e njerëzve të hedhet në deponi, meqë sjellja ndaj të ndjerëve është pasqyrë e sjelljes sonë në përgjithësi", ka shpjeguar Peshiqi.

Si i humbën gjurmët e kufomave?

Kreu ushtarak, shtetëror dhe partiak jugosllav, i cili e kishte inskenuar ngulfatjen me materie kimike (gaz) të rekrutëve shqiptarë, i pashembullt në histori, kishte planifikuar edhe zhdukjen e kufomave, në mënyrë që të gjitha gjurmët e krimit të mbuloheshin, kurse ngjarja të harrohej sa më shpejt që ishte e mundur. Për këtë qëllim Raguza ishte zgjedhur si vendi më i përshtatshëm për krimin gjenocidal, sepse, sipas autoriteteve shoviniste jugosllave, gjenocidi në luftë mund edhe të "mbulohej" apo të justifikohej. Madje, ishte llogaritur se askush nuk do të dyshonte se serbët, malazezët e maqedonasit mund ta bënin një krim të tillë në Kroaci. Kështu, Raguza bëhet varri më i madh i shqiptarëve, pas Tivarit.

Në dokumentet arkivore jugosllave duket se nuk ka shënime dhe as gjurmë për vendin e varrimit të shqiptarëve të vrarë në kazermën ushtarake të Raguzës (përveç varrezës masive në "Babin Kuk") dhe as që janë bërë përpjekje për identifikimin e tyre.

Nga të dhënat që kanë dhënë disa qytetarë raguzas dhe trebinjas, si është Mustafa Spasiq, por edhe nga të dhënat e Hasan Zukës, i cili më vonë

kishte qenë në shërbim ushtarak në Raguzë dhe Trebinjë, i cili kishte biseduar me disa qytetarë të Trebinjës, të cilët kishin qenë dëshmitarë me rastin e sjelljes së kufomave të shqiptarëve me kamiona të mbuluara nga Raguza në Trebinjë, numri më i madh i viktimave të Raguzës janë hedhë në dy ujdhesat më të afërta.

Nga këto të dhëna, me të drejtë mund të përfundojmë se:

a) një numër i kufomave të ushtarëve shqiptarë të ngulfatur janë bartur me kamiona dhe janë hedhur në det,

b) një pjesë e tyre janë varrosur në varrezë masive në "Babin Kuk" dhe Orsul, për të cilën që nga viti 1990 kujdeset shoqata "Ustashi Hrvatske" në Orsul.

Historiografia jonë e ka detyrë profesionale t'i hulumtojë terrenet e afërta, në mënyrë që t'i zbulojë varrezat kolektive dhe martirët të sillen në vendin e tyre.

Relativizimi i krimit dhe heshtja e kreut jugosllav

Një tendencë për ta relativizuar dhe për ta minimizuar helmimin e rekrutëve shqiptarë në Raguzë më 18 prill 1945, e bëri A. Rankoviqit në Kongresin e Parë (themelues) të Partisë Komuniste të Serbisë, mbajtur më 8 dhjetor 1945.

A. Rankoviqi, i cili është edhe ekzekutues i këtyre krimeve, pasi kishte folur për "incidentin" e Tivarit, do të deklarojë: "Rasti tjetër, i cili prapë është rrjedhim i burokracisë dhe i kriminalitetit të pavetëdijshëm, është se disa shqiptarë nga ai transport u vendosën në lokalet ku më herët ishte ndonjë depo e barutit dhe aty u ngulfatën 130 njerëz".

Por, Rankoviqi nuk kishte përmend emrin e komandantit dhe as njësitin ushtarak, përgjegjës për krimin. Nuk kishte përmend vendin dhe as ditën e krimit. Askush tjetër në atë Kongres nuk e kishte thënë asnjë fjalë në diskutimet vijuese. Delegatët e Kongresit, shumë nga të cilët ishin edhe vetë dëshmitarë të ngjarjeve dhe jo vetëm dëshmitarë, nuk ndjenë dhembje për "300 shqiptarë" të vrarë në Tivar dhe për "130 shqiptarë" tjerë të ngulfatur në Raguzë. Në mesin e pjesëmarrësve të Kongresit ishin edhe Dushan Mugosha, Gjoka Pajkoviqi, Fadil Hoxha, Mehmet Hoxha, Xhavid Nimani e të tjerë, të cilët kanë ditur për krimet, por kanë heshtur. Vetëm Xhavid Nimani shqitazi ka përmendur se "kohëve të fundit, kur ushtria jonë i ka mobilizuar shqiptarët, ajo ka vrarë disa shqiptarë"! Vetëm kaq. Asnjë fjalë më shumë nga ai dhe nga askush tjetër! Pse?

Lexuesi i librit mund t'i shtrojë edhe këto pyetje:

- Ku i kishte marrë Rankoviqi numrat 300 dhe 130, as më shumë e as më pak?

- Si u ngulfatën në kazermë ushtarake aq shumë njerëz, në hapësirat të cilat nuk kishin dritare për ajrosje?

- Pse në momentin kritik, kur rekrutët shqiptarë përpëliteshin me vdekjen nga helmimi, njësitë ushtarake speciale, të pajisura me maska, kishin bllokuar objektin dhe nuk i lejonin

ushtarët shqiptarë të dilnin jashtë nga dyert e as nga dritaret, me arsyetimin banal se ata gjoja nuk ishin të helmuar, por po shtiheshin të tillë me qëllim që të iknin nga lufta!!?

- As 130 ushtarë nuk mund të helmoheshin për disa sekonda, e jo më 800 ushtarë (sipas Prof. Ymer Berishës) apo 1300 (sipas burimeve tjera).

- Pse ushtarët jugosllav shtien me armë zjarri dhe vranë disa shqiptarë brenda në objekt, në momentin kur po tentonin të dilnin jashtë nga dyert e dritaret?

- Pse vetëm pas ndërhyrjes së qytetarëve të Raguzës, të cilët kishin ardhur për ndihmë, duke mos ditur se çka po bëhej, i kishin hapur dyert e dritaret e barakës në të cilën ishin helmuar rekrutët shqiptarë?

- Pse OZN-a, edhe pse ishte publikuar, nuk e vranë komandantin e atëhershëm të qytetit, Ilija Antunoviqin apo "Ilija gjakatarin", siç e quanin, por e dërguan me detyra tjera në Beograd?

- Pse u fshehën kufomat?

- Pse nuk u nis procedura e hetuesisë, nuk u kapën dhe nuk u dënuan fajtorët për këtë krim kaq të madh?

- Pse nuk ishte informuar opinioni, madje as familjet e viktimave për krimin?

- Pse edhe pas 60 vjetëve nuk janë identifikuar viktimat dhe nuk janë hulumtuar varrezat masive, ku janë groposur viktimat?

- Pse ushtarët shqiptarë, të mbytur në Raguzë, regjimi jugosllav i kishte shpallur armiq dhe familjeve të tyre ua kishte konfiskuar pasurinë, si ishte rasti i familjeve të Avdi Hajrës dhe Behram Tahirit nga Pantina, e të tjerë.

Në pohimet e A. Rankoviqit nuk ka asnjë të vërtetë. Kurse, të dhënat, të cilat i sollëm në këtë libër, janë dëshmi të pakontestueshme, të cilat saktësojnë qartë helmimin me gaz të ushtarëve shqiptarë në Raguzë, që ishte si një pjesë e skenarit, i përgatitur nga organet më të larta shtetërore nga Beogradi, Mali i Zi, Shkupi e Prishtina.

Është absurd edhe konstatimi i Dr. Muhamet Pirrakut, i cili synon të minimizojë dhe arsyetojë krimin më të madh që e njeh historia, ngulfatjen e rekrutëve shqiptarë nga kriminelët serbë, malazezë dhe maqedonas, kur thotë: "Helmimi qartë ishte incident, e jo kurth i parapërgatitur. As me këtë rast nuk u helmuan 1300 – 1500 ushtarë shqiptarë". Pirraku konteston edhe informatën për Hadsonin të Prof. Ymer Berishës, të thënë para më se 60 vjetëve, saktësisht më 22 tetor 1945, se në Raguzë Armata e Titos masakroi 800 shqiptarë. Sipas Pirrakut këtë numër "duhet parë në korrespondim me numrin e përgjithshëm të rekrutëve shqiptarë të vdekur në magazinën ushtarake ku ndodhi krimi, për të cilin dinin bukur më saktësisht përjetuesit e helmimit"! Pra, Prof. Pirraku bëhet se nuk i beson Prof. Ymer Berishës, por nuk i beson as kapiten Bajram Golës, i cili ka saktësuar se në Raguzë janë helmuar 650 shqiptarë.

Historianë dhe shkrimtarë,
Intelektualë dhe gazetarë,
Të mbijetuarit kanë një porosi,

Mos e harroni të hidhurën histori!
Çelni sytë, hulumtoni e shkruani drejt
Se ju dënojnë nënat, fëmija krejt,
Ju dënon gjaku i të vrarëve;
Dënim më të madh ju jep njerëzia
Se krimet e rënda s'i harron historia.

Dëshmitë e të gjallëve – sfidë për historianët

Në odën e Zeqir Hamzës ndodheshin dëshmitarët e ngjarjes kriminale: Bajram Bajraktari, Habib Berisha, Selim Sinani, Haxhi Maliqi, Ramë Hyseni, Hajdar Berisha, nga Tërsteniku, Hamdi Osmani e Rushit Osmani nga Besia, Latif Rushiti nga Krasmiroci, të cilët bënin pjesë në Eshalonin e Tretë. Ata kanë folur për dhunë, për mizori, për vrasje, për inskenime të incidenteve që kishin përjetuar gjatë marshimit për në Frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Shkodër, në lumin Buna, në Tivar, në Raguzë e në Tregur. Secili nga ata hezitonte t'i kujtonte ato ngjarje të tmerrshme. Në fytyrat e tyre vërehej pezmi, me emocione të përziera, kur pohonin: "Dyzet e pesë vjet po e bartim këtë peshë të rëndë shpirtërore, sepse ishim të detyruar të heshtim deri tash. Nuk dëshirojmë të shkojmë nga kjo botë pa e dhënë edhe ne kontributin tonë për ndriçimin e këtyre masakrave, e në veçanti, për helmimin e rekrutëve shqiptarë më 18 mars 1945 në Raguzë".

Habib Berisha nga Vasileva ka pohuar: "Jemi mobilizuar në Eshalonin e Tretë të marsit 1945. Në Prizren u jemi bashkangjitur rekrutëve tjerë shqiptarë të ardhur nga Tetova, Gostivari, Kërçova, Shkupi, Kumanova etj. Posa jemi dorëzuar, ushtarët shqiptarë, pa marrë parasysh nga ishin, u gjetën në një situatë shumë të rëndë, sepse nuk dinim se çka po bëhej me ta, nuk po kuptonim nëse ishim ushtarë apo robër lufte. Në ato rrethana shumë të rënda, më 1 prill 1945, arritëm në Tivar, ku ende vëreheshin gjurmët e masakrës. Ne nuk mund të besonim se një masakër, me përmasa aq të mëdha, mund t'u kishte ndodhur bashkëluftëtarëve të tyre, deri sa na informoi hollësisht Haxhi Haziri nga Pograxha, i cili e kishte përjetuar ngjarjen pasi ishte futur në një kotec të pulave. Pas qëndrimit disa ditësh në Tivar dhe vende tjera të bregdetit Adriatik, më 17 prill 1945, rreth orës 19 kemi mbërri në Raguzë..."

Bajram Gola: Për likuidimin e shqiptarëve u angazhuan të gjithë; ushtarë e qytetarë

Bajram Gola ka dëshmuar se në Tivar janë masakruar 4300 ushtarë shqiptarë, kurse në Raguzë janë mbytur një mijë të tjerë. Bajrami ka dëshmuar edhe për thirrjen e komandantëve ushtarakë: "Zhivela osveta, tako vam je trebalo shiptarima" (Rroftë hakmarrja, kështu u duhej bërë shqiptarëve).

Sipas Bajramit, nuk kishte mjaftuar krimi, por, duke treguar "trimëri", kriminelët kontrollonin kufomat dhe të plagosurit që merrnin frymën e fun-

dit, i vrisnin aty për aty ata, ua fusnin duart nëpër xhepa dhe ua plaçkitnin gjërat me vlerë. Një numër i vogël i rekrutëve në valën e masakrimit kishin kaluar muret dhe ishin shtrirë bregut, por nuk dihet se a kanë shpëtuar, sepse, përveç ushtarëve të Brigadës X malazeze, për t'i zënë ata që kishin shpëtuar ishin organizuar edhe qytetarët, që nga Ulqini e deri në Kotor. Bajram Gola tregon se si njëri nga eprorët malazezë i kishte përjetuar ato vrasje: "Lëkura më rrëqethej kur i zinin ata që kishin shpëtuar nga masakra duke u fshehur nëpër kaçuba, të cilët i vrisnin pa aspak mëshirë. Kurrë nuk do t'i harroj ato skena tragjike", thoshte malazezi dhe qante. Më pyeste: O Bajram, a e dinë shqiptarët dhe prindërit e të masakruarve për këtë tragjedi".

Një rrëfim nga Stambolli

Të qëndrosh sado pak në Stambollin e lashtë, mund të takohesh me ndonjë njeri të moshuar dhe gjatë bisedës me të, mund të ndalesh doemos te Masakra e Tivarit apo te helmimi i ushtarëve shqiptarë në Raguzë, ka shkruar Dr. Ali Jakupi.

Në arealet e lagjes "Saraj" të Stambollit, në janar 1957, gjatë një darke të rëndomtë, në tavolinën tonë ia behu një burrë i moshuar, por i pashëm dhe inteligjent. U pa se ai donte të hynte në bisedë me ne. Më vonë mësuam se ishte pronari i hotelit dhe quhej Mustafa Spahiq. Ishte me prejardhje nga Doboji i Bosnjës. Nga dokumentet që kishim dorëzuar në recepcion, ai kishte mësuar se ne ishim shqiptarë nga Kosova. Gjatë bisedës me të, u zu ngojë edhe Masakra e Tivarit. Ai filloi t'i shfletojë kujtimet e veta gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u ndalur sidomos për ngulfatjen e rekrutëve shqiptarë në Raguzë. "Atëherë isha duke shërbyer si ushtar në Raguzë", fillon rrëfimin me lot në sy boshnjaku Mustafa Spahiq. "Banorët e Raguzës posa u informuan për këtë tragjedi, të gjithë, burra e gra, vrapuan për t'u ndihmuar ushtarëve shqiptarë të helmuar, ndërsa ata që jepnin shenja jete, i dërgonin në spital të Raguzës. Këta qytetarë, por edhe ata të Trebinjës dhe lokaliteteve përreth, zbuluan edhe një të vërtetë të madhe, faktin se helmimi i rekrutëve shqiptarë do të vazhdonte deri në personin e fundit, sikur aty të mos shkonin qytetarët raguzian"... "Pikërisht frika nga përsëritja e skenave të tilla të tmerrshme edhe në të ardhmen na kanë detyruar t'ia kthejmë shpinën vendlindjes edhe ne. Tash këtu jetoj mirë, por malli për vendlindjen nuk po shuhet kurrë. Çmallem paksa vetëm kur vijnë këtu njerëzit tanë nga ato anë", tha në fjalën lamtumirëse të asaj nate Mustafa Spahiqi.

Edhe sipas tregimeve të përjetuesve nga Debreshi dhe Vranjeci, rrethi i Gostivarit, që kjo tragjedi të ishte kaq e madhe kishin ndikuar njësitë ushtarake speciale me maska, të cilët i pengonin ushtarët shqiptarë të dilnin nga dera dhe nga dritaret, me pretekst se gjoja shqiptarët po donin të iknin nga lufta.

Kapitulli V - TREGURI

EDHE NJË SKENAR I KOBSHËM NË TREGUR

Kriminelët nuk ishin ngopur me masakrimin e mbi 4300 shqiptarëve në Tivar, por kishin përgatitur edhe skenare dhe kurthe të tjera në Raguzë e Tregur të Dalmacisë, tash me metoda e strategji të re, me helmime e me fundosje të ushtarëve shqiptarë në det, në mënyrë që ngjarjet të kamufloheshin si të rastësishme dhe pa shkaktuar jehonë në opinion. Një krim pra duhej të kryhej edhe në Tregur të Dalmacisë, në territorin e Kroacisë, sepse atje ndoshta nuk do të dyshohej se tragjedinë e kishin shkaktuar serbët e malazezët, por, nëse ngjarja zbulohet, atë mund ta kishin kryer kroatët!

Në Eshalonin e Dytë, që shkonte drejt frontit të bregdetit Adriatik, marshuan edhe qindra luftëtarë nga komuna e Kaçanikut. Këta luftëtarë shumica ishin të rinjë, por edhe pionierë, që ende s'i kishin rënë brisk fytyrës dhe që deri atëherë nuk kishin dalë nga shtëpia, e jo më të marrin një rrugë aq të gjatë, të vështirë e të mundimshme. Shumica prej tyre deri atëherë kishin qenë barinjë. Kështu tregonte edhe Minush Kuçi, i cili rrugën për në luftë e kishte marrë kur ende nuk i kishte mbushur pesëmbëdhjetë pranvera.

Dëshira dhe entuziazmi se po shkonin të luftonin kundër fashizmit ishte e madhe, ngase ishin të vetëdijshëm se pavarësia e plotë, liria dhe e drejta për vetëvendosje mund të fitoheshin vetëm me luftën e përbashkët të koalicionit antifashist kundër nazifashizmit dhe aleatëve të tij. Kjo bindje bënte që ata të mos e ndienin lodhjen, por nuk e dinin se do të binin viktimë e skenarëve gjenocidalë të bashkëluftëtarëve të tyre serbë, malazezë dhe maqedonas, të cilëve nuk mund t'u gjendet edhe një shembull tjetër në historinë e njerëzimit.

Përcjellje me dhembje e lotë në sy

Pasi u përcollën nga familjet e tyre me shumë dhembje e me lotë në sy, luftëtarët u tubuan në Ferizaj, ku qëndruan disa ditë, derisa autoritetet e kohës kishin tubuar aty edhe luftëtarë tjerë të mobilizuar nga fshatrat përreth. Në rrugë për në frontin e Adriatikut luftëtarët kosovarë kaluan nëpër shtigje të vështira, duke filluar nga Shtimja, nëpër Prizren, Kukës, Shkodër e deri në Tivar, ku përjetuan masakrën e madhe të Tivarit.

Ata që patën fatin t'i shpëtonin masakrës së Tivarit, por edhe vrasjeve gjatë rrugëtimit, vazhduan rrugën me anije përgjatë bregdetit Adriatik. Meqë Treguri me rrethinë ishte çliruar nga okupatori disa muaj më parë, më 28 tetor 1944, kazermat ushtarake

të këtij qyteti të lashtë u shërbenin njësive ushtarake të ish – Jugosllavisë. Ushtarët shqiptarë i kishin vendosur në këto kazerma për pushim dhe për përgatitjet e fundit për t'u ballafaquar me forcat gjermane në frontet e Istries, të Kninit dhe kudo ku e kërkonte nevoja. Në mesin e kësaj ushtrie, që përbëhej nga shqiptarët e Kosovës dhe të viseve perëndimore të Maqedonisë, ishin edhe shumë luftëtarë nga komuna e Kaçanikut.

Në Tregur, në këtë qytet të vogël e të bukur të Dalmacisë, luftëtarët shqiptarë ishin vendosur në dy pjesë të tij. Shumica prej tyre kishin kaluar kanalin që ndante qytetin me ujdhesën Çiova dhe ishin vendosur në ish - kazermat e ushtrisë së Jugosllavisë monarkiste. Ndërsa, njësiti tjetër ishte vendosur nëpër disa shtëpi private përreth kanalit, pa kaluar në anën tjetër të tij. - Këtu për herë të parë u armatosëm me pushkë, me municione dhe u veshëm me uniforma angleze, - dëshmojnë pjesëmarrësit e këtyre njësive. Të bindur në idealin se po shkonim në front, - thonë Minush Kuçi dhe Ilaz Ymeri, - në asnjë moment nuk na shkonte mendja se ndaj nesh mund të përgatiteshin kurthe kaq monstruoze e djallëzore, si ishte fundosja e ushtarëve në det në Tregur.

Një natë, në pjesën e parë të prillit 1945, pak para se të gëdhinte dita e re, erdhi urdhëri për vazhdimin e rrugës për në front. Para se të marshonin ushtarët nga Treguri drejt fronteve të luftës, disa oficerë të lartë u thanë atyre se tani detyrë e shenjtë e secilit mbetet lufta e pamëshirshme kundër nazizmit gjerman dhe mbeturinave të shoqërisë (ustashë, çetnikë, bjellogardistë etj.), në mënyrë që të shpejtohet çlirimi definitiv i vendit, sepse "vetëm me luftë të armatosur, krah për krah me Aleancën Antifashiste, krijohet mundësia e fitimit të plotë të pavarësisë dhe e drejta për vetëvendosje". Për këtë qëllim u tha se nuk duhet kursyer asgjë. Po ashtu u komunikua se së shpejti do të na bashkojnë me luftëtarët trima dalmatinas dhe se, duke luftuar së bashku, krah për krah me ta, do të ndërtohet e do të kalitet vëllazërimi e bashkimi i popujve tanë, etj.

Të bindur në idealet e larta që shtronte para nesh fakti se shkonim në front, për asnjë moment nuk na shkonte mendja se ndaj nesh mund të përgatitej kurthi kaq monstruoz e djallëzor. Të gjithë luftëtarët shqiptarë u zotuan se do të luftojnë deri në fund, se nëpër shtëpitë e tyre do të ktheheshin bashkë me fitoren ose se ishin të gatshëm të binin fli për liri. Kështu e kujtojnë atë kohë e ato ngjarje pjesëmarrësit në ngjarjen tragjike të Tregurit.

Kanali i kobshëm

Për të marshuar për në front, ushtarët shqiptarë, që ishin të vendosur në kazermat ushtarake në ujdhesën Çiova, duhej ta kalonin përsëri kanalin që e ndante me qytetin. Meqenëse urën që lidhte dy brigjet e kanalit e kishin shkatërruar nazistët gjermanë me rastin e tërheqjes së tyre nga qyteti, luftëtarëve shqiptarë iu desh që këtë kanal të gjerë rreth 100 metra ta kalo-

nin me disa anije - barka të vjetra dhe të papërshtatshme. Si ka rrjedhë situata?

Grupi i parë kishte kaluar në anën tjetër të kanalit. Në grupin e dytë, thonë dëshmitarët, eprorët ushtarakë serbo - malazias, përgjegjës për "kujdesin" dhe rrugëtimin tonë, me dhunë na futën në një anije të vjetër dhe shumë të papërshtatshme. Ishim 150-180 luftëtarë shqiptarë që ishim ngarkuar në një anije dhe secili prej nesh ishte i ngarkuar edhe me armë e pajisje tjetër ushtarake. Kështu, u pa qartë se pesha e përballueshme e anijes ishte tejkaluar dy-tre fish. Dhe, pasi anija kaloi 20 - 30 metra nga bregu, u dëgjua një krismë e fuqishme, me ç'rast anija është shkatërruar, është ndarë në dysh, duke i lëshuar në ujë të gjithë ushtarët shqiptarë. Për të qenë tragjedia edhe më e madhe dhe pozita e tyre në valët e detit tepër e keqe, pothuaj se asnjëri nga luftëtarët shqiptarë nuk dinte të notonte. Aq më keq kur ushtarët ishin të veshur me uniforma ushtarake dhe në shpinë kishin të ngarkuar pushkë, municion, pajisje tjetër ushtarake, veshmbathje, ndonjë batanie etj. Britmat e thekshme, klithjet dhe kërkimi i ndihmës nga ushtarët shqiptarë që përpliteshin në valët e detit dhe kacafyteshin me vdekjen, por edhe të atyre që përpiqeshin t'i ndihmonin sadopak të tjerët nga moli, ishin shndërruar në një kor të fuqishëm. - Si t'u ndihmojmë!, - thërrisnin njëri – tjetrin ata që ndodheshin në mol.

- Në këtë anije më futën edhe mua, bashkë me disa shokë të tjerë, të afërm të mi, - tregonte Ali Bushi nga Hani Elezit, i cili e kishte përjetuar tragjedinë e Tregurit. - U nisëm për në anën tjetër të kanalit, por së shpejti ngjau diçka e papritur për ne. E di vetëm se rashë në ujë dhe se njëherë arrita ta ngre kokën mbi ujë, kur pashë shumë plisa të bardhë që notonin në det. Dëgjova edhe disa britma të thekshme duke kërkuar ndihmë. Më shumë nuk më kujtohet asgjë. Shokët më kishin nxjerrë të pavetëdijshëm në breg, duke menduar se isha i vdekur dhe më kishin radhitur në stere në një rresht me kufomat e shokëve të mbytur aty pranë kanalit.

Shokat shpëtimtare

Shumica e luftëtarëve shqiptarë, kur i kishin ndërruar kostumet e tyre kombëtare me uniformat ushtarake, kishin marrë me vete shokat e veta, si një shenjë, sigurisht për ta hequr mallin e familjes.

Në çastin tragjik, pasi ishin futur në trajekt, eprorët ushtarakë dhe njësitë tjera ushtarake, përgjegjëse për përcjelljen e ushtarëve shqiptarë, pa u vërejtur ishin larguar nga vendi i ngjarjes së ardhshme. Dhe, derisa ushtarët shqiptarë përpëliteshin në valët e detit dhe po kacafyteshin me vdekjen, eprorët, jo vetëm se nuk u angazhuan për shpëtimin e tyre, por as nuk ishin dukur fare në vendin e ngjarjes. Ata sigurisht kanë pandehur se ushtarët shqiptarë nuk kishte kush t'i ndihmonte dhe, duke mos e ditur notin, do të mbyteshin të gjithë ata që kishin hipur në anije. Prandaj, sigurisht se ata pandehnin se nuk do të

mbetej as edhe një dëshmitarë i gjallë.

- Kur u shkatërrua anija dhe u fundosa, isha mbështetur për Rizahun e katundit Rekë, të cilin nuk e pashë kurrë më, - ka treguar plaku Rexhep Malsiu. Edhe unë rashë në ujë, tha ky plak, por Rrahim Gudaçi i Stagovës ma gjuajti shokën e vetë për të cilën u kapa dhe dola në breg, duke shpëtuar nga vdekja e sigurtë. Atë ditë nuk do ta harroj kurrë, - ka përfunduar Rexhepi.

Pasi me rastin e tragjedisë ishte bërë alarm i madh, kjo gjendje i kishte alarmuar edhe qytetarët e Tregurit. Burrat e Tregurit nuk ndodheshin nëpër shtëpitë e tyre, sepse ata i kishte marrë lufta, por në ndihmë kishin shkuar pleqtë dhe gratë. Ata i kishin sjellë shumë shpejt disa barka të vogla, me të cilat i nxorën shumë luftëtarë të gjallë nga uji, të cilët ende përpliteshin mes jetës e vdekjes, por edhe të mbyturit. Për këtë tragjedi na kanë rrëfyer, pos shumë dëshmitarëve, edhe tregurasit Ivan Buble, Ante Rozhiq dhe bashkëshortët Jozo e Ana Gujina. Edhe banorët e Tregurit e kishin ndarë dhembjen, së bashku me luftëtarët shqiptarë, për tragjedinë e kobshme në kanalin e Tregurit.

Sipas pohimeve të shumë dëshmitarëve, të cilët jo vetëm se e përjetuan këtë tragjedi, por edhe që u angazhuan për dhënien e ndihmës luftëtarëve të fundosur në kanalin që ndanë qytetin e Tregurit me ujdhesën e afërme Çiova, u nxorën dhe u identifikuan 29 shqiptarë të mbytur, ndërsa numri i përgjithshëm i atyre që humbën jetën nuk do të dihet kurrë.

Shokat e hedhura nga shokët në breg të kanalit dhe ndihma e qytetarëve të Tregurit ishin vendimtare për shpëtimin e jetës së dhjetra ushtarëve shqiptarë, të cilët fatmirësisht e përjetuan tragjedinë.

Nderimet e fundit për 29 martirët e tregurit

Pasi u nxorën viktimat nga uji, të cilat u rreshtuan në stere, luftëtarët dhe tregurasit, së bashku e të pikëlluar për këtë humbje të madhe, u rreshtuan për t'ua bërë nderimet e fundit luftëtarëve të rënë. Qytetarët e Tregurit, përveç ndihmës dhe pjesëmarrjes në pikëllim, caktuan edhe një lokacion të veçantë ku do të varroseshin këta martirë kosovarë, të cilët humbën jetën në ujin e ftohtë të detit në qytetin e lashtë ilir të Tregurit.

Nga kanali në mes të ujdhesës Çiova dhe qytetit të Tregurit u nxorën dhe u identifikuan 29 kufoma të ushtarëve shqiptarë nga komuna e Kaçanikut, prej të cilëve 14 ishin nga rrethina e Hanit të Elezit dhe një nga fshati Varosh i komunës së sotme të Ferizajt. Ata janë:

Ajet M. Murseli (1917, Doganaj), Arif Sh. Provaliu (1918, Sopot), Azem H. Berisha (1920, Runevë), Ahmet A. Dernjani (1920, Paldenicë), Avdi I. Buqi (Drenushë), Bajram Sh. Bushi (1930, Pustenik), Beqir I. Çupi (1921, Paldenicë), Qamil I. Sopa (1923, Nikoc), Fetush Sh. Berisha (1924, Guranë), Hazir B. Berisha (1919, Guranë), Habib Xh. Brruti (1917, Drenushë), Hamit Xh. Topojani (1924, Neçac), Hasip M. Luma (1918, Qafëshqipe), Hamit L. Bela (1925,

Kodërtrim), Hazir V. Çupi (1926, Paldenicë), Ipë A. Qajani (1927, Kryenik), Jashar Sh. Dernjani (1919, Paldenicë), Kasem Sh. Berisha (1920, Guranë), Kadri L. Dullovi (1922, Bicaj), Nuredin M. Derguti (1923, Varosh, Ferizaj), Nazmi A. Bushi (1929, Puset e Nikës), Nazmi A. Huneli (1928, Rrezanë), Riza I. Kasa (1913, Malësi), Sabri A. Bushi (1929, Puset e Nikës), Ukshin H. Palloshi (1923, Bicaj), Veli V. Koka (1912, Runevë), Xhavit Sh. Koraçi (1920, Kurbali), Xhemajl V. Kaloshi – Berisha (1924, Guranë), Xhavit I. Reka (1926, Kurbali).

Shtabi ushtarak që komandonte ushtarët shqiptarë dukej se nuk ishte ngopur ende me krimin e bërë ndaj luftëtarëve shqiptarë në kanalin e Tregurit. Menjëherë pas varrimit të 29 viktimave, u vazhdua rruga për frontin e luftës në Istri dhe Knin, për t'u bërë mish për top në luftë me gjermanët. Kurse këta ushtarë tepër të rinj, të papërgatitur për luftë, të cilët më parë nuk kishin pasur armë në dorë, e kishin lënë Kosovën e tyre të riokupuar.

Luftëtarët e lënduar dhe të sëmurë rëndë nga fundosja e anijes ishin dërguar nga qytetarët e Tregurit në spital, ku kanë qëndruar disa ditë për shërim e pastaj edhe ata e kishin vazhduar rrugën e gjatë e të rrezikshme të luftës për në frontin veriperëndimor të Adriatikut.

Edhe pse ishin të papërvojë e të papërgatitur për luftë, ushtarët shqiptarë me sukses luftuan në kuadër të Armatës IV jugosllave kundër nazistëve gjermanë dhe aleatëve të tyre.

Edhe disa dëshmi rrëqethëse

Ali Bushi për vete ka thënë se ka pasur dy jetë. Për herë të dytë ka lindur në një agim prilli të vitit 1945 në qytetin e Tregurit (Trogir) të Dalmacisë, kur eprorët ushtarakë serbo - malazias, përgjegjës për "kujdesin" dhe transportimin e ushtarëve shqiptarë, i futën nja 180 luftëtarë shqiptarë në një anije të vjetër. Pasi anija kaloi 20 - 30 metra nga bregu i kanalit, ajo u nda në dysh dhe u shkatërrua plotësisht, kurse 180 luftëtarë ranë në valët e detit. - Por, unë shpëtova. Aty humbën jetën, u nxorën nga deti dhe u identifikuan 29 veta, mes të cilëve edhe dy kushërinjë dhe shokë të mi; Sabriu dhe Bajrami, - ka treguar Ali Bushi.

Xha Aliu ishte histori në vete. Kishte përjetuar e çfarë nuk kishte përjetuar. Hoqi të zitë e ullirit, si shumë bashkëluftëtarë të tij. Në kujtesën e tij brilante mbante mend shumëçka për masakrën e Tivarit, atë të Tregurit dhe për mizoritë që kishin përjetuar gjatë rrugës për në frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri.

Për xha Aliun kisha dëgjuar edhe më parë, veçanërisht si pjesëmarrës i ngjarjes së Tregurit. Kur u takova me të, shkruan Berat Luzha, autor i këtij shkrimi, ia tregova qëllimin: - dua të shkruaj për gazetë, - i thashë. Dhe pa pritur "lutje", i emocionuar, ia filloi rrëfimit, një rrëfimi të prekshëm. Shpejt e vërtetova se xha Aliu nuk rrëfente se ashtu e donte puna, por sepse ato ngjarje iu kishin ngulitur thellë në shpirt dhe ngase dëshironte

që përjetimet e tij t'i mësojnë të gjithë.

- Rruga ishte shumë e vështirë. Nga Hani i Elezit e deri në Tivar, thoshte ai, udhëtuam këmbë, të uritur, të etur, pa veshmbathje... Mbi 80 për qind ishim të zbathur, me këmbë të gjakosura, ngase gjatë rrugëtimit të gjatë na ishin grisur opingat e lëkurës. Gjatë tërë rrugës përjetuam dhunë, mizori, vrasje, inskenime të incidenteve, pushkatime para kolonës së ushtarëve etj.

Përpara, thotë Berat Luzha, kisha një njeri që kishte sakrifikur edhe jetën, që për pak e gjeti vdekjen në valët e pamëshirshme të kanalit të Tregurit. Një njeri i cili në moshën e tij të njomë marshoi skajeve më të largëta të Jugosllavisë në ndjekje të armikut.

"Disa orë para agimit duhej t'i lëshonim kazermat që ta vazhdonim rrugën e luftës kundër gjermanëve, ustashëve, bjellogardistëve e aleatëve të tjerë të okupatorit. Kanalin që na ndante nga pjesa kontinentale duhej ta kalonim me një anije të vogël e të vjetër. Një turrë kaloi në bregun tjetër. Në turrën e dytë, përveç shumë të tjerëve, më futën edhe mua. U nisëm, por shpejt ngjau e papritura; nga pesha e rëndë apo ndoshta nga ndonjë eksplodim, anija u nda në dysh, kurse shokët filluan të bien në det. Nuk di si rashë edhe unë, por e di se vetëm njëherë e kam ngritur kokën mbi ujë. Pashë vetëm plisa të bardhë që notonin dhe dëgjova britma të thekshme shpëtimi. Më shumë nuk di asgjë. Shokët më kishin nxjerrë të alivanosur dhe, duke menduar se jam mbytur, më kishin renditur me të mbytu-rit. Vetëm pas disa kohe, njëri prej shokëve të mi kishte hetuar disa shenja jete te unë dhe në vend se në varreza, më kishin dërguar në spital", - ka shpjeguar Aliu.

Për shpëtimin e luftëtarëve të fundosur kishin dalë edhe luftëtarë tjerë, të cilët kishin banuar afër vendit të ngjarjes. Ndër ta ishte edhe Nazmi Bushi, i cili menjëherë e kishte kuptuar se vëllai i tij, Bajrami, po bënte përpjekje për jetë a vdekje. Por, si t'i ndihmohej, kur as vetë nuk dinte not? Alarmin e kishin dëgjuar edhe banorët e qytetit, ku kishte vetëm gra, pleq e fëmijë, se burrat kishin shkuar në luftë. I sollën disa barka të vogla, me të cilat u nxorën disa shokë tanë. Ata e ndanë hidhërimin bashke me ne, ata qanin bashkë me ne…

Në Tregur, një ditë shtatori të vitit 1979, për ta vizituar varrin e përbashkët të luftëtarëve të rënë në këtë ngjarje, kishte shkuar edhe Isa Bushi, djalë i vetëm dhe trashëgimtar i Sabriut, pastaj Arif Dernjani e Xhemajl Koraçi. Xhemajlin babai i tij e kishte lënë vetëm trejavësh.

Për tragjedinë e Tregurit kanë dëshmuar edhe Minush Kuçi, Raif Zharku e shumë luftëtarë nga Kaçaniku.

Edhe bashkëshortja e të ndjerit Xhavit Sh. Koraçi nga Trimori (Kovaçeci) me mallëngjim e lot për faqe rrëfen për masakrën e Tregurit dhe thotë: "Asokohe, kur e mobilizuan bashkëshortin tim, isha nuse vetëm 20 – vjeçare. Kisha djalin trijavësh, të cilin Xhaviti e kishte pagëzuar me emrin Xhemajl. Para se të dilte nga shtëpia, ishte shumë i mërzitur, i

rodhën lotët, duke u përpjekur që lotët të mos ia shihnin të tjerët. Nxora nga paja dhe ja dhashë dy palë meste, dy këmisha, tëlina, një shall dhe çorape. As që më shkonte mendja se këto do të ishin gjërat e fundit që do t'ia jipja bashkëshortit tim. Për të më ngushëlluar, më porositi të mos mërzitem, sepse tha se shpejt do të kthehej në shtëpi. Më porositi të kujdesem për djalin. Fjalët e fundit që ia thashë ishin se do të mundohem të rris fëmijën sa më mirë. Pasi djalin e kisha shumë të vogël, nuk mund të shkoja e ta përcillja e as ta vizitoja deri sa qëndronte në Ferizaj. Pas disa ditëve flitej se nga dora e zezë serbo - malazeze e maqedonase në Tivar janë masakruar më shumë se 5000 ushtarë shqiptarë. Kjo na shqetësoi shumë, por shpresoja se bashkëshorti im një ditë megjithatë do të kthehet në shtëpi dhe në mesin familjar. Mirëpo, një ditë arriti lajmi se xhelatët nuk ishin ngopur vetëm me gjakun e Tivarit, por kishin përgatitur edhe një kurth tjetër në Tregur, ku gjetën vdekjen shumë shqiptarë. Në mesin e tyre kishte qenë edhe bashkëshorti im, të cilin e kishim përcjellë me lotë në sy dhe prisnim me padurim të na kthehej në shtëpi. Kështu, u shua edhe shpresa e jonë e fundit. Vështirë i përballoja ato momente kur më kujtoheshin fjalët e tij të fundit, përshëndetjet, porositë…"

Këto dhembje dhe tronditje përjetuan edhe shumë prindër, fëmijë, nuse dhe vajza që pritnin bijtë e tyre, etërit, bashkëshortin, të fejuarin, vëllanë.

Nazif Bushi, Minush Kuçi dhe Raif Zharku, në intervistën dhënë Azem Hajdinit - Xanit, mes tjerash, kanë pohuar: - "O Azem! Dyzet e pesë vjet po e bartim këtë peshë të rëndë shpirtërore, por kemi qenë të detyruar ta heshtim deri tash. Nuk dëshirojmë të shkojmë nga kjo jetë pa e dhënë edhe ne kontributin tonë modest për ndriqimin e këtyre masakrave të papara në historinë e njerëzimit. Mobilizimi i shqiptarëve të moshës prej 16 – 65 vjet, në kohën kur Lufta e Dytë Botërore ishte në përfundim e sipër, kishte për qëllim izolimin dhe asgjësimin e forcës aktive shqiptare në një kohë dhe në një vend më të përshtatshëm, jashtë trojeve të tyre, gjë që u pa në Tivar, në Tregur, në Raguzë etj. Nga Prizreni deri në Tivar na i vranë disa qindra shokë. E kursenin më shumë një plumb se një jetë njeriu, andaj na therrnin me bajoneta. Prej 5000 ushtarëve shqiptarë, sa u nisëm nga Prizreni, shpëtuam shumë pak. Mos pyet për tmerre. Në Tivar gjaku ecte si uji i shiut pas shtrëngatës. Atyre pak luftëtarëve shqiptarë, që e patën fatin t'i shpëtojnë masakrës së Tivarit, xhelatët e pashpirtë ua përgatitën kurthin tjetër në Tregur, kur në det u fundosën 180 luftëtarë shqiptarë. Me ndihmën e shokëve dhe banorëve të Tregurit, të cilëve u jemi mirënjohës përjetë, u nxorën dhe u identifikuan 29 trupa të pajetë të shokëve tanë".

Atyre pak luftëtarëve shqiptarë, të cilët e patën fatin t'u shpëtonin vrasjeve dhe mizorive tjera që përjetuan gjatë dërgimit për në frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri, në Masakrën e Tivarit dhe në atë të Tregurit, kreu ushtarak shtetëror dhe

partiak i Jugosllavisë nga Beogradi, Podgorica, Shkupi dhe Prishtina, ua kishin përgatitur edhe një kurthë tjetër, këtë herë në Raguzë (Dubrovnik), por tash jo me armë zjarri, as me thika e bajoneta, as me fundosje në det, por me ngulfatje në gjumë, ku gjetën vdekjen 1340 luftëtarë shqiptarë!

Një takim pas 35 vjetëve

Martirëve të Tregurit ua morën jetën në moshën e tyre më të mirë. Emrat e tyre janë skalitur në një varr të përbashkët përkujtimor në varrezat e qytetit të Tregurit, varrezë e cila është ndërtuar në vitin 1979. Përveç emrave të tyre, në pllakën përkujtimore të varrit është skalitur në dy gjuhë, në kroatisht dhe në shqip, edhe ky mbishkrim:

"Përkujtimorja e luftëtarëve të rënë të Batalionit të Brigadës VII Kosovare, të cilët prej Kaçanikut, Kosovë, kaluan rrugë të gjatë deri në Trogir, nëpër Shqipëri dhe përgjatë bregdetit Adriatik, për t'iu bashkuar Armatës IV, që së bashku me luftëtarët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë, ta çlirojnë definitivisht vendin nga okupatori fashist dhe bashkëpunëtorët e tij, por tragjikisht humbën jetën në Trogir, në muajin prill të vitit 1945".

Këtë varrezë përkujtimore martirëve ua ngriti Këshilli Komunal i Lidhjes së Shoqatave të Luftëtarëve të LNÇ të Kaçanikut, në bashkëpunim me Këshillin përkatës të Tregurit.

Për ta zbuluar këtë varr, në Tregur kishin udhëtuar edhe familjarët e dëshmorëve; vëllezërit, bijtë, nipat dhe shokët e luftës. Ishte ky një takim mjaft emocional, i cili u bë pas 35 vjetëve të kaluara nga tragjedia. Kështu, simbolikisht i biri ishte takuar me të atin, i vëllai me të vëllanë, nipi me gjyshin ose me xhaxhanë, shoku me shokun e luftës e të vuajtjeve, të cilët vetëm vdekja i kishte ndarë.

E kemi takuar në vendin e ngjarjes plakun Nazmi Bushi, kur ai po i fshinte lotët. Na tregoi se kishte qenë edhe vetë pjesëmarrës i ngjarjes tragjike, se për në luftë në frontin e Adriatikut është nisur bashkë me vëllain e tij, Bajramin, kurse bashkë me të kanë qëndruar deri në fund, deri në mbytjen e tij në det. Por, fati e kishte dashur që vëllai i tij të mos kthehej më.

Pranë varrit përkujtimor qëndronin edhe Isa Bushi, Arif Dernjani e Xhemajl Koraçi. Të tretë etërit e tyre i kishin lënë në djep. Bile kur është ndarë i ati i Xhemajlit, Xhaviti, familja e farefisi i kishin thënë ta përqafonte edhe djalin në djep, por nga turpi prindëror ai këtë nuk e kishte bërë. Xhaviti, nga emocionet që kishte dhe nga "turpi" prindëror, vetëm e kishte shikuar foshnjën nga larg dhe ishte larguar me sy përtokë. Isa, Arifi e Xhemajli etërit e tyre i njohin vetëm në bazë të tregimeve të të afërmve dhe në bazë të ndonjë fotografie të rrallë, por edhe fotografitë u mungojnë.

Pse u zhvarrosën eshtrat e martirëve të tregurit?

Me qenë se qyteti i Tregurit gjatë

pasluftës ishte zhvilluar dhe zgjeruar, varrezat e martirëve kosovarë paraqiteshin si pengesë e tij. Prandaj, në marrëveshje edhe me Këshillin Komunal të Lidhjes së Luftëtarëve të Kaçanikut, në vitin 1979 ishte vendosur që varrezat të dislokoheshin. Këshilli i Luftëtarëve të Kaçanikut, në bashkëpunim me Këshillin e Tregurit, martirëve shqiptarë u ndërton një varrezë tjetër, por këtë herë një varrezë të përbashkët brenda varrezave të qytetit të Tregurit! Pra, eshtrat e 29 martirëve ishin bërë bashkë, ishin përzier dhe ishin lëshuar në një varrezë të përbashkët brenda varrezave të qytetit të Tregurit. Varreza me pllakën përkujtimore mbi të, në të cilën, siç thamë, janë skalitur emrat e 29 luftëtarëve të mbytur në det, është "përuruar" më 28 tetor 1979, me rastin e kremtimit të 35 - vjetorit të çlirimit të qytetit të Tregurit me rrethinë.

Është koha e fundit që eshtrat e këtyre martirëve të zhvarrosen edhe njëherë, në mënyrë që ato të sillen nga Treguri në Kosovë dhe përfundimisht të pushojnë në vendlindjen e tyre, në territorin e komunës së Kaçanikut. Këtë ne ua kemi borxh dhe këtë borxh duhet t'ua lajmë, gjithësesi!

Edhe disa pyetje për tragjedinë në tregur

Pyetjet që na imponohen t'i bëjmë për tragjedinë e Tregurit janë të shumta. Ja disa prej tyre:

- Pse eprorët ushtarakë, përgjegjës për "transportimin" e rekrutëve shqiptarë, kanë angazhuar anije aq të vogël, të vjetër dhe të papërshtatshme? Pse?!

- Pse në anije u futën 150 - 180 shqiptarë, të cilët tashmë ishin të uniformuar, të ngarkuar me armë dhe me pajime tjera ushtarake, kurse pesha totale e lejuar në anije ishte tejkaluar dy-tre fish më shumë? Pse?!

- Pse as eprorët dhe as njësitë ushtarake, të cilët kishin dhënë urdhërin për transportimin e shqiptarëve me ato anije, jo vetëm se nuk ndërmorën asnjë masë për shpëtimin e tyre, por ata nuk u dukën fare në momentin e fundosjes së anijes, nuk u angazhuan fare për dhënien e ndihmës e as që urdhëruan ushtrinë për ndihmë në shpëtimin e tyre, edhe pse me rastin e fundosjes së luftëtarëve shqiptarë, nga britmat e thekshme, nga klithjet dhe kërkesat për ndihmë, ishte bërë alarm i madh, kur për ndihmë me barka dhe mjete tjera kishin ardhë edhe shumë qytetarë të Tregurit. Ku ishin eprorët dhe njësitë ushtarake, përgjegjëse për kujdesin dhe transportimin e tyre, si dhe njësitë tjera ushtarake në qytet. Pse?!

- Pse nga organet e Armatës IV apo nga organet më të larta jugosllave nuk u dha komunikatë zyrtare për numrin e ushtarëve të fundosur, për numrin e saktë të luftëtarëve, të cilët humbën jetën, kurse për vdekjen e tyre nuk u informuan as familjet e tyre. Nuk u dha asnjë komunikatë zyrtare as për mënyrën e fundosjes, as për shkaqet e fundosjes dhe të shkatërrimit të anijes. Pse?!

- Pse asnjëherë nuk u prononcuan eprorët ushtarakë, të cilët i futën me

dhunë 150 - 180 ushtarë shqiptarë në një anije të vjetër, e cila vetëm pas largimit 20 - 30 metra larg bregut të kanalit, u shkatërrua tërësisht dhe luftëtarët shqiptarë, të cilët shkonin në front, u fundosën në valët e detit?! Pse?

- A ndikoi ardhja e qytetarëve të Tregurit të mos vriteshin të gjithë ushtarët shqiptarë?

Qartë shihet se ekzistonte një skenar dhe një kurthë, si shumë skenarë dhe kurthe tjera të përgatitura nga organet më të larta ushtarake - shtetërore dhe politike të Beogradit, Shkupit, Podgoricës dhe Prishtinës. Por, tash jo më me armë zjarri, me thika e bajoneta, por me një strategji të re, në heshtje, me fundosjen në valët e detit Adriatik.

PËRFUNDIM

MUNGESA E KUJTIMIT, E PADREJTË SA EDHE VDEKJA

Për qëndrim të padrejtë ndaj martirëve të kombit të rënë në Tivar, Tregur, Raguzë, përgjatë rrugës Prizren – Tivar etj., përgjegjësi morale mbajnë të gjithë, sepse, përveç vdekjes së padrejtë të tyre, nuk ju kemi siguruar as edhe përkujtimin e drejtë. Edhe kjo padrejtësi është e rëndë, sa dhe vdekja:

- ngase të gjithë luftëtarët e vrarë dhe të masa-kruar në këto masakra nga organet e shtetit ishin shpallur armiq të popullit dhe të pushtetit;

- masakra e Tivarit, e Raguzës dhe e Tregurit dhe vrasjet që rekrutët shqiptarë përjetuan gjatë dërgimit për në frontin e Adriatikut, nga Prizreni e deri në Istri, afër pesëdhjetë vjet ishin temë tabu. Persekutoheshin, jo vetëm ata që merrnin guxim të flisnin për këto ngjarje, por edhe prindërit dhe fëmijët e tyre,

- luftëtarëve shqiptarë të vrarë dhe të masakruar në Tivar, të fundosur në Tregur, të ngulfatur në Raguzë dhe të vrarë e të masakruar gjatë rrugës për në frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri, duke i konsideruar si armiq, me vendim të gjyqit të rrethit përkatës, u ishte konfiskuar tërë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme. Ja disa shembuj:

1. Avdi Hajrës, nga Pantina, i ngulfatur në Raguzë, i cili pas vetes kishte lënë bashkëshorten shtatzënë, të cilit në ndërkohë i kishte lindur djalë, gjyqi i rrethit në Vushtrri, me aktvendimin nr.128/45, e kishte shpallur armik të popullit dhe ia kishte konfiskuar tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme: tre hektarë tokë të punuar, një tufë me dele, një buallicë dhe një kishk (buallicë e vogël),

2. Behram Tahirit nga Pantina, i masakruar në Tivar, gjyqi i rrethit në Vushtrri ia kishte konfiskuar tre hektarë tokë të punuar, dy buallica, një lopë dhe 10 dele.

Ka edhe qindra vendime tjera të kësaj natyre nga vendet e ndryshme të Kosovës. Tërë pasuria e konfiskuar nga "armiqtë e popullit" i ishte dhuruar kooperativave bujqësore të asaj kohe,

- ata pak luftëtarë shqiptarë, të cilët patën fatin t'i shpëtonin këtyre masakrave dhe pas shumë mundimeve dhe sakrificave, duke u fshehur nëpër male e fusha të Malit të Zi dhe të Shqipërisë, janë kthyer në shtëpi, në vend të pritjes vëllazërore, u dënuan si armiq të popullit (dezertorë) me burg nga 12 muaj deri në tetë vjet. Ja disa shembuj, sa për ilustrim:

1. Çerkin Muharrem Qallaku, nga Dervari, me vendimin e Gjyqit të Qarkut në Mitrovicë, është dënuar me 8 vjet burg,

2. Avdi Hajra, nga Kopiliqi, me vendimin e Gjyqit Ushtarak në Shkup, është dënuar me 4 vjet burg,

3. Bajram Berisha dhe Hamit Kuçica (miq të shtëpisë së Avdiut), vetëm pse kishin shkuar për ta vizituar Avdi Hajrën pasi ai ishte kthyer në shtëpi si përjetues i masakrës së Tivarit, Gjyqi Ushtarak i Shkupit i kishte dënuar me nga katër vjet burg,

4. Fatime Jupa, e vetmja femër shqiptare e veshur me kostume burrash, e paraqitur si mashkull dhe me emër të mashkullit, DALLUSH e që shërbente në Armatën Jugosllave si mashkull, i kishte shpëtuar masakrës së Tivarit, por ishte dënuar me 12 muaj burg me punë të detyrueshme,

5. Ibish Shaban Muhaxheri, nga Qirezi, është dënuar me 6 vjet burg,

6.Ymer Ilaz Muhaxheri, nga Qirezi, është dënuar me 6 vjet burg.

Në mungesë të hapësirës përmendëm vetëm disa prej shumë luftëtarëve shqiptarë të dënuar si dezertorë, edhe pse dihen edhe dhjetra emra tjerë të luftëtarëve të dënuar në këtë mënyrë. Por, për këta njerëz, të cilët u vranë për fajin e vetëm pse ishin shqiptarë:

- deri sot nuk është mbajtur asnjë simpozium apo sesion shkencor për sensibilizimin dhe ndriqimin e këtyre masakrave,

- deri sot nuk është bërë asgjë për hulumtimin e varrezave apo për kthimin e eshtrave të këtyre martirëve në atdhe,

- deri sot nuk është bërë asgjë për ngritjen e ndonjë memoriali, të paktën të ndonjë lapidari, të bërjes së ndonjë filmi, të ndonjë dokumentari, të ndonjë skene teatrale apo diçka tjetër,

- fare pak, për të mos thënë aspak, këto masakra janë të pranishme në programet e shkollave fillore e të mesme, e të mos flasim për shkollat e larta e fakultetet,

- një pjesë të fajit e bartin edhe mjetet e informimit dhe inteligjencia shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri, sepse heshtën qe 60 vjet e po heshtin edhe sot.

Edhe pse kanë kaluar 60 vjet, ende nuk dihet zyrtarisht për varret e më shumë se 4300 shqiptarëve të masakruar në Tivar më 31 mars 1945, pastaj të mbi 1300 rekrutëve shqiptarë të

ngulfatur në Raguzë më 18 prill 1945 (një varrezë masive është zbuluar me rastin e renovimit të hotelit "Liberta" në Babin Kuk të Raguzës) dhe të mbi 800 shqiptarëve të likuiduar gjatë udhëtimit të kobshëm që nga Prizreni e deri në Istri.

Është detyrë parësore dhe obligim moral, kombëtar e politik që Qeveria e Kosovës të kërkojë nga Qeveria e Malit të Zi kërkimfalje për masakrat, të kërkojë identifikimin e varrezave masive ku prehen eshtrat e më të dashurve tanë, të kërkojë që eshtrat e tyre të kthehen në Kosovë, kurse në vendin e ngjarjes të ngritet një memorial apo së paku aty të vendoset një pllakë përkujtimore në tri gjuhë për të njoftuar opinionin e gjerë mbi këtë ngjarje tragjike të vitit 1945. Po ashtu Qeveria e Kosovës të kërkojë nga Bashkia e Raguzës që ajo të angazhohet për hulumtimin dhe identifikimin e varrezave tjera masive të luftëtarëve shqiptarë të ngulfatur në Raguzë më 18 prill 1945 nga serbo - malazezët, kurse në vendin e ngjarjes të ngritet një përmendore, apo së paku edhe aty të vendoset një pllakë përkujtimore.

E përmbyllim këtë rrëfim faktografik me thënien e Sami Mulës, historian e publicist nga Shqipëria, i cili duke e ndier thellë dhembjen për vëllezërit e vet nga Kosova, në një shkrim të tij të botuar në shtypin e Tiranës, më 30 shtator 1995, mes të tjerave, shkruan:

"O Azem Hajdini! Ke hyrë në jetën time dhe u bëre një me mua. Kaç lehtë do të më thuash: pa u parë, pa u përshëndetur, pa e pirë as gjakun e gishtit të njëri - tjetrit. Po, po, jam miqësuar e besatuar përgjithmonë me ty e me kujtimet e tua te "Tragjedia e Tivarit". Që atë ditë jam tjetër njeri, jam, si të thuash, edhe unë një Azem Hajdin, që kam provuar dhembje, tmerre e trishtim. Edhe unë jam Azem Hajdin, që kam provuar HESHTJE karshi kësaj vepre çnjerëzore, që mbanë peshën e një varri në jetën e çdo shqiptari.

Shpresoj se një ditë, megjithatë, bota (ah bota! S.M.) do ta kuptojë ndyrësirën ndoshta më të madhe (sikur të mbaronte me kaç. S.M.) gjatë luftës kundër shqiptarëve, të cilën populli e vajtoi si "VARR TË TIVARIT". Prandaj, u bëra edhe unë një dëshmitar i gjallë pranë teje e me ty. Të 4310 shqiptarët e masakruar nga serbët e malazezët në Tivar, djemë e burra të zgjedhur e të mobilizuar nga (…) e tërë Kosova dhe viset tjera etnike shqiptare më thërrasin mua: "Ku është gjaku ynë, ku prehen eshtrat tanë?! A janë përgjigjur gjakësit e vërtetë të këtij krimi të paparë në histori? A u ka rënë gjaku ynë? Po ata që i kanë mbyllur sytë dhe veshët, ata politikanë "memecë", që ndihmuan për realizimin e këtij skenari të turpshëm e varrosjen e gjatë e skutimin e këtij tmerri, gjëma e të cilit ndihet edhe sot! Ku vajtën e ku janë, pse heshtën e pse heshtin sot?! Përse në hartën e Shqipërisë rruga e mistershme e marshutës për në Tivar, që nis në Mitrovicë dhe ka vazhduar në Prizren, në Kukës, në Pukë, në Shkodër e në Tivar, nuk është hedhur me të zezë, ku çdo shqiptar e njeri të kuptojë të fshehtat e saj, pabesinë e tradhtinë e pashoqe, mashtrimin e madh e urre-

jtjen deri në palcë të shovinistëve serbo - malazezë, hartues e ekzekutues të këtij mbikrimi të paimagjinueshëm e mesjetar kundër shqiptarëve. Të paktën gjeodetët tanë, me këtë vijë të zezë (tej ligjeve të ndërtimit të hartave), t'i tregonin botës (së paku të asaj shqiptare) marshimin më të tmerrshëm të këtij shekulli me përmasa tej kufirit të skllavërisë, të 4700 shqiptarëve të lënë pa bukë, pa ujë e pa strehë, ndonëse në tokën e tyre mëmë, pranë bukës së tyre e krojeve të veta, nën kërcënimin e pusive, të kamxhikëve e bajonetave të "rojeve" - bisha, që ishin serbë e malazezë. "Mallkuar qoftë ky marshim, të mallkuar qofshin ata që e sajuan këtë marshim, të mallkuar qofshin ata që e lejuan këtë marshim".

Kurse, për ta arsyetuar Masakrën e Tivarit, para opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, organet shtetërore jugosllave atë e emërtuan: "BARSKA POBUNA"!!! (KRYENGRITJA E TIVARIT).

EDHE DISA FJALË PËR LIBRIN

Ky libër është i mbështetur në rrëfime tronditëse të përjetuesve të gjallë të masakrave e tragjedive të ndodhura në pranverën e vitit 1945, por edhe në të dhëna arkivore të kohës, në dëshmi të përjetuesve, në mesin e të cilëve është edhe autori i këtij libri. Prandaj, mund të themi se libri është edhe një dëshmi autentike e shumë tragjedive që përjetoi populli shqiptar në trojet e veta etnike dhe në hapësirat e veta gjeografike, është një dëshmi e njërës ndër periudhat më të zeza të historisë shqiptare. Poashtu, libri është dëshmi e krimeve më të rënda, e zezonës kundërshqiptare që bëri shovinizmi serb, malazez dhe maqedonas, që bëri politika jugosllave e "vëllazërim – bashkimit".

Ky libër ka për qëllim ta ndriqojë sadopak një periudhë të caktuar historike, të cilën, po të mos ishin dëshmitarët e gjallë, do ta mbulonte harresa njerëzore.

Ky libër do t'u hyjë në punë dhe do t'u ndihmojë, veçanërisht, historianëve dhe studiuesve tjerë për vërtetimin e ngjarjeve nga dora e parë, sepse libri është një kronikë e gjallë e ngjarjeve të asaj kohe, e ngjarjeve të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Ky libër për Masakrën e Tivarit, Tragjedinë e Tregurit dhe atë të Raguzës, si dhe mizoritë që rekrutët shqiptarë përjetuan nga Prizreni e deri në Istri, është një libër – dëshmi, e cila zbulon fytyrën e vërtetë të politikës demagogjike antishqiptare serbo - malazeze dhe maqedonase, përkatësisht jugosllave, e cila në opinion paraqitej me një propagandë të fuqishme gjoja për barazinë kombëtare, për zgjidhjen e çështjes nacionale etj.

Kurse kreu politik i Kosovës i heshti këto masakra plot pesëdhjetë vjet, madje edhe pas kërkesave tona drejtuar të gjitha instancave më të lar-

ta të ish - RSFJ-së, të Republikës së Serbisë dhe të ish – Krahinës Autonome të Kosovës?!

Prej asaj kohe, prej momentit kur kanë ndodhur masakrat, gjithnjë kam menduar se a do të mund t'i qes në letër të tëra ato mizori që kemi përjetuar dhe që më rrinë vazhdimisht në kokë, tërë atë urrejtje shoviniste e fashiste serbo - malazeze e maqedonase ndaj shqiptarëve duarthatë, bashkëluftëtarë edhe të koalicionit antifashist.

Besoj se më në fund ia arrita qëllimit tim fisnik e njerëzor, natyrisht, me ndihmën edhe të përjetuesve tjerë të gjallë; e nxora në dritë këtë libër, që do t'u shërbejë brezave të ardhshëm si dëshmi autentike për veprimet kaq të rënda kundërshqiptare.

Për fund kam nderin t'i falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan për ndriqimin e këtyre masakrave; asaj të Tivarit, të varrit më të madh të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të Raguzës, që kanë mbetur pa asnjë skelet dhe pa asnjë gjurmë krimi, që është specifik në historinë e njerëzimit, si dhe për ndriqimin e tragjedisë së madhe të rekrutëve shqiptarë në Tregur dhe gjatë deportimit për frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri.

Dua të falënderoj edhe me këtë rast institucionet e ndryshme shkencore, si dhe individët: Dr. Zekeria Canën, Dr. Hakif Bajramin, Berat Luzhën, Bedri Hysën, Hajro Ulqinakun, Dr. Agim Hysenin, Qerim Zariqin, Halim Xhemajlin, dhe firmën "UNIO COMMERCE" – Hani i Elezit me pronar Zelqif Berishën, etj. Posaçërisht falënderoj përjetuesit e masakrave, të cilët përmes deklaratave, informatave, prezantimeve e rekomandimeve të tyre, ndihmuan që ta kompletojmë këtë libër me ngjarje të dhimbshme.

Nuk mund të mos i përmendi dhe të mos i falënderoj edhe Prof. Jahir Deliun me familje dhe Mon Beqirin, gazetar, të cilët në ditët më të vështira për mua dhe për familjen time, materialet, si: Masakra e Tivarit, Tragjedia e Raguzës dhe ajo e Tregurit, por edhe materialet për mizoritë që përjetuan rekrutët shqiptarë gjatë deportimit për në frontin e Adriatikut, që nga Prizreni e deri në Istri, pastaj materialin "Lëvizja Antifashiste Demokratike për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar" dhe materiale dhe shënime të tjera i fshehën për të mos rënë në duart e UDB-së. Këto materiale i kemi tërhequr nga shtëpia ime dhe ata i kanë strehuar, me ndihmën e familjes Delia nga fshati Javor, në malet e Kleçkës, në rrënjët e një druri të madh të ahut, kurse materialet e përmendura dhe disa gjëra tjera atje qëndruan një kohë të gjatë.

Çdo plotësim, rekomandim apo vërejtje nga Ju, lexues të nderuar, do të ishte e dobishme për ndriqimin objektiv, shkencor e historik të përmbylljes së këtij libri në ndonjë botim të ardhshëm. Vërejtjet tuaja për librin do të ishin tejet të mirëseardhura, sepse do ta plotësonin zbardhjen e plotë të këtyre krimeve kundër shqiptarëve duarthatë, të cilin bota e civilizuar do ta quante MAGNA - KRIMEN.

BURIMET DHE LITERATURA

a) BURIMET E LËNDËS

Bajrami, dr. Hakif: Tragjedia e Tivarit, Prishtinë, 1993

Bajrami, dr. Hakif: Dromca tragjike nga historia jonë kombëtare, me rastin e 83 vjetorit të Pavarësisë, "Dituria islame" nr.75, Prishtinë, dhjetor 1995

Berjashi, Ibrahim: Buka e shpëtimit, "Bujku", Prishtinë, 15 qershor 1991

Bozhoviq, Branislav; Vaviq, Branko: Surova vremena na Kosovu i Metohiju 1941 - 1944, Beograd, 1991

Braha, Shaban: Gjenocidi serbomadh dhe qendresa shqiptare 1844 - 1990, Tiranë, 1991

Cana, dr. Zekeria: Masakra më e madhe mbi shqip-tarët në vitin 1945, "Bujku", Prishtinë, 20 shtator 1990

Cana, dr. Zekeria: Lot malli dhe brenge; Ditari I. "Bujku", Prishtinë, 20 shkurt 1997

Dedijer, Vladimir: Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita, vll.II. Rijeka, Zagreb, 1981

Dobra, dr. Islam: Lufta e Drenicës 1941-1945, Prishtinë, 1995

Dobra, dr. Islam: Lufta e Drenicës 1941-1945 dhe NDSH deri në vitin 1947 (Botim i dytë i plotësuar), Prishtinë, 1997

Gola, Bajram: Rishqyrtime të disa ngjarjeve nga LNÇ (fejton), "Flaka e vëllazërimit", Shkup, shkurt - mars 1997

Hajdini, Azem: Tragjedia e Tivarit, Shtutgard, 1990

Hajdini, Azem: Tragjedia e Tivarit, SHBP, Prishtinë, 1998

Hajdini, Azem: Tragjedia e Tivarit (fejton) "Flaka e vëllazërimit", Shkup, nëntor 1997

Hajdini, Azem – Xani: Masakra e Tivarit, SHBP, Prishtinë, 1998

Luzha, Berat: Artikuj për Tragjedinë e Tregurit, Rilindja, 1979/1980

Mula, Sami: Në kalendarin e shqiptarëve mungojnë datat e Tivarit, Tiranë, 30 shtator 1995

Pirraku, dr. Muhamet: Ripushtimi jugosllav i Kosovës në vitin 1945, Prishtinë, 1992

Pirraku, dr. Muhamet: Kalvari i shqiptarësisë së Kosovës - Tivari 1945, Prishtinë, 1983

Rexhepi, dr. Fehmi: Gjenocidi sllav mbi shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (fejton), "Bujku", Prishtinë, prill 1995

Srbija i Albanci III: Pregled politike Srbije prema Albancima od 1944 do 1989, Maribor-Lubljanë, 1998

Vjetari nr. XVIII, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1984

b) REVISTA DHE GAZETA

Bota Sot (disa fejtone)

Fjala jonë, nr. 12, Prishtinë, dhjetor 1995

Zëri, Prishtinë, 16 dhjetor 1995

Zëri i Popullit, nr.157, 12 dhe 13. VII. 1991, Tiranë

Rilindja, 14. IX. 1980

(Azem Hajdini - Xani: *Nga Prizreni në Istri një sprovë për histori* (Kujtime dhe dëshmi, pranverë 1945), botues: Shoqata e të Burgosurve Politike e Kosovës, Prishtinë, 2007)

DIJA

Revistë vjetore për shkencë, kulturë, art
nr. 6/2008, viti VI
del një herë në vit

E boton
BASHKIMI I KRIJUESVE SHQIPTARË NË MAL TË ZI
ULQIN
Është themeluar më 12 nëntor 2002 në Ulqin
kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Kontakt:
E-mail: bkshmz@yahoo.com

U shtyp
Shtypshkronja PRESS STUDIO
ULQIN, 2008

Tirazhi
300 copë